

# *Zytetërimi i virtyteve*

*Nga epoka e lumturisë deri në ditët tona*

Osman Nuri TOPBASH



**PROGRESI**  
BOTIME





Shkodër, 2010

Titulli i origjinalit turqisht:

Asr-ı saadet'ten günümüze  
Faziletler Medeniyeti

Osman Nuri TOPBASH

ERKAM YAYINLARI  
İSTANBUL 2006

Përktheu nga origjinali:  
Fatmir SULAJ  
Burrel - 2009

Redaktoi:  
Shpëtim KELMENDI



**PROGRESI** sh.p.k

---

Adresa:	L: Vasil Shanto Rr: Çajupi	Shkodër / Shqipëri
Tel:	+355 22 25 46 34	Fax: +355 22 25 46 33
Mob:	+355 69 20 76768	Mob: +355 67 20 86767
Htp:	www.progresibotime.com	e-mail: botime@progresibotime.com
Design:	Ilir Hoxha	

---

Adresa Kosovë:	Rr: Ardian Zurnaxhiu / pn. Ralin / Prizren	
Tel:	+381 29 222 795	Fax: +381 29 222 797
		e-mail: kosova@progresibotime.com

---

Adresa Maqedoni:	Rr: Stiv Naumov / nr. 9 / lokal 25 / Shkup	
Tel:	+398 71 956 271	e-mail: maqedoni@progresibotime.com

# *Zytetërimi i virtyteve*

*Nga epoka e lumturisë deri në ditët tona*

Osman Nuri TOPBASH



## PARATHËNIE

*Falënderimet dhe lavdërimet e pafundme qofshin për Allahun Teala i cili e lartësoi botën e krijesave dhe veçanërisht vlerën e njerëzisë me Pejgamberin (s.a.v.s), përveç kësaj, Ai i cili duke u betuar në jetën e të Nderuarit të gjithësisë, e bëri Atë burim të dinjitetit dhe të nderit e na lumturoi edhe ne që na bëri ummet të tij!*

*Bekimi dhe paqja qofshin për Hazretin Muhammed Mustafanë Sulltanin e Pejgamberëve, i cili është mëshirë dhe bereqet për të gjithë botërat, i cili lartësoi moralin me cilësi virtyti të panumërta dhe i cili kishte një personalitet që na paraqitet si shembull i përhershëm e i pashoq për njerëzimin!*

Njeriu, për të cilin çfarë ka në tokë dhe qiell është nën urdhërin e tij, para së gjithash duhet të jetojë në përputhje ndaj mirëprirjes hyjnore. Kjo rrugë kalon nga një adhurim i mbushur me virtyt dhe fisnikëri. Thelbi i këtij adhurimi është “**mekarim-i ahlak**”, domethënë një moral i lavdëruar, i lartë dhe i stolisur me sjelljet më të bukura...

Po ashtu, edhe Pejgamberi jonë (s.a.v.s), duke thënë: “*Unë nuk jam dërguar me ndonjë qëllim tjetër, përveç se për të plotësuar moralin e lartë*” (Muvatta, Husnu'l-Hulk, 8), e tregoi urtësinë themelore të detyrës së tij dhe theksoi rëndësinë e moralit të bukur. Me të vërtetë, psre nga çdo aspekt, të gjitha gjendjet e Pejgamberit tonë (s.a.v.s) janë ekspozimi i shembujve të lartë të cilësive dhe të bukurive. Ashtu që Allahu e vërtetoi këtë realitet duke thënë:

“(O i Dërguari im!) **Me të vërtetë Ti je mbi një moral të lartë!**”.

Për këtë arsye, i Nderuari ynë (s.a.v.s) nuk ishte një mësues që ua



mësonte Kur'anin Kerim vetëm me fjalë, por ka jetuar në një gjendje Kur'ani të gjallë, dhe si një shpjegues udhëzimi ua mësonte të vërtetat hyjnore me vepra. Për këtë arsye jeta e tij e dashur dhe e bekuar u bë shembulli më i bukur për brezat që do të vijnë, deri në kiamet.

Me të vërtetë, me nderimin e lartë të asaj Qënie, horizontet e zeza të botës u mbytën në atë dritë, lindi një mëngjes i ri lumturie që njerëzimi e priste, zemrat u ndriçuan, mendimet u thelluan, horizontet e largpamësisë u hapën. Së fundi, ai e dërgoi njerëzimin te nderi dhe dinjiteti i tij i vërtetë, te mirësi-bamirësia, te Zoti, te drejtësia dhe te virtyti. Ai ua mësoi të fshehtë të jetës dhe të amshimit (përjetësisë).

Për shkak se pas Tij nuk do të vijë Pejgamber tjetër deri në ditën e kjametit, për çfarëdolloj bukurie dhe veçorie që të ketë nevojë njeriu, i janë dhënë personalitetit të tij të lartë. Nga ky aspekt, të gjitha bukuritë janë lartësuar te Ai. Në këtë mesatare:

Kulmi i dashurisë është Ai. Kulmi i heroizmit është Ai. Kulmi i durimit dhe vendosmërisë është Ai. Kulmi i bujarisë, i sakrifikimit dhe i altruizmit, është Ai. Kur përpara tij iu parashtruan pasuri të mëdha dhe mirësitë e botës, kulmi i asketizmit, i devotshmërisë, i bindjes dhe modestisë mbeti Ai. Kulmi i mëshirës, i butësisë dhe i ndihmës për nevojtarët është Ai. Kulmi i sinqeritetit dhe devotshmërisë është Ai. Kulmi i gjendjes së kënaqësisë dhe falenderimit është Ai. Kulmi i njohjes së Zotit, i diturisë, i bamirësisë dhe i mirësisë është Ai. Kulmi i profetësisë është Ai. Kulmi i edukimit, i mësimin, i fisnikërisë hyjnore dhe i arsimimit është Ai. Kulmi i drejtësisë dhe besnikërisë është Ai. Kulmi i të qenit mik dhe i dashuri i Zotit është Ai. Imami i tubimit në ditën e kiametit është Ai. Ndërmjetësuesi i mëkatarëve është Ai. Së fundi, kulmi i çdo virtyti, morali dhe shërbimi, domethënë kulmi i adhurimit më të përsosur është vetëm Ai.

Sepse morali i bukur, i përbërë nga karakteri i mirë, sjellja dhe virtytet me të cilat Zoti është i kënaqur, iu transmetua njerëzisë me gjuhën e bekuar dhe zbatimin e Pejgamberit tonë (s.a.v.s). Modelin “njeriu i përsosur” që ka dashur me Islamin, Zoti e ka shfaqur te personaliteti i Hazretit Pejgamber (s.a.v.s), të cilin e bëri një personalitet shembull për të gjithë njerëzimin.

Kështu që fjalët dhe principet e Hazretit Pejgamber (s.a.v.s) janë bërë sistem shembujsh më të përsosur që praktikisht jetoreshin edhe





në jetën e tij, edhe në jetën e ummetit të tij që do të vazhdojë deri në kiamet.

Sikundër kësaj, shumica e mendimeve të hedhura në emër të moralit, paqes dhe prehjes shoqërore nga filozofët, mendjet e të cilëve nuk janë edukuar me shpallje, pozitive a negative qofshin ato, kanë ngelur në librat e vendosur në raftet me pluhur të bibliotekave. Jeta e atyre mendimeve që janë transmetuar në jetë ka zgjatur shumë pak. Në fakt, atë që kanë thënë, këta filozofë nuk kanë mundur ta bëjnë shembull as në jetën e tyre dhe as te njerëzit e tjerë. Mendimet e tyre kanë ngelur vetëm në teori.

Për shembull, nuk është parë ndonjë njeri që të ketë besuar në filozofinë e Aristotelit, i cili ka hedhur me veprën e tij themelin e disa ligjeve dhe rregullave të filozofisë së moralit, dhe pasi t'i ketë hedhur në jetë ato parime të ketë arritur lumturinë, sepse Aristoteli nuk është mbështetur në shpalljen hyjnore. Po ashtu, edhe libri më i rëndësishëm i Farabiut në të cilin ai shprehu mendimet e tija imagjinative rreth “qytetit të bukurisë dhe shoqërisë ideale”, nuk mundi të ketë asnjë mundësi për praktikim dhe ata mendime nuk mundën të dilnin jashtë rreshtave të librit, sepse këta, siç nuk janë shkruajtur dhe thënë duke u jetuar, edhe pasi u shkruajtën, nuk mundën të kishin veçori për t'u jetuar.

Por Hazreti Pejgamber (s.a.v.s), para se të fillonte detyrën e misionit të tij, ia bëri gjithkujt veten e tij të dashur dhe personaliteti i tij nxori ne pah një përsosmëri që e bënte të nevojshme thënien e popullit

“Ti je Besniku dhe i Sinqerti” dhe ai, pas paraqitjes se një identiteti të tillë, filloi predikimin e tij.

Ja, kështu, më moralin e tij të lartë dhe edukimin e tij shpirtëror, u formuan shekuj dhe breza të tërë dhe njerëzimit iu paraqit një “Epokë Lumturie”. Karafi, i cili është nga figurat më të rëndësishme të metodologjisë së jurisprudencës Islame, ka thënë:

“Sikur Profeti (s.a.v.s) të mos kishte asnjë mrekulli tjetër, mjafton fakti që ka edukuar sahabët për të vërtetuar profetësinë e tij”.

Vetvetja, fjala dhe çdo gjendje e Pejgamberit (s.a.v.s) ishin të formuara nga kthimi në vepër i komentimit të moralit të bukur, që ishte i fshehur në Kur'anin fisnik nga fillimi në fund. Të gjithë shembujt më të përsosur dhe të lartë të virtyeteve të tij ishin paraqitur në jetën e tij.

Vepra më e madhe e artit të Zotit është njeriu. Kulmi i njerëzisë në përsosmërinë shpirtërore është Hazreti Pejgamber (s.a.v.s). Zoti, ashtu siç e ka pranuar dhe e ka shfaqur bindjen ndaj Pejgamberit si bindje ndaj Tij, edhe mosnënshtrimin ndaj Pejgamberit (s.a.v.s) e ka pranuar dhe shfaqur si mosnënshtrim ndaj Tij.

Në ajetin fisnik thuhet:

**“(O i dërguari Im!) Thuaj: Nëse e doni Allahun, më ndiqni mua ashtu që edhe Allahu t’ju dojë ju dhe t’ju falë mëkatet tuaja. Allahu është shumë falës dhe shumë mëshirues”.** ( Ali Imran, 31)

Sipas kësaj, të gjitha lavdërimet janë të lejuara për Pejgamberin tonë, me kusht që mos të arrihet në shirk. Ndërsa lavdërimi i tij reflekton në gjuhë vetëm aq sa mund ne ta konceptojmë atë.

Në krye të atyre që e konceptojnë në formën më të bukur (brenda fuqisë njerëzore) të dërguarin e Allahut, që është kulmi i një arti fantastik të Zotit tonë dhe nga i cili na transmetuan gjurmë, vijnë sahabët fisnikë.

Me të vërtetë, bukuritë e të dërguarit të Allahut (s.a.v.s) në adhurim, marrëdhënie, veprime, por dhe hallka e virtytit të parë në detyrë për të transmetuar te brezat e ardhshëm, janë këta njerëz të bekuar të cilët u nderuan me kuvendin e Tij. Për këtë arsye, Pejgamberi (s.a.v.s) ka treguar se *“ata janë si yjet në qiell”*.

Duke marrë mësim nga morali profetik i të dërguarit të Allahut (s.a.v.s), sahabët fisnikë që konceptuan se bukuria origjinale që i përket njeriut është në lidhje me të mirat që ka dërguar në ahiret, për hir të Allahut kanë shfaqur bujari, altruizëm dhe virtyte që nuk arrihen në shkallën e sakrifikimit. Ata i bënë jetët e tyre shembull për hir të Allahut, dhe duke u thelluar në mëshirë e butësi e lartësuan Zotin në shpërndarjen e ndjeshmërisë. Nga ai brez i bekuar, në çastet më të dëshiruara dhe më kuptimplota të jetës, brenda emocionit të një besimi të madh, pati disa kohë që iu qe dërguar njerëzimit mesazhi i njësimi.

Pas brezit të sahabëve, po ashtu të gjithë miqtë e Allahut që formojnë një zinxhir deri në ditët e kiametit, duke qenë se ishin ndjekës në një mënyrë të bukur të ligjeve të atyre u lartësuan në të vërtetën me bereqetin e begatisë nga dielli i virtytit të të dërguarit të Allahut (s.a.v.s).



Sa bukur e shpreh këtë gjendje Hazreti Mevlana:

“Eja o zemër! Festa e vërtetë është takimi me të nderuarin Muhammedin, sepse ndriçimi i botës është nga drita e bukurisë së asaj genie të bekuar.”

“Verasetu'l-enbija” domethënë miqtë e Allahut, dijetarët dhe të zgjuarit, që arritën të kenë nderin të jenë trashëgimtarë të Pejgamberit, janë kulmet e përsosmërisë së udhëzimit dhe sjelljes profetike të shpërndara nëpër kohë. Domethënë edhe ata janë pjesë e udhëzuesve të virtytit vepror dhe konkret për të gjithë njerëzit që nuk mundën ta kenë nderin për të parë Hazretin Pejgamber (s.a.v.s) dhe ashabët e tij.

Së fundi, në esencën e harxhit të virtytit që ngjall zemrat, padyshim që së pari janë Pejgamberët. Edhe në mihrabin e rreshtave që kanë krijuar ata, zë vend sulltani i pejgamberëve, i nderuari Pejgamberi ynë (s.a.v.s). Ndërsa më vonë, rreshtat dhe hallkat e virtytit janë dijetarët e sinqertë, robërit e devotshëm, të diturit, të dashurit etj., sipas shkallëve të afrimit në lidhje më ta. Ata janë fytyra të zgjedhura mes njerëzve, për shkak të përjetimit të bukur në adhurim dhe në mirësi. Përsëri ata, ngaqë e kanë jetuar me sinqeritet atë që është gjithmonë e bukur, kanë dhuruar rreth e rrotull kujtime të çmueshme në bukuri që kurrë nuk bëhet e kaluar, dhe kështu kanë formuar një **“Qytetërim të Virtyteve”**. Historitë e virtytit që janë transmetuar nga ata, u japin shpirtërave qetësi dhe rehati, ndërsa zemrave të sëmura u dhurojnë shërim.

Për këtë arsye, edhe për vetë Kur'anin fisnik i cili ka ndjekur një metodë për të kujtuar historitë rreth virtytit, imam Azami Ebu Hanife ka thënë:

“Historitë që tregojnë bukuritë e dijetarëve të devotshëm më duken më të dashura se sa shumica e fikhut, sepse këto histori na mësojnë ne edukatën dhe moralin e atyre që afrohen te Zoti”.

Në të vërtetë njeriu nuk mund të kuptojë një çështje në plotësinë e saj, pa qënë një shembull. E mira dhe e keqja qartësohen vetëm në dritën e shembujve. Dashuritë me shembuj vijnë në një gjendje më të gjallë dhe më emocionale. Të mbështillesh ndaj të dashurit, kjo realizohet me shembujt e bukur që reflektohen nga ai. Me këtë prestigj shembujt e bukur janë fate hyjnore që e dërgojnë njeriun te fisnikëria dhe dinjiteti i tij i vërtetë.

Po ashtu edhe Hazreti Malik bin Dinar thotë:

“Historitë e bukura të robërve të devotshëm janë pothuaj si dhuratat e xhennetit”.

Për këtë arsye, çdonjëra nga historitë e virtytit ka vlerën e një perle shumë të shtrenjtë që na është bërë dhuratë ne.

Shkurtimisht, e gjithë çështja është të zbatojmë moralin e bukur dhe virtytet. Po ashtu, i Nderuari ynë (s.a.v.s) thotë:

*“Në ditën e kiametit, në peshoren e besimtarit nuk gjendet asnjë gjë më e rëndë sesa morali i bukur. Allahu Teala nuk e do një person që bën lëvizje të shëmtuara dhe që thotë fjalë të këqija”.* (Tirmizi, Birr, 62/2002)

Pa dyshim që themeli i moralit të bukur kalon nga të qënit mik i Hazretit Pejgamber (s.a.v.s) dhe i robërve të devotshëm që ecin në gjurmët e tij. Ky është kushti i parë i kapjes ndaj hallkës së virtyteve. Ndërsa të shkatërrohesh në vorbullën e hutimit duke humbur miqësinë me ta, formon themelin e moralit të keq. Po ashtu, duke anuar nga kjo e vërtetë, në hadithin kudsî Zoti thotë:

*“Nëse dikush i bën armiqësi një mikut Tim (që më bën mua adhurim me sinqeritet), edhe Unë shpall luftë ndaj tij. Robi Im nuk mund të fitojë afrim ndaj Meje me çdo lloj gjëje të dashur, përveç gjërave që i kam bërë farz atij. Robi Im më afrohet Mua pa pushim me adhurime nafîle (që i ka bërë shtesë ndaj farzeve). Së fundi, Unë e dua atë. Kur e dua robin Tim, pothuajse Unë bëhem vesh i tij që dëgjon, syri i tij që sheh, dora e tij që kap, këmba e tij që ecën, zemra e tij që ndjen dhe gjuha e tij që flet. Çfarëdo që të kërkojë prej Meje, Unë patjetër ia jap. Nëse kërkon mbrojtje te Unë, e mbroj atë. Unë, në diçka që do të bëj, nuk kam rënë në hezitim si në mëdyshjen e marrjes së shpirtit të robit Tim besimtar<sup>1</sup>, (Sepse) ai nuk e do vdekjen, edhe Unë nuk e dua diçka që nuk e do ai”.* (shik. Buhari, Rikak, 38; Ahmed, VI, 256; Hejsemi, II, 248)

Për të fituar vitytet e larta që do të na bëjnë të pranueshëm te Zoti, duke ushqyer dashuri nga shpirti dhe zemra, është e nevojshme të jemi ndjekës të miqve të Zotit dhe Pejgamberit (s.a.v.s) të cilët po-

1. Zoti është larg nga cilësitë njerëzore si të rënit në mëdyshje. Ndërsa fraza këtu është përdorur për t'ia bërë të qartë perceptimit tonë njerëzor, vëmendjen dhe përkujdesjen që ka ndaj robit të cilin do.



thuaje ishin flutura rreth tij.

Për këtë arsye, duhet ta njohim të Nderuarin tonë alejhissalatu uesselam nëpërmjet asaj që i përshtatet edhe nëse nuk është në shkallën e të shikuarit dhe, duke i jetuar dhe marrë si shembull karakteret e larta që ishin të lavdëruara te Zoti, shpresojmë se Zoti do të bëjë të mundur të fitojmë nderin për të qenë nga “vëllezërit” që ka përgëzuar Hazreti Pejgamber (s.a.v.s).

Nëse ne e njohim atë Atë, edhe Ai na njeh neve nesër në mahsher. Nëse jemi në shkallën për ta parë Atë, edhe Ai na jep shikim. Nëse e dëgjojmë Atë dhe nëse e mbajmë fjalën e tij, edhe ai e dëgjon vuajtjen tonë dhe na kap ne për dore. Kështu ne vijmë në gjendjen e vendpamjes së cilësisë për të qenë shëmbull i bukur i Tij. Ky është virtyti më i madh për të gjithë ne.

Edhe kjo vepër e thjeshtë që keni në dorë është shkruajtur në lidhje me shembujt e virtytshëm në këtë kornizë. Së pari, këta shembuj të virtytshëm formohen nga shembujt e shkëlqyer që ishin në personalitetin e lartë të Hazretit Pejgamber (s.a.v.s), pastaj nga sjelljet shembullore të ashabeve, miqve të Zotit, dijetarëve dhe të devotshmëve, çdonjëri prej të cilëve ishte një pasqyrë e pastër e atyre shembujve të bukur.

Veçanërisht, duke mos u mjaftuar vetëm me tregimet e pejgamberëve dhe të miqve të Zotit që ecnin në rrugën e devotshmërisë, herë-herë jemi munduar të përmendim edhe shumë shembuj sjelljesh të virtytshme që kanë realizuar personalitetet historike, të cilët ishin të preokupuar brenda ngjarjeve administrative dhe shoqërore dhe të luftëtarëve që i japin drejtim botës. Ashtu që edhe ata që janë implikuar dhe do të implikohen porsia ata në ngjarje administrative dhe shoqërore, të gjejnë shembujt e sjelljeve ideale që u nevojiten.

Sigurisht, për ne të pafuqishmit është shumë e vështirë ta shpjegojmë në mënyrë të përshtatshme Sulltanin e të Dy Botërave, të Nderuarin tonë (s.a.v.ss), te personaliteti i tij i lartë i të cilit ishin mbledhur të tëra hallkat e të gjithë virtyteve, prej nga ku qenë shpërndarë më pas te të virtytshmit e tjerë. Në fakt, edhe qëllimi ynë nuk është që ta shpjegojmë Atë ashtu siç është, por vetëm që të shijojmë një pikë nga deti i begatisë së tij të pafundme, që të mund t'i afrohemi Atij edhe nje hap, që të përtërijmë dashurinë dhe përzemërsinë që kemi



ndaj Tij, të shfaqim besnikërinë tonë, të vrapojmë për te mëshira e tij e pafund dhe të strehohemi te ndërmjetësimi i tij...

Falenderimet i takojnë Allahut që na nderoi falas ne robërit e dobët, domethënë pa paguar ndonjë kundërvlerë, për të qënë ummeti i të Nderuarit tonë të Dashur dhe Bujar (s.a.v.s). Duke arritur të vërtetën e kësaj mirësie hyjnore, rruga e vetme për të qënë i përshtatshëm ndaj dashurisë së Rasulullahut (s.a.v.s) dhe lavdërimit të tij “vëllezërit e mi”, kalon nga të kapurit shumë pas Sunnetit Senijje të tij dhe nga të qenit të pajisur me moralin profetik (aq sa të kemi mundësi) si miqtë e Allahut që janë trashëgimtarët e tij.

Për këtë arsye, edhe në ditët tona, duke u mbushur me dashurinë e Rasulullahut (s.a.v.s) si sahabet dhe miqtë e Allahut, jemi të detyruar që të mësojmë moralin e lartë të Tij. Edhe pse kanë kaluar shekuj, duke i jetuar bukuritë e tyre që asnjëherë nuk do të vjetërohen dhe nuk do të veniten, duhet të mundohemi t'i përjetojmë, sepse kjo është kundërvlera e përshtatshmërisë së nderit dhe lumturisë për të qënë ummeti i vërtetë i të Nderuarit tonë (s.a.v.s).

Në përgatitjen e kësaj vepre që kemi botuar me ndjenja dhe mendime, së pari falenderoj Murat KAYA-në dhe të gjithë vëllezërit tanë akademikë, të cilët kanë bashkëpunuar, dhe lus Zotin për pranimin e përpjekjeve të tyre si një sadaka-i xharije.

Allahu na e bëftë rizik të gjithëve të jetojmë një jetë me sjellje të bukura, që do të jenë shkak për kënaqësinë e Tij, dhe të jemi të begatuar me shembujt e virtytshëm. Na bëftë miq të afërm të të Dërguarit të Tij në të dy botërat dhe na bëftë prej atyre që fitojnë ndërmjetësimin e madh të Tij.

Amin!..

Osman Nuri TOPBASH  
Maj 2006  
YSKYDAR

*Djesa e parë*



*Besimi  
adhurimi*





## 1. Përjetimi i besimit me dashuri

Besimi është drita e mendjes, zbukurimi i ndërgjegjes dhe harmonia e ndjenjave të zemrës. Kalimi nga kjo botë e përkohshme për te bota e përhershme është i mundur vetëm me udhëzimin e besimit.

Ndërsa udhëzuesit e besimit janë pejgamberët, librat hyjnorë dhe miqtë e Zotit, të cilët e kanë ndërtuar jetën shpirtërore të tyre mbi drejtimin që kanë treguar ata. Përgjatë historisë, pejgamberët, miqtë e Zotit dhe të devotshmit janë bërë shembuj të gjallë të shfaqjes së virtuteve që mund të jetohej vetëm me entuziazmin e besimit.

Besimi është një mirësi hyjnore. Sprovimi është një peshore që mat vërtetësinë e besimit. Ndërsa durimi që pritët nga besimtari dhe mbrojtja e besimit me nënshtrim është në vlerën e shkëmbimit të fitimit të shpërblimeve hyjnore. Domethënë Allahu Teala, për ta bërë të kuptueshme madhështinë e mirësisë së besimit që ka dhënë dhe vlerën e tij (e besimit), pothuajse kërkon një kundërvlerë nga robërit e tij.

Edhe ajeti fisnik: **“Me të vërtetë Allahu bleu nga besimtarët shpirtërat dhe pasuritë e tyre, sepse (si kundërvlerë e kësaj) atyre do tu jepet xhenneti”** (et-Teube, 111) është një dëshmi e qartë e kësaj të vërtete.

Për këtë arsye, të fitosh kënaqësinë hyjnore dhe të sakrifikosh me dëshirë në rrugën e Zotit shkëmbimet që ka dashur Ai (shpirtin, pa-



surinë, pronën etj.), është shkak për përsosmërinë e besimit.

Të kaluarët kënaqësi dhe nënshtrim të të gjitha mundimeve, vësh-tirësive dhe provave të jetës dhe ecja në rrugën e Allahut dhe të të Dërguarit të tij, përbëjnë shenjën më të rëndësishme të besimit për besimtarët. Çdo besimtar është i detyruar t'ia paguajë Allahut kundër- vlerën e mirësisë së besimit, sepse të pohosh pronësinë e diçkaje pa iu paguar kundërvlera, ose të kërkosh shpërblimin e një kundërvlere të papaguar, është preokupim për diçka të kotë.

Fitimi i ngritjes së besimtarit drejt kulmeve të besimit është në lidhje me atë që i themi *punë e devotshme*, me nijetin që është bërë synim kënaqësia e Allahut dhe me bukuritë e adhurimit e të sjelljeve. Për këtë arsye, besimi dhe puna e devotshme në Kur'an dhe në hadi- thet fisnike, në përgjithësi janë përmendur bashkë. Besimi nuk jetohet me të dhëna të thata dhe as me teori, por me të vërteta që ndjehen, që gdhenden në zemër dhe si rrjedhim reflektohen te sjelljet. Besimtari, në rezultatit e meditimit të rrjedhjeve të fuqisë hyjnorë në botë dhe në kryerjen e adhurimeve që u përshtatet me drejtimin e shpirtit, e shijon kënaqësinë e besimit të vërtetë dhe bëhet i suksesshëm në jetën e tij ndaj shfaqjeve të panumërta plot virtyt.

Besimi është më i lartë se të gjitha adhurimet, sepse adhurimet pranohen vetëm me besim. Adhurimet kryhen në një kohë të caktuar. Edhe namazi, që është nga adhurimet më të virtytshme, është farz pesë kohë në ditë. Ndërsa besimi, ngaqë gjithmonë është farz, duhet që çdo çast ta mbajmë të gjallë në zemrën tonë. Për këtë shkak, është e domosdoshme që të largohemi nga çdo gjë e kësaj bote që e shtyn zemrën në hutim dhe ta mbrojmë besimin tonë me punë të devot- shme, të cilat kanë pothuajse vlerën e një parzmoreje shpirtërore.

Xhevahiri i besimit është kapitali më i vlefshëm i besimtarit. Në Ajetin fisnik, shejtani i cili është deklaruar si një armik i hapur i joni, bashkë me ndihmëtarët e tij, përpiqet me ëdo kusht që me lloj-lloj hilesh dhe tundimesh të vjedhë xhevahirin e besimit nga zemrat besim- tare. Nga ky aspekt, duke qëndruar në vigjilencë shpirtërore, mbësh- tjellja e besimit tonë me një dashuri të madhe e dëshirë të zjarrtë dhe mbrojtja e tij në një mënyrë të patundshme me punë të devotshme,



është detyra jonë më e rëndësishme.

Për ta bërë xhevahirin e besimit si një pasqyrë e pastër dhe ndriçuese që reflekton ndaj shfaqjeve të Zotit, bsimtari ka nevojë për “përkujtimin e Allahut”. Kështu, përkujtimi i Allahut është gdhendja me dashuri dhe dëshirë e fjalës “**Allah**” në kutinë (vendin e ruajtjes) e zemrës. Për këtë arsye, ndryshku i gjërave të botës dhe i hutimit fshihet nga zemra edhe për shkak se zemra arrin një qetësi të plotë dhe siguri, g jendje në të cilën ndjehet shija e vërtetë e besimit.

Gëzimi i besimit të robërve të begatë dhe të veçantë që kanë arritur këtë pjekuri shpirtërore, i ka kaluar të gjitha dëshirat dhe kënaqësitë e përkohshme. Madje edhe të gjitha vuajtjet e dhimbjet djegëse të mundimeve të botës së atjeshme, në shikimet e tyre janë pothuajse një hiç.

Tani të shtjellojmë së bashku disa nga shembujt e panumërt që në këtë sakrifikim tregojnë durimin, qëndrueshmërinë, vendosmërinë, konceptimin, flijimin dhe këmbënguljen e të Dërguarit të Allahut (s.a.v.s) i cili na mësoi ne besimin dhe të besimtarëve të devotshëm të cilët kanë shërbyer në transmetimin e kësaj mirësie deri në ditët tona.

### *Tablo të virtytshme*

Kur Rasulullahu (s.a.v.s) ishte akoma një fëmijë dymbëdhjetë vjeçar dhe kur prifti Bahira i tha:

“-O biri im! Po të pyes për hir të Lat dhe Uzza, mu përgjigj!” Ai u përgjigj:

“-Mos më pyet ndonjë gjë duke u betuar në emër të Lat dhe Uzza! Për Zotin sa urrej këto, nuk urrej asgjë”.<sup>1</sup>

Krenaria e Gjithësisë, i Nderuari ynë (s.a.v.s) që në moshë të vogël, duke qenë me një natyrë të pastër, qëndroi larg putave dhe mosbesimit. Ndërsa vendosmëria dhe përpjekja e jashtëzakonshme që ka

1. Ibn Ishak, Siret, Konja 1981, fq. 54; Ibn Sa'd, et-Tabakatu'l-Kubra, Bejrut, Daru Sadër, I, 154. Veçanërisht shik. Ahmed bin Hanbel, Musned, V, 362.

treguar për përjetimin e besimit me predikim, mësim dhe dashuri pas profetësisë, është një e vërtetë që e di çdo besimtar.



Magjistarët që sfiduan me trimërinë e besimit dhe që refuzuan pohimin e Faraonit se është “Zot”, duke thënë përballë torturave të papërballueshme:

**“-Dhuna jote i përket kësaj bote, ti je i lirë në sundimin dhe në sjelljet e tua, sidoqoftë ne do të kthehemi te Zoti ynë!”**, përpara se t’u vareshin në degët e hurmave duart dhe krahët e tyre, pasi ua kishin prerë tërthor me urdhërin e Faraonit, në çastin kur treguan ligështi njerëzore i ngritën duart e tyre drejt qiellit me pikëllimin e rënies në dobësim të besimit dhe u shprehën:

**“-...O Zot! Na dhuro durim dhe na bëj të vdesim myslimanë!”** (el-A’raf, 126), iu përgjëruan Zotit dhe pas kësaj u takuan me Zotin e tyre në fatin hyjnor të shehadetit.



Edhe Isavitë që ishin myslimanë të devotshëm, e mbrojtën besimin e tyre në mes dhëmbëve të luanëve në cirk duke e shijuar edhe ata me dashuri sherbetin e të rënit dëshmor.



Po ashtu një grup tjetër që vjen në krye të heronjve të cilët e kanë jetuar besimin me dashuri, janë besimtarët që i kanë hedhur në zjarr të gjallë “Ashabu Uhdud”. Në shekullin e katërt para erës sonë hebreu Zu Nuvas që ishte sundues i Jemenit, e detyronte popullin e Nexhranit që ishin kristianë të lidhur ndaj besimit të njësimi të asaj kohe të ndryshonin besimin e tyre. Kur populli këmbënguli në të vetën, shumë njerëz u hodhën në kanale plot zjarr, duke u djegur të gjallë. Transmetohet se numri i të vararëve në këtë mënyrë është njëzet mijë.

Këta dhunues, duke hapur kanale dhe për arsye se ndezën zjarre për të djegur besimtarët, u quajtën “Ashabu Uhdud”. Por ata të cilët u munduan ta shkatërrojnë besimin që ishte i gdhendur në zemra dhe



i vendosur gjithmonë atje, nuk ia dolën mbanë. Përkundrazi, duke u trishtuar dhe dënuar, u mundën, u raskapitën dhe u mallkuan deri në pafundësi. Allahu thotë:

**“Mallkuar qofshin Ashabu Uhdudi të cilët hapën kanale të mbushura me zjarr ( për të djegur besimtarët)! (el-Buruxh, 4-5)**



Në Epokën e Lumturisë, duke e jetuar besimin me dashuri, Zonja fatlume sahabe që fitoi titullin “Dëshmorja e parë e Islamit”, ishte Hazreti Sumejje. Hazreti Sumejje radijallahu anha, që më përpara kishte shumë frikë edhe nga ngulja e një gjilpëre, pasi e shijoi kënaqësinë e lartë të besimit, tregoi një qëndrueshmëri të madhe. Edhe pse mushrikët ia vulosën trupin me hekur të nxehtë, kurrë nuk hoqi dorë nga besimi. Pasi u dënua ashpër, u copëtua në mënyrë çnjerëzore duke ia lidhur njërën këmbë te një deve dhe këmbën tjetër të një tjetër deve dhe ra dëshmore në një mënyrë tragjike. Gjithashtu bashkëshorti i saj Hazreti Jasir, paçka se ishte njeri i moshuar dhe i dobët, tregoi një durim të jashtëzakonshëm dhe së fundi edhe ai e piu sherbetin e dëshmorit. Kështu që familja Jasir radijallahu anhum u bë dëshmorja e parë e Islamit.<sup>2</sup> Kundërvlerën e besimit e paguan duke e jetuar atë me dashuri.



Madje Hazreti Bilal radijallahu anhu, trupi i të cilit rridhte gjak dhe ishte kthyer pothuajse në pelte nën torturat e rënda të mushrikëve të tërbuar e të egërsuar, vazhdonte të thoshte “Ehad, ehad, ehad: Allahu është një, Allahu është një, Allahu është një...”, duke predikuar tevhidin dhe duke përjetuar kënaqësinë e takimit me Allahun me një zemër që kishte shijuar kënaqësinë e lartë të besimit më shumë se dhimbjet e vuajtjet.<sup>3</sup>

Hazreti Omer radijallahu anhu në kohën e hilafetit të tij i kishte thënë Habbab bin Eretit që ishte nga myslimanët e parë:

“-A mund të na tregoshë torturat që ke hequr në rrugë të Allahut?”

2. Shik. Ibn Haxher, el-Isabe, Bejrut 1328, Daru Ihjai't-Turasi'l-Arabi, III, 648; Ze - ahsheri, Keshshaf, vërt. Muhammed Mersi Amir, Kajro 1988, III, 164.

3. Shik. Ahmed, I, 404; Ibn Sa'd, III, 233; Belazuri, Ensabu'l-Eshraf, Egjipt 1959, I, 186.



Hazreti Habbab tha:

“-O prijësi i bësimitarëve! Shikoje shpinën time!” Hazreti Omer që e pa shpinën e tij, duke thënë:

“-Në jetën time kurrë nuk kam parë shpinë të ndonjë njeriu të shkatërruar në këtë lloj mënyre”, tha ai i habitur. Habbab radijallahu anhu vazhdoi:

“-Qafirët ndiznin zjarr dhe më shtrinin mua mbi të të zhveshur. Zjarri fikej vetëm me dhjamin që shkrihej nga shpina ime.”<sup>4</sup>

Mushrikët, gurët që i kishin nxehur në zjarr i ngjisin në shpinën e Hazretit Habbab dhe mishi i sahabiut të bekuar derdhej prej ashpërsisë së torturës. Megjithatë, ai përsëri nuk i thoshtë fjalët që donin qafirët. (Ibn Esir, Usdu'l-Gabe, II, 114)

Sepse emocioni i takimit që ia kishte dhuruar besimi, i mënjanonte të gjitha vuajtjet e kësaj bote.

Habbab bin Ereti radijallahu anhu tregon:

Një ditë, kur i Dërguari i Allahut sallallahua alejhi ue sellem ishte në hijen e Qabes, i shkuam pranë dhe, duke iu ankuar, i treguam torturat që na bënin mushrikët. Pastaj i kërkuam që ta lusë Allahun për të na shpëtuar nga këto tortura.

Ai na tha:

*“Ndërmjet brezave përpara jush ka pasur besimtarë që pasi kape-shin, vendoseshin në një gropë, pastaj ndaheshin më dysh nga koka te këmbët me sharrë dhe u gërvishej mishi i tyre me krëhër hekuri, por përsëri nuk u kthyen nga feja e tyre. Betohem në Allahun se Ai do ta plotësojë këtë fe dhe do ta bëjë sunduese në një shkallë të tillë që një person pa ndjerë frikë përveç Allahut dhe sulmit të ujkut ndaj deleve të tij, do të mund të shkojë dhe të vijë i sigurtë nga Sanaja deri në Hadrameut. Por ju nuk duroni!...”* (Buhari, Menakibu'l-Ensar 29, Menakib 25, Ikrah 1; Ebu Davud, Xhihad 97/2649)



Armiqtë e Islamit e rrihnin edhe Hazretin Suhejb radijallahu anhu, derisa i binte të fikët. Këto tortura vazhduan deri në hixhret. Së fundi, Suhajbi radijallahu anhu, pas hixhretit të Pejgamberit (s.a.v.s), mori rrugën e mërgimit, me qëllim që të shpërngulej për në Medine. Disa nga mekasit, duke e arritur, i thanë:

“-Ti erdhe këtu si një person i varfër dhe i dobët. Fitove mes nesh shumë pasuri. Së fudi kërkon të ikësh duke marrë me vete edhe pasurinë! Për Zotin nuk ta lejojmë këtë!”

Suhejbi zbriti menjëherë nga kafsha. I nxorri shigjetat që kishte në të djathtë dhe tha:

“-O popull i Kurejshëve! Ju e dini mirë që unë jam shigjetari më i mirë prej jush. Për Zotin do tju gjuaj të gjitha shigjetat që kam dhe kur të mbarojnë, do të nxjerr shpatën. Përderisa njëra nga këto të gjendet në dorën time, nuk mund të më afroheni. Kur ato të më mbarohen, mund të më bëni çfarë të doni. Tani, nëse jua tregoj vendin e pasurisë time dhe nëse jua lë atë ju, a do të ma hapni rrugën dhe të më lini të lirë?”

Mushrikët e pranuan propozimin. Suhejbi radijallahu anhu, pasi ua tregoi atyre vendin e pasurisë, vazhdoi rrugën e tij. Në mesin e muajit rabiulevvel arriti në Qabe dhe takoi të Dërguarin e Allahut (s.a.v.s).

Kur i Dërguari i Allahut (s.a.v.s) e pa atë, buzëqeshi dhe duke pasur për qëllim sakrifikimin e të gjithë pasurisë së tij në rrugë të besimit të tij, tha:

*“-Suhejbi fitoi! Suhejbi fitoi! O Ebu Jahja! Shitja doli me fitim! Shitja doli me fitim!”*<sup>5</sup>

Sipas transmetimeve, ky ajet fisnik ka zbritur mbi këtë ndodhi:

**“Ka disa nga njerëzit që për hir të Allahut flijojnë veten (dhe pasurinë) e tyre. Edhe Allahu është shumë i mëshirshëm ndaj robërve të Tij”**. (el-Bekara, 207)



5. Ibn Sa'd, III, 226-230; Hakim, el-Mustedrek ala's-Sahihajn, Bejrut 1990, III, 450, 452.

Edhe Zinnire Hatun ishte nga gratë sahabe që u mundua dhe u keqtrajtua nga mushrikët. Për shkak të torturave që i bëri Ebu Xhehil, ajo u verbërua.

Ebu Xhehili i tha:

“-A e pe? Lat dhe Uzza t’i verbuan sytë”.

Zinnire Hatun tha:

“-Jo, për Zotin nuk m’i verbuan ata sytë e mi. Lat dhe Uzza nuk mund të më bëjnë mua as dobi, as dëm. Zoti im është i aftë që të më kthejë shikimin!”

Mushrikët, shpirtërat e të cilëve ishin varrosur në errësirën e përtjetshme, kur agoi dhe pasi panë se sytë e Zinnire Hatun ishin shëruar më mirësinë e Allahut, u hutuan.<sup>6</sup>



Edhe shumë të tjerë nga myslimanët e parë ishin në vuajtje dhe mundim. Sahabet e zgjedhur të Pejgamberit (s.a.v.s), si Amir bin Fuhejre, Ebu Fukejhe, Mikdad bin Amr, Ummu Ubejs, Lubejne Hatun, Nehdiye Hatun dhe vajza e saj, u torturuan në një mënyrë që nuk e imagjinon as mendja. Mushrikët, pasi i lidhnin ata me zinxhirë nga këmbët, duke i tërhequr zvarrë lakuriq, i nxirrnin në shkretëtirë në orët më të nxehta të vapës, mbi ta vendosnin copa guri të mëdha dhe u bënë lloj-lloj torturash, derisa i sillnin në një lloj gjendjeje kur ata e humbnin vetëdijen dhe nuk dinin se çfarë thonin më. I shtrëngonin për fyti dhe nuk i linin derisa pandehnin se kanë vdekur.<sup>7</sup>

Ashabet e nderuar e mbrojtën besimin e tyre nën tortura të rënda dhe nën dhunime të papërballueshme, dhe për ta përcjellë te ne këtë mirësi hyjnore dhanë pasurinë dhe shpirtërat e tyre, sepse ata e kuptuan vlerën e vërtetë të madhështisë së mirësisë së Islamit. Kështu ata e hapën në të dy botërat derën e madhështisë hyjnore. Duke u flijuar brenda urdhërit hyjnor:

6. Ibn Hisham, Siretu'n-Nebi, Bejrut 1937, Daru'l-Fikr, I, 340-341; Ibn Esir, el-Kamil fi't-Tarih, Bejrut 1979-1982; II, 69; Usdu'l-Gabe, VII, 123.

7. Shik. Ibn Maxhe, Mukaddime, 11; Ahmed, I, 404.





**“O ju që keni besuar, kini frikë Allahun me një sinqeritet të vërtetë dhe mos vdisni përveçse duke qenë myslimanë!”**. (Al-i Imran, 102) jetët e tyre fituan lumturinë e vërtetë dhe të përhershme.



Sa'd bin Ebi Vakkas radijallahu anhu ishte një djalë që i bindej shumë nënës së tij. Kur ai hyri në Islam, nëna e tij i tha:

“-O Sa'd! Çfarë ke bërë? Nëse nuk e lë këtë fe të re, betohem se nuk do të ha, as nuk do të pi dhe së fundi do të vdes. Edhe ty për shkakun tim do të të thërrasin vrasës i nënës tënde.

Kur Sa'di radijallahu anhu tha:

“-Mos e bëj këtë gjë o nëna ime e dashur, unë nuk mund ta lë këtë fe për asnjë lloj arsyeje!”, nëna e tij nuk hëngri dhe nuk piu dy ditë dhe dy net dhe për shkak të kësaj i ra fuqia. Sa'di për ta bërë nënën që e dontë shumë të hiqte dorë nga inati i saj, me një vendosmëri të plotë i tha:

“-O nëna ime! Për Zotin sikur të keshë edhe njëqind shpirtëra dhe edhe nëse dalin një nga një, unë nuk mund ta lë këtë fe për asnjë lloj arsyeje. Këtë ta dish!..”. Nëna që e kuptoi vendosmërinë e birit të saj, hoqi dorë nga inati dhe filloi të hajë.

Mbi këtë ngjarje zbritën këto ajete fisnike:

**“Ne e kemi urdhëruar njeriun që të silllet mirë ndaj prindërve të tij, sepse nëna e tij e barti atë me shumë mundime dhe pas dy vjetëve ia ndau gjirin. (Për këtë arsye) E porositëm që sëpari të jetë mirënjohës ndaj meje dhe pastaj ndaj prindërve të tij. Kthimi juaj është vetëm te Unë. (Megjithë këtë) Nëse ata të detyrojnë ty të më bësh mua shirk për diçka që ti nuk ke asnjë lloj dije, atëherë mos iu bind atyre. Kalo mirë me ata në këtë botë dhe ndiqe rrugën e atij që është drejtuar te Unë. Kthimi juaj është vetëm te Unë. Pastaj unë do tju njoftoj për atë që keni vepruar”**. (Lukman, 14-15) (Muslim, Fedailu's-Sahabe, 43-44; Ibn Esir, Usdu'l-Gabe, II, 368)



Kur Pejgamberi (s.a.v.s) do të shpërngulej për në Medine, e thirri Aliun radijallahu anhu. I tregoi për urdhërin hyjnor rreth hixhretit (shpërnguljes). Pastaj i tregoi se e ka caktuar zëvendës të tij për të dorëzuar emanetet që i kishte në vendet e tyre, sepse në Mekke, ngaqë e dinin sinqeritetin dhe besnikërinë e tij, pothuajse nuk kishte asnjë që posedonte diçka të vlefshme dhe që të mos ia jepte emanet të dërguarit të Allahut (s.a.v.s).

I Dërguari i Allahut, si marrje mase paraprake ndaj planeve të mushrikëve tha:

*“O Ali! Sonte ti fli në dyshekun tim! Mbulohu me mantelin tim! Mos ki frikë! Nuk ka për të të ndodhur ndonjë gjë që ti nuk e do!”* (Ibn Hisham, II, 95, 98)

Hazreti Ali radijallahu anhu me guximin e një besimi të madh, nën hijen e topuzave të tërbuar që ishin gati të zbritnin në trupin e tij, u shtri në dyshekun e të Nderuarit tonë (s.a.v.s). Kur mushrikët e tërbuar, të cilët erdhën në shtëpinë e lumturisë për të vrarë të Dërguarin e Allahut panë nën mbulesë Hazretin Ali, u zemëruan tmerrësisht dhe bërtitën:

“O Ali! Ku është biri i xhaxhait tënd!?”

Hazreti Ali radijallahu anhu tha:

“-Nuk e di, nuk kam asnjë lloj mendimi! Në fakt unë nuk jam mbiqyrësi i tij! Ju i thatë Atij që të ikë nga Mekka! I thatë: Ndahu prej nesh dhe ik. Kështuqë Ai iku.”

Në lidhje me këtë mushrikët ia tërhoqën vërejtjen Hazretit Ali dhe e keqtrajtuan. Madje e dërguan në Mesxhidi Haram dhe pasi e burgosën njëfarë kohe, e lanë të lirë.<sup>8</sup>



Nexhidët, të cilët erdhën te Pejgamberi (s.a.v.s) duke ia bërë të ditur se duan të mësojnë Islamin, kërkuan dikë që tua mësojë. Mbi këtë, i Dërguari i Allahut u dërgoi atyre rreth shtatëdhjetë hafiza, të cilët ishin nga Ehli Suffe dhe që e dinin mirë Islamin. Kur myslimanët



arritën në Bi'ri Maune dhe kur po qetësoheshin te një shpellë, ranë në një kurth të tmerrshëm. Ja, pikërisht në këto çaste, një topuz i hedhur nga mushriku me emër, Xhebbbar bin Sulma, hyri nga shpina dhe doli nga gjoksi i Amir bin Fuhejre radijallahu anhu. Në atë kohë, kur Ibn Fuhejre ishte dyzet vjeç, kur e kuptoi se ishte në prag të pirjes së sherbetit të heroizmit, bërtiti me zë të lartë:

**“Fitova për Zotin!”**

Ibn Tufejl, i cili ishte koka e atyre që përgatitën këtë kurth në mënyrë tradhëtare, pasi mori një mysliman që i kish mbijetuar masakrës, erdhi në krye të dëshmorit tonë të nderuar dhe e pyeti:

“-Kush është ky?” Kur mori përgjigjen:

“-Amr bin Fuhejre!” tha:

“-Pasi ai u vra, unë pashë kufomën e tij që ngrihej në qiell. Qëndrimi i saj mes qiellit dhe tokës, është akoma përpara syve të mi. Pastaj zbriti në tokë.”

Ibn Tufejl i cili ishte nga poetët më të njohur, edhe pse e pa pikërisht vetë këtë ndodhi, nuk u bë mysliman. Por Xhebbbari, i cili e lëshoi dëshmor Amir bin Fuhejren, së fundi arriti udhëzimin. Sepse klithma e personit që ra dëshmor me fjalët **“Fitova për Zotin”** ushtoi ditë të tëra në veshët e tij. Këto fjalë u bënë enigmë për të. Ai mendoi disa javë që “Unë po e vrisja, ndërsa ai thoshte fitova! Ç’është kjo punë?” Një ditë ai pyeti patriotin e tij, Dahhak bin Sufjan, i cili ishte i njohur me heroizmin e tij dhe të cilin Hazreti Pejgamber e kishte numëruar në shkëmbim të njëqind personave, se çdo të thotë fjala “Fitova për Zotin”. Kur ai i tha se kjo fjalë do të thotë “Fitova Xhennetin” Xhebbbari u zgjua nga gjumi i thellë i hutimit në të cilin kishte humbur dhe u nderua me besim.<sup>9</sup>



Në fund të luftës së Uhudit, Hazreti Safije radijallahu anha deshi të shikonte vëllain e saj Hazretin Hamza radijallahu anhu, të cilit i ishte

9. Shik. Ibn Haxher, Fethu'l-Bari, Daru'l-Fikr, botim Fuat Abdulbakiut, VII, 390, Megazi 28; Ibn Hisham, III, 187; Vakidi, Megazi, Bejrut 1989, I, 349.

bërë trupi copë-copë. Për këtë qëllim ai u drejtua nga ana në të cilën gjendeshin dëshmorët. Biri i saj Zubeyri, pasi e takoi, i tha:

“-O nëna ime e dashur, i Dërguari i Allahut të urdhëron që të kthehesh mbrapa.” Ndërsa ajo tha:

“-Përse? A që të mos shikoj vëllain tim? Unë e di se në ç’mënyrë tragjike e kanë prerë dhe copëtuar. Në fakt asgjë përveç kësaj nuk mund të na ngushëllonte ne. Inshallah do të duroj dhe do ta pres shpërblimin nga Allahu.”

Zubejri shkoi dhe i tregoi të Dërguarit të Allahut ato që kish thënë nëna e tij. I nderuari jonë (s.a.v.s) tha:

“-Nëse është ashtu, lëreni ta shikojë.” Edhe Safija radijallahu anha, pasi shkoi te trupi i vëllait të saj që kishte arritur nderin për të qenë i nderuari i dëshmorëve, u lut për zemërsisht. (Shik. Ibn Hisham, III, 48; Ibn Haxher, el-Isabe, IV, 349)



Edhe trimëria e guximit të ashabeve të nderuar të cilët dërguan te mbretërit letrat që i kishte shkruajtur i Dërguari i Allahut (s.a.v.s), është e famshme. Ata ua dërguan atyre mesazhet e të Nderuarit tonë (s.a.v.s), pa pasur frikë nga askush përveç Allahut dhe u vune përballë mizorëve që kishin fituar famë në mbarë botën, duke qëndruar ndërmjet xhelatëve që ishin gati për të prerë koka. Ata nuk ngurruan aspak për të bërë fjalime të guximshme nën hijen e shpatave dhe të topuzave. Disa shembuj nga këta janë:

Kur një ditë i Dërguari i Allahut (s.a.v.s) pyeti:

“-O njerëz! Kush nga ju e dërgon këtë letër te Mukavkisi i Iskenderijes duke e pritur shpërblimin dhe sevapin e tij vetëm nga Allahu?” Hatib bin Ebi Beltaa u ngrit, shkoi te i Nderuari ynë dhe tha:

“-O i Dërguari i Allahut! E dërgoj unë.”

I Dërguari i Allahut (s.a.v.s) tha:

“O Hatib! Allahu e bekoftë detyrën tënde!”



Hatib bin Ebi Beltaa radijallahu anhu, pasi arriti në Iskenderije, e lexoi letrën e të Dërguarit të Allahut në prani të mbretit. Mukavkisi, e thirri Hatibin radijallahu anhu dhe i mblodhi edhe klerikët. Vazhdimin e ngjarjes le ta dëgjojmë nga Hatibi radijallahu anhu:

Mukavkisi më tha:

“-Do të flas me ty për disa gjëra që dua t’i kuptoj”

Unë i thashë:

“-Urdhëroni! Flasim.”

Mukavkisi më pyeti:

“-A nuk është peygamber Zotëriu yt?” Thashë:

“-Po, Ai është i Dërguari i Allahut.”

Kur më pyeti: “-Nëse Ai me të vërtetë është peygamber, përse nuk i bëri lutje Allahut kundër njerëzve të popullit të tij, të cilët e nxorën nga atdheu dhe e detyruan që të strehohet në një vend tjetër?” Unë i thashë:

“-Ti dëshmon se Isa bin Merjem është i Dërguari i Allahut, apo jo? Meqë ai ishte një peygamber i vërtetë, a nuk mund t’i lutej Allahut për t’u ngritur në qiell dhe për shkatërrimin e popullit të tij, pasi e kapën dhe donin ta kryqëzonin?”

Mukavkisi nuk gjeti fjalë për të më thënë. Pasi heshti një farë kohe dhe pasi u mendua, deshi që t’ia përsërisja fjalët. Pasi i përsërita, përsëri Mukavkisi u mendua për një farë kohe. Pastaj tha:

“-E the shumë bukur. Ti je i urtë, flet me vend dhe vjen nga ai i cili është i urtë.”

Menjëherë pas kësaj, i thashë Mukavkisit:

“-Këtu një njeri para teje pati pohuar se ishte Zoti më i lartë. Allahu Teala e dënoi Faraonin me ndëshkimin e botës dhe të ahiretit. Merr mësim nga ata të cilët kanë qenë para teje dhe mos u bëj mësim për të tjerët!”

Mukavkisi tha:



“-Ne e kemi një fe dhe nuk e lëmë derisa të shohim një më të mirë!”

Edhe unë i thashë:

“-Islami kategorikisht është më i lartë se feja me të cilën ti je i lidhur! Ne po të ftojmë ty te Islami, të cilin Allahu Teala e ka zgjedhur si fe për njerëzit. Muhammed Mustafa (s.a.v.s) nuk të fton vetëm ty, por të gjithë njerëzit. Ata të cilët janë sjellur më ashpër dhe më keq ndaj tij janë Kurejshit. Armiqësinë më të madhe ndaj tij e bënë çifutët. Ndërsa ata që iu afruan më shumë janë kristianët. Siç e përgëzoi Hazreti Musa Hazretin Isa, edhe Hazreti Isa përgëzoi ardhjen e Hazretit Muhammed alejhissalatu uesselam. Ftesa që ne ju bejmë juve në Kur'an është si ftesa që u bëni ju në Inxhil atyre që janë të lidhur me Teuratin. Çdo njeri është i detyruar të jetë ummet i peygamberit që vjen në kohën e tij. Edhe ti je nga ata që kanë arritur kohën e Muhammedit alejhissalatu uesselam. Për këtë arsye ne, duke të ftuar për te Islami, nuk të largojmë nga feja e Isait alejhisselam por përkundrazi, po të kërkojmë që të bësh atë që është e përshtatshme ndaj mesazhit të tij.”

Mukavkisi tha:

Unë e analizova fenë e këtij peygamberi. Pashë që në të nuk urdhërohet të heqësh dorë nga bota dhe se nuk ndalohet asnjë gjë e pëlqyeshme dhe e pranuar. Ai nuk është as një magjistar i hutuar dhe as një gënjeshtar që pohon se sjell lajme nga gajbi. Përkundrazi, te ai ka shenja profetësie që zbulojnë gajbin si dhënja e lajmit. Megjithë këtë dua të mendoj edhe pak.”

Më vonë i shkruajti një përgjigje letrës së Peygamberit...

Mukavkisi as nuk bëri ndonjë gjë më tepër se kjo dhe as nuk u bë mysliman. Edhe mua më tërhoqi vërejtjen:

“-Kujdes! Egjiptianët të mos dëgjojnë asnjë fjalë nga goja jote, përndryshe do të të dhunojnë.<sup>10</sup>

Sa shembull i bukur janë këto fjalë të urta që Hatibi radijallahu anhu tha përpara mbretit me trimërinë e besimit, në lidhje me koncep-

10. Ibn Kethir, el-Bidaje ue'n-Nihaje, Kajro 1993, IV, 266-267; Ibn Sa'd, I, 260-261; Ibn Haxher, el-Isabe, III, 530-531.



timin dhe trimërinë e një besimtari që e jeton besimin me dashuri.



Ndërsa letrën që i ishte shkruar mbretit të Iranit, e dërgoi Abdullah bin Huzafe. Mbreti, duke parë që emri i Pejgamberit ishte shkruajtur përpara emrit të tij, u zemërua, e copëtoi letrën e bekuar dhe e ofendoi rëndë dërguesin.

Me forcën dhe fisnikërinë që kishte marrë nga besimi i tij, Abdullahu radijallahu anhu u foli mbretit dhe njerëzve të tij

“-O populli i Persisë! Ju po kaloni ditët tuaja të numëruara si sundues të vetëm të një pjese të tokës, e cila ndodhet në dorën tuaj dhe që është pa pejgamber e pa libër hyjnor, dhe po jetoni një jetë ëndërrimtare. Ndërsa pjesa e tokës që nuk e sundoni, është më e madhe.

O Mbret! Përpara teje kanë ardhur dhe kanë sunduar shumë mbretër që dëshironin këtë botë ose ahiretin. Ata që donin ahiretin, e morën pjesën e tyre edhe nga kjo botë. Ndërsa ata që donin këtë botë, humbën edhe pjesën e ahiretit. Ti e nënvlerëson këtë fe që po të parashtrajmë, por për Zotin, kudo që të jesh, kur gjëja që nënvlerësove do të vijë mbi ty, ke për të pasur frikë prej saj dhe nuk do mund të mbrohesh!”

Mbreti, duke u përgjigjur, tha se pasuria dhe sulltanati i perkasin atij dhe se nuk ka frikë nga humbja apo nga dalja e ndonjë ortaku.<sup>11</sup> Pastaj urdhëroi njerëzit e tij që ta nxirrnin jashtë Abdullah bin Huzafen.

Abdullahu radijallahu anhu doli menjëherë nga pallati i mbretit, ia hypi kafshës së tij dhe filloi rrugën për në Medine. Me vete po thoshte:

“-Për Zotin, sido që të më shkojë rrugë (të vdes ose të kthehem shëndoshë e mirë) unë nuk shqetësohem. Unë e dërgova letrën e të Dërguarit të Allahut dhe e kreu detyrën time.”<sup>12</sup>

Ja qetësia e ndërgjegjes së heronjve të Islamit, që merrnin para-

11. Suhejli, Raudu'l-Unf, Bejrut 1978, VI, 589-590.

12. Shik. Ahmed, I, 305; Ibn Sa'd, I, 260, IV, 189; Ibn Kethir, el-Bidaje, IV, 263-6; Hamidullah, el-Uesaiku's-Sijasijje, Bejrut 1985, fq. 140.

sysh flijimin e shpirtit të tyre për të kryer një dëshirë të të Dërguarit të Allahut...



Abdullah bin Huzafe radijallahu anhu ka edhe një histori tjetër të mbushur me shumë shembuj që e shfaqin virtytin dhe guximin e besimit të tij të pashoq.

Në periudhën e Hazretit Omer radijallahu anhu, një ushtri Islame u dërgua mbi Bizantinët që ishin në anët e Kajserijes së Shamit. Edhe Abdullah bin Huzafe radijallahu anhu gjendej në ushtri. Bizantinët e kapën rob atë. E dërguan te mbreti i tyre dhe thanë: “Ky është nga ashabët e Muhammedit!”

Mbreti e mbylli në një shtëpi Hazretin Abdullah radijallahu anhu dhe pasi nuk e lejoi disa ditë që të hajë dhe të pijë, i dërgoi atij pak verë dhe mish derri. E përgjuan tri ditë. Abdullah radijallahu anhu nuk ia zgjati dorën as verës, as mishit të derrit. Mbreti i thanë:

“-Qafa e tij është përkulur shumë. Nëse nuk e nxjerrim nga aty, do të vdesë!”

Mbreti, pasi urdhëroi ta sillnin, e pyeti

“-Çfarë të pengon që të mos hash dhe të mos pish?”

Abdullah radijallahu anhu tha:

“-Me të vërtetë nevoja ma lejon që të ha dhe të pi nga ato, por unë nuk desha që ti të qeshësh me mua dhe me Islamin!”

Mbreti përballë kësaj sjelljeje të denjë tha:

“-A nuk pranon bën të bëhesh kristian, nëse unë të jap gjysmën e pasurisë, nëse të bëj ortak të pasurisë dhe mbretërisë sime dhe nëse të martoj me vajzën time?”

Abdullah radijallahu anhu tha:

“- Edhe nëse ti çilembyll sytë më jep mua të gjithë pasurinë tënde dhe pasurinë e Arabëve, si kundërvlerë për të hequr dorë nga feja e Muhammedit alejhissalatu uesselam, nuk do ta bëja kurrë një gjë të tillë.”





Mbreti tha:

“-Atëherë do të të vras.”

Hazreti Abdullah tha:

“-Ajo është diçka që e di ti.”

Abdullahun radijallahu anhu e vendosën në kryq. Shigjetarët gjuajtën shigjeta për ta trembur në mënyrë që të mos e qëllonin. Pastaj përsëri i propozua që të bëhet kristian. Sahabi i begatë nuk bëri asnjë lloj animi. Mbreti mbi këtë tha:

“-Ose do të bëhesh kristian, ose do të të hedh në një kazan që valon.”

Kur ai nuk pranoi, sollën një kazan bakri të cilin e bënë të valojë duke hedhur vaj ulliri ose ujë. Mbreti urdhëroi që të sillnin një rob nga myslimanët. I propozoi që të bëhet kristian. Kur robi nuk e pranoi këtë propozim, urdhëroi që të hidhet në kazan. Robi mysliman u hodh në kazan. Abdullahu radijallahu anhu po e shikonte atë. Menjëherë mishi i tij u nda nga kockat dhe u derdh.

Mbreti përsëri i propozoi Abdullahut radijallahu anhu që të bëhej kristian. Kur nuk pranoi, urdhëroi që të hidhet në kazan. Në çastin kur do të hidhej në kazan, Hazreti Abdullah filloi të qajë. Mbreti, duke pandehur se ndërroi mendim, urdhëroi që ta sillnin Abdullahun radijallahu anhu dhe përsëri i propozoi që të bëhet kristian. Kur e pa se refuzonte ashpër, duke u habitur, e pyeti:

“-Atëherë, përse qave?”

Hazreti Abdullah dha këtë përgjigje të mrekullueshme:

“-Mos kujto se qava duke pasur frikë nga ajo që doje të më bëje! Unë qava sepse kam vetëm një shpirt që mund ta jap në rrugë të Allahut. I thashë vetvetes; Ti tani ke vetëm një shpirt, do të hidhesh në këtë kazan, do të vdesësh në çast në rrugë të Allahut dhe do të ikësh. Por sa do të dëshiroja të kisha aq shpirtra sa ç’kam qime në trup, ashtu që çdonjërin ta flijoja në rrugë të Allahut.

Kjo sjellje e çuditshme që shfaqti Hazreti Abdullah me trimërinë



dhe fisnikërinë e besimit, i pëlqeu shumë mbretit dhe deshi ta lërë të lirë. Tha:

“-Më puth kokën dhe të lë të lirë.”

Abdullahu radijallahu anhu këtij propozimi që nuk kishte ndonjë druajtje iu kundërpërgjigj me një propozim të ri:

“-A do t'i lëshë të lirë të gjithë robërit mysliman që janë me mua?”

Kur mbreti tha:

“-Po do t'i lë.” Tha:

“-Tani në rregull.”

Hazreti Abdullah thotë:

“-I thashë vetes; Çfarë problemi ka nëse i puth kokën një armiku nga armiqtë e Allahut, për të shpëtuar edhe jetën time edhe jetën e robërve myslimanë? Puthë!”

Atë ditë u liruan tetëdhjetë myslimanë. Kur erdhën te Hazreti Omer dhe ia treguan situatën, hazreti Omer radijallahu anhu tha:

“-Të puthësh kokën e Abdullah bin Huzafes është një detyrë që i takon çdo myslimani! Së pari unë po filloj ta kryej këtë detyrë.” Pastaj u ngrit, shkoi afër tij dhe i puthi kokën.<sup>13</sup>

Besimtarët e përkryer konceptues, për shkak të horizontit të mendimit të gjërë që ua dha besimi, i shohin ndodhitë nga dritarja e ahiretit. Për këtë arsye, për çdo shtesë-mungesë të qëndrueshme janë në llogaritjen e dobisë dhe dëmit. Për këtë shkak, çdo keqtrajtim dhe vuajtje e kësaj bote, mundimet dhe dëshpërimi i përkohshëm, përballë dashurisë së besimit të atyre kishin kishin për ta aq pak rëndësi sa s'ia vlen të flitej për to.



Një tjetër nga heronjtë që e ka jetuar besimin me dashuri është

13. Ibn Esir, Usdu'l-Gabe, III, 212-213; Dhehebi, Sijeru A'lami'n-Nubela, Bejrut 1986-1988, II, 14-15.



Uehb bin Keshbe. Tyrbeja e këtij sahabinu të bekuar është në Kinë.<sup>14</sup> Pejgamberi jonë (s.a.v.s) i pati dhënë detyrën për të predikuar në Kinë. Por në kushtet e asaj kohe, Kina ishte një vit larg Medine-i Munevveres. Ky sahabi shkoi atje dhe pasi predikoi një kohë të gjatë, mori rrugën e Medines me shpresë për të shuar qoftë edhe pak mallin e të Dërguarit të Allahut që i digjte zemrën. Pas një vit udhëtimi të mundueshëm arriti në Medinen e përndritur. Por për fat të keq nuk mundi ta shohë Atë, sepse Hazreti Pejgamber (s.a.v.s) ndërkohë kishte vdekur. Përsëri me një mall të shtuar edhe një herë më shumë u kthye në Kinë duke konceptuar shenjtërinë e shërbimit që ia kishte dhënë i Dërguari i Allahut dhe e dorëzoi shpirtin e tij në këtë shërbim.

Uehb bin Keshbe radijallahu anhu fitoi kështu nderin për të qenë përfaqësuesi i parë i të Dërguarit të Allahut në Kinë. Trupi i përkohshëm i tij ngeli në Kinë, ndërsa shpirti i tij i përherëshëm ngeli në klimën e ndriçuar të Medine-i Munevveres, mbushur plot me ndjenjën shpirtërore të të Dërguarit të Allahut.



Edhe këto ngjarje që rrodhën në periudhën midis Sulltanit Bejazidit të dytë dhe vëllait të tij Xhem Sulltan, pasqyrojnë në një mënyrë të qartë bukurinë dhe virtytin që dhuroi Islami me trimërinë e besimit të stërgjyshërve tanë:

Bejazid Veli, pasi u bë padishah në vitin 1481, i kaloi 14 vitet e para të mbretërisë së tij duke u përpjekur me problemet që lindnin si rezultat i pohimit të vëllait të tij Xhem Sulltan se ai nuk e meritonte postin e Osmanëve. Kjo situatë e bëri Bejazidin e dytë të jetë jo aktiv deri në një masë ndaj botës së Krishterë. Xhem Sulltani i propozoi Bejazid Hanit:

“-Ta ndajmë vendin tonë më dysh, në njërin gjysmë sundo ti dhe

14. Në qytetin Guangzhou të Kinës ndodhet edhe një vend që ka lidhje me Sa'd bin Ebi Uakkas. Varret e sahabeve dhe të miqve të Allahut janë të vërteta historike që dihet dhe se shumicën e kohës kanë ndikuar për të mbajtur aktiv dhe për të ruajtur ndjenjat fetare të popullit të krahinës ku ndodhen. Kështu pra shembujt e këtyre gjenden edhe në krahinat si Semerkanti në Azinë e Mesme, Buhara, Turkistan dhe Tashkent.



në gjysmën tjetër të sundoj unë!”

Ndërsa Bejazid Veli e refuzoi këtë propozim duke thënë:

**“-O vëllai im, atdheu është pasuria e popullit. Nëse e ndajmë atë, shteti e humb fuqinë. Si rezultat i kësaj vijmë në gjendje feudale. Ky është një mëkat i madh. Trupi im ndahet më dys, por toka e popullit nuk ndahet!”**

Në këtë kohë Xhem Sulltani i hutuar shkoi në Rodos i nxitur nga thirrja me gjuhë të sjellshme që i kishin bërë kalorësit e Rodosit. Kalorësit, duke e shkelur fjalën e dhënë, ia shitën atë patriarkatit si një rob. Patriarkati planifikonte të përdorte Shehzade Xhemin në një udhëtim kryqëzatesh që do të bëhej mbi Osmanët. Por Papa Innoçent i cili e kuptoi se nuk do t’ia dilte mbanë, i propozoi që të bëhet kristian. Ky propozim i erdhi shumë rëndë Xhem Sulltanit. U mërzi jashtëzakonisht shumë. I tha Papës:

“-Sikur të më jepni jo vetëm Mbretërinë Osmane, por të gjithë botën, përsëri nuk do ta ndryshoja fenë time. Ky përgjërëm që Xhem Sulltani i bëri Zotit në çastin kur e kuptoi se kryqëzatat donin ta përdornin kundër botës Islame, është i mjaftueshëm për të treguar përpjekjen e tij fetare:

“O Zoti im! Nëse qafirët duan të më bëjnë vegël të tyre për t’i bërë dëm botës Islame, mos e lër më shumë që të jetojë robin tënd! Një çast e më parë ma merr shpirtin për te lavdia jote!...

Lutja e tij u pranua dhe në moshën tridhjetë e gjashtë vjeç ai vdiq në Napoli. Në frymën e fundit, kur po i jepte lamtumirë kësaj bote të përkohshme, u dha këtë porosi atyre që kishte afër:

*“Lajmin e vdekjes sime patjetër shpërndajeni në një lloj mënyre në çdo anë. Këtë bëjeni me qëllim që lojrat që qafirët duan të luajnë mbi myslimanët për shkakun tim, të marrin fund patjetër! Pastaj shkoni te vëllai im Sulltan Bejazidi. I luteni që të ma kthej trupin tim në atdhe, sado e vështirë që të jetë. Nuk dua të varrosem në një vend qafir. Çfarë do që ka ndodhur deri tani, ka ndodhur. Kini kujdes që të mos e refuzojë këtë. Të bëjë mirësi dhe të m’i lajë të gjitha borxhet e mija.*

*Nuk dua të shkoj me borxhe në praninë hyjnore. Ta falë familjen time,*



*fëmijët e mi dhe ata që më kanë shërbyer. T'i gëzojë sipas gjendjes së tyre!..”*

Edhe vëllai i tij Bejazid Hani i kreu këto porosi.

Ja sjellja që i ka dhënë Islami njeriut! Veprimet e ndërsjellta të këtyre dy vëllezërve kanë shfaqur shumë virtyte, si flijimi i gjithçkaje për hir të dashurisë së atdheut dhe paqjes së popullit, toleranca, kërkimi i llogarisë me ndërgjegje që rrjedh si pasojë e kuptimit të gabimit, shmangia nga haku i robit, falja dhe mëshira.



Vëllezërit Iljasi, Oruçi dhe Hëzëri, të cilët kishin një vend të madh në historinë e flotës Osmane, merreshin me tregti në Detin e Zi para se të hapej flamuri i xhihadit. Por kjo punë shfaqte një rrezik të madh në Detin e Zi. Po ashtu, Oruç Reisi një ditë u zu rob nga piratët e Rodosit. Vëllai i tij Hëzër Reis, pasi tha “Do apo nuk do, ajo që do të ndodhë do të ndodhë, po deshe mërztitu, po deshe mos u mërztit.” filloi të kërkojë zgjidhje për këtë. Edhe pse dërgoi shumë para për shpëtimin e vëllait të tij, për shkak të hileve të piratëve gënjeshtarë që nuk mbanin fjalën, skllavëria e vëllait të tij zgjati shumë. Duke mos u mjaftuar me këtë, qafirët i dërguan një prift Oruç Reisit, duke guxuar t'i propozonin që të bëhej kristian. Por përgjigja e Oruç Reisit në formën: “-O të hutuar! Si mund të lë një fe të vërtetë dhe të bëhem përkrahës i një feje të humbur?”, pothuajse u bë si një shuplakë e dhimbshme që ra në fytyrat e tyre.

Piratët u zemëruan kësaj, duke thënë:

“-Atëherë le të vijë Muhammedi yt dhe të të shpëtojë!” i thanë ata dhe e lidhën në një barkë për të lëvizur velat.”

Oruç Reisi, duke u mbështetur te Allahu, tha: “-Ju do ta shikoni se si do të më ndihmojë Zoti im!”. Pas kësaj iu lut Allahu.

Pas pak, me ndihmën e disa personave më rroba të bardha dhe me çallma të gjelbra, të cilët i shquan edhe qafirët, nyjet që Oruç Reisi kishte te duart dhe te këmbët, u zgjidhën dhe ai u hodh në detin e thellë duke shpëtuar nga robëria. Kështu, me trimërinë e besimit ai fitoi



bereqetin e nënshtrimit dhe të mbështetjes te Allahu.

Ja, pas kësaj ndodhie Oruç Reisi bashkë me vëllain e tij Hëzër Reisin filluan një luftë të pamëshirshme kundër piratëve të Detit të Zi. Brenda një kohe të shkurtër djemtë detarë u mblodhën rreth tyre dhe së bashku, duke thënë:

**“Tani është koha e luftës; Bismillah, ejani! E u shpërndanë nëpër dete.**



Edhe në frontin e Çanakkales shfaqjet e përjetimit të besimit me dashuri janë të shkëlqyera. Një oficer pensionist që pati komanduar dhe që ishte plagosur në luftimet e Çanakkales, na tregon në kujtimet e tij:

“Ishim në ditën e parë të luftës së Çanakkales. Beteja vazhdoi deri në mbrëmje, e megjithatë, edhe pse armiku kishte epërsi nga aspekti material, përsëri po përfundonte në fitoren tonë. Nga vendi i vëzhgimit e ndiqja luftën me emocion deri në fazën e fundit. Thirrjet e luftëtarëve “Allah Allah...” i tronditnin horizontet dhe këto britma të fuqishme mpaknin edhe zërat e lartë që përfaqësonin gjithë nderin e një civilizimi të frikshëm.

Në njëfarë çasti m’u bë sikur dëgjova zhurmë hapash. Kur u ktheva mbrapa, u takova me Rreshter Aliun. Në fytyrën e tij të zverdhur lexohej halli i frikshëm. Pa pritur ta pyesja se çfarë kishte, ai më tregoi krahun e tij, që mjaftonte për të më bërë të ditur gjithçka. U rrënqetha me tmerr. Krahu i tij i majtë, deri në katër gisht mbi bërryl, pothuajse ishte duke u këputur nga goditja që kishte pësuar dhe vetëm një copë lëkure e hollë e mbante dorën e tij që të mos binte në tokë. Rreshter Aliu, duke shtrënguar dhëmbët, mundohej ta mposhte dhimbjen. Më dha thikën që e kishte në dorën e djathtë dhe tha:

**“-Prite këtë, o komandanti im!”**

Kjo fjali tri fjalëshe shprehte një dëshirë të zjarhtë dhe një detyrim të tillë saqë e mora thikën dhe ia ndava dorën nga krahu që tundej në majë.

Kur po e bëja këtë gjë të tmerrshme, mundohesha t’i jepja kurajo:



“-Mos u mërzit Rreshter Aliu. Allahu i dhashtë shëndet trupit tënd!”

Pa kaluar shumë, Rreshter Aliu jo vetëm dorën e tij, por edhe trupin e tij të bekuar e flijoi për hirë të atdheut. Kur po i mbyllte syte, gjithë duke përsëritur fjalitë “Rroftë atdheu! **Allahu mos na ndaftë nga besimi!**.. Shpirti im u flijoftë për atdheun!..”, ai dha frymën e fundit dhe vendi rreth e rrotull tij u shndërrua në një liqen gjaku.”

Ja pra luftëtari në Çanakkale, i cili e kishte gjoksin të mbushur me besim, ndërsa mbrojtjen e atdheut e shihte si një borxh të nevojës së besimit, pa ngurruar ta lante këtë borxh qoftë edhe me shpirtin e tij. Për këtë arsye kapej pas fesë ashtu siç kapej pas armëve, dhe kapej ndaj armëve ashtu siç kapej pas besimit...



Në luftën e Çanakkales, llogorja e Mexhidijes së Rumelisë pothuajse ishte fshirë plotësisht si rezultat i një sulmi të frikshëm armik. Pjesa e madhe e depos së municionit ishte hedhur në erë dhe gjashtëmbëdhjetë artilierë kishin rënë dëshmorë. Gjithë ç’kishte ngelur nga tërë ajo llogore ishte një kapiten, dy ushtarë dhe një top te cilit i ishte thyer vinçi dhe që nuk e merrte gjylen. Kur kapiteni ishte larguar për t’u treguar gjendjen njësave që ishin rreth e rrotull, njëri nga ushtaret, Koxha Sejjid, teksa shikonte anijet armike që përparonin duke shpërtëyer zjarr e vdekje mbi det, mori frymë thellë dhe sytë iu mbushën me lot. Zemra e tij e dëshpëruar po përpëlitej nga vuajtja teksa shihte pamundësinë përballë armikut. Atëherë ai i ngriti duart drejt Zotit të lartë, u mbështet të Ai dhe i kërkoi ndihmë me fjalët: “O Zot! O Allahu im që je i fuqishëm! Më jep mua një fuqi që të mos ketë asnjë rob më të fortë se unë!”

Koxha Sejjid pothuajse ishte zhveshur nga kjo botë... Tashmë ai sikur gjendej në prani të Zotit tës tij. Lotët që i rridhnin nga sytë, binin poshtë nga faqet.

Pastaj, befas ai thirri “**Ja Allah**” dhe përpara shikimeve të mbushura me hutim dhe habitje e mbërtheu gjylen 215 okëshe (afërsisht 276 kile) dhe e ngriti. Hypi tri herë në shkallët e hekurit dhe doli.



Dëgjoheshin kërkërimat e kockave të kraharorit dhe të shpatullave. Ndërkohë që nga njëra anë djersët i shkonin rrëke dhe buzët i kishte të plasaritura, Koxha Sejjid vazhdonte lutjen: “O Zoti im! Mos e shkëput forcën tënde nga unë!”

Së fundi, fati i luftës ndryshoi me gjylen e tretë që arriti ta fuste në tytën e topit. Anija e koracuar e anglezëve me emrin “Ocean” u godit dhe sipërfaqja e detit u mbërthye nga një flakë xhehnemi.

Pasha Xhevat, pasi mësoi për këtë ndodhi nisi të falenderonte Zotin. Ndërkohë që po uronte Koxha Sejjidin, ai i kërkoi atij që të ngrinte një gjyle tjetër me të njëjtën peshë, por Koxha Sejjid dha këtë përgjigje: “O Pashai im! Kur unë e ngrita këtë gjyle, zemra ime ishte e mbushur me begatinë e Allahut dhe kishte arritur përforcimin hyjnor. Në veten time ndjeja diçka tjetër. Në pranimin e lutjeve që i bëja Zotit, u shfaq ndihma dhe mirësia e Tij. Kjo i përkiste atij çasti. Tani nuk mund ta ngre o komandati im. Më falni!..”

Në lidhje me këto fjalë të Sejjidit, Pasha Xhevat tha:

“-O biri im! Ia dole mbanë një pune të madhe. Kërko nga unë një shpërblim.”

Trimi flijues që e kishte fshirë gjithçka nga zemra përveç adhurimit ndaj Allahut, e shprehu me këto fjalë heroizmin e dytë që e kishte në shpirt:

“-O komandanti im! Nuk kam asnjë kërkesë, por ngaqë jam shtat-madh nuk më mjafton një bukë në ditë. Urdhëroni që të më japin dy bukë që të jem më i fortë përballë armikut!..”

Pasha Xhevat buzëqeshi ndaj kësaj kërkesë, e shpërbleu atë duke e bërë kapter.

Kur erdhi mbrëmja, të gjithëve iu dha nga një bukë, ndërsa Kapter Sejjidit dy. Zemra e heroit të besimit të madh nuk e pëlqeu këtë. Në kohën kur sundonte zia e bukës nuk donte që të ishte i ndryshëm nga shokët. Njëren nga bukët që i jepeshin e ktheu mbrapa dhe kurrë nuk mori më dy bukë.





Sejjidit është e përbërë nga një shprehje konkrete e sinqeritetit dhe çiltërsisë me trimërinë e besimit.



Së fundi, besimi nuk është një pretendim i thatë. Besimi është dëshmitari i gradës së zemrës së besimtarit dhe i përsosmërisë së tij. Ndërsa shenja e tij është flijimi. Duke qenë se besimi është një kapital i përhershëm që duhet ruajtur dhe forcuar, gjatë gjithë gjithë historisë janë flijuar shumë shpirtëra dhe janë duruar shumë tortura të pabërballueshme dhe vuajtje. Për hir të Allahut janë shfaqur shumë heroizma të paparë. Edhe në ditët e sotme, më shumë se për gjithçka kemi nevojë për entuziazmin e përjetimit të besimit me këtë dashuri dhe dëshirë. Si borxh falenderimi ndaj mirësisë së besimit që na është dhënë, është e nevojshme të jemi gati për hyrjen e gjithë njerëzisë në Daru's-Selam. Një besimtar që e jeton besimin me dashuri, e ndjen veten e tij përgjegjës për gjendjen e popullit. Aq sa ç'mund të flijojmë për plotësimin e besimit në këtë botë të përkohëshme, po aq dashuri hyjnore do të fitojmë nesër, inshallah!

**Zoti na bëftë të gjithëve prej robërve të tij që arrijnë përsosmërinë e gëzimit të besimit dhe prej atyre që e shpenzojnë jetën e tyre në këtë rrugë!..**

**Amin!..**

## **2. Sinqeriteti**

I Dërguari i Allahut (s.a.v.s) thotë:

*“Veprat janë sipas synimeve...”* (Buhari, Iman, 41; Muslim, Iman, 155)

Kjo përbën bazën që që në rradhë të parë adhurimet, e më pas të gjitha punët e mira, të bëhen për hir të Allahut. Kjo mund të realizohet vetëm me sinqeritet. Thënë ndryshe, të gjitha punët e bëra mund t'i ngremë në cilësinë dhe gradën e adhurimit, vetëm nëse i lidhim me besimin të një qëllim i lartë. Për këtë arsye, kushti bazë për pranimin e veprave të Allahu mbetet sinqeriteti.



Sinqeriteti është kryerja e veprave që kanë si qëllim vetëm kënaqësinë hyjnore, pa rënë mbi ta hija e qëllimeve vetjake. Sinqeriteti për veprat është i ngjashëm me atë që shpirti është për trupin. Vepra pa sinqeritet është një lodhje e thatë dhe e privuar nga e vërteta.

Sinqeriteti është mbrojtja e zemrës nga çdo lloj interesi i kësaj bote dhe ka si qëllim afrimin te Zoti.

Sinqeriteti është dëlirja e punëve nga çdo lloj papastërtie shpirtërore që prihet nga vetpëlqimi, sepse këto janë sëmundje të zemrës që fëlliqin dhe shkatërrojnë sinqeritetin.

Të heqësh dhe të hedhësh nga zemra të gjithë punët që nuk janë për hir të Zotit, është një detyrë e madhe që duhet ta kryejë çdo mysliman.

Por duhet të kemi parasysh se personat e sinqertë janë në çdo çast ballë për ballë me humbjen e kësaj gjendjeje të bukur, gjë që ndodh si rezultat i epërsisë së dëshirave vetiake. Siç është vështirë të qëndrosh në majë, po ashtu është e vështirë të ruash sinqeritetin. Është shumë e njohur fjala e Hazretit Zunnun Misri në lidhje me këtë çështje.

“Të gjithë njerëzit janë të vdekur, përveç dijetarëve. Të gjithë dijetarët janë në gjumë, përveç atyre që punojnë me diturinë e tyre. Edhe ata që veprojnë me dituri, ka mundësi të gënjejnë, përveç të sinqertëve. Edhe të sinqertët (në çdo çast në botë) janë përballë një rreziku të madh...”<sup>15</sup>

Ndërsa robërit që mund ta ruajnë sinqeritetin, edhe pse me vështirësi, fitojnë shumë mirësi hyjnore. Kryesisht:

Sinqeriteti i bën robërit të fitojnë kënaqësinë hyjnore që është mirësia më e madhe, sepse ajo që do Allahu nga veprat e njerëzve, është pasja si qëllim vetëm kënaqësinë e Tij, domethënë është sinqeriteti. Në ajetet fisnike thuhet:

**“(O i Dërguari Im) Ne ta shpallëm ty librin për hir të së vërtetës. Për këtë arsye adhuro Allahun duke qenë i sinqertë në adhurimin ndaj Tij!”** (ez-Zumer, 2)



**“Thuaj: Unë jam i urdhëruar ta adhuroj Allahun dhe të jem i singertë në adhurimin ndaj Tij”** (ez-Zumer, 11)

Sinqeriteti e shpëton besimtarin nga ngacmimi i shejtanit, i cili është armiku më i madh, sepse ai ngacmon vetëm e vetëm ata që kanë dobësi në sinqeritet. Në ajetin fisnik thuhet:

**“(Shejtani) tha: O Zoti im, për shkak se më largove, unë do t’ua zbukuroj (mëkatet) sa të jenë në tokë dhe do t’i largoj të gjithë nga rruga e drejtë, përveç robërve të tu të cilët janë të singertë.”** (el-Hixhr, 39-40)

Të sinqertët janë të lirë nga ndëshkimi i xhehennemit. Urdhëri i Zotit: **“Vetëm robërit e mi të singertë** (do të shpëtojnë nga ndëshkimi)” (es-Saffat, 40) e përgëzon këtë të vërtetë.

Vepra që bëhet me sinqeritet, edhe nëse është pak, është e mjaftueshme për shpëtimin e vepruesit. Po ashtu Pejgamberi (s.a.v.s) ka thënë:

*“Ji i singertë në fenë tënde! Nëse vepron kështu, edhe vepra e paktë është e mjaftueshme për ty”.* (Hakim, IV, 341)

Sinqeriteti tërheq ndihmën hyjnore. Pejgamberi (s.a.v.s) thotë:

*“Allahu e ndihmon këtë ummet për shkak të lutjes, namazeve dhe sinqeritetit të të pafuqishmëve”.* (Nesai, Xhihad, 43)

Nuk duhet të dyshojmë te fitorja e besimit, sepse përpjekjet e sinqerta mbrohen dhe kurrë nuk humben. Gjatë gjithë historisë, shumë ushtri të pakta në numër por që përbëheshin nga persona të sinqertë dhe të durueshëm, kanë arritur të fitojnë me lejen e Allahut ndaj ushtrive që ishin shumë më të mëdha si në numër ashtu edhe në armatim. Këto të dhëna tregojnë qartë se sinqeriteti është baza e fitores.

### ***Tablo të virtytshme***

Jeta e të Dërguarit të Allahut (s.a.v.s) është e mbushur me shembuj që formojnë kulmin e sinqeritetit. Po ashtu, kjo ngjarje që ndodhi në periudhën e parë të predikimit, e shpreh shumë bukur këtë realitet.



Mushrikët, duke e lajmëruar Hazretin Pejgamber (s.a.v.s) me anë të xhaxhait të tij Ebu Talibit, i kërkuan që të heqë dorë nga thirrja. Ja si iu përgjigj xhaxhait të tij në lidhje me këtë, Hazreti Pejgamber (s.a.v.s):

*“-O xhaxha! Nëse më vendosin në dorën e djathtë diellin dhe në dorën e majtë hënën që të heq dorë nga predikimi i fesë së Allahut, unë përsëri nuk do të hiqja dorë nga kjo thirrje. Ose Allahu i lartë do ta shpërndajë atë në të gjithë botën dhe kështu mbaron puna ime, ose do të vdes në këtë rrugë!”<sup>16</sup>*

Mushrikët, të cilët ishin të shqetësuar nga lindja e dritës së Islamit, pasi dështuan në përpjekjet që bënë me ndërmjetësimin e Ebu Talibit, këtë radhë erdhën vetë te i Dërguari i Allahut (s.a.v.s) duke guxuar t'i bënë këto propozime:

“Nëse dëshiron të bëhesh i pasur, ne të japim pasuri sa të duash, aq sa askush ndërmjet njerëzve të fiseve tona të mos jetë më i pasur se ti!

Nëse dëshiron të jesh kryetar, të bëjmë kryetarin tonë! Bëhu sunduesi i Mekkes!

Nëse mendon të martohesh me një grua fisnike, të japim gruan më të bukur nga Kurejshët!

Jemi gati të bëjmë çfarë të duash. Mjafton që të vish dhe të heqësh dorë nga kjo thirrje!”

Edhe i Dërguari i Allahut (s.a.v.s) menjëherë, duke iu përgjigjur të gjitha kërkesave të rëndomta dhe vetiake që bënë, tha:

*“-Unë nuk dua asgjë nga ju. As pasuri, as pronë, as sulltanat, as prijësi dhe as grua! Dëshira ime e vetme është të adhuroni vetëm Allahun duke hequr dorë nga putat e paafta që po adhuroni!”<sup>17</sup>*

I Nderuari ynë alejhissalatu uesselam e kaloi jetën e tij me përpjekjen e predikimit të fesë së Allahut dhe për këtë arsye, duke mos pasur nevojë nga njerëzit, nuk kërkoi asgjë për vete. I Nderuari ynë dhe të

16. Shik. Ibn Esir, el-Kamil, II, 64.

17. Shik. Ibn Hisham, I, 236



gjithë peygamberët, kanë përsëritur fjalën:

**“Unë nuk kërkoj asnjë lloj pagese si kundërvlerë të thirrjes që po ju bëj. Shpërblimin tim do të ma japë vetëm Allahu që është Zoti i botërave.”<sup>18</sup>**



Çfarë shfaqje morali të shkëlqyer është gjendja e Hazretit Musa alejhisselam.

Allahu thotë:

**“Kur Musai arriti te uji i Medjenit, gjeti disa njerëz që po u jepnin ujë bagëtime. Pak më larg tyre pa dy gra që ndalonin kafshët e tyre. U tha atyre: Çfarë halli keni? Ato u përgjigjën: Ne nuk u japim ujë kafshëve derisa të largohën barinjtë. Edhe babai ynë është shumë i vjetër”**. (el-Kasas, 23)

Ato ishin vajzat e Hazretit Shuajb alejhisselam, Safura dhe Sufejra. Edhe pse Musai alejhisselam ishte i uritur që prej tetë ditësh, edhe pse ndodhej në gjendje shumë vështirë, ai nxori ujë nga pusi dhe u dha kafshëve për të pirë. Gratë e falenderuan dhe u larguan.

Më vonë Shuajbi alejhisselam, duke e ftuar Hazreti Musanë në shtëpi, e nderoi me ushqim. Edhe pse Musai ishte i uritur prej disa ditësh, e refuzoi ushqimin. Shuajbi alejhisselam e pyeti për shkakun. Musai alejhisselam i dha këtë përgjigje të shkëlqyer:

“Ne jemi një familje e tillë që, sikur të na japin të gjithë botën, nuk e ndërrojmë me një vepër të ahiretit! Unë nuk ju kam ndihmuar për këtë ushqim, por për kënaqësinë hyjnore.”

Shuajbi alejhisselam u gëzua shumë ndaj kësajë përgjigjeje dhe tha:

“Nderimi ynë nuk është për arsye se na ndihmove, por ngaqë je miku ynë; hajde, ha!”

Pas kësaj, Musa alejhisselam, që ishte shumë i lodhur dhe i uritur, e pranoi ushqimin.

18. Shik. Esh-Shuara, 109, 127, 145, 164, 180; Junus, 72; Hud, 29.



Edhe ky shembull tregon se për të mos humbur shpërblimin e mirësive që bëhen për hir të Allahut, duhet që sinqeritetin që është në njet të mos e vrasim me asnjë gjë të ardhur si kundërvlerë e kësaj bote.



Një shembull sinqeriteti që ndodhi në udhëtimin e Tebukut, Vasile bin Eska radijallahu anhu na e tregon kështu:

“Në ditët kur do të niseshim për në udhëtimin e Tebukut (nuk kisha as forcë materiale, as kafshë rruge për të marrë pjesë në udhëtim. Për të mos ngelur i privuar nga ky udhëtim i bekuar), thirra kështu në Medine:

“Kush më le të hip në kafshën e tij, por që të mos jem i detyruar t’i jap si kundërvlerë pjesën që do të marr nga plaçka e luftës?!”

Një burrë i vjetër nga Ensarët tha se mund të më dërgonte në luftë duke hipur me radhë në kafshë. Kur menjëherë thashë “U kuptuam!”, ai tha:

“-Atëherë ec mbi bereqetin e Allahut!”

Kështu mora rrugën me një shok të mirë. Allahu na mundësoi edhe plaçkën e luftës. Pjesës time i takuan disa deve. I vura përpara ato dhe i dërgova te i moshuari Ensar. Ndërsa ai më tha:

“-Merri devetë e tua!”

Edhe mbasi thashë:

“-Sipas marrëveshjes që bëmë në fillim, këto janë të tuat”, Ensari më tha:

“-O vëlla! Merre plaçkën tënde të luftës! Unë nuk doja pjesën tënde materiale. (unë mendova të marr pjesë në sevap, domethënë në fitimin shpirtëror).” (Ebu Davud, Xhihad, 113/2676)

Ashabët e nderuar që përdornin bujarisht të gjitha mundësitë e tyre për të fituar kënaqësinë e Allahut, edhe kur dilnin për luftë në rrugë të Allahut, edhe kur ndihmonin një vëlla besimtar, e respektonin shumë të fshehtën e sinqeritetit dhe tregonin përpikmëri të madhe që



edhe një hije e vogël e interesave të përkohshme të mos përziheshin në mirësitë që bënin për hir të Allahut.



Aishja radijallahu anha, kur ndihmonte ndonjë të varfër, si kundërvlerë ndaj lutjes së të varfërit i përgjigjej me të njëjtën lutje. Kur u pyet:

“Si ndodh që edhe jep para, edhe lutesh?”, ajo dha këtë përgjigje:

“Kam frikë se lutja që bëri ai, është kundërvlera e lëmoshës sime. Lutem për të me të njëjtën lutje, ashtu që lëmosha ime të jetë e sinqertë. Kështu, shpërblimin e lëmoshës sime e pres vetëm nga Allahu.”<sup>19</sup>

Sa shembull i shkëlqyer sinqeriteti! Në të vërtetë, ata njerëz të bekuar kanë treguar një sensibilitet të madh për të mbrojtur sinqeritetin e tyre.

Sa e shkëlqyer është ndodhi që tregon thellimin dhe sensibilitetin e Hazretit Ali radijallahu anhu në sinqeritet:

Gjatë një beteje, Hazreti Ali kishte vënë poshtë një ushtar armik dhe po bëhej gati ta vriste. Në atë çast ushtari bëri një gjest shumë të shëmtuar, duke pështyrë fytyrën e begatë e të ndriçuar të Hazretit Ali.

Për Hazretin Ali, i cili ishte një person trim i Ehli Bejtit dhe “luani i Allahut”, nuk ishte e vështirë që me një të rënë t’ia fluturonte kokën atij qafiri që kishte vënë poshtë në sheshin e luftës. Por në atë çast, duke pasur frikë nga ndërhyrja e vetes në nijetin e luftës që ishte për hir të Allahut, ai ndaloi menjëherë dhe duke e ulur ngadalë armën që kishte në dorë, pra shpatën Dhulfikar që e kishte dhuratë nga Pejgamberi, hoqi dorë nga vrasja e armikut.

Ushtari, i cili kishte mbetur i shtrirë përtokë dhe po priste vdekjen në një gjendje të poshtëruar, u çudit shumë ndaj kësaj sjelljeje, sepse si rezultat i sjelljes së shëmtuar që bëri mendoi se Hazreti Ali do ta

19. Nexhati Jeniel-Hyzejn Kajapënar, Suneni Ebu Davud Terxheme ve Sherhi, Stamboll 1998, VI, 304.



vriste atë me një ashpërsi dhe zemërim më të madh. Por nuk ndodhi ashtu siç mendoi ai, përkundrazi u ndodh perballe një realiteti që as mund ta imagjinonte. Kështu, duke mos arritur ta kuptonte dot sjelljen e Hazretit Ali që ishte heroi i Islamit dhe i zemrës, pyeti me habi dhe merak:

“-O Ali! Përse ndalove kur po më vrisje? Përse hoqe dorë nga vrasja ime? Çfarë ndodhi që, nga një zemërim i ashpër dhe i papërshkruar, kalove në qetësi? Teksa po shpërtheje një rrufe, papritmas u paqtove si një kohë e qetë pa furtunë...”

Hazreti Ali radijallahu anhu tha:

“Këtë Dhulfikar që e kam dhuratë nga Hazreti Pejgamber, unë e përdor vetëm në rrugë të Allahut. Edhe kokat e armiqve të Allahut përsëri i pres për hir të Tij. Kurrë nuk e përziej veten në këtë... Ti, duke më pështyrë mua, doje të më zemëroje dhe të më poshtëroje. Kjo do të thotë se, nëse do të të vrisja në gjendje zemërimi, do të të vrisja për një shkak të zakonshëm siç është dëshira vetiake, gjë që nuk i ka hije kurrë një besimtari. Por unë luftoj për hir të Allahut dhe jo për të kënaqur krenarinë time.”

Së fundi zemra e armikut gjeti përsëri jetë përballë moralit të lartë të një njeriu që kishte ardhur për ta vrarë. Ai u nderua me besim duke marrë pjesë nga besimi, nga rezistenca ndaj vetes dhe sinqeriteti i Hazretit Ali.



Në tregun e bakrit në Bagdad pati rënë një zjarr i madh. Dy fëmijë kishin ngelur të rrethuar në njërin nga dyqanet që po digjeshin. Edhe pse fëmijët thërrisnin për ndihmë, nga shkak se flakët ishin shumë të ashpra, askush nuk guxonte t'i shpëtonte. Ndërsa pronari i fëmijëve thërriste jashtë i dëshpëruar: “Kush më shpëton fëmijët, do t'i jap dhjetë mijë flori!”

Në atë çast, po kalonte andej Hazreti Ebu'l-Hysejn Nuri i cili, kur e pa këtë ngjarje, hyri menjëherë në zjarr me butësi dhe mëshirë të madhe. Zjarri pothuajse u bë si një kopsht trëndafilash. Nën shikimeve e mbushura me habi të të pranishmëve, me ndihmën e Zotit, i moshuari





i nxorri fëmijët shëndoshë e mirë nga flakët e zjarrit.

Pronari i fëmijëve i ia dha florinj të me një gëzim të madh Hazretit Ebu'l-Hysejn Nuri. Ndërsa i moshuari befasisht i rrudhi vetullat dhe tha:

“Mbajni florinj të e tu dhe falendero Allahun Teala! Sikur unë ta kisha bërë këtë me shpresë të ndonjë kundërvlerë materiale dhe jo për hir të Allahut, kurrë nuk do të mund t'i nxirrja fëmijët nga ato flakë!”

Siç u pa edhe nëpërmjet këtij shembulli, me bereqetin e sinqeritetit shumë zjarre shndërrohen në kopështe trëndafilash. Por për të hyrë në zjarr, është e mundur vetëm duke ndryshuar me gjendjen e Hazretit Ibrahim i cili ishte miku i Allahut, domethënë me Ibrahimizëm. Sepse mosngurimi i tij nga zjarri, është një nder i veçantë që i kishte dhuruar Allahu si kundërvlerë e nënshtrimit ndaj Zotit me dashurinë dhe për zemërsinë e Zotit.



Sinqeriteti e tregon ndikimin e tij në çdo punë. Kur lëmosha e dhënë jepet me nijet të pastër, edhe nëse shkon te një njeri që nuk e meriton, ai që e jep fiton shpërblimin si kundërvlerë e sinqeritetit. Në lidhje me sinqeritetin e tij, edhe tek ata që e kanë dhënë linden prirje pozitive drejt mirësisë. Këtë të vërtetë, i Dërguari i Allahut (s.a.v.s) e ka treguar kështu:

*“Një herë një njeri kishte thënë:*

*Unë patjetër do të jap një lëmoshë. Në mbrëmje, pasi mori lëmoshën, doli nga shtëpia dhe pa e ditur, ia dha një hajduti. Të nesërmen populli i krahinës filloi të fliste:*

*Çudi! Këtë mbrëmje iu dha lëmoshë një hajduti! Njeriu tha:*

*O Allahu im! Falenderimi të takon Ty. Unë edhe sot do të jap një lëmoshë.*

*Përsëri, duke e marrë lëmoshën, doli nga shtëpia (edhe këtë rradhë pa e ditur) dhe ia dha një gruajë të pamoralshme. Të nesërmen populli filloi të fliste:*



*Gjë që s'bëhet! Këtë mbrëmje iu dha lëmoshë një gruaje të pandershme. Njeriu tha:*

*O Allahu im! Ty të takon falenderimi që i dhashë lëmoshë goftë edhe një gruaje të pamoralshme. Unë përsëri do të jap lëmoshë.*

*Atë natë përsëri mori lëmoshën, doli nga shtëpia e edhe këtë radhë, pa e ditur dhe ia dha një të pasuri. Të nesërmen populli filloi të fliste me habi:*

*Çështë kjo punë!? Edhe këtë mbrëmje iu dha lëmoshë një të pasuri. Njeriu tha:*

*O Allahu im! Ty të takon falenderimi që munda t'i jap lëmoshë goftë edhe një hajduti, një gruaje të pamoralshme dhe një të pasuri.*

*Për shkak të sinqeritetit të tij, njeriut iu tha në ëndërr:*

*Lëmosha që i dhe hajdutit, ndoshta do ta bëjë të turpërohet nga vjedhjet që ka bërë dhe të heqë dorë. Gruaja e pamoralshme ndoshta do të pendohet nga ajo që ka bërë dhe do të bëhet një grua e ndershme. Edhe i pasuri ndoshta ka për të marrë mësim nga kjo dhe do t'u japë të varfërve nga pasuria që i ka dhënë Allahu." (Buhari, Zekat, 14)*

Ja bereqeti i çiltërsisë dhe i sinqeritetit... Në hadithin fisnik tregohet rreth çiltërsisë dhe sinqeritetit që duhet të ketë në zemër njeriu kur të japë lëmoshën. Veçanërisht tregohet se nijeti është më i vlefshëm se vepra. Por, duke u nisur nga kjo, nuk duhet të pandehim se është një punë e virtytshme ta shpërndashë lëmoshën vend e pa vend. Përkundrazi besimtari, kur të japë lëmoshën dhe zekatin e tij, duhet të kërkojë sa të ketë mundësi dhe t'ia japë një nevojtar të vërtetë dhe njerëzve që e meritojnë më shumë.



Sa mësimdhënëse është edhe kjo ngjarje, e cila është një shfaqje e hadithit fisnik të mësipërm:

Gjatë një udhëtimi në Anadoll të Hazretit Sami Efendi në Yrgyp, një person duke kthyer makinën e tij, kërkoi nga ai para për cigare. Hazreti Sami Efendi që ishte një diell bujarie, megjithë kundërshtimin



shpirtëror të disa shokëve të rugës, tha: “Meqënëse i do, duhet me ia dhënë.” Kështu, pa u menduar fare ia dha personit paratë që kërkonte, mes shikimeve të habitura të atyre që ishin rreth e rrotull. I varfëri, i cili u gëzua për këtë, e ndërroi njetin e tij dhe, duke thënë: “Tani do të shkoj të marr bukë me këto para.” u largua me gëzim.

Ky është një shembull i qartë i cili flet për shfaqjen e mirësisë që lind si kundërvlerë e hallallit të pasurisë që jepet dhe pastërtisë së njetit.



Në vitet e para të historisë Islame në Medine Munevvere, një njeri i panjohur çdo mëngjes vendoste një thes ushqimesh në dyert e të varfërve. Një mëngjes, kur të varfërit u zgjuan, panë se te dera nuk ishte vendosur më thes ushqimesh. Në çastin kur po merakoseshin për këtë shkak, u dëgjua një zë i ndjeshëm salati dhe Medine Munevvere u trondit nga lajmi i vdekjes së nipit të Hazretit Ali radijallahu anhu, Hazretit Zejnelabidin. Gjithkush filloi të mbajë zi.

Detyrat e fundit ndaj këtij fëmije profetik filluan të bëhen me kujdes. Kur erdhi rradha për larjen e xhenazes së bekuar, personi që do ta bënte këtë detyrë, u habit kur në kurrizin e të vdekurit pa plagë të mëdha që kishin mbledhur ujë nga mbrenda. Nuk e kuptoi dot shkakun. Ndërsa, kur pyeti të afërmit e tij, njëri nga Ehli Bejt që gjindej aty e që kishte dituri për këtë të fshehtë, tha këto fjalë:

“-Hazreti Zejnelabidin çdo mëngjes, duke i mbajtur në shpinë thasët e ushqimeve që i kishte përgatitur, i dërgonte te dera e të varfërve herët dhe kthehej mbrapa pa e parë askush. Edhe njerëzit nuk e dinin se kush i kishte lënë këta thasë. Plagët që i shikoni në kurrizin e tij janë plagët e shkaktuara nga mbartja e atyre thasëve.” (Shik. Ibn Kesir, el-Bidaje, IX, 112; Ebu Nuajm, Hilje, III, 136)

Ja shfaqja e sinqeritetit në zembrën e një besimtari të mbushur me mëshirë, i cili i nënshtrohej Allahut me një shpirtmadhësi që do të transmetohet gjatë gjithë jetës për të mos vrarë shpërblimin e mirësive me lavdërimet e njerëzve...



Sa shembull i bukur i sinqeritetit është gjendja e Sulltan Alparsllanit, i cili e kishte zemrën bashkë me Zotin.

Alparsllani, para se të hynte në Luftën e Sheshit të Malazgirtit në 1071, veshi rroba të bardha dhe tha: “Ky është qefini im!” Domethënë e përgatiti veten e tij për të rënë dëshmor me dashurinë e një besimi të pastër dhe jo për famën botërore. Para se të hynte në luftë, u mbajti ushtarëve të tij këtë fjalim të shkurtër:

“Ose do të fitoj dhe do të arrij qëllimin tim, ose do të shkoj në xhennet si dëshmor. Ata që duan të më ndjekin mua, le të më ndjekin. Ata që duan të ikin, le të ikin! Këtu nuk ka sulltan që urdhëron dhe ushtar që urdhërohet. Sepse sot edhe unë jam një nga ju. Jam një luftëtar që luftoj bashkë me ju. Ata që më ndjekin mua dhe që bien dëshmorë duke ia dhuruar Allahut shpirtërat e tyre, do të fitojnë xhennetin, ndërsa ata që do të ngelin të gjallë, do të fitojnë luftën. Ndërsa ata që u ndanë, në ahiret i pret zjarri dhe në këtë botë i pret poshtërimi.”

Si shpërblim sinqeriteti, Zoti i dha Sulltan Alparsllanit fitore përballë Romen Dijozhen, i cili kishte një ushtri pesë herë më të madhe se ushtria e tij.

Siç u tha edhe më parë, vetëm njerëzit e sinqertë do mund të arrijnë shpëtimin e vërtetë. Vetëm të sinqertit janë gjithmonë përballë një provimi të madh dhe të rrezikshëm. Po ashtu edhe atentati që i ndodhi në jetë Alparsllanit, komandantit të madh të Islamit, ishte një formë provimi. Ashtu që:

Sulltan Alparsllani, pas fitores në Malazgirt në vitin 1072 me shumë kalorës mori rrugën për në Maveraunnehir. E rrethoi kalanë Hana që ndodhej mbi lumin Amuderya. Komandanti i kalasë ishte Jusuf el-Harezmi i cili i përkiste Batinijes që ishte një sekt i devijuar. Kur e kup-toi se kalaja nuk mund të qëndronte më shumë, njoftoi se u dorëzua. Ky tradhëtar, kur doli në prani të Alparsllanit, e sulmoi Sulltanin dhe e plagosi me hanxharin e tij. Jusuf el-Harezmin e vranë menjëherë, por edhe Sulltan Alparsllani nuk mundi të shpëtojë nga plagët që kishte marrë. Më datë 25 tetor 1072 u takua me Zotin e tij si dëshmor. Fjalët e fundit të tij ishin këto:

Allahu Teala dhe kërkoja ndihmë nga Ai. Dje, kur dola në krye të kodrës, më erdhi sikur mali poshtë këmbëve të mia dridhej nga numri i madh i ushtarëve të mi dhe nga madhësia e ushtrisë time. Nga zemra ime më erdhi një mendim: “Unë jam sunduesi i botës, kush mund të fitojë ndaj meje!” Ja, si rezultat i kësaj, Zoti më ndëshkoi me një rob të dobët të Tij. Për shkak të këtij mendimi që më kaloi nga zemra dhe për shkak të gabimeve dhe mëkateve që kam bërë më përpara, kërkoj falje nga Allahu dhe pendohem. La ilahe illallah Muhammedu’r-Rasulullah!..” patjetër që kjo gjendje është kontabiliteti i një ndërgjegje të sinqertë të një zemre të pastër.



Njërën nga miqtë e Zotit e pyetën:

“-O i nderuari ynë! A keni jetuar ndonjë ngjarje që ka ndikuar në çështjen e sinqeritetit?” ai tha:

“-Po, kam jetuar.” Dhe tregoi këto:

“-Në Mekke Mukerreme pata humbur qesen e parave dhe ngela në gjendje nevoje. Prisja para nga Basra, por nuk po vinin në asnjë lloj mënyre. Flokët dhe mjekrra ime ishin zgjatur shumë. Shkova te një berber dhe e pyeta:

Para nuk kam, a mund të m’i rregulloshë flokët për hir të Allahut? Në atë moment berberi po qethte një njeri tjetër. Menjëherë më tregoi vendin e lirë që ishte afër tij dhe më tha: “Ulu këtu” dhe duke e lënë tjetrin, filloi të më qethte mua. Njeriu kundërshtoi. Berberi tha:

“Ju kërkoj ndjesë, ju po ju qeth në kundërvlerë të pagesës, por ky person deshi ta qeth për hir të Allahut. Punët që bëhen për hir të Allahut gjithmonë kanë përparësi dhe nuk kanë kundërvlerë. Robërit kurrë nuk mund ta dinë dhe nuk mund ta paguajnë kundërvlerën e veprës që është për hir të Allahut.

Berberi, pasi më qethi, më futi në xhep me insistim disa florinj dhe tha:

“-Kryej me to nevojat tua emergjente, kaq kam mundësi, të kërkoj ndjesë!”



Kaluan disa ditë. Paraja që prisja nga Basra, më erdhi. I dërgova berberit një qese me florinj. Ai tha:

“Kurrë nuk mund t’i marr! Robërit nuk kanë fuqi të paguajnë kundërvlerën e veprës që është për Allahun. Rrofshi, vazhdoni rrugën tuaj, Allahu ju dhashtë paqe!”

Ja bëmë hallall njëri tjetrit dhe u ndava, por u bënë plot dyzet vjet që ngrihem natën dhe lutem për të.”

Ja, Zoti, kundërvlerën e veprave të mira dhe mirësive që bëhen për Të me një mënyrë të sinqertë, e jep në një bukuri që i përshtatët famës së Tij.



Në shoqërinë Osmane, në ditët e Ramazanit, shumë të pasur shëtitnin nëpër vende të panjohura fare me rroba të ndryshme dhe duke shkuar te tregëtarët e vendit, kërkonin prej tyre që të nxirrnin fletoren e veresijes. Paganin sasinë që dilte nga mbledhja e borxhëve të shkruajtura nëpër disa faqe që ua kapte dora dhe pasi thonin:

“I fshini këta borxhe! Pranoje o Allahu im!” largoheshin pa i njohur dikush.

Atij që i paguhej borxhi, nuk e dinte se kush ia ka paguar, edhe ai që fshinte borxhin nuk e dinte së kë ka shpëtuar nga borxhi. Personat që e dinin se lëmosha nafile e dhënë fshehtas është më e pranueshme se ajo që jepet haptas, aq sa kishin mundësi, mundoheshin që ndihmat e tyre t’i bënin fshehtas. Stërgjyshërit tanë, atë që e jepnin me dorë të djathë e fshihnin edhe nga dora e majtë. Edhe mirësitë që i bënin, i harronin menjëherë.

Të mëdhenjt e miqve të Allahut thonë që harroji dy gjëra:

1. Mirësitë që ke bërë ashtuqë të të mos japin egoizëm dhe vetë-pëlqim.

2. Të këqiat që të janë bërë ashtuqë në zemrën tënde urrejtja dhe zemërimi të mos shpërthejnë sytha.



Së fundi sinqeriteti është një xhevahir që fitohet vështirë dhe mbrohet vështirë ashtuqë vlerën e tij nuk mund ta vlerësojë askush përveç Allahut. Sepse dritaret e zemrës janë të hapura ndaj Allahut. Sinqeriteti është një kriter i lartë që e bën robin të fitojë grada të larta edhe në këtë botë, edhe në ahiret dhe që e afron te Allahu. Allahu Teala nuk i pranon veprat e privuara nga sinqeriteti. Veprat që bëhen me sëmundje shpirtërore si pëlqimi i vetes dhe hipokrizia, në ditën e gjykimit i hidhen në fytyrë vepruesit si një rrobë e vjetër dhe e hedhur. Ndërsa Allahu Teala, duke i dhënë bereqet sinqeritetit, veprën e paktë të robit e bën shumë, ia bën jetën të gjatë dhe begatinë të përherëshme.

### 3. Devotshmëria

Devotshmëria është mbrojtja e zemrës nga gjërat e kësaj bote, domethënë nga gjithçka që e largon nga Allahu dhe të ardhurit në një gjendje reflektuese të shfaqjeve të bukurosisë. Devotshmëria është të mbrojturit e besimtarit më përpikmëri nga gjërat që i bëjnë dëm dhe i japin dhimbje në ahiret duke u mbështetur në mbrojtjen e Allahut dhe kryerja e punëve të mira duke u larguar nga mëkatet.

Krenaria e Gjithësisë, i Nderuari ynë ,duke i treguar Ebu Zerrit radijallahu anhu se devotshmëria është e vetmja peshore e vlerës dhe e pranimit te Allahu, është shprehur kështu:

*“Shiko! Ti nuk je as më i lartë se i kuqi, as se i ziu. Përballë atyre mund të bëhesh më i lartë vetëm me devotshmëri.”* (Ahmed, V, 158)

Përsëri i Nderuari ynë (s.a.v.s), duke thënë:

*“Unë jam më i devotshmi nga ju.”* (Buhari, Iman, 13; Muslim, Sijam, 74), në çdo fushë të jetës ka lëvizur me masat e devotshmërisë. Ja, për këtë shkak, për t’u bërë një besimtar i devotshëm, është kusht të zbatojmë sunnet-i seniyye të të Dërguarit të Allahut (s.a.v.s).

Sa bukur e përshkruan devotshmërinë Hazreti Isa alejhisselam:

Një person, duke ardhur te Isai alejhisselam, pyeti:

“-O mësuesi i mirësive! Si mund të bëhet i devotshëm një rob ndaj Allahut?”

Isa alejhisselam dha këtë përgjigje:

“-Kjo është një punë e lehtë. Duaje Allahun Teala nga shpirti dhe zemra me atë që e meriton. Bëj vepra të mira për hir të Tij sa të keshë mundësi. Ji i mëshirshëm dhe i butë si ulluk edhe ndaj bijve të Ademit, edhe ndaj vetes tënde!” Pastaj tha kështu:

“-Mos i bëj dikujt diçka që nuk dëshiron të të bëhet ty! Atëherë do të bëhesh i devotshëm ndaj Allahut me atë që e meriton!” (Ahmed, ez-Zuhd, fq. 59)

Edhe Hazreti Omer radijallahu anhu e pyet një ditë Ubej bin Kabin se çfarë është devotshmëria. Ubej radijallahu anhu i tha:

“-O Omer, a ke ecur ndonjëherë në rrugë me ferra?”

Kur Hazreti Omer u përgjigj:

“-Po, kam ecur.” Këtë rradhë e pyeti:

“-Shumë mirë, po çfarë bëje?”

Hazreti Omer u përgjigj:

“-I mblidhja rrobat e mia dhe mundohesha me gjithë mundësinë që fërrat të mos më dëmtojnë.”

Mbi kërë Hazreti Ubej bin Kab tha:

“-Ja, kjo është devotshmëria.”<sup>20</sup>

Kulmi i devotshmërisë është ikja nga kufri dhe shirku siç ikën për të mos rënë në zjarr. Edhe shfaqja e kësaj është kryerja e farzeve më atë që e meritojnë dhe largimi nga mëkatet.

I Nderuari ynë (s.a.v.s) ka thënë:

*“Kudo që të ndodhesh, ji i devotshëm ndaj Allahut dhe menjëherë pas mëkatit, bëj një të mirë ashtuqë kjo ta zhdukë (fshijë) atë. Edhe ndaj njerëzve sillu me moral të mirë!”* (Tirmidhi, Birr, 55/1987)





Gjendja kulminante e devotshmërisë është drejtimi i robit me të gjithë qënien e tij për te Allahu Teala duke u larguar nga çdo gjë që e bën zemrën e tij të shkujdesur nga Ai. Kjo gradë nuk ka fund. Ja kjo fazë e fundit është devotshmëri e vërtetë që urdhërohet në ajetin fisnik:

**“O ju që keni besuar, kini frikë Allahun me sinqeritet të vërtetë dhe mos vdisni vetëm se duke qenë muslimanë (besimtarë)!”**

(Ali Imran, 102)

Për të arritur përsosmërinë në devotshmëri, duhet të largohemi menjëherë edhe nga gjërat e dyshuara. I Dërguari i Allahut thotë:

*“Robi, derisa të mos largohet edhe nga disa gjëra që nuk janë problematike me frikën së po bie në gjëra problematike, nuk mund të arrijë gradën e të devotshmëve të sinqertë.”* (Tirmidhi, Kijame, 19/2451; Ibn Maxha, Zuhd, 24)

Abdullah bin Omer radijallahu anhu ka paralajmëruar:

“Robi, nuk mund të arrijë gradën e devotshmërisë derisa të mos i lërë gjërat që e shqetësojnë dhe që i gërvishin zemrën.” (Buhari, Iman, 1)

Robi, për t’u bërë i devotshëm, gjithmonë duhet t’i kërkojë llogari vetes, sepse për të rezistuar ndaj dëshirave të ashpra të nefsi emmares dhe për t’u mbrojtur nga katastrofat e saj, është e mundur vetëm me forcimin e ndjenjës së devotshmërisë.

Jusufi alejhisselam për të mos besuar mashtrimet e dhjetra gjërave shumë tërheqëse që i shfaqeshin, duke thënë “Zoti më ruajt”, vuri në pah se zgjidhja e vetme është “mbrojtja te Allahu” me një devotshmëri të lartë. Edhe kjo, për të hyrë në fazën e ndihmës hyjnore, tregon se devotshmëria është e nevojshme.

Edhe Krenaria e Gjithësisë i Nderuari ynë, në lutjet e tij, i lutej kështu Allahut që ti japë devotshmëri:

*“O Allahu im! Më jep devotshmëri dhe më pastro! Ti je ai që më pastron më mirë. Ti je kujdestari dhe Zoti im.”* (Muslim, Dhikr, 73)

*“O Allahu im! Kërkoj nga Ti udhëzim, devotshmëri, nder dhe pasuri shpirtërore.”* (Muslim, Dhikr, 72)

Njeriu më i lartë te Allahu është i devotshmi.<sup>21</sup> Allahu Teala i do robërit e tij të devotshëm<sup>22</sup> dhe është gjithmonë me ta.<sup>23</sup> Të devotshmëve u ka premtuar xhennetin gjërësia e të cilit është sa qiejt dhe toka.<sup>24</sup> Përsëri Allahu, robit të tij të devotshëm, i jep një inteligjencë që i shërben për të ndarë të mirën nga e keqja dhe i fal mëkatet e tij.<sup>25</sup> Në çaste të vështira i tregon shumë rrugë dhe i jep rizik nga nuk shpresohet. Ia lehtëson punët, ia fal të këqiat dhe i jep shumë shpërblime.<sup>26</sup>

Po ashtu, sipas transmetimit të Ebu Dherrit radijallahu anhu, një ditë i Dërguari i Allahut tha:

*“Unë di një ajet. Sikur njerëzit ta zbatonin, do të ishte i mjaftueshëm për të gjithë.”*

Ashabët e nderuar thanë:

“O i Dërguari i Allahut, cili ajet është ky?”

I Dërguari i Allahut lexoi ajetin:

**“...Kush i përmbahet dispozitave të All-llahut, Allahu i hap një rrugë atij.”** (et-Talak, 2) (Ibn Maxhe, Zuhd, 24)

Njerëzit që janë më afër Pejgamberit nga ana shpirtërore, janë të devotshmit. Muadh bin Xhebel thotë:

Kur i Dërguari i Allahut po më dërgonte mua si përfaqësues në Jemen, duke më përcjellë, erdhi deri jashtë Medines. Unë isha mbi kafshë, ndërsa Ai po ecte. Pasi më dha disa këshilla tha:

*“O Muadh! Ndoshta pas këtij viti nuk do mund të më shohësh më! Mundet që të vizitoshë xhaminë dhe varrin tim!”*

Kur i dëgjova këto fjalë, fillova të qaj me mërzitjen që jep ndarja prej mikut, domethënë prej të Dërguarit të Allahut. I Dërguari i Allahut tha:

---

21. Shik. el-Hucurat, 13.

22. Shik. Ali Imran, 76.

23. Shik. en-Nahl, 128.

24. Shik. Ali Imran, 133.

25. Shik. el-Enfal, 29.

26. Shik. et-Talak, 2-5.



“-Mos qaj o Muadh!” dhe duke e kthyer fytyrën drejt Medines, tha:

“-Ata që janë më afër meje nga njerëzit, kushdo qoftë dhe kudo që të jenë, janë të devotshmit të cilët kanë frikë Allahun.”<sup>27</sup>

I Nderuari ynë ka thënë:

“Pa dyshim që miqtë e mi janë të devotshmit.” (Ebu Davud, Fiten, 1/4242)

Një zemër që arrin përsosmërinë në devotshmëri, tashmë fiton nderin për të qenë vendi ku shikon Zoti dhe vendi i shfaqjeve të urtësive dhe të fshehtave hyjnore.

### *Tabllo të virtytshme*

Miqtë e Zotit që janë dijetarë të vërtetë si Imam Azami, Imam Shafii dhe Imam Ahmed bin Hanbeli, e kanë kaluar jetën e tyre në kriteret e devotshmërisë. Poashtu, një herë ata që e panë Imam Ebu Hanifen kur po pastronte një papastërti në rrobën e tij, e pyetën:

“O Imam! Sipas fetvasë që keni dhënë kjo papastërti e vogël nuk është pengesë për namazin, përse po heq keq për ta pastruar atë?”

Hazreti Imam Azam tha:

“-Ajo është fetva ndërsa kjo është devotshmëri!..”

Siç u pa edhe më sipër devotshmëria është një përpikmëri dhe sensibilitet i madh që tregohet ndaj urdhërave dhe ndalesave të Allahut.

Sa mësim dhënëse është gjendja e kësaj zonje të devotshme që nuk fliste fjalë tjetër përveç ajeteve të Kur’anit me frikë se mos bie në mëkat:

Hazreti Abdullah bin Mubarek tregon:

E vizitova Bejtu’l-Haram të Allahut (Qaben) dhe mora rrugën me qëllimin për të vizituar varrin e Pejgamberit (s.a.v.s). Në rrugë pashë një njollë të zezë. Pashë me kujdes, por çfarë të shikoja? Një grua të

27. Ahmed, V, 235; Hejsemi, Mecmau’z-Zevaid, Bejrut 1988, IX, 22.



vetme që kishte një copë të zezë në kurriz dhe një shami prej leshi në kokë!.. Duke i thënë:

“-Esselamu alejkum ue rahmetullahi ue berakatuhu!” i dhashë selam.

Edhe ajo duke lexuar ajetin e sures Jasin:

“(Ky) **Është selam nga Zoti i mëshirshëm i tyre!**” (Jasin, 58) më ktheu selamin.

E pyeta: “-Allahu të dhashtë mirësi! Çfarë bën këtu?” Ajo më lexoi këtë pjesë nga ajeti 186 i sures A’raf:

“**Atë që e humb Allahu nuk ka kush ta udhëzojë...**” E kuptova që ka humbur rrugën dhe ka ngelur aty. E pyeta:

“-Ku dëshiron të shkoshë? Ajo më lexoi këtë pjesë nga ajeti 1 i sures Isra:

“**...Ai që në një natë e mori robin e Tij nga Mesxhidi Haram dhe e dërgoi te Mesxhidi Aksa..**” E kuptova se ajo ka bërë haxhin dhe dëshiron të shkojë në Bejtu’l-Makdis (Kuds). E pyeta:

“-Sa ditë u bënë që je këtu?” Ajo më lexoi këtë pjesë nga ajeti 10 i sures Merjem:

“**...Ti sa te jeshë shëndoshë e mirë, tri net...**”

I thashë: “-Nuk paske edhe ndonjë ushqim për të ngrënë?” Ajo më lexoi ajetin 79 të sures Shuara:

“**Ai ëshë i cili më jep për të ngrënë dhe për të pirë!**”

E pyeta: “-Me çfarë merr abdes në këtë shkretëtirë pa ujë?” Ajo më lexoi këtë pjesë të ajetit 43 të sures Nisa:

“**...Nëse nuk mund të gjeni ujë, atëherë merrni tejemmum me dhe të pastër...**”

I thashë: “-Unë kam ushqim.” Ajo më lexoi këtë pjesë të ajetit 187 nga sureja Bakara:

“**...Pastaj, plotësojeni agjërimin deri në mbrëmje!..**”



I thashë: “-Ky muaj nuk është muaji i Ramazanit?” Ajo më lexoi këtë pjesë të ajetit 158 të sures Bakara:

**“...Kush bën ndonjë të mirë (nga veprat që nuk janë vacib), pa dyshin që Allahu është shpërblyes dhe i gjithëdijsëm!”**

I thashë: “-A na është bërë i lejuar të ngrënit në udhëtim?”

Ajo më lexoi këtë pjesë të ajetit 184 nga sureja Bakara:

**“...Nëse e dini, agjërimi është më mirë për ju.”**

E pyeta: “-Përse nuk flet me mua siç flas unë me ty?” Ajo më lexoi ajetin 18 të sures Kaf:

**“Njeriu nuk thotë ndonjë fjalë e që pranë tij të mos ketë një melek vëzhgues dhe i gatshëm për të shkruajtur!”**

I thashë: “-Po të vë në devenë time që të të dërgoj te karvani yt.” Ajo më lexoi këtë pjesë të ajetit 197 të sures Bakara:

**“...Çfarëdo të mire që të bëni, Allahu e di...”**

Menjëherë e përgatita devenë për ta hipur atë. Ajo lexoi këtë pjesë të ajetit 30 nga sureja Nur:

**“U thuaj besimtarëve t’i ruajnë shikimet nga harami!..**

Kur hypi në deve lexoi këtë pjesë të ajeteve 13-14 të sures Zuhruf:

**“...Falenderimi i takon Allahut i cili i nënshtroi këto për ne, sepse ne nuk do të kishim mundësi ta bënim këtë. Patjetër që ne do të kthehemi te Zoti ynë.”**

Kur filloi rrugën, lexoi këtë pjesë të ajetit 20 të sures Muzemmil:

**“...Tashmë lexoni nga Kur’ani atë që ju duket më e lehtë!..”** Edhe unë, lexova këtë ajet:

**“...Kujt i është dhënë urtësia, patjetër që i është mirësi shumë e madhe...”** (el-Bakara, 269) dhe me frymëzim i thashë:

“-Ty të është dhënë shumë mirësi!” Edhe ajo lexoi pjesën vazhduese të këtij ajeti:



**“...Por askush nuk mendon përveç të mençurve!”** (el-Bakara, 269)

Së fundi e arritëm karvanin dhe i thashë:

“-Ja ky është karvani yt! Kë ke nga njerëzit e tu aty?” Ajo më lexoi këtë pjesë të ajetit 46 të sures Kehf:

**“Pasuria dhe fëmijët janë stoli e kësaj bote...”** E kuptova se në karvan ka bijtë e saj.

E pyeta: “-Çfarë detyre kanë ata në karvanin e haxhit?” Ajo më lexoi ajetin 16 të sures Nahl:

**“(Krijoi) shumë shenja. Ndërsa ata orjentojnë me anë të yjeve.”** E kuptova se bijtë e saj janë udhëzues në karvan. Duke i treguar çadrat dhe vendet e ushqimit të tyre, e pyeta:

“-Kush nga këta janë bijt e tu? Ajo më lexoi pjesën e fundit të ajetit 125 të sures Nisa:

**“...Allahu e bëri mik Ibrahimin.”** Pastaj lexoi këtë pjesë nga ajeti 164: **“...Me të vërtetë Allahu foli me Musain.”** Pastaj lexoi pjesën e parë nga ajeti i 12 i sures Merjem: **“O Jahja! Merre librin tënd me shumë kujdes...”** Edhe unë mbi këtë kur thirra:

“-O Ibrahim! O Musa! O Jahja!” dolën tri djem si copa hëne. Kur erdhën dhe u ulën, nëna e tyre u lexoi këtë pjesë të ajetit 19 të sures Kehf:

**“...Tani dërgojeni njërin prej jush në qytet me këtë argjend, të zgjedhë ushqimin më të pastër dhe tjua sjellë juve...”** Njëri nga djemtë, shkoi, mori ushqim dhe ma vendosën mua përpara. Gruaja lexoi ajetin 24 të sures Hakka:

**“Hani dhe pini si shpërblim i të mirave që keni bërë në ditët e kaluara!”** Por unë u thashë bijve të saj:

“-Haram më qoftë ushqimi juaj po nuk më treguat gjendjen e nënës tuaj!” Djemt mbi këtë thanë:

“-Nëna jonë që prej dyzet vjetësh nuk thotë asgjë përveç ajeteve të Kur’anit me frikë se mos bie në ndonjë gabim ndaj Allahut i cili është i Mëshirshëm. Edhe unë lexova ajetin e katërt të sures Xhuma:

**“Kjo është mirësi e Zotit i cili ia jep kujt të dojë. Allahu po-**



sedon mirësi të madhe!”<sup>28</sup>



Devotshmëria ka nevojë që t'i lëshë gjërat e dyshimta me frikë se mos bie në haram bile edhe disa gjëra të lejuara. Një shembull i kësaj është kështu:

Sulltan Abdulaziz Han i cili e solli ushtrinë dhe flotën e saj në një shkallë që të magjepste syrin, që zhduku trazirat e mbrendëshme me një politikë të shkëlqyer dhe që në këtë mënyrë filloi ta ngre shtetin drejt pozitës së vjetër me reputacion, tërhoqi vëmendjen e të gjithë botës. Për këtë arsye Sulltani u ftua në Francë dhe Angli.

Abdulaziz Hani që ishte një padishah shumë fetar, solli me vete guzhinjerë nga Bolluja duke menduar se ushqimet e Europianëve janë problematike nga ana e sheriatit.

Abdulaziz Han ishte një njeri i mirë që jetonte shumë fetarisht dhe në mënyrë të sistemuar. Ishte i devotshëm saqë gjatë gjithë jetës së tij në vend të ujit ka pirë zemzem. Bile transmetohet se, kur udhëtonte për në Europë, e merrte me vete ujin e abdesit. Namazin e falte në mënyrë të sistemuar dhe lexonte shumë Kur'an. Kur ra dëshmor në një mënyrë gjakpirëse, në tavolinën që ishte në dhomën e tij, u gjet një Kur'an Fisnik i hapur te **“Sureja Jusuf”**. Ky Kur'an Fisnik i përlyer me gjakun e bekuar të tij, tani ruhet në kështjellën e Topkapësë.

Në hadithin fisnik thuhet:

*“Njeriu vdes mbi gjendjen që jeton dhe do të tubohet mbi atë gjendje që ka vdekur.”<sup>29</sup>*



Edhe një personalitet tjetër historik që ka jetuar mbi masat e devotshmërisë sensibël, është Abdulhamid Han i Dytë. Ai, kur dilte ndonjë punë urgjente, kërkonte që ta zgjonin qoftë në çdo lloj kohe të natës dhe nuk kënaqej që ta linte për ditën tjetër. Në këtë çështje

28. M. Asëm Këksall, Kitap ve Sunnet, Stamboll, 1999, 21-25.

29. Shik. Muslim, Xhennet, 83; Munavi, Fejzu'l-Kadir, Bejrut 1994, V, 663.



kryeshkrimtari i administratës Zotëria Es'ad, në kujtimet e tij thotë kështu:

Në një mesnatë trokita derën e Sulltanit për firmën e një dokumenti, por nuk u hap. Pasi prita pak, trokita përsëri, por përsëri nuk u hap. U shqetësova: “A mos i ka ardhur Sulltanit urdhëri i vërtetë” (vdekja). Pas pak trokita përsëri. Këtë rradhë dera u hap dhe Sulltani doli te dera me një peshqir. Po fshinte fytyrën. Buzëqeshi dhe tha:

“-O biri im! E kuptova se në këtë kohë ke ardhur për një punë të rëndësishme. Që në trokintjen e parë të derës, u zgjova, por u vonova ngaqë mora abdes! Sepse u bënë shumë kohë që unë nuk kam firmosur pa abdes asnjë dokument të popullit... Sille ta firmos...” dhe duke thënë besmelenë, e firmosi dokumentin.”

Gruaja e Abdulhamidit të dytë, në lidhje me sensibilitetin e tij, ka transmetuar kështu:

Abdulhamid Hani në krye të krevatit gjithmonë vendoste një tullë të pastër. Kur ngrihej nga shtrati, merrte tejemmum me tullën që të mos shkelte asnjë vend pa abdes derisa të shkontë të vendi i çezmës. Një herë, kur e pyeta për shkakun e kësaj, u përgjigj:

**“Si një halife e gjithë këtyre myslimanëve, nëse ne nuk i kemi kujdes kriteret e sunnetit, ummeti i Muhammedit ka dëm nga kjo!..”**

Jeta e devotshme e solli atë në një gjendje gjeniu edhe në politikë. Konceptimin e tij e shënoi në historinë botërore me administrimin e tij në vitet më të vështira dhe më të rrezikshme.



Së fundi, devotshmëria është baza e fesë dhe koka e veçorive që zbukurojnë jetën shpirtërore. Kapitali më i madh i lumturisë së ahiretit është devotshmëria. Një jetë pa devotshmëri është e mbushur me rreziqe. Një jetë që nuk jetohet mbi devotshmëri, bëhet shkak i fatkeqësisë së frymës së fundit –Zoti na ruajt- që tregon hadithi fisnik “*Si të jetoni, ashtu do të vdisni.*” (Munavi, V, 663) dhe si rezultat bëhet shkak edhe i humbjes së përhershme. Në këtë botë, për tu ruajtur nga





e keqja e dëshirave vetjake është e domosdoshme që të kalojmë një jetë të përpiktë dhe të kujdesshme siç ecim në një tokë të minuar.

Luftërat bëhen në vende dhe në kohëra të caktuara dhe mbarojnë. Ndërsa përpjekja e devotshmërisë që ndërmerret kundra vetes, duhet të vazhdohet pa shkëputje gjatë gjithë jetës. Në ajetin fisnik thuhet:

“...Dhe adhuroje Zotin tënd derisa të të vijë e vërteta (vdekja!)” (el-Hixhr, 99)

“Allahu na mundësoftë të vazhdojmë adhurimin mbi devotshmëri dhe na mundësoftë që të jemi gjithmonë të zgjuar ndaj “pakujdesisë” që hap derë ndaj hileve dhe kurtheve të vetes tonë!..”

Amin!..

#### 4. Pendimi dhe kërkimi i faljes

Kur mposhtet nga dëshirat vetjake dhe humb begatinë e ndjenjën shpirtërore të besimit, njeriu anon nga mëkatet. Kur mbaron ndihma e moralit në ndërgjegje, humbet edhe mendjemprehtësia dhe thellimi shpirtëror dhe lind një dobësim serioz në rrugën e të qenit posedues i drejtimit. Mëkatet fillojnë të duken joshëse si një muzikë e ëmbël dhe njeriu mund të veprojë sikur nuk e ndjen fare peshën e mëkatit.

Por njeriu vjen në botë si pasqyrë e pastër dhe e qartë e pafajësisë. Edhe feja është shfaqje mëshire e dhuruar njeriut nga Allahu për të mbrojtur pastërtinë e kësaj natyre. Për këtë arsye, robi mund ta ruajë pastërtinë që ka në natyrën e tij dhe, në rastet kur hap perdet e pakujdesisë duke marrë pjesë nga ndjenja shpirtërore e fesë së tij, sa herë bën ndonjë faj e ndjen peshën e tij në ndërgjegje. Për këtë arsye, ndjenjat e virtutshme që janë të fshehta në këtë botë, zgjohen duke u holluar. Zemra e tij digjet thellë nga një pendim i madh, e kësaj me lotë të ngrohtë ia hap zemrën Zotit të tij. Ja, kjo djegie dhe ky pishmanllëk është “pendimi”. Ndërsa përgjërimit që shpërthejnë nga zemrat, janë “kërkimi i faljes”.



Mëkatet janë pengesë për të hyrë në xhennet, por nga ana tjetër edhe pendimet që përforcohen me punë të mira dhe që bëhen me djegien e zemrës, janë shkaqet e mbrojtjes nga xhehennemi.

Pejgamberi (s.a.v.s) ka thënë kështu:

*“Kur robi bën një mëkat, në zemrën e tij i bëhet një pikë e zezë. Nëse e lë atë mëkat dhe duke kërkuar falje i drejtohet pendimit, zemra i ndriçohet. Nëse nuk bën kështu dhe u kthehet përsëri mëkateve, pikat e zeza shtohen dhe së fundi e mbulojnë zemrën. Ja kjo është gjendja që ka përmendur Allahu Teala:*

**“Jo, nuk është ashtu! Por të këqijat që vepruan, ua mbuluan zemrat e tyre.”** (el-Mutaffin, 14) (Tirmidhi, Tefsir, 83/3334)

Edhe në një tjetër hadith fisnik thuhet:

*“Vuajtja më e madhe është vuajtja e mëkatit. Ilaçi i tij është kërkimi i faljes në errësirën e natës.”<sup>30</sup>*

Kur nevoja e njeriut bie në çfarëdo lloj mëkati, mënjëherë është e domosdoshme që të pendohet, të kërkojë falje dhe t'i drejtohet Allahut, sepse Zoti, robërit e devotshëm nga të cilët është i kënqur, i lavdëron kështu:

**“Edhe ata të cilët, kur bëjnë ndonjë mëkat të shëmtuar, ose kur e dhunojnë veten e tyre, e përkujtojnë Allahun dhe kërkojnë falje për mëkatet e tyre. Në të vërtetë kush i fal mëkatet përveç Allahut? Ata, duke e ditur, nuk vazhdojnë në punët që patën vepruar.”** (Ali Imran 135)

**“Të devotshmit, flinin pak natën dhe kërkonin falje për mëkatet.”** (edh-Dharijat, 17-18)

Zoti njofton në shumë ajete se do t'i falë robërit e tij që pendohen në mënyrë të sinqertë. Madje, duke ua bërë të ditur se do t'i shndërrojë në sevape mëkatet e atyre që kthehen tek Ai me një pendim të sinqertë, Allahu thotë kështu:

**“Përveç atyre që pendohen dhe bëjnë vepra të mira, Allahu të këqijat e tyre i shndërron në të mira. Allahu është mëshirues**



**dhe falës.**” (el-Furkan, 70)

Edhe Profeti i nderuar thotë:

*“Allahu Teala natën hap dorën e Tij për të pranuar pendimin e atij që ka bërë mëkat ditën. Ditën hap dorën e Tij për të pranuar edhe pendimin e atij që ka bërë mëkat natën. Derisa të lindë dielli nga vendi që perëndon, domethënë deri në kiamet, kjo do të vazhdojë kështu.”*  
(Muslim, Pendimi, 31)

Por sinqeriteti dhe pastërtia janë kushtet më kryesore në pendim. Një person që e prish vazhdimisht pendimin e tij, do të thotë se është bërë tashmë një maskara i shejtanit. Allahu thotë:

**“Premtimi i Allahut është i sigurtë. Pra le të mos ju mashtrojë jeta e kësaj bote dhe të mos ju mashtrojë djalli ndaj Allahut.”**  
(Llukman, 33)

Nga një anë tjetër, pendimi dhe kërkimi i faljes janë shkak për shpëtimin nga ndëshkimi në këtë botë dhe në ahiret. I Dërguari i Allahut (s.a.v.s) thotë:

*“Allahu Teala më ka zbritur dy përgëzime për ummetin tim:*

1. **Derisa ti të jesh në mes tyre, Allahu nuk do t'i ndëshkojë ata.**
2. **Përderisa ata të kërkojnë falje, Allahu nuk do t'i ndëshkojë ata.** (el-Enfal, 33)

*Kur unë të ndahem prej tyre, ummetit tim do t'i lë kërkimin e faljes deri në kiamet i cili është përgëzimi i dytë që e ndalon ndëshkimin e Allahut.”* (Tirmidhi, Tefsir, 8/3082)

Pendimi dhe kërkimi i faljes me natyrën e vërtetë të tyre, për shkak se janë një strehim dhe keqardhje e thellë, janë shkak i vetëm i dëlirjes nga papastërtitë shpirtërore. Një pendim i pranuar heq pengesat dhe perdet që janë ndërmjet robit dhe Zotit dhe arrin dashurinë e Allahut Teala. Po ashtu, Allahu thotë:

**“Me të vërtetë Allahu i do ata që pendohen dhe ata që pastrohen.”** (Bakara, 222)

Pejgamberi ynë, për të treguar se sa këaqet Zoti ynë me pendimin



e njerëzve, na jep këtë shembull:

*“Kënaqësia që ndjen Allahu Teala për shkak të pendimit të çdonjërit prej jush, është më e madhe se sa gëzimi i një personi i cili, duke udhëtuar në shkretëtirë të zhveshur humb devenë bashkë me ushqimet që ishin mbi të. Duke e humbur plotësisht shpresën për ta gjetur devenë, pasi që kërkimi nuk i ka sjellë ndonjë dobi, shkoi dhe shtrihet nën hijen e një peme. Në atë moment sheh që vjen deveja. E kap për kapistre dhe duke u ngatërruar fjalët, thotë: O Zoti im, ti je rob i im dhe unë jam Zoti yt.”* (Muslim, Pendimi 7; Tirmidhi, Kiamet 49, Deavat 99)

I Dërguari i Allahut (s.a.v.s) në disa hadithe të tjera të tij i ka treguar kështu dobitë e kërkimit të faljes:

*“Nëse një person nuk e heq nga gjuha e tij kërkimin e faljes, Allahu Teala i tregon një rrugëdalje në çdo gjendje të vështirë dhe një rrugë shpëtimi nga çdo pikëllim duke i dhënë atij rizk atij nga një vend që nuk e shpreson.”* (Ebu Davud, Vitir, 26/1518; Ibn Maxha, Edukata, 57)

Por çështja më kryesore e robërve është pastrimi i vetes dhe i zemrës. Ndërsa pendimi dhe kërkimi i faljes që kemi shpjeguar deri tani, është në lidhje vetëm me derën e fitimit të kësaj gjendjeje. Të bësh punë të mira pasi të hysh nga kjo derë, sigurisht që është e domosdoshme. Pasi të kryejmë farzet, vaxhibet dhe synetet mbi kriteret e tyre, veçanërisht duhet të kemi veçori të bukura si: përpikmëria ndaj të drejtës së robit, respekti ndaj të drejtës së nënës dhe babait, dhënia e lëmoshës për hir të Allahut, mëshira ndaj të gjitha krijesave dhe të afruarit me butësi dhe falje.

### ***Tablo të virtytshme***

Krenaria e gjithësisë i Nderuari ynë (s.a.v.s) thotë kështu:

*“O njerëz! Pendohuni te Allahu dhe kërkojini falje Atij, sepse unë pendohem ndaj Tij njëqind herë në ditë.”* (Muslim, Dhikir, 42)

Pendimi dhe kërkimi i vazhdueshëm i faljes nga ana e të Dërguarit të Allahut, në një kohë kur atij i ishin falur të gjitha mëkatët e ardhura dhe të kaluara, na ofron një mësim të lartë edukate për ummetin e



tij, aq sa është edhe falenderim ndaj mirësive që i ka dhënë Allahu Teala.

Pejgamberi i nderuar, i cili e dinte se detyra më e rëndësishme e robit është përkujtimi i Allahut dhe adhurimi i Tij në çdo çast, duke menduar se duhej të bënte akoma më shumë adhurim, pendohej dhe kërkonte falje në çdo çast.



Ibn Omeri radijallahu anhu thotë:

“Në në një kuvend vërenim se Pejgamberi (s.a.v.s) thoshte njëqind herë:

رَبِّ اغْفِرْ لِي وَتُبْ عَلَيَّ إِنَّكَ أَنْتَ التَّوَّابُ الرَّحِيمُ

“O Allahu im! Më fal dhe ma prano pendimin tim! Sepse Ti je Ai që i pranon më shumë pendimet dhe je shumë mëshirues!” (Ebu Davud, Vitir, 26/1516; Tirmidhi, Deavat, 38/3434)

Pendimet dhe kërkimet e faljes, i Dërguari i Allahut i bënte që të afrohej sa më shumë me Allahun Teala dhe që të fitonte kënaqësinë e Tij, por kjo jo për shkak të ndonjë gabimi të tij. Ngaqë çdo çast ishte në progres shpirtëror, i Nderuari ynë gjithmonë kërkonte falje për gjendjen dhe pozitën e mëparshme.



Në ditët e tij të fundit, i Dërguari i Allahut (s.a.v.s) thoshte shpesh këto fjalë:

سُبْحَانَ اللَّهِ وَبِحَمْدِهِ أَسْتَغْفِرُ اللَّهَ وَأَتُوبُ إِلَيْهِ

“Unë besoj se Allahu është larg nga atributet që nuk i shkojnë pozitës së uluhijetit dhe e falenderoj Atë.” Nëna jonë, Hazreti Aishe e pyeti:

“-O i Dërguari i Allahut! Shoh se i thua shumë shpesh fjalët ‘sub-



hanallahi ue bi-hamdihi estagfirullahe ue etubu ilejh'. Cili është shkaku që i thua?"

Pejgamberi (s.a.v.s) tha:

*"Zoti më ka njoftuar se do të shikoj një shenjë në ummetin tim. Që kur e kam parë këtë, e them shpesh këtë tespih. Unë atë shenjë e kam parë në suren Nasr, e cila tregon çlirimin e Mekkes. (Muslim, Salat, 220)*

**Kur erdhi ndihma e Allahut dhe çlirimi dhe kur i pe njerëzit që hynin në fe grupe grupe. Ti pra lartësoje Zotin tënd duke e falenderuar dhe kërko falje nga Ai. Sepse Ai i pranon shumë pendimet."**

I Dërguari i Allahut (s.a.v.s) i ka mësuar ummetit të tij edhe forma të ndryshme të kërkimit të faljes. Më e rëndësishmja e këtyre është "Sejjidu'l-Istigfar", të cilën i Dërguari (s.a.v.s) e ka shprehur kështu në një hadith fisnik të tij:

*"Kërkimi i faljes më i lartë është të thëniturit e robit:*

اللَّهُمَّ أَنْتَ رَبِّي لَا إِلَهَ إِلَّا أَنْتَ خَلَقْتَنِي وَأَنَا عَبْدُكَ وَأَنَا عَلَى عَهْدِكَ وَوَعْدِكَ  
مَا اسْتَطَعْتُ أَعُوذُ بِكَ مِنْ شَرِّ مَا صَنَعْتُ أَبُوؤُكَ لَكَ بِنِعْمَتِكَ عَلَيَّ وَأَبُوءُ بِدُنْيِي  
فَاغْفِرْ لِي فَإِنَّهُ لَا يَغْفِرُ الذُّنُوبَ إِلَّا أَنْتَ

*O Allahu im! Ti je Zoti im. Nuk ka Zot tjetër që meriton të adhurohet përveç Teje. Ti më ke krijuar mua. Unë jam rob i Ty. Akoma sa kam mundësi, qëndroj në fjalën dhe në premtimin që të kam dhënë Ty në ezel. Mirësitë që mi ke dhënë i kujtoj me mirënjohje në praninë tënde të lartë dhe e pranoj mëkatin tim. Më fal mua, padyshim që askush nuk i fal mëkatet përveç Teje."*

I Dërguari i Nderuar e vazhdon kështu fjalën e tij:

*"Kushdo që ditën thotë Sejjidu'l-Istigfarin duke i besuar me zemër sevapit dhe virtytit të tij, nëse vdes atë ditë para se të bëhet mbrëmbe, do të hyjë në xhennet. Përsëri kushdo që e thotë natën duke i besuar sevapit dhe virtytit të tij, nëse vdes para se të bëhet mëngjes, do të hyjë*



*në xhennet.*” (Buhari, Deavat, 2, 16; Ebu Davud, Edukata, 100-101)



Pendimin dhe kërkimin e faljes duhet ta forcojmë me vepra të mira që bëhen pas tyre. Ibn Omer radijallahu anhu tregon:

“Një njeri erdhi te i Dërguari i Allahut dhe i tha:

“Unë kam bërë një mëkat të madh. A ka mundësi që të pendohem për këtë?”

I Dërguari i Allahut e pyeti:

“A e ke nënën gjallë?”

Sahabiu tha:

“Jo.”

I Dërguari i Allahut e pyeti:

“Po teze a ke?”

Kur sahabiu tha:

“Po, kam”, i Dërguari i Allahut i tha:

“Atëherë (bëji mirë) ndihmoji asaj. Tezja është në vend të nënës.” (Tirmidhi, Birr, 6; Ahmed, II, 13-14)

Kjo është këshilla që i Dërguari i Nderuar i dha sahabiut, i cili digjej me zjarrin e keqardhjes dhe po kërkonte falje me qëllim që pendimin e tij ta mbështeste me vepra të mira. Ai tregoi se veprat e mira dhe mirësitë që bëhen si keffaret ndaj të këqijave, i zhdukin këto të fundit.



Krenaria e Gjithësisë, i Nderuari ynë një natë pa në ëndërr Bilalin radijallahu anhu. Në mëngjes e thirri muezin Bilalin dhe e pyeti:

“O Bilal! Mbrëmë në ëndërr, dëgjova në xhennet, përpara meje, zhurmën e këpucëve të tua. Çfarë pune të mirë ke bërë që hyre në xhennet para meje?”

Bilali radijallahu anhu tha:



“-O i Dërguari i Allahut! Kurdo që bëj ndonjë mëkat të vogël, menjëherë pas tij ngrihem dhe fali dy rekate namaz. Edhe kur më prishet abdesi menjëherë marr abdes.”

Mbi këtë i Dërguari i Allahut tha:

“Ja, për këtë arsye!”<sup>31</sup>

Siç u pa, kur të bëjmë çdo lloj gabimi, pa humbur kohë duhet të pendohemi dhe për këtë arsye është e nevojshme që të ndërmjetësojmë me vepra të mira.



Kab bin Malik u vonua për të marrë pjesë në udhëtimin e Tebukut nga shkak i neglizhencës së tij dhe si përfundim i iku karvani. Për këtë gabim të tij Ai u pendua menjëherë për këtë gabim të tij dhe kërkoi falje, po për shkak të gabimit që kishte bërë bota i dukej shumë e ngushtë, paçka se ishte shumë e gjerë. Ndërsa kur mori lajmin se i është pranuar pendimi, menjëherë bëri sexhde nga gëzimi. (Ibn Maxha, Salat, 192) Pastaj deshi të japë lëmoshë, duke ia dorëzuar të gjithë pasurinë e tij Pejgamberit. Por i Dërguari i Allahut, e porositi që gjysmën e pasurisë ta japë si lëmoshë dhe gjysmën tjetër t’ia lërë familjes së tij. (Buhari, Megazi, 79)

Sepse i Dërguari i Allahut e pranonte lëmoshën e çdokujt sipas gjendjes shpirtërore të tij. Sepse nuk donte që në fund (dhënësi i lëmoshës) të bëhej pishman dhe të humbej shpërblimi i asaj që e kishte dhënë si lëmoshë.



Allahu robërit e tij që pendohen dhe i kërkojnë falje i shpëton nga çdo lloj telashi dhe u jep shumë mirësi. Një herë, katër vetë shkuan te Hazreti Hasan Basriu. Njëri u ankua nga thatësira, tjetri nga varfëria, tjetri nga mosprodhimi i tokës, ndërsa tjetri u ankua se nuk kishte fëmijë. Të katër burrat kërkuan ndihmë nga Hazreti. Ky mik i madh e porositi secilin prej tyre që të kërkojë falje. Ata që ishin afër tij i thanë:





“-O i nderuari ynë! Hallet dhe telashet e këtyre njerëzve ishin të ndryshme, ndësa ti u këshillove të gjithëve të njëjtën gjë?!” Hazreti Hasan Basri u përgjigj atyre duke u lexuar këtë ajet fisnik:

**“Kërkoni Falje nga Zoti juaj sepse ai është shumë falës. (Kërkoni falje ashtu që) tju lëshojë nga qielli shumë shi, t’iu shtojë pasurinë dhe fëmijët, t’iu japë kopshte dhe lumenj!”** (Nuh, 10-12)  
(Ibn Haxher, Fethu'l-Bari, XI, 98; Ajni, Umdetu'l-Kâri, Bejrut XXII, 277-278)



Të vonosh pendimin duke u mashtruar nga devijimi i djallit, është harxhim i jetës dhe si pasojë është harxhimi më i madh. Një besimtar i mençur duhet të nxitojë në pendim dhe duhet ta përgatisë vetveten për frymën e fundit.

Sipas transmetimeve, një rrobaqepës pyeti një person të devotshëm:

Çfarë thoni për hadithin fisnik të të Dërguarit të Allahut: *Allahu Teala e pranon pendimin e robit përderisa të mos i vij shpirti te fyti.* (Tirmidhi, Deavat, 98/3537) Edhe personi pyeti:

“-Po, ashtu është. Por kush është profesioni yt?”

“-Unë jam rrobaqepës, qep rroba.”

“-Kush është puna më e lehtë në rrobaqepsi?”

“-Të kapësh gërshërët dhe të presësh copën.”

“-Prej sa vjetësh e bën këtë punë?”

“-Që prej tridhjetë vjetëve.”

“-A mund ta presësh copën kur të të vijë shpirti te gurmazi?”

“-Jo, nuk mund ta pres.”

“-O rrobaqepës! Nëse nuk mund të bëshë një punë që, pasi ke hequr keq njëfarë kohe, e ke mësuar dhe e ke bërë me lehtësi tridhjetë vjet, si mund ta bësh në atë çast pendimin që nuk e ke bërë fare në jetën tënde? Pendohu sot që e ke forcën dhe fuqinë në vend! Përndryshe, ka mundësi që në frymën e fundit të mos e kesh rizk



kërkimin e faljes dhe të përfundimit të mirë... A nuk e ke dëgjuar fare fjalën: Nxitoni në pendim para se t'iu vijë vdekja! (Munavi, V, 65)

Në lidhje me këtë, rrobaqepsi u pendua me sinqeritet dhe u bë prej robërve të devotshëm.

Sepse Pejgamberi ka njoftuar se njerëzit, ashtu siç kanë jetuar, mbi atë gjendje do të vdesin, dhe siç ashtu kanë vdekur do të tubohen.<sup>32</sup>



Hazreti Bajezid Bistami i tha një mjeku të cilin e takoi ndërkohë që ai po përgatiste ilaçet:

“-O mjek! A ke ndonjë ilaç për sëmundjen time?”

Kur mjeku pyeti: “Çfarë sëmundje ke?” Hazreti Bajediz u përgjigj:

“Sëmundja e mëkatit...” Mjeku duke i hapur duart në të dy anët tha:

“Unë nuk e njoh ilaçin e mëkatit.”

Në atë çast, një i ri i marrë që ndodhi atje, ndërhyri në bisedë duke thënë:

“-Baba, unë e di ilaçin tënd.” Hazreti Bajezid tha më gëzim:

“-Thuaje, djalosh!”

I riu, të cilin populli e pandehte për të marrë, por që në të vërtetë ishte një dijetar, e përkufizoi kështu ilaçin e mëkatit:

“-Merr dhjetë derhem rrënjë pendimi dhe dhjetë derhem gjethe kërkimi faljeje! Këto vendosi në havanin e zemrës! Rrihi me çekiçin e njësimi! Siti në sitën e ndërgjegjes! Ngjeshi me lot! Skuqi në furrën e dashurisë dhe të keqardhjes! Paskëtaj, çdo ditë merr nga pesë lugë prej brumit që do të bëhet. Në fund nuk do të ngelet kurrfare shenje nga sëmundja jote!..”

Bajezid Bistami i cili i dëgjoji këto, u prek dhe tha:

“Sa turp për ata që i thonë të marrë dijetarëve si ti, ndërsa veten



e pandehin të mençur!..”



Së fundi, njeriu që nuk është i sigurtë se mund të mos bëjë gabime, e ka të domosdoshme të mos e lëshojë asnjëherë nga gjuha pendimin dhe kërkimin e faljes. Edhe nijetin e tij duhet ta regjistrojë dhe forcojë me punë të devotshme. Kërkimet e faljes dhe punët e devotshme janë të nevojshme për të qenë rob i Allahut. Në ajetin fisnik thuhet:

**“O njerëz! Padyshim qe premtimi i Allahut është i vërtetë. Pra le të mos ju mashtrojë jeta e kësaj bote dhe shejtani i mallkuar ndaj Allahut.”** (Fatir, 5)

Ta lësh pendimin për në fund të jetës, duke iu bindur vetes dhe shejtanit, është mashtrimi më i madh që përfundon vetëm me humbje. Atëherë është e nevojshme të nxitojmë në pendim dhe në kërkimin e faljes, të jemi të sinqertë dhe të orientohemi kah veprt e mira. Kjo gjendje, ashtu siç e mbron robin nga belatë dhe fatkeqsitë, e ndihmon po ashtu të fitojë edhe mirësitë hyjnore.

## **5. Bindja ndaj urdhërave të Allahut dhe të të Dërguarit të Tij**

Grada shpirtërore e besimtarit është në lidhje me bindjen ndaj urdhërave të Allahut dhe të të Dërguarit të Tij. Edhe përsosmëria e besimit shtohet në lidhje me përpikmërinë, sensibilitetin, përzemërsinë dhe dashurinë që është në këtë bindje. Ata të cilët fitojnë shkallë në dashurinë dhe bindjen ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij, në të dy botërat fitojnë mirësitë hyjnore. Në ajetin fisnik thuhet:

**“Kushdo që i bindet Allahut dhe të Dërguarit të Tij, do të jenë së bashku me Pejgamberët, besnikët, dëshmorët dhe të mirët të cilët Allahu i shpërbleu. Sa shokë të mirë janë ata!”** (en-Nisa, 69)

Edhe i Dërguari i Allahut ka lajmëruar kështu:

*“Zoti juaj azze ue xhelle thotë: “Sikur robërit të më bindeshin*



*mua siç duhet, Unë edhe shiun do tua lëshoja natën, ndërsa ditën do tu nxirrja diellin. Veçanërisht do të bëja të mos e dëgjonin zhurmën e rrufesë...”* (Ahmed, II, 359; Hakim, IV, 285/7657)

Veprat shpirtërore të atyre që mund ta mbrojnë gjendjen e kënaqësisë përballë kushteve që ndryshojnë, duke e kryer bindjen ndaj urdhërave të Allahut me dashuri dhe nënshtrim, bëhen rrjedhë e urtësisë, mirësisë dhe begatisë. Nga ana tjetër, zemrat dhe trupat të cilët nuk mund të mbrohen nga harami dhe gjërat e dyshuara, kthehen fundekrye në strehë sherri dhe fole imoraliteti.

### *Tablo të virtytshme*

Para luftës së Bedrit, i Dërguari i Allahut sallahu alejhi ue sellem deshi të mësonte mendimin e shokëve të tij. Atëherë Mikdad bin Esued radijallahu anhu, duke u ngritur në këmbë, mbajti këtë fjalim:

“O i Dërguari i Allahut! Bëj atë që të është urdhëruar! Ne jemi me ty. Beto hem në Allahun që ne nuk të themi ty atë që i thanë bijtë e Izraelit Musait alejhisselam! Ata i patën thënë Musait: “ **Shkoni ti dhe Zoti yt dhe luftoni! Ne do të rrijmë këtu.**” ( el-Maide, 24) Beto hem në Allahun i cili të ka dërguar Ty si Pejgamber të vërtetë që, nëse na bën të ecim deri në Birku'l-Gimad<sup>33</sup>, pasi të jemi me ty, durojmë edhe ndaj vështirësive më të mëdha! Çdo çast jemi gati të përleshemi me armikun në të djathtën, në të majtën, para dhe pas teje deri në fund!...”<sup>34</sup> (Buhari, Megazi 4, Tefsir 5/4; vakidi, I, 48)

Pas Hazretit Mikdad, u ngrit në këmbë Sa'd bin Muadh dhe tha:

“O i Dërguari i Allahut! Ne të kemi besuar dhe dëshmuar ty. Dëshmuam se Kur'ani dhe sunneti që ke sjellë, janë të vërtetë. Po ashtu të kemi dhënë edhe fjalë të prerë për të dëgjuar fjalën tënde dhe për të t'u bindur ty në këtë rrugë!

33. Birku'l-Gimad: është emër i një vendi afër Detit të Kuq dhe pesë ditë larg Mekke Mukerreme. Transmetohet se është edhe emri i një qyteti në Jemen.

34. Ibn Mesut radijallahut anhu thotë: “U bëra dëshmitar i një fjale të prerë të Mikdad bin Esuedit, fjalë që po ta kisha thënë unë, do të ishte më e gëzueshme se sa të gjitha fjalët e vlefshme që ishin të njëjta me të...” ( Buhari, Megazi 4, Tefsir 5/4)



O i Dërguari i Allahut! Bëj si të duash. Beto hem në Allahun i cili të ka dërguar si Pejgamber të vërtetë se, nëse zhytesh në këtë det duke na treguar neve, edhe ne zhytemi me ty dhe askush nga ne nuk mbetet pas. Nuk ndjejmë keqardhje nëse nesër do të na shpiesh ballë për ballë me armikun. Durimi dhe qëndrueshmëria në luftë, mosndarja nga besnikëria edhe kur takohemi me armikun, është shenja jonë. Shpresojmë se Allahu do të të tregojë ty përmes nesh gjëra që do të ta ndriçojnë syrin. Eja o i Dërguari i Allahut! Na bëj të ecim drejt bereqetit të Allahut!”

Fytyra e bekuar e të Dërguarit të Allahut vezulloi në buzëqeshje nga këto fjalë të mbushura me qëndrueshmëri dhe nënshtrim. Duke u lutur, tha:

*“Atëherë. Ejani dhe ecni me bereqetin e Allahut! Përgëzimet qofshin për ju! Allahu ka premtuar njërin nga dy grupet që nuk është i qartë.<sup>35</sup> Për Zotin unë tani sikur shikoj vendet në fushën e luftës ku do të shkatërrohen Kurejshët...”* (Muslim, Xhihad, 83; Vakidi, I, 48-49; Ibn Hisham, II, 253-254)

Sa bukur e treguan ashabët e nderuar dashurinë dhe bindjen që kishin ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij.



Enesi radijallahu anhu transmeton këtë ngjarje që, në një mënyrë të shkëlqyer tregon pastërtinë, sinqeritetin, ndjeshmërinë dhe gatishmërinë e ashabëve të nderuar ndaj urdhërave të Allahut dhe të të Dërguarit të Tij:

Alkooli u bë haram kur po u shërbeja njerëzve në shtëpinë e Ebu Talhas, domethënë në kohën kur po u mbushja gotat. I Dërguari i Allahut kishte urdhëruar një thirrës dhe ai ua shpalli këtë ndalesë njerëzve. Ne e dëgjua zërin e thirrësit kur ishim në shtëpi. Ebu Talha tha:

“Dil dhe shiko! Çfarë është ky zë?” Dola, shikova dhe thashë:

35. Njëri nga dy grupet e premtuara në ajetin 7 të sures Enfal, janë vetë Kurejshët, d.m.th humbja dhe kapja rob e tyre, ndërsa tjetra është karvani i madh i Kurejshëve që vinte nga Shami.



“-Një thirrës po thërret dhe thotë: “Kujdes, kujdes; alkooli është bërë haram!” Atëherë ai më tha:

“-Atëherë, shko dhe derdhe të gjithë alkoolin!”

Që nga ai moment alkooli rrodhi nëpër rrugët e Medines. (Buhari, Tefsir, 5/11)

Ashabët e nderuar, sapo dëgjuan se alkooli është bërë haram, menjëherë iu bindën urdhërit, treguan aftësi për të derdhur të gjithë alkoolin derisa arritën te pija që kishte ngelur në gotën që po pinin në atë çast pa pretenduar dhe pa hyrë në ndonjë hutim si: “ta mbaroj këtë që kam në dorë, pastaj e lë”.



Një djalosh nga fisi Eslem, duke ardhur te Pejgamberi, i tha:

“-O i Dërguari i Allahut! Unë dua të marr pjesë në luftë, por nuk kam asnjë pajisje të nevojshme për luftë.” Pejgamberi i tha:

“-Shko te filan person! Ai qe përgatitur për luftë, por u sëmur.” Djaloshi shkoi te ai person dhe i tha:

“-I Dërguari i Allahut (s.a.v.s) të urdhëron dhe thotë që të më japësh mua pajisjet që ke përgatitur për luftë.” Me të dëgjuar këtë, burri i tha gruas së tij:

“-Zonjë! Jepi këtij djaloshi të gjitha pajisjet e luftës që kam përgatitur dhe mos lër asgjë mangët. Për hir të Allahut mos lër asgjë mangët, ashtu që të fitojmë bereqetin.” (Muslim, Imare, 134)

Ky sahabi iu bind urdhërit të të Dërguarit të Allahut me një dashuri, entuziazëm dhe me këmbëngulje aq të madhe, sa i tërhiqte vërejtjen gruas së tij t'ia jepte të gjitha pajisjet që kishte përgatitur, pa lënë asgjë mangut. Kështu, ai shfaqti edhe dashurinë, besnikërinë dhe bindjen e tij ndaj të të Dërguarit të Allahut, edhe dëshirën dhe përmallimin që ndjente ndaj veprave të mira.



“Në ditën e Çlirimit, kur erdhi te Mesxhidi Haram, Hazreti Pejgamber (s.a.v.s) urdhëroi Osman bin Talhan, i cili ishte nga haxhibët<sup>36</sup> e Qabes, që të sillte çelësin e Qabes. Osmani radijallahu anhu shkoi te nëna e tij që mbante çelësat, por gruaja, që ishte mushrike, nuk pranoi që t’i jepte ato. Osmani radijallahu anhu tha:

“Për Zotin, ose do të japësh çelësat, ose kjo shpatë do të dalë nga ky këllëf!”

Gruaja i dha çelësat. Osmani radijallahu anhu ia solli të Dërguarit të Allahut. I Nderuari ynë alejhissalatu uesselam e hapi derën dhe hyri në Bejtullah (shtëpinë e Allahut). Bashkë më Të hynë edhe Hazreti Usame, Bilali dhe Osmani radijallahu anhum. I Nderuari ynë ditën qëndroi gjatë në Qabe e mandej doli. Pastaj njerëzit filluan të garojnë për të hyrë brenda kush e kush më parë.

Abdullah bin Omeri radijallahu anhu ishte personi i parë që hyri. Sapo hyri brenda, pas dere gjeti Bilalin radijallahu që po qëndronte në këmbë.

E pyeti: “Ku fali namaz i Dërguari i Allahut?” Hazreti Bilal, duke ia bërë me shenjë, i tregoi vendin ku pati falur namaz i Nderuari ynë (s.a.v.s). Abdullahu radijallahu anhu thotë:

“Harrova ta pyes se sa rekate fali.” (Buhari, Cihad 127, Salat 30, 81, 96, Tehexhxhud 25, Haxh 51, 52, Megazi 77, 48; Muslim, Haxh, 389)

Në këtë shembull shihet vendosmëria e lartë e Osmanit radijallahu anhu në kryerjen e urdhërave të të Dërguarit të Allahut dhe përpikmëria e denjë e Abdullah bin Omerit ndaj kushteve në pasimin e të Nderuarit tonë.



Pejgamberi thotë:

36. **Haxhib:** person që merr përsipër detyrën “hixhabe” në lidhje me Qaben. Ndërsa **Hixhabe** shpreh shërbimet e rëndësishme si, përkujdesja e Qabes, ruajtja e derës dhe e çelsave të saj, hapja e derës për vizitorët në kohëra të caktuara, mbrojtja dhe përkujdesja e Makami Ibrahim, e gjërave të çmueshme që u bënin dhuratë, si dhe e mbulesave të mbrendshe dhe të jashtme.



*“Askush të mos ngrëjë nga vendi ndonjë tjetër dhe pastaj të ulet vetë atje. Por zgjerojeni (rrethin), hapni vend ashtu që edhe Allahu t’ju japë gjërësi juve.*

Abdullah bin Omeri radijallahu anhuma, që e mësoi këtë urdhër të të Dërguarit të Allahut, e praktikoi këtë gjatë gjithë jetës. Pra, nëse dikush ngrihej dhe i lëshonte vendin, ai nuk ulej kurrë aty.” (Buhari, Isti’zan, 32; Muslim, Selam,29)



I Dërguari i Allahut (s.a.v.s) thotë:

*“Përgjigjuni kur të ftoheni!”*

Hazreti ibn Omer, i cili e dëgjoi këtë, edhe nëse ishte agjërueshëm, i përgjigjej doemos ftesave të dasmës dhe ftesave tjera. (Buhari, Nikah, 71, 74; Muslim, Nikah, 103)

Domethënë, nëse agjëronte nafile (agjërime vullnetar), kur shkante në vendin ku ishte i ftuar, e prishte agjërimit dhe e bënte më vonë kaza. Nëse agjëronte farz ose vaxhib, edhe nëse nuk e prishte agjërimit, i përgjigjej ftesës për t’iu bindur urdhërit të Allahut dhe të të Dërguarit të Tij.



Krenaria e gjithësisë, i Nderuari ynë, tha për njëren derë të xhamisë:

*“Sikur këtë derë ta lëmë për gratë!”*

Mbi këtë, Ibn Omer radijallahu anhuma deri sa vdiq, nuk hyri fare nga ajo derë. (Ebu Davud, Salat, 53/571)



Tufejli, i biri i Ubej bin Kabit, i cili numërohet një nga tabiinët, takohej me sahabet dhe përfitonte nga dija e tyre. Herë-herë e vizitonte Abdullah bin Omerin dhe së bashku dilnin në treg.

Ja si e tregon Tufejli përpjekjen e Hazretit Abdullah në bindjen ndaj urdhërave të Pejgamberit tonë:





“Kur dilnim në treg, Abdullah bin Omeri i jepte selam çdonjërit që takonte. Patjetër i jepte selam kujtdo që takonte, qoftë shitës i gjërave të vjetra, qoftë shitës malli të shtrenjtë, qoftë i varfër apo qoftë ndonjë që nuk e njihite fare. Një ditë shkova te ai. Përsëri më propozoi që të shkonim në treg. I thashë:

“-Çfarë do të bësh në treg! Ti nuk kupton nga tregtia. Nuk pyet as çmimet e mallrave që janë në shitje. Nuk blen ndonjë gjë. Nuk ulesh në vende ku secili ulet dhe bisedon. Më mirë se të dalim në treg, ulu këtu dhe të bisedojmë së bashku.”

Mbi këtë Abdullahu radijallahu anhu më tha këto:

“O vëllai im! Ne dalim në treg për t’u dhënë selamin e Allahut atyre që takojmë. Nuk kemi ndonjë qëllim tjetër.” (Muvatta, Selam, 6; Buhari, el-Edebu'l-Mufred, fq. 348)

Të gjithë sahabët e nderuar tregoheshin shumë të ndjeshëm në çështjen e bindjes ndaj urdhërave të Allahut dhe të të Dërguarit të Tij. Duke shpërndarë selamin dhe duke shtuar dashurinë, ata ndërtonin një bazë të jashtëzakonshme ku do të mund të jetonte vëllazëria e besimit të besimtarit. Por dashuria dhe entuziazmi i Abdullah bin Omerit radijallahu anhuma në këtë çështje ishte aq i lartë, sa të tërhiqte vëmendjen. Po ashtu, shembujt e mësipërm e shprehin këtë në një mënyrë më të qartë.

Kur nga Kur’ani Fisnik zbriti ajeti; **“O ju që keni besuar! Mos e ngrini zërin tuaj mbi zërin e Pejgamberit!..”** (el-Huxhurat, 2) Sabit bin Kajs radijallahu anhu u ul në shtëpi dhe filloi të qajë.

I Dërguari i Allahut (s.a.v.s), pasi për një farë kohe nuk e pa Sabitin, pyeti se ku është. Njëri nga ata që gjendeshin aty tha:

“-O i Dërguari i Allahut! Unë e di ku është!” dhe menjëherë iku dhe e gjeti në shtëpi të ulur dhe të përlotur.

E pyeti: “-Çfarë ke, (përse qan)?” Ai u përgjigj:

“(Mos pyet) Sa keq! Zëri im dilte mbi zërin e të Dërguarit të Allahut (s.a.v.s), të gjithë punët e mia shkuan kot dhe kështu u bëra prej banorëve të xhehnemit.”

Sahabiu ia tregoi të Dërguarit të Nderuar fjalët e Sabitit. I Nderuari ynë tha:

*“Shko dhe i thuaj, ti nuk je prej banorëve të xhehnemit, përkundrazi ti je nga banorët e xhennetit.”* (Buhari, Menakib 25, Tefsir 49/1; Muslim, Iman 187)

Sabiti radijallahu anhu, i cili ishte një sahabi që e kishte zërin e fortë, duke menduar se nuk i është bindur urdhërave të Allahut, u mbyt në një mërzi të madhe dhe jeta e tij pothuajse u errësua. Por, ngaqë zëri i fortë ishte një gjendje e natyrshme e tij dhe ngaqë kishte një zemër të singertë, gjendja e tij formoi një situatë të jashtëzakonshme. Sahabiu që solli lajmin, duke u kthyer me një gëzim të madh, e përgëzoi atë me xhennet.

Edhe sahabiu që vraponte për të mësuar gjendjen e Sabitit radijallahu anhu, është një shembull i bukur që tregon se sahabet ishin gati për të flijuar çdo gjë të tyre, duke e pranuar si urdhër edhe një shenjë të Pejgamberit të Nderuar.



Gruaja e Abdullah bin Revahas tregon kështu:

I Dërguari i Allahut (s.a.v.s) pati dalë në hytbe. Në atë moment Abdullahu radijallahu anhu i cili po vinte drejt xhamisë, dëgjoi nga larg urdhërin e të Dërguarit të Allahut: “Uluni!”. Edhe pse nuk kishte arritur akoma në xhami, menjëherë u ul në vendin ku gjendej. Më vonë, kur kjo gjendje iu informua të Dërguarit të Allahut (s.a.v.s), ai i tha Hazretit Abdullah:

*“Allahu Teala ta shtoftë dëshirën e bindjes ndaj Allahut dhe të të Dërguarit të tij.”<sup>37</sup>*



Abdullah bin Abbas radijallahu anhu tregon kështu:

Ujejne bin Hisn erdhi në Medine dhe qëndroi si mik te nipi i tij

37. Ali el-Muttaki el-Hindi, Kenzu'l-Ummal, Bejrut 1985, XIII, 450/37171; Hejsemi, IX, 316.



Hur bin Kays. Hur bin Kays bënte pjesë në kuvendin e këshillit të Hazretit Omer. Në fakt të gjithë dijetarët (Kurra) qofshin të rinj apo të vjetër gjendeshin në kuvendin e këshillit të Hazretit Omer. Kësisoj, Ujejne i tha nipit të tij Hur bin Kaysit:

“-O nipi im! Prestigji yt te kryetari i shtetit është i lartë. Më tako me të.”

Huri mori leje nga Omeri radijallahu anhu. Ujejne, kur hyri te Hazreti Omer, tha:

“-O biri i Hattabit! Beto hem në Allahun se nuk na jep ndonjë gjë tepër. Edhe ndërmjet nesh nuk gjykon me drejtësi.”

Hazreti Omer u zemërua. Deshi ta dënojë Ujejnën. Huri i cili e ndjeu këtë, tha:

“-O prijësi i besimtarëve! Allahu i tha Pejgamberit të tij: **“Fal, urdhëro për të mirë dhe largohu nga të paditurit!”** (el-A'raf, 199) Edhe xhaxhai im është nga të paditurit.”

Betohem në Allahun se kur Huri lexoi këtë ajet, Omeri radijallahu anhu hoqi dorë nga ndëshkimi. Në fakt Hazreti Omer ishte shumë i lidhur me librin e Allahut. (Buhari, Tefsir 7/5, l'tisam 2)

Kur Hazreti Omer i kujtonin një urdhër të Allahut, e mposhte zemërimin e tij dhe duke iu bindur urdhërit hyjnor, menjëherë hiqte dorë nga ajo gjë që donte të bënte. Kështu shfaqti ndjeshmërinë e një besimtari të përsosur në bindjen ndaj urdhërave të Allahut.



Hisham bin Hakim i cili ishte njëri nga sahabet, ndodhej në Palestinë. Ai pa një grup bujqish jomuslimanë, të cilët për shkak se nuk kishin paguar taksat, ishin dënuar. I kishin lidhur jashtë nën nxehtesinë e diellit dhe po u hidhnin vaj ulliri në kokë. Duke shkuar drejt te vendi i prefektit, ai tha se kjo është një sjellje shumë e gabuar. Pastaj transmetoi hadithin fisnik që e kishte dëgjuar vetë nga i Dërguari i Nderuar (s.a.v.s):

*“Patjetër Allahu i ndëshkon ata të cilët ndëshkojnë njerëzit prad-*



*rejtësisht në këtë botë!”*

Me të dëgjuar këtë prefekti i la menjëherë të lirë bujqit. (Muslim, Birr, 117-119; Ebu Davut, Imare, 32; Ahmed, III, 403, 404, 468)

Sepse ata nuk hezitonin asnjë çast përballë deklarimeve pejgamberike dhe bindeshin menjëherë.



Abdullah bin Ebi Eufa radijallahu anhumu, në namazin e xhenazes së vajzës së tij pati marrë katër tekbire. Pas tekbirit të katërt ndaloi aq sa ndaloi ndërmjet dy tekbireve, kërkoi falje për vajzën dhe bëri lutje.

Të pranishmit pandehën se do të marrë tekbirë për herë të pestë. Pastaj dha selam në të djathtë dhe në të majtë. Pas namazit e pyetën:

“Çfarë është kjo që bëre?” Ai u përgjigj:

Kështu vepronte i Dërguari i Allahut (s.a.v.s).” (Hakim, I, 360; Ibn Maxhe, Xhenaiz, 24)

Përgjigja e Abdullah bin Ebi Eufa është shumë e rëndësishme nga aspekti i të treguarit i përpikmërisë duke marrë si shembull në çdo çështje të Dërguarin e Allahut. Kriteri e jetës së tyre ishte Sunneti i Pejgamberit. Për këtë shkak mbrojtja dhe sqarimet e tyre ishin në formën e dhënies së argumentave nga Kur’ani dhe Sunneti. Jetën e tyre e patën sistemuar sipas Kur’anit dhe Sunnetit. Sa nevojë kemi edhe në ditët e sotme për të marrë sunnetin si kriter në çdo punë tonën dhe për përafrimin e argumenteve dhe të debateve në drejtimin hyjnor, duke përfutur nga begatia e Kur’anit dhe Sunnetit, sepse madhështia jonë në karakter, në personalitet e në përsosmërinë tonë në Islam, është e lidhur me përkushtimin tonë ndaj Kur’anit dhe Sunnetit.



Në një kohë jacie, i Dërguari i Allahut (s.a.v.s) u tha ashabëve të tij:

*“-Nesër mblihduni për namaz, kam disa çështje që dua t’ua tregoj.”* Njëri nga ashabët u tha shokëve të tij:



“-O filan! Ti mësoje përmendësh fjalën e parë që do të thotë i Dërguari i Allahut, ti tjetrën, edhe ti tjetrën ashtuqë të mos humbim asgjë nga ajo që tha i Dërguari i Allahut.” (Hejsemi, I, 46)

Edhe përpikmëria që treguan ashabët në çështjen e mësimit dhe praktikimit të urdhërave të Pejgamberit fisnik, janë një meritë e konsiderueshme, sepse për shkak të këtyre përpjekjeve të përpikta të atij brezi, posedojmë mundësi për të mësuar më nga afër çdo gjendje dhe lëvizje të Pejgamberit tonë të Nderuar. Allahu qoftë i kënaqur nga ata...



Ebu Burde tregon kështu:

Ebu Musa el-Esh'ari u sëmur dhe i ra të fikët teksa e kishte kokën në prehërin e gruas së tij. Kur ndodhi kjo, gruaja e tij bërtiti me të madhe dhe filloi të qajë me zë të lartë. Por Ebu Musa nuk ishte në gjendje ta ndalonte gruan e tij për të shfaqur një sjellje të tillë. Kur erdhi në vete, ai i bëri vërejtje gruas së tij:

“Gjërat të cilave Pejgamberi nuk i pëlqen dhe që u qëndronte larg, nuk i pëlqej as une dhe po ashtu u rri larg. Pejgamberi rrinte larg grave që bërtisnin me të madhe, që shkullnin flokët e tyre dhe atyre që shqyenin fytyrën dhe kokën.” (Buhari, Xhenaiz, 37, 38; Muslim, Iman, 167; Nesai, Xhenaiz, 17)

Sa sensibilitet i madh është përkushtimi me bindje me përpikmëri ndaj urdhërave të të Dërguarit të Allahut, edhe kur je në luftë me vdekjen.



Dihje bin Halife radijallahu anhu, një ditë (kur pa disa që vepronin në të kundërtën e sunnetit) tha:

“Për Zotin, sot kam parë një ngjarje që nuk mendoja se do të mund të ndodhte: Disa njerëz u larguan nga sunneti i të Dërguarit të Allahut dhe i ashabëve të tij. O Zoti im! Tashmë më merr mua pranë Teje, (ma merr shpirtin!)” (Ebu Davud, Saum, 47/2413)

Bishri Hafi rahmetullahi alejh thotë:



“Një natë pashë në ëndërr Krenarinë e Gjithësisë, të Nderuarin tonë. Ai më tha:

“-O Bishr! A e di përse ta ka ngritur Allahu vlerën?” I thashë:

“-Jo o i Dërguari i Allahut!” Ai më tha:

“-Ty të ngriti në pozitën e të devotshmëve për shkak se ndoqe sunnetin tim, u shërbeve të devotshmëve, i këshillove vëllezërit në fe dhe për shkak se i doje ashabët e mi dhe Ehli Bejtin.”<sup>38</sup>



Sa bukur e sqaron adhurimin e vërtetë Hazreti Abdulhalik Gyxhdyvani:

Një ditë e pyetën:

“Të bëjmë ato që do vetja, apo ato që nuk i do?”

Hazreti u përgjigj kështu:

“Është shumë e vështirë të vërtetosh ndryshimin e këtyre të dyjave. Vetja i bën të gabojnë shumë njerëz në çështjen e të kuptuarit nëse këto dëshira janë nga Rrahmani apo nga shejtani. Për këtë arsye, bëhet vetëm ajo që ka urdhëruar Allahu dhe nuk bëhet ajo që ka ndaluar. Ky është adhurimi i vërtetë.”



Ndjekësit e rrugës së Zotit duhet ta bëjnë për veten e tyre një ligj që nuk i shmang në bindjen ndaj urdhërave të Allahut, shërbimin dhe këshillën e vëllezërve të fesë, dhe me rrugët e kësaj lumturie të përhershme duhet të mundohen të fitojnë kënaqësinë e Zotit. Një ditë, një person që shkante në ligjëratat e Hazretit Davud Tai, i tha Maruf Kerhit:

“Kujdes, mos e lër veprën e mirë, sepse vepra të afron ty te kënaqësia e Zotit.” Marufi pyeti:

“Çfarë duhet kuptuar me *veprën e mirë*?” Personi tha:



“Bindja ndaj Zotit në çdo lloj gjendjeje, shërbimi dhe këshillimi i myslimanëve...”



Së fundi, shenja më e madhe e dashurisë ndaj Allahut është bindja ndaj Tij. Një besimtar që e do Zotin sipas ligjit “Ai që do, i bindet atij që do”, i bindet gjithmonë Atij. Një adhurim i pakët i bërë me bindje dhe nënshtrim, është më i pranueshëm te Allahu se një adhurim i madh sa malet por që është bërë pa bindje dhe pa nënshtrim, sepse adhurimi fillon me bindje dhe nënshtrim. Po ashtu, djalli u përzu nga vendi i lartë jo për shkak të mangësisë në adhurim, por për shkak të mangësisë së bindjes dhe nënshtrimit.

Ashabët e nderuar u përsosën në lidhje me dashurinë, përzemërsinë dhe bindjen që kishin ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij. Për shkak të bindjes së tyre pa kundërshtim, me dashuri dhe me nënshtrim, ata u bënë personalitete yje dhe shembuj për të gjithë ummetin.

Sa bukur e shpreh Hazreti Mevlana në Mesnevinë e tij se edhe krijesat e pashpirtë binden ndaj urdhërave hyjnore:

“A nuk e shikon? Retë, dielli, hëna dhe të gjithë yjet lëvizin mbi një sistem. Secili nga këto yje të panumërta lind në kohën e tij. Koha e lindjes së tyre as nuk vonohet dhe as nuk shpejtohet.

Si ndodhin këto gjëra fantastike dhe ne nuk dimë dhe nuk kuptojmë nga mrekullitë e peygamberit? Ata e bënë të mençur gurin dhe shkopin. Shikoj këto dhe krahasoi krijesat e tjera të pashpirt me shkopin dhe me copën e gurit.

Bindja e copave të gurit ndaj Peygamberit tonë të Nderuar dhe bindja e shkopit ndaj Hazretit Musa, tregojnë se si i binden urdhërit të Zotit të gjitha krijesat që ne i pandehim të pashpirt.

Me gjuhën e zakonshme thonë: Ne e njohim Allahun dhe i bindemi Atij. Ne nuk jemi gjëra boshe të krijuara rastësisht. Të gjithë ne i ngjajmë detit të kuq. Ai edhe pse ishte det, e ndau Faraonin nga bijtë e Izraelit kur do të mbytej.

Pemët dhe gurët, kur e shikonin Hazretin Mustafa, i jepnin selam



të qartë. Ja, kështu, dije se çdo gjë që e pandehje të pajetë, është e gjallë.

Domethënë jo vetëm njerëzit dhe xhindët, por edhe kafshët dhe gjërat e pajetë janë në gjendjen e bindjes ndaj Allahut dhe të të Dërguarit të Tij. Kur të gjitha krijesat vrapojnë për në bindje, sa trishtuese është gjendja e njeriut që mbytet në kënetën e mëkatit. Atëherë, duke marrë mësim nga bindja e treguar nga krijesat e krijuara nga Allahu, është e nevojshme që në praninë hyjnore të bindemi me respekt të përsosur.

## 6. Përpikmëria në adhurime

Njeriu, është stolitur me zbulimet e panumërta të rrjedhjeve të madhështisë dhe fuqisë hyjnore. Ai është krijuar si kulmi i artit hyjnor në këtë botë dhe për falenderimin e këtij krijimi dhe për fitimin e “Takimit me Zotin”, domethënë të qenit mik me Zotin, është obliguar me adhurime. Në shumë ajete fisnike, Allahu e ka urdhëruar njeriun që të bëjë vepra të mira për të shpëtuar nga humbja e përhershme, për të fituar zemrën e pastër dhe zemrën munib<sup>39</sup>.

Adhurimet janë një shenja besnikërie të cilat tregojnë se robi i ka qëndruar besnik fjalës që i ka dhënë Zotit të tij qysh në zanafillë. Janë të fshehtat e takimit ato që e afrojnë besimtarin te Zoti. Nga një anë tjetër, adhurimet janë burimi i shërimit, i qetësisë dhe i shfaqjes më ndikuese që mund ta shpëtojnë njeriun nga shqetësimet dhe ankthet e jetës pas vdekjes. Janë një burim mirësie edhe për ekuilibrin shpirtëror, për arritjen e paqes dhe për fitimin e gradave të adhurimit.

Për këtë arsye, adhurimet tona vijnë në krye të temave që kanë nevojë të tregojmë shumë përpikmëri, dhe ne duhet të jemi të sakte me këto adhurime.

39. Zemra munib: Zemra që i drejtohet gjithmonë Allahut duke shpëtuar nga robërimi i gjërave tërheqëse të përkohshme.





## *Tabllo të virtytshme*

Duke u mbështetur në rëndësinë e tyre, së pari duhet të flasim për nevojën e përpikmërisë në çështjen e abdesit, sepse pakujdesitë dhe neglizhencat që bëhen në abdes, ndikojnë në mënyrë negative, e në të njëjtën masë, edhe në adhurimet që bëhen pas tij.

Një herë, i Dërguari i Allahut (s.a.v.s) fali me xhemat namazin e mëngjesit. Kur në namaz po lexonte suren Rum, ai bëri disa gabime. I Nderuari ynë alejhissalatu uesselam pasi plotësoi namazin, u kthye nga xhemati dhe tha:

*“Djalli bëhet shkak që të ngatërrojme këndimin për shkak se disa persona vijnë pa abdes në namaz. Kur të vini në namaz merrni abdes bukur!”* (Ahmed, III, 471; Nesai, Iftitah, 41; Muxhtebea Sherhi, II, 156)

Domethënë përpikmëria për të marrë abdes bukur para se të falim namazin, është çështje shumë e rëndësishme sa i takon cilësisë së adhurimeve tona.

Marrja abdes ka gjithmonë në lidhje me mundësitë, por ajo është një mirësi e madhe. I Dërguari i Allahut dëshironte që të gjitha punët t'i bënte kur kishte abdes.

Sipas transmetimit të Ebu Xhuhejmit radijallahu anhu, i Dërguari i Allahut takoi një person kur po vinte nga Pusi i Devesë. Personi i dha selam atij, por i Nderuari ynë nuk e pranoi selamin. Menjëherë shkoi të një mur, fshiu fytyrën dhe duart e tij, mori tejemmum, pastaj e pranoi selamin e atij personi. (Buhari, Tejemmum, 3)

Me këtë sjellje i Dërguari i Allahut na tregon se të qenit me abdes dhe bërja e çdo pune me abdes, paçka se nuk është e detyrueshme, përfaqëson një mënyrë sjelljeje të virtytshme.



Ibn Abbasi radijallahu anhu tregon:

“I Dërguari i Nderuar, sa herë dilte nga banjoja, së pari hidhte ujë, lante duart, pastaj merrte tejemmum me dhé. I thashë:



“O i Dërguari i Allahut, jeni afër ujit! (Përse veproni kështu)?” I Nderuari ynë u përgjigj:

*“-Nuk e di, ndoshta para se të arrij te uji (mund të jap shpirt).”*  
(Ahmed, I, 288, 303; Hejsemi, I, 263)

Edhe sipas një transmetimi tjetër, Krenaria e Gjithësisë i Nderuari ynë, kur duhej të merrte gusull, fshinte duar në mur dhe merrte tejmum për të mos qëndruar pa abdes derisa të merrte gusull. (Hejsemi, I, 264)

Ja pra horizonti material dhe shpirtëror që na tregoi ne ummetit të tij i Nderuari ynë, Krenaria e Gjithësisë.



Një ditë i Dërguari i Allahut (s.a.v.s) bashkë me shokët e tij shkoi te varrezat dhe tha:

*“Paqja e Allahut qoftë mbi ju o banorë të vendeve besimtare! Inshallah edhe ne një ditë do të vijmë te ju. Do doja shumë që të shikoja vëllezërit e mi. Sa më ka marrë malli për ta!”*

Ashabët e nderuar thanë:

“O i Dërguari i Allahut! Ne a nuk jemi vëllezërit e tu?” I Nderuari ynë tha:

*“-Ju jeni shokët e mi. Ndërsa vëllezërit e mi janë ata që nuk kanë ardhur akoma.”* Mbi këtë ashabët e nderuar thanë:

“O i Dërguari i Allahut! Si do mund t’i shquash nga ummeti yt ata të cilët nuk kanë ardhur akoma?” Pejgamberi ynë alejhissalatu uesellam pyeti:

*“-Mendoni një njeri që ka një kalë me ballë dhe këmbë të bardha. Ai, a nuk mund ta njohë atë mes një grumbulli me kuaj të zinj?”*  
Sahabët thanë:

“Po, e njeh o i Dërguari i Allahut!” Mbi këtë i Dërguari i Nderuar (s.a.v.s) tha:

*“-Ja, ata për shkak të abdesit do të vijnë me fytyra të ndritshme*



*dhe me duar e këmbë të ndriçuara. Unë do të shkoj dhe do t'i pres ata për t'i nderuar në krye të burimit tim. Kini kujdes! Një grup njerëzish do të dëbohen nga burimi im siç dëbohet dhe largohet deveja e huaj nga kopeja. Unë do t'i thërras Ejani këtu. Mua do të më thuhet:*

*“Pas teje ata i ndryshuan gjendjet e tyre. (Ata duke e lënë sunnetin tënd devijuan në rrugë të tjera).” Mbi këtë edhe unë do të them:*

*“Le të qëndrojnë sa më larg, sa më larg.”* (Muslim, Taharet 39, Fedail 26)

Domethënë, besimtarët që sillen të përpiktë në çështjen e abdesit, fitojnë dashurinë dhe përgëzimin e të Dërguarit të Allahut me titullin **“Vëllezërit e mi”**. Ndërsa ata të cilët tregojnë dobësi në abdes dhe në adhurimet e tjera dhe që kanë devijuar në rrugë të gabuara, në ditën e kiametit do të dëbohen ashtu siç dëbohet një deve e huaj dhe do të kenë një fat më të tragjik se dëbimi nga i Dërguari i Allahut.



Ebu Hazim, i cili ishte nga tabiinët, vuri re se kur merrte abdes, Ebu Hurejra i lante krahët deri poshtë supit.

E pyeti: “Ebu Hurejre, ç’është ky abdes?” Ebu Hurejra radijallahu anhu, pasi tha:

“O bijtë e Ferruhut! A këtu ishit ju? Sikur ta dija se ishit këtu, nuk do të merrja abdes kështu”, vazhdoi:

“Unë kam dëgjuar mikun tim të Dërguarin e Allahut kur tha:

*“Në ditën e kiametit drita e besimtarit do të arrijë deri atje ku ka arritur uji i abdesit.”* (Muslim, Taharet, 40)



Sa bukur e shprehin vazhdimësinë e adhurimeve të të Dërguarit të Allahut fjalët e Hazreti Ali radijallahu anhu:

“Në ditën e Bedrit, ndërmjet nesh nuk kishte asnjë kalorës përveç Mikdadit. E di shumë mirë që në atë kohë të gjithë ne patëm fjetur, përveç të Dërguarit të Allahut. I Dërguari i Nderuar fali namaz dhe qau



nën një pemë deri në mëngjes.”<sup>40</sup>

Çfarë dashurie madhështore dhe çfarë adhurimi që nuk dobësohet as në paqe dhe as në luftë!..

Allahu thotë:

**“Adhuroje Zotin tënd derisa të të vij jakini (vdekja)!”** (el-Hixhr, 99)

**“Bëj sexhde dhe afrohu!”** (el-Alak, 19)



I Dërguari i Allahut (s.a.v.s), duke i marrë zemrën me fjalën “Vëllai im” Hazretit Abdullah bin Revahas që sillej shumë i ndjeshën në çështjen e namazit, e lavdëroi kështu:

*“Allahu e mëshiroftë vëllain tim Abdullah bin Revahan! Kudo që të gjejë koha e namazit, ai menjëherë ndalet dhe e fal.”* (Hejsemi, IX, 316)



Xherh bin Abdullah radijallahu anhu tregon:

Një natë po qëndronim me të Dërguarin tonë të Nderuar. Duke parë hënën e plotë, ai tha këto:

*“Siç e shikoni hënën e plotë rehat dhe pa u shtyrë me njëri tjetrin, edhe Zotin do ta shikoni po kaq rehat. Tashmë përpiquni sa të keni mundësi për të falur të gjithë namazet para se të lindë dhe perëndojë dielli.”*

Pastaj lexoi këtë ajet fisnik:

**“...Falendero Zotin tënd para se të lindë dhe perëndojë dielli, madhëroje në orët e natës dhe ditën ashtuqë të jeshë i kënaqur.”**  
(Taha, 130) (Buhari, Mevakit 16, 26, Tefsir 50/1, Tevhid 24; Muslim, Mesaxhid 211)

Domethënë që arsyeja më e madhe për të parë Zotin e madhërueshëm është përpikmëria që tregohet ndaj namazeve farze.



Çdo adhurim që bëhet, duhet parë pothuajse si një vizë hyrje në xhennet dhe duhet të kryet në këtë entuziazëm të lartë shpirtëror.

Hazreti Pejgamber (s.a.v.s) thotë kështu:

*“Nëse dikush e kryen namazin e tij në një mënyrë të bukur, duke e bërë të plotë rukunë dhe sexhden, namazi do t’i thotë:*

*“Allahu të ruajt siç me ruan ti mua! Namazi i ngrihet.*

*“Nëse dikush nuk e fal namazin mirë dhe nuk e bën rukunë dhe sexhden të plotë, namazi do t’i thotë:*

*“Siç më humbe ti mua edhe Allahu të humbtë ty! Namazi zhubroset siç zhubroset një rrobë e vjetër dhe i përplaset në fytyrë atij.”<sup>41</sup>*

Në ajetin fisnik thuhet:

**“Mjerë për ata të cilët falin namaz dhe që nuk janë të kujdeshëm ndaj tij.”** (el-Maun, 4-5)



Të vonosh namazin deri në kohën e fundit të tij, duke e marrë me përtaci, dhe të falësh farzin menjëherë sikur të hedhësh ndonjë detyrë e duke u ngritur me vështirësi, është një veti e keqe që e dërgon njeriun në hipokrizi, Allahu na ruajttë. Ala bin Abdurrahman tregon:

“Një ditë pasdreke shkuam te Enes bin Maliku. Kur arritëm, Enesi, duke u ngritur menjëherë, fali namazin e iqindisë. Kur e mbaroi namazin, i thamë që e kishte falur herët. Ai, duke na treguar se përse e fali herët, tha:

“Kam dëgjuar se i Dërguari i Allahut (s.a.v.s) ka thënë:

*“Ai është namazi i hipokritëve! Ai është namazi i hipokritëve! Ai është namazi i hipokritëve!”<sup>42</sup> Ndonjëri prej tyre qëndron sa qëndron dhe ngrihet sapo dielli zverdhet dhe fillon të perëndojë dhe kur hyn mes dy brirëve të shejtanit, ulet dhe ngrihet katër herë me shpejtësi ashtu siç mbledh ushqim zogu dhe në namaz e kujton shumë pak*

41. Sujuti, el-Xhamiu`s-Sagir, Egjipt 1321, I, 58/364.

42. Hipokrizia që përmendet që hadithin fisnik, nuk është nga aspekti i besimit, por është shenja e hipokrizisë në vepër.



*Allahun.*” (Muvatta, Kur’ani Kerim, 46; Muslim, Mesaxhid, 195)



Hazreti Omer radijallahu anhu i këshilloi kështu prefektët e tij:

“Puna juaj më e rëndësishme për mua është namazi. Kush e ruan atë dhe kush ka kujdes ndaj kohës së tij, e ka mbrojtur fenë e tij. Kush nuk e kryen dhe e humb, në një kohë të shkurtër humb edhe fenë e tij.” (Muvatta, Vukutu’s-Salat, 6)



Misuer bin Mahreme radijallahu anhu tregon:

“Kur Omer bin Hattabi radijallahu anhu u godit me hanxhar, herë-herë i binte të fikët. Njëherë hyra te ai. Sipër i kishin hedhur një mbulesë. Ai ishte shtrirë në gjendje kome. I pyeta ata që ishin pranë tij:

-Si e ka gjendjen?

Më thanë:

-Siç e shikon, në gjendje kome.

Thashë:

-A e thirrët për namaz? Nëse është gjallë, asnjë gjë nuk mund ta trembë atë për ta zgjuar përveç namazit.” Mbi këtë thanë:

-O prijësi i besimtarëve, Namazi! Namazi u fal. Hazreti Omer radijallahu anhu menjëherë erdhi në vete dhe tha:

“-Ashtu? Për Zotin, ai që lë namazin nuk ka pjesë nga Islami.”

Pastaj u ngrit dhe fali namazin duke i rrjedhur gjak nga plagët.” (Hejsemi, 1, 295; Ibn Sa’d, III, 35; Muvatta, Taharet, 51)



Kur Hazreti Ali radijallahu anhu po mbante hytbe në Kufe, duke treguar se e ka dëgjuar nga i Dërguari i Allahut, tha kështu:

“Kur vjen dita e xhuma (e premte), djalli shkon herët në treg bashkë me flamujtë e tij dhe duke u nxjerrë njerëzve shumë pengesa, mundo-



het t'i pengojë dhe së pakti t'i vonojë për xhuma. Edhe ëngjëjt shkojnë herët dhe qëndrojnë te dera e xhamisë. Ata që vijnë i shkruajnë: ata që kanë ardhur në orën e parë, ata që kanë ardhur në orën e dytë. Kjo gjendje vazhdon derisa imami të dalë në hytbe. **Nëse personi ulet në xhami në një vend që e shikon dhe e dëgjon imamin, nëse e dëgjon me gjithë shpirt dhe nëse nuk flet, ka dy herë më shumë sevape.** Nëse personi qëndron larg, ulet në një vend që nuk mund ta dëgjojë imamin, nëse qëndron pa zë dhe nuk flet, merr një sevap. Nëse ulet në një vend që e shikon dhe e dëgjon imamin por flet gjëra boshe dhe nuk rri urtë, atij i shkruhen dy mëkate...” (Ebu Davud, Salat, 209/1051)

Ata të cilët vijnë herët në xhami duke i dhënë rëndësi namazit të xhumasë, dëgjojnë me meditim duke u ulur në një vend ku mund ta dëgjojnë lehtësisht imamin dhe janë modestë, sigurisht që do të dalin më të fituar se ata që nuk janë kështu.



Lideri i tabiinëve, Muxhahid rahmetullahi alejh i cili ishte nga dijetarët e tefsirit dhe kiraatit (leximit të Kur'anit), thotë:

“Abdullah bin Zubejr radijallahu anhumā arriti në një pikë adhurimi që nuk e kishte arritur askush. Një herë vendin e tavafit e kishte mbuluar rrëkeja. Njerëzit një javë nuk mundën të bënin tavaf. Ndërsa Abdullahu gjatë një jave duke notuar bëri tavaf qaben.” (Ali el-Mutteki, XIII, 471/37228; Dhehebi, Sijer, III, 370)



Sa bukur e shpreh se adhurimet nuk duhet t'i humbim me gabimet shpirtërore edhe kujtimi i Shejh Sadiit që ka shkruajtur në librin e tij më titull “Kopështi i Trëndafilave”:

Në fëmijërinë time isha i dhënë ndaj asketizmit, edukimit dhe adhurimeve natën. Një natë po qëndroja pranë babait. Gjithë natën nuk i mbylla sytë dhe Kur'anin Fisnik nuk e lëshova nga dora. Disa persona po flinin rreth nesh. I thashë babait:

Asnjëri prej këtyre nuk e ngriti kokën për të falur dy rekate namaz. Po fletë si të vdekur. Kur dëgjoi këto, babai rudhi vetullat dhe u përgjigj:



-O biri im Sadi! Ah sikur të flije edhe ti si ata! Do të ishte më mirë se sa t'i përgojosh! (Sepse këta që i nënvlerësove ti, tani edhe nëse janë të privuar nga mëshira hyjnore, ëngjëjt Kiramen Katibin nuk u shkruajnë atyre asnjë gjë të keqe. Ndërsa në fletoren e veprave të tua u shkruajt mëkati i nënçmimit dhe i përgojimit të vëllezërve të fesë).



Përpikmërinë që kanë treguar ndaj adhurimeve, myslimanët e kanë mbrojtur edhe në kohë lufte, gjë me të cilën fituan ndihmën e Allahut. Travijani nga Venediku e përshkruan kështu ushtrinë heroike dhe ngadhënjimtare të Jëlldërëm Bajezidit:

“Në ushtrinë osmane nuk ka alkool, bixhoz dhe prostitucion si te ne. Përveç mësimave ushtarake që nuk i lënë mangët, ata vazhdimisht përkujtojnë emrin e Allahut të lartë dhe madhështor, natën e ditë ata përkushtohen me adhurim. Për këtë shkak fitojnë gjithmonë.”



Xhamija Bajezid u hap për adhurim një ditë xhumaje dhe namazin e parë e fali i biri i Fatihut Bajezid Hani II. Këte ngjarje Evlija Çelebi e tregon kështu:

“Kur mbaroi ndërtimi i xhamisë, ajo u hap për adhurim në një ditë të premtë, me një ceremoni të madhe. Bajezidi Veli tha:

-Kush nuk e ka lënë fare në jetën e tij synetin e parë të namazeve të iqindisë dhe jaciesë, le të bëhet ai imam në këtë kohë të bekuar. Kur nuk doli asnjë njeri nga turma e xhematit, Bajezid Hani tha:

**-Elhamdulillah! Ne këto synete nuk i kemi lënë as në luftë e as në paqe!..., dhe duke u bërë imam, fali namazin.**



Mehmed Reshadi VI, i cili ishte një nga sulltanët osmanë, zonjës Safije të cilën e kishte emëruar si “Mualime-i Selatin, Mësuese e Sulltanëve” që t’u jepte mësim fëmijëve të familjes në kështjellë, së pari i pat urdhëruar këtë:





“Haram u qoftë kripa dhe ushqimi që u kam dhënë, atyre që nuk falin namaz dhe që nuk mbajnë agjërime! Urdhëri im le t’i përcillet nga zonja mësuese të gjithë princave që janë nxënës, si dhe zonjave mbretëresha.”<sup>43</sup>

Pozita e kësaj bote nuk i bëri ata të harrojnë ndjenjën e adhurimit si namazi dhe agjërimi në krye të çdo pune dhe nuk mundi t’i lërë pas për të vendosur përpjekjet, të cilat janë ushqimi i botës tjetër.



Një nga shembujt më të gjallë të përpikmërisë në çështjen e adhurimeve është shembulli i luftëtarit të famshëm kaukaz Shejh Shamilit. Në mbrojtjen e Gimrit, në në vitin 1829, ai pati marrë shumë plagë shpate, bajonete dhe plumbi. Një bajonetë e cila i hyri nga gjoksi dhe i doli nga shpina, ia copëtoi mushkëritë, veçanërisht kraharorin dhe kockën që lidh kraharorin me supin. Si rezultat i mjekimeve nga vjehri i tij i cili ishte kirurg, ai u rimëkëmb vetëm pas një kohë afërsisht gjashtëmujore. Ky luftëtar i ri, i cili shtrihej në koma gjatë 25 ditëve, duke filluar që nga dita kur qe plagosur, në fund të ditës së 25 erdhi në vete dhe me të hapur sytë gjeti te koka nënën e tij. Fjala e parë që i tha asaj ishte:

-Nënë e dashur! A ka kaluar koha e namazit?<sup>44</sup>



Ishte një ditë para bajramit të Ramazanit, kur ende vazhdonte lufta e Çanakkalesë. Komandanti i frontit, Vehip Pasha, duke thirrur imamin e ri të çetës së nëntë, në një mënyrë të mërziatur, duke mos dashur, i tha:

O hafiz! Nesër është bajrami i Ramazanit. Ushtarët duan ta falin namazin e bajramit me xhemat. Çfardo që thashë, nuk munda t’i bëj të heqin dorë, sepse kjo është diçka shumë e rrezikshme, domethënë është një shans për fshirjen në masë që armiku e kërkon dhe s’e gjen. Edhe ti shpjegojua njëherë këtë me një gjuhë të përshtatshme!...

43. Safije Ynyvar, Saray Hatıralarım, Stamboll 1964, fq. 21.

44. Ibrahim Refik, Efsane Soluklar, Stamboll 2002, fq. 78.



Imamit të nderuar, akoma pa u ndarë nga pashai, i doli para një person me fytyrë të ndriçuar dhe i tha:

“-O biri im! Kujdes mos u thauj asgjë ushtarëve! Lind një ditë e re dhe ka mirësi inshallah! Çfarë të thotë Allahu, ashtu bëhet.

Mëngjesin e së nesërme u jetua një shfaqje hyjnore që e habiti çdonjërin. Nga qielli zbritën retë varg-varg dhe ranë mbi ushtarët besimtarë, zemra e të cilëve mbushej dhe shpërthente me dashurinë e adhurimit të Allahut. Forcat armike që i vëzhgonin ata me dylbi, tashmë nuk mund të shikonin asgjë përveç reve të bardha. Tekbirët me zë të lartë që u morën në namazin e bajramit i cili u fal me një emocion shpirtëror komplet tjetër, u ngritën dallgë-dallgë për në qiell. Zërat e fjalës së shehadetit që shpërthenin nga zërat e ushtarëve, ndërkohë që i moshuari me fytyrë të ndriçuar po lexonte disa ajete nga surja Fetih, dëgjohej një nga një si klithmë besimi edhe nga palët e armikut.

Ja, në këtë kohë lindi një anarki e madhe ndërmjet forcave angleze, sepse një pjesë ushtarësh myslimanë që ishin sjellë nga kolonitë e ndryshme angleze duke i gënjyer, me të dëgjuar zërat e tekbirëve dhe të teuhidit e kuptuan se po luftonin kundër një populli mysliman si ata dhe bënë kryengritje. Anglezët e dhunshëm, të cilët nuk dinin çfarë të bënin, një pjesë të tyre i vranë, ndërsa të tjerët u detyruan detyruan t'i largonin menjëherë nga vija e frontit.

Besimi, që ishte një kala e patundshme në zemrat e ushtarëve të Islamit, bëri të mundur që adhurimet të mund të kryheshin edhe në front, dhe si rezultat i kësaj mbi të gjithë ushtrinë zbriti bekimi dhe ndihma hyjnore.



Hazreti Pejgamber alejhissalatu uesselam duke njoftuar se njerëzit do të kalojnë shpejt nga ura e siratit, në lidhje me rëndësinë që u kanë dhënë adhurimeve tha kështu:

*“Njerëzit vijnë në xhehnm, pastaj kalojnë sipas veprave të tyre: Grupi i parë i tyre do të kalojë me shpejtësinë e rrufesë, grupi i dytë do të kalojë si erë. Tjetri me shpejtësinë e një kalorësi, tjetri me shpejtësinë e një njerui që i ka hipur devesë, tjetri duke vrapuar dhe më i fundit*



*kalon duke ecur.*” (Tirmidhi, Tefsir, 19/3159)



Së fundi, qëllimi në adhurim dhe nënshtrim është qëndrimi shpirtëror me Allahun, domethënë njësimi me Allahut dhe dashuria ndaj Tij. Adhurimet japin njeriut mirësi dhe moral të bukur aq sa shfaqja e besimit në zemër. Adhurimet që bëhen me dashuri dhe mall, e thellojnë shpirtin dhe e afrojnë robin të Allahu. Zhvillojnë ndjenjat e mëshirës dhe bujarisë në zemër. Zoti bëhet këtyre robërve syri që shikojnë dhe veshët që dëgjojnë. Domethënë, mendimet, ndjenjat dhe deklaratimet e tyre formohen tashmë nga rrjedhjet e dritës hyjnore.

**Zoti na e mundësoftë të gjithëve! Amin!..**

### **a. Adhurimet nafile (Vullnetare)**

Adhurimet nafile i forcojnë farzet dhe bëhen shkak për afrimin e robit të Allahu. T'i falësh farzet të plota dhe pa mungesa, me një natyrë të pranueshme të Allahu, në kuptim të plotë është e pamundur (nga shkak i nevojave njerëzore). Sado që të kihet kujdes, sigurisht që herë-herë ndodhin mangësi dhe gabime. Për këtë arsye, për të plotësuar këtë mangësi, nuk ka zgjidhje tjetër përveç nafileve. I Dërguari i Allahut lajmëron:

*“Puna e parë që do t'i pyetet robit ditën e kiametit është namazi. Nëse namazin e ka të saktë, puna i shkon mirë dhe fiton. Nëse namazin nuk e ka të saktë, humbet dhe del me dëm. Nëse ka diçka mangët nga farzet, Zoti që është Aziz dhe Xhelil thotë:*

*Shikoni, a ka namaze nafile robi im? Mangësia e farzeve plotësohet me nafile. Pastaj në këtë mënyrë pyetet edhe për veprat e tjera.”* (Tirmidhi, Salat, 188/413)

Por nga këto nuk duhet të na krijohet ideja se, duke lënë farzet, të përqendrohemi te nafilet. Siç nuk është e saktë që të neglizhojmë nafilet duke u përqendruar vetëm te farzet, nuk është e drejtë që të neglizhojmë farzet duke u përqendrohemi te nafilet. E drejta është që,



krahas kryerjes së farzeve të përpiqemi për të kryer me qetësi edhe adhurimet nafile, aq sa të kemi mundësi. Praktika e të Dërguarit të Allahut dhe të ashabëve të tij në jetë, sa i takon kësaj çështjeje, është e vetmja rrugë e drejtimit.

Nga ana tjetër, edhe lënia e nafileve të atyre që kanë borxhe kaza, duke falur vetëm kazatë nuk është e drejtë, sepse kazatë mund të falen në çdo kohë të ditës përveç kohëve të papëlqyera. Ndërsa sa u takon disa namazeve nafile si namazi i tehexhjudit, i ishrakut, i paradites dhe i evvabinëve, ngaqë janë të lidhur me kohën, duhet të sillemi të kujdesshëm në çështjen e kryerjes së tyre.<sup>45</sup>

Robi nuk mund t'i afrohet Allahut me asnjë lloj pune tjetër sa ç'i afrohet me farze. Por ky udhëtim i lartë u vazhdon me nafile. I Dërguari i Allahut (s.a.v.s) thotë kështu:

“Kushdo (që më adhuron Mua me sinqeritet) dhe është armik i një mikut tim, edhe unë i shpall luftë atij. Robi nuk mund të më afrohet mua me ndonjë gjë më të dashur se sa me gjërat që ia kam bërë farz. Robi im më afrohet pa pushuar me adhurime nafile (që ka kryer si shtesë ndaj farzeve). Atëherë edhe Unë e dua atë. **Kur e dua robin tim, unë i bëhem pothuajse veshi që dëgjon, syri që shikon, dora që kap, këmba që ecën, mendja që mendon dhe goja që flet.** Çfardo që të dojë nga unë, ia jap. Nëse strehohet te unë, Unë e mbroj atë. Unë nuk kam rënë në hezitim në punët që do të bëj aq sa kam rënë në marrjen e shpirtit të robit tim, sepse ai nuk e do vdekjen, edhe unë nuk e dua diçka që nuk e do ai.” (Shik. Buhari, Rikak, 38; Ahmed, VI, 256; Hejsemi, II, 248)

Adhurimet nafile e mbajnë të gjallë ndërgjegjen e adhurimeve, zemrën e bëjnë të ndjeshme, shpirtin e hollojnë dhe fytyrës i falin bukuri vezulluese. Entuziazmi i besimit të atyre që vazhdojnë nafilet më frikë-respekt, me qetësi shpirtërore dhe me zgjuarsinë e zemrës, është më i madh ndërsa dëshirat e takimit janë më të entuziasmuara. Sigurisht, edhe lumturia dhe gëzimet e tyre në ahiret realizohen në lidhje me të.

45. Muxhtehidët e medhhebit hanefi këmbëngulin për të mos lënë namazet sunnet. Por ai që i thuhet sinn-i kebir (i moshuari) në gjendje të pleqërisë që ka rënë nga fuqia saqë nuk ka mundësi t'i falë përnjëherë edhe namazet farze dhe namazet sunnet, në vend të namazeve sunnet mund të falet namaz kaza.



## *Tabllo të virtytshme*

Ditët dhe netët e të Dërguarit të Allahut (s.a.v.s) begatoheshin shumë me adhurimet nafile, të cilat i vazhdonte përveç farzeve. Namazet sunnet që i falte para dhe pas namazeve farz, namazi i Tehexhxhudit të cilin e vazhdonte netëve, adhurimet si dhikri dhe meditimi, leximi i një pjese të Kur'anit çdo ditë, namazet si i işrakut, i duhasë dhe namazi i evvabin, agjërimet nafile, lëmoshat që nuk kishin të mbaruar, përpjekjet në rrugën e Allahut, buzëqeshjet e përhershme që shpërthenin si trëndafil në fytyrën e tij të bekuar, ishin shenjat e unitetit të tij qetësues me Allahun Teala. Kur gëzohej ose kur merrte ndonjë lajm të gëzuar, bënte sexhde<sup>46</sup> dhe falte namaz<sup>47</sup> për të falenderuar për këtë mirësi të Allahut. Menjëherë falte namaz<sup>48</sup> ndaj ngjarjeve të jash-tëzakonshme si eklipsi i diellit dhe i hënës, domethënë ndaj shfaqjeve madhështore hyjnore. Përsëri falte namaz kur do të kërkontë ndonjë nevojë të tij nga Allahu. Ramazani fisnik i të Dërguarit të Allahut fitonte më shumë ndjenjë shpirtërore me adhurimet si taravitë, itikafi dhe lëmosha. Edhe pas ramazanit, herë-herë vazhdonte të mbante agjërimet nafile. Përfundimisht pëlqente të agjëronte ditën e hënë dhe të enjte dhe shkakun e kësaj e sqaron kështu:

*“Veprat paraqiten (dërgohen) te Allahu Teala ditën e hënë dhe të enjte. Unë dua që puna ime të dërgohet kur unë jam agjërueshëm.”*  
(Tirmidhi, Saum, 44/747)

Në çdo muaj të hixhrit në ditët e 13, 14 dhe 15 që quhen “Ejjam-i Biz”, i jepte rëndësi agjërimit dhe ua këshillonte edhe ashabëve të tij. Ibn Abbas radijallahu anhu thotë:

“Agjërimin në “Ejjam-i Biz”, Pejgamberi ynë i Nderuar nuk e linte as në paqe, as në luftë.” (Nesai, Saum, 70)

Gjashtë ditë të muajit të Shevvalit, i Dërguari i Allahut i kalon-

46. Sexhdeja e falenderimit është njëloj si sexhdeja e tilavetit. Nijeti për sexhden e falenderimit bëhet duke qënë me abdes, pa ngritur duart duke thënë “Allahu ekber” merret tekbir, shkohet në sexhde, sexhdeja bëhet e gjatë sa të kesh mundësi dhe pastaj ngrihesh.

47. Ibn Maxhe, Salat, 192.

48. Buhari, Kusuf, 2-4; Ibn Hibban, Sahih, Bejrut 1993, VII, 68, 100.

te agjërueshëm<sup>49</sup>, ndërsa në ditën e 9-10 ose 10-11 të Muharremit mbante agjërimin e Ashures.<sup>50</sup>

Përsëri Krenaria e Gjithësisë (s.a.v.s) tregonte vlerat e larta të umres dhe të haxhit, përkujtonte gjithmonë Allahun dhe nuk e ndërpriste falenderimin, tespihet dhe kërkimin e faljes. Priste kurban për vete dhe në emër të të dobtëve të ummetit.<sup>51</sup>



Rebia bin Ka`b radijallahu anhu tregon:

“Gjatë shumë netëve unë i përgatitja të Dërguarit tonë të Nderuar ujin e abdesit në derën e tij dhe i sillja gjërat që i nevojiteshin. Natën e dëgjoja tek thoshte një herë Semiallahu li-men hamideh dhe një herë Elhamdu lillahi Rabbi`l-alemin. (Ibn Sa`d, IV, 313)

Një ditë i Dërguari i Allahut më tha:

“*Kërko nga unë atë që do!*” Unë i thashë:

“Dua të jem në xhennet bashkë me ty.” I Nderuari ynë tha:

“*A nuk bën të kërkosh diçka tjetër?*” Unë thashë:

“Ajo që dua është vetëm kjo.” Në lidhje këtë i Dërguari i Allahut tha:

“*Atëherë, duke bërë shumë sexhde për veten tënde, më ndihmo mua!*” (Muslim, Salat, 226)

Qëllimi i sexhdes përgjithësisht është namazi. Atëherë, ata që duan të hyjnë në xhennet dhe që duan të jenë pranë me të Dashurin e Allahut, duhet të falin shumë namaz dhe duhet t'i shtojnë sexhdet të cilat janë çaste të afrimit me Allahun, sepse pozita e Hazretit Pejgamber (s.a.v.s) në xhennet është një pozitë e lartë e cila është edhe mbi pejgamberët e tjerë. Siç kuptohet nga hadithi fisnik, për të qënë afër të Nderuarit tonë në xhennet, është e nevojshme që të kryejmë detyrat e sunnetit senijje të tij dhe veçanërisht është e nevojshme që të falim shumë namaz.



---

49. Muslim, Sijam, 204.

50. Muslim, Sijam, 115.

51. Ebu Davud, Edahi, 3-4/2792; Ibn Sa`d, I, 249.



Ummu Habibe radijallahu anhu tregon:

“I Dërguari i Allahut (s.a.v.s) thotë

*Kushdo që fal çdo ditë dymbëdhjetë rekate nafile përveç farzeve, Allahu patjetër bën një shtëpi për të në xhennet. Që kur e kam dëgjuar këtë përgëzim nga i Dërguari i Allahut, nuk i kam lënë fare këto namaze.”* (Muslim, Musafirin, 103)



Ditën kur u çlirua Hajberi, një njeri shkoi te Pejgamberi (s.a.v.s) dhe i tha:

“O i Dërguari i Allahut, sot kam fituar aq sa mos pyet! Një fitim të tillë nuk e ka arritur asnjëri nga njerëzit e kësaj lugine.” I Nderuari ynë e pyeti:

“-Pa të shikojmë! Çfarë ke fituar?” Sahabiu tha:

“Nuk kam ndaluar fare së marri dhe së shituri ashtuqë kam fituar treqind ukijje<sup>52</sup>.” Si kundër kësaj i Nderuari ynë (s.a.v.s) e pyeti:

“A të të tregoj fitimin më të mirë?”

Ai i tha

“Kush është o i Dërguari i Allahut?” I Dërguari i Allahut u përgjigj:

“-Janë dy rekate nafile namaz që do të falësh pas namazit (farz).” (Ebu Davud, Xhihad, 168/2785)



I Dërguari i Allahut (s.a.v.s) dërgoi në një krahinë një grup ushtarak. Ushtarët e Islamit u kthyen brenda një kohe të shkurtër, me shumë ganimete (plaçka lufte). Dikush nga të pranishmit tha:

“O i Dërguari i Allahut! Ne nuk kemi parë ndonjë grup që të kthehet kaq shpejt dhe me kaq shumë ganimet, si këta. I Dërguari i Allahut e pyeti:

“-A tju tregoj diçka që kthehet më shpejt së këta dhe që sjell më

52. Ukijje: Është një peshë e vjetër 1283 gramëshe dhe masë vlere.



shumë ganimet?” dhe vazhdoi:

“-Nëse dikush, duke marrë abdes, bukur vjen në xhami, fal namazin e sabahut pastaj namazin e paradites, ja, ky person është ai i cili kthehet më herët dhe fiton më shumë.” (Ibn Hibban, VI, 276/2535)



Ibn Omer radijallahu anhu thotë:

I thashë Ebu Dherrit radijallahu anhu:

“O xhaxha i dashur! A mund të më këshillosh?” Më tha:

“-Edhe ti po kërkon nga unë atë që kam kërkuar nga i Dërguari i Allahut. I Dërguari i Allahut tha kështu:

*Nëse namazin e paradites e fal dy rekate, nuk shkruhesh nga të shkujdesurit, nëse e fal katër rekate, shkruhesh si adhures, nëse e fal gjashtë rekate, Allahu t'i mbyll nevojat e tua, nëse e fal tetë rekate, shkruhesh prej atyre që bëjnë shumë adhurim, nëse e fal dymbëdhjetë rekate, në xhennet ndërtohet një shtëpi për ty.*

*Nuk ka asnjë ditë, madje asnjë natë e as edhe një çast që Allahu në atë kohë të mos i japë robërve atë që duan! Allahu Teala robit të tij nuk i ka dhënë gjë më të madhe sesa frymëzimin e dhikrit (përkujtimit) në zemrën e tij.” (Hejsemi, II, 236; Ali el-Muttaki, VII, 809/21511)*



Hazreti Pejgamber (s.a.v.s) thotë:

“Në xhennet ka një derë e cila e ka emrin “Dera e Paradites”. Në ditën e gjykimit një thirrës do të thërrasë:

-Ku janë ata të cilët e kanë vazhduar namazin e Duhasë<sup>53</sup> (paradites)? Ja dera juaj, hyni atje me mëshirën e Allahut!.” (Sujuti, I, 355/2323)



Gjithmonë, pasi të marrësh abdes ose gusul, të falenderosh

53. Namazi i Duhasë, mund të falet pasi të kalojë e ditës dhe qëkur dielli të fillojë të ngrohë ambjentin derisa të shkojë deri në mesin e qiellit në vaktin e mesditës.





Allahun, i cili na dhuroi mirësinë e Islamit dhe fatin për të marrë abdes duke falur të paktën dy rekate; kjo është një veti e bukur.

Kështu, Hazreti Osman radijallahu anhu, me qëllim që të mësonte njerëzit, pasi mori abdes, tha:

“Unë kam parë të Dërguarin e Allahut (s.a.v.s) kur merrte abdes në këtë mënyrë. I Nderuari ynë kur mbaronte abdesin thoshte:

*-Kush merr abdes si unë, pastaj fal dy rekate namaz dhe në namaz qëndron larg druajtjeve të vetes, i falen mëkatet e kaluara.”* (Buhari, Vudu, 24)



I Dërguari i Allahut (s.a.v.s) e pyeti Bilalin radijallahu anhu:

“-O Bilal! Pasi je bërë mysliman, nga cilat adhurime që ke bërë ke pritur më shumë sevape? Sepse në xhennet përpara meje kam dëgjuar zhurmën e nallaneve të tua!” Edhe Hazreti Bilal tha:

“Natën ose ditën, pasi marr abdes, fal namaz sa të kem mundësi. Adhurimi nga i cili pres më shumë sevap, është ky.” (Buhari, Tehexhjud 17, Tevhid 47; Muslim, Fedailu’s-Sahabe 108)

I Dërguari i Allahut (s.a.v.s) në ëndërr pa Hazreti Bilalin që ecte përpara tij në xhennet.<sup>54</sup> Zoti, për të treguar rëndësinë e namazeve nafile, i shfaqti një ëndërr të tillë të Nderuarit tonë.



Një ditë, Ebu Katade erdhi në xhaminë e Profetit. Kur e pa të Dërguarin e Nderuar të ulur mes sahabëve, edhe ai erdhi dhe u ul. Në lidhje me këtë, i Dërguari i Allahut (s.a.v.s), duke u kthyer nga Ebu Katade, i tha:

*“-Kush të ndaloj që të falësh dy rekate namaz para se të uleshe?”* Ebu Katade tha:

“O i Dërguari i Allahut! Pashë se ti dhe xhemati ishit të ulur (për këtë shkak nuk i fala).” I Dërguari i Allahut (s.a.v.s) tha:

54. Shik. Buhari, Ashabu’n-Nebi, 6.



*“Kur ndonjëri prej jush të hyjë në xhami, mos të ulet para se të falë dy rekate namaz!”* (Muslim, Musafirin, 70)



Ashabët e nderuar, kur kishin ndonjë nevojë apo problem, menjëherë falnin namaz nafile dhe i luteshin Allahut. Një ditë vere, një kopështar shkoi te Hazreti Enes dhe u ankua se nuk kishte rënë shi dhe se i qe tharë tërë kopshti. Enesi radijallahu anhu, duke kërkuar ujë, mori abdes dhe fali namaz. Pasi dha selam, e pyeti kopshtarin:

“A shikon gjë në qiell?” Kopshtari tha

“Nuk shikoj.” Enesi radijallahu anhu hyri përsëri brenda dhe vazhdoi të falë namaz. Kur e pyeti për të tretë ose të katërt:

“A shikon gjë në qiell?” Kopshtari tha:

“Shoh një re sa një fletë zogu.” Pas kësaj, Enesi radijallahu anhu vazhdoi namazin dhe lutjen e tij. Pas pak, kopshtari hyri te ai dhe i tha:

“Qielli u mbulua me re dhe filloi të bie shi.” Hazreti Enes tha:

“Eja, hip në kalin që e ka dërguar Bishr bin Shegaf dhe shiko se deri ku ka rënë shi!”

Kopështari i hipi kalit dhe pasi i ra rreth e rrotull dhe vuri re se shiu nuk kishte kaluar përtej shtëpive Musejjerin dhe kështjellës Gadban, kufinj brenda të cilëve ndodhej edhe kopshti i Hazretit Enes. (Ibn Sa’id, VII, 21-22)



Ndjenjat që kishin në namazet nafile, ashabët e nderuar i reflektonin edhe te fëmijët e tyre. Një zonjë nga sahabet Rubejji’ bint Muavvidh radijallahu anha thotë:

“...Ne mbanim agjërimin e ditës së Ashures. Po ashtu i bënim edhe fëmijët që ta mbajnë. Shkonim në xhami dhe u bënim lojra prej leshi fëmijëve. Kur ndonjëri prej tyre qante për të ngrënë, ua largonim vëmendjen deri në iftar duke u dhënë këto lojëra.” (Buhari, Saum, 47; Muslim, Sijam, 136)



Së fundi, farzet janë adhurimet në shkallën më të vogël që i janë urdhëruar robërve. Besimtarët, si shtesë e këtyre detyrave më të vogla, me dëshirën e afrimit kah Zoti i tyre dhe si falenderim ndaj mirësive që kanë fituar, është e nevojshme që të vazhdojnë adhurimet nafile edhe kur janë mirë edhe kur bien ngushtë, e kësisoj duhet t'i shtojnë në lidhje me mundësitë e tyre, sepse adhurimet janë dalja në prani të Allahut dhe takimi me Të. Ky është një sukses që mbytet në dëshirat shpirtërore të zemrave besimtare dhe i cili u hap shteg klimave madhështore.

Ushtrimet që bëhen me adhurime nafile dhe përpjekjet që tregohen, së fundi e dërgojnë robin në një gjendje që shpreh të qenit gjithmonë bashkë me Allahun.

Nafilet janë sjelljet më të përshtatshme ndaj qëllimit të krijimit të njeriut dhe janë ushqimi më i rëndësishëm i ahiretit për robin.

## **b. Frekuentimi në xhemat**

Edukimi shoqëror është njëri nga themelet më të rëndësishme të Islamit. Edukimi i parë shoqëror i myslimanëve fillon nga falja e namazit me xhemat. Ja, kjo është vepra e devotshme më e rëndësishme që forcon ndjenjën e bashkimit dhe unitetit në shoqërinë Islame, e cila është ndërtuar mbi tevhidin. Aty ku falet namaz me xhemat, do të thotë se ka filluar të konceptohet struktura shpirtërore dhe sociale e Islamit.

Islami urdhëron që besimtarët të jetojnë në gjendje xhemati, që të ndihmojnë njëri-tjetrin në çdo çështje dhe të përpiqen në rrugë të Allahut, në bashkim dhe unitet të plotë, pothuajse si një rresht. Allahu thotë:

**“Allahu i do ata që luftojnë në rrugën e Tij të rreshtuar sikur të jenë një ndërtesë e fortifikuar.”** (es-Saff, 4)

I Dërguari i Allahut (s.a.v.s) thotë

*“...Dua që të jëni në gjendje xhemati dhe dua që patjetër të lar-*



*goheni nga ndarja dhe përhapja, sepse djalli është me ata që jetojnë vetëm. Edhe nëse janë dy vetë, nëse janë nga ata që jetojnë të bashkuar, ai është larg. Ai që dëshiron të jetë në mes të xhennetit, le të frekuentojë në xhemat...*” (Tirmidhi, Fiten, 7/2165)

Në çdo rekat të namazit, kur themi, **“Vetëm ty të adhurojmë dhe vetëm nga Ti kërkojmë ndihmë!”** në leximin e sures Fatiha, së paku dyzet herë në ditë i shprehim Zotit tonë se jemi xhemat.

Pejgamberi (s.a.v.s), kur shkoi si në Kuba ashtu dhe në Medine Munevvere, puna e parë që bëri ishte ndërtimi i një xhamie. Duke punuar edhe vetë në ndërtimin e saj, ai hodhi themelet e shoqërisë Islame.

Edhe stërgjyshërit tanë, të cilët ndiqnin sunnetin e të Nderuarit tonë, kur ngrinin qytete, ndërtonin më së pari një xhami të madhe për qendrën, pastaj thurnin qytetin rreth kësaj xhamie si një kurorë drite.

Për këtë arsye, të falësh namazin me xhemat, është sjellja më e përshtatshme ndaj Islamit dhe urdhëri i Zotit tonë të Lartë.

I Nderuari ynë thotë:

*“Kur një nga myslimanët gjendet shpesh nëpër xhami për namaz dhe dhikër, Allahu Teala kënaqet nga gjendja e këtij personi ashtu siç kënaqet familja kur i kthehen të afërmit që janë në kurbet.”* (Ibn Maxhe, Mesaxhid, 19)

*“Kush i njeh xhamitë, edhe Allahu e njeh atë.”* (Sujuti, II, 143)

*“A t’ju tregoj se me çfarë jua fshin Allahu Teala gabimet dhe me çfarë jua rrit gradat? Të marrësh abdes në ditët e ftohta, të shkosh në xhemat nga vendet e largëta dhe pasi të falësh namazin të presësh kohën e namazit tjetër. Ja kjo është dashuria e vërtetë! Ja kjo është dashuria e vërtetë! Ja kjo është dashuria e vërtetë!”* (Muvatta, Kasru’s-Salat, 55)

Aishe radijallahu anha thotë:

*“Kush e dëgjon ezanin dhe nuk shkon në xhami, nuk e do të mirën, ose nuk i është dhënë e mira.”* (Bejhaki, es-Sunenu’l-Kubra, III, 57)



I Dërguari i Allahut (s.a.v.s) është sjellur shumë ashpër ndaj atyre që bënin neglizhime në çështjen e frekuentimit në xhemat. Po ashtu një ditë tha:

*“Kush e dëgjon muezinin dhe nuk shkon në xhemat në një kohë kur nuk ka asnjë arsye që e pengon, namazin që e ka falur vetëm, nuk pranohet (si një namaz i plotë).”* Ashabët e nderuar thanë:

“(O i Dërguari i Allahut!) Cila është arsyeja?” I Nderuari ynë tha:

*“-Frika ndaj rrezikut, ose sëmundja.”* (Ebu Davut, Salat, 46/551)

Lënia e xhematit bëhet shkak për shpërndarjen e shoqërisë Islame. Allahu i ka qortuar kështu ata që e copëtojnë shoqërinë:

**“Vërtetë ti nuk ke asnjë lloj përgjegjësie për ata që e përçanë fenë e tyre dhe u ndanë në grupe...”** (el-En’am, 159)

### ***Tabllo të virtytshme***

Ebu Hurejra radijallahu anhu tregon:

“Gjatë në një udhëtimi, i Dërguari i Allahut (s.a.v.s) pati qëndruar ndërmjet Daxhxhan dhe Usfan. Mushrikët thanë:

-Ata kanë një namaz që për ata është më i vlefshëm se sa baballarët dhe fëmijët e tyre. Ky namaz është namazi i iqindisë. Përgatituni për mësymje të përgjithshme!

Në lidhje me këtë, Xhebraili alejhisselam, duke ardhur te i Dërguari i Allahut, solli ajetin e 102 të sures Nisa, ku përshkruhet se si duhet falur namazi me xhemat në kohë lufte.” (Tirmidhi, Tefsir, 4/21)

Domethënë, kushtet le të jenë si të jenë, madje edhe nëse është gjendje lufte, për muslimanët nuk bëhet fjalë që ta vonojnë apo të mos e falin namazin me xhemat.



Xhafer bin Amr transmeton se babai i tij ka thënë:

“E pashë të Dërguarin e Allahut (s.a.v.s) kur po prente dhe po



hante nga pjesa e përparme e shpatullës (së një deleje). Në atë moment e thirrën për në namaz. Menjëherë u ngrit në këmbë, e la thikën që kishte në dorë në një anë dhe filloi të falë namaz pa marrë përsëri abdes.” (Buhari, Ezan, 43)

I Dërguari i Allahut, për shkak të përpikmërisë që kishte në çështjen e frekuentimit në xhemat, e la ushqimin dhe menjëherë fali namazin në kohën e parë të tij, i cili mund të falej edhe pas ushqimit.



Jeziid bin Amr radijallahu anhu tregon:

“Shkova te i Dërguari i Allahut kur po falte namaz. U ula dhe nuk mora pjesë në xhemat. Pas namazit, kur i Nderuari ynë u kthye nga ne, pa se isha ulur në qoshe. Tha:

*“O Jezid, a nuk je bërë mysliman?”* Thashë:

*“-Jam bërë o i Dërguari i Allahut!”*. Tha:

*“Atëherë kush të pengoi që të mos merrje pjesë në xhemat?”*. Thashë:

*“Unë e fala në shtëpi, duke menduar se ju e keni falur.”* Mbi këtë Pejgamberi tha:

*“Nëse vjen në namaz dhe i gjen njerëzit në namaz, fale bashkë me ta. Nëse e ke falur namazin më përpara, kjo bëhet nafile për ty. Ai që ke falur në shtëpi kalon në vendin e farzit.”* (Ebu Davud, Salat, 56/577)



Njëra nga çështjet më të rëndësishme, për të cilën i Dërguari i Allahut (s.a.v.s) ka treguar përpikmëri edhe në kohën e sëmundjes, e që u bë shkak edhe të vdiste, ishte namazi me xhemat. Sipas të dhënave të Hazretit Enes, i Nderuari ynë, Krenaria e Gjithësisë, vetëm në tre ditët e fundit të sëmundjes nuk mundi të merrte pjesë në xhemat. (Buhari, Ezan, 46)

Hazreti Aishe radijallahu anha thotë:

*“Kur iu ashpërsua sëmundja, Pejgamberi i Nderuar pyeti:*



“-A e falën namazin ashabët e mi?” I thamë:

“-Jo, O i Dërguari i Allahut.” Tha:

“-Atëherë më përgatitni ujë!” I përgatitëm ujin dhe u la. Kur po mundohej të ngrihej, i ra të fikët. Pas një farë kohe erdhi në vete. Përsëri pyeti:

“-A e falën namazin ashabët e mi?” I thamë:

“-Jo, O i Dërguari i Allahut, po iu presin Ju.” Tha:

“-Atëherë më përgatitni ujë!” I përgatitëm ujin dhe u la. Kur po mundohej të ngrihej i ra të fikët. Pas një farë kohe erdhi në vete.

Këtë e përsëri disa herë. Në atë kohë njerëzit po e prisnin Pejgamberin (s.a.v.s) për namazin e jacisë. Pas kësaj, i Dërguari i Allahut i dërgoi lajm Hazretit Ebu Bekir që të falte namazin. Ebu Bekiri radijallahu anhu, ishte një njeri me zemër të butë, për këtë arsye i tha Hazretit Omer:

“O Omer, a po e fal ti namazin me njerëzit?” Ndërsa Hazreti Omer u përgjigj:

“Ti je më i përshtatshëm për ta bërë një gjë të tillë.” Atë ditë namazin e fali Ebu Bekri, radijallahu anhu.

Kur në ditët e tjera i Dërguari i Allahut (s.a.v.s) e ndjeu veten më mirë, ai shkoi në xhami për namazin e një dreke, teksa e mbanin për krahësh. (Akoma e kam përpara syve zvarritjen nëpër tokë të këmbëve të tij të bekuara, për shkak të pafuqisë për të ecur.)<sup>55</sup> Hazreti Ebu Bekir në këtë kohë po falte namazin. Kur pa se erdhi i Nderuari ynë, deshi që të tërhiqej mbrapa, por i Dërguari i Allahut (s.a.v.s), ia bëri me shenjë që të mos lëvizte nga vendi. Pastaj erdhi dhe u ul pranë Hazretit Ebu Bekir. Në këtë gjendje e plotësuan namazin. Ebu Bekri radijallahu anhu duke ndjekur Hazretin Pejgamber, ndërsa njerëzit duke ndjekur Hazretin Ebu Bekir.” (Buhari, Ezan, 51)

Enesi radijallahu anhu tregon kështu:

“Hazreti Ebu Bekir po falte namazin. Së fundi, kur erdhi dita e

55. Buhari, Ezan, 67.



hënë dhe kur po falnim namazin reshta-rreshta, i Dërguari i Allahut (s.a.v.s) ngriti perden e dhomës së lumturisë (dhomës së Tij) dhe filloi të na shikonte. Po qëndronte në këmbë. Fytyra e Tij ishte e pastër si fletë Kur'ani. Pastaj buzëqeshi, iu dukën dhëmbët e bekuar. Kur e pamë të Nderuarin tonë, u gëzuam aq shumë, sa për pak sa s'e prishëm namazin. Duke menduar se i Dërguari i Allahut do të vijë në namaz, Hazreti Ebu Bekir filloi të tërhiqej mbrapa, por Krenaria e Gjithësisë (s.a.v.s), pasi na e bëri me shenjë që ta plotësonim namazin, mbylli perden. Ja, (ky ishte takimi ynë i fundit me të) atë ditë shkoi në botën e përhershme." (Buhari, Ezan, 46)

Duke parë se po linte prapa një shoqëri të organizuar si në një rresht të vetëm, ose si një ndërtesë e përforcuar me plumb, që vazhdonte namazin me xhemat, i Dërguari i Allahut u gëzua aq shumë sa që kur i shikonte ata, në fytyrën e tij të bekuar çelnin trëndafilat. Kjo buzëqeshje e të Nderuarit të Botërave, që ndriçonte gjithësinë, u dha shpresë ashabëve të nderuar, por tashmë duke qenë shpirtërisht i qetë, Ai po drejtohej nga Miku më i Lartë dhe po priste çastin e takimit.

Fjalët e fundit të të Dërguarit të Nderuar në çastet e vdekjes ishin:

*"Kini kujdes namazin, veçanërisht namazin. Kini frikë nga Allahu edhe për ata që i keni nën mbikqyrje."* (Ebu Davud, edeb, 123-124/5156; Ibn Maxhe, Uasaya, 1)



Xhabir bin Abdullah radijallahu anhumat tregon:

Lagjja e bijve të Selimes, që ishin fisi im, banonin shumë larg xhamisë. Ndërsa rreth Xhamisë së Profetit kishte vend bosh. Ne deshëm që t'i shisnim shtëpitë tona dhe të shpërnguleshim pranë xhamisë. Me këtë rast zbriti ky ajet fisnik:

**"Vërtetë Ne i ngjallim të vdekurit, i shkruajmë veprat dhe gjurmët e tyre dhe çdo gjë e kemi regjistruar në Levhi Mahfudh (librin e ruajtur)."** (Jasin, 12)



e Selimes:

*“Me sa kam dëgjuar ju doni të shpërnguleni afër xhamisë, apo jo?”* Ata thanë:

“Po o i Dërguari i Allahut! Me të vërtetë e duam këtë.”

Atëherë Hazreti Pejgamber tha:

*“O bijtë e Selimes! Qëndroni në vendin tuaj, ashtu që kur të vini në xhami, t’ju shkruhet nga një sevap (e mirë) për çdo hap që të hidhni. Po, qëndroni në vendin tuaj, me qëllim që kur të vini në xhami t’ju shkruhet nga një sevap për çdo hap që të hidhni.”* (Muslim, Mesaxhid, 280, 281; Tirmidhi, Tefsiru’l-Kur’an, 36/1)



Abdullah bin Umri Mektum radijallahu anhu tha:

“O i Dërguari i Allahut! Medineja ka shumë insekte helmuese dhe kafshë të egra. (Unë kam frikë nga këto (insekte dhe kafshë) se mos më dëmtojnë. A më lejohet të mos vij në xhemat dhe ta fal namazin në shtëpi?)”

I Dërguari i Allahut (s.a.v.s) tha:

*“A e dëgjon hajja ala’s-salah dhe hajja ala’l-felahin? Atëherë mos u ndal, eja në xhami.”* (Ebu Davud, Salat, 46/553)

Siç u pa, i Dërguari i Allahut alejhissalatu uesselam, ka theksuar frekuentimin në xhemat në çdo lloj situatë, qoftë edhe duke i përdorur të gjitha mundësitë.



I Dërguari i Allahut (s.a.v.s) i ka kritikuar në mënyra të ndryshme ata që nuk marrin pjesë në xhemat. Ubej bin Ka’b tregon:

“I Dërguari i Allahut një ditë na fali namazin e mëngjesit dhe pyeti:

*“A nuk ka ardhur në namaz filan person?”* I thanë:

“Nuk ka ardhur.” I Dërguari pyeti:

*“A nuk ka ardhur filani?”* Përsëri i thanë:



“Nuk ka ardhur.” I Dërguari i Allahut mbi këtë tha:

*“Ja këta dy namaze (jacia dhe sabahu) janë namazet që u vijnë më rëndë hipokritëve. Sikur ta dinit se sa shumë shpërblim dhe sevap ka në këto dy namaze, do të vinit në xhemat qoftë edhe duke u zvarritur. Safi (rreshti) i parë është si safi i ëngjëjve. Sikur ta dinit mirësinë që ka aty, do të shkonit atje duke garuar. Namazi i dikujt bashkë me një tjetër, është më i mirë dhe ka më shumë sevape sesa namazi që ke falur vetëm. Namazi i atij që e ka falur me dy vetë, është më i mirë dhe më i lartë se sa namazi i atij që e ka falur me një person. Sa më shumë që të jetë numri i atyre që falen bashkë, aq shumë i pëlqen edhe Allahut Teala.”* (Ebu Davud, Salat, 47/554; Nesai, Imamet, 45)



Abdullah bin Mes'ud radijallahu anhu ka thënë kështu:

“Për Zotin, unë nuk kam parë ndonjë hipokrit tjetër që të rrijë larg namazit përveç atij që i dihej dyftyrësia. Beto hem në Allahun se një njeri (i sëmurë) sillet në namaz edhe kur lëkundet në këmbë ndërmjet dy burrave dhe vendoset në saf me ndihmën e dyanshme të atyre.” (Muslim, Mesaxhid, 256, 257)



Kur Abdullah bin Omer radijallahu anhu, një ditë po endej në treg, pati ardhur koha e namazit. Pa se myslimanët, sapo dëgjuan ezanin, duke i mbyllur tezgjahet dhe dyqanet e tyre, shkuan në cami. Mbi këtë tha:

Ja, këta janë personat të cilët i ka lavdëruar Allahu:

**“Ata janë njerëz që nuk i pengon as tregëtia dhe as shitblerja për të përmendur Allahun, për të falur namazin dhe për të dhënë zekatin. Ata i frikësohen një dite kur do të tronditen zemrat dhe shikimet.** (en-Nur, 37) (Ibn Kethir, Tefsir, III, 306; Hejsemi, VII, 83)

Shifa bint Abdullah radijallahu anha ka thënë:

Omer bin Hattabi pati ardhur te ne. Kur pa se dy vetë nga pjesëtarët e familjes po flinin, tha:

“Çfarë kanë këta të dy që nuk morën pjesë bashkë me mua në



xhemat? Unë thashë:

“-O prijësi i besimtarëve! Në mbrëmje falën namaz së bashku me të gjithë dhe vazhduan të falin namaz deri në mëngjes (kjo ngjarje ishte në Ramazan). Pastaj falën namazin e sabahut dhe ranë të flejnë. Ndërsa Hazreti Omer tha:

“Të falësh namazin e sabahut me xhemat, është më e dashur për mua se sa të falësh namaz deri në sabah.”<sup>56</sup>



Osman bin Affan radijallahu anhu pati shkuar në namazin e jacisë. Kur pa se kishte pak xhemat, u ul në fund të xhamisë dhe priti që të shtohet xhemati. Në atë moment erdhi Ibn Ebi Amre dhe u ul pranë Hazretit Osman. Osmani radijallahu anhu e pyeti se kush ishte. Ai u prezantua.

E pyeti: “Sa di nga Kur’ani? Pasi u përgjigj edhe kësaj Hazreti Osman tha:

“O biri i vëllaut tim! E kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut kur tha:

*“Ai që e fal namazin e jacisë me xhemat, është si ai që e ka kaluar gjysmën e natës me namaz. Ndërsa ai që e fal namazin e sabahut me xhemat, është sikur të ketë falur namaz gjithë natën.”* (Shik. Muvatta, Salatu'l-Xhemaa, 7; Muslim, Mesaxhid, 260)



Sabit bin Haxhxhaxhi trasmeton këtë ngjarje që reflekton shikimin (mendimin) e ashabëve ndaj atyre që nuk frekuentonin xhematin:

Omer bin Hattab radijallahu anhu kishte ardhur në xhami për namaz. U kthye nga njerëzit, urdhëroi muezinin që të thirrë ezanin, dhe duke u ngritur në këmbë tha:

“Nuk presim askënd për namazin tonë.” Pasi e fali namazin, duke u kthyer nga xhemati tha këto fjalë:

56. Abdurrazzak, el-Musanef, Bejrut 1970, I, 526; Muvatta, Salatu'l-Xhemaa, 7.



“Çfarë kanë disa që qëndrojnë larg xhematit, në këtë mënyrë bëhen shkak që edhe të tjerët të rrinë larg namazit. Për Zotin, më vjen të dërgoj tek ata një njeri që t’i sjellë këtu për t’u tërhequr vërejtje. Merrni pjesë në namaz!” (Abdurrazzak, I, 519)



Ummu’ d-Derda radijallahu anha tregon:

Ebu’ d-Derda radijallahu anhum, erdhi tek unë i zemëruar. E pyeta:

“Çfarë të ka zemëruar?”. Ai më dha këtë përgjigje:

“Për Zotin, për ummetin e Muhammedit (s.a.v.s) nuk di gjë tjetër përveç se falin namaz me xhemat. (Përse këta njerëz sillen neglizhent në çështjen e namazit?)” (Buhari, Ezan, 31)



Abdullah bin Omeri radijallahu anhum, kur i kalonte ndonjë namaz pa e falur me xhemat, përkushtohej me adhurim deri në kohën e namazit tjetër. Madje ky rregull vlente edhe për namazin e jacisë. Domethënë, në një gjendje të tillë bënte adhurim deri në mëngjes. (Ibn Haxher, Isabe, II, 349)



Haris bin Hassan radijallahu anhu, që ishte nga ashabët e nderuar, sapo ishte martuar. Asokohe burri i sapomartuar nuk dilte jashtë disa ditë dhe nuk vinte as në namzin e sabahut, por Harisi erdhi në xhami në mëngjesin e mbrëmjes që ishte martuar. Atij i thanë:

“Këtë natë sapo ke hyrë në dhomën e dhëndërrisë, si mund të dalësh jashtë?” Ai u dha këtë përgjigje:

“-Për Zotin sa zonjë e keqe është ajo që më ndalon që të fal namazin e sabahut me xhemat.” (Hejsemi, II, 41)



Ibn Xhurejxh pyeti Atan rahmetullahi alejh, i cili ishte nga dijetarët e famshëm të tabiinëve:



“A duhet ta ndërpresë namazin dhe të shkojë në xhami dikush që është duke e falur farzin në shtëpi, nëse dëgjon ezanin ose ikame-tin?”

Ai u përgjigj: “Po, nëse shpreson se do ta zë farzin në ndonjë pjesë të tij.”

E pyeti: “Mirë, a duhet të vij në namaz edhe kur të dëgjojë ikame-tin, ashtu sikundër dëgjon ezanin?” Atani edhe këtë herë u përgjigj: “Po.” (Abdurrazzak, I, 514)

Po ashtu, Ibn Omer radijallahu anhu, në shtëpinë e tij pati falur dy rekatë të namazit farz katër rekatësh. Në atë çast dëgjoji ikametin dhe shkoi menjëherë në xhami. (Abdurrazzak, I, 514-515)



Amir bin Abdullah ishte në shtratin e vdekjes. Kur po merrte fry-mën e fundit, të afërmit qanin rreth e rrotull tij. Kur dëgjoji ezanin e namazit të akshamit, u tha atyre që i kishte pranë:

“-Ngremëni! Ata i thanë:

“Për hajër, po për ku?” Ai tha:

“-Për në xhami!”. Ata që ishin pranë, thanë me çudi:

“Në këtë gjendje?”. Por ai, me një vendosmëri të madhe tha:

“Subhanallah, të dëgjoj muezinin dhe të mos i përgjigjem? A është e mundur kjo? Ngremëni!”

Duke u shoqëruar nga të afërmit ai shkoi në xhami dhe pasi fali atje dy rekatë bashkë me imamin, e dorëzoi shpirtin në sexhde.

Sa shfaqje e bukur e hadithit fisnik “*Si të jetoni ashtu do të vdisni*” është dhënia e frymës së fundit në sexhde me mirësinë e Zotit, nga një rob i cili i ka dhënë rëndësi xhematit gjatë tërë jetës.



Ata bin Sabit rahmetullahi alejh tregon kështu:

Dëgjuam se Abdullah Sulemi, i cili ishte nga miqtë e Zotit, që



sëmurë. Thamë të shkojmë dhe ta vizitojmë. Na thanë se gjendej në xhami. Ne e pamë si të papërshtatshme këtë. U çuditëm që ai qëndronte në xhami kur shtratin e kishte në shtëpi. Kur shkua në xhami, me të vërtetë e pamë duke falur namaz. Kur vumë re se merrte frymë me vështirësi, u frikësua dhe u mërzitëm. I thamë:

“O shejh! A nuk do të ishte më rehat për ty sikur të jesh në shtrat?” Ai dha këtë përgjigje:

“-Sipas një hadithi që më ka ardhur, i Dërguari i Allahut (s.a.v.s) ka njoftuar se është më e mirë për robin të falë namaz me xhemat. Unë dua që shpirti të më merret kur të jem duke falur namaz në xhami.”



Hazreti Muhammed bin Semmad ishte një person që adhuronte shumë Zotin. Ai sillej tregohej shumë i ndjeshëm në çështjen e faljes së namazit me xhemat. Ai thoshte:

“Namazet i falja me xhemat. Për dyzet vjet rresht, qoftë edhe një herë të vetme nuk më ka humbur tekberi i iftitahut (i fillimit të namazit), por kur vdiq nëna ime, për shkak se isha i zënë me xhenazen nuk munda ta arrij rekatin e parë të një namazi. Namazin e kësaj kohe e kam falur njëzet e pesë herë me shpresën që të marr sevapin e xhematit. Atë natë në ëndërr mu tha:

-O Muhammed, namazin e fale njëzet e pesë herë, por si do të kompensosh sevapin e të thënit të melekëve “amin”?” (Kandehlevi, Fazaili'l-A'mal, fq. 275)

Sepse i Dërguari i Allahut (s.a.v.s) ka thënë kështu

*“Kur imami të ketë mbaruar fatihanë, xhemati duhet të thotë Amin! sepse, nëse kjo fjalë e xhematit thuhet në të njëjtën kohë kur thonë Amin! Banorët e qiellit, robët e falen të gjitha mëkatet e vogla të kaluara.”* (Buhari, Ezan, 113; Muslim, Salat, 76)

Sipas transmetimit, Allahu në ditën e kiametit do të pyesë:

“-Ku janë komshinjtë e mi?”

Ëngjëjt do të thonë:



“-Kush mund të bëhet komshiu yt, o Zoti ynë?!”

Allahu Teala do të thotë:

“-Ata që zbukurojnë xhamitë e mia (d.m.th. ata që falin namaz me xhemat).” (Ali el-Muttaki, VII, 578/20339)

I Dërguari i Allahut (s.a.v.s) thotë:

*“Xhamia është shtëpia e çdo të devotshmi. Atij që shtëpinë e ka xhami, Allahu Teala i ka premtuar kalimin e urës së siratit me lehtësi dhe mëshirë, hyrjen në xhennet dhe arritjen e kënaqësisë së Tij.”<sup>57</sup>*



Ashëk Pashazade i cili ishte një nga historianët e parë Osmanë, thotë:

“Osmanët ishin një soj besnik. Ata nuk kanë bërë asnjë vepër jo të ligjshme. Ata largoheshin shumë nga ato punë dhe sjellje që dijetarët i quanin haram.”

Kështu, për shkak të sjelljeve të tyre në këtë në këtë mënyrë, Shejhulislam Molla Fenari tregoi guxim për të mos e pranuar dëshminë e Jëldërëm Bajezidit, për shkak se ai nuk frekuentonte në xhemat. Edhe vetë Sulltanit, i cili e pyeti për arsyen, i dha këtë përgjigje:

“O Sulltani im! Juve nuk ju shikoj në xhemat. Ndërsa ju duhet të gjendeni në safin e parë, si udhëzues i këtij populli. Domethënë duhet të bëni vepra të mira... Nëqoftëse nuk merrni pjesë në xhemat, do të bëheni shembull i keq për popullin, gjë e cila është ndalim për pranimin e dëshmisë suaj...”

Mbi këtë ngjarje, sipas edhe një transmetimi tjetër, Jëlldërëm Bajezidi ndërtoi xhaminë e famshme Ullu në Bursa si falenderim ndaj Nigbollu Zaferit dhe i vazhdoi pesë kohët e namazit me xhemat.



Përfundimisht, të frekuentosh në xhemat është një shfaqje e sin-

57. Taberani, el-Mu'xhemu'l-Kebir, verif. Hamdi Abdulmexhid es-Selefi; Beyrut, Daru Ihjai't-Turasi'l-Arabi, VI, 254/6143; Ali el-Muttaki, VII, 580/20349.



qeritetit në besim. Po ashtu, Pejgamberi i Nderuari (s.a.v.s) ka thënë:

*“Nëse shikoni një njeri që frekuenton xhaminë, dëshmoni se ai është një njeri besimtar.”* Dhe pastaj lexoi ajetin fisnik:

**“Xhamitë e Allahut i ngjallin vetëm ata të cilët i kanë besuar Allahut, ditës së gjykimit, e falin namazin, e japin zekatin dhe të cilët nuk i frikësohen askujt përveç Allahut. Të tillët do të jenë të udhëzuar (në rrugën e drejtë).”** (et-Teube, 18) (Tirmidhi, Iman, 8/2617)

Miqtë e Zotit i kanë radhitur kësisoji dobitë që përfitohen nga frekuentimi në xhemat në pesë kohët e ditës:

-Falja e namazit në kohën më të pranuar, domethënë falja e namazit në kohën e parë të tij.

-Meritimi i lutjes, kërkit të faljes dhe dëshmimit të engjëjve.

-Largimi nga djalli.

-Fitimi i shpërblimit të madh duke arritur tekbirin e iftitahut.

-Pastrimi nga vesi i hipokrizisë në vepra.

-Përfitimi nga begatia e lutjeve dhe e dhikrit që bëhet së bashku.

-Përforcimin e vazhdimësisë së miqësisë ndërmjet myslimanëve.

-Ndihma e ndërsjellë në çështjen e bindjes dhe të adhurimit.

-Përshtatja dhe mësimi i rregullave të leximit të Kur'anit në namazet që falen me zë.

-Falja e namazit në një mënyrë të përsosur dhe të qetë.

Siç u pa, falja e namazit me xhemat ka shumë dobi. Ja, për këtë shkak Allahu Teala dhe i Dashuri i Tij i Nderuar i kanë urdhëruar me këmbëngulje besimtarët që të frekuentojnë xhaminë dhe xhematin.

### **c. Adhurimi i natës**

Të jesh bashkë me Allahun në një pjesë të natës, për robin është një burim lumturie i papërshekrueshëm. Për shkak se edhe Zoti ynë





kënaqet dhe gëzohet me këtë, është pretekst i një mëshire, faljeje dhe mirësie të veçantë. Në ajetin fisnik thuhet:

**“(Ata të devotshmit) i lënë shtratet e tyre (për të falur namaz dhe për të kërkuar falje). E lusin Zotin e tyre me frikë dhe me shpresë. Ata japin nga ajo që ne u kemi dhënë.”** (es-Sexhde, 16)

Zemra e njeriut lartësohet në lidhje me shkallën e të fshehtave, urtësive dhe begative që Zoti ynë ia ka dhënë natës. Ndodhja e mirësive hyjnore në një pjesë të natës si miraxhi, zbritja e shpalljes dhe shfaqja e hakmarrjes hyjnore si e kundërta e këtyre, tregon më shumë se sa e nevojshme është të shfaqim një përkujdesje të veçantë ndaj kohës të namazeve të ditës.

Netët janë një pasuri e veçantë, për arsye të qetësisë dhe begatisë në zemrën e besimtarëve që vendosin t’i afrohen Allahut. Po ashtu, në hadithin fisnik thuhet:

*“Ka një kohë gjatë natës, në të cilën një mysliman mund t’i lutet Allahut për mirësi në lidhje me këtë botë apo me ahiretin, dhe Allahu ia jep patjetër atij atë që kërkon. Kjo kohë (orë) është çdo natë.”* (Muslim, Musafirin, 166)

Haxhe Ali Ramiteni kuddise sirruh, thotë kështu:

“Kur të bashkohen tre zemra, realizohet dëshira e robit besimtar. Zemra e sinqertë e besimtarit, sureja Jasin që është zemra e Kur’anit dhe kohët e agimit që janë zemra e natës.”<sup>58</sup> Ata që me të vërtetë e dinë vlerën e këtyre shanseve, gjejnë vendin më të begatë për t’u lutur, për të bërë adhurim dhe për t’iu drejtuar Zotit të tyre në një kohë kur të gjitha krijesat bien në rehati dhe e gjithë bota bie në një qetësi të thellë. Duke i lavdëruar këta robër fatmirë, Allahu thotë kështu:

**“Ata flinin pak natën dhe në kohën e agimit kërkonin falje.”** (edh-Dharijat, 17-18)

Vetëm e vetëm për shkak të dashurisë, netët janë koha e flijimit në praninë hyjnore duke i lënë krevatet e ëmbël dhe të butë për hir të kënaqësisë së Allahut Teala. Për këtë arsye, namazet që falen, Kur’ani

58. Muhammed Parsa, Muhammed Bahaeddin Hazretleri’nin Sohbetleri, përkth. Nexhdet Tosun, Stamboll 1998, fq. 60.



që lexohet dhe tespitë që bëhen në klimën e qetë të natës, kanë një rëndësi shumë të madhe në lidhje me afrimin ndaj Allahut. Adhurimet që bëhen natën, pothuajse janë si takimi me të Dashurin e Lartë dhe bisedimi me Të. Të jesh i zgjuar kur të gjithë flejnë, do të thotë të hysh në klimën e mëshirës dhe marrjes pjesë ndërmjet robërve të veçantë, që janë brenda kuvendit dhe mëshirës së Mevla'l-Muteal.

Dëshira që shfaqet ndaj adhurimeve të natës, është e lidhur me forcën e dashurisë hyjnore që ndodhet në zemra. Po ashtu, disa njerëz të devotshëm që shijonin kënaqësinë dhe begatinë e adhurimit të natës, thonin: “Unë nuk kisha frikë nga vdekja, por ajo hyn ndërmjet meje dhe namazit të natës.”

Me të vërtetë, si mund të mendohet se dikush që pohon se e do Zotin e tij të flejë deri në mëngjes me indiferencë? Për këtë arsye, ngjallja e kohëve të agimit është shfaqja e dashurisë dhe e madhështisë që ndjen robi ndaj Zotit të tij. Ndërsa nata që kalohet me indiferencë ose me gjumë, duhet të llogaritet si një humbje e pafrytshme dhe që është e vështirë që të kompensohet si shiu që bie në gurë, dete dhe shkretëtira.

Kështu, i Dërguari i Allahut (s.a.v.s) i dha këtë këshillë Abdullah bin Amr bin As:

*“-O Abdullah! Mos u bëj si filan njeri, sepse ai vazhdonte adhurimin e natës ndërsa tashmë nuk ngrihet fare.”* (Buhari, Tehexhxhud, 19)

Domethënë, të qëndruarit larg namazit të tehexhxhudit është shkak për një humbje të madhe.

Marrja e riskut nga nata fillon me istigfarin (kërkimin e faljes) dhe vazhdon me teuhidin (njësimin), me salavatet fisnike dhe me ndjesinë e dhikrit. Dhikri i agimit, që domethënë takimi i robit me Zotin e tij nga aspekti i ngjalljes së zemrës, është një shans që nuk gjendet dhe një nevojë që nuk mund të neglizhohet, sepse siç ka nevojë trupi ynë për ushqim material, ashtu edhe shpirti ynë ka nevojë për ushqim shpirtëror. Dhikrit që bëhet në agim, Zoti i jep më shumë vlerë se sa dhikrit që bëhet në kohëra të tjera. Në ajetin fisnik thuhet:

**“Bëj sexhde në një pjesë të natës, pastaj madhëroje Atë edhe**



**në një pjesë të gjatë të natës. Këta e duan shumë këtë jetë dhe e neglizhojnë ditën e vështirë që e kanë përpara.”** (el-Insan, 26-27)

Amr bin Abese radijallahu anhu tregon:

E pyeta të dërguarin e Allahut: “O i Dërguari i Allahut! A ekziston ndonjë kohë që ka më shumë mirësi së sa kohët e tjera, sa i takon afrimit tek Allahu?”

*(I Dërguari i Allahut tha: “Po, koha kur Allahu është më afër robit është mesi i pjesës së fundit të natës. Nëse ke mundësi që t’i bëshë dhikër Allahut në atë kohë, bëji! Sepse namazi në atë orë është i njohur (ëngjëjt janë të pranishëm në atë kohë).”* (Nesai, Mevakitu’s-Salat, 35)

Përfundimisht, nëse besimtari e shfrytëzon natën nën orientimin e këshillave të Allahut dhe të të Dërguarit të Tij dhe përfiton nga ndjesia e dhikrit, nata e tij bëhet më e ndritshme se sa dita e tij. Në lidhje me këtë, Hazreti Bajezid Bistami ka thënë:

“Asnjë e fshehtë nuk më është shfaqur derisa netët e mia u bënë ditë.

Ndjesia e agimit reflekton në të gjithë ditën për ata që e ngjallin përnjëmend atë kohë të mbushur me mirësi të mëdha, duke ditur vlerën e netëve. Nisur nga kjo, është e nevojshme të largohemi nga mëkati edhe ditën, duke e shpërndarë modelin e agimit në të gjithë ditën tonë, në mënyrë që të përfitojmë me të vërtetë nga klima e netëve të mbushura plot me begati dhe ndjenjë shpirtërore.

### ***Tabllo të virtytshme***

Zoti e urdhëroi kështu të Dashurin e tij që të përfitonte nga klima e begatë e netëve:

**“Zgjohu në një pjesë të natës, lexo Kur’an dhe fal namaz nate. Sigurisht që Zoti yt do të të ngrejë ty në një vend të lavdishëm.”** (el-Isra, 79)

Pas këtij urdhëri hyjnor, i Dërguari i Allahut sallahu alejhi ue sellem, në çastet me begati dhe mirësi të netëve, nuk e ka lënë fare faljen e namazit, kërkimin e faljes, leximin e Kur’anit dhe lutjen. Madje as në



kohën kur u sëmur aq sa nuk kishte fuqi të ngrihej në këmbë, nuk e ka lënë pa falur namazin e tehexhudit dhe i ka ngjallur agimet, paçka se mund të ishte i detyruar të qëndronte i ulur. (Ebu Davud, Tatavvu', 18/1307)

Gjatë gjithë jetës së tij, i Dërguari i Nderuar e ka falur namazin e tehexhudit trembëdhjetë rekatë bashkë me vitrin, ndërsa në vitet e fundit të jetës e ka falur njëmbëdhjetë rekatë. Ndërsa gjatë periudhës kur ishte i sëmurë, afër kohës së vdekjes, e ka falur nëntë rekatë dhe asnjëherë nuk e ka lënë. (Ebu Davud, Tatavvu', 26/1363)



Nëna jonë, Hazreti Aishe tregon:

I Dërguari i Allahut (s.a.v.s), as në ramazan e as ndonjëherë herë tjetër, natën nuk falte më shumë se njëmbëdhjetë rekatë. Së pari falte katër rekatë, bukuria dhe gjatësia e të cilave nuk shpjegohet. Pastaj falte edhe katër rekatë. Edhe për bukurinë dhe gjatësinë e tyre nuk bëhet fjalë. Pastaj falte edhe tre rekatë. Një herë e pyeta:

“O i Dërguari i Allahut! A po flini pa falur vitrin?” Ai më tha:

“*O Aishe! Sytë më flëjnë por zemra jo.*” (Buhari, Tehexhjud 16, Teraviih 1; Muslim, Musafirin 125)

Ky hadith fisnik tregon se zemra e Pejgamberit ishte e lidhur me Zotin jo vetëm gjatë adhurimeve, por gjithmonë.



Një herë, Huzejfe radijallahu anhu, filloi të falet pas të Nderuarit tonë i cili po falte namaz. Gjendjen e Tij gjatë adhurimit e tregon kështu:

“Një natë po falja namaz bashkë me të Dërguarin e Allahut. Ai filloi të lexojë suren Bakara. Thashë me vete: Kur të arrijë te ajeti i njëqind do të ndalojë. Pasi arriti te ajeti i njëqind, ai filloi të lexojë përsëri. Mendova: ndoshta me këtë sure do të falë dy rekatë. Por ai vazhdoi të lexojë. Mendova: kur të mbarojë suren do të bierë në ruku, por përsëri nuk mbaroi, filloi të lexojë suren Nisa. Kur e mbaroi, kaloi në suren



Ali Imran.<sup>59</sup> Lexonte dalëngadalë. Kur kalonin ajetet e tespive thoshte subhanallah, kur kalonte ajeti i lutjes, bënte lutje, kur kalonte ajeti i istiadhes (eudhu billahi minesh-shejtanirr-rрахhim) kërkonte mbrojtje nga Allahu. Pastaj ra në ruku, filloi të thoshte Subhane Rabbije'l-Adhim. Edhe rukunë e zgjati sa qëndrimi në këmbë. Pastaj, duke thënë Semiallahu li-men hamideh. Rabbena leke'l-hamd u drejtua (u ngrit nga rukuja). Në këmbë qëndroi afërsisht sa qëndroi në ruku. Pastaj ra në sexhde. Në sexhde thoshte Subhane Rabbije'l-A'la. Edhe sexhdeja zgjati afërsisht sa qëndrimi në këmbë.” (Muslim, Musafirin, 203)



Nëna jonë Hazreti Aishe thotë:

“Një natë e kuptova se i Dërguari i Allahut (s.a.v.s) nuk ishte pranë meje. Mendova se ka shkuar te ndonjëra nga gratë e tjera (të tij). Fillova ta kërktoj. Pastaj u ktheva dhe erdha. Pashë se Ai në ruku ose në sexhde thoshte:

سُبْحَانَكَ وَبِحَمْدِكَ لَا إِلَهَ إِلَّا أَنْتَ

(O Allahu im) Ty të lartësoj dhe të falenderoj. (O Zoti im) Nuk ka Zot tjetër përveç Teje. Mbi këtë (duke duke më ardhur pak zor nga vetja ime) i thashë kështu:

-Nëna dhe babai im të qofshin falë, o i Dërguari i Allahut! Për çfarë shqetësohem unë, e për çfarë ju!..” (Muslim, Salat, 221)

I Dërguari i Allahut (s.a.v.s), ka kërkuar nga i gjithë ummeti faljen e namazit të tëhexhjudit, i cili është një nga mënyrat më të rëndësishme të zhvillimit të ndjenjës shpirtërore. Së pari, këto këshillime i filloi me të afërmit e tij, ndaj një natë duke trokitur derën e Hazretit Ali dhe Fatma, u tha:

59. Sipas këtij hadithi fisnik, i Nderuari ynë alejhissalatu uesselam, pas sures Bakara ka lexuar suren Nisa dhe pastaj suren Ali Imran. Leximi me këtë rradhitje nuk i përshatet rradhitjes në mënyrën që janë bakara, Ali Imran dhe Nisa. Këtë urtësi, shpjeguesit e haditheve e kanë sqaruar në dy mënyra. E para, radhitja e sureve akoma nuk e kishte marrë formën e fundit. Ndërsa e dyta, për të treguar se është e lejuar që të lexosh edhe në këtë mënyrë.



“-A nuk do të falni namaz?”<sup>60</sup> dhe i këshilloi me këmbëngulje që të përfitojnë nga begatia shpirtërore e natës.

Po ashtu edhe disa ashabëve të tij, duke u thënë:

“*Ju lutem mundohuni të ngriheni natën! Sepse ky ishte zakoni dhe shkaku për t’u afruar te Allahu i njerëzve të devotshëm që ishin para jush. (Ky adhurim) të ndalon nga mëkatet, është shfajësim për mëkatet dhe largon sëmundjet nga trupi.*” (Tirmidhi, Deavat, 101/3549), ai i thirte ata që të jenë të zgjuar në agim.



Xhabir bin Abdullah radijallahu anhu tregon:

I Dërguari i Allahut (s.a.v.s) ka thënë:

“Nëna i tha Sulejmanit alejhisselam, i cili ishte i biri i Hazretit Davud:

-O biri im! Mos fli shumë natën, sepse gjumi i tepërt natën e lë njeriun të varfër në ditën e gjykimit.” (Ibn Maxha, Ikametu’s-Salah, 174)



Kjo ngjarje që tregon Ibn Omeri radijallahu anhuma, nxjerr në pah se tehexhkhudi e largon njeriun nga ndëshkimi i xhehennemit:

“Çdonjëri që shikonte ëndërr në kohën kur i Dërguari i Allahut ishte gjallë, ia tregonte Atij. Edhe unë doja të shikoja një ëndërr dhe t’ia tregoja atë Pejgamberit. Atë kohë isha djalë beqar dhe flija në xhami.

Një herë pashë në ëndërr dy melekë që më dërguan mua në xhehennem. Pashë se ai ishte i thurur si mur pusi dhe kishte dy shtylla si të pusit. U habita. Atje kishte disa njerëz që i njihja. Unë thërrita:

-I kërkoj Allahut mbrojtje nga xhehennemi! I kërkoj Allahut mbrojtje nga xhehennemi! Në atë çast më erdhi një ëngjëll tjetër, i cili më tha:

-Mos ki frikë, ty nuk do të të ndodhë asgjë!



Këtë ëndërr ia tregova motrës së madhe Hafsës. Ajo ia tregoi të Dërguarit të Allahut. Në lidhje me këtë ëndërr, i Dërguari i Allahut kishte thënë:

*“Sa njeri i bukur dhe i mirë është Abdullahu! Sikur të falte namaz edhe natën!...”*

Abdullahu radijallahu anhu, që nga ajo ditë një pjesë të madhe të natës e kalonte me adhurim dhe flinte shumë pak. (Buhari, Ashabu'n-Nebi, 19)



I Dërguari i Allahut (s.a.v.s), në një hadith kudsij që e transmeton nga Zoti i tij, duke i lavdëruar besimtarët që japin lëmoshë fshehtas, që ngrihen për namazin e tehexhjudit dhe që mundohen me sinqeritet në rrugën e Allahut, thotë kështu:

*“Ka tre persona që Allahu i do. Po ashtu ka edhe tre persona që Allahu i urren. Ata të tre që Allahu i do janë:*

*Një njeri vjen në xhemat, jo për shkak se ka ndonjë afërsi gjaku me ta, por sepse në emër të Allahut kërkon nga ata diçka. Ata nuk ia japin atë që do. Dikush nga ky xhemat, shkon mbrapa xhematit pa rënë në sy të askujt dhe e ndihmon atë që kërkon ndihmë. (Ia jep aq fshehtas saqë) atë që e ka dhënë e di vetëm Allahu dhe ai të cilin e ndihmoi.*

*(Ndërsa i dyti.) Një xhemat është në rrugë. Ecin gjatë gjithë natës. Ata lodhen dhe gjumi bëhet më i vlefshëm se çdo gjë. Ata buajnë në një vend. (Të gjithë flenë.) Njëri prej tyre ngrihet, më përgjërohet me modesti dhe lexon ajetet e mia.*

*(Ndërsa i treti është ky:) Një njeri ka marrë pjesë në luftë. Të gjithë luftojnë me armikun dhe humbin, kurse ai përparon dhe vazhdon të luftojë derisa të vdesë ose të fitojë.*

*Ndërsa tre personat që Allahu i urren janë: I moshuari që bën zina, i varfëri mendjemadh dhe i pasuri tiran.”* (Tirmidhi, Xhennet, 25/2568; Nesai, Zekat, 75)



Sipas transmetimit të Hazretit Ali radijallahu anhu, i Dërguari i Allahut (s.a.v.s) ka thënë:

*“Në xhennet ka disa shtëpi të mrekullueshme. Pjesa e jashtme e tyre dallohet edhe nga mbrenda dhe pjesa e mbrendshme e tyre dallohet edhe nga jashtë.”* Një bedevi (banor i shkretëtirës arabe) u ngrit në këmbë dhe tha:

“O i Dërguari i Allahut, për kë janë këto shtëpi të mrekullueshme?” Krenaria e Gjithësisë i Nderuari ynë, tha:

*“Ato janë për ata që flasin mirë dhe bukur, për ata që janë gojëëmbël, për ata që ushqejnë të tjerët, për ata që mbajnë agjërim dhe për ata që falin namaz natën për Allahun, kur të gjithë flejnë!”* (Tirmidhi, Birr, 53/1984)



Profesori ynë i nderuar Musa Efendi rahmetullahi alejh, e tregon kështu një çast nga netët e ngjallura me njësimin e Allahut dhe me moralin e lartë në rrugën e adhurimit, që kishte Hazreti Mahmud Sami Ramazanoglu, Sulltani i Dijetarëve, i cili ishte udhëzues i virtytshëm:

“Edhe pse fytyra e lartë dhe e bekuar e Hazretit Mahmud Sami Ramazanoglu ishte i qeshur, zemra e tij e lartë qante. Ai qante që ummeti mysliman të shpëtonte nga dora e tiranëve. Qante për shpëtimin dhe faljen e mëkatarëve dhe lotët i derdhte përbrenda. Kur lexohej Kur’ani Kerim, ai dëgjonte me përlujtje dhe nënshtrim, aq sa nganjëherë lotët i kullonin duke i rrjedhur nëpër faqe. Veçanërisht gjatë kohës së haxhit. Shokët e tij, teksa ishin shtrirë për të fjetur në mjetin e transportit, e shihnin nën dritën e hënës se si i rridhnin lotët nga sytë si perla. Kjo panoramë hyjnore dhe e papërshkrueshme, ishte aq e bukur sa që edhe poetët e letrarët e kishin shumë të vështirë ta për-kufizonin.”



Dëshira e zjarrtë që kishte ndaj adhurimeve të natës i ndjeri babai ynë Hazreti Musa Efendi, ishte shfaqja e papërshkrueshme e pasionit dhe e mallit të çastit të bashkimit mes të dashuruarit dhe të dashurit.





Ai e mbante këtë gjendje edhe në ditët kur ishte i sëmurë fizikisht, dhe kështu jetonte gjithmonë në kulmin e horizontit të dashurisë hyjnore. Kështu, pa u zgjuar akoma nga narkoza pas operacionit të syrit, pyetja e parë që u bëri atyre që i kishte pranë ishte:

“Sa është ora?”

Kur i thanë: “O i nderuari ynë! Ora po vjen tre!”:

Dhe duke thënë “Adhurimi i natës është shumë i rëndësishëm e nuk ka mundësi të lihet pas dore!”, me ndihmën e atyre që kishte pranë mori menjëherë tejemmum, fali dy rekat namaz nate me një dëshirë dhe mall hyjnor të papërshekrueshëm, duke ia përkushtuar zemrën Zotit. Kësisoj ai e harroi gjendjen u vuajtshme që kishte dhe bëri dhikrin e tespihatit e zakonshëm. Me këtë gjendje të tij, ai duket sikur dëshironte të na tregonte neve të fshehtë të ajetit fisnik:

**“Ata largohen nga shtrati duke iu lutur Zotit të tyre nga frika dhe shpresa dhe japin (lëmoshë) nga ajo që iu kemi dhënë.”** (es-Sexhde, 16)



Kur dikush i tha Hazretit Ibrahim bin Ed'hemit:

“Unë nuk ngrihem në adhurimin e natës, më trego një zgjidhje”.  
Ai mori këtë përgjigje:

“Mos bëj mëkat ndaj Allahut ditën që Ai të të ngrejë natën ty. Të jesh në prani të Allahut natën, është nderi më i lartë. Mëkatarët nuk e meritojnë këtë nder!”



Adhurimi i natës është një nga ndikuesit më të rëndësishëm në përforcimin e shëndetit shpirtëror dhe fizik.<sup>61</sup> Largon sëmundjet e dhuron forcë, aftësi dhe madhështi materiale e shpirtërore. Sa mësimdhënëse janë këto ngjarje në lidhje me këtë çështje:

Në luftën e Jermukut, kur të dy ushtritë u afruan pranë njëra tjet-

61. Shik. Tirmidhi, Deavat, 101/3549.



rës, komandanti bizantinëve i pati dhënë detyrë një spiuni arab që të analizonte gjendjen e ushtarëve të Islamit. Pasi spiuni i mori të dhënat e duhura, komandanti e pyeti:

“Si është gjendja e myslimanëve? Çfarë bëjnë? Spiuni i tregoi kështu ato që kishte parë:

بِاللَّيْلِ رُهْبَانٌ وَبِالنَّهَارِ فُرْسَانٌ

“-Ata natën bëjnë shumë adhurim dhe ditën janë një popull kaloresish luftëtarë!..” Komandanti tha:

“-Nëse ti thua të vërtetën, është më mirë të hyjmë nën dhé se sa të përballemi me ta...”<sup>62</sup>



Ja edhe një ngjarje tjetër e ngjashme me këtë:

Në luftë asnjë armik nuk mund të fitonte mbi shokët e të të Dërguarit të Allahut. Në të njëjtën mënyrë edhe prijësi i bizantinëve, Herakliu, që humbi me myslimanët, i pyeti ushtarët e tij me kërcënim:

“-Tju vijë turp! Çfarë njerëzish janë ky popull që po i luftoni? A nuk janë njerëz si ju? Ata thanë:

“-Po.” Kur ai pyeti:

“-Mirë, po a ju jeni më shumë, apo ata?” Ata thanë:

“-O i nderuari ynë, ne në çdo çështje jemi më shumë se ata.” Ndërsa kur Herakliu tha:

“-Atëherë çfarë keni që humbni sa herë që përballeni me ta?”. Një dijetar i moshur, një nga dijetarët më të mëdhenjtë të bizantinëve, duke u ngritur në këmbë, vuri në dukje:

“-Sepse ata i kalojnë netët duke bërë adhurim, gjatë ditës agjërojnë, mbajnë premtimet e tyre, urdhërojnë për të mirë, i shmangen së keqes dhe gjithçka e ndajnë midis tyre...”



Kur dëgjoi këtë përgjigje, Herakliu tha:

“-Ti me të vërtetë the të drejtën.”<sup>63</sup>



Së fundi, netët janë kohë të veçanta ku mendja dhe zemra janë të pastra, konceptimi është i ndjeshëm dhe të shprehurit është i prerë, kujtesa është e fortë, gjëra që përbëjnë mënyrën më të shpejtë dhe të lehtë për të përparuar në rrugët materiale dhe shpirtërore. Netët janë një shans shumë i mirë për ata të cilët i presin punë të mëdha dhe duan të përgatiten ditën. Për të devotshmit, që mundohen për të mirën e popullit dhe të cilët janë flijues dhe të ndërgjegjshëm, janë kohë për ndërtimin e personalitetit. Ndërsa të fshehtat e vërteta të panoramës hyjnore të natës plot qetësi, janë vetëm të besimtarëve të devotshëm që i ngjallin netët duke u thelluar në adhurime dhe mendime ndaj Zotit. Bota shpirtërore e robërve që zotërojnë këto të fshehta dhe urtësi, duke u zgjeruar me natyrë të lartë sa qiejt dhe toka, jehon ndaj shfaqjeve hyjnore dhe shëndërrohet në veshje të njësimi të Zotit.

**O Zot! Na mbro që në këtë jetë të shkurtër të mos i kalojmë netët me neglizhencë, na mbro nga shpërdorimi dhe humbja! Na jep nga të fshehtat e natës! Na i begato zemrat tona me mirësinë e netëve të ngjallura! Të paktën një natë na dërgo në mëngjesin e ahiretit si i dashuruar i sinqertë që ka arritur kënaqësinë Tënde nga kjo botë që është nën sundimin tënd dhe na i kënaq shpirtërat tanë me kënaqësinë e takimit me Ty!**

Amin!..

## **ç. Lutja dhe përgjërimi**

Lutja dhe përgjërimi është të kërkuarit e robit mirësi dhe ndihmë nga Allahu mbrenda ndjenjës së dashurisë dhe madhërimit, duke e shprehur paaftësinë e tij përballë madhështisë së Allahut. Përgjërimi, domethënë nënshtrimi në lutje, është shumë i rëndësishëm fetarisht,

63. Ibn Asakir, Tarihu Dimashk, pa dt., II, 97.



për shkak se përbën pohimin e paaftësisë dhe një shenjë të kërkimit të mbrojtjes vetëm nga Allahu.

Përgjërimit e tij ndaj Allahut, robi duhet ta bëjë me një sinqeritet të madh dhe jo vetëm me zemër. Lutjet e duhet t'i bëjë në një gjendje mes "havf dhe rexha", domethënë mes "frikës dhe shpresës". Lutja duhet të vijë nga zemra, ndërsa zemra duhet të dridhet me dëshirat e kuptimit që ka lutja. Nëse në të njëjtën kohë lutja është në drejtimin e faljes së mëkatit, duhet të bëhet me një vendosmëri dhe këmbëngulje të prerë se nuk do ta bëjë më atë mëkat. Hazreti Mevlana thotë:

*"Bëj lutje dhe pendohu me një zemër të mbushur me nënshtrim dhe me sy të lagur, sepse lulet çelin në një vend me diell dhe të lagur!"*

Besimtari duhet të jetë gjithmonë në gjendje përgjërimit ndaj Zotit të tij, si një nevojë e adhurimit. Edhe edukimi i vërtetë fetar synon që lutja të qëndrojë vazhdimisht në shpirtin e besimtarit, sepse lutja është çelësi i derës më të lartë që hapet në zemër ndaj Allahut. Në ajetin fisnik thuhet kështu:

**"Kur të të Pyesin robërit e mi për Mua, (le ta dinë se) Unë jam shumë afër tyre. Unë i pranoj lutjet e atyre që më luten..."**  
(el-Bakara, 186)

Kur lutja përsëritet në formë ndjenjash të thella, gdhendet në shpirtin e besimtarit, e ndikon personalitetin e tij dhe bëhet një gjendje e veçantë e tij. Për këtë shkak, shpirtërat e mëdhenj dhe të lartë jetojnë gjithmonë në gjendje lutjeje.

Lutja është nështrimi ynë me qetësi dhe dorëzim në prani të Allahut duke ia shfaqur Atij paaftësinë tonë në një mënyrë ndijuese ndaj Zotit fuqiplotë. Me të vërtetë, ta fillosh lutjen duke treguar paaftësinë dhe gabimet, duke kërkuar mëshirën hyjnore, ka një ndikim të madh në pranimin e lutjes.

Ai që na e mëson lutjen në mënyrën më të bukur, pra duke e jetuar, është i Nderuari ynë, Hazreti Pejgamber (s.a.v.s). Ai gjithmonë i lutej Allahut me ndjenjat e paaftësisë si shtesë ndaj namazeve që pati falur me lot, derisa i enjtëshin këmbët. Ai i donte shumë lutjet e sin-



qerta dhe kurrë nuk bënte lutje që nuk ishin të sinqerta.<sup>64</sup> Pejgamberi këshillonte:

*“Koha kur robi është më afër Zotit të tij, është koha e sexhdes. Për këtë arsye bëni shumë lutje në sexhde!”* (Muslim, Salat, 215)

Krahas lutjes së tij, besimtari duhet të përpiqet të marrë edhe lutjen e të varfërve, të dobtëve dhe të nevojtarëve, sepse Pejgamberi (s.a.v.s) ka thënë:

*“Nuk ka asnjë lutje që të pranohet më shpejt se sa lutja që një besimtar bën për një besimtar tjetër, në kohën kur ai nuk është i pranishëm.”* (Tirmidhi, Birr, 50/1980)

Edhe Hazreti Mevlana thotë:

“Jepe pasurinë dhe pronën tënde në një mënyrë të bukur dhe merr një zemër, ashtu që lutja e asaj zemre të të ndriçojë dhe të të japë dritë ty në varr dhe në atë natë shumë të zezë!..”

### ***Tabllo të virtytshme***

Një ditë, i Dërguari i Allahut (s.a.v.s) tha:

*“Nëse në tokë një mysliman kërkon diçka nga Allahu, nëse nuk është ndonjë gjë që është mëkat, ose derisa të mos dëshirojë të presë lidhjen me të afërmit, Allahu Teala patjetër ia plotëson dëshirën atij ose e largon nga e keqja aq sa do t'i jepte.”*

Kur njëri nga sahabet e nderuar tha:

“Atëherë ne do të kërkojmë shumë gjëra nga Allahu!”, i Dërguari i Nderuar tha:

*“-Mirësia e Allahut është më e madhe se sa gjërat që ju kërkonit.”* (Tirmidhi, Deavat, 115/3573; Ahmed, III, 18)

Allahu nuk i refuzon lutjet e sinqerta, por nuk i pranon disa kërkesa që nuk përputhen me kaderin absolut, paçka se mund të jenë të

64. Ebu Davud, Vitir, 23/1482.



sinqerta, por robi asnjëherë nuk duhet të mërzitet dhe duhet të bëjë lutje, ngaqë shpërblimi i lutjes në këto gjendje do të thotë se është lënë për botën tjetër, sepse Allahu thotë:

“...Më luteni Mua ashtu që t’jua pranoj lutjet tuaja...” (el-Muminun, 60)



Krenaria e Gjithësisë i Nderuari ynë thotë:

“*Lutja e robit pranohet përderisa ai të mos kërkojë ndonjë gjë që është mëkat, ose ndonjë gjë që i hap rrugë për t’u zemëruar me të afërmin e tij ose përderisa të mos nxitojë.*” E pyetën:

“O i Dërguari i Allahut! Çdo të thotë të nxitosh?”

I Dërguari i Allahut (s.a.v.s) u përgjigj:

“*Robi thotë; Shumë herë u luta, por Zoti nuk ma pranon lutjen. Ai mërzitet që lutja e tij nuk i pranohet menjëherë dhe e le lutjen. (Ja atëherë ka nxituar.)*” (Muslim, Dhikir, 92)

Kështu, Zekerijja alejhisselam, vazhdoi të thoshte “...**O Zoti im! Mos më lër vetëm!..**”, me qëllim për të forcuar fenë, ndërsa djalin që e deshi, Jahjanë alejhisselam, ia dha vetëm pas dyzet viteve.<sup>65</sup>



Njëherë, pas namazit, i Dërguari i Allahut (s.a.v.s) vuri re një njeri që po lutej pa thënë salatin dhe selamin. Në lidhje me këtë, tha:

“*Ky njeri u nxitua.*” Pastaj e thirri atë dhe e porositi të gjithë ummetin.

“*Kur dikush prej jush do të lutet, së pari të falenderojë Allahun, pastaj të dërgojë selam mbi mua, pastaj të lutet si të dojë.*” (Tirmidhi, Deavat, 64/3477)



Krenaria e Gjithësisë, i Nderuari ynë rekomandonte që një besim-



tar të lutej për vëllain e tij në fe, qoftë kur ai të jetë i pranishëm, qoftë edhe kur ai nuk është i pranishëm. Hazretit Omer, i cili kërkoi leje për umre, i tha:

*“O vëlla, bëj lutje edhe për ne, mos na harro.”* (Tirmidhi, Deavat, 109/3562)

Hazreti Omer radijallahu anhu gjendjen e tij përballë kësaj kërkese frytdhënëse e shpreh duke thënë:

*“-Nuk do të gëzohesha edhe sikur të më jepnin botën si kundërvlerë e kësaj fjale të të Dërguarit të Allahut (s.a.v.s).”* (Ebu Davud, Vitir, 23/1498)

I Dërguari i Allahut (s.a.v.s) thotë kështu:

*“Lutja që një mysliman bën për një vëlla në fe, i cili nuk është i pranishëm, pranohet. Kur një njeri bën lutje për vëllain e tij në fe, edhe një ëngjëll që gjendet pranë tij, lutet kështu: Allahu e pranofte lutjen tënde, edhe ty të dhashtë të njëjtat gjëra!”* (Muslim, Dhikir 87, 88; Ibn Maxhe, Menasik, 5)

Atëherë edhe ne duhet të lutemi për vëllezërit myslimanë dhe po ashtu të kërkojmë që ata të luten për ne.



Për shkak se devotshmëria është veçoria për të cilën kemi më shumë nevojë në këtë botë, ne duhet të kërkojmë në lutjet tona më shumë devotshmëri. Një njeri shkoi te Pejgamberi alejhissalatu uestesalam dhe i tha:

*“O i Dërguari i Allahut! Po nisem për udhëtim, kështu që luto për mua.”*

I Dërguari i Nderuar tha:

*“-Allahu të dhashtë devotshmëri.”* Kur njeriu tha:

*“Më shumë, o i Dërguari i Allahut!”*, i Dërguari i Allahut tha:

*“-Allahu t'i faltë mëkate!”* Sahabiu tha:

*“Nëna dhe babai im të qofshin falë, pak më shumë o i Dërguari i*



Allahut!”

Krenaria e Gjithësisë (s.a.v.s) tha:

“-Allahu të dhashtë mundësi që të bësh të mira kudo që të ndodhesh.” (Tirmidhi, Deavat, 44/3444)



Një ditë, i Dërguari i Allahut lexoi fjalën e Ibrahimit alejhisselam:

“O Zoti im, ata po i devijojnë shumicën e njerëzve. Tashmë kush me ndjek mua, ai është prej meje (është në fenë time)...” (Ibrahim, 36), dhe lutjen e Isait alejhisselam:

“Nëse i ndëshkon ata, në të vërtetë ata janë robërit e tu. Nëse i fal, Ti je i gjithëfuqishmi, i urti.” (el-Maide, 118) Pastaj i ngriti duart dhe qau duke u lutur:

“O Allahu im, ruaje ummetin tim, mëshiroje ummetin tim!” Në lidhje me këtë, Allahu tha:

“O Xhebrail! Zoti yt e di më së miri, (ashtu që ta dinë edhe njerëzit) shko te Muhammedi dhe pyete përse qan.”

Xhebraili alejhisselam erdhi. I Dërguari i Allahut i tregoi se qau për shkak se ishte shqetësuar për ummetin. (pasi Hazreti Xhebrail u kthye për të shfaqur situatën) Allahu i tha:

“O Xhebrail! Shko të Muhammedi dhe jepi përgëzimin tim: Ty do të të kënaqim dhe kurrë nuk do të të zemërojmë në çështjen e ummetit tënd.” (Muslim, Iman, 346)

Ja, Pejgamberi, i Nderuari ynë në këtë mënyrë ishte i dhënë dhe i mëshirshëm ndaj ummetit të tij. Ne, duke e meditaruar mirë këtë hadith fisnik, duhet të llogarisim se sa e duam Atë, sa e reflektojmë në sjelljet tona Sunnetin Senijje të tij, si argument të dashurisë tonë dhe sa i jemi afruar moralit të tij.





Natën kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut (s.a.v.s), i cili pas namazit thoshte këtë lutje:

*“O Allahu im! Nga Ti dua një mëshirë të tillë që zembrës sime t’i japë udhëzim, punëve të mia rend, shpërndarjes sime rregull, brendësisë sime besim të plotë, pamjes sime të jatshme punë të devotshme, punëve të mia pastërti dhe sinqeritet. Më frymëzo drejtimin që është i përshtatshëm ndaj kënaqësisë tënde, më jep një mik që të bëhem mik me të dhe më mbro nga çdo e keqe!*

*O Allah, më jep një besim dhe një vendosmëri që tashmë të mos (pandeh se ka) ngelur kufër. Më jep mëshirë, ashtu që të mund të arrij në këtë botë dhe në botën tjetër një gradë që është e vlefshme për Ty.*

*O Allah! Dua shpëtim me mirësinë me të cilën do të na gjykosh, lus nga Ti pozitën që i përket dëshmorëve (e cila fiton afërsinë tënde), kërkoj nga Ti të jetoj si robërit e Tu fatmirë dhe kërkoj ndihmë nga Ti kundër armiqve.*

*O Allah! Edhe nëse të konceptuarit tim dhe puna ime është pak, nevojat e mia (të kësaj bote dhe të botës tjetër) t’i paraqes Ty (Kërkoj që të mi plotësosh). Kam nevojë për mëshirën tënde, gjendjen time po ta shfaq.*

*O Zoti im që i sundon dhe i kryen punët, që e shikon nevojën dhe u jep shërim zemrave! Dua të më ndash (largosh) nga ndëshkimi i xhehennemit, ashtu siç ke ndarë detrat nga njëri-tjetri, e të më mbrosh nga thirrja në shkatërrim dhe nga ndëshkimi i varrit.*

*O Allah! Nëse ka ndonjë mirësi që i ke dhënë ndokujt, ose ndonjë mirësi që i ke premtuar ndokujt nga krijesat e tua dhe nuk e kam kuptuar, ose synimi im nuk e ka arritur, apo nëse ka ngelur jashtë atyre që kam kërkuar, të përgjërohem që të ma dhurosh edhe mua, dhe kërkoj nga Ti që të ma japësh me mëshirën tënde.*

*O Allah! O zotërues i litarit të fortë (Kur’ani dhe feja) dhe i rrugës së drejtë! Në ditën e kiametit në të cilën u ke premtuar qafirave xhehennemin, kërkoj mbrojtje nga Ti prej xhehennemit, pastaj dua xhennetin bashkë me ëngjëjt mukarrabin që kanë arritur praninë tënde të*



*madhe, bashkë me ata që (kur ishin në këtë botë) bënë shumë ruku dhe sexhde dhe bashkë ma ata që i mbajnë premtimet. Ti ke mëshirë të pakufishme. Ti ke dashuri të pakufishme. Ti bën çfarë të duash. (Ti ke fuqi që të plotësosh gjithçka, sado që të kërkojnë njerëzit dhe sado që të jenë të mëdha.)*

*O Allah! Na jep për udhëzim udhëzues jo të devijuar, që të mos devijojmë. Miqve të Tu jepu paqe dhe armiqve të Tu jepu armiq. Atë që të do Ty, e dua për shkak të dashurisë që ka për Ty. Ndërsa atij që të kundërshton Ty, i shfaqim armiqësi për shkak të urrejtjes që ke për të.*

*O Allah! Kjo është lutja jonë. Kjo të bie Ty ta pranosh me mirësinë dhe nderin tënd. Kjo është përpjekja jonë, vendi ku mbështetemi ne je Ti.*

*O Allah! Jepi zemrës sime dritë, jepi varrit tim dritë, përpara meje më jep dritë, në të djathtë më jep dritë, në të majtë më jep dritë, lart më jep dritë, poshtë më jep dritë, veshit tim jepi dritë, syrit tim jepi dritë, flokëve të mia jepu dritë, lëkurës time jepi dritë, mishit tim jepi dritë, gjakut tim jepi dritë, kockave të mia jepu dritë!*

*O Zoti im, ma shto dritën time, më jep një dritë që të jetë shkëmbim i gjithë atyre që thashë), më jep një dritë (që t'i mbërthejë ato që thashë)!*

*Unë madhëroj atë që është i madhërueshëm dhe që është i lartë. Unë madhëroj atë që është i lartë dhe për këtë shkak u jep robërve të tij shumë. Lartësoj vetëm Atë që e meriton të lartësohet dhe të madhërohet. Lartësoj Atë të cilin zotëron shumë mirësi dhe nimete. Lartësoj Atë që është madhështor dhe bujar. Lartësoj Atë që është i lartë dhe bujar. Ai është larg çdo mangësie.” (Tirmidhi, Deavat, 30/3419)*



Një herë u ankuan te Pejgamberi për shkak se nuk binte shi. Mbi këtë i Dërguari i Allahut urdhëroi që t'i sillej një minber. Minberi u bë në vendin ku faleshin namazet e xhumasë, bajramit dhe xhenazes. U caktua një ditë për t'u mbledhur njerëzit. Krenaria e Gjithësisë (s.a.v.s) doli në udhëtim sapo u dallua në horizont e kuqja e diellit. Shkoi në



faltore dhe u ul në minber. Madhëroi dhe falenderoi Allahun dhe pastaj tha:

*“Ju u ankuat ngaqë vendi juaj është tharë dhe nga vonimi i shiut që nuk po bie në kohën e tij. Allahu xhelle xhelaluhu urdhëron që t’i luteni. Ai premton se do t’i përgjigjet lutjes suaj.”.* Pastaj u lut:

*“Falenderimi i takon Zotit të botërave. Ai është mëshirues dhe mëshirëbërës. Është sunduesi i ditës së kiametit. Nuk ka Zot tjetër përveç Allahut. Ai bën çfarë të dojë. O Zoti ynë! Ti je Allahu përveç të cilit nuk ka Zot tjetër. Ti je i pasur, ndërsa ne jemi të varfër. Na lësho shi. Bëje forcë dhe fuqi për ne atë shi që e zbrit. Na e sill atë sa më shpejt.”*

Pasi tha këtë, i ngriti duart. I ngriti aq shumë, saqë i dukej e bardha e sqetullës. Pastaj ua ktheu shpinën njerëzve, i ktheu rrobat mbrapsh dhe në këtë kohë duart i kishte të ngritura lart. Pastaj u kthye përsëri nga njerëzit. Zbriti nga minberi dhe fali dy rekatë namaz. Allahu Teala menjëherë në atë çast i dërgoi retë. Qielli vetëtoi dhe rrufeja shpërtheu. Filloi të bie shi me lejen e Allahut. Krenaria e Gjithësisë, i Nderuari ynë pa u kthyer akoma në xhami, rrëketë patën filluar të rridhnin. I Dërguari i Allahut, kur i pa njerëzit duke u kthyer me nxitim nëpër strehët e tyre, buzëqeshi dhe tha:

*“Dëshmoj se Allahu është i aftë për gjithçka dhe se unë jam rob dhe i Dërguari i Tij.”* (Ebu Davud, Istiska, 2/1173)

Pejgamberi, i Nderuari ynë fali namazin e istiskasë kur kërkoi shi nga Allahu, kështu fali edhe namaz nafile që t’i pranohej lutja e tij.



Nëna jonë Hazreti Aishe thotë:

Kur një natë u ngrita, nuk e pashë të Dërguarin e Allahut pranë meje. Kujtova se mos kishte shkuar te ndonjëra nga gratë e tij. Kërkova me dorë rreth e rrotull. Dora ime preku këmbën e tij. Atëherë e kuptova se i Dërguari i Allahut ishte në sexhde. E dëgjova me vëmendje, ai po qante dhe po lutej kështu:



اللَّهُمَّ أَعُوذُ بِرِضَاكَ مِنْ سَخَطِكَ وَبِمُعَافَاتِكَ مِنْ عُقُوبَتِكَ وَأَعُوذُ بِكَ مِنْكَ لَا أُحْصِي ثَنَاءً  
عَلَيْكَ أَنْتَ كَمَا أَثْنَيْتَ عَلَيَّ نَفْسِكَ

*“O Allahu im! Strehohem te kënaqësia jote nga ndëshkimi yt. Strehohem te falja jote nga ndëshkimi yt! O Allahu im prej askujt tjetër, por kërkoj mbrojtje nga Ti prej Teje. Unë jam i paaftë të të falenderoj aq sa e meriton. Ti je ashtu siç e ke lavdëruar veten Tënde!”*  
(Muslim, Salat, 222; Tirmidhi, Deavat, 75/3493)



Hazreti Omer radijallahu anhu tregon:

“Ditën e Bedrit, i Dërguari i Allahut (s.a.v.s) pa se mushrikët ishin njëmijë vetë, ndërsa ashabët e tij ishin treqind e dhjetë vetë.<sup>66</sup> Menjëherë u drejtua nga kibla dhe i ngriti duart. Ai filloi t’i lutet Zotit të tij me zë:

*O Allahu im! Ma fal premtimin që më ke dhënë! O Allahu im! Më jep fitore. O Allahu im! Nëse e shkatërron këtë grup që përkrah islam-in, tashmë në tokë nuk do të ngelë asnjë që të të adhurojë Ty!*

Ai e vazhdoi lutjen me duar të ngritura në një lloj mënyre, saqë mbulesa që kishte mbi supë i ra në tokë. Ebu Bekri radijallahu anhu i cili e pa këtë, duke ardhur pranë tij, e mori mbulesën, ia vuri mbi supë dhe duke iu qasur më pranë, i tha:

-O i Dërguari i Allahut! Të mjafton kjo lutje që i bëre Zotit tënd. Allahu patjetër do ta mbajë premtimin që të ka dhënë.

Në ato çaste, Allahu Teala i cili është i fortë dhe i madhërueshëm, zbriti këtë ajet fisnik:

**Përkujtoni kur kërkuat ndihmë prej Zotit tuaj dhe Ai iu përgjigj: “Unë do t’ju ndihmoj me njëmijë ëngjëj që vijnë një pas një (grup pas grupi)”** (el-Enfal, 9)

Allahu atë ditë i ndihmoi besimtarët me ëngjëjt e tij.” (Muslim,



Xhihad, 58; Buhari, Megazi, 4)



Ishte një sahabi që e quanin Ebu Mi'lak. Ky person bënte tregti duke krijuar shoqëri me të tjerët. Ishte një person i drejtë dhe i devotshëm. Një herë, ai kishte dalë përsëri në udhëtim. Një hajdut i armatosur i doli përpara dhe i tha:

“Çfarëdo që të kesh, nxirre se do të të vras.” Ebu Mi'lak tha:

“Nëse ke si qëllim të marrësh mallin, merre!” Hajduti tha:

“-Unë dua vetëm jetën tënde.” Ebu Mi'lak tha:

“-Atëherë më lejo të fal pak namaz.”. Hajduti tha:

“-Fal sa të duash!”. Ebu Mi'lak, pasi fali namazin, u lut kështu:

يَا وَدُودُ يَا ذَا الْعَرْشِ الْمَجِيدِ يَا فَعَالًا لِمَا يُرِيدُ أَسْأَلُكَ بِعِزَّتِكَ الَّتِي  
لَا تُرَامُ وَ مَلِكِكَ الَّذِي لَا يُضَامُ وَ بِنُورِكَ الَّذِي مَلَأَ أَرْكَانَ عَرْشِكَ  
أَنْ تَكْفِيَنِي شَرَّ هَذَا {اللَّصِّ} يَا مُغِيثُ اغْنِنِي

“O i dashuri i zemrave! O ti që zotëron arshin e madh! O Allahu im që bën çfarë të duash! Dua që të më mbrosh nga ky hajdut për hir të madhërisë tënde që nuk arrihet, për hir të sundimit tënd që nuk arrihet dhe për hir të dritës tënde që ka mbuluar të gjithë arshin tënd! O Allahu im që je ndihmues, më ndihmo!”

Ebu Mi'lak e përsëriti tre herë këtë lutje. Sapo e mbaroi lutjen e tij, u shfaq një kalorës që e mbante heshtën lart dhe e vrau hajdutin.

Sahabiu i cili shpëtoi me lejen e Allahut, e pyeti kalorësin:

“-Kush je ti? Allahu më ndihmoi mua duke të bërë ty shkak!”

Kalorësi tha:

“-Unë jam nga banorët e qiellit të katërt. Kur bëre lutjen e parë dëgjova se u hapën dyert e qiellit. Kur bëre lutjen e dytë, dëgjova zhurmën e banorëve të qiellit. Kur bëre lutjen e tretë, u tha: Po lutet dikush



që ka ngelur në vështirësi! Kur e dëgjova këtë, kërkova nga Allahu që të më urdhërojë që ta vrasë hajdutin. Allahu Teala e pranoi dëshirën time dhe erdha. Dije se dikush që merr abdes, fal katër rekatë namaz dhe bën këtë lutje, lutja e tij i pranohet, qoftë në vështirësi apo jo.” (Ibn Haxher, el-Isabe, IV, 182)



Nëna jonë Ummu Seleme radijallahu anha, ishte pyetur:

“O nëna e besimtarëve! Çfarë lutje bënte më shumë i Dërguari i Allahut kur ishte prane teje? Ajo u përgjigj:

“Shumë herë lutej kështu:

يَا مُقَلَّبَ الْقُلُوبِ ثَبِّتْ قَلْبِي عَلَى دِينِكَ

*O Allahu im që i kthen zemrat nga një gjendje në një gjendje tjetër! Përforcoje zemrën time në fenë tënde!”* (Tirmidhi, Deavat, 89/3522; Ahmed, IV, 182, VI, 91)



I Dërguari i Allahut (s.a.v.s) lutej shumë për udhëzimin e ummetit të tij. Ai ishte lutur kështu për udhëzimin e popullit të Jemenit: “*O Allah! Drejtoji zemrat e tyre nga ne!*” (Tirmidhi, Menakib, 71/3934) Ai lutej dhe i përgjërohej Allahut edhe për banorët e Taifit, të cilët e nxorën nga vendi i tyre duke i rënë me gurë dhe duke e sharë me ofendime të ndryshme, të cilët u dhanë shumë humbje myslimanëve duke ngulmuar deri në vitin e nëntë të hixhrit: “*O Zoti im! Udhëzoi banorët e Sakifit! Dërgoji ata te ne!*” (Ibn Hisham, IV, 134; Tirmidhi, Menakib, 73/3942)

Përsëri Krenaria e Gjithësisë, i Nderuari ynë (s.a.v.s), kur po e dërgonte Hazretin Ali si gjykatës në Jemen, duke e vendosur dorën në gjoksin e kushëritit të tij që brengosej nga përgjegjësia e detyrës që kishte marrë, bëri këtë lutje:

“*O Allah! Udhëzoje zemrën e tij në të drejtë dhe përforcoje gju-*



*hën e tij në hak (vërtetë)."*

Hazreti Ali radijallahu anhu thotë:

"Pas kësaj lutjeje nuk kam rënë në dilemë kur gjykoja ndërmjet dy vetëve." (Ibn Maxhe, Ahkam, 1)



I Dërguari i Allahut (s.a.v.s), gjatë kohës së haxhit në vakfe, teksa njëren dorë e mbante te kapistra e devesë, dhe tjetrën të ngritur lart, bëri një lutje të gjatë e cila shpreh ndjeshmërinë e adhurimit të tij dhe të jetës së tij shpirtërore. Një pjesë e kësaj lutjeje të bukur është kë-shtu:

*"O Allahu im! Ty të përket falenderimi ashtu siç ke e thënë dhe më lart nga ç'mund ta themi ne! O Allah! Namazi, adhurimi, jeta dhe vdekja ime është për Ty! Kthimi im është vetëm te Ti!*

*O Allah! Kërkoj mbrojtje prej Teje nga ndëshkimi i varrit, nga druajtjet që e ftohin zemrën dhe nga parregullsia e punëve! O Allah! Kërkoj mbrojtje prej Teje nga e keqja e katastrofës që sjellin erërat!*

*O Allah! Krijë në syrin tim një dritë, në veshin tim një dritë dhe në zemrën time një dritë! O Allahu im! Zgjerë krahërorin tim! Lehtësoje punën time! O Allahu im! Kërkoj mbrojtje prej Teje nga kthimi i shëndetit në sëmundje, nga ndëshkimi yt që vjen befasisht! O Allahu im! Më dërgo në rrugë të drejtë! Më fal mëkatet e kaluara dhe të ardhme!*

*O Allah që i ngre gradat, që zbret bereqet dhe që ke krijuar qiejt dhe tokën! Zërat në gjuhë të ndryshme ngrihen për tek Ti duke u entuziasmuar dhe kërkojnë nga Ti! Dëshira ime është që të më kujtosh në vendin e provimit, atje ku do të më harrojnë njerëzit e kësaj bote!*

*O Allahu im! Ti e dëgjon fjalën time, e shikon vendin ku gjendem dhe e di çfarë kam të fshehtë dhe çfarë kam të hapur! Unë jam i pa rrugëdalje, i varfër, kërkoj nga ti ndihmë dhe mbrojtje! Kam frikë dhe i pranoj gabimet e mia! Siç kërkon një që nuk ka rrugëdalje, ashtu kërkoj edhe unë! Po të përgjërohëm ashtu siç të përgjërohet një mëkatar i nënçmuar! Po të lutem ashtu siç të lutet një rob i Yti që e ka*



*ulur kokën në prani të madhërisë tënde, që i rrjedhin lot nga sytë për Ty, që e flijon të gjithë pasurinë e tij për Ty dhe që e vë fytyrën e tij në tokë për Ty! O Zoti im! Mos më lër të privuar nga pranimi i lutjes sime! O Ti më i miri nga i cili kërkohet, O më bujari i atyre që japin, Ji mëshirues dhe falës ndaj meje!*<sup>67</sup>

Ja një lutje e sinqertë dhe thelbësore që tregonte vendosmërinë shpirtërore të të Dërguarit të Allahut, që nuk kishte asnjë mëkat në prani të Allahut...



Një pjesë e lutjeve që bënin në Arafat selefët (paraardhësit) e devotshëm, është kështu:

“O Zoti im! Kush mund ta lavdërojë veten e tij përpara Teje? O Zoti im! Gjuha më është mbajtur me mëkate, unë nuk kam asnjë ndërmjetës që të ndërmjetësojë për mua te Ti, as ndonjë punë që ka dobi përveç shpresës për mëshirën tënde! O Zoti im! E di që për shkak të mëkatëve të mia nuk kam pozitë në praninë tënde dhe nuk kam fytyrë për të kërkuar falje nga Ti! Por Ti je më bujari i bujarëve! O Zoti im! Mëshira Jote mund të më arrijë mua edhe nëse nuk e meritoj atë! Sepse mëshira Jote është aq e gjërë, sa mund të përfshijë gjithçka! O Zot! Sado i madh të jetë mëkatim im, ai është i vogël në krahasim me mëshirën tënde! Fali ata o Zoti im bujar!

O Zoti im! Ku do të shkojnë dhe të strehohen mëkatarët, nëse Ti do të falësh vetëm robërit e tu të bindshëm? O Zoti im! Nga kush do të kërkojnë ndihmë mëkatarët, nëse Ti do të falësh dhe mëshirosh vetëm robërit e tu të devotshëm!

Unë në çdo çast kam nevojë për Ty! Ndërsa Ti nuk ke fare nevojë për mua! Vetëm Ti më fal mua si krijuesi im që je! O Zoti im, më kthe mua nga ky vend, me nevoja të kryera, me kërkesa të plotësuara dhe me shpresa të realizuara!

O Allahu im që ke dhe posedon nevojat e kërkuesve! O Allahu

67. Shik. Ibn Kethir, el-Bidaje, V, 166-168; Hejsemi, III, 252; Ibn Kajjim, Zadu'l-Mead, Bejrut 1995, II, 237.





im që e di se çfarë mendojnë ata që heshtin! O Allahu im, nuk pritet ndihmë prej askujt përveç teje, dhe që nuk ka Zot tjetër përveç Teje! O Allah, nuk ka krijues tjetër përveç Teje që të kihet frikë! O Allah, ministri vjen pranë Teje dhe Ti nuk ke derë që të jepet rryshfet! O Allahu im që e shton bujarinë dhe fisnikërinë kur shtohen kërkesat, o Ti që e shton mirësinë dhe begatinë kur shtohen nevojat! O Allahu im! Ti e nderon çdo mik! Edhe ne jemi miqt e Tu! Na ndero me xhennetin tënd!

O Allahu im! Çdo karvani i jepet dhuratë, çdo kërkuesi i jepet dhuratë, çdo vizitor nderohet! Çdokujt që shpreson sevap i jepet sevap! Ne kemi ardhur bashkërisht në Bejtu'l-Haram tëndin! Ne ndaluam në Vakfe, në këto ceremoni të mëdha! Ne gjendemi gati në këto vende të bekuara! Shpresa jonë është që të fitojmë sevap dhe shpërblim te madhëria Jote! O Allahu im, mos e lër të shkojë kot shpresën tonë!<sup>68</sup>



Ebu Umame radijallahu anhu thotë kështu:

I Dërguari i Allahut (s.a.v.s) pati bërë shumë lutje, por ne nuk mundëm të mësonim asgjë nga ato. Mbi këtë thamë:

“O i Dërguari i Allahut! Ju bëtë shumë lutje, por ne nuk mundëm t’i mësojmë.” Atëherë i Dërguari i Allahut tha:

*“A t’ju mësoj një lutje e cila i përfshin të gjithë ato lutje? Thoni kështu:*

اللَّهُمَّ إِنَّا نَسْأَلُكَ مِنْ خَيْرِ مَا سَأَلَكَ مِنْهُ نَبِيُّكَ مُحَمَّدٌ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ  
وَنَعُوذُ بِكَ مِنْ شَرِّ مَا اسْتَعَاذَكَ مِنْهُ نَبِيُّكَ مُحَمَّدٌ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ  
وَأَنْتَ الْمُسْتَعَانُ وَعَلَيْكَ الْبَلَاغُ وَلَا حَوْلَ وَلَا قُوَّةَ إِلَّا بِاللَّهِ

*O Allah! Edhe ne kërkojmë nga Ti atë që kërkoi Pejgamberi Yt, Muhammedi (s.a.v.s). Edhe ne strehohemi te Ti nga ato gjëra prej*

68. Shik. Gazali, Ihjau Ulumi'd-Din, Bejrut 1990, I, 337-338; Bejhaki, Shuabu'l-Iman, II, 25-26.



*të cilave është strehuar te Ti Pejgamberi Yt, Muhammedi (s.a.v.s). Ndihma pritet vetëm nga Ti. Ti je ai i cili e dërgon njeriun tek ajo që dëshiron në këtë botë dhe në botën tjetër. Vetëm me ndihmën e Allahut mund të fitohet forca për të ikur nga mëkati dhe fuqia për të bërë adhurim.” (Tirmidhi, Deavat, 88/3521)*

Enesi radijallahu anhu, tregon kështu:

I Dërguari i Allahut vizitoi një të sëmurë që ishte dobësuar shumë dhe e pyeti:

“A i bëje lutje Allahut për ndonjë gjë, ose a kërkoje gjë prej Tij?”  
I sëmuri u përgjigj:

“Po, lutesha kështu: O Allah! Dënimin që do të ma japësh në ahiret, ma jep menjëherë këtu!”. I Dërguari i Allahut (s.a.v.s) tha kështu:

“Subhanallah! Ti nuk ke fuqi për këtë. A nuk do të ishte më mirë të luteshe kështu:

رَبَّنَا آتِنَا فِي الدُّنْيَا حَسَنَةً وَفِي الْآخِرَةِ حَسَنَةً وَقِنَا عَذَابَ النَّارِ

**...O Zoti ynë! Na jep në këtë botë të mira dhe në botën tjetër të mira dhe na mbro nga ndëshkimi i xhehennemit!** (el-Bakara, 201)”

Mbi këtë burri bëri këtë lutje dhe u shërua. (Muslim, Dhikr, 23; Tirmidhi, Deavat, 71/3487)

Kur të lutemi, duhet të kemi kujdes se çfarë kërkojmë nga Allahu Teala dhe duhet të respektojmë rregullat e lutjes. Nga Allahu vazhdimisht duhet të kërkojmë hajër, mirësi dhe falje.



Sipas transmetimit të Hazretit Ali radijallahu anhu, një rob (që kishte bërë marrëveshje me të) shkoi tek ai i tha:

“Nuk kam fuqi që të paguaj borxhin tim, më ndihmo! Ai tha:

“A të të mësoj lutjen që më ka mësuar i Dërguari i Allahut (s.a.v.s)?  
Gjatë kohës që të bësh këtë lutje, Allahu do të të ndihmojë për të pa-



guar borxhin, edhe nëse është sa mali Sebir.”, dhe bëri këtë lutje:

اللَّهُمَّ اكْفِنِي بِحَلَالِكَ عَنْ حَرَامِكَ وَأَغْنِنِي بِفَضْلِكَ عَمَّنْ سِوَاكَ

“O Zoti im! Më mbro nga haramet, duke më dhënë risk hallall dhe mos më lër që t’ia kem nevojën askujt përveç Teje!” (Tirmidhi, Deavat, 110/3563)



Sulltani i parë Murat Hydavendigar, kur hyri në fushën e Kosovës më 8 gusht 1389, u ballafaqua me një furtunë që e përzinte pluhurin me tymin. Ishte një pamje aq e turbullt saqë syri nuk e shikonte syrin. Ja, ajo natë ishte Nata e Beraatit. Murad Hani, pasi fali dy rekatë namaz, me lot në sy bëri këtë lutje:

“O Zoti im! Nëse kjo furtunë ka dalë për shkak të mëkateve të robit tënd Murad të paaftë, mos i ndëshko ushtarët e mi të pafajshëm për shkak të kësaj!.. O Allahu im! Ata kanë ardhur deri këtu për të lartësuar emrin tënd dhe për të përhapur islamit!

O Zoti im! Shumë herë nuk më ke lënë të privuar nga fitorja. Gjithmonë e ke pranuar lutjen time. Përsëri të përgjerohem, pranoje lutjen time! Lësho një shi që kjo re pluhuri të hiqet. T’i shikojmë qafirat qartë dhe të luftojmë ballë për ballë!

O Zoti im! Edhe gjithësia edhe ky rob është i Yti. Unë jam një rob i paaftë. Ti e di më mirë synimin dhe të fshehtat e mia. Qëllimi im nuk është pasuri dhe pronë. Dua vetëm kënaqësinë tënde.

O Zoti im! Mos i lër të humbin në dorën e qafirave këta ushtarë besimtarë dhe mos i shkatërro ata! Jepu atyre një fitore, ashtu që të festojnë të gjithë besimtarët! **Nëse do, kurban i asaj dite feste le të jetë robi Yt Muradi!**

O Zoti im! Mos më bëj mua shkak për shkatërrimin e gjithë këtyre ushtarëve myslimanë! Ndihej këta dhe jepu fitore! Unë e bëj kurban shpirtin tim për këta, mjafton që Ti të më pranosh në grupin



e dëshmorëve!... Jam i kënaqur të dorëzoj shpirtin tim për ushtarët e Islamit... Mua më bëre luftëtar. Së fundi, me mirësinë dhe bujarinë tënde më jep edhe martirizmin! Amin!”

Pas kësaj lutje të sinqertë, me një qetësi të jashtëzakonshme Sulltani filloi të lexonte Kur’anin Fisnik. Pa kaluar shumë, u shfaqën retë e mëshirës. Në fushën e Kosovës ra menjëherë shi. Era ndaloi. Pluhuri u shpërnda...

Pas këtyre shfaqjeve armiku u mund. Lufta e cila zgjati tetë orë, përfundoi me fitore.

Murad Han ecte mes të plagosurve dhe dëshmorëve që gjendeshin në sheshin e luftës. Një ushtar serb i plagosur, duke u ngritur nga mesi i të vdekurve, tha:

“Lërmëni mua; do të puth dorën e padishahut dhe do të bëhem mysliman!” Serbi që hiqej sikur ishte i plagosur, bëri kinse po puthte dorën e padishahut dhe ia nguli Sulltanit në gjoks hanxharin që e mbante fshehur nën sqetull. Dhe lutja e Murad Hanit i cili piu sherbetin e martirizmit, u realizua plotësisht...



Së fundi, lutja është pozita e esencës së adhurimit dhe e jetës së adhurimit, sepse një nga gjërat që i pëlqen Allahut është që robi, gjithë duke e kuptuar dobësinë e tij dhe duke shtrirë duart, t’ia shfaqë Zotit gjendjen e vet, t’i lutet dhe t’i përgjërohet. Për këtë arsye, Allahu Teala e ndëshkon atë që nuk lutet dhe që nuk kërkon gjë prej Tij.

Po kështu në ajetin fisnik thuhet:

“(O i Dërguari im!) **Thuaj: Për çfarë do t’ju jepte vlerë Zoti im sikur të mos ishte lutja juaj!..**” (el-Furkan, 77)

Lutja është çelësi i dyerve të mëshirës, arma e besimtarit, shtylla e fesë dhe drita e qiejve dhe e tokës. Kujt i janë hapur dyert e lutjes u janë hapur dyert e hajrit, urtësisë dhe mëshirës. Ai që dëshiron t’i pranohet lutja në vështirësi dhe ngushtësi, duhet të bëjë shumë lutje edhe në kohë kur ka pasuri dhe në kohë qetësie. Shpirtërat e mëdhenj janë ata që jetojnë gjithmonë duke bërë lutje.



#### **d. Hushu-ja** (Frikërespekti ndaj Allahut)

Hushuja është mbushja e zemrës me dashurinë dhe frikën ndaj Allahut dhe qetësimi i organeve me këto ndjenja.

Hushuja është e dyanshme, origjina në zemër dhe shfaqjet e saj në trup. Ana që i përket zemrës është bindja e vetes ndaj urdhërave të Zotit, duke e konceptuar pavlerësinë e saj përballë madhësisë dhe lartësisë së Zotit, si dhe përforcimi i ndjenjës së një edukate shumë të lartë, madhërimi dhe respekti. Ndërsa ana që ka lidhje me paraqitjen e jashtme, është mbrauajtja e një gjendjeje dinjiteti dhe qetësie në pjesët e trupit, nën ndikimin e kësaj ndjenje. Përshembull, shikimi në vendin e sexhdes dhe jo rreth e rrotull në namaz...

Shembujt më të bukur të përjetimit të jetës dhe adhurimeve me hushu, i gjejmë në jetën shembullore të Pejgamberit tonë të nderuar dhe të ashabëve fisnikë. I Dërguari i Allahut (s.a.v.s), i cili as edhe një çast të vetëm të jetës së tij nuk e ndante nga e vërteta e ahiretit, edhe në adhurime tërhiqte vëmendjen për domosdoshmërinë e shndërrimit në gjendjen shpirtërore deri në frymën e fundit.

Një herë, një sahabi shkoi te i Dërguari i Allahut (s.a.v.s), dhe i tha:

“O i Dërguari i Allahut! Më këshillo, por këshilla të jetë e shkurtër dhe thelbësore! Në lidhje me këtë, i Dërguari i Allahut (s.a.v.s) tha:

*“Fale namazin si një person që po i jep lamtumirë jetës! Mos thuaj një fjalë për të cilën duhet të kërkosh falje! Mos ki lakmi ndaj gjërave që kanë njerëzit!”* (Ibn Maxhe, Zuhd, 15; Ahmed, V, 412)

Adhurimet fitojnë vlerë vetëm kur të kryhen me vigjilencë shpirtërore, me hushu dhe me meditim. Veçoria më e rëndësishme e ashabëve të nderuar dhe e atyre që i pasonin ata në një mënyrë shumë të bukur, ishte zotërimi i kësaj vendosmërie shpirtërore. Po ashtu, Abdullah bin Mes'ud radijallahu anhu u thoshte kështu miqve të tij:

“Ju falni më shumë namaz dhe përpiqeni më shumë se ashabët, por ata ishin më të virtytshëm se ju.”

Kur iu tha “Në çfarë ishin më të virtytshëm se sa ne?”, ai u përgjigj:



“Ata ishin më asketë se sa ju ndaj kësaj bote dhe me më dashamirës se sa ju ndaj ahiretit.” (Ibnu'l-Xheuzi, Sifatu's-Safue, Bejrut 1979, I, 420)

Hushuja në namaz është aq e rëndësishme, sa që rruga e robit që çon drejt shpëtimit kalon nga kjo derë, sepse në suren Mu'minun thuhet:

**“Është e sigurtë se kanë shpëtuar besimtarët: Ata të cilët janë të përlulur dhe të kujdesshëm gjatë faljes së namazit.”** (el-Mu'minun, 1-2)

Edhe Pejgamberi, i Nderuari ynë, njofton se robi do të trajtohet në lidhje me respektin që ka pasur ndaj namazit:

*“Robi fal namaz, por vetëm një e dhjeta, një e nënta, një e teta, një e shtata, një e gjashta, një e pesta, një e katërta ose gjysma e namazit i shkruhet për të.”* (Ebu Davud, Salat, 123-124/796)

Domethënë, për robin ka vetëm sevapin e namazit të cilin e ka falur me hushu dhe me qetësi.

Ja si e sqaron Zoti ynë mënyrën se si mund të falet namazi me hushu:

**“Kërkoni ndihmë me durim dhe me namaz, vërtetë ai (namazi) është i vështirë përveç për ata të cilët e kanë frikë (Zotin e tyre). Të cilët janë të bindur se do të takojnë Zotin e tyre dhe se ata do t'i kthehen Atij.”** (el-Bakara, 45-46)

Domethënë, një person i cili e fal namazin me vetëdijen se një ditë do të dalë patjetër në prani të Zotit të tij, pra me vetëdijen se së fundi do të kthehet te Ai për të dhënë llogari, ka arritur hushunë e vërtetë.

Nëse kjo gjendje hushuje vazhdon në namaz, me kalimin e kohës e mbulon të gjithë jetën e besimtarit. Për këtë arsye, ajetin fisnik

**“Ata të cilët janë të rregullt në faljen e namazit të tyre.”** (el-Mearixh, 23) , Hazreti Mevlana e komenton në këtë mënyrë:

“Gjendja jote pas namazit duhet të jetë si gjendja jote në namaz.”

Për të arritur këtë gjendje, është e nevojshme të bëhemi si i Dërguari i Allahut (s.a.v.s), duke marrë pjesë nga morali i tij i lartë me lidhjen e një zemre të sinqertë dhe të pastër, sepse i Nderuari ynë



alejhissalatu uesselam ka thënë kështu:

*“...Allahu Teala, duke u mësuar mirësinë njerëzve të cilët e kanë frikë Atë, të brengosurve, mëshiruesve, e do çdo zemër që thërret për në bindje ndaj Allahut. Po ashtu Ai nuk e do zemrën e ngurtë, atë që merret me gjëra boshe, atë që e kalon gjithë natën në gjumë edhe pse nuk e di nëse do t'i kthehet shpirti apo jo dhe çdo zemër që e përkujton shumë pak Allahun.”* (Dejlemi, I, 158)

### ***Tabllo të virtytshme***

Abdullah bin Shihhir radijallahu anhu e tregon kështu hushunë e të Nderuarit tonë:

“Një herë shkova te i Dërguari i Allahut (s.a.v.s). Ai po falte namaz dhe për shkak se po qante, nga kraharori i tij vinin disa zëra si kazani që valon.” (Ebu Davud, Salat, 156-157/904; Ahmed, IV, 25, 26)

Po ashtu, është e nevojshme që të tregohet kujdes edhe në drejtim të legjislacionit islam të namazit. Por është e domosdoshme që t'i japim rëndësi edhe anës shpirtërore të tij, sipas mënyrës që tregohet në hadithin fisnik. Kur fikhu (legjislacioni Islam) e përgatit robin për namaz me taharet, abdes dhe pastërti, pastërtia shpirtërore, domethënë hushuja e bën robin të fitojë qetësi, ndjenja shpirtërore dhe “takimin hyjnor”.

I Nderuari ynë (s.a.v.s) ka thënë se është e nevojshme që namazi të falet me një hushu të madhe dhe me një gjendje të lartë shpirtërore, duke iu lutur Zotit:

*“Namazi falet dy nga dy. Në çdo dy rekatë ka një teshehud. Namazi është të ndjerit e hushusë, modestisë dhe të shfaqurit e thjesh-tësisë. (Kur ta falë), t'i ngrejë duart drejt Zotit të lartë në mënyrë që shuplaka e duarve të jetë e kthyer nga fytyra dhe pastaj të lutet: O Zoti im! O Zoti im!. Kush nuk e bën këtë, e ka namazin e mangët.”* (Tirmidhi, Salat, 166/385)



Aishe radijallahu anha tregon:

Ebu Xhehm i pati dhuruar të Dërguarit të Allahut (s.a.v.s) një rrobë të qëndisur dhe të hijshme. I Dërguari i Nderuar fali namaz me atë rrobë. Pasi e mbaroi namazin, tha:

*“Jepjani këtë rrobë Ebu Xhehmit sepse në namaz më ngelën sytë të qëndisjet e saj. Për pak sa nuk e humba përqëndrimin në namaz.”*  
(Muvatta, Salat, 67; Buhari, Salat, 14)



Në haxhin e lamtumirës, i Dërguari i Allahut (s.a.v.s) u mësoi njerëzve shtyllat e haxhit, duke i praktikuar ai vetë. Ai tha se edhe në haxh veçanërisht, duhet të kemi hushu si në adhurimet e tjera.

Po ashtu, i Nderuari ynë alejhissalatu uesselam në ditën e Arafatit po kthehej (nga Arafati për në Muzdelife). Kur prapa tij pa disa njerëz që thërrisnin dhe u binin deveve të tyre, e kur dëgjoi zërat e deveve, ua bëri me shenjë atyre dhe u tha kështu:

*“O Njerëz! Ecni më ngadalë! Nuk fitohet sevap duke nxituar.”*  
(Buhari, Haxh, 94; Muslim, Haxh, 268)

Hazreti Ali radijallahu anhu, transmeton kështu:

Pejgamberi, i Nderuari ynë, pa një njeri që luante me mjekrën e tij gjatë namazit. Në lidhje me këtë tha:

*“Sikur zemra t’i ndjente hushu, edhe gjymtyrët e tij do të ishin në hushu.”* (Ali el-Muttaki, VIII, 197/22530)



Sipas transmetimit të Hazretit Aishe, nëna e saj Ummu Ruman ka thënë:

Kur po falja namaz, lëvizja majtas djathtas. Kur Ebu Bekri e pa këtë gjendje, më qortoi në një lloj mënyre të tillë, sa që për pak do të prishja namazin. Pastaj m’u drejtua me fjalët:

“I Dërguari i Allahut ka thënë:





*Kur dikush prej jush të falë namaz, çdo anë e tij le të jetë e qetë, le të jetë në hushu. Të mos lëvizë si çifutët, qetësia në namaz është nga çështjet që e plotësojnë namazin.*”<sup>69</sup>



Hazreti Sulejman alejhisselam, edhe pse atij i qe dhënë pasuri shumë e madhe dhe salltanet, duke jetuar gjithmonë një jetë me hushu, modesti dhe entuziazëm, dinte se si ta bënte zemrën që të mos kishte nevojë të kësaj bote. Po ashtu, për të shprehur virtytin e tij, thuhet:

“Sulejmani alejhisselam, megjithë pasurinë që i ishte dhënë, nuk e kishte ngritur kokën nga qielli deri sa vdiq, për shkak të hushusë që ndjente për Allahun.”<sup>70</sup>



Abdullah bin Ebu Bekr radijallahu anhuma, transmeton:

“Ebu Talha po falte namaz në bahçen e tij. Një zog, që quhet Dubsi, fluturoi për të dalë jashtë bahçes. Shkoi majtas-djathtas duke kërkuar vend për të ndalur. Kjo i pëlqeu Ebu Talhas dhe e shikoi një çast. Pastaj u kthye në namaz, por harroi se sa rekatë kishte falur. Në lidhje me këtë, duke menduar se pasuria e tij u bë shkak për fitne dhe e prishi hushunë e tij, shkoi te i Dërguari i Allahut (s.a.v.s) dhe ia tregoi situatën, duke i thënë:

“O i Dërguari i Allahut! Pasuria ime është sadaka për hir të Allahut, përdore si të duash dhe jepja kujt të duash.” (Muvatta, Salat, 69)



Sa e mrekullueshme është kjo ngjarje që tregon hushunë që sahabët kishin në namaz:

Pejgamberi ynë i Nderuar qëndroi në një vend kur po kthehej nga një udhëtim në Medine. Duke u kthyer nga ashabët, i pyeti:

“-Kush do të na presë ne sonte?”

69. Alusi, Ruhu'l-Meani, Bejrut, Daru'l-Fikr 1989, VIII, 118.

70. Ibn Ebi Shejbe, el-Musannef, Bejrut, Daru'l-Fikr 1989, VIII, 118.



Ammar bin Jasir, i cili ishte nga Muhaxhirët dhe Abbad bin Bishr, i cili ishte nga Ensarët, menjëherë thanë:

“-Të presim ne, o i Dërguari i Allahut!”

Abbadi radijallahu anhu e pyeti Ammarin:

“Në cilën pjesë të natës dëshiron të bëshë roje, në fillim apo në fund?” Ammar radijallahu anhu tha:

“-Dua të bëj rojë në pjesën e fundit!”. Dhe duke u shtrirë mbi diçka, filloi të flejë. Abbadi filloi të falë namaz. Në ato momente erdhi një mushrik. Kur pa një diçka të zezë që qëndronte në këmbë, e kuptoi se është roje dhe menjëherë hodhi një shigjetë. Shigjeta e qëlloi Abbadin. Abbadi e nxori shigjetën dhe e vazhdoi namazin. Mushriku hodhi dy tre shigjeta dhe e qëlloi atë. Në çdo herë që i binte shigjeta, Abbadi radijallahu anhu, duke qëndruar në këmbë, i tërhiqte shigjetat, i nxirrte dhe e vazhdonte namazin. Në këtë mënyrë bëri rukunë dhe sexhden. Pasi dha salam, duke e zgjuar shokun e tij, i tha:

“-Ngrihu! Unë u plagosa!”

Ammari kërcëu dhe u ngrit. Kur mushriku i pa ata, e kuptoi se e panë dhe u largua. Kur Ammari e pa Abbadin të mbuluar me gjak, tha:

“-Subhanallah! Përse nuk më zgjove kur u hodh shigjeta e parë?!” Abbadi dha këtë përgjigje të shkëlqyer që tregon dashurinë dhe dëshirën që kishte për namazin dhe hushunë që kishte në adhurim:

“-Po lexoja një sure, nuk doja ta prishja namazin pa e mbaruar atë. Por kur shigjetat erdhën njëra pas tjetrës, e ndërpreva leximin dhe shkova në ruku. Betohem në Allahun se sikur të mos kisha frikë se mos humb këtë vend që i Dërguari i Allahut më ka urdhëruar që ta ruaj, nuk do ta lija suren në mes dhe do dëshiroja të vdisja më mirë se sa të lija namazin.” (Ebu Davud, Taharet, 78/198; Ahmed, III, 344; Ibn Hisham, III, 219; Vakidi, I, 397)



Nipi i Esmas, bijës së Hazretit Ebu Bekr, e pyeti atë:

“Gjyshe! Çfarë bënin ashabët e Pejgamberit kur dëgjonin Kur’an?”



Esma u përgjigj:

“Ata vepronin ashtu si thotë Kur’ani, u rridhnin lotë nga sytë dhe u dridheshin trupat.” (Bejhaki, Şuabu’l-Iman, II, 365)

Ja si i përshkruan Allahu robërit e tij që lexojnë Kur’an me hushu:

“(Kur lexohet Kur’ani) bëjnë sexhde duke qarë. Kur’ani ua shton atyre hushunë e tyre.” (el-Isra, 109)

“...Atyre që e kanë frikë Zotin e tyre u dridhen qimet e trupit prej Kur’anit dhe me përkujtimin e Allahut u qetësohen lëkurat dhe zemrat e tyre...” (ez-Zumer, 23)



Në një betejë Hazretin Ali e kishte qëlluar një shigjetë. Nuk mundën t’ia nxirrnin për shkak të dhimbjes. Hazreti Ali radijallahu anhu tha:

“Unë po fal namaz dhe kështu nxirreni!”

Bënë ashtu si tha: ata e nxorën pa asnjë vështirësi. Hazreti Ali, i cili nuk ndjeu asnjë llojë dhimbjeje, kur dha selam pyeti:

“Çfarë bëtë?”

Ata thanë:

“E nxorëm shigjetën!..”



Hazretin Vejsel Karani e pyeti nëna e tij:

“O biri im, si mund të bësh adhurim gjithë natën deri në mëngjes? Si mund të durosh?”

Vejsel Karani i cili ishte një mik i madh i Allahut tha: “O nëna ime e dashur! Adhurimin e bëj për Zotin. Zemra ime zgjerohet me hushu dhe lidhjet e mia ndërpriten me tokën dhe me çdo ndjenjë trupore, aq sa nuk di se ç’është lodhja. Pastaj, befas e kuptoj se ka ardhur agimi!..”

“O Uvejs, çfarë është hushuja?”



“Hushuja është mosndjesia e shpirtit edhe nëse e godet trupin një shigjetë.”



Sipas transmetimit, Hazreti Zejnelabidin zverdhej kur ngrihej për të marrë abdes dhe i dridheshin këmbët kur do të falte namaz. Ai u përgjigj kështu atyre që e pyetën për shkakun e kësaj:

“A nuk e dini se përpara kujt do të dal?” (Ebu Nuajm, Hilje, III, 133)

Një herë, kur ai po falte namaz në shtëpinë e tij, pati rënë zjarr. Por ai nuk e ndjeu këtë. Kur dha selam, i treguan dhe e pyetën:

“Çfarë ishte ajo që të bëri të mos e ndjesh kur shtëpia jote digjej?”

Hazreti Zejnelabidin tha:

“Këtë zjarr të vogël të kësaj botë më bëri të mos e ndjej zjarri i ahiretit i cili i pret njerëzit.”



Edhe namazi i Muslin bin Jesarit ishte kështu. Ai po falte namaz në një xhami në Basra. Në atë moment, faltorja u shemb me një zhurmë të madhe, por Muslim bin Jesar e vazhdoi namazin e tij pa e ndjerë këtë. Kur dha selam, i thanë:

“Xhamia u rrëzua, ndërsa ti nuk u trembe fare? Çështë kjo punë?”

Ndërsa ai duke thënë me habi:

“U shemb xhamia?!” tha ai i habitur, prejse nuk kishte ndjerë asgjë gjatë faljes së namazit.



Një mik i Zotit tregon:

Fala namazin e iqindisë pas Hazretit Zunnun Misri. Kur ai mik i begatë i Zotit tha *Allahu ekber*, përkujtimi i Allahut pati një ndikim aq të madh mbi të, saqë pothuajse nuk i ngeli shpirti në trup. Ngriu dhe ngeli ashtu. Kur tha *Ekber*, zemra ime u copëtua prej frikës së tekbitit që dha.”



Kur Amir bin Abdullah falte namaz, ndërpriteshin lidhjet e tij me këtë botë dhe hushunë që e kishte në namaz nuk mund t'ia prishte asgjë që kishte lidhje me gjërat e kësaj bote. Ai thoshte:

“Në namaz, më mirë të më bie një shigjetë, se sa të dëgjoj dhe ndjej fjalët dhe lëvizjet e të tjerëve.”

E pyetën Bahauddin Nakshibendin, kuddise sirruh:

“Si e arrin një njeri hushunë në namaz?”

“Me katër gjëra!”, u përgjigj ai:

“1. Ushqimi hallall.

2. Të mos qenit neglizhent gjatë marrjes së abdesit.

3. Të qenët i qetë në marrjen e tekbitit të parë,

4. Mos-harrimi i Zotit edhe jashtë namazit, domethënë vazhdimi i gjendjes së qetësisë dhe shmangia nga mëkatet si në namaz, edhe pas namazit.”



Së fundi, hushuja është kryerja e urdhërave të Allahut me dëshirë dhe largimi me përpikmëri të madhe nga ato që Ai ka ndaluar. Fjalët hushu, takva, ihlas dhe ihsan, janë gjendje me kuptim shumë afër njëra tjetrës.

Burimi i këtyre gjendjeve është dashuria ndaj Allahut. Dashuria ndaj Allahut është shenja e shkallës shpirtërore të besimtarit. Kjo shkallë shpirtërore shfaqet në adhurimet që janë kryer me hushu dhe në shkëlqyeshmërinë e sjelljeve.

Hushuja duhet ta mbushë zemrën tonë në çdo çast, në radhë të parë në namaz, por pastaj duhet të reflektohet në gjendje qetësie e heshtjeje edhe nga organet tona, brënda mjedisit që na rrethon.

## 7. Të jesh në një gjendje me Kur'anin Fisnik

Kur'ani fisnik është një udhërrëfyes që u tregon njerëzve rrugën



e drejtë, është mëshirë për besimtarët dhe shërim për sëmundjet që gjenden në zemër. Në të njëjtën kohë, ai është nxjerrës i njerëzve nga errësira në dritë me lejen e Zotit, si dhe një udhëzues hyjnor që të afron te Allahu Teala.

Kur'ani Fisnik është një urdhër hyjnor i cili tregon qëllimin e krijimit të krijesave dhe urtësinë e ekzistencës së njeriut dhe që urdhëron të ndjekim një jetë të përshtatshme me sistemin hyjnor në gjithësi. Allahu thotë:

**“Allahu e shpalli fjalën më të mirë, librin, të ngjashëm në mrekulli, (me këshilla dhe dispozita) të përsëritura herë pas here që prej dëgjimit të tij rrënoqethen lëkurat e atyre që e kanë frikë Zotin e tyre, pastaj me përkujtimin e Allahut u qetësohen lëkurat dhe zemrat e tyre. Ky (libër) është udhëzim i Allahut, me të udhëzon atë që do. Atë që e humb Allahu, nuk ka kush ta udhëzojë.”** (ez-Zumer, 23)

Ky ajet fisnik tregon se si duhet të jenë marrdhëniet tona shpirtërore me Kur'anin Fisnik.

Dëshmia e gradës sonë të devotshmërisë është kultura jonë e Kur'anit Fisnik. Nëse Kur'ani është kultura jonë, shfaqet edhe morali i Kur'anit, që përbëhet nga sinqeriteti në adhurim, bukuria në sjellje dhe ndjeshmëria shpirtërore.

Kur'ani Fisnik është urtësia më e fortë ku njerëzit mund të mbështeten, urësi të cilën Allahu ua ka dhënë atyre që duan të fitojnë kënaqësinë e Allahut, të shpëtojnë nga të këqijat dhe nga ndëshkimi i përhershëm. Ata që mbahen te kjo urësi, shpëtojnë, lartësohen dhe nderohen. Ndërsa ata që e lënë atë, poshtërohen, nënçmohen dhe largohen nga rruga e drejtë.

Kur'ani Fisnik është një sofër gostie shpirtërore që Allahu Teala ka përgatitur për të nderuar robërit e Tij. Ata të cilët marrin pjesë në këtë gosti dhe iu përgjigjen kështu thirrjes së Zotit, shijojnë mirësitë e pafundme që u japin qetësi, gëzim dhe lumturi.

Vlera dhe nderi i vërtetë i njeriut është veprues me ligjet e Kur'anit dhe i plotë me moralin e tij. Domethënë, njeriu arrin nderin dhe vlerën



kur të kthehet te urdhërat hyjnore, te begatia dhe ndjenja shpirtërore e Kur'anit. Zoti na urdhëron që jetën dhe ndodhitë t'i meditojmë nëpërmjet logjikës së Kur'anit, duke e konceptuar Kur'anin Fisnik ashtu siç duhet, sepse është e nevojshme që mendjen tonë, e cila është shkaku i lumturisë por edhe i skamjes, ta drejtojmë kah përmbajtja e shpalljes.

Sikur të mos ishte dera e meditimit që Kur'ani Fisnik ka hapur për ne, do të ishim të mangët në konceptimin dhe shprehjen e shumë të vërtetave. Nisur nga kjo, lodhja e mendjes mbi përmbajtjen e pafundme të Kur'anit, do të bëjë të mundshme zbulimin e shumë rrugëve të hajrit.

Për të mësuar moralin e Islamit ashtu siç duhet, është e nevojshme të jemi në një gjendje me Kur'anin Fisnik dhe të përkushtohemi më shumë në të.

Në hadithet fisnike thuhet:

*“Kushdo prej jush që dëshiron t'i lutet Zotit dhe të takohet me Të, le të lexojë Kur'an me qetësi shpirtërore.”* (Sujuti, I, 13/360)

*“Lexoni Kur'an, sepse në ditën e gjykimit Kur'ani do të jetë ndërmjetësues për ata që e lexojnë.”* (Muslim, Musafirin, 252, 253; Ahmed, V, 249, 251)

*“Kush e lexon Kur'anin Fisnik dhe vepron me të, në ditën e gjykimit prindërve të tij i vishet një kurorë. Drita e kësaj kurore është më e bukur se sa drita e diellit kur bie në një shtëpi të kësaj bote. Atëherë a mund ta mendoni se si mund të jetë drita e atij që vepron vetë me Kur'anin Fisnik?”* (Ebu Davud, Vitir, 14/1453)

Të jesh në një gjendje me Kur'anin Fisnik është një nga punët e devotshme me të cilat Allahu kënaqet. I Dërguari i Allahut thotë:

*“Allahu Teala nuk është kënaqur nga asnjë gjë siç është kënaqur nga leximi i Kur'anit me zë të lartë me teganni<sup>71</sup> i një peygamberi zëbu-*

71. Teganni do të thotë, të zbukurosh Kur'anin i cili është fjala më e bukur, me një mënyrë që i ka hije, të shprehurit e gëzimit dhe hidhërimit në zë kur ta lexosh, e të lexosh hapur edhe me zë të lartë. Për më shumë detaje, shik. M. Jashar Kandemir, Ismail Lytfi Çakan, Rashit Kyçyk, Rijazu's-Salihin – Përkthim dhe Komentim-, Stamboll 2001, V, 118.



*kur.*” (Buhari, Fadailu'l-Kur'an 19, Teuhid 32; Muslim, Musafirin 232-234)

*“Allahu nuk dëgjon asgjë aq sa dëgjon një rob të Tij i cili natën fal dy rekatë namaz (dhe lexon Kur'an). Mëshira e Allahut bie mbi robin përderisa ai të jetë në namaz. Robërit kurrë nuk mund të jenë më afër Allahut se sa kur janë në një gjendje me Kur'anin.”* (Tirmidhi, Fadailu'l-Kur'an, 17/2911)

Është informuar se njerëzit të cilët harrojnë suret që i dinë, kanë hyrë në mëkat të madh.<sup>72</sup> Ai i cili nuk ka në zemrën e tij një pjesë nga Kur'ani, faktikisht është bërë si një shtëpi e shkatërruar.<sup>73</sup>

I Dërguari i Allahut (s.a.v.s) thotë:

*“Zemrat ndryshken siç ndryshket hekuri.”* Sahabët e nderuar pyetën:

*“Çfarë është ajo që e pastron atë, o i Dërguari i Allahut?”*. I Dërguari i Allahut u përgjigj:

*“Është leximi shumë i Kur'anit dhe përkujtimi shumë i Allahut.”* (Ali el-Muttaki, II, 241)

Përsëri, një ditë i Dërguari i Allahut i këshilloi sahabët e tij:

*“Jepjani syve tuaj pjesën e tyre nga adhurimi!”*

E pyetën: Kush është pjesa e syve tonë, o i Dërguari i Allahut?” I Dërguari i Allahut (s.a.v.s) tha:

*“Është shikimi në Kur'an, meditimi në atë që ndodhen në të, dhe marrja e mësimit nga imtësitë e tij.”* (Sujuti, I, 39)

Në vijim, i Nderuari ynë alejhissalatu uesselam ka thënë:

*“Sigurisht që ka nga njerëzit që janë afër Allahut!”*

Kur u pyet: “O i Dërguari i Allahut! Kush janë ata?” Ai u përgjigj:

*“Ata janë njerëzit e Kur'anit, miqtë e Allahut dhe robërit e veçantë të Allahut!”* (Ibn Maxhe, Mukaddime, 16)

72. Ebu Davud, Salat, 16/461.

73. Tirmidhi, Fadailu'l-Kur'an, 18/2913; Darimi, Fadailu'l-Kur'an, 1.





Krenaria e Gjithësisë, i Nderuari ynë gëzohej shumë kur njerëzit, të mbledhur së bashku, lexonin Kur'anin dhe përpiqeshin ta kuptonin. Kështu, për ata të cilët veprojnë në këtë mënyrë, ka thënë:

*“...Nëse një xhemat mbliidhet në një nga shtëpitë e Allahut dhe lexojnë librin e Allahut, e diskutojnë atë ndërmjet tyre dhe mundohen ta kuptojnë e konceptojnë, mbi ta zbret qetësia dhe i mblulon mëshira. Ëngjëjt i rrethojnë. Edhe Allahu Teala i kujton ata në mesin e atyre që gjenden në prani të Tij. Ndërsa atë që e ka lënë punën e mirë, nuk mund ta bëjë të përparojë soji i tij.”* (Muslim, Dhikr, 38; Ibn Maxhe, Mukaddime, 17)

Atëherë, për të fituar lumturinë e të dy botërave, duhet ta shtojmë lidhjen tonë shpirtërore me Kur'anin Fisnik. Atë duhet ta lexojmë, kuptojmë, duhet ta ndjejmë në zemër dhe duhet të përpiqemi që ligjet e tij t'i zbatojmë me sinqeritet.

### *Tabllo të virtytshme*

I Nderuari ynë alejhissalatu uesselam, e lexonte Kur'anin Fisnik ashtu siç duhet, meditonte shumë mbi kuptimin e tij dhe i zbatonte menjëherë ligjet e tij. E lexonte Kur'anin pothuajse me zemër, duke e ndjerë dhe jetuar. Kur e lexonte dhe kur kalonin ajete që flisnin për madhërimin e Allahut, ai e madhëronte Allahun me shprehje si “Subhanallah”. Kur kalonin ajete lutjesh, i lutej Allahut. Kur lexonte ajete që flisnin për kërkimin e mbrojtjes nga Allahu, menjëherë kërkonte mbrojtje nga Ai.<sup>74</sup>

Pejgamberi ynë i Nderuar alejhissalatu uesselam çdo ditë lexonte Kur'anin Fisnik në mënyrë të rregullt.<sup>75</sup> Evs bin Huzejfe radijallahu anhu, i cili gjendej në delegacionin e Fisit Sakif dhe që po vinte në Medine, tregon kështu:

“Një natë pas jacie, i Dërguari i Allahut (s.a.v.s) nuk erdhi te ne për një kohë të gjatë. E pyetëm:

74. Shik. Muslim, Musafirin, 203; Nesai, Kijamu'l-Lejl, 25.

75. Muslim, Musafirin, 142; Ahmed, IV, 9; Ibn Maxhe, Salat, 178.



-O i Dërguari i Allahut! Përse u vonove për të ardhur te ne? Pejgamberi, i Nderuari ynë tha:

-Ja kam bërë detyrë vetes që të lexoj çdo ditë një hizb (pjesë) nga Kur'ani dhe nuk desha të vija derisa ta mbaroja këtë.

Kur zbardhi mëngjesi, i pyetëm sahabët e nderuar: Si e lexoni Kur'anin duke e ndarë në pjesë? Ata thanë:

-Ne e lexonim Kur'anin Fisnik (në shtatë pjesë) duke i bërë një hizb tre suret e para, pastaj pesë suret në vazhdim një hizb, pastaj bënin një hizb duke i bashkuar me rradhë shtatë, njëmbëdhjetë dhe trembëdhjetë sure. Më në fund, suret nga sureja Kaf deri në fund i bënim një hizb.” (Ahmed, IV, 9; Ibn Maxhe, Salat, 178)



Abdullah bin Mes'ud radijallahu anhu transmeton:

Njëherë Pejgamberi (s.a.v.s) më urdhëroi:

*“O Ibn Mes'ud! Lexo Kur'an për mua!”* Unë i thashë:

“O i Dërguari i Allahut! A unë të lexoj Kur'an Ty, kur Ty të shpallet ai?”

I Dërguari i Allahut (s.a.v.s) tha:

*“Më pëlqen ta dëgjoj Kur'anin nga dikush tjetër.”*

Unë fillova të lexoj suren Nisa. Kur arrita te ajeti fisnik:

**“Si do të jetë gjendja e atyre (që nuk besuan) kur ne do të sjellim dëshmitarë për çdo popull dhe ty do të të sjellim dëshmitarë mbi ta (që nuk të besuan)?”** (en-Nisa, 41), i Dërguari i Allahut (s.a.v.s) tha:

*“Mjafton!”*

Në atë çast pashë se nga sytë e të të Dërguarit të Allahut po rridhin lotët si perla.” (Buhari, Tefsir, 4/9; Muslim, Musafirin, 247)

Sa panoramë e bukur kjo në të cilën shfaqet mëshira e të Nderuarit tonë ndaj nesh që jemi ummeti i tij...



Një ditë, kur nëna jonë Hazreti Aishe u vonua për të shkuar te i Dërguari i Allahut, i Nderuari ynë e pyeti për shkakun. Ajo u përgjigj:

“O i Dërguari i Allahut! Në xhami ishte një burrë, i cili lexonte Kur’an. Nuk kam parë njeri të lexojë Kur’an më mirë se ai.”, duke e vënë kështu në dijeni se shkakun e vonimit ishte dëgjimi i Kur’anit. Pastaj, duke shkuar në xhami, i Nderuari ynë pa se ai person ishte Salim radijallahu anhu. I Dërguari i Allahut u shpreh kështu:

*“Falenderimi i takon Allahut i cili i dha ummetit tim një person të tillë!”* (Ibn Maxhe, Ikamet, 176; Ahmed, VI, 165; Hakim, III, 250/5001)



Një sahabi e pyeti të Dërguarin e Allahut (s.a.v.s):

“O i Dërguari i Allahut! Cila punë është më e dashur te Allahu?” I Dashuri ynë i nderuar u përgjigj:

*“Vepra (puna) e hal-it dhe murtehil-it.”* Kur sahabinu pyeti:

“-Mirë, kush është hal-i dhe murtehil-i?”. I Nderuari ynë tha:

*“Është ai i cili e lexon Kur’anin nga fillimi në fund dhe sa herë ta mbarojë kthehet përsëri në fillim dhe vazhdon leximin.”* (Tirmidhi, Kiraat, 11/2948)

Duke u mbështetur në urtësinë për të arritur mirësinë që bëhet fjalë në këtë hadith fisnik, në lutjet e hatmes pas leximit të sures Ihlas, Felek dhe Nas të cilat janë suret e fundit të Kur’anit, duke u kthyer përsëri në krye të Kur’anit, lexohet sureja Fatiha dhe pesë ajetet e para të sures Bakara. Në këtë mënyrë, kjo punë e mirë e cila është e pranuar te Allahu, praktikohet menjëherë duke filluar një hatme të re.



I Dërguari i Allahut (s.a.v.s) i jepte shumë rëndësi Kur’anit Fisnik dhe i donte shumë ashabët që përkushtoheshin në lexim.

Një herë, Pejgamberi ynë i Nderuar do të dërgonte një grup ushtarak që ishte i madh në numër. Ata i urdhëroi të lexojnë Kur’an. Secili lexoi nga ajetet e Allahut që i kishte mësuar përmendësh. I Nderuari



ynë erdhi pranë sahabiut që ishte më i riu në moshë dhe i tha:

*“O filan! Çfarë di përmendësh?”*. Ai tha:

*“Unë di përmendësh këtë këtë sure dhe suren Bakara!”* I Nderuari ynë e pyeti:

*“A e di përmendësh suren Bakara?”*

Kur mori përgjigjen “Po!”, i Dërguari i Allahut tha:

*“Shko, ti je komandanti i tyre, sepse kjo sure pothuajse e përmbledh të gjithë fenë.”*

Njëri nga prijësit e xhematit tha:

*“O i Dërguari i Allahut! Frika se nuk do ta praktikoj në jetë përmbajtjen e saj, më ka ndaluar që ta mësoj suren Bakara.”*

Mbi këtë i Dërguari i Allahut (s.a.v.s) tha:

*“Mësojeni Kur’anin, lexojeni, mësojuani të tjerëve dhe punoni me të, sepse ai që e mëson Kur’anin, e lexon dhe punon me të, është si një çantë e mbushur me misk, kundërmimi i të cilit shpërndahet në çdo anë. Ai që e mëson Kur’anin dhe flen (e lë shërbimin e Kur’anit), është si një çantë e mbushur me misk por që i është lidhur gryka.”*  
(Tirmidhi, Fadailu'l-Kur’an, 2/2876)

Kjo ngjarje shfaq gradën e fitimit material dhe edukimit shpirtëror të një personi i cili e lexon dhe e jeton suren Bakara. Përsëri nëpërmjet një hadithi fisnik, i Nderuari ynë alejhissalatu uesselam shfaq përgjegjësinë e besimtarit për të qenë në një gjendje me Kur’anin dhe përgjegjësinë në çështjen e mësimin të tij.



Kur mësonin dhjetë ajete nga i Dërguari i Allahut, ashabët e nderuar nuk kalonin në dhjetë ajetet e tjera, pa i kuptuar dhe pa i zbatuar në jetën e tyre urdhërat dhe urtësitë që gjenin në to. Ata punonin me dijen që ishte në Kur’an, dhe po ashtu u bënë të përsosur me urtësitë Kur’anore. (Ahmed, V, 410)



“Suren Bakara e kam plotësuar në dymbëdhjetë vjet dhe si falenderim për këtë kam bërë kurban një deve.”<sup>76</sup>

Edhe Abdullah bin Omer radijallahu anhu, suren Bakara mund ta mbarojë në tetë vjet. (Muvatta, Kur'an, 11)

Nëse bëhet për të lexuar, praktikuar dhe mësuar të tjerëve Kur'anin, kjo shpreh një vlerë.



Përfaqësuesit e fisit Sakif, të cilët kishin ardhur për t'u takuar me Pejgamberin tonë të Nderuar, Othman bin Ebi'l-Asin e linin te kafshët e tyre, për shkak se ishte më i riu në moshë. Kur përfaqësuesit ktheheshin te ai dhe kur flinin në vapën e drekës, Othmani radijallahu anhu shkante te Pejgamberi, i bënte pyetje fetare, dëgjonte dhe mësonte Kur'anin Fisnik. Kështu që, duke i lexuar, i mësonte disa sure përmendësh nga i Nderuari ynë.

Othmani radijallahu anhu, i cili më përpara, duke dhënë besën fshehtas bëhet musliman, kur vinte për të mësuar Kur'an, nëse i Dërguari i Allahut (s.a.v.s) nuk ishte i lirë, shkante te Ebu Bekri ose te Ubej bin Ka'b, pyeste atë që kishte për të pyetur dhe mësonte atë që donte.

I Dërguari i Allahut e pëlqente këtë dhe e donte Othmanin. Kur përfaqësuesit e Sakifit deshën të ktheheshin në vendin e tyre, thanë:

“O i Dërguari i Allahut! Bëje njërin prej nesh imam (prijës)!”

Edhe i Dërguari i Allahut u vendosi prijës atyre Othman bin Ebi'l-As, edhe pse ishte më i riu në moshë. (Ibn Sa'd, V, 508; Ibn Hisham, IV, 185; Ahmed, IV, 218)



Ajetet e Kur'anit, të cilat zbritnin pjesë-pjesë dhe duke u mbështetur në shkaqe të ndryshme, sa herë që zbrisnin u jepnin shumë gëzim të Dërguarit të Allahut dhe ashabëve të tij, duke ua shtuar vendosmërinë dhe duke ua ripërtërirë lidhjet shpirtërore që kishin me Allahun.

76. Kurtubi, el-Xhami li-Ahkami'l-Kur'an, Beirut 1985, I, 40.



Ata ishin njësuar aq shumë me shpalljen, saqë ndërprerja e shpalljes, pas të Nderuarit tonë, ua shtonte edhe më shumë brengën e tyre. Shembullin më tërheqës të kësaj dashurie e shikojmë në këtë ngjarje:

Pas vdekjes së të Dërguarit të Allahut (s.a.v.s), Hazreti Ebu Bekr i tha Omerit radijallahu anhu:

“Ngrehu të shkojmë te kushërira e të të Dërguarit të Allahut, Ummu Ejmen, dhe ta vizitojmë ashtu siç ka vepruar i Dërguari i Allahut.”

Kur shkuan te Ummu Ejmen radijallahu anha, ajo filloi të qajë. Ata i thanë:

“Përse qan? A nuk e di se i Nderuari ynë ka më shumë mirësi te Allahu?” Ummu Ejmen tha:

“Unë prandaj po qaj. Sigurisht që e di se i Nderuari ynë ka më shumë mirësi te Allahu. Unë po qaj për shkak se është ndërprerë shpallja.”

Me këto fjalë, përmes të cilave shprehu mallin e saj për shpalljen hyjnore, ajo mallëngjeu edhe Ebu Bekrin e Omerin. (Muslim, Fadailu's-Sahabe, 103)



Ashabët e të Nderuarit tonë e lexonin shumë Kur'anin dhe nuk donin që t'u kalonte as dhe një ditë pa e lexuar ose pa hedhur një sy nëpër faqet e tij. Ata e fillonin ditën me Kur'an dhe për shqetësimet e syrit këshillonin që të shikonin Mushafin Sherif. (Hejsemi, VII, 165)

Hazreti Othman radijallahu anhu, i cili lavdërohet me cilësinë “Xhamiu'l-Kur'an” (Mbedhësi i Kur'anit) për shkak të shërbimit që i bënte Kur'anit, ka vjetëruar dy mushafë për shkak se përkushtohej shumë me Kur'anin Fisnik.<sup>77</sup>



Usejd bin Hudajr radijallahu anhu tregon:

77. Kettani, Nizamu'l-Hukumeti'n-Nebeuijke (et-Teratibu'l-Idarije), Beirut 1996, II, 197.



Një natë po lexoja suren Bakara. Kali im ishte i lidhur afër meje. Papritmas kali filloi të nervozohet. E ndërpreva leximin dhe kali u qetësua. Përsëri fillova të lexoj, përsëri kali filloi të nervozohet, aq sa birin tim Jahjanë e mora pranë, nga shqetësimi se mos e shtyp kali. Në atë çast, kur hodha sytë kah qielli, pashë mbi vete disa gjëra që u ngjanin kandilave. Pastaj ata u ngritën në qiell dhe u humbën nga sytë.

Kur u bë mëngjes dhe kur ia tregova atë që ndodhi të Dërguarit të Allahut (s.a.v.s), më tha:

*“Lexo o Usejd, lexo!”* Pastaj më pyeti:

*“O Usejd! A e di se çfarë ishin ata që i ke parë?”*

I thashë: “Jo.” Në lidhje me këtë, i Dërguari i Allahut tha:

*“Ata ishin engjëj që kanë ardhur për të dëgjuar leximit të Kur’anit. Sikur ta kishe vazhduar leximin, ata do të të dëgjonin deri në mëngjes. Ata, duke mos qëndruar fshehtas ndaj njeriut, edhe njerëzit mund t’i shohin.”* (Buhari, fadailu’l-Kur’an 15, Menakib 25; Muslim, Musafirin 241-242)



Një ditë i Dërguari i Allahut (s.a.v.s), i tha Ubej bin Ka’bit, i cili ishte i dashuruar me Kur’anin:

*“Allahu Teala më urdhëron të të lexoj ty suren Lem jekunilledhine keferu.”*

Ubej bin Ka’b radijallahu anhu tha:

*“A e ka përmendur emrin tim Allahu Teala?”*

I Dërguari i Allahut (s.a.v.s) tha:

*“Po.”*

Ubej bin Ka’b radijallahu anhu u ndikua shumë dhe ia shkrepiti të qarit, i prekur nga ky lavdërim hyjnor. (Buhari, Menakibu’l-Ensar 16, Tefsir 98/1, 3; Muslim, Musafirin 246)

Ubej bin Ka’b vinte në krye të sahabëve hafiza që e mësonin Kur’anin komplet. Ishte njëri nga fatlumët që fituan lavdërimin e Pejgamberit, “Mësojeni Kur’anin nga katër vetë!”. Ai e lexonte më



bukur dhe më shumë Kur'anin.<sup>78</sup> Ja Ubej radijallahu anhu, i cili në këtë mënyrë ishte në një gjendje të njësuar me Kur'anin fisnik, fitoi mirësi, nder, dinjitet, por edhe lavdërim hyjnor, gjë që e kanë kismet disa njerëz të numëruar, përveç pejgamberëve. Sa dinjitet i madh, sa lumturi e madhe!..



Duke e shkrirë dashurinë e Kur'anit dhe përmbajtjen e tij në botën e zemrës, si në çdo çështje tjetër ashtu edhe në çështjen për të jetuar një jetë Kur'anore ashabët e nderuar ecnin në gjurmët e të Dërguarit të Allahut. Kinane el-Adevi rahimehullah tregon:

Omer bin Hattab radijallahu anhu u shkruajti komandantëve të ushtrisë:

“Identifikoni ata që e kanë mësuar përmendësh Kur'anin dhe m'i tregoni mua, t'i nderoj, t'u jap të mira dhe t'i dërgoj rreth e rrotull ashtuqë t'jua mësojnë Kur'anin njerëzve.”

Ebu Musa el-Esh'ari njoftoi së nën administrimin e Hazretit Omer kishte 300 e më shumë hafiza. Një pjesë e këshillave që zinin vend në letrën që Hazreti Omer u shkruajti atyre hafizave<sup>79</sup>, vijnë kështu:

“Dijeni se Kur'ani për ju është një thesar sevapi dhe nderi. **Ndiqeni atë. Mos e komentoni Kur'anin sipas interesave tuaja. Kush e komenton Kur'anin sipas interesave vetjake, Kur'ani e rrëzon dhe e hedh atë në xhennem.** Kush e ndjek Kur'anin, Kur'ani e dërgon atë në xhennetin Firdeus. Nëse keni mundësi, mundohuni që ta bëni Kur'anin ndërmjetësuesin tuaj dhe jo armikun tuaj, sepse ai për të cilin Kur'ani bëhet ndërmjetësues, shkon në xhennet dhe ai ndaj të cilit Kur'ani ankohet, shkon në xhennem. Dijeni se Kur'ani është burimi i udhëzimit dhe dija më e shkëlqyer. Ai është libri më i fundit që ka ardhur nga Rrahmani dhe me të hapen sytë e verbuar, veshët e shurdhër dhe zemrat e kyçura...” (Ali el-Muttaki, II, 285-286/4019)



78. Buhari, Fadailu'l-Kur'an, 8.

79. Në atë kohë termi “Hamele-i Kur'an: Hafizat e Kur'anit” përdorej për dijetarët që i dinin edhe fjalët edhe përmbajtjen e Kur'anit.





Shërbëtori shpirtëror dhe i mençur i të Dërguarit të Allahut, Enes bin Malik radijallahu anhu, kur e bënte hatme Kur'anin Fisnik, mblihdhte tërë familjen e tij për të bërë duanë e hatmes.<sup>80</sup>



Omer bin Hattab radijallahu anhu, e herë herë Ebu Musa el-Esh'ari i cili e kishte zërin shumë të bukur dhe e lexonte Kur'anin në një mënyrë të shkëlqyer, i thoshte:

“O Ebu Musa! Eja dhe na kujto Zotin tonë!”

Edhe ai lexonte Kur'an.<sup>81</sup>

Edhe një herë i kishte thënë Ebu Musa el-Esh'ari:

“O vëllai im! Na e shto dashurinë ndaj Zotit tonë!”

Edhe ai filloi të lexojë Kur'an. Pasi lexoi një farë kohe, Hazreti Omerin e thirrën për në namaz. Halifeja i cili po e dëgjonte Kur'anin me një hushu të thellë, menjëherë, duke ardhur në vete, tha:

“Në fakt a nuk ishim në namaz?” (Ibn Sa'd, IV, 109)



Kur u pyet Nafi, skllavi i liruar i Abdullah bin Omerit:

“Çfarë bënte Abdullahu në shtëpinë e tij?”, ai tha:

“Njerëzit nuk mund të bëjnë atë që bënte ai! Ai për çdo kohë namazi merrte abdes të ri dhe ndërmjet këtyre dy kohëve hapte Mushafin Sherif dhe vazhdimisht e lexonte.” (Ibn Sa'd, IV, 170).



Hafizat e vërtetë që ishin në një gjendje të njësuar me Kur'anin Fisnik, fitojnë shumë nderime hyjnore edhe në këtë botë, edhe në ahiret. Kështu, Mahmud Sami Ramazanoglu kuddise sirruhu, i cili ishte nga miqtë e Allahut, ka transmetuar si një dëshmitar që e ka parë vetë, se nga nevoja e domosdoshme për të ndërtuar një rrugë, në Adana

80. Ibn Ebi Shejbe, el-Musannef (Hut), Rijad 1409, VI, 128.

81. Ibn Sa'd, IV, 109; Ebu Nuajm, Hiljetu'l-Evlja, Bejrut 1967, I, 258.



është hapur pas tridhjetë vjetësh varri i një hafizi që kishte vdekur me këtë cilësi, por qe vënë re se trupi i tij nuk ishte prishur fare dhe mbi të gjitha qefini i tij ishte i pastër.

Në hadithin fisnik thuhet:

“Kur vdes një hamil-i Kur’an (një hafiz i nderuar që jeton me ligjet e Kur’anit, që edukohet me moralin e Tij dhe që arrin përsosmërinë me urtësinë e Tij) Allahu urdhëron tokën që të mos ia hajë trupin. Edhe toka thotë:

O Zoti im! Si mund ta ha unë trupin e tij kur ai është në gjirin tënd?..” (Dejlemi, I, 284/1112; Ali el-Muttaki, I, 555/2488)



Ne duhet të sillemi shumë të ndjeshëm dhe të përpiktë në çështjen e edukatës dhe respektit ndaj Kur’anit Fisnik, i cili është fjala e Zotit tonë, sepse po jetojmë në një kohë kur kemi më shumë nevojë për virtytin dhe ndjenjën shpirtërore të Kur’anit.

Përshebull, është e nevojshme që të mos lexojmë Kur’an pa abdes dhe të mos ua mësojmë të tjerëve atë pa abdes, sepse në ajetin fisnik thuhet haptaz dhe prerë:

**“Atë nuk e prek kush përveç të pastërve.”** (el-Vakia, 79)

Në këtë ajet bëhet fjalë për abdesin e vogël, abdesin e madh dhe për gjendjet e caktuara të grave (domethënë gjendjet e menstruacioneve dhe lehonisë). Edhe të katër medhhebet e vërtetë kanë rënë dakort se është haram ta prekësh Kur’anin pa abdes.<sup>82</sup>

Në fakt ky ligj është praktikuar kështu që nga Hazreti Pejgamber deri 1400 vjet e më shumë. Në hadithet fisnike thuhet:

*“Asnjë grua me menstruacione dhe asnjë burrë që është xhunub nuk mund të lexojë asgjë nga Kur’ani.”* (Tirmidhi, Taharet, 98/131)

*“Askush të mos e prekë Kur’anin përveç atij që është i pastër!”* (Hakim, I, 553/1447)



Kur i Dërguari i Allahut (s.a.v.s), po e dërgonte Amr bin Hazmin në Jemen, i shkruajti një deklaratë që sqaronte farzet, sunnetet dhe ligjet juridike. Në atë shkrim, krahas urdhërimit që njerëzve tua mësojë Kur'anin, urdhërat dhe urtësitë e tij, Hazreti Amr **njoftohet që të ndalojë njerëzit që nuk janë të pastër nga prekja e Kur'anit.**<sup>83</sup>

Imam Maliku thotë:

“Një person që nuk është i pastër (ai që nuk ka abdes) nuk mund ta mbajë Kur'anin qoftë edhe me këllëfin e tij ose mbi jastëk. Është mekruh... Kjo është për shkak të nderimit dhe lartësimit të Kur'anit.” (Muvatta, Kur'an, 1)

Nga ana tjetër është e nevojshme që ta kryejmë me entuziazëm e adhurimin çdo lloj nderi dhe respekti si, mosmbajtja e Kur'anit Fisnik në një pozitë poshtë belit, moszgjatja e këmbëve drejt tij, mosvendosja e ndonjë libri apo ndonjë gjëje tjetër mbi të dhe mos hyrja me Kur'anin Fisnik në tualet, dhe këtë përpikmëri t'ua transmetojmë brezave të rinj, sepse Kur'ani Fisnik është nga “Sheairu'l-Islam” më të rëndësishme, domethënë, vjen në krye të simptomave të Islamit. Ndërsa në ajetin fisnik thuhet:

وَمَنْ يُعْظَمِ شَعَائِرَ اللَّهِ فَإِنَّهَا مِنْ تَقْوَى الْقُلُوبِ

“...Kush madhëron dispozitat e Allahut, padyshim që kjo është nga devotshmëria e zemrave.” (el-Haxh, 32)

Së fundi, Kur'ani Fisnik është një libër hyjnor i dërguar për t'ua mësuar njerëzve rrugën e drejtë, për t'ua mësuar çështjet që nuk mund t'i mësojnë me përpjekjet e tyre dhe për të fituar ahiretin. Atëherë le të kapemi pas tij dhe t'i dalim zot, sepse është rruga më e mençur ku mund të kapemi.

Ja si tregohet në hadithin fisnik mirësia e të qenit në gjendje njësimi me Kur'anin:

*“Kur'ani është si një litar i fortë, njëri skaj i të cilit është në dorën e Allahut dhe skaji tjetër është në dorën tuaj. Kapuni shumë pas tij. Ja*

83. Muvatta, Kur'an, 1; Kettani, I, 216.



*atëherë nuk devijoni dhe nuk shkatërroheni.*” (Hejsemi, IX, 164)

Aq sa mund të marrim ndjesi dhe begati nga Kur’ani, edhe besimi ynë fiton po aq gradë. Ata që e zbatojnë Kur’anin Fisnik në mënyrë të përpiktë, duke fituar kënaqësinë e Allahut dhe kënaqësinë e të Dërguarit të tij, fitojnë mirësi hyjnore që janë të pakonceptueshme nga ana e njeriut. **Allahu na e dhashtë dhe lehtësoftë të gjithë neve këtë gjendje.**

**Amin!..**

## **8. Përkujtimi i Allahut dhe salavatet fisnike**

Sipas një mendimi, fjala “Insan” (njeri) vjen nga e njëjta rrënjë me fjalën “nisjan” domethënë harresë. “Nisjan” është e kundërta e dhikrit (përkujtimit) dhe shpreh harresën që është njëra nga dobësitë më të mëdha të njeriut. Për kompensimin e dëmeve të “nisjanit”, që gjendet në natyrën e njeriut dhe me qëllim që të mbahet gjithmonë i gjallë dhe aktiv konceptimi i “Allahut” dhe i “adhurimit” ndaj Tij, para së gjithash është i nevojshëm dhikri, sepse çdo përkujtim e forcon vendin e asaj që përmendet në konceptim dhe në bindje.

Fjala *dhikër* në Kur’anin Fisnik përmendet më shumë se në dyqind e pesëdhjetë vende, për shkak të rëndësisë së çështjes në detyrat e adhurimit, sepse adhurimi në kuptim të vërtetë ndaj Allahut dhe arritja përmes kësaj mënyre te njësimi i Allahut, realizohet në lidhje me thellësinë e pozitës dhe ndjesisë që dhikri ka fituar në zemër. Për këtë arsye, Zoti ynë i lartë thotë:

**“Përkujtoje Zotin tënd në vete me respekt dhe frikë pa zë të lartë, (përmende) në mëngjes dhe në mbrëmje dhe mos ji prej atyre që nuk janë të kujdesshëm!”** (el-A’raf, 205)

**“...Sigurisht që përkujtimi i Allahut është (adhurimi) më i madh...”** (el-Ankebut, 45)

**“Besimtarët e përmendin gjithmonë Allahun, kur janë në këmbë, kur janë ulur dhe kur janë shtrirë...”** (Ali Imran, 191)



Zemra që është në pozitën e sunduesit te gjithësisë që egziston, kur arrin një përndritje të atillë sa të mund ta ndajë të vërtetën nga e gabuara duke u ngjallur me përkujtimin e Allahut, mbërrin në gjendjen e një busulle busulle që e drejton trupin kah Allahu dhe kah e mira. Atëhere arrin t'i ketë organet nën sundim dhe t'u japë urdhërat e duhura. Së fundi, arrihet qëndrueshmëria e një adhurimi me të cilin Allahu është i kënaqur.

Ja si e shpjegon virtytin e dhikrit i Dërguari i Allahut (s.a.v.s):

*“Shembulli i atij që e përmend Allahun me atë që nuk e përmend është si i gjalli me të vdekurin.”* (Buhari, Deavat, 66)

Po ashtu, ata që janë larg dhikrit gjenden nën kërcënimin hyjnor, për shkak se janë edhe larg dashurisë së Allahut. Në ajetin fisnik thuhet:

**“O ju që keni besuar! Kujdes, as pasuria juaj dhe as fëmijët tuaj të mos iu shmangin prej përkujtimit të Allahut! Kush vepron kështu, janë prej të humburve.”** (el-Munafikun, 9)

**“...Mjerë për ata që nuk e përmendin Allahun nga zemërfortësia!..”** (ez-Zumer, 22)

**“Kush është neglizhent nga përkujtimi i Rahmanit, atij i shoqërojmë një djall që nuk i ndahet kurrë.”** (ez-Zuhruf, 36)

**“Kush ia kthen shpinën përkujtimit tim, ai do të ketë një jetë të vështirë dhe në ditën e gjykimit do ta ringjallim të verbër.”** (Taha, 124)

Për shkak të rreziqeve të mëdha që ka neglizhenca e dhikrit të Allahut, Allahu na ka qortuar shumë ne robërve të tij.

Në njërën nga këto thotë:

**“A nuk ka ardhur koha që zemrat e atyre që besuan të zbuten me dhikrin e Allahut dhe me të vërtetën (Kur'anin) që zbriti?..”** (el-Hadid, 16)

Ky ajet ka zbritur për të qortuar një pjesë të sahabëve që u liruan për shkak të riskut të bollshëm dhe mirësive që arriten pas hixhre-



tit, mbasi patën jetuar me vështirësi dhe vuajtje në Mekë. (Shik. Sujuti, Lubab, II, 151-152)

Kur i dërgoi te faraoni për të predikuar fenë e tyre Hazreti Musanë dhe Harun alejhimusselam, që ishin pejgamberë, Allahu tha:

**“Shko me argumentet e mia ti dhe vëllai yt dhe mos jini neglizhentë në përkujtimin tim.”** (Taha, 42) Kështu, duke i qortuar edhe ata në çështjen për të mos qëndruar larg dhikrit, ka dëshiruar të na japë ne shembull dhe mësim.

Në lidhje me domosdoshmërinë e dhikrit dhe të meditimit të Allahut në çdo çast, i Dërguari i Allahut (s.a.v.s) ka thënë kështu:

*“Mos Humbni në biseda të padobishme duke e harruar Allahun, sepse shumë biseda që bëhen duke e harruar Allahun, e ngurtësojnë zemrën. Ai që është më larg Allahut, është ai që e ka zemrën e ngurtë.”* (Tirmidhi, Zuhd, 62/2411)

Për zemrat besimtare të cilat shpëtojnë nga ngurtësia e neglizhencës, rruga për të arritur ndjesinë e të fituarit të kënaqësisë hyjnore kalon nga “dhikri daimi” (përkujtim i përhershëm). Kjo është e mundur me mbartjen e ndërgjegjes së dhikrit të Allahut gjatë gjithë jetës dhe në çdo frymëmarrje dhe jo për një kohë apo periudhë që vetëm për shkak të kësaj lind mosneglizhenca shpirtërore.

Po ashtu nëna jonë, Hazreti Aishe, ka thënë:

“I Dërguari i Allahut (s.a.v.s) e përkujtonte në çdo çast Allahun Teala.” (Muslim, Hajz, 117)

Kështu, kur Ibn Abbas radijallahu anhu komentoj ajetin:

**“O ju që keni besuar! Përkujtojeni shumë Allahun!”** (el-Ahzab, 41), tha:

“Allahu Teala çdo adhurimi që ua ka bërë farz njerëzve, i ka caktuar një kufi. Në këtë çështje i ka pranuar edhe arsyet e tyre, por dhikri është jashtë këtyre. Për dhikrin Allahu Teala nuk ka caktuar ndonjë kufi, fundi i të cilit mund të arrihet. Askujt nuk ia pranon arsyen e lënies së dhikrit, përveç atij që është me të meta mendore. Allahu i ka



urdhëruar njerëzit që ta përkujtojnë në çdo lloj mënyre.”<sup>84</sup>

Krenaria e Gjithësisë, i Nderuari ynë (s.a.v.s), ka urdhëruar kë-shtu në lidhje me dhikrin dhe në lidhje me qëndrimin e atyre që bëjnë dhikër:

*“Të ulesh bashkë me një xhemat që i bën dhikër Allahut nga koha e namazit të mëngjesit e derisa të lindet dielli, mua më duket më e dashur se sa të lirosht nga robëria katër vetë nga bijtë e Ismailit. Përsëri, të jesh bashkë me një xhemat që e përkujton Allahun nga koha e namazit të iqindisë deri sa të perëndojë dielli, mua më duket më e dashur se sa të lirosht katër vetë.”* (Ebu Davud, Ilim, 13/3667)

Nga ana tjetër, edhe salavatet fisnike që ia dërgojmë Pejgamberit, të Nderuarit tonë, janë nga tërësia e dhikrit. Allahu thotë:

**“Është e vërtetë që Allahu dhe ëngjëjt e tij i Dërgojnë salavate Pejgamberit. O ju që keni besuar! I dërgoni pra salavate atij dhe përshëndeteni me selam.”** (el-Ahzab)

I Nderuari i Botrave e shpreh në këtë mënyrë vlerën e salavateve:

**“Kush më dërgon mua një salavat, për këtë shkak Allahu Teala i dërgon atij dhjetë herë salavate si ai (që më ka dërguar mua),<sup>85</sup> i fshihen dhjetë gabime dhe ngrihet dhjetë shkallë.”**  
(Nesai, Sehv, 55)

*“Njerëzit që do të jenë më afër meje në ditën e kiametit, janë ata të cilët më kanë dërguar mua më shumë salavate.”* (Tirmidhi, Vitir, 21/484)

Krahas kësaj, si shtesë e adhurimeve, siç janë namazi, tespihet, madhërimi i Allahut, tekbiri, tehlili (të thuash La Ilahe Illa Allah) kërkimi i faljes, veçanërisht leximi i Kur’anit Fisnik e meditimi mbi ajetet është një dhikër.

84. Taberi, Xhamiu’l-Beyan an Te’vili Aji’l-Kur’an, Bejrut 1995, XXII, 22; Kurtubi, XIV, 197.

85. Muslim, Salat, 70.



## Tabllo të virtytshme

Hazreti Aishe radijallahu anha tregon se kur i Dërguari i Allahut (s.a.v.s) ngrihej natën për adhurim, bënte dhikër dhjetë herë “Allahu ekber”, “elhamdulillah”, “subhanallahi ue bihamdih” dhe pastaj bënte lutje në këtë mënyrë:

اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ مِنْ ضَيْقِ الدُّنْيَا وَضَيْقِ يَوْمِ الْقِيَامَةِ

“O Allah! Kërkoj mbrojtje nga Ti prej vështirësive dhe vuajtjeve të kësaj bote dhe të botës tjetër.”, pastaj fillonte të falte namaz. (Ebu Davud, Edeb, 101/5085)



I Dërguari i Allahut (s.a.v.s) i donte më shumë dhikret dhe lutjet që ishin me fjalë të shkurtëra dhe me kuptim të gjërë. Një ditë, pasi fali namazin e mëngjesit, kur nëna jonë Xhujejrije radijallahu anha ishte e ulur në vendin e saj të faljes së namazit, i Nderuari ynë alejhissalatu uesselam doli herët nga shtëpia. Paradite kur u kthye në shtëpi, pa se Hazreti Xhujejrije ndodhej akoma e ulur në vendin e saj. E pyeti:

“A ke qëndruar vetëm këtu dhe je prkushuar me dhikër që kur ika prej teje e deri tani?” Kur nëna jonë e Nderuar u përgjigj : “Po”, Pejgamberi i Nderuari ynë tha:

“Këto katër fjali që i kam thënë tri herë pasi u ndava nga ti, nëse i peshojmë me dhikrin që ke bërë ti që nga mëngjesi, janë barazim me to nga aspekti i sevapit:

سُبْحَانَ اللَّهِ وَبِحَمْدِهِ عَدَدَ خَلْقِهِ وَرِضَا نَفْسِهِ وَزِينَةَ عَرْشِهِ وَمِدَادَ كَلِمَتِهِ

“E falënderoj dhe e lartësoj Allahun sa numri i krijesave, aq sa të kënaqet, sa pesha e Arshit dhe sa numri i fjalëve të tij që nuk mbarojnë dhe nuk përfundojnë.” (Muslim, Dhikr, 79)





I Dërguari i Allahut (s.a.v.s) ka thënë:

*“Ka dy fjali që për gjuhën janë të lehta, por në peshore janë të rënda dhe Allahu i cili është Mëshirues, kënaqet me to:*

سُبْحَانَ اللَّهِ وَبِحَمْدِهِ سُبْحَانَ اللَّهِ الْعَظِيمِ

*“E lartësoj dhe e fanderoj Allahun. E lartësoj dhe e fanderoj Allahun i cili është i madhërishtëm.”* (Buhari, Deavat 65, Ejman 19, Tevhid 58; Muslim, Dhikr 31)

Allahu do që zemra e robit të Tij të jet bashkë me Të në çdo moment. Kështu, në ajetin fisnik thuhet: **“...Ata (në çdo kohë) bëjnë dhikër kur janë në këmbë, ulur dhe shtrirë...”** (Ali Imran, 191) Ndërsa në hadithet fisnike të mësipërme shprehet madhështia e virtytit të tespive që bëhen dhe madhësia e shpërblimit. Domethënë, nga njëri aspekt janë për të frikësuar dhe për të inkurajuar. Nisur nga kjo, sipas ajeteve dhe haditheve fisnike është e domosdoshme që të bëjmë dhikër gjithmonë dhe të mos e kufizojmë dhikrin e Allahut vetëm me tespiket.



Abdullah bin Büsr radijallahu anhu tregon:

Dy bedevi (fshatarë arabë) erdhën te i Dërguari i Allahut që ta pyesnin për diçka. Njëri prej tyre tha:

“O i Dërguari i Allahut! Cili është më i miri i njerëzve?” I Dërguari i Allahut (s.a.v.s) tha:

*“Është ai i cili e ka jetën e gjatë dhe që bën vepra të mira.”* Tjetri tha:

“O i Dërguari i Allahut! Ligjet e Islamit janë shumë, më thuaj një vepër që të mos i ndahem asaj.” I Dërguari i Allahut alejhissalatu uesselam tha:

*“Gjuha jote le të jetë e lagur gjithmonë me dhikrin e Allahut.”* (Ahmed, IV, 188)

Përkujtimi i përhershëm i Allahut nga besimtari, sipas këshillave që ka dhënë i Nderuari ynë alejhissalatu uesselam, do ta mbrojë besimtarin



nga neglizhenca dhe harresa, por edhe do të bëhet shkak për shtimin e bindjes dhe nënshtrimin të tij ndaj urdhërave dhe ndalesave të Allahut. Në të njëjtën kohë, dhikri është një shkak forcimi dhe begatie që e shton dëshirën e besimtarëve në çështjen e zbatimit të ligjeve fetare.



Një sahabi, duke ardhur te i Dërguari i Allahut (s.a.v.s), e pyeti:

“Cili xhihad e ka shpërblimin më të madh?”. Pejgamberi i Nderuari ynë tha:

*“Xhihadi i atij që e përkujton më shumë Allahun!”* Burri pyeti:

“Cili agjërim e ka shpërblimin më të madh?”. I Nderuari ynë tha:

*“Agjërimi i atij që e përkujton më shumë Allahun!”*

Pastaj burri përsëri të njëjtën pyetje edhe për ata që falin namaz, për ata që japin zekatin, për ata që shkojnë në haxh dhe për ata që japin lëmoshë. Krenaria e Gjithësisë, i Nderuari ynë (s.a.v.s), për të gjitha këto pyetje u përgjigj:

*“I atij që e përkujton më shumë Allahun!”*

Në lidhje me këtë, Ebu Bekri radijallahu anhu i tha Hazretit Omer:

“O Omer! Ata që e përmendin Allahun, e morën mirësinë!” I nderuari i Gjithësisë (s.a.v.s), i cili e dëgjoji këtë, u kthye drejt nga ata dhe tha:

*“Po, ashtu është!”* (Ahmed, III, 438; Hejsemi, X, 74)

Domethënë, ushtrimi i vetes sonë për të bërë dhikër në çdo moment, do të jetë fitimi ynë më i madh.



Muaz bin Xhebel radijallahu anhu thotë:

I thashe të Dërguarit të Nderuar të Allahut (s.a.v.s):

“O i Dërguari i Allahut! Më këshilloni mua!”

I Dërguari i Allahut (s.a.v.s) tha:



*“Ji i Devotshëm ndaj Allahut sa të kesh mundësi! Përkujtoje Allahun pranë çdo guri dhe çdo peme që të gjendesh. Pendohu fshehtas për shkak të çdo lloj të keqeje që e bën fshehtas dhe për atë që e bën haptas!”* (Hejsemi, X, 74)



Një ditë, duke u shprehur sahabeve mirësinë e mexhliseve të dhikrit, i Dërguari i Allahut (s.a.v.s) tha:

**“Përfitoni shumë kur të shkoni në kopshtet e xhennetit.”**  
Ashabët e nderuar thanë:

*“Çfarë duhet të kuptojmë me kopshtet e xhennetit?”*

I Nderuari ynë (s.a.v.s) u përgjigj:

**“Mexhliet e dhikrit.”** (Tirmidhi, Deavat, 82/3510)



Kur takohej me ndonjërin prej ashabëve të nderuar, Abdullah bin Revaha radijallahu anhu thoshte:

*“Eja (o vëllau im!) të ulemi një farë kohe për hir të Allahut dhe ta rifreskojmë besimin që kemi ndaj Zotit tonë (ta përkujtojmë Atë).”*

Një sahabi, i cili nuk e kuptoi se çdo donte të thoshte kjo shprehje, shkoi te Hazreti Pejgamber (s.a.v.s) dhe ia tregoi këtë. I Nderuari ynë (s.a.v.s) i tha:

*“Allahu e mëshiroftë Abdullah bin Revahan. Ai i do shumë mexhliet e dhikrit që i lavdërojnë ëngjëjt.”* (Ahmed, III, 265)



Abdullah bin Sheddad radijallahu anhu tregon:

Tre vetë nga fisi Beni Uzre erdhën te i Dërguari i Allahut (s.a.v.s) dhe u bënë myslimanë. I Dërguari i Allahut (s.a.v.s) pyeti:

*“Kush e merr përsipër përkujdesjen e këtyre?”* Talha radijallahu anhu tha:



“Unë, o i Dërguari i Allahut!”

Kur ata ishin pranë Talhas radijallahu anhu, i Dërguari i Allahut (s.a.v.s) i dërgoi ata në një betejë. Njëri nga këta të tre doli nga ky grup dhe ra dëshmor. Më vonë i dërgoi në një betejë tjetër. Edhe me këtë betejë doli i dyti dhe ra dëshmor. Ndërsa i treti vdiq në shtrat pas një farë kohe.

Talha radijallahu anhu e tregon kështu vazhdimin e kësaj:

“Pashë në ëndërr se ata tre vetat që rrinin te unë ishin në xhennet. Ai që vdiq në shtrat ishte më përpara, ai që kishte rënë dëshmor i dyti vinte pas tij, ndërsa ai që ra dëshmor i pari ishte më në fund. U habita dhe më erdhi pak rëndë kjo gjendje. Shkova menjëherë te Pejgamberi (s.a.v.s) dhe ia tregova ëndrrën që kisha parë. I Dërguari i Allahut (s.a.v.s) tha kështu:

*“Në këtë nuk ka ndonjë gjë për tu habitur! Nuk ka njeri më të virtutshëm se sa besimtari i cili e kalon jetën e tij mbi Islamin, pa i lënë tespihet, tekbirin dhe tehlin (la ilahe illallah).”* (Ahmed, I, 163)



Një ditë, Hazreti Yftade doli me nxënësit e tij në një kuvend në fushë. Pas urdhërit të hoxhës, të gjithë dervishët dolën në vendet më të bukura të fushës dhe i sollën hoxhës së tyre nga një buqetë me lule. Por në dorën e ish gjykatësit të Bursës, Mahmud Efendi, i cili do të bëhej i famshëm me emrin Aziz Mahmud Hydaji, kishte vetëm një lule të vyshkur dhe me bisht të thyer... Pasi ata të tjerët ia dhanë me gëzim hoxhës ato që kishin në dorë, Mahmud Efendi duke e ulur kokën, ia dha këtë lule të thyer dhe të vyshkur Hazretit Yftade. Mes shikimeve të merakosura të nxënësve të tjerë, Hazreti Yftade pyeti:

“O biri im Mahmud! Përse solle një lule të vyshkur dhe me bisht të thyer, kur të gjithë të tjerët sollën buqeta me lule?”

Mahmud Efendi uli kokën dhe u përgjigj tërë edukatë:

“O i Nderuari im! Çfarëdo që të të jap është pak. Por çdo lule që zgjatja dorën për ta këputur e gjeja duke i bërë dhikër Zotit e duke thënë Allah, Allah. Nuk më bëri zemra t'i pengoja ato nga ky dhikër. Dhe kështu u detyrova të sillja këtë lule që kam në dorë, e cila nuk mund ta



vazhdonte më dhikrin.”

Çdo copëz në hapësirë është skenë mësimesh për ata të cilët kanë një zemër të butë. Të gjithë krijesat të gjalla dhe të pashpirta e përkujtojnë Allahun. Në ajetin fisnik thuhet:

**“Atë e madhërojnë shtatë qiejtë dhe toka dhe çfarë ka në to. Nuk ka asnjë gjë që nuk e lartëson atë me falenderim, por ju nuk e kuptoni madhërimin e tyre. Ai është i butë dhe falës.”**

(el-Isra, 44)

Ja pra edhe njeriu, duke marrë mësim nga këto tablo madhështore në hapësirë, duhet ta kuptojë detyrën origjinore dhe nuk duhet të rrijë neglizhent nga dhikri i Allahut.



Njëri nga dhikret më të vertyshme është salavati fisnik. Besimtari përfiton shpirtërisht aq herë sa ç'i dërgon salavate të Dërguarit të Allahut (s.a.v.s), sepse vlera e të Nderuarit tonë te Allahu është shumë e lartë.

Para gjithçkaje vetë Zoti ynë, duke i dërguar salavate të Dërguarit të Allahut e ka lartësuar atë me mëshirën, kënaqësinë dhe pëlqimin e Tij dhe ne na ka urdhëruar që të bëjmë kështu.

Një nga vendet ku i dërgojmë selam të Dërguarit të Allahut (s.a.v.s) është Tehijjati, të cilin e lexojmë në namaz. Sipas transmetimeve, i Nderuari ynë ka thënë:

*“Në natën e Miraxhit e kam parë Zotin me syrin e zemrës”.* Allahu Teala më tha:

Fol me mua o i Dashuri im! Unë ngriva nga habia. Pastaj Allahu Teala e frymëzoi zemrën time dhe thashë:

التَّحِيَّاتُ لِلَّهِ وَالصَّلَوَاتُ وَالطَّيِّبَاتُ

“Të gjitha adhurimet gjuhësore si falenderimet dhe madhërimet, veprare si namazi e agjërimi, por dhe ato materiale si zekati, i takojnë



vetëm Allahut xhelle ue ala.

Në lidhje me këtë, Allahu Teala tha:

السَّلَامُ عَلَيْكَ أَيُّهَا النَّبِيُّ وَرَحْمَةُ اللَّهِ وَبَرَكَاتُهُ

**O Pejgamber i Nderuar! Selami, mëshira dhe të gjithë begatitë e Allahut qofshin mbi Ty.**

Edhe unë u përgjigja duke thënë:

السَّلَامُ عَلَيْنَا وَعَلَىٰ عِبَادِ اللَّهِ الصَّالِحِينَ

*“Paqja e Allahut qoftë mbi ne dhe mbi të gjithë robërit e devotshëm të Allahut. Allahu Teala tha:*

**-O i Dërguari im, unë e nxora edhe Xhebrailin nga mesi ynë. Ti nuk e nxore ummetin tënd nga mesi ynë. Xhebraili alejhisselam i cili e dëgjoji këtë fjalë të Allahut ra në shehadet duke thënë:**

أَشْهَدُ أَنْ لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَأَشْهَدُ أَنَّ مُحَمَّدًا عَبْدُهُ وَرَسُولُهُ

Dëshmoj se nuk ka asnjë Zot tjetër që meriton të adhurohet përveç Allahut dhe dëshmoj se Muhammedi është robi dhe i Dërguari i Tij.” (Shik. Kurtubi, III, 425)

Ubej bin Kab radijallahu anhu thotë:

“Kur kaloi një e treta e natës, i Dërguari i Allahut (s.a.v.s) u zgjua, u ngrit dhe tha:

*O Njerëz! Përkujtojeni Allahun! Përkujtojeni Allahun! Do t’i fryhet surit të parë i cili e lëviz vendin nga toka. Menjëherë pas tij do të vijë i dyti. Vdekja do të afrohet me të gjithë tmerrin e saj! Vdekja do të afrohet me të gjithë tmerrin e saj!*

E pyeta Hazretin Pejgamber:

**-O i Dërguari i Allahut! Unë të dërgoj Ty shumë salavate fisnike.**



Sa here duhet ta bëj këtë?

Ai më tha: *-Dërgo sa herë të duash.*

E pyeta: -A është e mundur që një të katërtën e lutjeve të mia ta ndaj për salavatet fisnike?

Ai më tha: *Ndaj sa të duash, por nëse bën më shumë është më mirë për ty.*

I thashë: -Atëherë gjysmën e lutjes sime po e ndaj për salavatet fisnike.

Ai më tha: *Ndaj sa të duash, por nëse bën më shumë se aq, është më mirë për ty.* Unë e pyeta përsëri:

-Atëherë a mjafton dy e treta?

Ai më tha: *Ndaj sa të duash, por nëse shton më shumë, është shumë më mirë për ty.*

Kur i thashë: -Atëherë a bën të dërgoj salavate fisnike në të gjithë kohën që e kam ndarë për lutjen?

Ai më tha: *-Atëherë Allahu t'i rregullon të gjitha problemet dhe t'i fal mëkatet e tua.*” (Tirmidhi, Kijame, 23/2457)

Një herë, kur pa një prej sahabeve duke falenderuar Allahun dhe duke i dërguar salavate të Dërguarit të tij, të Nderuar tonë, të Dërguarit (s.a.v.s) i pëlqeu shumë që ai po bënte një gjë të tillë dhe i tha:

*“O ti që po fal namaz! Bëj lutje, lutja jote pranohet (përderisa ta fillosh lutjen me falenderim dhe salavate).”* (Tirmidhi, Vitir, 21/486)



Po ashtu, Omer bin Hattabi radijallahu anhu ka thënë:

“Lutja që ke bërë, qëndron ndërmjet tokës dhe qiellit. Asnjë lutje nuk ngrihet për tek Allahu, përderisa të mos i dërgohet salavat Pejgamberit tonë të Nderuar.” (Tirmidhi, Vitir, 21/486)

Ka'b bin Uxhre radijallahu anhu tregon:

Një ditë i thamë të Dërguarit të Allahut (s.a.v.s):



“O i Dërguari i Allahut! Ne e mësuam se si të të japim selam, por nuk e dimë se si të të dërgojmë salavate?” Ai tha kështu:

اللَّهُمَّ صَلِّ عَلَى مُحَمَّدٍ وَعَلَى آلِ مُحَمَّدٍ كَمَا صَلَّيْتَ عَلَى (إِبْرَاهِيمَ وَعَلَى) آلِ إِبْرَاهِيمَ  
إِنَّكَ حَمِيدٌ مَجِيدٌ اللَّهُمَّ بَارِكْ عَلَى مُحَمَّدٍ وَعَلَى آلِ مُحَمَّدٍ كَمَا بَارَكْتَ عَلَى (إِبْرَاهِيمَ وَ  
عَلَى) آلِ إِبْرَاهِيمَ إِنَّكَ حَمِيدٌ مَجِيدٌ

“O Zoti im! Mëshiroje Muhammedin dhe familjen e Muhammedit ashtu siç mëshirove Ibrahimin dhe familjen e Ibrahimit. Padyshim që Ti e meriton të lavdërohesh dhe je i lartë. O Zoti im! Begatoje Muhammedin dhe familjen e Muhammedit siç ke begatuar Ibrahimin dhe familjen e Ibrahimit. Padyshim që Ti e meriton të lavdërohesh dhe je i lartë.” (Buhari, Deavat, 32; Tirmidhi, Vitri, 20; Ibn Maxhe, Ikame, 25)



I Dërguari i Allahut (s.a.v.s) ka thënë:

“Dita më e mirë është dita e xhuma (e premte)... për këtë arsye atë ditë më dërgoni shumë salavate dhe selame sepse salavatet dhe selamet e juaja më paraqiten mua.

Kur në lidhje me këtë sahabët pyetën:

“O i Dërguari i Allahut! Si do të të shfaqen Ty salavatet dhe selamet tona, kur të kesh ndërruar jetë dhe kur të mos ketë ngelur asnjë gjurmë e jotja?”, i Dërguari i Allahut alejhissalatu uesselam tha:

“Allahu Teala ia ka ndaluar tokës që të prishë trupat e pejgamberëve.” (Ebu Davud, Salat 201/1047, Vitri 26)



Hazreti Ali radijallahu anhu thotë kështu në lidhje me mirësinë e vazhdimit të salavateve dhe të selameve në ditën e xhuma:

“Kushdo që ditën e xhuma i dërgon salavate dhe selame njëqind herë Pejgamberit, ditën e kiametit do të vijë në mahsher (vendin e tubimit) me fytyrë të bukur dhe të ndriçuar. Njerëzit do ta pyesin njëri-





tjetrin ngaqë dëshirojnë ta kenë edhe vetë atë gjendje, Çfarë pune bënte ky njeri?” (Bejhaki, Shuabu'l-Iman, III, 212)



Ka'b bin Uxhre radijallahu anhu tregon:

Një ditë, i Dërguari i Allahut (s.a.v.s) na tha:

“*Afrohuni te minberi.*” Dhe ne u afruam. Ai doli në shkallën e parë dhe tha: “*Amin!*” Doli në shkallën e dytë dhe përsëri tha: “*Amin!*” Doli në shkallën e tretë dhe në të njëjtën mënyrë tha: “*Amin!*”

Kur zbriti nga minberi e pyetëm:

“O i Dërguari i Allahut! Sot kemi dëgjuar nga Ti disa gjëra që nuk i kemi dëgjuar më parë. (Cila është urtësia e kësaj?)” Ai tha:

“*Kur dola në shkallën e parë mu shfaq Xhebraili alejhisselam dhe më tha: Larg mëshirës qoftë ai që e arrin ramazanin dhe nuk i falen mëkatet! Edhe unë thashë Amin!. Kur dola në shkallën e dytë më tha: Larg mëshirës qoftë ai që nuk të dërgon salavate Ty kur pranë tij përmendet emri Yt! Edhe unë thashë: Amin! Kur dola në shkallën e tretë më tha: Larg mëshirës qoftë ai që nuk mund ta fitojë xhennetin kur pranë tij nëna dhe babai, ose njëri prej tyre arrin pleqërinë (duke i kënaqur ata)! Edhe unë thashë! Amin!* (Hakim, IV, 170/7256; Tirmidhi, Deavat, 100/3545)



Nga një prej njerëzve të devotshëm është transmetuar kështu:

Unë kisha një komshi. Ai i shumonte librat e dijetarëve duke i shkruajtur. Kur ndërroi jetë e pashë në ëndërr. E pyeta:

“Si të trajtoi Allahu?”

Ai më tha: “Më fali.”

I thashë: “Cila vepër e jotja u bë shkak për këtë?”

Ai më tha: “Kur shkruaja në libër emrin fisnik të bekuar të të dërguarit të Allahut (s.a.v.s), patjetër i dërgoja salavate dhe selame. Për



këtë arsye Zoti më dha mirësi që asnjë sy nuk i ka parë, asnjë vesh nuk i ka dëgjuar dhe askush nuk ka mundur t'i imagjinojë.” (Nebhani, Saadetu'd-Darejn, s.101)



Transmetohet se një njeri i cili kishte marrë shumë mirësi nga morali i Hazretit Pejgamber (s.a.v.s) se një ditë kishte parë në ëndërr të Nderuarin e Botrave. I Dërguari i Allahut nuk interesohet për të dhe nuk e lavdëronte. Gjithë duke qenë i mërziur, ai e pyeti:

“O i Dërguari i Allahut! A je i zemëruar me mua?”. Ai tha:

“Jo!”

“Atëherë përse nuk interesohesh për mua?”

“Nuk të njoh ty!”

“Si ka mundësi o i Dërguari i Allahut? Unë jam një njeri prej ummetit tënd. Dijetarët thonë që Ti i njeh njerëzit e ummetit tënd më mirë se sa njeh një nënë fëmijët e saj...”

*“Është e vërtetë, por unë nuk shikoj te ti ndonjë shenjë nga morali im i bukur. Mbi të gjitha ti nuk më ke dërguar fare salavate dhe selame. Dije se unë e njoh çdonjërin nga ummeti im në përputhje me atë sa ai ka marrë nga morali im.”*

Ky njeri besimtar u zgjua nga gjumi me një mërzi të madhe, u pendua për gjendjen e tij të mëparshme dhe mori nga morali i bukur i Hazretit Pejgamber (s.a.v.s). Ai u përkushtua shumë me salavatet fisnike. Pas një farë kohe, përsëri pa në ëndërr të Dërguarin e Allahut. Këtë herë i Dërguari i Allahut (s.a.v.s) i tha:

“Tani të njoh dhe do të ndërmjetësoj për ty...”



Thelbi i fjalës është ky, i Nderuari ynë (s.a.v.s) ka thënë: “Njeriu është me atë që e do.” (Buhari, Edeb, 96) Sipas ligjit “Ai që dashuron, dashuron çdo gjë që do ai të cilin e dashuron.”, është kusht që ta ndjekim me sjelljet tona Pejgamberin (s.a.v.s). Ashtu që dashuria,



përzemërsia dhe përndjekja të formojnë kockën e belit të dashurisë ndaj Zotit. Çdo dashuri që është e kundërt me këtë, është e pavlerë në Kur'an dhe në Sunnet. Rrugës së vetme të dashurisë që mund të çojë të Zoti, i është vënë pikë me dashurinë e Hazretit Pejgamber.

Dhikri i Allahut dhe salavatet fisnike janë ushqimi i ekzistencës sonë shpirtërore dhe garancia e lumturisë tonë të përhershme. Bota jonë e zemrës dhe e shpirtit përsoset me dhikër. Po ashtu Allahu thotë:

**“...Dijeni se zemrat qetësohen vetëm me dhikrin e Allahut.”**  
(er-Ra'd, 28)

Ruga për të qënë një rob i afërt ndaj Allahut, kalon nga “dhikri i vazhdueshëm”. Vetëm atëherë jeta jonë mund të fitojë kënaqësi dhe ëmbëlsi shpirtërore.

**Zoti na e bëftë kismet të gjithëve!**

**Amin!..**

## **9. Shqetësimi i frymës së fundit. Të parapërgatitesh për vdekjen dhe për pasvdekje**

Kur njeriu ta shikojë sistemin e mrekullueshëm të gjithësisë me syrin e mësimit, e kupton se e vërteta e “vdekjes” është çështja me të cilën ai duhet të jetë më i lidhur në këtë jetë.

Kështu, Allahu thotë:

**“Çdo gjë që gjendet mbi tokë është e përkohshme...”** (er-Rahman, 26)

**“Çdo i gjallë do ta shijojë vdekjen (do të vdesë).”** (el-Enbija, 35)

Sa e çuditshme është që njeriu e gënjen veten e tij, pa e kuptuar se gjendet si mik në këtë botë. Edhe pse i shikon përditë skenat e xhenazes, vdekjen e shikon larg tij. Ai e pandeh veten si zotërues absolut të amaneteve të përkohshme, të cilat mund t'i humbasë nga çasti në çast. Por qysh se njeriu dërgohet në këtë botë nga një derë, duke iu veshur trup shpirtit të tij, kjo do të thotë se tashmë ai është një udhëtar i vdekjes. Ai tashmë ka hyrë në vendin e parapërgatitjes së kësaj



ruge, por nuk e sjell në mend. Pastaj vjen një ditë dhe shpirti ndahet nga trupi. Përmes varrit, i cili është dera e ahiretit, ai përcillet për një udhëtim të madh. Allahu Teala thotë:

**“Atij që i kemi dhënë jetë të gjatë, e kthejmë mbrapa në krijimin e tij. A nuk mendojnë? (A nuk e kuptojnë këtë udhëtim mësimdhënës?)”** (Jasin, 68)

Për njeriun, qëllimi themelor i kësaj bote është fitimi i lumturisë së ahiretit, duke jetuar një jetë adhurimi nga e cila Allahu është i kënaqur. I Dërguari i Allahut (s.a.v.s) thotë:

*“I mençur është ai që nuk i nënshtrohet dëshirave dhe pasojave vetjake dhe i cili parapërgatitet për pasvdekjen...”* (Tirmidhi, Kijamet, 25/2459)

Sa bukur e shpreh këtë i ndjeri Nexhip Fazëll:

Argjendari koprac është i dhënë pas një traste tjetër;

Mblidh atë para që vlen në varr!..

Jeta është si pikat e ujit që mbushin gotën. Ndërsa pastërtia e ujit në gotë është e lidhur me pastërtinë e pikave. Pika e fundit që mbush gotën është fryma e fundit.

Në hadithin fisnik thuhet:

*“Nëse fjala më e fundit e jetës së çdokuj do të jetë fjala: لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ<sup>أ</sup> do të hyjë në xhennet.”* (Ebu Davud, Xhenaiz, 15-16/3116; Hakim, I, 503)

Domethënë, nëse e mbush zemrën e tij me Allahun, duke i shkatërruar zotërat e pasioneve dhe dëshirave vetjake të panevojshme që ka në zemër dhe nëse jeton deri në çastin e fundit një jetë shpirtërore mbi këtë rrugë, shpresohet të fitojë xhennetin duke kaluar me besim në botën tjetër, sepse është shumë e vështirë që dikush i cili ka jetuar një jetë tjetër, të thotë në frymën e fundit “La ilahe illallah”. Po ashtu i Dërguari i Allahut (s.a.v.s) thotë:

*“Njeriu vdes mbi atë gjendje që ka jetuar dhe tubohet në atë gjendje që ka vdekur.”* (Shik. Muslim, Xhennet, 83; Munavi, V, 663)



Fryma e fundit është si një pasqyrë pa avull dhe e pastër. Njeriu, veten e tij e njeh më mirë në frymën e fundit të tij. Llogaria e jetës i shfaqet përpara zemrës dhe syrit të tij. Për këtë arsye, për njeriun nuk ka ndonjë pamje më mësimdhënëse se sa çasti i vdekjes.

Hazreti Pejgamber (s.a.v.s) thotë:

*“(Sipas veprave) varri ose është një kopsht nga kopshtet e xhenetit, ose është një gropë nga gropat e xhehennemit.”* (Tirmidhi, Kijamet, 26/2460)

Me qëllim që t'i japim lamtumirë kësaj bote të përkohshme si një rob i mirë dhe me qëllim që varri ynë të jetë një nga kopështet e xhenetit, është e domosdoshme që frymët e numëruara t'i parapërgatisim për frymën e fundit. Domethënë, për një jetë të lumtur në ahiret është e domosdoshme që në këtë botë të kemi një jetë të zbukuruar me vepra të mira, një jetë të begatë dhe nën drejtimin e Islamit, sepse Zoti thotë:

**“Adhuroje Zotin tënd derisa të të vijë vdekja!”** (el-Hixhr, 99)

Robërit e veçantë që rrojnë me dashurinë e Allahut dhe të të Dërguarit të Tij dhe e zbukurojnë jetën me vepra të mira në këtë drejtim, -me mirësinë e Allahut-, në frymën e tyre të fundit shpërngulen me qetësinë shpirtërore të fjalës së shehadetit. Në të kundërt të kësaj, ai që i beson mashtrimeve tërheqëse të përkohëshme, energjike e vetjake mbi këtë tokë, si dhe fatkeqi që në këtë mënyrë i dobëson ndjenjat shpirtërore, duke vdekur në një mënyrë të ngjashme me jetën e tij, edhe poshtë tokës humbet dhe poshtërohet.

I Dërguari i Allahut (s.a.v.s) me njetin për të na qortuar ne, ummetin e tij, ka thënë:

*“Nuk ka asnjë që vdes dhe të mos pendohet.”*

U pyet: “Çfarë është ai pendim, o i Dërguari i Allahut?”. I Nderuari ynë (s.a.v.s) u përgjigj:

*“(I vdekuri) nëse ka qënë një njeri i devotshëm, do të pendohet se përse nuk ka mundur ta shtojë edhe më këtë devotshmëri, por nëse ka qënë njeri i keq, do të pendohet se përse nuk e ka rregulluar gjendjen*



*e tij duke hequr dorë nga e keqja.*” (Tirmidhi, Zuhd, 59/2403)

Në lidhje me këtë çështje, Allahu i qorton kështu robërit e tij:

“O ju që keni besuar, as pasuria juaj dhe as fëmijët tuaj të mos iu shmangin nga adhurimi i Allahut. Ata të cilët veprojnë kështu, janë prej të humburve. Dhe jepni nga ajo që ne u kemi furnizuar para se ndonjërit prej jush t’i vijë vdekja dhe atëherë të thotë: “O Zoti im, sikur të ma kishe vonuar edhe pak afatin (e vdekjes) që të jepja lëmoshë dhe të bëhesha prej të devotshmëve. Por Allahu kurrësi nuk e lë për më vonë asnjë që i ka ardhur afati i tij. Allahu e di shumë mirë atë që veproni.” (el-Munafikun, 9-11)

Së fundi, vdekja jonë dhe jeta jonë e varrit, që do të zgjasë deri në kiamet, do të formohet sipas gjendjes dhe punëve tona në këtë botë.

Sa bukur thotë Hazreti Mevlana:

“O bir, vdekja e gjithkujt është sipas karakterit të tij. Atyre që e urrejnë vdekjen, pa e menduar se ajo e dërgon te Allahu dhe atyre që janë armiq të saj, vdekja u shfaqet si një armik i tmerrshëm. Ndërsa ndaj atyre që janë miq me vdekjen, u shfaqet si mik.”

“O ti që ke frikë dhe ikën nga vdekja! Nëse dëshiron të dish të vërtetën e punës dhe të drejtën e fjalës, ti në të vërtetë nuk ke frikë nga vdekja por ti frikësohesh nga vetja jote.”

“Sepse ajo që ke frikë dhe trembesh, kur të shohësh në pasqyrën e vdekjes, nuk është fytyra e vdekjes por fytyra jote e shëmtuar. Shpirti yt i ngjan një peme. Ndërsa vdekja është gjethja e asaj peme. Çdo gjethe është sipas llojit të pemës...”

Domethënë zbukurimi i vdekjes është në lidhje me zbukurimin e jetës me vepra të mira.

### *Tabllo të virtytshme dhe mësimdhënëse*

Abdullah bin Omer radijallahu anhu tregon:

Isha bashkë me të Dërguarin e Allahut (s.a.v.s). Një person nga



Ensarët erdhi të i Dërguari i Allahut, i dha selam dhe e pyeti:

“O i Dërguari i Allahut! Kush është besimtari më i virtytshëm?” I Nderuari ynë (s.a.v.s) u përgjigj:

*“Është ai që e ka moralin më të bukur!”* Këtë herë personi pyeti:

“Mirë, kush është më i mençuri i besimtarëve?” Pejgamberi alejhissalatu uesselam u përgjigj:

*“Është ai që e kujton vdekjen më shumë dhe i cili përgatitet në mënyrën më të bukur për pasvdekjen. Ja këta janë të mençurit (e vërtetë).”* (Ibn Maxhe, Zuhd, 31)



Bera radijallahu anhu tregon:

“Ne ishim bashkë me të Dërguarin e Allahut (s.a.v.s) në një xhe-naze. I Nderuari ynë alejhissalatu uesselam u ul te varri dhe qau aq sa toka u lag (me lotët e tij). Pastaj tha:

*-O vëllezërit e mi! Ja, përgatituni për vdekjen e cila do të na vijë të gjithëve.* (Ibn Maxhe, Zuhd, 19)



Hazreti Omer radijallahu anhu e kishte urdhëruar një rob të tij që çdo ditë t’ia kujtonte këtë fjali: “O Omer, mos e harro vdekjen!” Por kur iu zbardh mjekra, i tha:

“Mjaft! Mjekra ime e bardhë ma kujton vdekjen në çdo çast.”

Me të vërtetë, është e nevojshme që të mos e harrojmë fundin, domethënë vdekjen, që të arriimë t’i frenojmë dëshirat e vetes tonë.



Me qëllim që të mendohemi dhe të marrim mësim dhe që të përgatitemi për frymën e fundit, vdekjen dhe pasvdekjen, Krenaria e Gjithësisë, i Nderuari ynë (s.a.v.s) ka transmetuar disa pamje nga gjendjet e kiametit dhe ahiretit. Një pjesë e këtyre është:

“Kur një mysliman është në frymën e fundit, ëngjëjt e mëshirës



vijnë me një mëndafshf (rrobë) të bardhë dhe i thonë kështu:

-Dil nga trupi si i kënaqur nga Zoti dhe Zoti i kënaqur me ty. Shko të mëshira dhe kënaqësia e Allahut dhe tako Zotin tënd që nuk është i zemëruar me ty!

Mbi këtë shpirti del si era më e bukur e miskut. Ashtu që ëngjëjt ia japin atë njëri-tjetrit, e sjellin deri te dera e qiellit dhe thonë:

-Sa e mirë është kjo erë që po ju vjen nga toka! Pastaj e Dërgojnë te shpirtërat e besimtarëve. Ata gëzohen me ardhjen e tij më shumë se sa gëzohet ndonjëri prej jush kur gjen gjënë që ka humbur. Ata e pyesin për lajmet nga kjo botë:

-Çfarë ka bërë filani? Çfarë ka bërë filani? Disa shpirtëra, për ndonjërin që kanë pyetur, thonë:

-Lëre atë, ai ka humbur në telashet e botës. Në lidhje me këtë, shpirti i sapoardhur thotë:

-Filani ka vdekur, a nuk ka ardhur te ju? Ata thonë:

-(Ashtu e? Atëherë) ai është dërguar në vendin ku do të shkojë, në xhehennemin Havije!

Kur qafiri të jetë në frymën e fundit, ëngjëjt e ndëshkimit i vijnë me një rrobë të keqe prej leshi të cilës i thuhet mish, dhe i thonë:

-Dil nga ky trup i zemëruar me veten tënde dhe si tërheqës i zemërimit të Allahut dhe vrapo për te ndëshkimi i Allahut!

Pas kësaj ai del nga trupi me erën më të keqe. Ëngjëjt e dërgojnë te dera e tokës. Atje thonë:

-Sa pis qenka kjo erë! Së fundi e dërgojnë te shpirtrat qafirë.”  
(Nesai, Xhenaiz, 9)



I Dërguari i Allahut (s.a.v.s) lajmëron:

“Në ditën e kiametit njeriu do të sillet përpara Allahut pothuajse si një qengj, do të ndalet dhe Allahu do t’i thotë kështu:





**-Ty të kam dhënë shumë mirësi, të kam dhënë pasuri, të kam dhënë shumë begati dhe mirësi. Çfarë ke bërë në shpërblim të kësaj?**

*Ai do të thotë:* -O Zoti im, i kam kursyer, i kam shtuar dhe i kam lënë mbrapa në një gjendje më shumë se sa ishin. Më dërgo mbrapa (në botë) dhe të t'i sjellë Ty. *Allahu Teala do të thotë:*

**-Eja më trego ato që i ke dërguar më parë në ahiret!**

*Ai do të thotë:* -O Zoti im, i kam kursyer, i kam shtuar dhe i kam lënë mbrapa në një gjendje më shumë se sa ishin. Më dërgo mbrapa (në botë) dhe të t'i sjellë Ty.

*Sepse ky rob nuk ka dërguar asgjë të mirë më parë. Ja për këtë shkak do të hidhet në xhehennem.*” (Tirmidhi, Kijamet, 6/2427)

Ja, ata që nuk përgatiten për ahiretin në këtë botë dhe e mbyllin jetën në një nëglizhencë të tillë, do të kenë një të ardhme të zymtë.

Ja si e tregon këtë Allahu në ajetin fisnik:

**“Kujt i jepet libri i tij pas shpine, ai do t'i ndjellë vetes shkëterrim dhe do të hyjë në zjarr të ndezur fort. Ai ka qënë i gëzuar në familjen e tij dhe ka menduar se nuk do të kthehet (te Zoti i tij).”** (el-Inshikak, 10-14)

Një shembull tjetër i fundit tragjik që i pret ata të cilët kanë devijuar duke i besuar pasurisë, pozitës dhe forcës së tyre në këtë botë është Karuni. Allahu e tregon kështu historinë e tij (Karunit) të mbushur me mësim:

**“Karuni ishte nga populli i Musait dhe ai e shtypte shumë atë popull ngase Ne i patëm dhënë aq shumë pasuri sa që një grup fuqishëm mezi mbartnin çelësat e (e pasurisë së) tij, kur populli i tij i tha: “Mos u kreno aq shumë, sepse Allahu nuk i do të çoroditurit. Kërko botën tjetër me atë që të ka dhënë Allahu dhe mos e lër mangët atë që të takon nga kjo botë, bëj mirë ashtu siç të ka bërë Allahu ty dhe mos bëj të këqia në tokë, sepse Allahu nuk i do shkatërrimtarët.**

**Ai (Karuni) tha: “Më është dhënë vetëm për shak të dijes**



sime!” A nuk e di ai se Allahu shkatërroi para tij nga popujt e lashtë të cilët ishin edhe më të fuqishëm edhe më të pasur se ai, por mëkatarët nuk do të pyeten për fajet e tyre (Allahu i di të gjitha).

Ai doli përpara popullit të tij me stolinë e tij. Ata të cilët dominin këtë botë thanë: Ah sikur të na ishte dhënë edhe ne pasuri ashtu siç i është dhënë Karunit, me të vërtetë ai është shumë fatmirë!

Ndërsa ata që kishin dije thanë: “Të mjerët ju, shpërblimi i Allahut është shumë më i mirë për ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, por atë nuk mund ta arrijë askush përveç durimtarëve!

Së fundi Ne e shkatërruam atë dhe e bëmë rrafsh me tokën sarajën e tij. Atë nuk pati kush ta ndihmojë përveç Allahut dhe ai nuk mundi ta mbrojë as veten e tij.” (el-Kasas, 76-81)

Gjendja e Karunit është një shembull i qartë për të ardhmen e atyre që çoroditen duke i besuar pasurisë e fuqisë që kanë në këtë botë dhe neglizhentëve që nuk mendojnë se do të vdesin një ditë.



Një ditë e pyetën Pejgamberin (s.a.v.s):

“O i Dërguari i Allahut! A do ta shikojmë Zotin në ditën e kiame-tit? I Dërguari i Allahut (s.a.v.s) pyeti:

“A bëheni kalaballëk për të parë diellin në kohën e drekës në një ditë pa re?” Kur ashabët e nderuar thanë:

“Jo!” Ai përsëri pyeti:

“A e shtyni njëri-tjetrin për të parë hënën në një natë pa re?” Kur ashabët përsëri thanë:

“Jo o i Dërguari i Allahut!”, Ai tha:

“Betohem në Allahun në dorën e të Cilit është shpirti im se ju nuk do ta shtyni njëri-tjetrin fare për të parë Zotin tuaj, ashtu siç nuk shtyheni për të parë diellin dhe hënën. Kështu robi do të vijë ballë për ballë me Zotin e tij. Allahu do ta pyesë:



**-O filan! A nuk të kam nderuar? A nuk të kam bërë zotëri? A nuk të kam dhënë bashkëshorte? A nuk ti kam nënshtruar kalin dhe devenë? A nuk të kam lejuar të udhëheqësh dhe të marrësh një të katërtën nga pasuria e ganimetit? Robi do të thotë:**

-Po o Zoti im!

Allahu Teala do të thotë:

**“Mirë po a nuk mendove fare se do të takohesh me mua?**  
Robi kësaj pyetjeje i përgjigjet:

-Jo o Zoti im! Allahu Teala do t'i thotë:

**-Atëherë edhe Unë po të harroj ty ashtu siç më ke harruar ti Mua (në botë)!**

Pastaj del përpara Allahut robi i dytë. Allahu Teala i pyet të njëjtat gjëra. Pastaj edhe të tretit i thotë të njëjtën gjë. Robi (duke ngelur i detyruar të pranojë ato që thotë Zoti) thotë: Po o Zoti im! Allahu do ta pyesë:

**-A ke menduar se do të takohesh me Mua?** Robi do të thotë:

-O Zoti im, unë të kam besuar Ty, librave të Tu dhe pejgamberëve të Tu. Kam falur namaz, kam agjëruar dhe kam dhënë lëmoshë!, dhe e lavdëron Allahun Teala aq sa ka mundësi. Allahu xhelle xhelaluhu thotë:

**-Prit atëherë! Tani do të dërgohet një dëshmitar kundër teje!**

Robi do të mendojë në vete:

-Kush do të jetë ai që do të dëshmojë kundër meje? Ndërkaq robit i vuloset goja. Këmbëve, mishit dhe kockave të tij do t'u thuhet: Hajde, flisni! Këmbët, mishit dhe kockat e tij do të flasin dhe do të tregojnë gjithçka që ka bërë ai. Kjo është që të mos e lënë të shfaqë ndonjë arsye. Ky person është munafiku (hipokriti), i cili do të shkojë te zemërimi i Allahut.” (Muslim, Zuhd, 16)

Si mund t'i fshehë robi mëkatet e tij në një gjykatë ku do të dëshmojnë të gjithë organet e tij dhe toka. Për këtë arsye, është e domosdoshme që jetën tonë ta jetojmë me përpikmëri për të mos u turpëruar atje.



I Dërguari i Allahut (s.a.v.s) thotë:

*“Kur robi të vendoset në varr, - ai e dëgjon zërin e këmbëve të njerëzve që kthehen prapa- i vijnë dy ëngjëj. E ulin dhe e pyesin:*

*-Çfarë mendoje për Muhammedin (s.a.v.s)? Njeriu besimtar kësaj pyetjeje i përgjigjet kështu:*

*-Dëshmoj se Ai është rob dhe i Dërguari i Allahut! Atij i thuhet:*

*-Shikoje vendin tënd në xhennem! Allahu e ndërroi atë me një vend në xhennet. (Njeriu vëren) dhe i shikon që të dy. Allahu i hap atij një penxhere nga varri dhe shikon xhennetin.*

*Nëse ai që vdes është qafir ose hipokrit (pyetjes së melekëve) i përgjigjet kështu:*

*-Nuk e njoh (atë që më pyetët). Edhe unë thoja atë që thoshte gjithkush. Atij i thuhet:*

*-Nuk e kuptove dhe nuk e ndoqe! pastaj e godit me një shkop prej hekuri në mes veshëve. Ai prej dhimbjes së shkopit lëshon një klithmë ashtuqë e dëgjojnë të gjitha gjallesat që ka afër përveç njerëzve dhe xhindëve.” (Buhari, Xhenaiz, 68, 87; Muslim, Xhennet, 70)*



Sulejmani alejhisselam, i biri i Hazretit Davud kaloi pranë një bujku që po punonte tokën. Bujku tha:

*“Padyshim që familjes së Davudit i është dhënë një salltanet i madh!”*

Era e dërgoi këtë zë te veshi i Sulejmanit alejhisselam. Sulejmani alejhisselam menjëherë zbriti nga kafsha, shkoi pranë bujkut dhe i tha atij:

*“Erdha në këmbë tek ti, që të mos shpresosh në një gjë për të cilën nuk ke fuqi!”. Pastaj shtoi:*

*“Një tespìh që e pranon Allahu, sigurisht që është më e mirë se sa pasuria dhe salltaneti që i është dhënë familjes së Davudit.”<sup>86</sup>*

Me të vërtetë, veprat e mira që bëhen me nijet të sinqertë në këtë



botë të përkohëshme, do të jenë fitimi i lumturisë sonë në botën e përhershme. Në ajetin fisnik thuhet:

**“O ju që keni besuar! Kini frikë Allahun dhe le të shikojë gjithkush se çfarë ka përgatitur për nesër. Kini frikë Allahun, sepse Allahu e di atë që veproni.”** (el-Hashr, 18)



Është e pamundur të ikësh nga vdekja. Zgjidhja e vetme është përgatitja për të. I Dërguari i Allahut (s.a.v.s) thotë:

“Davudi alejhisselam ishte shumë i ashpër në përpjekjen për fenë dhe i dhënë shumë pas nderit. Kur dilte nga shtëpia, e mbyllte derën shumë mirë dhe nuk mund te hynte atje askush derisa të kthehej. Një ditë doli përsëri nga shtëpia dhe e mbylli derën... Kur Davudi alejhisselam u kthye mbrapa, gjeti një njeri në mes të shtëpisë. E pyeti:

-Kush je ti? Ai tha:

-Unë jam dikush që nuk ka frikë nga mbretërit dhe nuk mund ta ndalojnë pengesat.

Kur dëgjoji këtë, Davudi alejhisselam tha:

-Atëherë, ti je engjëlli i vdekjes, për Zotin. Mirë se ke ardhur me urdhërin e Allahut.

Pas një farë kohe iu mor shpirti...” (Ahmed, II, 419)

Ja takimi që do të kenë me Azrailin alejhisselam ata që janë gati për vdekjen në çdo çast...

Sa bukur thotë i ndjeri Nexhip Fazëll:

Atëherë hiqen perdet dhe shfaqet gjithçka,

I aftë për t'i thënë Azrailit mirë se erdhe...



Mirësitë që i ka dhënë Allahu Teala duhet të dërgohen në ahiret kur kemi mundësi dhe duhet të përgatitet për ditën e vështirë dhe me bela të kiametit. Sa bukur i përmbledh Ebu Zer radijallahu anhu këto fjalë me urtësi, si urtësi që nevojiten për t'u përgatitur për vdekjen dhe



udhëtimin që pason:

“Në një pasuri ka tre ortakë. I pari është i zoti i pasurisë, domethënë ti, i dyti është kaderi. Ai nuk të pyet ty se çfarë do të të sjellë mirësi apo shkatërrim dhe vdekje. I treti është trashëgimtari. Edhe ai pret që të vdesësh sa më parë, dhe kur të vdesësh e merr pasurinë për vete, ndërsa ti do të japësh llogari. Nëse ke mundësi, mos ji më i paafti i këtyre tre ortakëve!

Allahu Teala thotë:

لَنْ تَنَالُوا الْبِرَّ حَتَّى تُنْفِقُوا مِمَّا تُحِبُّونَ

**Nuk do ta arrini përsosmërinë derisa të mos jepni nga ajo që e doni...** (Al-i Imran, 92) Ja kjo deve është pasuria ime që e dua më shumë, po e dërgoj atë përpara meje dhe po e jap (lëmoshë) (që të më dalë përpara në ahiret).” (Ebu Nuajm, Hilje, I, 163)

Në kohën e Osmanllinjve kishte qenë një dijetar i njohur me emrin Yçbash Nureddin Hamza Efendi.<sup>87</sup> Ai nuk i kishte harxhuar paratë dhe i kishte kursyer. Ai nuk hypte në kalë, vishte rroba dhe këpucë të vjetra dhe kështu e kursente pasurinë. Për këtë shkak në popull njihej si “Hoxha i dhënë pas parasë”.

Ky hoxhë i nderuar, me paratë që kishte kursyer në Fatih Karagymryk, së pari kishte bërë Shkollën Yçbash dhe pastaj Xhaminë Yçbash. Ai, duke bërë dhoma që të rrijnë dijetarët dhe të varfërit, u dha shumë vakëfe. Ata që e njihnin dhe që e dëgjuan këtë, u habitën dhe pyetën:

“O hoxhë, si munde t’i harxhosh paratë kur ne e dimë se ti i do shumë ato?” Hoxha i nderuar dha këtë përgjigje të logjikshme dhe të urtë:

“O miqtë e mi të nderuar! Ju keni të drejtë. Unë e dua shumë paranë. Për këtë arsye zemra ime nuk u kënaq që paraja ime të ngelë

87. Për shkak se ka lindur në fshatin Yçbash, i cili ishte i lidhur me provincën Karasu, emri i fshatit iu bë pseodonim. Ai ka ndërruar jetë në vitin 948/1541. Për hollësitë e jetës së tij dhe për këtë ngjarje shiko Tashkëpryzade, esh-Shekaiku'n-Nu'manijje (shq. A. Suphi Furat), fq. 540-541.



në këtë botë. Ato i dërgova përpara vetes në ahiret.”



Hazreti Ali radijallahu anhu ka thënë:

“Bota e ka kthyer shpinën dhe po shkon. Ndërsa ahireti e ka kthyer fytyrën dhe po vjen. Secila ka njerëz që e kërkojnë. Ju jini prej atyre që duan ahiretin, mos jini prej atyre që duan këtë botë! **Sot është dita për të bërë vepra të mira, nuk ka llogari. Ndërsa nesër ka llogari dhe nuk ka mundësi për të bërë vepra të mira.**” (Buhari, Rikak, 4)

Tamam si një nxënës që del nga salla e provimit dhe tashmë nuk mund të shkruajë përgjigje për pyetjet e provimit...

Disa miq të Zotit, duke përfituar nga kjo fjalë e Hazretit Ali, kanë thënë kështu:

“Bota e ka kthyer shpinën dhe po shkon. Ndërsa ahireti është drejtuar nga ne dhe po vjen. Çudi për atë që drejtohet nga ajo që i ka kthyer shpinën nuk do t'ia dijë për atë që i vjen drejt.”



Ebu'd-Derda radijallahu anhu thoshte:

“Kam frikë se mos jepeni pas dëshirave vetjake të fshehta, duke u përhumbur në mirësitë të cilat e zbavisin njeriun. Këto dëshira vetjake sipas dijes shfaqen mbasi ta mbushni stomakun me ushqim kur jeni të uritur. Më i miri prej jush është ai që i jep shokut të vet këtë këshillë:

-Eja të agjërojmë përpara se të vdesim.

Më i keqi prej jush është ai që i thotë mikut të vet:

-Eja dhe të zbavitemi para se të vdesim, të hamë dhe të pimë, ta shijojmë jetën...” (Ebu Nuajm, Hilje, I, 218)



Hazretit Sufjan eth-Theurit i ishte kërësuar beli që në moshë të re. Atyre që e pyetën për shkakun e kësaj u tha:

“-Ishte një hoxhë prej të cilit merrja mësim. Në çastet e vdekjes, ai



nuk e tha shehadetin në asnjë lloj mënyre edhe pse unë ia përmendja. Ja shikimi i kësaj gjendjeje ma shtrembëroi belin.”

Në çështjen e frymës së fundit, askush nuk është i siguar përveç pejgamberëve. Bile edhe lutja e Jusufit alejhisselam që i bëri Zotit:

“...(O Zoti im!) Më bëj të vdes mysliman dhe më bashko me të mirët!” (Jusuf, 101) tregon se edhe pejgamberët shqetësohen për frymën e fundit. Për këtë arsye, besimtari duhet të punojë vazhdimisht mes frikës dhe shpresës dhe duhet ta mbushë me ushqim trastën e ahiretit.



Kur po kalonte pranë një vendi varrezash, Shakik Belhi vështroi me vëmendje dhe u tha atyre që kishte:

“Shumica e atyre që janë këtu e kanë kuptuar se janë gënjer kur ishin në këtë botë...”

E pyetën: “Përse?”. Ai u përgjigj kështu:

“Kur ishin në jetë a nuk pandehnin se kishin pasuri, pronë, shtëpi, kafshë udhëtimi, farefis dhe vreshta e kopështije? Por tani edhe ju e shikoni se nuk paska qenë kështu!..”



Gjendja e mikut të Allahut, Rebi bin Hajsemit është një shembull tërheqës në çështjen e përgatitjes për vdekjen dhe për ahiretin, duke e shqyrtuar veten shpesh e shpesh:

Hazreti Rebi bin Hajsemi kishte hapur një varr në bahçen e tij. Kur e ndjente se zemra i është ngurtësuar, shkonte te varri dhe qëndronte një farë kohe atje. Ai mendonte se do të vijë një ditë dhe do t'i japë lamtumirën kësaj bote dhe se në varr do të ketë nevojë për një kërkim faljeje dhe sadakaje që ka dhënë, duke menduar llogarinë në ahiret. Pastaj thoshte këta ajete:

حَتَّىٰ إِذَا جَاءَ أَحَدَهُمُ الْمَوْتُ قَالَ رَبِّ ارْجِعُونِ لَعَلِّي أَعْمَلُ صَالِحًا فِيمَا تَرَكْتُ





**më kthe pas që të bëj vepra të mira e të kompensoj atë që e lashë!..”** (el-Mu'minun, 99-100) Kur dilte nga varri, thoshte në vetvete:

“-O Rebi! Shiko, sot u ktheve mbrapa. Do të vijë edhe një kohë që kjo lutje nuk do të pranohet dhe nuk do të kthehesh në këtë botë. Merri masat që tani dhe shtoji veprat e mira, përpjekjet në rrugën e Allahut dhe përgatitjet për ahiretin.”



Sa të mira janë këto këshilla të Hazretit Imam Gazali:

“Çdo besimtar, pasi të falë namazin e mëngjesit dhe para se të fillojë ditën e re, duhet të bëjë disa kontrata dhe akte mbi disa kushte, duke qëndruar një farë kohe ballë për ballë me veten. Po ashtu edhe një tregtar bën të tilla akte, nëse është i detyruar që pasurinë e tij t'ia lërë ortakut. Në këto çaste nuk harron t'i bëjë edhe ndonjë qortim. Edhe njeriu duhet ta qortojë dhe kritikojë veten e tij:

-Kapitali im është jeta ime. Kur të mbarojë jeta ime, mbaron edhe paraja dhe tashmë nuk ka as qar dhe as fitim, por kjo ditë që fillon është një ditë e re. Allahu Teala më nderoi duke më lejuar edhe këtë ditë. Sikur të ma kishte marrë shpirtin, sigurisht që do të shpresoja të kthehesha mbrapa qoftë edhe një ditë, që të mund të bëja vazhdimisht vepra të mira dhe mirësi. Tani përfytyro sikur ta ka marrë shpirtin dhe je kthyer mbrapa. Atëherë, duke filluar që sot mos iu afro në asnjë lloj mënyre gjynahut dhe mëkatit dhe ki kujdes që asnjë çast të kësaj dite mos e harxho bosh, sepse çdo frymë është një mirësi shumë e madhe.

Dije mirë se një ditë bashkë me natën dhe ditën e saj është njëzet e katër orë. Në ditën e kiametit përpara njeriut për çdo ditë do të sillen njëzet e katër kuti të mbyllura. Pasi ta hapë njërën nga tutitë dhe kur të shikojë mbrendësinë e saj plot me dritë si shpërblim i veprave që ka bërë atë orë, robi duke menduar shpërblimin që do t'ia japë Allahu, gëzohet aq shumë sa që, nëse ky gëzim i tij do të mund t'u shpërndahej banorëve të xhehennemit, ata nuk do të ndjenin më dhimbje. Kur të hapë kutinë e dytë, nga kjo do të dalë errësirë dhe erë e keqe. Ja kjo është ora që ka kaluar me mëkate. Me këtë ai mërzitet aq shumë sa që, sikur kjo mërzi do të mund t'iu shpërndahej banorëve të xhen-



netit, ata nuk do ta ndjenin dot kënaqësinë e xhennetit nga tërë ky hidhërim. Hapet edhe kutia e tretë dhe mbrendësia e saj është bosh. Edhe kjo është ora që ka kaluar në gjumë ose me gjëra mubah, por në atë ditë kur do të ndjehet nevoja edhe për shpërblimin e një mirësie të vogël, digjet me zjarrin e pendimit si pikëllimi i një tregtari që humb një fitim të madh kur ka mundësi ta fitojë, madje edhe më shumë, ndërsa tani rri e përpëlitet mes dhimbojeve për atë orë të kaluar kot së koti.

Atëherë, o vetja ime! Mbushe kutinë tënde kur e ke shansin në dorë dhe mos e lër bosh. Mos përto, se përndryshe do të biesh nga gradat e larta!”



Edhe Hazreti Halid Bagdadi, i cili kishte arritur kulmin e dijeve dhahiri dhe batini, e kishte kaluar jetën e tij duke u shqetësuar për frymën e fundit. Në mektubatin e tij u ka dhënë vend edhe këtyre fjalive:

“...Betohem në Allahun se, që kur më ka lindur nëna e deri më sot, nuk besoj se kam bërë qoftë edhe një të mirë që të jetë e pranuar dhe e vlefshme te Allahu dhe që nuk do të kërkohet llogari për të. (Por unë strehohem te mëshira e Zotit tim.) Nëse nuk e shikon veten tënde si të falimentuar në të gjitha punët e mira, kjo është pika më e fundit e injorancës...”<sup>88</sup>

Edhe këto fjali që zënë vend në letrën që Hazreti ia ka dërguar një miku të tij, janë një reflektim i shqetësimit në çështjen e përgatitjes për frymën e fundit:

“...Dua nga ju që të përkushtoheni me gjëra që do t’ju duhen në frymën e fundit, të bëni vepra të mira që i përshtaten sunnetit senijje, të mos lavdëroni bukuritë mashtruese të kësaj bote të përkohëshme, (duke pasur për qëllim veten e tij) të mos harroni që të luteni për suksesin dhe husnu’l –hatime (fund të mirë të jetës) e këtij robi të varfër (domethënë që të jetoj dhe të vdes ashtu si do Allahu).” (Mektubatë Mevlana Halid, fq. 175)

Kështu, duke mos u besuar asnjëherë veprave të tyre, miqtë e mëdhenj të Allahut janë strehuar gjithmonë te mëshira dhe falja e



Allahut në çështjen e frymës së fundit. Atëherë është e domosdoshme që gjithmonë të kërkojmë nga Allahu husnu'l-hatime, pa u besuar dijes dhe veprave tona.

Ishte një shitës që e kishte dyqanin te porta e daljes së qytetit. Sa herë që nga ajo derë kalonte ndonjë xhenaze, hidhte në qypin që kishte pranë nga një farë fruti, dhe kur i numëronte në fund të muajit, thoshte:

“Këtë muaj kanë rënë në qyp kaq vetë!”

Një ditë vdiq edhe ai. Pasi kaloi shumë kohë, një mik i tij që nuk e dinte se ka vdekur erdhi për ta vizituar. Kur se gjeti atë, pyeti komshinjtë:

“Çfarë i ka ndodhur tregtarit që banonte këtu?”

I thanë:

“Edhe ai ka rënë në qyp!..”

Sa fjalë e urtë mësimdhënëse... Të mos harrojmë se në fund të fundit secili do të bie në qypin e exhelit, por njeriu zakonisht i shikon njerëzit që ka përreth duke shkuar një nga një në botën e përhershme, por përsëri e shikon veten larg nga vdekja për shkak të pakujdesisë...



Miku i Javuz Sulltan Selim Hanit, Hasan Xhan tregon kështu:

“Në shpinën e Javuzit doli një çiban që quhet njollë e kuqe. Çibani u rrit në një kohë të shkurtër dhe qe bërë si vrimë. Aq sa nga plaga i shikonim mushkëritë e Javuzit. Ai ishte në një hall të madh. Pothuajse ishte si një luan i plagosur. Ai nuk e pranonte paaftësinë dhe vazhdon-te tu jepte taktika dhe urdhëra ushtarëve të tij. Iu afrova afër. Ai më tha mua duke pasur për qëllim veten e tij:

-Hasan Xhan, ç'është kjo punë?

Ngaqë e ndjeva se tashmë kishte mbërritur në fund të udhëtimit të përkohshëm dhe se ndodhej në prag të jetës së përhershme, gjithë me brengën e ndarjes që më digjte, i thashë:

-O Padishuhu im, tashmë më duket se ka ardhur koha që të jesh



bashkë më Allahun Teala!

Sulltani i lartë u kthye, më pa në fytyrë me habi dhe më tha:

**-Hasan, Hasan! Me kë ke kujtuar se kam qenë deri tani?.. A ke parë ndonjë të metë në dashurinë time ndaj Allahut?**

Duke u turpëruar përpara këtyre fjalëve, thashë:

-Zoti na ruajt o Sulltani im! Nuk doja të thoja këtë. Guxova të ta thosha një gjë të tillë vetëm duke menduar të ardhmen, për të treguar se je ndryshe nga të tjerët në këtë kohë që gjendeni.

Sulltani i lartë, tashmë në një gjendje krejt të humbur në botëra të tjera, si fjalë të fundit më tha:

-Hasan! Lexo suren Jasin!

Vazhdova ta lexoj me lot në sy. Kur arrita te ajeti i Selamit ia kishte dorëzuar Zotit shpirtin e tij të nderuar. Për këtë arsye, që të kemi një vdekje të mirë është e nevojshme që ta jetojmë jetën me një qëllim.



Sulltani Murad Hani II. ishte një personalitet që mendonte për kënaqësinë e Allahut dhe jo për rehatinë e tij. Ai ishte aq i vendosur dhe i fortë, sa që nuk kishte frikë të flijonte edhe jetën e tij në këtë rrugë. Shqetësimi i tij më i madh ishte të jepte frymën e fundit me besim, të dilte përpara Allahut në ditën e tubimit ballëhapur dhe i pastër nga mëkatet. Kështu, pasi martoi të birin dhe vajzat e tij, Ibrahim Pasha i tha vezirit Çandarllë:

“O Çandarllë! Falenderimi i takon Allahut, me lejen e Allahut i kryem edhe detyrat që kishim ndaj femijëve në këtë botë. Gjithë çfarë ka ngelur është të shkojmë në botën tjetër me besim...”



Oficeri Muzaffer, i cili kishte arritur suksese të mëdha në luftën e Çanakkales, luftoi heroisht edhe më pas, në frontin e lindjes. Ai u plagos rëndë gjatë një beteje të përgjakshme. Tashmë, në çastet e fundit të jetës, kur zëri nuk i dilte dhe sytë nuk mund të shprehnin më asgjë, nxori një zarf nga xhepi, mori një shkop nga toka dhe duke e ngjyer atë me gjakun që i dilte nga plaga, filloi të shkruajë:



**“Nga cila anë është kibla?..”**

Ata që gjendeshin afër, të cilët e kuptuan se Muzafferi donte t’ia dorëzonte shpirtin Zotit duke qenë i kthyer me fytyrë kah kibla, ia plotësuan menjëherë këtë dëshirë. Në çastin e vdekjes, fytyra e oficerit që nga njëra anë ishte e mbushur me gëzimin e bashkimit me Zotin, por nga ana tjetër me shqetësimin e fundit që lidhej me mbrojtjen e lartë të qëllimit të shenjtë, u dha këtë mesazh ushtarëve të tij:

**“Ushtarët le ta vazhdojnë luftën, gjaku im të mos ngelë në tokë!..”**

Ai donte të shkruante edhe një mesazh tjetër, por jeta nuk i mjaftoi dhe ia dorëzoi shpirtin e tij Zotit si një dëshmor.

Sa përpikmëri e madhe për një njeri të mundohet të shfaqë qëllimin e tij duke tërhequr gjak nga damarët edhe në frymën e fundit, edhe atëherë kur gjuha nuk mund të shprehë asgjë, për të dhënë shpirt nga kibla. Ja, kështu bëhet e begatë dhe e shenjtë fryma e fundit e jetës që harxhohet në rrugën e Allahut.



Edhe gjendja në frymën e fundit të Hazretit Mahmud Sami Ramazanoglu, i cili ishte nga miqtë e Zotit, përfaqëson një shembull të bukur për ne. Sami Efendi ishte një mik i Zotit dhe e kishte zemrën e mbushur plot me dashuri ndaj Pejgamberit. Ashtu si një njeri i cili e gjen rrugën duke ndjekur gjurmët e dikujt që ka ecur në dëborë, edhe Sami Efendi e kaloi jetën duke ndjekur me besnikëri gjurmët e Pejgamberit të Nderuarit tonë. Si shfaqje e kësaj, atij iu bë risk ta japë frymën e fundit te tij në vende afër Hazretit Pejgamber (s.a.v.s), i përfshirë nga dashuria dhe entuziazmi i ndjekjes së gjurmeve të tij gjatë gjithë jetës, dhe gjatë këndimit të ezanit të tehexhjudit. Ata të cilët që ndodheshin pranë tij në frymën e fundit, dëgjonin se nga gjuha e tij dilnin vetëm fjalët:

**“Allah, Allah, Allah!..”**

Në fakt jo vetëm gjuha e tij por edhe trupi bashkë me gjithë qelizat edhe shpirti i tij, gjithmonë thoshte “Allah”...



Së fundi, për ta dhënë frymën me husnu'l-hatime, domethënë me besim, është e nevojshme që pikësëpari robi ta pastrojë veten dhe zemrën, domethënë të vijë në një gjendje të zbukuruar me natyrë të lartë, duke u pastruar nga gjërat e këqia, dhe të fitojë shfaqjet e esmau'l-husna, emrave të bukur të Allahut, sepse arritja e zemrës me shpejtësi në këtë devotshmëri është kandili më i vlefshëm orientues i udhëtimit të jetës. Edhe këto fjalë të Mevlanës pothuajse e shpjegojnë natyrën e pastrimit:

“Varri nuk bëhet as me gurë as me dërrasë dhe as me copë të trashë. Është e domosdoshme që t’i hapësh vetes një varr në një zemër pa njolla, dhe në botën e pastrimit të brendshëm të shkatërrosh përpara Allahut të lartë inatin dhe egoizmin tënd.”

Pastaj duke bërë adhurime, duke u bindur, duke bërë të mira dhe duke dhënë lëmosha me brendi të pastruar, është e domosdoshme të përgatitemi për botën e përhershme në mënyrë sa më të bukur.

Po ashtu, robit të tij që e ka zbukuruar jetën e vet me vepra të mira dhe nuk e ka harruar asnjëherë, në frymën e fundit Zoti i jep këtë përgëzim të bukur:

**“Pa dyshim se atyre që thanë: “Zoti ynë është Allahu” dhe ecën në rrugë të drejtë, atyre (në prag të vdekjes) u vijnë ëngjëjt dhe u thonë: mos kini frikë, mos u mërzisni dhe gëzohuni me khennetin që u është premtuar.”** (Fussilet, 30)

**Allahu na e dhashtë të gjithëve hyrjen në natyrën e këtij përgëzimi!**

**Amin!..**



# *Djesa e dytë*



*Personaliteti  
dhe  
vendosmëria shpirtërore*





## 1. Dashuria

Dashuria është ëmbëlsia, gëzimi, qetësia dhe hareja e jetës sonë. Brumi i ekzistencës është rrahur me majanë e dashurisë. Fuqia e dashurisë është nga mirësitë më të mëdha që Zoti ua ka dhënë robërve të tij. Për këtë arsye është e nevojshme që dashurinë ta mbajmë në zemra që kanë arritur të vërtetën e miqësisë, por sa keq që shumë njerëz e harxhojnë dashurinë në rrugë të përkohëshme dhe për dëshirat vetjake. Çfarë vlere dhe nderi mund të ketë një zemër e cila është ngurtësuar aq shumë, sa të mos ndjejë nevojë dashurie për Zotin e tij?

Për ata që e privojnë veten nga dashuria për Allahun, duke e harxhuar dhuratën e dashurisë në rrugën e gjërave të përkohshme dhe relative, Hazreti Mevlana jep këtë shembull mësimdhënës:

*“Ata që i japin zemrën kësaj bote, janë krejt si gjuetari që gjuan në hije. Si mund të jetë hija gjahu i tyre? Po ashtu një gjuetar i çmendur kujtoi se hija e zogut ishte zog dhe deshi ta kapte, por edhe zogu që ishte në degë u habit ndaj kësaj çmendurie.”*

Të ndjekësh njërën nga faqet e dashurisë së përkohëshme si pasuria, prona, pozita, paraja, familja dhe fëmijët dhe duke harruar “**Takimin me Allahun**”, që është qëllimi i fundit ku do të arrihet, kjo do të thotë humbje e botës shpirtërore. Një poet e ka sqaruar kështu këtë të vërtetë:



*Nxirr nga zemra jote gjithçka, që Zoti të mbetet në zemrën tënde,  
Padishahu nuk hyn në saraj pa u ndërtuar e gjitha...*

Fitorja e të çmendurit është mosndjekja e Lejlës që ia ngatërronte mendjen dhe mendimet, domethënë mospranimi i saj si gjëja e fundit në rrugën e Zotit. Lejla në këtë rrugë të vështirë për dikë ishte një lloj i kundërt, për dikë pasuri dhe për dikë pozitë. Këto dashuri, që janë quajtur figurative, patjetër duhet të bëhen urë e dashurisë së vërtetë.

### **a. Dashuria ndaj Allahut (Muhabbetullah)**

Njeriu fiton një gradë në lidhje me përshtatjen ndaj qënies për të cilën ndjen dashuri. Duke u udhëhequr nga prirja për të dashur, gjë që është në natyrën e saj, zemra e njeriut arrin përsosmërinë në dashuri vetëm kur t'ia drejtojë atë Allahut, sepse e vetmja qenie që e meriton dashurinë e vërtetë, është Allahu Teala, i cili është edhe burimi i të gjitha dashurive. Sepse:

-Ai është krijuesi i çdo gjëje, është Ai u jep shpirt dhe rizik krijesave, i vetmi që është i përsosur, i fortë, absolut dhe që i mbron dhe kujdeset për to.

-Ai i do shumë robërit e tij. E krijoi Ademin në xhennet në formën më të bukur dhe me një përkujdesje të madhe. Ai dëshiron që edhe robërit e tij të hyjnë në xhennet. Shpërblimi i dashurisë është vetëm dashuria.<sup>1</sup>

-Ai ua ka lehtësuar robërve rrugët e takimit dhe të dashurisë për te Ai.

-Ai është sunduesi i vetëm i kësaj bote dhe i ahiretit.

-Më në fund njeriu do të dalë përpara Allahut dhe nuk do të gjejë asnjë vend strehimi dhe ndihme përveç Atij. Sa i mirë dhe sa ndihmues është Allahu, i cili është Zoti i botrave!

-Krahas gjithë këtyre mirësive hyjnore që kemi, borxhi ynë për fale-



nderimin e Allahut është i pafund, sepse na bëri ummet të Pejgamberit që na do shumë dhe sepse na bëri rizk Kur'anin Fisnik.

Për këtë arsye, është domosdoshmëri e adhurimit tonë që dashurinë t'ia japim Allahut Teala.

Padyshim se dashuria shfaqet ndyshe te të dashurit dhe dijetarët që janë miq të Zotit. Për shkak të këtyre shfaqjeve te ndryshme, Hazreti Mevlana është bërë një burim shpirtëror dhe urtësie, aq sa nga goja e tij shpërthenin urtësi dhe perla të rralla në oqeanin e pafund të fjalës dhe me zjarrin e dashurisë i digjte zemrat. Mansur Hallaxhi ka fituar arritjen hyjnore në klimën e dashurisë hyjnore, që e ka bërë të përkohshëm atë që dashuron në atë që dashurohet. Hazreti Bahauddin Nakshibend me vite ishte bërë një njeri i sinqertë për hir të Allahut dhe një det i pafund në mrekulli dhe në njësim me Allahun, duke u përkujdesur për kafshët e plagosura dhe të mjeruara, duke u marrë me pastrimin e rrugëve dhe me shërimin e sëmundjeve prej të cilave iknin të gjithë. Rrugët janë të ndryshme, por kapitali shpirtëror gjithmonë është i njëjtë: të jesh i mbushur me dashuri dhe me muhabbetullah...

Allahu, të gjithë miqve të Tij që kanë arritur shfaqje të tilla të ndryshme, duke i zbukuruar në të vërtetë me dashurinë dhe njësimin me Të, u ka dhuruar gjendje gonxhesh të veçanta në klimën e dashurisë.

Së fundi një besimtar i cili e do Allahun, duhet ta kuptojë dhe konceptojë që në të vërtetë nuk ka pronësi mbi asgjë, sepse dashuria nuk mirëkuptohet me pronësi por me sakrifikim. Domethënë është e nevojshme që ai i cili dashuron, të kalojë me gjithçka nëpër rrugën e atij që e dashuron. Dashuria lind në zemër një ndjenjë nderimi material dhe shpirtëror si diçka e natyrshme. Për këtë arsye njerëzit i paguajnë vlerat e tyre më të mëdha si barazvlerë me dashurinë. Kjo shfaqet si një tablo sakrifice e cila mund të arrijë deri në dorëheqjen nga mirësitë e jetës për hir të atij që dashuron.

Sa mirë për ata besimtarë që dashurinë për Allahun dhe të të Dërguarit të Tij e mbajnë më lart se gjithçka dhe që nuk gënjejn nga lulet fallso të bahçeve të huaja!...



## Tabllo të virtytshme

Pa dyshim që personaliteti më i lartë në çështjen e dashurisë ndaj Allahut është Pejgamberi ynë i Nderuar (s.a.v.s). Në lutjet e tij, duke kërkuar dashurinë e Allahut Teala, ai përsëriste vazhdimisht këtë lutje të Davudit alejhisselam:

اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ حُبَّكَ وَحُبَّ مَنْ يُحِبُّكَ وَالْعَمَلَ الَّذِي يُبَلِّغُنِي حُبَّكَ  
اللَّهُمَّ اجْعَلْ حُبَّكَ أَحَبَّ إِلَيَّ مِنْ نَفْسِي وَأَهْلِي وَمِنَ الْمَاءِ الْبَرْدِ

*“O Zoti im! Kërkoj nga ti dashurinë tënde, dashurinë e atyre që të duan Ty dhe veprën që më dërgon te dashuria jote. O Zoti im! Ma bëj dashurinë tënde më të dashur se vetja ime, më të dashur se familja ime, më të dashur se pasuria ime dhe më të dashur se uji i ftohtë!”*  
(Tirmidhi, Deavat, 72/3490)

Ja një lutje tjetër e Pejgamberit tonë të Nderuar në lidhje me këtë çështje:

*“O Zoti im! Ma bëj rizik dashurinë tënde dhe dashurinë e dikujt që është i dobishëm te Ti. O Zoti im! Bëji fuqi mirësitë që mi ke dhënë dhe të cilat i dua për të bërë vepra të mira që Ti i do dhe je i kënaqur prej tyre. O Zoti im! Edhe gjërat që nuk i kam, bëji shkak që mendjen time ta përqendroj në gjërat që Ti i do dhe që t’i drejtohem plotësisht bindjes ndaj teje.”* (Tirmidhi, Deavat, 73/3491)

Sipas rregullit “I dashuri nuk e harron kurrë atë që e dashuron dhe e mendon gjithmonë.”, Edhe Pejgamberi, i Nderuar ynë, në çdo situatë e përkujtonte Allahun dhe i bënte lutje në çdo lëvizje, duke menduar gjithmonë mbi cilësitë, fuqinë, shfaqjet madhështore dhe mbi mirësitë e Tij që na ka falur. Po ashtu, kur hynte në një vend, kur dilte nga atje, kur ulej, kur ngrihej, kur fillonte ndonjë punë, kur e mbaronte atë, ai lutej. Lutjet që bënte në kohëra dhe vende të ndryshme kishin arritur sasi të atillë sa ashabët pothuajse e kishin të pamundur t’i mësonin përmendësh, arsye për të cilën ishin të detyruar t’i kërkonin të bënte lutje të shkurtëra dhe esenciale.



Sa mësimdhënës është ky transmetim i cili na bën me dije se ai që arrin dashurinë e Zotit, do të fitojë kënaqësinë e Tij dhe frikërespektin:

Një ditë ashabët e nderuar e pyetën të dërguarin e Allahut (s.a.v.s):

“Një besimtar e shikojmë që ka hushu, ndërsa një tjetër e shikojmë të privuar nga hushuja. Kush është shkaku i këtij ndryshimi?”

I Dërguari i Allahut (s.a.v.s) u përgjigj:

*“Ai besimtar që shijon besimin, ka hushu. Ndërsa ai besimtar që nuk e shijon besimin, ai nuk mund të ketë hushu!”*

Kur u pyet: “Si fitohet shijimi i besimit, si mund të arrihet kjo?” Pejgamberi ynë i Nderuar tha:

*“Kjo arrihet duke qënë i sinqertë në dashurinë ndaj Allahut.”* Ashabët e nderuar këtë herë pyetën:

“Me çfarë fitohet dashuria ndaj Allahut?”. Pejgamberi i Nderuar tha:

*“Dashuria ndaj Allahut fitohet me dashurinë ndaj të Dërguarit të tij. Për këtë shkak, kënaqësinë e Allahut dhe të të Dërguarit të tij kërkojeni duke ushqyer dashuri përsëri ndaj Allahut dhe të të Dërguarit të tij.”* (Senderusi, Keshf-i Ilahi, II, 651; Halebi, Mevsuatu'l-Ehadis, VI, 492/16010)



Pejgamberi ynë i Nderuar (s.a.v.s), i cili e kaloi të gjithë jetën e tij me dashuri dhe mall ndaj Allahut Teala, edhe çastin e takimit me Zotin e priti me entuziazmin e natës së dasmës. Aishja, nëna jonë tregon:

“Kur i dërguari i Allahut po jetonte çastet e fundit, e kishte kokën të mbështetur te kraharori im. Unë kërkoja shërim për të duke thënë: O Zoti i njerëzve! Vetëm ti e shëron sëmundjen! Ti je shërues i vërtetë dhe ai që jep shërim! Ndërsa Pejgamberi, i Nderuari ynë vazhdonte lutjen duke thënë:

*-Jo! O Allahu im më bashko me Refiku'l-A'la (me Mikun më të Lartë). O Allahu im! Më fal mua! Më fal mëshirën tënde! Më bashko*



*me Refiku'l-A'la.*” (Ahmed, VI, 108, 231)

Në një transmetim tjetër Aishja nëna jonë e tregon kështu vazhdimin e ngjarjes:

“Në ditët kur ishte shëndosh, Hazreti Pejgamber (s.a.v.s) thoshte shpesh herë:

*Asnjë Pejgamberi nuk i merret shpirti pa e parë vendin e tij në xhennet! Pastaj lihet i lirë ndërmjet qëndrimit në këtë botë dhe shkuarjes në vendin e tij në xhennet!* Kur u sëmur dhe kur iu afrua vdekja, kokën e kishte mbi gjurin tim dhe i ra të fikët. Kur erdhi në vete, i ktheu sytë nga tavani i shtëpisë dhe tha:

*O Allahu im! Refiku'l-A'la!*

Atëherë unë thashë:

I Dërguari i Allahut nuk na zgjodhi ne! E kuptova se lutja e të Nderuarit tonë ishte një shenjë e lajmit që do t'i ndodhte, gjë që na e thoshte ne kur ishte shëndosh!” (Buhari, Megazi, 84; Ahmed, VI, 89)

Kjo bisedë që ndodhi ndërmjet të nderuarit të Botrave dhe ëngjëllit të vdekjes gjatë çasteve të vdekjes së tij, e tregon në një mënyrë më të qartë muhabbetullahin që kishte i Dërguari i Allahut ndaj Allahut.

Kur erdhi çasti i vdekjes së Krenarisë së Gjithësisë, të Nderuarit tonë, ëngjëlli i vdekjes kërkoi leje për të hyrë brenda. Xhebraili alejhis-selam tha:

“O Ahmed! Ky është ëngjëlli i vdekjes. Po kërkon leje që të vijë te Ti. Ai siç nuk ka kërkuar leje për të hyrë te asnjë përpara teje, nuk do të kërkojë leje për të hyrë te asnjë edhe pas teje. Jepi leje që të hyjë!”

Ëngjëlli i vdekjes, pasi hyri brenda, qëndroi përpara Pejgamberit dhe tha:

“O i Dërguari i Allahut! O Ahmed! Allahu i lartë më ka dërguar te ti dhe më ka urdhëruar që t'i bindem çdo urdhërit tënd. Nëse më urdhëron që të ta marr shpirtin, do të ta marr, nëse më urdhëron që të ta lë, do të ta lë shpirtin!” I Dërguari i Allahut e pyeti:



“A me të vërtetë do ta bësh këtë?” Ëngjëlli i vdekjes tha:

“-Unë jam urdhëruar të të bindem Ty në çdo çështje!”

Në këtë moment Xhebraili alejhisselam tha:

“O Ahmed! Allahun e ka marrë malli për Ty!” I Nderuari ynë (s.a.v.s) tha:

*“Ai që është te Allahu, është më i mirë dhe më i vazhdueshëm! O ëngjëlli i vdekjes! Eja dhe kryeje atë që je urdhëruar të bësh! Merrma shpirtin!”<sup>2</sup>*



Në çështjen e dashurisë ndaj Allahut mund të jepen shumë shembuj edhe nga pejgamberët e tjerë: një pjesë nga këto mund t'i përmendim kështu:

Allahu Teala i kishte dhënë Ibrahimit alejhisselam aq shumë kope delesh sa që nuk mund të numëroheshin. Xhebraili alejhisselam duke ardhur në formën e njeriut, e pyeti:

“Të kujt janë këto kope? A mund të ma shesësh mua njërën nga kopetë?”

Ibrahimi alejhisselam tha:

“Këto kope janë të Zotit tim. Tani gjenden te unë si amanet. Nëse e përmend Atë një herë, merr një të tretën, nëse e përmend tri herë, merri të gjitha!”

Kur Xhebraili alejhisselam e përmendi Zotin tr herë:

سُبُوْحٌ قُدُّوسٌ رَبُّنَا وَرَبُّ الْمَلَائِكَةِ وَالرُّوحِ

“Zoti ynë është Zoti i Xhebrailit dhe i ëngjëjve të nderuar. Ai është larg çdo mangësie dhe është i lartë.”, Ibrahimi alejhisselam tha:

“Merri të gjitha, janë të tuat!” Xhebraili alejhisselam tha:

2. Ibn Sa'd, II, 259; Hejsemi, IX, 34-35; Belazuri, Ensabu'l-Eshraf, Egjipt 1959, I, 565.



“Unë nuk jam njeri, jam ëngjëll, nuk mund t’i marr.” Ibrahim alejhisselam u përgjigj duke thënë:

“Nëse ti je ëngjëll, edhe unë jam Halil (miku i Allahut). Nuk më ka hije mua ta marr atë që e dhashë.”

Së fundi Ibrahim alejhisselam i shiti të gjitha kopetë. Mori një pronë dhe e fali për hir të Allahut.

Ibrahimi alejhisselam ka kaluar një sprovë të rëndë me jetën, fëmijët dhe me pasurinë. Në të gjitha iu bind Zotit me një nënshtrim dhe dashuri të madhe. Ai arriti kulmin e adhurimit si Halilullah (miku i Allahut).



Ja historia e një sahabiu i cili e shfaqte me fjalën e Allahut dashurinë hyjnore që kishte në zemër:

I Dërguari i Allahut (s.a.v.s) e kishte dërguar këtë sahabi si komandant në krye të një grupi ushtarak. Ky sahabi i nderuar e falte namazin si imam dhe në çdo rast që lexonte Kur’an në namaz, e mbaronte leximin me suren Ihlas. Kur u kthyen në Medinetu’l-Munevera, ia treguan këtë të Dërguarit të Allahut. I Nderuari ynë tha:

“Pyeteni atë se përse ka vepruar kështu!” Kur shokët e tij e pyetën për arsyen, sahabiu u përgjigj:

“Kjo sure shpjegon atributet (cilësitë) e Rrahmanit (Mëshiruesit). Për këtë arsye më pëlqen ta lexoj.

Pejgamberi ynë i Nderuar i cili e dëgjoji këtë, tha:

*“I thoni atij se edhe Allahu Teala e do atë.”* (Buhari, Tevhid, 1)



Kur po kalonte në bregun e lumit Euftrat për të marrë pjesë në një luftë, Ammar bin Jasir radijallahu anhu e shprehte në këtë mënyrë dashurinë që kishte ndaj Allahut:

“O Allahu im! Sikur ta di se nëse hidhem nga ky mal, kjo do të jetë shkak që të kënaqesh më shumë nga unë, do ta bëja menjëherë këtë.

Sikur ta di se, nëse hidhem në zjarr, kjo do të jetë shkak që të këna-





qesh më shumë nga unë, do ta bëja menjëherë këtë. O Zoti im! Sikur ta di se, nëse mbytem duke u hedhur në ujë, kjo do të jetë shkak për të fituar më shumë kënaqësinë tënde, edhe këtë do ta bëja menjëherë. O Allahu im! Unë po luftoj vetëm për Ty dhe të bëj lutje që të mos humbas, sepse unë të dua Ty.” (Ibn Sa’d, III, 258)



Abdullah bin Omer radijallahu anhu ishte njëri nga më të pasurit e sahabëve të nderuar. Ai nuk e mblihdhte (kursente) pasurinë e tij, por ua jepte të varfërve atë që kishte. Atë çfarë ai donte më shumë nga gjërat që kishte, e ndante për ta harxhuar në rrugë të Allahut. Ai pati filluar të lironte të gjithë robërit e tij që ishin në gjendje të mirë, veçanërisht kur i dëgjonte se falnin namaz. Njëri nga miqtë e tij e qortoi dhe i tha: disa nga robërit e tu nuk vijnë në xhami për hir të Allahut, por vijnë me qëllim vetëm për tu liruar. Hazreti Abdullah dha këtë përgjigje të shkëlqyer që reflekton dashurinë që kishte në zemër ndaj Allahut:

“Ne jemi të kënaqur të mashtrohemi ndaj atyre që duan të na mashtrojnë duke u shtirë sikur e kanë për hir të Allahut!” (Ibn Esir, Usdu'l-Gabe, III, 343)



Hazreti Fudajl bin Ijas ishte një njeri dijetar, i devotshëm dhe qante shumë për shkak të frikës që kishte ndaj Allahut. Ky njeri u takua me zonjën Shi’vane, e cila jetonte në të njëjtën kohë. Ajo ishte e devotshme, adhuruese shumë e mirë dhe qante shumë nga dashuria dhe frika që kishte ndaj Allahut. Fudajli i tha:

“Lutu për mua.” Zonja Shi’vane u përgjigj:

**“O Fudajl! A nuk ka ndonjë afërsi ndërmjet teje dhe Allahut që Ai të të pranojë lutjen tënde kur të lutesh, por kërkon lutje nga unë.”**

Kur dëgjoji këto fjalë të mrekullueshme, Fudajli kaloi nga vetja duke u mbytur në britmat e tij.<sup>3</sup>



3. Ibnu'l-Xhevzi, Sifatu's-Safue, IV, 56.



Sipas transmetimeve, kjo lutje që ka bërë Mensur Hallaxhi para se të ekzekutohej, e shpreh shumë bukur gradën e dashurisë dhe sinqeritetin që ai kishte ndaj Allahut:

“O Zoti im! Robërit e Tu janë mbledhur për të më vrarë mua për shkak të afërsisë që kanë me Ty dhe për shkak të lidhjes që kanë me fenë e tyre. Fali ata, sepse po t’ua kishe dhënë edhe atyre të fshehtat që më ke dhënë mua, nuk do të trajtonin kështu. Por, sikur t’i kishe fshehur nga unë gjërat që ua ke fshehur atyre, nuk do të gjendesha në një vend të tillë që më shikojnë të gjithë. O Zoti im fali ata, sepse ata po më dërgojnë te Ti.”

Prej atyre që e shikonin gjendjen e Hallaxhit në botën shpirtërore, transmetohet se, kur e varën në shtyllë, i erdhi iblisi dhe e pyeti:

“-Ene<sup>4</sup> the ti, ene thashë edhe unë. Si ka mundësi që ti të mëshirohesh ndërsa unë të mallkohem!”

Hallaxhi iu përgjigj djallit kështu:

“-Ti, duke thënë ene e pranove veten tënde më të lartë se Ademi dhe e shfaqe mendjemadhësinë tënde. Ndërsa unë e bashkova veten time me Zotin duke thënë Ene’l-Hak. Mendjemadhësia e cila është shfaqja e egoizmit, është shenjë e xhehennemit. Ndërsa të zhdukësh egoizmin, domethënë të bashkohesh me Zotin është të shprehurit e asgjësë. Për këtë arsye mua më zbriti mëshira, ndërsa ty mallkimi dhe poshtërimi.”

Transmetohet se Hallaxhi i ka thënë kështu Ibrahim bin Fatikut i cili e vizitoi:

“O biri im! Disa njerëz mendojnë se unë kam rënë në kufër, ndërsa disa të tjerë janë të bindur se unë jam mik i Zotit. Ata të cilët e shpallin kufrin tim, janë më të dashur te Allahu dhe te unë se sa ata që thonë se unë jam mik i Zotit.”

Ndërsa kur iu tha: “O i Nderuari ynë, përse thua kështu?”, ai u përgjigj:

“Ata që besojnë se unë jam mik i Zotit thonë kështu për shkak se



mendojnë mirë për mua, ndërsa ata që shpallin kufrin tim, thonë kështu për shkak të dashurisë që kanë për fenë. Ata që janë të sinqertë ndaj fesë së tyre, janë më të dashur te Allahu se sa ata që mendojnë mirë për të tjerët.”



Sa bukur e shpreh Hazreti Mevlana djegien e zemrës me dashuri hyjnore në fena-fillah dhe beka-billah dhe se ky zjarr që ndizet në shpirt nuk do të shuhet edhe me vdekje:

“Pasi të vdes, hape varrin tim dhe shiko se si ngrihen tymëra nga qefini im për shkak të zjarrit të shpirtit tim! Ai që e bën të frikshme vdekjen është ky kafaz trup. Kur ta thyesh trupin me dashuri si sedef, do të mund ta shohësh edhe ti se vdekja i ngjan një perle!..”

Edhe njëra nga veçoritë më të rëndësishme të miqve të Allahut është djegia me dashurinë hyjnore. Përsëri Hazreti Mevlana ka kërkuar gjatë gjithë jetës të dashuruar të vërtetë që digjen në dashurinë që përmendet në fjalët e mësipërme. Këtë dhëshirë të tij e shpreh kështu:

“Mua më duhet një dashuri e tillë që të shpërthejë kiameti nga flakët e brendshme, që të mund t’i bëjë hi edhe zjarret me nxehtësinë e zemrës!..”



Një nga miqtë e Allahut e pyeti Hazretin Maruf Kerhin:

“O Maruf! Çfarë është ajo që të tërheq kaq shumë në adhurim?”

Hazreti heshti. Shoku i tij duke këmbëngulur, i tha:

“-Mos vallë kujtimi i vdekjes?”

Maruf Kerhi tha:

“Çfarë është vdekja që përmende?”

“Mos vallë të menduarit e varrit dhe botën e berzahut?”

“Çfarë është varri që përmende?”



Shoku i tij vazhdoi të këmbëngulte përsëri:

“Mos vallë frika e xhehennemit apo shpresa e xhennetit?”

Pas kësaj Hazreti Maruf Kerhi dha këtë përgjigje të shkëlqyer:

“Po këto çfarë janë?! Ajo qënie e lartë që i mban këto gjëra është Zoti i lartë dhe nëse ndaj Tij ke një dashuri dhe përmallim të thellë, të bën t'i harrosh të gjitha ato që the ti. Pastaj, mes teje dhe Allahut lind një marifet dhe dashuri, përmes të cilave Ai të shpëton nga të gjitha ato që the!”<sup>5</sup>



Edhe gjendja e Mexhnunit është shumë tërheqëse nga aspekti i reflektimit të gjendjes së atyre që kanë fituar dashurinë e Allahut:

Një ditë, krejt papritur Mexhnuni u sëmur dhe ra në shtrat nga vuajtja se qëndronte pa Lejlën. Thirrën një doktor për ta mjekuar. Doktor i tha:

“Nuk ka rrugë tjetër, duhet të të marr gjak nga damari!”.

Kështu ia lidhi krahun Mexhnunit për të bërë haxhamat. Sapo pati marrë bistrinë në dorë, Mexhnuni i tha:

“O doktor, lëre haxhamatin! Merr pagesën dhe ik! Nëse vdes nga kjo sëmundje le të vdes, nuk ka ndonjë humbje. Çfarë ndryshimi ka nëse jeton apo vdes ky trup i vjetëruar?!”

Doktori e pyeti habitur Mexhnunin:

“Ti nuk ke frikë nga ulërimat e luanëve në shkretëtirë, por ke frikë për të dhënë gjak?”

Mexhnuni u përgjigj kështu:

“Unë nuk kam frikë nga bistruria... E di gjithë bota se durimi im është më i madh se një mal me shkëmb! Unë jam një njeri që nuk kam frikë nga asgjë dhe nuk kam as edhe një kashtë; trupi im nuk qetësohet po nuk u plagos! Plagët janë ilaçi i dashurisë sime; për këtë arsye kam shumë dëshirë të plagosem...”



Por trupi im është i mbushur plot me Lejlën; përveç Lejlës nuk ka asnjë gjë tjetër! Trupi im i cili është si guackë, është i mbushur me cilësitë e asaj perle. Për këtë arsye o doktor, kam frikë se kur të më bësh haxhamatin bisturia do t'i bierë Lejlës dhe do ta plagosë e do ta lëndojë...

Sepse robërit e veçantë të Allahut e dinë mirë se nuk ka dallim ndërmjet Lejlës dhe meje.”

Lejla erdhi te Mexhnuni pas disa vitesh. Mexhnuni nuk u interesua me të. Lejla i tha:

“A nuk je ti ai që ecje në shkretëtirë për mua?” Mexhnuni u përgjigj:

“Lejla që ndryshonte dhe ishte hije u tret dhe doli nga lidhja.”

Lejla, e cila dikur ishte qëllimi i jetës së Mexhnunit, kishte formuar një shkallë ndaj dashurisë hyjnore. Kur Mexhnuni e gjeti të vërtetën që kërkonte në botën e dashurisë hyjnore, roli i Lejlës mbaroi në jetën e tij.

Lejla, e cila përmendet në tregimet e Mesnevisë, është simboli i dashurisë hyjnore që kthehet te dashuria hyjnore dhe që e bashkon personalitetin e saj me Zotin. Thënë me fjalë të tjera, Lejla është një horizont dashurie hyjnore që i çmend zemrat dhe që e bën zero dëshirën fizike. Nga ky aspekt, nëse aventurat e dashurisë që fillojnë me Lejlat gjejnë qetësi te Mevla, fitojnë një vlerë të lartë.



Mexhnuni i cili ecte nëpër shkretëtira për hir të Lejlës dhe të dashurisë ndaj saj, po ledhatonte një qen të cilit i rridhnin jargë nga goja, e përkëdheltë dhe e puthte nga sytë. Dikush që e pa këtë situatë të tij, nuk duroi dhe i tha:

“O Mexhnun i papërvojë! Çfarë është kjo çmenduri që bën? Përse e përqafon dhe e puth atë kafshë?” Mexhnuni u përgjigj:

“Ti nuk mund ta kuptosh këtë që bëj, sepse kur ti je i përbërë kokë e këmbë nga forma! Hyr mbrenda, domethënë hyr në botën time të



shpirtit dhe shikojë një herë atë edhe me syrin tim! A e di se çfarë vlerë ka ky qen?! Në këtë qen ka një të fshehtë hyjnore që ti nuk mund ta gjesh. Allahu ka fshehur në zemrën e tij thesarin e dashurisë dhe besnikërisë që ai ndjen ndaj të zotit të tij. Dhe shiko, ky ka shkuar në shumë fshatra, por ka zgjedhur fshatin e Lejlës si vend për të qëndruar dhe për ta ruajtur!..

Mos thuaj se është qen duke e trajtuar si të pavlerë, shiko mundimin e tij. Ai është Kitmiri fytyrëbekuar i botës sime shpirtërore. Ai është ortaku im i gëzimit dhe i mërzitjes. Qimen e këtij nuk e ndërroj edhe me luanë. Ti ki kujdes ndaj zemrës, shpirtit dhe dijenisë së tij, ashtuqë të arrishë të shikosh mirësinë e tij!.. Për mua është e vlefshme edhe toka që ka shkelur këmba e qenit që e ka bërë vendbanim fshatin e Lejlës...”

Një zemër e cila digjet me dashurinë e Allahut, i do të gjitha krijesat e Tij për shkak të kësaj dashurie. Çdo gjë që të kujton Allahun, sipas gradëve që ka ndaj Tij, e konsideron një vlerë shumë të shtrenjtë.



Një mik i Zotit transmeton këtë ngjarje që tregon virtytin e dashurisë ndaj Allahut:

Po kaloja nga një luginë e gjerë dhe e qetë. Takova një bari të çuditshëm. Pashë se po falte namaz me një hushu të thellë dhe kopenë e tij e ruanin ujqërit. U habita. Prita me merak derisa fali namazin dhe e pyeta:

“O bari! Si ka mundësi që ujqërit janë bërë miq me delet e tua? Si ka mundësi që shpirti armik i tyre ia ka lënë vendin paqes dhe dashurisë?”

Bariu i devotshëm, të cili i ishte bërë fytyra dritë për shkak të sexhdes që i bënte Allahut, u përgjigj kështu:

“O udhëtar i huaj! E fshehta e miqësisë së këtyre ujqërve me delet është e lidhur me miqësinë ndaj Zotit të çobanit, kopesë dhe të ujqërve. Domethënë kjo situatë është një e fshehtë në dashuri.



Ai që dashuron, e flijon gjithçka për hir të atij që dashuron. Kjo ngjarje që tregon Hoxha Xhami -kuddise sirruh- është nga ky lloj:

Në mexhlin e kuvendit të Dervishit tonë Mevlana Sadeddin Kashgari ndodhej një i ri. Ky djalosh kishte përparuar më shumë duke qëndruar gjatë në një vend për të bërë adhurim dhe në dashuri. Edhe ai, ashtu si unë kishte rënë në dashuri ndaj një të bukure. Kështu që të gjithë vlerën që kishte mbledhur në zemër, në një çast ia kishte dhënë asaj ane.

Ai kishte marrë një dhuratë prej floriri dhe argjendi, e kishte lënë në rrugën ku do të kalonte ajo dhe ishte fshehur në një qoshe që të mos e merrte ndonjëri prej të rinjve. Sipas mendimit të tij, e dashura e tij do të kalonte atje dhe pasi ta shikonte dhuratën, do ta merrte. Por ai nuk e dinte nga cila anë dhe si do të vinte ajo. Kur e mësova këtë situatë, i thashë atij:

“Sa punë të çuditshme po bën! Gjënë që e ke fituar me shumë përpjekje, e le në rrugën e saj! Nëse e gjen, pra po e shikoi dhe po e mori, ajo nuk do ta marrë vesh se kush ia ka bërë atë dhuratë. Të paktën gjej një mënyrë që ajo ta dijë se dhuratën e ka prej teje!”

Djaloshi, duke u dridhur me lot në sy, u përgjigj:

“Çfarë po më thua? A pandeh se nuk e di unë këtë gjë të çuditshme që bëj! Unë nuk pres ndonjë shpërblim ndaj kësaj punë që bëra, sepse unë nuk dua që ajo të më bëjë ndonjë mirësi për shkak të dhuratave të mia!”

Unë u drodha nga kjo përgjigje. Nëse dashuria figurative ndaj diçkaje të përkohshme shfaq një thellësi, imtësi, hijeshi dhe bukuri shpirtërore të tillë, kush e di sa shfaqje të larta reflektojnë ata të cilët fitojnë “dashurinë hyjnore”.



Së fundi, Pejgamberi ynë i Nderuar thotë:

“*Allahu është i bukur dhe e do bukurinë!*” (Muslim, Iman, 147)

Nisur nga kjo, Allahu i cili zotëron të gjitha bukuritë, në të njëjtën



kohë është edhe burimi i dashurisë së vërtetë, sepse Ai është **Vedud**.<sup>6</sup> Ky emër fisnik që ka kuptimin “ai që do shumë”, ka po ashtu edhe kuptimin “ai që duhet shumë”.<sup>7</sup> Për këtë arsye, detyra e besimtarit është që të shndërrohet në një derë mëshire që u jep zemrave dashurinë hyjnore, sepse besimtari nuk mund të arrijë plotësisht “Siratu’l-Mustekim”, derisa dashuria që ka për Zotin të mos jetë bërë më e lartë se dashuria që ndihet për gjërat e tjera. Në ajetin fisnik, Allahu thotë:

“...Dashuria që kanë besimtarët ndaj Allahut është e fortë...” (el-Bakara, 165)

Në një ajet tjetër fisnik shprehet se kjo gjendje është e domosdoshme për besimtarët:

**“Thuaj (o i dërguar): “Në qoftë se etërit tuaj, vëllezërit tuaj, bashkëshortet tuaja, farefisi juaj, pasuria që e fituat, tregëtia që frikësoheni se do të dështojë, vendbanimet me të cilat jeni të kënaqur, (të gjitha këto) janë më të dashura për ju se All-llahu, se i Dërguari i Tij dhe se lufta për në rrugën e Tij, atëherë, prisni derisa All-llahu të sjellë vendimin e Tij. All-llahu nuk vë në rrugën e drejtë njerëzit e prishur.”** (et-Teube, 24)

Për të fituar dashurinë e Allahut, është e domosdoshme që ta njohësh Allahun në zemër, domethënë të fitosh shfaqjet e Esmau’l-Husna (emrave të bukur) të Tij.

Përkujtimi i Allahut bëhet shkak për lartësim në istikametin e dashurisë së Allahut, por ky lartësim realizohet në lidhje me të bërit e dhikrit, domethënë në lidhje me shkallën e të ndjerit në zemër.

Krenaria e Gjithësisë, i Nderuari ynë (s.a.v.s) thotë:

*“Shenja e dashurisë ndaj Allahut është dashuria për të përmendur Allahun.”* (Sujuti, II, 52)

Për të përparuar në istikametin e dashurisë ndaj Allahut, është e nevojshme që zemra të fitojë një përshtatshmëri dhe mjaftueshmëri për ta dërguar dërgojë te ajo. Kjo mund të fitohet me mësimet dashurie njerëzore. Për këtë arsye, për shkak se formon një përgatitje

6. Shik. el-Buruxh, 14.

7. Fahrud-din Razi, Mefatihul-Gajb (et-Tefsiru’l-Kebir), Bejrut 1990, XXXI, 112.





për zemrën, dashuria njerëzore shikohet në masat e lejuara me syrin e tolerancës dhe përkujtohet me emrin “dashuri figurative”. Ashtu si dashuria e një njeriu që ka për familjen e tij...

Të arrish dashurinë e Allahut duke vazhduar në këtë gjendje, realizimi i qëllimit të krijimit të njeriut do të thotë të fituarët e kënaqësisë e Allahut, sepse në Islam kulmi i obligimeve hyjnore dhe qëllimi i fundit që i parashtrahet njeriut, është të bëhet “njeri që të arrijë te Allahu”. Kapitali më i rëndësishëm i kësaj është dashuria. Veprat e tjera janë shfaqje e kësaj dashurie.

Një besimtar që arrin njësimin dhe dashurinë e Allahut, largohet nga të këqiat e vetes e tundimet e shejtanit dhe jeton vetëm duke kërkuar kënaqësinë e Allahut. Atij i hapen faqet e librit të gjithësisë dhe bëhet mik me të gjithë krijesat. Domethënë, ai fiton aftësinë për të parë krijesat me shikimin e Zotit. Ai i shikon ato me qëllim që të marrë mësim nga të gjitha urtësitë dhe rrymat e fshehta hyjnore që ndodhen në gjithësi. Pasi të kryejë me një hushu të madhe detyrat më të vogla të adhurimit që Allahu ia ka bërë farz dhe obligim, ai përpigjet me edukatë të lartë, me respekt dhe dëshirë të zjarrtë, që të falë nafile dhe të bëjë vepra të mira edhe kur nuk janë obligim, por thjesht për shkak të dashurisë dhe përzemërsisë që i vjen nga zemra. Duke u dhënë fund të gjithave kënaqësive vetjake, ai e gjen te besimi të fshehtën e kënaqësisë së vërtetë.

## **b. Dashuria ndaj të Dërguarit të Allahut**

*Dërgo salavate për Sejjidu'l-Kevnej Muhammed Mustafanë!..*

*Dërgo salavate për Rasulu'th-Thekalej Muhammed Mustafanë!..*

*Dërgo salavate për Imamu'l-Haramejn Muhammed Mustafanë!..*

*Dërgo salavate për Xheddu'l-Hasenejn Muhammed Mustafanë!..*

Pika më e lartë që duhet të arrihet në frazat e dashurisë njerëzore, është dashuria ndaj të Dërguarit të Allahut (s.a.v.s). Asnjë njeri nuk mund të imagjinohet se e meriton më shumë dashurinë njerëzore se sa Ai, sepse:



-Të gjitha krijesat ia kanë borxh ekzistencën e tyre dashurisë që Allahu ka për Pejgamberin.

-Duke e njohur botën e njerëzve dhe të xhindëve me të vërtetën e pafillimtë dhe të pafund, i Dërguari i Allahut a.s është bërë shkak që ata të shpëtojnë nga ndëshkimi i përhershëm në ahiret.

-Allahu Teala ua ka shfaqur robërve të tij mirësitë e Kur'anit dhe të Islamit përmes zemrës së pastër të Pejgamberit.

-Atij i kanë ndodhur vështirësi dhe vuajtje aq sa s'i kanë ndodhur asnjë njeriu dhe ai i ka përballuar ato për hir të ummetit.

-Ai është i mëshirshëm ndaj besimtarëve. Ai është një det mëshire. Ai e do shumë ummetin e tij dhe atij i vjen shumë rëndë për vuajtjet e tyre.<sup>8</sup>

-Ai është një personalitet shembullor dhe ideal në adhurim.

-Përsëri Ai është ndërmjetësuesi më i mirë që i dërgon robërit te njësimi në Allahun Teala.

-Duke u betuar vetëm në jetën e Muhammedit (s.a.v.s) mes të gjithë pejgamberëve të tjerë, Allahu Teala ka thënë: “لَعْمُرُكُ” Beto hem në jetën tënde!” , dhe kështu ka urdhëruar që ummeti i tij të mendojë shumë për jetën e të Dërguarit të Allahut, e cila është usve hasene.

- Dashurinë dhe faljen e Tij Allahu Teala e ka lidhur me kushtin e bindjes ndaj Pejgamberit. Në ajetin fisnik thuhet:

**“Thuaj: Nëse e doni Allahun, më ndiqni mua ashtu që edhe Allahu tju dojë ju dhe t'i falë mëkatet tuaja. Allahu fal shumë dhe është mëshirues.”** (Ali Imran, 31)

-Dashuria që kemi ndaj të Dërguarit të Allahut është një shkak për të shpëtuar nga ndëshkimi hyjnor, sepse Zoti thotë:

**“Allahu nuk do t'i dënojë ata derisa Ti je në mësin e tyre!..”**  
(el-Enfal, 33)

Më e rëndësishmja është se Allahu e do Atë dhe e ka nderuar me



lavdërimin Habibi, i dashuri im.<sup>9</sup> Sa nder i madh është të duash të Dashurin e Allahut!

Atëherë, me shkrimin e një dashurie që nuk fshihet kurrë, ashtu që zemrat tona të fillojnë të fitojnë përputhmëri ndaj vlerës së lartë që i është dhënë Atij, le t'i gdhendim në zemrat tona salavatet dhe emrin e nderuar të Tij, sulltanit të pashoq.

Por duhet të themi edhe këtë: që edhe Pejgamberi, i Nderuari ynë, nuk është qëllimi i fundit në dashuri. Qënia e vetme që njeriu duhet t'ia kushtojë dashurinë, është Allahu Teala, krijuesi i gjithësisë. Ndërsa dashuria që kemi për të Nderuarin Tonë është një shkas dhe rrugë që na prin kah njësimi dhe dashuria e Allahut.

### *Tabllo të virtytshme*

Për shkak të dashurisë së tyre, ashabët e nderuar bëheshin flutura rreth të Dërguarit të Allahut dhe për çdo fjalë të tij, për çdo urdhër të tij, madje edhe për ndonjë shenjë më të vogël, thonin:

**“O i Dërguari i Allahut! Të qofshin falë nëna, babai, pasuria dhe shpirti im!..”** Ata të cilët mund t'ia preknin trupin, ndiheshin shumë krenarë me këtë dhe i tregonin duart e tyre duke thënë:

“Ja, me këto dy duar i kam dhënë besën të Dërguarit të Allahut!”.  
(Ibn Sa'd, IV, 306; Hejsemi, VIII, 42)

Një nga shembujt në lidhje me këtë temë është Ebu Esma esh-Shami radijallahu anhu:

Ai pati ardhur te i Dërguari i Nderuar si përfaqësues. Pasi mësoi çështjet themelore të Islamit dhe disa çështje që do t'ia dërgonte fisit të cilin përfaqësonte, ai i dha besën të Dërguarit të Allahut duke shtrënguar dorën e tij. Ebu Esma, i cili u trondit me ndjenjën e thellë që përjetoi kur kapi dorën e të Nderuarit tonë, Diellit të dy Botrave, i udhëhequr nga mendimi se duhej ta ndjente gjithmonë begatinë dhe

9. Shik. Tirmidhi, Menakib, 1/3616; Darimi, Mukaddime, 8; Ahmed, VI, 241; H - jsemi, IX, 29.

nxehtësinë e asaj dore të bekuar, i dha fjalën vetes se nuk do t'ia jepte më dorën askujt. Dhe në të vërtetë, për tërë jetën e tij, deri sa vdiq, ai nuk ia dha dorën askujt më. (Ibn Haxher, el-Isabe, IV, 7)



Dashuria që ashabët e nderuar kishin ndaj të Dërguarit të Allahut ishte në një gradë të atillë, saqë gratë sahabe i qortonin fëmijët e tyre kur ata nuk takoheshin për një kohë të gjatë me të Dërguarin e Allahut. Nëna e Huzejfes radijallahu anhu ishte nxehur dhe e kishte qortuar atë, për shkak se ai nuk kishte parë për disa ditë të Nderuarin tonë (s.a.v.s). Ai këtë e tregon kështu:

Nëna më pyeti:

“Kur je takuar me Pejgamberin herën e fundit?”

Unë thashë: “Nuk kam pasur mundësi të takohem me të prej disa ditësh.” Ajo u nxeh shumë dhe më qortoi në një mënyrë shumë të ashpër. Unë i thashë:

“O nënë! Prit, mos u nxeh! Menjëherë po shkoj te i Dërguari i Allahut, do të fal namazin e akshamit me Të dhe do të kërkoj nga Ai që të kërkojë falje bashkë me mua për ty.” (Tirmidhi, Menakib, 378; Ahmed, V, 391-2)



Vëllai i Zejd bin Harithes, Xhelebe radijallahu anhu e shfaq kështu lidhjen e tij me dashurinë që kishte ndaj Krenarisë së Gjithësisë të Nderuarit tonë:

“Shkova te Hazreti Pejgamber dhe i thashë:

-O i Dërguari i Allahut! Dërgoje me mua vëllain tim Zejdin. I Dërguari i Allahut tha:

*-Ja, ai është vetë këtu. Nëse do të vijë me ty, nuk e pengoj. Por Zejdi duke e refuzuar propozimin tim, tha:*

-O i Dërguari i Allahut! Unë nuk zgjedh asnjë mbi ty.

Pastaj e kuptova se mendimi i vëllait tim Zejdit është më i saktë se



sa i imi.” (Tirmidhi, Menakib, 39/3815)



Mus'abi radijallahu anhu, i cili ishte në krye të karvanit në bejatin e dytë të Akabes, shkoi te i Dërguari i Allahut përpara se të shkonte në shtëpinë e tij. Ai lajmëroi se Medinasit po e pranonin Islamin me një shpejtësi të madhe. I Dërguari i Allahut (s.a.v.s) u gëzua me lajmet që solli Mus'abi.

Kur nëna e hazretit Mus'ab, e cila ishte mushrike, dëgjoi se Mus'abi ka shkuar më së pari te Krenaria e Gjithësisë, te Nderuari ynë, u zemërua shumë. Ndërsa Mus'abi tha:

“Unë nuk shkoj te askush para se të shkoj te i Dërguari i Allahut (s.a.v.s). Unë nuk mund t'i jap përparësi askujt kur është Ai.”

Pasi kërkoi leje nga i Nderuari ynë, ai shkoi te nëna e tij dhe e thirri në Islam. (Ibn Sa'd, III, 119)



Gjatë hixhretit, kur po shkonin drejt shpellës Theur, Hazreti Ebu Bekr nganjëherë ecte përpara Krenarisë së Gjithësisë dhe nganjëherë prapa. I Dërguari i Allahut e pyeti:

*“O Ebu Bekr, përse vepron kështu?”*

Hazreti Ebu Bekr radijallahu anhu u përgjigj:

“O i Dërguari i Allahut! Eci i prapa duke menduar se mund të të arrijnë, dhe ec përpara duke menduar se janë në pritje fhe mund të të kurdisin ndonjë kurth!”

Së fundi arritën te shpella Theur. Ebu Bekri radijallahu anhu tha:

“O i Dërguari i Allahut! Ti prit këtu derisa ta pastroj shpellën!”. Dhe pas këtyre fjalëve hyri në shpellë dhe e pastroi atë. Ai e kontrollonte shpellën me dorë dhe kur gjente ndonjë vrimë, shqyente një copë nga rrobat e tij dhe e mbyllte atë. Në këtë mënyrë, të gjitha rrobat e sipërme i pati vënë te vrimat, por kishte ngelur vetëm një vrimë. Asaj vrimë i vuri thembrën e tij dhe pastaj tha:



“Tashmë mund të vini o i Dërguari i Allahut!”

Në mëngjes, kur i Dërguari i Allahut pa se Ebu Bekr nuk kishte robra në pjesën e sipërme të trupit, e pyeti me habi:

*“Ku i ke rrobat o Ebu Bekr?”*

Ebu Bekri radijallahu anhu i tregoi se çfarë kishte bërë. I Dërguari i Allahut u ndikua ndaj kësaj sjelljeje të virtytshme dhe duke ngritur duart, bëri dua për Ebu Bekrin.<sup>10</sup>

Kur mushrikët erdhën te hyrja e shpellës, Ebu Bekri Siddik u shqetësua dhe i tha të Dërguarit të Allahut (s.a.v.s):

“Nëse vritem, unë jam një njeri, por nëse të ndodh ndonjë gjë Ty, atëherë shkatërrohet një ummet.”

Pejgamberi po falte namaz në këmbë, ndërsa Hazreti Ebu Bekr po e ruante. Hazreti Ebu Bekr tha:

“Mekkasit po të kërkojnë Ty. Për Zotin unë nuk shqetësohem për veten time, por kam frikë se mos të bëjnë ndonjë gjë Ty.”

I Dërguari i Nderuar i tha shokut të shpellës:

*“O Ebu Bekr! Mos u mërzit! Padyshim që Allahu është me ne!”<sup>11</sup>*

Në shpellën Theur, i Dërguari i Allahut (s.a.v.s), një çast e vuri kokën e tij të bekuar te gjuri i Hazretit Ebu Bekr dhe fjeti. Në ato momente Ebu Bekr radijallahu anhu e mbyllte me këmbë vrimën që kishte ngelur hapur.

Me të vërtetë Ebu Bekr kishte të drejtë në mendimin e tij, sepse një gjarpër ia pickoi shumë keq këmbën dhe e helmoi. Sahabiut të madh i dhembti shumë shpirti por, pavarësisht se nuk lëvizi nga vendi, që të mos zgjohej i Dërguari i Allahut (s.a.v.s), nuk mundi t'i ndalojë disa pika loti që i rrodhën nga sytë. Njëra nga pikat e lotit ra si një perlë në fytyrën e bekuar të të Dërguarit të Allahut (s.a.v.s). Mbi këtë i Nderuari i të dy botrave alejhissalatu vesselam u zgjua dhe e pyeti:

10. Shik. Hakim, III, 7/4268; Ibn Kethir, el-Bidaje, III, 222-223; Ali el-Kari, Mirkat, Bejrut, 1992, X, 381-382/6034; Ebu Nuajm, Hilje, I, 33.

11. Ibn Kethir, el-Bidaje, III, 223-224; Dijarbekri, Tarihu'l-Hamis, Bejrut, I, 328-329.



“Çfarë ka o Ebu Bekr? Çfarë ndodhi?”

Hazreti Ebu Bekr radijallahu anhu tha:

“Nuk ka asgjë o i Dërguari i Allahut!”. Por pastaj, me këmbënguljen e të Dërguarit të Allahut (s.a.v.s) u detyrua të tregonte se çfarë i kishte ndodhur<sup>12</sup>, me fjalët:

“Nëna dhe babai im të qofshin falë, o i Dërguari i Allahut! Gjarpëri më pickoi këmbën!”

I Dërguari i Allahut sallallahu ue sellem ia lyu këmbën Hazretit Ebu Bekr me pështymën e tij të bekuar. Pas kësaj, dhimbja e Hazretit Ebu Bekr pushoi menjëherë, sikur të mos i kishte ndodhur asgjë.

Kohë më vonë, pasi i Dërguari i Allahut (s.a.v.s) vdiq, helmi filloi të ndikojë përsëri dhe u bë shkak për martirizmin e Hazretit Ebu Bekr.<sup>13</sup>



Kur gjatë periudhës së halifetit e tij, Hazreti Omer radijallahu anhu dëgjoi se disa njerëz e mbanin veten më lart se Hazreti Ebu Bekr, tha:

“Për Zotin, ajo natë e Ebu Bekrit është më e mirë se e gjithë bujaria e Omerit! Kur i Dërguari i Allahut (s.a.v.s) doli nga shtëpia për të shkuar në shpellë, Ebu Bekri ishte pranë Tij...” (Hakim, III, 7/4268)



Bera radijallahu anhu, e tregon kështu dëshirën që kishte në çdo cast për të dëgjuar një kujtim të babait të tij, kujtim i cili kishte lidhje me të Dërguarin të Allahut:

Ebu Bekr Siddik radijallahu anhu bleu nga babai im një samar me trembëdhjetë dirhem dhe tha:

“-I thua Beras që ta Dërgojë në shtëpinë time.”. Babai im tha:

“-Jo! Nuk bën, derisa të më tregosh se si është shpërngulur i

12. Bejhaki, Delailu'n-Nubuvve ve Ma'rifeti Ahvali Sahabi'sh-Sher'ijje, shpj: Abdulmu'ti Kal'aci, Bejrut 1985, II, 477; Ibn Kethir, el-Bidaje, III, 223.

13. Ali el-Kari, Mirkat, X, 381-382/6034.



Dërguari i Allahut nga Mekka në Medine.”

Pas kësaj Ebu Bekri radijallahu anhu e tregoi udhëtimin e hixhretit gjatë e gjatë. (Buhari, Ashabu'n-Nebi, 2; Ahmed, I, 2)



Kur ushtria Islame vendosi shtabin në Bedr, Sa'd bin Muadh mbajti një fjalim, përmes të cilit shfaqet dashuria që ai kishte ndaj të Dërguarit të Allahut dhe se si dridhej gjatë kohës që fliste:

“O i Dërguari i Allahut! Ne po te ngremë një çadër. Po ashtu edhe kafshët po t'i lëmë afër. Pastaj ne do të luftojmë me armikun. Sa mirë do të qe nëse Allahu do të na jepte forcë dhe na mundësonte fitoren! Në të kundërt, Ti hipi kalit dhe shko te vëllezërit që kemi lënë pas! O i Dërguari i Allahut! Edhe ata të duan shumë sikundër dhe ne. Ata kurrë nuk do të rrinin pa ardhur, sikur ta dinin se Ti do të hyje në luftë. Allahu të mbron Ty me ata. Ata janë të lidhur me Ty nga shpirti dhe luftojnë pranë teje.”

Pejgamberi, i Nderuari ynë, e falenderoi Hazreti Sa'din dhe u lut për të. Sa'di radijallahu anhu nxori shpatën dhe bëri rojë te dera e çadrës që kishin ngritur për Të. (Ibn Hisham, II, 260; Vakidi, I, 49)



Abdurrahman bin Auf radijallahu anhu, rrëfen këtë histori në të cilën del në pah përkushtimi i ashabëve të nderuar ndaj dashurisë për të Dërguarin e Allahut:

Në ditën e Bedrit pashë nga e djathta dhe e majta, isha në mes dy të rinjëve Ensarë. Kjo nuk më pëlqeu shumë. Unë doja të isha ndërmjet disave më të fortë. Njëri prej tyre më pyeti pa e dëgjuar tjetri:

“Xhaxha! A e njeh Ebu Xhehlin?”. Unë i thashë:

“-Po, e njoh! Çfare ke ndërmend t'i bësh?”. Djaloshi tha:

“Me sa kam dëgjuar, ai ka ofenduar të Dërguarin e Allahut! Beto hem në Allahun, në dorën e të cilit është jeta ime, se nëse do ta shoh atë, nuk do të ndahem prej tij pa vdekur njëri prej nesh!”





U çudita shumë ndaj kësaj fjale të djaloshit. Edhe djaloshi tjetër më tha të njëjtat gjëra. Tashmë ndjeja një gëzim të madh që gjendesha në mes të atyre të rinjve. Pak më vonë pashë Ebu Xhehlin që vërvitej në sheshin e luftës dhe u thashë:

“Shikoni, ja ky është ai për të cilin po flisnim!

Djemtë nxorën shpatat menjëherë. Ata vrapuan drejt Ebu Xhehlit dhe e vranë. Këta djem ishin Muadh bin Afra dhe Muadh bin Amr.” (Buhari, Megazi, 10; Muslim, Xhihad, 42)



Kur i Nderuari ynë u plagos në luftën e Uhudit, tha:

*“Allahu Teala është shumë i nxehur me popullin që ka plagosur fytyrën Pejgamberit të Tij!”*

Sa’d bin Vakkas radijallahu anhu ka thënë:

“Për Zotin, kur dëgjova këtë fjalë të të Dërguarit të Allahut, nuk kam ndjerë zemërim aq të madh për të vranë asnjë njeri. Sa ç’ndjeva zemërim për të vranë vëllain tim i cili (e kishte plagosur atë!)”

Kësisoj Sa’di, i cili e kishte zemrën të mbushur me dashurinë e të Dërguarit të Allahut, atë ditë, duke i ndarë rreshtat e mushrikëve, donte të vriste vëllain e tij, por i Dërguari i Allahut (s.a.v.s) e ndaloi.<sup>14</sup>



Talha bin Ubejdullah thotë:

“Në luftën e Uhudit, kur ashabët e të Dërguarit të Allahut u shpërndanë, mushrikët filluan të sulmojnë dhe e rrethuan të Dërguarin e Allahut nga çdo anë. Unë isha në një gjendje që nuk dija nga ta mbroja nga përpara, nga mbrapa, nga e djathta apo nga e majta prej sulmeve që vinin kundrejt Tij. Nxora shpatën dhe njëherë largova ata që vinin nga përpara dhe pastaj ata që vinin nga mbrapa, së fundi ata u larguan.” (Vakidi, I, 254)

Përsëri në Uhud, Malik bin Zuhejr i cili ishte shigjetari i mush-

14. Vakidi, I, 254)



rikëve, i vërviti një shigjetë të Dërguarit të Allahut. Kur Talha bin Ubejdullah e kuptoi se shigjeta do të godiste të Dërguarin e Allahut (s.a.v.s) e nxori dorën përballë shigjetës. Gishti i ngeli sakat për shkak se e qëllloi shigjeta.<sup>15</sup>



Një pjesë sahabësh, që ishin Muhaxhirë dhe Ensarë, e rrethuan të Dërguarin e Allahut të cilin e donin më shumë se jetën e tyre. Ata i dhanë fjalën Allahut se do të binin dëshmorë përpara të Dërguarit të Allahut, me fjalët:

“Fytyra ime është mburojë përpara fytyrës tënde, trupi im të qoftë falë! Paqja e Allahut qoftë gjithmonë mbi Ty! Kurrë nuk ndahemi nga Ti o i Dërguari i Allahut!”. Pastaj ata luftuan deri në fund. (Ibn Sa’d, II, 46; Vakidi, I, 240)



Ebu Talha ishte një shigjetar i shkëlqyer që e tendoste shumë har-kun. Në ditën e Uhudit i ishin thyer në dorë dy-tri harqe. Gjithkujt që kalonte pranë tij me torbë shigjetash, i Dërguari i Allahut i thoshte:

“Zbrazë torbën e shigjetave të Ebu Talha!” Kur Pejgamberi ynë i Nderuar e ngrinte kokën për të parë mushrikët që ishin pas tij, Ebu Talha thoshte:

“O i Dërguari i Allahut! Nëna dhe babai im të qofshin falë! Mos e ngri kokën! Ndoshta të qëllon ndonjë shigjetë e mushrikëve. Kraharori im qoftë mburojë për kraharorin tënd. Më qëlloftë mua ai që do të të qëllojë Ty!” (Buhari, Megazi, 18)



Edhe Katade bin Numan radijallahu anhu, duke qëndruar përpara të Dërguarit të Allahut për ta mbrojtur, hodhi shigjeta mbi mushrikët derisa iu shtrembërua koka. Së fundi edhe ai u godit në sy. Bebja e syrit i ra mbi faqe. I Dërguari i Allahut qante kur e shikonte kështu Kataden. I Nderuari ynë (s.a.v.s) e mori me dorën e tij beben e syrit të



Katades dhe e vendosi në vendin e saj. Pastaj ky sy u bë më i bukur se syri tjetër dhe filloi të shikojë më mirë.<sup>16</sup>



Edhe Ummu Umare radijallahu anha, e cila ishte nga gratë sa-habe që mori pjesë në luftën e Uhudit, ishte prej atyre që e mbronin të Nderuarin tonë Krenarinë e Gjithësisë me shigjetë dhe hark. Pas luftës, i Dërguari i Allahut u kthye në Medine dhe tha:

*“Gjatë luftës, kur kthehesha djathtas dhe majtas, shikoja Ummu Umaren duke luftuar pranë meje.”* (Ibn Haxher, e-Isabe, IV, 479)

Me këtë rast zonja Ummu Umare, e cila u ndje e nderuar nga lavdërimet dhe lutjet e ndryshme të Pejgamberit, i tha të Dërguarit të Allahut:

“Lutju Allahut që të bëhemi komshinjtë e Tu në xhennet.”  
Pejgamberi alejhissalatu vesselam u lut duke thënë:

*“O Zoti im! M'i bëj këta komshi dhe shokë në xhennet!”* Mbi këtë Ummu Umare radijallahu anha tha:

“Tashmë nuk i jap rëndësi asnjë lloj fatkeqësie që mund të vijë në këtë botë!” (Vakidi, I, 273; Ibn Sa'd, VIII, 415)



Kur nga një pjesë besimtarësh të cilët ishin në pesimizëm dhe nuk dinin çfarë të bënin, dëgjoji një thashetheme sipas së cilës i Dërguari i Allahut kishte rënë dëshmor, Enes bin Nadr radijallahu anhu bërtiti duke ndjerë një djegie të madhe shpirtërore:

“Çfarë do të bëni në këtë jetë tani që i Dërguari i Allahut ka rënë Dëshmor? Ejani, edhe ju bini dëshmorë duke luftuar si Ai!” dhe vërshoi drejt mushrikëve. Pas pak, ai piu sherbetin e martirizmit, duke qenë i plagosur me më shumë se tetëdhjetë plagë. (Ahmed, III, 253; Ibn Hisham, III, 31)

Kur mbaroi lufta e Uhudit, Pejgamberi ynë i Nderuar (s.a.v.s) dër-

16. Hakim, III, 334/5281; Hejsemi, VI, 113; Ibn Sa'd, III, 453.



goi një nga ashabët për ta gjetur dhe për të mësuar se në çfarë gjendje ishte Sa'd bin Rabi radijallahu anhu. Sahabiu, edhe pse e kërkoi gjithandej Sa'd bin Rabian radijallahu anhu, nuk e gjeti. Edhe pse i thirri në emër, nuk mori përgjigje. Së fundi, me shpresën e fundit, thirri nga ana e të plagosurve dhe të dëshmorëve:

“O Sa'd! Mua më ka dërguar i Dërguari i Allahut. I Dërguari i Allahut më ka urdhëruar ta njoftoj nëse je gjallë apo ke rënë dëshmor.

Në ato çaste Sa'di radijallahu anhu po jetonte çastet e fundit të jetës së tij dhe nuk kishte mundësi të përgjigjej, por kur dëgjoji se i Dërguari i Allahut bëhej merak për të, duke e mbledhur të gjithë forcën, në një gjendje rënkimi të dobët, mundi të thoshte:

“Unë tashmë jam prej të vdekurve!” Ishte e qartë se ai po shikonte anën e përmatanshme (të jetës pas vdekjes). Sahabiu vrapoi drejt e të Sa'di radijallahu anhu. Trupi i tij i ishte bërë vrima-vrime me goditjet e shpatave. Sahabiu mundi të dëgjojë nga ai këto fjalë me një zë të prerë dhe në gjendje pëshpërime, por që shprehin dashurinë legjendare që ai ndjente ndaj të Dërguarit të Allahut:

“Për Zotin, përderisa t'ju lëvizin sytë, nëse nuk e mbronit të Dërguarin e Allahut nga armiqtë dhe nëse atij i ndodh ndonjë gjë, nuk keni asnjë arsye që të shfaqeni përpara Allahut!” (Muvatta, Cihad, 41; Hakim, III, 221/4906; Ibn Hisham, III, 47)



Gratë sahabe që ndodheshin në Medinetu'l-Munevera dolën jashtë qytetit me shpresën për të marrë ndonjë lajm që mund të vinte nga sheshi i luftës. Edhe Hazreti Aishe ishte ndërmjet tyre. Kur nëna jonë Aishe arriti në vendin e quajtur Harre, takoi Hind bint Amr, e cila ishte një grua e devotshme. Hindi po sillte trupat dëshmorë të bashkëshortit të saj Amr bin Xhemuh, të birit të saj Hallad dhe të vëllait të saj Abdullah, të cilët i kishte ngarkuar në një deve. Hazreti Aishe e pyeti:

“Çfarë lajmi kemi?”

Hind bint Amr radijallahu anha dha këtë përgjigje të mrekullueshme:



“-Hajër, i Dërguari i Allahut është gjallë. Kur Ai është gjallë, çdo fatkeqësi është e lehtë...”<sup>17</sup>



Edhe një pamje tjetër mësimdhënëse nga Uhudi është kjo:

Në ditën e Uhudit Medineja u trondit me një lajm. Kur thanë: “Muhammedi (s.a.v.s) është vrarë!”, në qytet filluan klithmat, britmat u ngritën në qiell. Secili doli në rrugë dhe mundohej të merrte ndonjë lajm nga ata që vinin. Kur Sumejra radijallahu anhasë e cila ishte nga Ensarët, iu dha lajmi se dy bijtë, babai, bashkëshorti dhe vëllai i saj kishin rënë dëshmorë, ajo zonjë e nderuar nuk i dha rëndësi, por çështja e vetme që e shqetësonte ishte gjendja e të Dërguarit të Allahut:

Ajo pyeste: “A i ka ndodhur gjë Atij?”

Sahabët e nderuar u përgjigjeshin:

“Falenderimi i takon Allahut që Ai është mirë. Ai është gjallë, ashtu si do ti!”

Zonja Sumejra tha:

“Zemra ime nuk qetësohet pa e parë Atë. Më tregoni të Dërguarin e Allahut.”

Kur ia treguan të Dërguarin e Allahut, ajo iu afrua menjëherë, e kapi nga fundi i rrobave dhe i tha:

“O i Dërguari i Allahut, nëna dhe babai im të qofshin falë! **Pasi vura re se Ti je gjallë, asgjë tjetër nuk ka më rëndësi për mua!**”  
(Vakidi, I, 292; Hejsemi, VI, 115)

Ja, ky është kulmi i dashurisë që ndihej ndaj të Dërguarit të Allahut (s.a.v.s), këto janë flijimet dhe shembujt e virtytshëm që shfaqin zemrat besimtare, të cilat mbusheshin dhe entuziazmoheshin me këtë dashuri...



I Dërguari i Allahut (s.a.v.s) shkoi një ditë te dëshmorët e Uhudit.

17. Vakidi, I, 265; Ibn Haxher, Fet’hu’l-Bari, Daru’l-Fikr, III, 216; Ibn Abdilber, el-Istiab, Kajro, III, 1168.



Në lidhje me ata, tha:

*“Unë jam dëshmitar (ndaj besimit dhe besnikërisë së tyre).”*

Ebu Bekri radijallahu anhu tha:

“O i Dërguari i Allahut! A nuk jemi ne vëllezërit e tyre? Siç janë bërë myslimanë ata, ashtu edhe ne jemi bërë myslimanë, siç kanë luftuar ata, edhe ne ashtu kemi luftuar!”

I Dërguari i Allahut u përgjigj:

*“Po (këto që i the janë të vërteta), por unë nuk e di se çfarë bidatesh do të nxirrni pas meje (pasi të ndërroj jetë).”*

Ebu Bekri radijallahu anhu, i cili nuk mund të duronte edhe një çast ndarjen nga i Dërguari i Allahut, qau dhe duke thënë:

“Domethënë ne do të mbetemi pas teje o i Dërguari i Allahut?”. Me këto fjalë ai shfaqti shqetësimin dhe pikëllimin që ndjente për një jetë që do të jetohej pa të Dërguarin e Allahut. (Muvatta, Xhihad, 32)



I Dërguari i Allahut (s.a.v.s) dërgonte mësues te fiset e tjera për t'u mësuar fenë. Edhe fiset Adall dhe Kare kërkuan nga i Dërguari i Allahut që t'u dërgonte dikë për t'ua mësuar fenë. Për këto fise mori rrugën një delegacion i përbërë prej dhjetë vetësh, por ky karvan ra në kurth. Tetë nga mësuesit ranë dëshmorë, ndërsa dy të tjerët u kapën rob. Edhe Zejd bin Desine dhe Hubejb radijallahu anhuma, të cilët u kapën rob, u martirizuan nga mushrikët Mekkas. Hazreti Hubejben e pyetën para se të binte dëshmor:

“A do të doje që të ishte Pejgamberi në vendin tënd, si shpërblim për shpëtimin e jetës tënde?”

Hubejbi radijallahu anhu, duke ndjerë keqardhje për Ebu Sufjanin i cili bëri këtë pyetje, tha:

“Kurrën e kurrës nuk do të doja që unë të jem te fëmijët e mi, ndërsa Pejgamberi të jetë këtu. Unë nuk dua që atij t'i ngulet qoftë edhe një gjëmb atje ku është.”



Ebu Sufjan, i cili shtangu nga habia që i shkaktoi kjo panorame e pashoqe dashurie, tha:

“Çudi! Unë kurrë nuk kam parë në këtë botë dy vetë që ta duan njëri-tjetrin aq sa ç’e duan ashabët Muhammedin.” (Vakidi, I, 360; Ibn Sa’d, II, 56)

Hubejbi radijallahu anhu, para se të ekzekutohej, kishte vetëm një dëshirë:

“Ti dërgonte Hazretit Pejgamber një selam plot me dashuri!..”

Por me kë t’ia dërgonte! I paçajre, ngriti sytë nga qielli dhe iu lut Allahut:

“O Zoti im! Këtu nuk ka kush t’ia dërgojë selamin tim Pejgamberit. Dërgoja Ti selamin tim Atij!

Pikërisht në atë çast, i Dërguari i Allahut, i cili ishte bashkë me ashabët e tij në Medine, tha: “Ue alejhisselam!”, që do të thotë: “Edhe mbi atë qoftë paqja!”. Kur sahabët e dëgjuan këtë shprehje, pyetën me habi:

“O i Dërguari i Allahut! Kujt ia ktheve selamin?”. Pejgamberi tha:

“*Ja ktheva selamin vëllait tuaj Hubejbit. Xhebraili më solli selamin e Hubejbit!*” (Shik. Buhari, Xhihad 170, Megazi 10, 28; Vakidi, I, 354-363)



Nganjëherë dashuria që ashabët kishin ndaj të Nderuarit tonë entusiasmohej aq shumë, saqë nuk mund ta ndanin të Dërguarin e Allahut ndërmjet tyre. Ka’b bin Uxhre radijallahu anhu tregon këtë ngjarje mësimdhënëse:

“Një ditë po rrimim pranë të Dërguarit të Allahut në xhaminë e lumturisë. Aty kishte një grup prej Ensarëve, një prej Muhaxhirëve dhe një prej Benihashimit. Filluam të debatojmë për të ditur se cilin grup prej nesh e donte më shumë i Dërguari i Allahut? Ne të grupit të Ensarëve thamë:

-Ne i kemi besuar të Dërguarit të Allahut, e ndoqëm Atë kudo dhe



luftuam bashkë me Të kundër armiqve të tij. Për këtë arsye, i Dërguari i Allahut (s.a.v.s) na do më shumë ne.

Vëllezërit tanë Muhaxhirë thanë:

-Ne kemi bërë hixhret për hir të Allahut dhe të Dërguarit të tij, kemi lënë fëmijët tanë, pasurinë tonë dhe kemi marrë pjesë në po ato luftëra që keni marrë pjesë edhe ju. Për këtë arsye, i Dërguari i Allahut na do më shumë ne.

Ndërsa vëllezërit tanë nga Benihashim thanë:

-Ne jemi të afërmit e Pejgamberit. Edhe ne kemi marrë pjesë në luftërat në të cilat keni marrë pjesë ju. Për këtë shkak, i Nderuari ynë na do më shumë ne.

I Dërguari i Allahut u afrua dhe tha:

-Ju po thonit diçka, çfarë po flisnit?

Secili prej nesh e përsëriti atë që tha. I Dërguari i Allahut i tha çdo grupi:

*-Paskeni folur drejt! Kush mund të pohojë të kundërtën e kësaj? Pastaj pyeti?*

*-A doni që të gjykoj mes jush?*

Ne thamë:

-Sigurisht o i Dërguari i Allahut! Nëna dhe babai ynë të qofshin falë. I Dërguari i Allahut (s.a.v.s) tha:

*-O grupi i Ensarëve! Unë jam vëllai juaj.*

Ensarët thanë me gëzim:

-Allahu ekber! Falenderimi i takon Zotit të Qabes që ne e fituam Atë.

I Dërguari i Allahut (s.a.v.s) tha:

*-O grupi i Muhaxhirëve! Unë jam prej jush.*

Edhe Muhaxhirët duke u gëzuar thanë:

-Allahu ekber! Falenderimi i takon Zotit të Qabes që ne e fituam Atë.





I Dërguari i Allahut (s.a.v.s) tha:

*-O Benihashim! Ju jeni nga unë dhe keni ardhur te unë.*

Edhe ata të grupit Benihashim thanë të gëzuar:

-Allahu ekber! Falenderimi i takon Zotit të Qabes që ne e fituam Atë. Të gjithë u ngritëm të gëzuar. Çdo grup u gëzua dhe u kënaq me lavdërimin e të Dërguarit të Allahut.” (Hejsemi, X, 14)



Të donin atë që donte Pejgamberi, ishte një dëshirë e madhe për ashabët. Hazreti Enes radijallahu anhu rrëfen:

“Një rrobaqepës e ftoi të Dërguarin e Allahut (s.a.v.s) në një drekë që kishte përgatitur. Edhe unë shkova bashkë me të. (I zoti i shtëpisë) na solli në sofër bukë elbi, një supë me kungull dhe mish të thatë. Unë pashë se i Dërguari i Allahut (s.a.v.s) veçanërisht zgjidhte të hante kungujt që ishin në pjatë. Që nga ajo ditë vazhdoj ta dua kungullin.” (Buhari, Et’ime 33, Buju’ 30; Muslim, Eshribe 144; Muvatta, Nikah 51)

Të duash çdo gjë që do ai të cilin ti do, është shenja më e qartë e dashurisë.

Edhe kjo gjendje e Hazretit Ebu Bekr është shenja e një dashurie dhe delikatese të pashoq. Në çlirimin e Mekkes ai solli te Pejgamberi babain e tij të verbër për tu bërë mysliman. Kur e pa i Dërguari i Allahut, i tha:

“Përse e ke munduar dhe e ke sjellë këtu babain tënd të moshuar? Ne mund të shkonim te ai.”

Ndërsa Hazreti Ebu Bekr radijallahu anhu tha:

“E solla te Ti, për arsye që Allahu t’i japë sevape.”

Kur Ebu Kuhafe radijallahu anhu, babai i Hazretit Ebu Bekr, ia zgjati dorën Krenarisë së Gjithësisë për t’i dhënë besën, Ebu Bekri i cili e donte shumë Pejgamberin, nuk mundi ta mbajë veten dhe filloi të qajë. Kur i Dërguari i Allahut e pyeti me habi Ebu Bekrin se përse po qante, Ebu Bekri radijallahu anhu me lot në sy tha:



“O i Dërguari i Allahut! Ah sikur kjo dorë që po të zgjatet për të të dhënë besën të mos ishte dora e babait tim, por të ishte dora e xhaxhait tënd Ebu Talibit, dhe sikur Allahu Teala të të gëzonte Ty në vendin tim, kush e di sa do të gëzohesha, sepse Ti e doje shumë atë dhe dëshiroje shumë që ai të besonte...” (Hejsemi, VI, 174; Ibn Sa’d, V, 451)



Kur shkonte në haxh, Dërguari i Allahut falte namaz me ata myslimanë të cilët banonin në ato vende. Më vonë, duke ndërtuar xhamia në ato vende, myslimanët donin të bënë në përhershëm kujtimin e tij, si një shfaqje bese dhe dashurie. (Ibn Sa’d, II, 173)



Edhe në çështjen e teberrukut me diçka të Krenarisë së Gjithësisë, ashabët e nderuar kanë shfaqur shumë shembuj të virtytshëm. Kur në haxhin e lamtumirësë Pejgamberi (s.a.v.s) qethi flokët që kishte në ballë, Halid bin Velid iu lut duke thënë:

“O i Dërguari i Allahut! M’i jep mua flokët e ballit tënd! Mos ia jep askujt tjetër përveç meje! Nëna dhe babai im të qofshin falë!”<sup>18</sup> Kur ia dha flokët, Halidi i fshiu sytë me to dhe i vendosi në pjesën e mbrendëshme e të përparme të qylafit të tij. Me bereqetin e këtyre flokëve të bekuara nuk doli asnjë grup që ta mposhte në luftë. Po ashtu Halidi radijallahu anhu ka thënë:

“Nga cila anë që ta ktheja atë, ajo anë çlirohej!” (Vakidi, III, 1108; Ibn Esir, Usdu’l-Gabe, II, 111)



Po ashtu, një zonjë e nderuar nga ashabët i solli si dhuratë të Dërguarit të Allahut (s.a.v.s) xhamadanin që ia kishte thurur. Ajo i tha:

“Këtë e kam thurur me duart e mia, që ta vishni.”

18. Në këtë çast hazreti Ebu Bekr po mendonte atë që Halid bin Velidi radijallahu anhu u kishte bërë myslimanëve në Uhud, Hendek dhe në Hudejbije dhe gjendjen e tij e çuditej. (Ibn Sa’d, II, 174)



Pejgamberi i cili kishte nevojë për një copë të tillë, e mori, e veshi dhe erdhi pranë sahabëve. Njëri prej tyre i tha:

“Sa e bukur qenka! Ah sikur të ma japësh dhe ta vesh edhe unë, o i Dërguari i Allahut!” I Dërguari i Allahut tha:

“-*Mirë!*” Pasi qëndroi pak aty, u kthye në shtëpi, e palosi rrobën dhe ia dërgoi sahabiut. Ashabët e nderuar i thanë sahabiut:

“Nuk bëre mirë fare. I Dërguari i Allahut e veshi atë, sepse kishte nevojë për atë rrobë. Mbi të gjitha ti e kërkove atë nga Hazreti Prjgamber, duke e ditur se ai nuk e kthen mbrapa bosh atë që i kërkon diçka!”

Mbi këtë sahabiu bëri këtë sqarim:

“Për Zotin, unë nuk e doja atë për ta veshur, por për qefinin tim.”

E me të vërtetë, kjo rrobë u bë qefini i atij sahabiu. (Buhari, Xhenaiz 28, Buju' 31, Libas 18)



Sehl bin Sa'd radijallahu anhu tregon se edhe fëmijët e vegjël kishin të njëjtën vetëdije në dashurinë ndaj të Dërguarit të Allahut:

Të Dërguarit të Allahut i sollën diçka për të pirë. Ai piu nga ajo. Në atë çast, në anën e djathtë të tij ishte ulur një fëmijë dhe në anën e majtë ishin ulur disa të moshuar nga të mëdhenjtë e sahabëve. Sipas zakoneve në këtë çështje, i Nderuari ynë alejhissalatu vesselam i cili fillonte gjithmonë nga e djathta, e pyeti fëmijën që e kishte në të djathtë me njerëzi dhe edukatë të pashoq:

*“A më lejon që këtë së pari t'ua jap të mëdhenjve?”*

Por fëmija i mençur dha këtë përgjigje të jashtëzakonshme dhe plot mësim që i habiti të gjithë:

“O i Dërguari i Allahut! Askujt nuk ia jap riskun me të cilin më nderoni ju!”

Kur dëgjoji këto fjalë, Pejgamberi i dashur (s.a.v.s) pijen që e kishte



në dorën e bekuar ia dha fëmijës më së pari. (Buhari, E ribe, 19)

Ashabëve të nderuar u erdhi shumë e rëndë ndarja e të Dërguari të Allahut, të cilin e donin më shumë se jetën e tyre. Enes bin Malik radijallahu anhu rrëfen:

Kur Pejgamberit iu rëndua sëmundja, iu shtuan edhe vuajtjet. Hazreti Fatime, duke e parë në atë gjendje, tha:

“Ah babai im, sa vuajtje të madhe ke!” I Dërguari i Allahut (s.a.v.s) tha:

“(O bija ime), *babai yt nuk do të ketë më vuajtje pas ditës së sotme.*”

Kur i Dërguari i Nderuar ndërroi jetë, Hazreti Fatime qau:

يَا أَبَتَاهُ رَبِّهِ مَا أَذْنَاهُ  
يَا أَبَتَاهُ أَحَابَ رَبًّا دَعَاهُ  
يَا أَبَتَاهُ مَنْ جَنَّةُ الْفِرْدَوْسِ مَأْوَاهُ  
يَا أَبَتَاهُ إِلَى جِبْرِيلَ نَعَاهُ

“Vaj babai im që nuk ka më afër se sa Ti te Zoti yt! Vaj babai im, i cili iu përgjigj ftesës së Zotit! Vaj babai im, vendi i të cilit është Firdeusi! Vaj babai im, lajmin e zi mund ta ndajmë vetëm me mikun tënd Xhebrailin!”

Edhe pas varrosjes së të Dërguarit të Allahut (s.a.v.s), Hazreti Fatime e shprehu kështu mallin dhe dhimbjen e saj:

“Si guxuat dhe si u bëri zemra të hidhni dhé kaq shpejt mbi të Dërguarin e Allahut?” (Buhari, Megazi, 83; Darimi, Mukaddime, 14, Shik. Ibn Maxhe, Xhenaiz, 65)



Abdullah bin Zejd el-Ensari radijallahu anhu një ditë erdhi te i Dërguari i Allahut (s.a.v.s) dhe qau duke thënë:

“O i Dërguari i Allahut! Ti je më i dashur për mua se vetja ime, se pasuria ime, se fëmijët e mi dhe se pjesëtarët e familjes sime. Sikur të



mos ishte mirësia për të të parë, do të dëshiroja të vdisja.”

Kur mbi këtë i Dërguari i Allahut (s.a.v.s) e pyeti:

“*Përse qan?*”, Abdullah bin Zejd radijallahu anhu u përgjigj:

“O i Dërguari i Allahut! Qava duke u shqetësuar se nuk do të të shoh Ty, duke menduar se një ditë do të ndërrosh jetë dhe do të vdesim, Ti do të kesh grada të larta me pejgamberët, ndërsa ne, edhe nëse do të hyjmë në xhennet, do të jemi në gradat e ulëta.”

Deti i mëshirës, Pejgamberi (s.a.v.s) nuk u përgjigj, urdhëroi hesh-tje dhe në këtë moment zbriti ky ajet fisnik:

**“E kushdo që i bindet All-llahut dhe të Dërguarit të tij, të tillët do të jenë së bashku me ata që All-llahu i shpërbleu: (me) pejgamberët, besnikët e dalluar, dëshmorët dhe me të mirët. Sa shokë të mirë janë ata!”** (en-Nisa, 69)

Një ditë, kur Abdullah bin Zejd radijallahu anhu po punonte në kopshtin e vet, i biri erdhi tek ai duke iu marrë fryma, dhe me një brengë të madhe i tregoi se i Dërguari i Allahut (s.a.v.s) kishte ndërruar jetë. Abdullahu radijallahu anhu i cili u brengos shumë, u lut kështu:

“O Zoti im! M’i merr sytë e mi, që tashmë të mos shikoj asnjë tjetër përveç të vetmin që e doja, Hazretin Muhammed (s.a.v.s).”

Lutja e Abdullahut radijallahu anhu u pranua dhe menjëherë sytë iu verbuan.<sup>19</sup>

Edhe ndjesia e një sahabiu tjetër që humbi sytë pasi i Dërguari i Allahut ndërroi jetë, nuk ishte e ndryshme nga ajo e Abdullah bin Zejdit. Kur humbi sytë pas vdekjes së të dashurit të të dashurve, shokët e tij erdhën për ta ngushëlluar. Por ai nuk ndjehej në hall për shkak se kishte humbur sytë. Atyre që kishin ardhur për ta ngushëlluar, u tha kështu:

**“Unë i doja sytë e mi për të parë të Dërguarin e Allahut. Çfarë të mire ka pas vdekjes së tij nëse e kam syrin e sorkadhes më të bukur në botë!”** (Ibn Sa’d, II, 313)

19. Shik. Kurtubi, V, 271.



Gjendja e ashabëve pas vdekjes së të Dërguarit të Allahut (s.a.v.s) u ngjante qirinjve që treten duke u djegur nga pikëllimi. Atë ditë zemrat u takuan befasisht me zjarret e mallëngjimit të ndarjes së të Dërguarit të Allahut dhe ashabët kalonin nga një gjendje në tjetrën. Edhe Hazreti Omer radijallahu anhu doli nga vetja dhe vuajti shumë derisa Ebu Bekri radijallahu anhu i qetësoi njerëzit, sepse këta zemra të dashuruara që nuk mund të duronin edhe një ditë pa e parë Atë, tashmë nuk do ta shihnin më kurrë në këtë botë të përkohshme.



Pas vdekjes së të Nderuarit tonë, edhe muezini i tij Bilal el-Habeshi radijallahu anhu, nga pikëllimi që ndjente nuk mundi ta thirrte më ezanin me atë zë të bukur që trondiste qiejt. Sa herë që Hazreti Bilal vendoste të thirrte ezanin duke mos u rezistuar këmbënguljeve të ashabëve, teksa nuk e shikonte më të Dërguarin e Allahut në mihrab, fyti i zihej me lemnë, zëri i ndërpritej dhe nuk ishte në gjendje ta thirrte ezanin. Ai u largua nga Medineja dhe shkoi në Sham për të qetësuar zjarrin e dashurisë që e digjte nga brenda. Një natë ai pa në ëndërr të Dërguarin e Allahut (s.a.v.s), i cili e qortoi:

*“Ç’është kjo ndarje o Bilal? A nuk të ka ardhur koha për të më vizituar?”*. Bilali radijallahu anhu u zgjua i mërziur dhe menjëherë mori rrugën. Shkoi në Medine për të vizituar varrin fisnik të të Nderuarit të Botrave. Ai po qante pranë varrit të të Dërguarit të Allahut (s.a.v.s) dhe kur e vendosi fytyrën mbi varrin e tij, erdhën nipërit e Pejgamberit Hazreti Hasan me Hazretin Hysejn. Bilali radijallahu anhu filloi t’i puthte. Ata i thanë:

“O Bilal! Duam shumë që ta dëgjojmë ezanin tënd!”.

Pas kësaj Bilali filloi ta thërriste përsëri ezanin. Në atë çast Medineja u trondit. Kur ai thirri: “Eshhedu enne Muhammedurr-Rrasulullah”, të gjithë njerëzit, gra e burra, duke kujtuar se u ngjall i Dërguari i Allahut dolën nëpër rrugët e Xhamisë së Profetit. Në Medine nuk ishte parë asnjë ditë që njerëzit të qanin kaq shumë përveç ditën kur ndërroi jetë i Dërguari i Allahut (s.a.v.s). (Ibn Esir, Usdu'l-Gabe, I, 244-245; Dhehebi, Siyer,



Ky sahabi i bekuar, mik i dashur i të Dërguarit të Allahut ndërroi jetë në Damask në moshën gjashtëdhjetë e sa vjeçare. Kur ishte në shtratin e vdekjes tha:

“Nesër do të takohem me mikun tim të dashur inshallah, Hazreti Muhammed alejhissalatu vesselam dhe me shokët tuaj.”. Kur dëgjoi këto fjalë, bashkëshortja e tij filloi të qante:

“Mjerë për këtë që po më ndodh mua!”. Ndërsa miku i dashur i Pejgamberit, i cili e kishte zemrën të mbushur me mall, Bilali radijallahu anhu thoshte:

“Ah sa bukur, ah sa mirë! (Dhehebi, Siyer, I, 359)

Tashmë ata po mbanin fjalën e të Nderuarit tonë, Krenarisë së Gjithësisë: *“Atëherë ti do të jeshë me atë që dashuron.”*, dhe përiqeshin ta shtonin dhe ta shumëfishonin dashurinë e të Dërguarit të Allahut, e cila ishte kapitali më i madh dhe burimi i vetëm i ngushëllimit që kishin. Po ashtu, Enesi radijallahu anhu ka thënë:

“Pas mirësisë së hyrjes në islam, asgjë nuk më ka gëzuar më shumë se përgëzimi i të Dërguarit të Allahut: *Patjetër ti do të jesh me atë që e do.* Ja edhe unë e dua Allahun, të Dërguarin e Tij, po ashtu Ebu Bekrin dhe Omerin. Edhe pse nuk kam mundur të bëj ato vepra që kanë bërë ata, unë shpresoj të jem bashkë me ta.” (Muslim, Birr, 163)



Një natë, Hazreti Omer radijallahu anhu, kur po ecte në rrugët e qytetit me qëllim që të kontrollonte, pa se në një shtëpi kandili ishte i ndezur. Kur iu afrua shtëpisë, vuri re se një grua e vjetër po thurte lesh dhe po thoshte një poezi që kishte këtë kuptim:

“Salavatet dhe selamet e të devotshmëve qofshim mbi Hazretin Muhammed Mustafa (s.a.v.s). O i Dërguari i Allahut! Të gjithë personalitetet e larta lutshin mëshirë për Ty. Ti natën adhuroje, në kohët e mëngjezit qaje shumë, por vdekja dalëngadalë e arrin gjithkënd. Ah! Sikur ta di. A do të më bashkojë vallë ahireti me Pejgamberin tim të dashur?”

Omeri radijallahu anhu u ul dhe qau për shkak të kësaj poezie të



mbushur me ndjesi. Pastaj trokiti derën. Gruaja e moshuar e pyeti se kush ishte:

Ai u përgjigj: “Omer bin Hattabi.” Gruaja e moshuar filloi të shqetësohej:

“Çfarë pune ka Omeri me mua, çfarë kërkon ai në këtë orë këtu?” Hazreti Omer tha:

“Nëse e do Allahun, hape derën! Mos ki frikë!” Kur gruaja e hapi derën, Hazreti Omer i tha:

“A mund ta thuash edhe një herë poezinë që po thoje më parë?”

Gruaja e tha poezinë. Kur ajo arriti në rreshtat e fundit, Omeri radijallahu anhu i tha:

“Të lutem, më fusni edhe mua ndërmjet jush!”.

Pas kësaj, gruaja e thurri kështu rreshtin e fundit:

“Ah! Sikur ta di, a do të na bashkojë ahireti mua dhe Omerin me Pejgamberin tim të dashur? O Allah që je shumë falës! Fale Omerin!”. Omeri radijallahu anhu u kthye pas i gëzuar. (Ali el-Muttaki, XII, 562/35762)



Pas vdekjes së të Dërguarit të Allahut (s.a.v.s) nuk është parë kurrë më të fytyra e Hazretit Fatime. (Ibn Sa'd, II, 312)

Edhe Abdullah bin Omeri radijallahu anhu qante çdo here që kujtonte të Dërguarin e Allahut.

Enesi radijallahu anhu thoshte kështu, duke qarë:

“Nuk ka asnjë natë që nuk e kam parë Pejgamberin në ëndërr.” (Ibn Sa'd, VII, 20)

Enesi radijallahu anhu, ngaqë ishte njëri prej atyre që e njihnte më mirë Pejgamberin, jetonte si i Dërguari i Allahut dhe falte namaz si ai. Ai e mbante pranë gjithmonë një thupër dhe një fije flokësh të të Dërguarit të Allahut (s.a.v.s). Kur ndërroi jetë kjo thupër iu vendos në varr pranë tij ndërsa qimja e flokut nën gjuhën e tij, ashtu siç kishte





lënë testamentin.



Ashabët e nderuar, kur flisnin për të Dërguarin e Allahut ndjenin shumë kënaqësi ta fillonin ligjërimin veçanërisht me disa shprehje që nxirrnin në pah dashurinë e tyre për Të, si “habibi: i dashuri im”, “halili: miku im”.<sup>20</sup> Çdo gjë në këtë botë u kujtonte Mikun e tyre të dashur. Po ashtu, Ebu Dherr radijallahu anhu thoshte:

“Për Zotin, kur i Dërguari i Allahut (s.a.v.s) kaloi në botën tjetër, na pati lënë në një gjendje të tillë saqë, edhe nëse një zog rrihte krahët në qiell, lëvizja e tij na kujtonte një hadith të Dërguarit të Allahut, sepse i Nderuari i Botërave na pati thënë: *Gjithçka që u afron te xhenneti dhe që u largon nga xhehennemi u është sqaruar.* (Ahmed, V, 153, 162; Hejsemi, VIII, 263)



Ukbe bin Haris radijallahu anhu rrëfen:

Një ditë Ebu Bekri radijallahu anhu, pasi kishte falur namazin e iqindisë, kishte dalë nga xhamie dhe po ecte (bashkë me Hazretin Ali). Në atë çast ata panë nipin e të Nderuarit tonë, Hasanin, i cili po luante me fëmijët. Hazreti Ebu Bekr e kapi menjëherë, e hypi në qafë dhe filloi të thotë:

بَابِي شَبِيهٌ بِالنَّبِيِّ لَا شَبِيهٌ بَعَلِي

“Babai im të qoftë falë! Për Zotin ky i ngjan të Dërguarit të Allahut dhe jo Aliut!” Hazreti Ali po i shikonte nga pranë me buzëqeshje. (Buhari, Menakib, 23)



Ashabët e nderuar, edhe kur transmetonin hadithet fisnike të të

20. Buhari, Tehexhxhud 33, Saum 60; Muslim, Musafirin 85, 86; Ebu Davud, Vitr 7; Nesai, Sijam 81, Kijamu'l-lejl 28; Ibn Maxhe, Sadakat 10; Darimi, Saum 38; Ahmed, V, 159; Ibn Sa'd, IV, 229.



Dërguarit të Allahut, tregoheshin shumë të përpiktë, nga frika se mos thoshin ndonjë gjë fjalë jashtë porosive të të Nderuarit tonë. Amr bin Mejmun tregon kështu:

“Unë shkoja gjithmonë në bisedat fetare të Ibn Mes’udit radijallahu anhu, që i mbante mbrëmjeve të ditëve te enjteve. Gjatë bisedave të tij, në asnjë rast (për shkak të ndjesisë së tij) nuk e kam dëgjuar të thotë: “I Dërguari i Allahut (s.a.v.s) ka thënë...”, por në njërin nga këto mbrëmje ia filloi fjalës kësisoj: “I Dërguari i Allahut ka thënë...”, por përsëri e la fjalën përgjysmë dhe uli kokën. (Pasi prita pak) e hodha vështrimin kah ai. Ai qëndronte në këmbë, këmisha i qe hapur, nga sytë i rridhnin lot dhe mollzat e faqeve i ishin enjtur. (Pasi qëndroi për pak kohë kështu) e plotësoi fjalën e tij:

“I Dërguari i Allahut (s.a.v.s) pati thënë ashtu ose një diçka të tillë.” (Ibn Maxhe, Mukaddime, 3)



Ebu Bekr radijallahu anhu, kur donte të transmetonte ndonjë hadith pas vdekjes së Pejgamberit, kur e kujtonte të Dërguarin e Allahut, qante dhe fliste me shumë vështirësi. Ebu Hurejra e tregon kështu gjendjen e Ebu Bekrit:

“Ebu Bekri radijallahu anhu doli në minber dhe tha:

-Ju e dini se i Dërguari i Allahut (s.a.v.s) vitin e kaluar qëndronte mes jush ashtu si po qëndroj unë tani... Pastaj qau. Pastaj e përsëriti përsëri këtë fjalë dhe përsëri qau. Sërish e përsëriti për së treti dhe përsëri qau, pa mundur ta përmbante veten...” (Shik. Tirmidhi, Deavat, 105)



Aishja radijallahu anha, e shpreh kështu entuziazmin e takimit që babai i saj, Hazreti Ebu Bekr ndjente ndaj mikut të tij të vetëm Hazretit Pejgamber, në çastin e vdekjes:

Babai im Ebu Bekri radijallahu anhu, në shtratin e vdekjes pyeti:

“-Çfarë dite është sot?”. I thamë:



“-E hënë.” Ai tha:

“-Nëse vdes sonte, mos më lër të pres të nesërmen, sepse dita dhe nata që dua më shumë është ajo që është më afër të Dërguarit të Allahut. (Domethënë çasti që do ta takoj atë sa më parë.) (Ahmed, I, 8)

Pas vdekjes së të Dërguarit të Allahut (s.a.v.s), Hazreti Ebu Bekr radijallahu anhu, e ndjente veten në kurbet. Ndërsa kur po vdiste, ai ndjehej i entuziazmuar me hixhretin që do të bënte për te Allahu dhe i Dërguari i tij.



Edhe disa nga ashabët fisnikë ishin të dashuruar me të Dërguarin e Allahut dhe sëmundjet që ua afronin takimin me të (vdekjen) i shihnin me dashuri, ngaqë do të mund të takoheshin me Allahun dhe të Dërguarin e tij, e kësaj ata i dërgonin të Nderuarit tonë, Sulltanit të zemrave, selamet e tyre plot dashuri. Për shembull, Muhammed bin Munkedir radijallahu anhu i kishte bërë vizitë në ditët e tij të fundit Hazretit Xhabir, i cili ishte mik i dashur i të Dërguarit të Allahut. Kur ai e kuptoi se Xhabirit radijallahu anhu, zemra e të cilit vuante nga malli për të Dërguarin e Allahut, i qe afruar vdekja shumë, i tha:

“Bëji selam nga ne të Dërguarit të Allahut (s.a.v.s)!” (Ibn Maxhe, Xhenaiz, 4)



Dashuria ndaj të afërmve të të Dërguarit të Allahut dhe dashuria ndaj atyre që donte Ai, ishin nga shenjat e ashabëve. Përshembull, Hazreti Omer kishte nëntë copë pjata. Gjithçka që kishte, fruta gjelëra i vendoste në këto pjata dhe ua dërgonte bashkëshorteve të të Dërguarit të Allahut (s.a.v.s). Ndërsa më në fund ia dërgonte vajzës së tij Hafsa. Nëse kishte ndonjë mangësi në të, e plotësonte nga pjesa e tij. (Muvatta, Zekat, 44)



Po ashtu Hazreti Omer radijallahu anhu i kishte dhënë pesë mijë dirhem Usames, birit të Zejd bin Harithes, robit që kishte liruar



Pejgamberi, ndërsa birit të tij Abdullahut i kishte dhënë tre mijë dirhem.

Abdullahu, duke e kundërshtuar ndarjen e babait të tij Hazretit Omer, tha:

“Përse e mban më shumë Usamen se sa mua? Ai nuk ka marrë pjesë në luftë më shumë se unë!”

Hazreti Omer radijallahu anhu, si shtesë ndaj drejtësisë së tij të pashoq dha këtë përgjigje që nxjerr në pah se sa botë shpirtërore të pjekur kishte:

“O biri im! I Dërguari i Allahut e donte babanë e Usames më shumë se babain tënd. Edhe Usamen e donte më shumë se sa ty. Ja, për këtë shkak e mbaj më shumë atë që donte i Dërguari i Allahut se sa atë që dua unë.” (Tirmidhi, Menakib, 39/3813)



Edhe kjo ngjarje plot ndjesi që rrëfen Enesi radijallahu anhu, ishte si ato të mësipërmet:

“Unë pata dalë në një udhëtim me Xherir bin Abdullah.<sup>21</sup> Ai më shërbente (edhe pse ishte më i vjetër se unë). Kur i thashë:

-Ju lutem mos bëni kështu! Ai më tha:

-Kur pashë se Ensarët i shërbenin shumë të Dërguarit të Allahut, u betova në vetvete se, nëse do të bëhem shok me ndonjë Ensar, edhe unë do t'i shërbej atij. (Buhari, Xhihad, 71; Muslim, Fedailu's-Sahabe, 181)

Aman o Perendi, ç'është kjo dashuri e lartë!..



Shumica e ashabëve të nderuar jetonin me kujtimet që u kishin ngelur nga i Dërguari i Allahut. Përshembull Ebu Mahzura radijallahu

21. Xherir bin Abdullah radijallahu anhu, ishte kryetari i fisit Bexhile që jetonte në Jemen. Në Ramazanin e vitit të dhjetë të hixhretit, domethënë tre muaj para vdekjes së të Nderuarit tonë, duke ardhur në Medine me një grup prej njëqind e pesëdhjetë vetësh, u bënë myslimanë. Ai e donte shumë Pejgamberin. Edhe i Dërguari i Allahut e donte shumë atë dhe sa herë e shikonte, buzëqeshte.



anhu, as nuk i qethte e as nuk i ndante flokët që i kishte në ballë, sepse ato i kishte prekur i Dërguari i Allahut (s.a.v.s). (Ebu Davud, Salat, 28/501)



Përsëri i Dërguari i Allahut (s.a.v.s) e kishte këshilluar një grua nga Gafari:

**“Merr një enë me ujë, hidh brenda saj kripë. Pastaj laj me të gjakun që ka rënë në mbulesë!”**

Ajo zonjë sahabie e zbatoi këtë këshillë gjatë gjithë jetës me një dashuri të madhe dhe asnjëherë nuk i ka larë rrobat pa i hedhur ujit kripë. Madje edhe kur vdiq ujit të xhenazes së saj i hodhën kripë, sipas amanetit të saj.” (Ebu Davud, Taharet, 122/313)

Sa dashuri e lartë e atij që gjatë gjithë jetës nuk humbet asgjë nga fuqia e dashurisë, po përkundrazi vazhdon ta shtojë!..



Një ditë, Ibn Omerit radijallahu anhumu i ishin bymyer nervat e këmbës dhe i ishte tkurrur këmba. Abdurrahman bin Sa'd i cili ndohej afër tij, i tha:

“Përkujto emrin e atij që e do më shumë!” Ai tha:

“O Muhammed!”. Dhe në atë çast këmba iu shërua. (Ibn Sa'd, IV, 154)



I Nderuari ynë, Krenaria e Gjithësisë (s.a.v.s) duke treguar dashurinë e thellë që ummeti i tij ndjente për të, tha:

*“Një pjesë e atyre që do të më duan mua nga ummeti im, do të dalin nga ata që do të vijnë pas meje. Ata janë të gatshëm të sakrifikojnë pasurinë dhe familjen e tyre për të më parë mua.”* (Muslim, Xhennet, 12; Hakim, IV, 95)

Ja, për këtë arsye, që nga koha e lumturisë e deri më sot kanë



ardhur shumë miq të Allahut që digjeshin me dashurinë e Allahut dhe të të Dërguarit të Tij. Disa shembuj nga këta janë:

Abdullah bin Mubarek tregon:

Isha pranë Imam Malikut. Ai po na tregonte disa nga hadithet fisnike të të Dërguarit të Allahut. Në ato momente erdhi nje akrep dhe e pickoi disa herë. Ngjyra i ndryshoi, po zverdhej, por nuk e ndërpriste hadithin e të Dërguarit të Allahut (s.a.v.s). Pasi mbaroi mësimi dhe pasi u shpërndanë njerëzit, i thashë:

“O Ebu Abdullah! Sot po shikoj diçka të çuditshme te ti?”

Ai tha: “Po. Një akrep më pickoi disa herë dhe në të gjitha durova. Munda të qëndroj vetëm nga dashuria dhe respekti që kam ndaj të Dërguarit të Allahut.” (Munavi, III, 333; Suyuti, Miftahu'l-Xhennet, fq. 52)

Imam Maliku rahmetullahi alejh jetonte me dëshirën për t'u përsosur me moralin e të Dërguarit të Allahut (s.a.v.s). Për shkak të respektit që kishte për të Nderuarin tonë, në Medinetu'l-Munevvera ai nuk i hipte kafshës dhe as nuk shkonte në tualet. Kur ishte imam në Ravza, gjithmonë fliste me zë të ulët. Kur halifeja e asaj kohe foli me zë të lartë, ai i tha

“O halife! Ule zërin në këtë vend! Ndëshkimi i Allahut ka zbritur edhe mbi ata njerëz që janë më të virtytshëm se ti.” Dhe pastaj lexoi këtë ajet fisnik:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا لَا تَرْفَعُوا أَصْوَاتَكُمْ فَوْقَ صَوْتِ النَّبِيِّ وَلَا تَجْهَرُوا لَهُ بِالْقَوْلِ  
كَجَهْرِ بَعْضِكُمْ لِبَعْضٍ أَن تَحْبَطَ أَعْمَالُكُمْ وَأَنتُمْ لَا تَشْعُرُونَ

“O ju që keni besuar! Mos e ngrini zërin tuaj mbi zërin e Pejgamberit dhe mos flisni me të siç flisni me njëri-tjetrin, përndryshe veprat tuaja ju humbin pa e ditur.” (el-Huxhurat, 2)



Që në moshën e rinisë imam Maliku ishte shumë i përpiktë në respektin ndaj haditheve fisnike të Hazretit Pejgamber. Krahas rrespektit



që kishte për t'i mësuar ato saktë, i jepte shumë rëndësi edhe dëgjimit në qetësi dhe heshtje. Për këtë shkak, hadithet nuk i dëgjonte në këmbë dhe nuk merrte mësim hadithi kur ishte në vështirësi, i mërzhitur apo në një gjendje të pavendosur. Ai kishte frikë se bënte ndonjë gabim në hadithet fisnike. Një ditë kur e pyetën:

“A ke dëgjuar hadith nga Amr bin Dinar?” ai u përgjigj kështu:

“Unë e kam parë atë kur transmetonte hadithe. Njerëzit ishin në këmbë dhe shkruanin. Ndërsa mua nuk më pëlqen t'i shkruaj në këmbë hadithet fisnike të Pejgamberit tonë të Nderuar.”

Imam Maliku, aq sa kishte frikë kishte edhe një moral të bukur në të gjitha gjendjet dhe mësimet e tij. Fytyra i ndriçonte qoftë kur jepte fetva për disa çështje, qoftë kur transmetonte hadithe fisnike nga Hazreti Pejgamber. Ai, kur donte të transmetonte hadithet fisnike të Hazretit Pejgamber, merrte abdes, përgatitej dhe vishte rrobat më të bukura që kishte. Ai ulej në vend të lartë vetëm kur lexonte hadithet fisnike.

Kur i vinin njerëzit në shtëpi, shërbëtori i tij dilte dhe u thoshte:

“Imami po ju pyet: Doni të dëgjoni hadith, apo do të pyesni ndonjë çështje fikhu? Nëse do të pyesnin për ndonjë çështje fikhu, imami dilte jashtë dhe përgjigjej, por nëse donin të dëgjonin hadith, atëherë u thoshte: Uluni! Pastaj menjëherë shkonte dhe merrte gusull, hidhte erë të mirë, vishte rroba të reja, e lidhte çallmën, ulej në një vend të lartë dhe jepte mësim hadithi me frikërespekt ndaj Allahut. Mbrenda ndizte një lloj peme që shpërthente erë të mirë derisa të mbaronte mësimi.



Abide es-Selmani ishte njëri nga fakihët dhe muhaddithët dije-tarë të brezit të Tabiinëve. Ai u bë mysliman dy vjet para vdekjes së Pejgamberit, por nuk pati fatin që ta shikonte. Kjo fjalë e Abide e tregon shumë bukur dashurinë e myslimanëve të parë që ndjenin për të Nderuarin tonë:

“Një qime floku që kam nga i Dërguari i Allahut, është më e vlef-



shme për mua se sa pasuria e gjithë botës.” (Ahmed, III, 256)

Dijetari i njohur Islam Dhehebi i shprehte kështu ndjenjat e tij kur lexonte fjalët e mësipërme të Abide es-Selmanit, që shfaqnin dashurinë peygamberike:

“Fjalët e Abides, që preferonin një qime të flokut të të Dërguarit të Allahut më shumë se sa florinjt dhe argjendet që kishin njerëzit, ishin shenjë e një dashurie të lartë. Nëse ky dijetar i madh thotë kështu kur kanë kaluar vetëm pesëdhjetë vjet nga vdekja e Pejgamberit, po ne pas shtatëqind vjetëve të vdekjes së tij çfarë duhet të themi nëse do të fitojmë një qime floku të Tij, apo ndonjë copë të enës prej dheu në të cilën pinte ujë?

Nëse një njeri i pasur e harxhon pjesën më të madhe të pasurisë së tij për të fituar një gjë të tillë, a do ta shikoje si një njeri që e harxhon pasurinë jo moralisht? Jo, jo! Mos ki frikë nga harxhimi i pasurisë tënde për të vizituar Xhaminë e Profetit, të cilën i Dërguari i Allahut e ka bërë me duart e tij të bekuara, për t'i dhënë selam atij në krye të Dhomës së Lumturisë!

Kur të shkosh në Medine, shikoje shumë Malin e Uhudit, i cili ishte i dashuri i Tij dhe duaje edhe ti, sepse Hazreti Pejgamber alejhis-salatu vesselam e donte shumë Malin e Uhudit. Mundohu ta bindësh shpirtin tënd, duke shkuar shpesh në Ravzan e Tij dhe në vendet ku qëndronte, sepse nuk mund të jesh besimtar po s'e deshe Atë, të Nderuarin e Gjithësisë më shumë se shpirtin tënd, se fëmijën tënd, se çdo gjë që ke, shkurt, po s'e deshe më shumë se të gjithë njerëzit...” (Dhehebi, Sijer, IV, 42-43)



Rabi bin Sulejman, që ishte nga nxënësit e Imam Shafiut, tregon:

Një ditë Imam Shafiu më tha:

“Rabi, merre këtë letër, dërgoja Ahmed bin Hambelit dhe pastaj më sill përgjigje.”





takova me Ahmet bin Hanbelin. Namazin e sabahut e fala me të. Pasi Imam Ahmedi u largua nga mihrabi, i dorëzova letrën dhe i thashë:

“Këtë letër ta ka dërguar Imam Shafiu, vëllai yt nga Egjipti.” Ai më pyeti:

“A e di se për çfarë bën fjalë letra?” Unë iu përgjigja:

“Jo.” Pastaj Ahmed bin Hanbeli e hapi letrën dhe filloi ta lexojë. Sytë iu mbushën menjëherë më lot. Unë i thashë:

“O Imam! Çfarë ka! Çfarë thuhet në atë letër?” Ai u përgjigj:

“Imam Shafiu ka parë në ëndërr Hazretin Pejgamber (s.a.v.s). Pejgamberi i ka thënë:

*-Shkruaj një letër Ahmed bin Hambelit dhe bëji selam nga unë. Ai do të përballet me një fitne të madhe. Do t'i kërkohet që të thotë: “Kur’ani është i krijuar!” Kujdes, të mos i bindet kësaj kërkese! Allahu do ta lartësojë emrin e tij do ta bëjë të jetojë dhe deri në kiamet.*

Unë i thashë:

“O Imam! Sa përgëzim i madh është ky për ty.”

Nga gëzimi që ndjente Imam Ahmedi hoqi këmishën dhe ma dha mua. Pasi mora përgjigjen e letrës, unë u ktheva në Egjipt. Letrën ia dhashë Imam Shafiut. Imam Shafiu më tha:

“Ne nuk duam të të marrim këmishën që ta ka dhuruar ai dhe të të mërzisim, por të paktën fute në ujë atë dhe pastaj ujin na e jep neve, ashtu që edhe ne të jemi ortakë në bereqetin e asaj këmishë.”<sup>22</sup>



Dijetari i hadithit dhe muxhtehidi Hazreti Imam Nevevi, në çdo gjendje dhe lëvizje të tij, e kishte gdhendur në jetën e tij pasimin e të Dërguarit të Allahut dhe kishte marrë nga morali i të Nderuarit tonë aq shumë, sa nuk ka ngrënë shalqi gjatë gjithë jetës vetëm për arsye se nuk e dinte si e ka ngrënë shalqirin i Dërguari i Allahut, duke e thyer, apo duke e prerë?

22. Shik. Ibnu'l-Xhevzi, Menakibu'l-Imam Ahmed bin Hanbel, (skt. Abdullah bin A - dulmuhsin et-Turki) Kahire 1409, fq. 609-610.



Po ashtu, është e vlefshme të përmendim edhe dashurinë që kishite Imam Busirit ndaj të Dërguarit të Allahut:



Një ditë, Imam Busiri i cili ishte autori i poezisë së njohur Bur'e, kur po shkonte në shtëpi, takoi në rrugë një shejh, fytyra e të cilit ndriçonte. I moshuari e pyeti:

“O Busiri! A e ke parë mbrëmë në ëndërr të Dërguarin e Allahut (s.a.v.s)? Imam Busiri u përgjigj:

“Jo, nuk e kam parë.”

Pas kësaj bisede të shkurtër, shejhu u largua pa thënë asgjë, por fjalët e tij e entuziazmuan dashurinë që Imami kishte në zemër ndaj Hazretit Pejgamber. Atë natë Imami e pa në ëndërr Hazretin Pejgamber dhe kur u zgjua ndjeu se zemra i ishte mbushur me gëzim dhe rehati. Pas kësaj nate ai shkroi shumë poezi që lavdëronin Pejgamberin, të Nderuarin tonë (s.a.v.s) dhe të dashurit e Pejgamberit që ishin mbytur në detin e dashurisë.

Pas një farë kohe, iu paralizua gjysma e trupit. Nuk mund të ecte dhe nuk mund të lëvizte. Atëherë shkruajti poezinë e njohur Bur'e dhe me të i kërkoi shërim Allahut. Natën që e mbaroi poezinë, pa në ëndërr Hazretin Pejgamber (s.a.v.s) dhe ia lexoi poezinë Atij. Pasi ia lexoi të tërë poezinë të Dërguarit të Allahut (s.a.v.s), Ai ia fshiu Imam Busirit me duart e tija të bekuara gjymtyrët e paralizuar. Kjo ishte një shenjë aq e thellë dashurie, sa që kur u zgjua nga gjumi, Imam Busiri vuri re se ishte shëruar dhe falenderoi Allahun.

Në mëngjesin e asaj nate, kur po shkonte në xhami i gëzuar dhe i shëruar, takoi në rrugë Shejh Ebu'r-Rexhanë. Hazreti i tha:

“O Busiri! A mund ta lexosh poezinë në të cilën ke lavdëruar Krenarinë e Botërave?”

Imam Busiri e pyeti:

“Unë kam shkruar shumë poezi që e lavdërojnë të Dërguarin e Allahut (s.a.v.s). Cilën prej tyre doni ju?”



Shejhu Ebu'r-Rexha tha:

“Dua atë që ia lexove Hazretit Pejgamber, sepse pashë që Pejgamberi u kënaq shumë nga kjo poezi.”

Imam Busiri u habit pa masë, ngaqë e dinte mirë se këtë poezi nuk e kishte dëgjuar askush.<sup>23</sup>



Miku i madh i Zotit, Sejjid Ahmed Jesevi, i cili ngjalli në zemra dritën dhe mirësinë e Islamit që nga Azia e Mesme e deri në Ballkan, kur hyri në moshën 63 vjeç, hapi një varr në tokë dhe tha:

“Nuk është e nevojshme për mua që të jetoj më mbi këtë tokë pas kësaj moshe!”. Sipas një transmetimi, dhjetë vjet jetë adhurim dhe udhëzim i vazhdoi në varr, me dëshirën për të marrë nga morali i të Dërguarit të Allahut.



Çliruesi i Indisë Gazneli Mahmud kishte një shërbëtor që e donte shumë dhe të cilin e quanin “Muhammed”. Atij i thërriste gjithmonë me emrin e tij. Një ditë ai nuk e thirri shërbëtorin me emrin që kishte, por me emrin e babait të tij. Nga shkaku i kësaj sjelljeje, shërbëtori u mërzit dhe iu thye zemra përpara Sulltan Mahmudit. Kur e pyeti se përse e thirri kështu, miku i dashur i Pejgamberit, Gaznel Mahmudi dha këtë përgjigje:

“O biri im! Çdo ditë të kam thirrur me emrin tënd sepse kisha abdest, ndërsa tani nuk kam. Për këtë shkak u turpërova ta them emrin tënd pa abdest. Për këtë arsye të thirra me emrin e babait tënd.”



Perandoria Osmane ishte një perandori që shquhej për dashurinë që i gjithë populli kishte për Pejgamberin, duke filluar që nga padi-shahu e deri te bariu më i thjeshtë. Krahas selameve që i dërgonin Pejgamberit (s.a.v.s) sa herë që i përmendej emri, por ishin bërë zakon

23. Shik. İlhan Armutçuoglu, Kaside-i Bürde Manzum Tercümesi, Konja 1983, fq. 7-10.



edhe shfaqjet e panumërta nderuese si, vendosja e dorës në zemër me respekt dhe dëgjimi në këmbë i rreshtave që shprehnin çastin e lindjes, kur lexohej Mevludi i Tij. Kur vinte posta e Medines së Ndriçuar, nuk kishte asnjë padishah Osman që ta lexonte letrën e ardhur pa marrë abdest të ri, pa e puthur, pa i fshirë sytë me të dhe pa u ngritur në këmbë.

Mbi të gjitha, ndrojtja që kishin Osmanët për të mos e shqetësuar të Dërguarin e Allahut në riparimin e Xhamisë së Tij; çdo gur e vendosnin në vendin e tij me abdest dhe me besmele, mbështjellja e çekiçëve me shajak, etj, ishin shembuj të një edukate dhe respekti i pashoq.

Po ashtu, në kohën e Osmanëve Surre Ala<sup>24</sup>, që dërgohej në Medinetu'l-Munevvera, para se të hynte në qytet, qëndronte në një vend afër saj, përgatiteshin për atmosferën shpirtërore të Medinetu'l-Munevvera dhe pasi konsultoheshin në kuptim figurativ, shkonin para të Dërguarit të Allahut dhe e kryenin vizitën e tyre. Edhe kur ktheheshin, sillnin nga dheu i bekuar i Medinetu'l-Munevveras si shërim dhe bereqet.

Puplat në majë të çallmave të padishahëve Osmanë, vihen re në portretet e asaj kohe, ishin një maskë fshese. Përmes kësaj ata shprehnin dhe pranonin se ishin fshirësit e Haramejni'sh-Sherifejn, dhe shpërblimin e atyre që kishin marrë përsipër pastrimin e Haramejnëve, e paguanin me paratë e tyre.



Sa shenjë e madhe e dashurisë dhe e respektit është që qimet e flokëve dhe të mjekrrës së Pejgamberit (s.a.v.s) të jenë bereqet dhe mëshirë për ummetin prej shekujve, me emrin “Mjekrra Fisnike”, duke i fshehur në dyzet bohçe në minberet e xhamive si një dhuratë fisnike nga i Nderuari ynë.



---

24. **Surre Ala:** Janë para, floriinj dhe dhurata që dërgonin Padishahët në muajin Rexhep, nga Stambolli në Mekke dhe Medine, para sezonit të Haxhit, për t'ua ndarë njerëzve, që nga më të parët e deri te më të varfërit, nëpërmjet një ceremonie. (Shik. Munir Atalar, Surre-i Hümayun ve Surre Alayları, Ankara 1991, fq. 2)



Sulltan Javuz Selimi pati çliruar Egjiptin. Edhe administrata e krahinës së Hixhazit i ishte dorëzuar atij. Më 20 shkurt, ditë e premtë, hatibi foli për të në Xhaminë Melik Muejjed dhe tha:

“**Hakimu’l-Haramejni’sh-Sherifejn**” (Sunduesi i dy vendeve fisnike Mekke dhe Medine). Javuzi e ndërpreu fjalën e hatibit dhe u përgjigj me sy të përloitur:

“-Jo, jo! Përkundrazi, **Hadimu’l-Haramejni’sh-Sherifejn** (Shërbëtori i dy vendeve fisnike Mekke dhe Medine). Pastaj hoqi qilimin dhe falenderoi Zotin, duke i bërë sexhde në tokë. Për ta shfaqur se ai ishte Hadimu’l-Haramejni’sh-Sherifejn, vendosi një pupël mbi calmën e tij, pupël që simbolizonte fshesën.

Edhe këto fjalë që i tha pashait të moshuar, të cilit i kishte dhënë detyrën si padishah në këto vende të bekuara, janë një shfaqje e sinqertë e dashurisë që kishte ndaj Hazretit Pejgamber (s.a.v.s):

“O pasha! Padishahllëku i Mekkes dhe i Medines është në dorën e bijve të nderuar të të Nderuarit të Gjithësisë. Unë nuk e kam marrë atë vend me ushtri. Ata m’u bindën mua për hir të bashkimit Islam, për shkak të përsosmërisë, edukatës dhe mirësisë që kanë. Shpërblimi i këtij nderi është vaxhib për mua. Unë e falenderoj Allahun Teala natë e ditë, që emri im përkujtohet në hytbet të cilat mbahen në këto vende të bekuara. Këtë lumturi nuk e ndërroj edhe me sundimin e të gjithë botës! Për këtë arsye mos kurse asgjë që në lidhje me nevojat që ka populli i Haramejni’sh-Sherifejn dhe mos u orvat të ndërhysh gjë në punët e këtyre dy vendeve!”



Gjyshërit tanë të bekuar kanë shfaqur gjatë shekujve një respekt dhe dashuri të papërkufizueshme ndaj kujtimeve dhe amaneteve të shenjta të të Dërguarit të Allahut. Për të parë disa nga këto shembuj të shkëlqyer, është e mjaftueshme që t’i hedhim një sy historisë së amaneteve të shenjta, që gjyshërit tanë u shërbenin shumë dhe i praninin si të tilla me një nder të madh.

Sulltanët Osmanë që nuk dëshironin të largoheshin qoftë edhe një çast nga Hirkatu’s-Saade e Pejgamberit të Nderuar, edhe në vendet ku



shkonin e merrnin me vete në mënyra të ndryshme. Po ashtu edhe në Sarajën Istavro, e cila tashmë gjendet në vendin ku është Saraja e Bejlerbejit dhe në Sarajën e vjetër të Edirnesë, u ndërtua nga një dhomë e Hirkatu's-Saade, si ajo që është në Topkapë.

Hirkatu's-Saaden e merrnin edhe në luftëra. Është shumë tërheqëse një miniatyrë në të cilën përshkruhet njëra nga këto luftëra. Siç kuptohet nga miniatyra, gjatë udhëtimit për në luftë Hirkatu's-Saade transportohej mbi kokat e ushtarëve mbrojtës, të cilëve u ishte ngarkuar kjo detyrë.

Mehmedi III i cili ishte një nga Sulltanët Osmanë, edhe pse nga pikëpamja e karakterit ishte padishah shumë i ashpër dhe nervoz, ishte gjithashtu një personalitet i mbushur me dashurinë e Pejgamberit. Kur përmendej emri fisnik i të Dërguarit të Allahut (s.a.v.s), ai e shfaqte dashurinë dhe respektin që kishte ndaj Tij duke u ngritur në këmbë. Kur Mehmedi III shkoi në luftën e Egrit, mori me vete Flamurin Fisnik dhe Hirkatu's-Saade. Kur gjatë luftës mes myslimanëve ndodhi një mosmarrëveshje, hoxha i Sulltanit, Sadeddin Efendi i dha fetva padishahut që të veshë Hirkatu's-Saade, duke i thënë:

“O padishahu im! Është e përshtatshme që një Sulltan i lartë që është halife në rrugën e Pejgamberit alejhisselam të veshë Hirkatu's-Saade në raste të tilla dhe t'i lutet Allahut”. Pasi Sulltan Mehmedi III e veshi Hirkatu's-Saade me salate, selam dhe tekbiere, ushtarët e Islamit u mbushën me entuziazëm të thellë dhe më në fund korrën një fitore të sigurtë.



Sulltan Ahmed Hani i, gjatë ndërtimit të xhamisë e cila do të përkujtohej me emrin e tij, solli në tyrben e Ejjub Sulltanit gjurmët e këmbëve të bekuara, që në arabisht quhen “**Nakshu'l-Kadem**”. Kur mbaroi ndërtimi i xhamisë, ato i vendosi te kjo xhami.

Por, natën kur u transportuan ato, Sulltani pa një ëndërr të tillë:

*“Ishte krijuar një kuvend i lartë në të cilin ishin mbledhur të gjithë Sulltanët, ndërsa Hazreti Pejgamber ishte ulur në vendin e gjykatësit.*

*Pothuajse ishte krijuar në lloj gjykate. Sulltan Kajëtbaj ishte ankuar*



*nga Sulltan Ahmed i për shkak se kishte sjellë në Stamboll Kademu's-Saade, të cilat ishin shkak për vizitën e tyrbes së tij. I Dërguari i Allahut (s.a.v.s) me kompetencën e gjykatësit gjykoi që Kademu'sh-Sherif duhet të kthehet prapa menjëherë...”*

Sulltan Ahmed Hani u zgjua me trishtim dhe frikë. Ai u tha dijeta-rëve dhe të urtëve, mes të cilëve ndodhej edhe Aziz Mahmud Hydaji, që ta komentonin atë. Ata thanë:

“O Sulltani ynë! Ëndërra është shumë e qartë dhe nuk ka nevojë për komentim. Amaneti duhet të kthehet prapa menjëherë...”

Sulltan Ahmed Hani i, i cili ishte mik i dashur i Pejgamberit, iu bind vendimit që u mor dhe i mërzhitur e ktheu amanetin me një përpikmëri të madhe, por Ahmed Hani i, të cilit i digjej zemra nga dashuria që kishte ndaj Pejgamberit, u bëri një maket mbi mermer gjurmëve të këmbëve të bekuara të të Dërguarit të Allahut (s.a.v.s). Ai u mundua të marrë begati nga mendimet e përbashkëta, duke i vendosuar ato në arkën më pambuk. Këto vargje që dalin nga zemra e tij e djegur, e reflektojnë shumë bukur dashurinë që kishte:

*Çfarë ka nëse të mbaj vazhdimisht si kurorën time*

*Këmbën e pastër të Hazretit Pejgamber...*

*Ajo këmbë zotëron kopështin e trëndafilave të profetësisë,*

*Vëre në fytyrë këmbën e Ahmedit që është si trëndafil!..*



Abdulaziz Hani, i cili ishte një padishah i dashuruar shumë me të Dërguarin e Allahut (s.a.v.s), pati dërguar në Medine një letër<sup>25</sup> shumë të ndjeshme që bënte fjalë për Hazretin Pejgamber, për t'u vendosur në Ravdatu'l-Mutahhara.

Tani po paraqesim disa fjali nga kjo letër!

“Bismillahi'rr-Rrahmani'rr-Rrahim.

Falenderimi i takon Allahut i cili është i vetëm!

25. Sot kjo letër ndodhet në dhomën e Hirkatu's-Saade në Sarajën e Topkapës.

Salatet dhe selamet qofshin mbi ty o i Dërguari i Allahut!

Salatet dhe selamet qofshin mbi ty o i Dashuri i Allahut!

Salatet dhe selamet qofshin mbi ty o Pejgamberi i këtij ummeti!..

Ai e respektonte miqësinë dhe ishte shenja e pandryshuar e mirësisë dhe bujarisë, ishte ai i cili u lartësua me këtë lavdërim të lartë, “Sikur të mos ishte Ti, nuk do ta krijoja gjithësinë!”, ishte burimi i krenarisë së krijesave, i nderuari i të nderuarve, ndërmjetësuesi ynë, vendstrehimi ynë, ishte ai që çdo punë e bënte të pastër dhe me mendjempërhtësi, atij edhe pluhuri i këmbës i shkëlqente, ai ishte edukuesi më i lartë i botës së krijesave, zotëruesi i gjurmëve të begata që përhapnin erë të mirë, dashuria e tij mbushte tërë gjithësinë, i fundit i pejgamberëve, i nderuari i ditës së gjykimit, ndërmjetësuesi i mëkatarëve nga ummeti i tij, bukuria e kuvendit unik, bukuria e çatisë së oborrit të pejgamberëve, sunduesi i kuvendit të profetësisë, pejgamberi i atyre që hyjnë në rrugën e Allahut të Butë. Ishte i dashuri i Allahut të Mëshirshëm.

Ai që kam për qëllim me këto cilësi, është Hazreti Muhammed Mustafa...

Mora guximin ta lyej fytyrën time të zezë dhe të mjerë me dritën e tij dhe me dheun e pastër si ujë të varrit të tij të ndritshëm, me përgjërim, edukatë dhe me shumë ndjenja të mia të fshehta. Mora guxim që me ballin tim që meriton të ndëshkohet, të bëj këtë kërkesë e cila është shfaqja e brengave ndaj derës së tij ku shpërthejnë erëra të bukura.

Falenderimi i takon Allahut, i Cili më ndihmoi dhe më dha sukses që me mirësi, me nder dhe me devotshmëri, të bëhem ummet i përsosur në besnikëri i të Dashurit të Allahut, i cili është hëna e plotë e hënave të botës së melekutit dhe i cili kishte aq shumë bereqet sa që edhe dielli ndriçues i qiellit të xheberutit turpërohej dhe merrte dritë nga ai, të bëhem ummet i mikut të Allahut i cili është i Mëshirshëm dhe furnizues dhe i kryekomandantit të të devotshmëve, të cilët meritojnë bukuritë dhe mirësitë më të mira...

Përsëri falenderimi i takon Allahut i Cili më bëri roje të rrobës së bukur (Hirkatu's-Saade) që është marrë nga vendi ku mblidhen ëngjëjt





(nga Pejgamberi e Medineja) dhe nga ekzistenca e burimit të bujarisë mëshirore të përsosur, të nderuar dhe të bereqetshme, që ishte mirësia e xhennetit të krijesave të larta dhe të atyre që ishin të nderuar e te bekuar...

Inshallah fitoj ndërmjetësimin tënd ditën e shpërblimit dhe të ndëshkimit, ditën kur Pasuria dhe fëmijët të mos kenë asnjë dobi. (esh-Shura, 88) si vazhdim i kësaj mirësie. Ja, unë Abdulaziz Han Gazi, i biri i Mahmud Hanit, që është fajtor, mëkatar dhe mosbindës prej ummetit tënd, që bëj lutje dhe përgjërohem natë e ditë për të të takuar ty me ata që hyjnë të parët në Xhennet, pohoj çdo faj dhe mosbindje që kam bërë dhe se do të merrem në llogari para të Nderuarit tonë, lavdisë së profetësisë. Mora guximin të shfaq këtë gjendjen time të mbushur me fatkeqësi (e shpreha këtë të vërtetë për të marrë ndërmjetësimin tënd, o i Dërguari i Allahut, te dera jote që shpërndan mëshirë.)

I kërkoj falje Allahut për të gjitha mëkatet e mia! Përsëri përsëri i kërkoj falje Allahut!..

Ndërmjetësim, ndërmjetësim o i Dërguari i Allahut! Mos më lër të vetëm!..

O babai i Fatimetu'z-Zehra radijalahu anha! Salatet dhe selamet qofshin mbi Ty!

O gjyshi i Hasanit dhe i Husejnit! Salatet dhe selamet qofshin mbi Ty!

O i Nderuari i paraardhësve dhe i pasardhësve! Salatet dhe selamet qofshin mbi Ty!...<sup>26</sup>



Edhe Abdulhamid Hani i II, i cili ndërtoi linjën hekurudhore të Hixhazit, me qëllim që muslimanët e botës të shkojnë dhe të vijnë lehtë nga Haramejni, urdhëroi që të bëhen stacione në vendet ku kishte pushuar Pejgamberi nëpër udhëtime, ashtu që kjo hekurudhë të ishte e përshtatshme ndaj sunnetit të lartë. Ja, me një dashuri të tillë kishte

26. Hilmi Ajdën, Hırka-i Saadet Dairesi ve Mukaddes Emanetler, Stamboll 2004, fq. 272-275



bërë hekurudhat deri në Medine.



Poezitë dhe vjershat e poetëve që shfaqin dashurinë e tyre ndaj të Dërguarit të Allahut, janë aq shumë sa që mund të bëhen libra me vëllime. Sa bukur thotë poeti Nabi:

*Unë të lavdërova Ty për arsye se shumë pemë, gurë, bimë dhe krijesa të pashpirtëra erdhën dhe folën para teje.”*



Me të vërtetë, përveç njerëzve, herë herë edhe kafshët e bimët e kanë shfaqur dashurinë e tyre të thellë që kishin ndaj të Dërguarit të Allahut. Sefine, robi që u lirua nga i Dërguari i Allahut, na tregon një nga këto shembuj:

“Pata dalë në det. Anija mbi të cilën kisha hipur u copëtua. U kapa mbas një cope dërrase. Ajo më dërgoi në një vend të dendur me pemë, ku kishte luanë. Njëri prej luanëve erdhi drejt meje që të më hante. I thashë:

-O Ebu'l-Harith! Unë jam robi i të Dërguarit të Allahut, mua më ka ndodhur kështu.

Kur thashë këto fjalë, luani ndaloi e pastaj u afrua me kokën ulur. Duke më shtyrë me supet e tij, ai më nxori nga pemët e dendura. Pasi më drejtoi për në rrugë, filloi të lëshoj ca hungërima të lehta. E kuptova se po më përshëndeste. Ky ishte takimi im i fundit me të.” (Hakim, III, 702/6550; Abdurrazzak, XI, 281-282; Taberani, VII, 94)



Së fundi, ka shumë fjalë të tjera që mund të thuhet, shumë shembuj që mund të transmetohen, të cilat shprehin dashurinë legjendare që ndjente ummeti ndaj të Dërguarit të Allahut. Ne paraqitëm vetëm disa shembuj nga deti.

E dimë shumë mirë se ndjenjat shpirtërore në adhurim, edukata në vepra, mirësjellja në moral, hijeshia në zemra, drita e bukur në fyty-



ra, mirësjellja në komunikim, imtësia në ndjenja, thellësia në mendime dhe të gjitha bukuritë e tjera, janë veçellime që reflektojnë në zemra nga dashuria për Dritën e Atij. Burimi i vetëm i mëshirës dhe dashurisë që të shpie në detin e dashurisë ndaj Allahut, është Pejgamberi, i Nderuari ynë (s.a.v.s). Ashtu sikundër dashuria ndaj Pejgamberit (s.a.v.s) është dashuri ndaj Allahut, edhe bindja ndaj Tij është bindje ndaj Allahut. Nga ana tjetër, mosbindja ndaj Tij është mosbindje ndaj Allahut.

Allahu Teala u dhashtë zemrave tona rizk nga klimat shpirtërore të Hazretit Pejgamber (s.a.v.s), i cili është udhëzuesi i vetëm për në rrugën e drejtë, dhe u faltë atyre vesa të begata nga ndjenjat e Tij të pafundme shpirtërore. Qofshin zemrat tona një vend i përhershëm për dashurinë e Allahut dhe të të Dërguarit të Tij. Allahu na e bëftë rizk të gjithë neve ndërmjetësimin e Tij të madh. Amin!..

### **c. Dashuria ndaj vëllait në fe**

Kur të shtohet në zemrën e robit dashuria ndaj Allahut, është e nevojshme që, së pari kjo dashuri të dojë Dritën e Muhammedit, pastaj ekzistencën e Hazretit Pejgamber, pastaj miqtë e Zotit dhe më pas, duke u zgjeruar dora-dorës të dojë çdo krijesë që është e pranuar te Allahu sipas shkallës së pranimit. Ja, një sferë e tillë dashurie e drejtuar për te Allahu, përbën një burim shërimi dhe mëshire për shpirtërat. Për këtë arsye, në mardhënjet ndërmjet tyre besimtarët nuk duhet të dalin kurrë jashtë kësaj sfere mëshire dhe dashurie, sepse ky është rezultati i saj, dashuria ndaj Allahut dhe rruga për shfaqjen e afrimitetit ndaj Tij.

Në Kur'anin Fisnik, Allahu Teala thotë se besimtarët janë vëllezër.<sup>27</sup> Edhe i Nderuari ynë (s.a.v.s) thotë se nuk mund të arrihet besimi i përsosur pa u krijuar një lidhje e fortë dashurie ndërmjet vëllezërve në fe. Për krijimin e kësaj dashurie, Ai e ka porositur ummetin e Tij që të

27. el-Huxhurat, 10.



shpërndajnë selamin ndërmjet tyre.<sup>28</sup>

Dashuria e besimtarëve ndaj njëri-tjetrit është një veti e bukur me të cilën Allahu është i kënaqur. Edhe lumturia e të dy botrave është e lidhur me këtë dashuri. Krenaria e Gjithësisë, i Nderuari ynë, ka thënë:

*“Në ditën e kiametit Allahut Teala do të thotë: Për hir të madhërisë sime, ku janë ata që e kanë dashur njëri tjetrin me qëllim për të m'u bindur Mua? Sot kur nuk gjendet asnjë hije, do t'i marr ata në hijen Time dhe do t'i mbroj.”* (Muslim, Birr, 37)

*“Allahu Teala thotë: Për ata që e kanë dashur njëri-tjetrin për hir Tim, do të ketë minbere drite të cilat edhe pejgamberët dhe dëshmorët do t'i kenë zili<sup>29</sup>.”* (Tirmidhi, Zuhd, 53/2390)

Në një tjetër hadith fisnik tregohet se ditën kur nuk do të ketë hije tjetër përveç hijes së Tij, Allahu do t'i marrë në hijen e Arshit.<sup>30</sup> vëllezërit në fe, ata të cilët kanë dashur njëri-tjetrin për hir të Allahut dhe që takimet dhe ndarjet e tyre i kanë bërë vetëm për hirë të Allahut. Sigurisht, kjo është dashuria vëllazërore e kohërave të vështira dhe të mundimshme.

Edhe zemërimet e vëllezërve besimtarë ndërmjet njëri-tjetrit janë sjellje të këqia të cilat asnjëherë nuk janë konsideruar të drejta. I Dërguari i Allahut (s.a.v.s) thotë:

*“Nuk është hallall që një besimtar ta lërë vëllain e tij në fe dhe të rrijë i zemëruar me të më shumë se tre dite. Pasi të kalojnë tre ditë të takohet me të dhe ti japë selam. Nëse tjetri e pranon selamin e tij, që të dy kanë sevape. Nëse nuk e pranon, ai që nuk e pranon ka bërë mëkat, dhe ai që ka dhënë selamin ka dalë nga zemërimi.”* (Ebu Davud, Edeb, 47/4912)

*“Kush e lë vëllain e tij në fe një vit dhe rri i zemëruar, ka hyrë në*

28. Muslim, Iman 93-94.

29. Sipas shpjegimeve të muhaddithëve, qëllimi i shprehjes “do të ketë minbere drite që edhe pejgamberët dhe dëshmorët do t'i kenë zili” nuk është për të thënë se ata janë më lart se pejgamberët dhe dëshmorët, por për ta shfaqur në mënyrë të sigurtë mirësinë dhe pozitën e lartë të atyre që duan për hir të Allahut.

30. Buhari, Ezan, 36.



*mëkat sikur t'i ketë derdhur gjakun.*" (Ebu Davud, Edeb, 47/4915)

Sipas haditheve të Pejgamberit alejhissalatu uesselam, veprat që kanë bërë njerëzit i paraqiten Allahut Teala ditën e hënë dhe ditën e enjte. Çdo robi që nuk ka bërë shirk, i falën mëkatet, përveç atij që ka armiqësi me vëllain në fe. Engjëjve u thuhet shpesh: "Vonojeni faljen e tyre, derisa të pajtohen me njëri-tjetrin!" (Muslim, Birr, 35-36; Ebu Davud, Edeb, 47)

### ***Tabllo të virtytshme***

Një ditë, duke i kapur dorën Muadhit radijallahu anhu, i Dërguari i Allahut (s.a.v.s) i tha:

*"O Muadh! Beto hem në Allahun se me të vërtetë të dua ty."* Edhe Muadhi tha:

"Nëna dhe babai im të qofshin falë, o i Dërguari i Allahut! Edhe unë të dua shumë. Pastaj Pejgamberi i tha atij:

*"O Muadh! Të rekomandoj që në fund të çdo namazi të mos e lësh këtë lutje: O Allah! Më ndihmo që të mund të të përkujtoj, që të të falenderoj dhe që të të adhuroj si duhet."* (Ahmed, V, 244-245; Ebu Davud, Vitir, 26; Nesai, Sehv, 60; Tirmidhi, Zuhd, 30)

Sa shfaqe e bukur dashurie!.. I Dërguari i Allahut e do Muadhin si një vëlla besimtar dhe si shenjë e kësaj dashurie i jep një rekomandim që të përfitojë prej tij.



I Dërguari i Allahut (s.a.v.s) thotë:

*"Ka disa njerëz prej robërve të Allahut që nuk janë as pejgamberë dhe as dëshmorë, por ditën e kiametit pejgamberët dhe dëshmorët do t'i shohin ata me ëndje, për shkak të pozitës që kanë te Allahu."*

Ashabët e nderuar thanë:

"O i Dërguari i Allahut! Kush janë ata dhe çfarë punësh të mira



bëjnë? Na trego që edhe ne t'i duam ata dhe të interesohemi për ta!"

I Dërguari i Allahut (s.a.v.s) tha:

*"Këta janë një popull që e duan njëri-tjetrin vetëm për hir të Allahut, pa pasur ndërmjet tyre ndonjë lidhje farefisi, tregtie apo pune. Për Zotin, fytyrat e tyre janë dritë dhe ata janë mbi minbere prej drite. Ata nuk kanë frikë kur të gjithë njerëzit do të kenë frikë, ata nuk do të brengosen kur të gjithë njerëzit do të brengosen."* Pasi mbaroi fjalën, ai lexoi menjëherë këtë ajet fisnik:

**"Dijeni se Miqtë e Allahut nuk do të kenë frikë dhe kurrfarë brengosje (në botën tjetër). (Ata janë) të cilët besuan dhe ruheshin. Atyre u jepet përgëzim në këtë botë dhe në botën tjetër. Premtimet e Allahut nuk ndryshojnë. Ja, kjo është fitorja e madhe."** (Junus, 62-64) (Ebu Davud, Buyu, 76/3527; Hakim, IV, 170)



Ebu Idris el-Havlani rahimehullah tregon:

"Pata hyrë në xhaminë e Damaskut. Aty pashë një djalosh me fytyrë të qeshur dhe një grup njerëzish që ishin mbledhur përreth tij. Këta kur binin në kundërshtim për ndonjë çështje, pyesnin këtë djalosh dhe ia pranonin mendimin. Pyeta se kush është ky djalosh. Më thanë se është Muadh bin Xhebel radijallahu anhu."

Ditën e nesërme shkova herët në xhami. Pashë se ky djalosh kishite ardhur para meje në xhami dhe po falte namaz. E prita derisa mbaroi namazin, i dola përpara dhe i dhashë selam, pastaj i thashë:

"Betohem në Allahun se unë të dua ty!"

Ai më tha: "A më do për hir të Allahut?" I thashë:

"Po, për hir të Allahut." Ai më tha edhe dy herë:

"(Me të vërtetë) a për hir të Allahut më do?". Edhe unë, çdo herë iu përgjigja:

"Po, (me të vërtetë) të dua për hir të Allahut." Atëherë më kapi për rrobash, më tërhoqi drejt vetes dhe më tha:



“Të përgëzoj, sepse unë e kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut duke thënë:

*Allahu Teala thotë: “Ata që duhen për vetëm për hatrin Tim, ata që mblidhen vetëm për kënaqësinë Time, ata që e vizitojnë njëri tjetrin për hatrin Tim dhe ata të cilët japin lëmoshë dhe bëjnë mirë vetëm për kënaqësinë Time, ata e meritojnë dashurinë Time.”* (Muvatta, Sha`r, 16)



Pejgamberi i Nderuar ka transmetuar këtë ngjarje, për mes së cilës del në pah se ai që e do vëllain e tij në fe për hir të Allahut, do të fitojë dashurinë e Allahut:

*“Një njeri kishte marrë rrugën për të vizituar një vëlla në fe, i cili jetonte në një fshat tjetër. Allahu Teala urdhëroi një ëngjëll që ta vëzhgojë atë në rrugën e tij. Kur njeriu arriti te ëngjëlli, ëngjëlli i tha:*

*-Ku po shkon? Ai u përgjigj:*

*-Në atë fshatin atje kam një vëlla në fe dhe po shkoj ta vizitoj.*

*Ëngjëlli e pyeti:*

*-A ke ndonjë interes material nga ai vëlla? Njeriu tha:*

*-Jo, unë po e vizitoj atë sepse e dua vetëm për hir të Allahut.*

Atëherë ëngjëlli i tha:

*-Ashtu si e do ti atë, edhe Allahu të do ty. Unë jam një i Dërguar nga Allahu për të të dhënë ty këtë përgëzim.”* (Muslim, Birr, 38; Ahmed, II, 292)



Edhe kjo ngjarje që transmeton Enes bin Malik radijallahu anhu, tregon se vëllazëria në fe e cila jetohet ashtu si duhet, të ndihmon të fitosh xhennetin:

Po qëndronim ulur bashkë me të Dërguarin e Allahut. Ai tha:

*“Tani do të vijë një njeri që është prej banorëve të xhennetit.”*

Pamë se erdhi një njeri nga Ensarët, të cilit i rridhte uji i abdestit



nga mjekrra dhe këpucët i kishte në dorën e majtë. Të nesërmen, i Dërguari i Nderuar përsëri tha të njëjtat fjalë si një ditë më parë. Ditën e tretë i Dërguari i Nderuar përsëri tha të njëjtën fjalë, dhe përsëri u shfaq i njëjti njeri me të njëjtën pamje. Kur i Dërguari i Nderuar u largua, Abdullah bin Amr e ndoqi pas Ensarin dhe i tha:

“Unë kam bërë shamatë me babain tim dhe jam betuar se nuk do të shkoj tek ai tre dit. A më pranon si mik në shtëpinë tënde për kaq dit?”

Ai tha:

“Në rregull.”

Pastaj Abdullah bin Amr radijallahu anhu tregon:

“Tri net i kaluam bashkë, por nuk e pashë atë që të ngrihej natën. Ai e përkujtonte dhe e madhëronte Allahun vetëm kur ngrihej në namazin e sabahut. Po ashtu, nuk e dëgjova të thoshte diçka tjetër, përveç se fjalë të mira. Pasi kaluan tri ditë, veprat e tij mu dukën pak, arsye për të cilën i thashë:

-O rob i Allahut! Unë nuk kam bërë ndonjë shamatë me babain tim, por e kam dëgjuar tri herë të Dërguarin e Allahut duke thënë për ty: *“Tani do të vijë një njeri që është prej banorëve të xhennetit.”* Në të tri herët ishte vetëm ti që vije. Unë desha të rrija tek ti për të të parë se çfarë veprash bëje, me qëllim që të merrja shembull. Cila është ajo punë që të ngre ty në shkallën e atij vlerësimi që të bën Dërguari i Allahut?

Njeriu tha:

-Asgjë përveç kësaj që ke parë.

Kur po ikja, ai më tha:

-Veprat e mia nuk janë asgjë tjetër përveç asaj që ke parë, por unë nuk mbaj urrejtje në zemër për asnjë mysliman (zemra ime është e mbushur me dashuri për të gjithë myslimanët) dhe nuk kam zili asnjë njeri, për çdo të mirë që Allahu ia ka dhënë.

Mbi këtë i thashë:





-Ja, kjo është ajo që të ngre ty në atë shkallë. (Ahmed, III, 166)

Ja pra zemra e një myslimani që i shikon të gjithë besimtarët me syrin e vëllait dhe që i trajton ata me mirësi...



Zubejr bin Auuam radijallahu anhu tregon një panoramë të jashtëzakonshme vëllazërie në fe, e cila ndodhi në Uhud:

“Nëna ima Safija na dha dy jelekët që kishte sjellë dhe tha:

-Unë i kam sjellë këto që t’ia bëni qefin vëllait tim Hamzasë.

I morëm jelekët dhe shkuaam të Hazreti Hamza. Pranë tij ndodhej edhe një dëshmor nga Ensarët, për të cilin nuk ishte gjetur ende një qefin për ta mbuluar. U turpëruam që ta mbështillnim Hamzanë me të dy jelekët dhe ta linim Ensarin pa qefin. Menduam që njërin nga jelekët të bëhej qefin për Hamzanë, ndërsa tjetrin ta vishte Ensariu. Hodhëm short, për shkak se njëri jelek ishte i madh dhe tjetri ishte i vogël.” (Ahmed, I, 165)

Sa panoramë e virtytshme dhe mësimdhënëse, përmes së cilës tregohet se vëllazëria në fe ia kalon lidhjeve farefisnore...



Sa bukur që e shpreh Ibn Omeri radijallahu anhu pjekurinë shpirtërore në epokën e lumturisë:

“Ne kemi parë kohëra të tilla, në të cilat asnjëri prej nesh nuk mendonte se mund ta meritonte floririn dhe argjendin më shumë se sa vëllai i tij. Tashmë jemi në një kohë të atillë, kur floririn dhe argjendin e duam më shumë se sa vëllain mysliman.” (Hejsemi, X, 285)



Një besimtar duhet të interesohet për vëllezërit e tij në fe, duhet të mendojë për ata dhe t’i ndihmojë në vështirësi. Bile ai duhet të mendojë për ta para se të mendojë për veten dhe duhet t’ua plotësojë nevojat e tyre para se të plotësojë të vetat. Njëren prej shfaqjeve më të bukura në lidhje me sa u tha, mund ta shikojmë në sjelljen e bukur



të Hazretit Davud Tai:

Një nxënës i tij, i cili i shërbente, i tha:

“Kam zier pak mish, a po urdhëroni?”. Pasi hoxha ndenji i heshur, ai e solli mishin. Atëherë Davud Tai kuddise sirruhu, duke parë mishin që iu shtrua përpara, pyeti:

“O biri im, si janë filan jetimët”

Duke dashur të tregojë se nuk e kanë gjendjen mirë, nxënësi tha i mërzhitur:

“Siç e dini o i nderuari im.”. Pasi dëgjoi këto fjalë, miku i madh i Allahut tha:

“Atëherë këtë mish dërgojua atyre!”. Nxënësi i sinqertë, i cili donte që hoxha i tij të hante nga ajo që kishte përgatitur, këmbënguli me fjalët:

“O i nderuari im, por edhe ju ka shumë kohë që nuk keni ngrënë mish!..., Duke mos pranuar një gjë të tillë, Hazreti Davud Tai tha:

“O biri im! Nëse unë e ha këtë mish pas një kohe të shkurtër do të dalë jashtë, por nëse e hanë jetimat, do të ngrihet te Arshi i Lartë për të qëndruar gjithmonë.



Ata që janë miq me Allahun, janë miq me të gjitha krijesat dhe veçanërisht me vëllezërit në fe. Vëllezërit besimtarë i shikon me shikimin e butë dhe të mëshirshëm të Allahut. Ai ka një dashuri të thellë për ta. Madje, duke e zgjeruar edhe më shumë këtë dashuri, mundohet t'i shpëtojë të gjithë njerëzit. Po ashtu Krenaria e Gjithësisë, i Nderuari ynë, i cili ishte në kulmin e miqësisë, kur e goditnin me gurë në Taif, i lutej Allahut që ta udhëzonte popullin e asaj krahine.

Habib en-Nexhhar historia e të cilit shtjellohet në faqen e dytë të Jasinit Fisnik, kur u mbyllën perdet e kësaj bote dhe u hapën perdet hyjnore, duke ndjerë mëshirë për ata që e goditën me gurë, tha:

**“Ah, sikur ta dinte populli im për çka më fali Zoti im dhe më bëri prej të nderuarve!”** (Jasin, 26-27) Kjo shfaq butësinë dhe më-



shirën që është në horizontin e zezës së besimtarit, i cili dëshironte shpëtimin e njerëzve prej të cilëve qe martirizuar.



Kur shprehte ndjenjat e tij për vëllazërinë në fe, Hazreti Ebu'l-Hasan Harakani thoshte:

“Nëse dikujt i ngulet në gisht një gjemb në fushën nga Turkistani deri në Sham, ai gjemb është ngulur në gishtin tim. Nëse dikujt i bie një gurë në këmbë, ai gur i ka rënë këmbës sime. Unë e ndjej dhimbjen e tij. Nëse ka brengë në një zemër, ajo zemër është zemra ime.”



Sehl bin Ibrahim e tregon gjithashtu një shembull të shkëlqyer të vëllazërisë në fe:

Isha mik me Ibrahim bin Ed'hemin. Një herë u sëmura rëndë. Mbi këtë, Ibrahim bin Ed'hemi e harxhoi gjithçka që kishte për shëndetin tim. Pastaj fillova të shërohem. Një herë i kërkova diçka për të ngrënë. Ai shiti gomarin e tij, sepse se nuk i kishte ngelur asgjë tjetër, dhe ma plotësoi dëshirën. Kur u shërova, më duhej të shkoja në një vend, këstu që e pyeta:

“O Ibrahim, ku është gomari?” Ibrahim bin Ed'hemi më tha:

“E shita.”

Për shkak se shëndeti nuk më lejonte të ecja, i thashë:

“Mirë po ku do të hyp unë tani?” Ai, sullatni i dijetarëve më tha:

“Do të hypësh në kurrizin tim o vëlla! Dhe më mbajti në kurriz për një rrugë të gjatë.”



Pas çlirimit të Stambollit, Hazreti Fatih Sulltan Mehmed pyeti disa priftërinj të drejtë, të cilët në kohën e Bizantëve qenë burgosur për mendimet që kishin për shtetin Osman. Ata thanë se do t'i shprehin mendimet e tyre vetëm pasi të bënin disa verifikime dhe hetime.



Sipas urdhërit që u ishte dhënë, priftërinjtë hynë e dolën në çdo vend. Herët në mëngjes shkuan te një tregtar dhe deshën të merrnin disa gjëra. Tregtari u tha:

**“O të nderuar, unë kam shitur diçka për sot. Shkoni dhe blini nga ky komshiu që nuk ka shitur asgjë!”**

Kjo panoramë e vëllazërimit në Islam i habiti ata... Me të vërtetë nuk mjafton kurrë sado që ta dëshirojmë këtë zemër të lartë, të pastër nga interesi dhe që mendon edhe për vëllanë mysliman aq sa për veten e tij.



Së fundi, Allahu Teala do që vëllazërit në fe të jenë si dy duart që lajnë njëra-tjetrën. Miqësia e vertetë për hir të Allahut, është jetimi në një zemër i dy krijesave me trup të ndarë. Jeta e atyre që përpiqen ta kryejnë përgjegjësinë vëllazërore në fe me përpikmëri dhe sakrifikim, vazhdon edhe pas jetës së përkohshme. Ata gjithmonë përkujtohen me mëshirë. Ashtu si Muhaxhirët, Ensarët dhe ata besimtarë që i kanë bërë vakëf botërat e tyre shpirtërore...

Në kushtet e sotme, butësia dhe mëshira me vëllazëri besimtare të mbushur plot me dashuri ndaj atyre që kërkojnë udhëzim, ndaj të vobektëve, ndaj jetimave dhe ndaj të paaftëve, është një nga detyrat më të rëndësishme vëllazërore që përbën shkakun për të fituar kënaqësinë hyjnore.

### **ç. Dashuria ndaj të gjitha krijesave**

Të gjithë krijesat janë krijuar për t'i shërbyer njeriut, për t'i shërbyer si shembull dhe sërish i janë dhënë amanet njeriut në këtë botë. Për këtë arsye, njeriu e ka si borxh ndërgjegjeje që t'u afrohet me dashuri të gjithë krijesave.

Bleta jeton për t'i dhënë mjaltë njeriut. Delja, gjatë gjithë jetës së saj i jep njeriut qumësht, lesh, qengja dhe mish. Macja dhe qeni përsëri janë nën urdhërin e njeriut. Edhe krijesat si gjarpëri, shumëkëmbëshi



dhe arkrepi, që janë një formë e shfaqjes së lartë të Zotit, për shkak se janë krijuar për të përkujtuar ndëshkimin e Allahut dhe detyrat e shumta që kanë në natyrë, përfshihen në mirësitë që i janë dhënë njeriut. Guri, dheu, pema, reja, mali dhe lugina janë vetëm për njeriun...

Po ashtu në ajetin fisnik thuhet:

**“Ai nënshtroi për ju gjithçka që ka në qiej dhe në tokë. Me të vërtetë në këtë ka argumente për një popull që mendon.”** (el-Xhathije, 13)

Të dhunosh krijesat që janë nën shërbimin tonë, është një poshtërsi që në fund të fundit do ta vuajmë ne. Ndërsa t’u bësh padrejtësi kafshëve, është një mëkat i rëndë, i cili do të na dalë përpara në ditën e gjykimit. Në ajetin fisnik thuhet:

**“Nuk ka asnjë gjallesë në tokë dhe as shpend që fluturojnë me krahë që të mos jenë të ndara në grupe (të ndryshme) ashtu siç u ka krijuar Zoti edhe ju. Ne nuk kemi lënë gjë mangët në libër (në leuhi’l-mahfudh). Së fundi të gjithë do të tubohen te Zoti i tyre.”** (el-En’am, 38)

Nga një aspekt tjetër, dashuria ndaj krijesave për hir të Krijuesit është një detyrë e robit.

Edhe krijesat e tjera kanë të drejtat e tyre në këtë botë dhe në mirësitë e saj. Marrja e hakut të tyre është një llogari e madhe që do te jepet në ditën e kiametit.

Sa bukur thotë poeti Firdeusi në librin e tij me titull *Shehname*:

ميازار موری که دانه کشست

که جان دارد و جان شیرین خوشست

*“Mos lëndo qoftë edhe një milingonë që tërheq një kokërr gruri, sepse edhe ajo ka shpirt. Ndërsa shpirti është i ëmbël dhe i dhimbshur.”*

I Nderuari i botrave e ka ndaluar vrasjen e kafshëve pa dobi, pa vend dhe për argëtim. Në një hadith fisnik thuhet kështu:



*“Kush vret një harabel pa vend vetëm për t’u argëtuar, në ditën e kiametit harabeli, duke u ankuar te Allahu, do t’i thotë:*

*–O Zoti im! Filan njeri më ka vrarë pa vend dhe jo për ndonjë dobi.”* (Nesai, Dahaja, 42)

### **Tabllo të virtytshme**

Abdullah bin Mesud radijallahu anhu thotë:

Në një udhëtim ishim bashkë me të Dërguarin e Allahut (s.a.v.s). I Nderuari ynë u nda nga ne për një nevojë të tij. Në ata momente pamë një zog. Ai kishte edhe dy të vegjël. Ne ia morën të vegjëlit. Zogu filloi të fluturojë lart e poshtë. Kur erdhi i Dërguari i Nderuar e pa këtë dhe tha:

*“Kush e bën të vuaj këtë të shkretë duke i marrë të vegjëlit? Shpejt jepjani të vegjëlit!”* (Ebu Davud, Xhihad 112/2675, Edeb 163-164)

Një ditë, kur i Dërguari i Allahut (s.a.v.s) po qëndronte bashkë me ashabët e tij, erdhi një burrë i cili kishte në dorë diçka të mbuluar dhe i tha të Nderuarit tonë:

“O i Dërguari i Allahut, kur të pashë Ty, erdha këtu. Kur po vija, kalova pranë një peme në të cilën kishte fole. Aty dëgjova disa zëra zogjsh të vegjël. I mora dhe i mbështolla me rrobat e mia. Në ata momente erdhi nëna e tyre dhe filloi të sillet mbi kokën time. Së fundi i zbulova të vegjëlit. Nëna e tyre erdhi dhe u ul mbi ta. Unë i mbulova përsëri. Tani ja ku janë këtu.”

Krenaria e Gjithësisë, i Nderuari ynë e urdhëroi:

*“Menjëherë lëri ata!”* Ai i la. Në vend që të ikte, zogu nënë u ul te zogjtë dhe nuk i la ata. Në lidhje me këtë, i Dërguari i Allahut (s.a.v.s) i pyeti ashabët:

“A po habiteni ndaj mëshirës së kësaj nëne që ka për të vegjëlit e saj, apo jo?” Ata thanë:

“Po o i Dërguari i Allahut!” Pejgamberi tha:



*“Betohem në Allahun që më ka dërguar me të vërtetën, se mëshira e Allahut që ka për robërit e tij është më e madhe se mëshira që ka kjo nënë për të vegjëlit e saj. Shko dhe lëri ata në vendin ku i ke marrë. Le të rrinë bashkë me nënën e tyre!”* Sahabiu i dërgoi ata menjëherë në vendin e tyre. (Ebu Davud, Xhenaiz, 1/3089)



Një herë, nëna jonë Hazreti Aishe kishte hypur në një deve zemë-rake. Ajo filloi ta çojë para e mbrapa në një mënyrë të ashpër, për ta qetësuar atë. I Dërguari i Allahut (s.a.v.s) i tha Hazretit Aishe:

*“Sillu butë ndaj kafshës, sepse kudo që të ndodhet butësia e zburkuron atë vend. Çdo sjellje në të cilën nuk ka butësi, është e keqe.”* (Muslim, Birr, 78, 79)



Sa bukur e tregon i Dërguari i Allahut alejhissalatu uesselam përmes këtij shembulli, se nganjëherë kënaqësia e Allahut mund të jetë edhe në një gjë shumë të vogël:

*“Një herë, një njeri që po udhëtonte ishte shumë i etur. Gjeti një pus, hyri në të, piu ujë dhe doli jashtë. Por çfarë të shikojë!; një qen që i kishte dalë gjuha një pullëmbë dhe nga etja po lëpinte tokën e lagur. Njeriu në vetvete bëri një llogari ndërgjegjeje dhe tha:*

*-Ky qen është i etur ashtu siç isha unë! menjëherë hyri në pus, e mbushi këpucën e tij me ujë, ia mbylli grykën, doli jashtë dhe i dha ujë qenit. Allahu u kënaq nga sjellja e këtij njeriu dhe e fali.”*

Sahabët thanë:

*“O i Dërguari i Allahut! A kemi sevape edhe për kafshët?”. I Dërguari i Nderuar tha:*

*“Për çdo gjallesë ka sevape.”* (Buhari, Shurb, 9; Muslim, Selam, 153)



I Dërguari i Allahut (s.a.v.s) kishte shkuar te kopështi i një Ensariu dhe aty kishte parë një deve. Deveja, me të parë Pejgamberin, filloi të



rënkonte dhe të lotonte. I Nderuari ynë shkoi te deveja dhe e ledhatoi me butësi pas veshëve. Deveja u qetësua. Pastaj Hazreti Pejgamber pyeti:

*“E kujt është kjo deve?”* Një djalosh nga Medineja u afrua dhe tha:

*“Kjo deve është e imja o i Dërguari i Allahut!”*. Krenaria e Gjithësisë, i Nderuari ynë, tha:

*“A nuk ke frikë nga Allahu për këtë kafshë që të ka dhënë? Ajo po më ankohet se e ke lënë të uritur dhe se e ke lodhur shumë.”* (Ebu Davud, Xhihad, 44/2549)



I Nderuari ynë alejhissalatu uesselam i ka qortuar kështu edhe ata që i mundojnë kafshët, duke humbur në muhabete të pavend kur ndërkohë që udhëtojnë hipur mbi ta:

*“Kini kujdes, mos e përdorni kurrizin e kafshëve si minber, sepse Allahu jua ka nënshtruar ata juve që t’u dërgojnë në vende ku e keni të vështirë të shkoni në këmbë. Edhe toka është e juaja (e ka bërë vendpushim për ju), kështu që nevojat tuaja i kryeni mbi tokë (domethënë duke zbritur nga kurrizi i kafshëve).”* (Ebu Davud, Xhihad, 55/2567)



Një ditë, i Dërguari ynë i Nderuar sallallahu alejhi ue selem, në orët e para të mëngjesit doli jashtë ngaqë kishte nevojë. Në derën e xhamisë ai pa një deve të ulur. Pejgamberi, i Nderuari ynë, në orët e fundit të ditës kaloi përsëri andej: deveja po qëndronte në të njëjtin pozicion. I dërguari i Nderuar (s.a.v.s) pyeti:

*“Ku është i zoti i kësaj deveje?”*

E kërkuan të zotin e devesë, por nuk e gjetën. I Dërguari i Allahut, i cili kuptohej se ishte mërzitur shumë për shkak se deveja ishte lënë e uritur dhe e etur, tha:

*“Kini frikë Allahun dhe mos u bëni padrejtësi këtyre kafshëve të shkret, a të cilat nuk mund ta shprehin hallin e tyre. Hipuni atyre kur të*





*jenë të forta, të fuqishme dhe të shëndetshme.*” (Ahmed, IV, 181)



Sehl bin Amr radijallahu anhu thotë:

I Dërguari i Allahut (s.a.v.s), kur po kalonte pranë një deveje së cilës i qe ngjitur barku me shpinën (i kishin dalë brinjët), tha:

*“Kini frikë Allahun për këto kafshë që nuk flasin! Hipuni, i prisni dhe i hani kur të jenë të shëndetshme!”* (Ebu Davud, Xhihad, 44/2548)



Pejgamberi, i Nderuari ynë pa një njeri që po therrte delen. Njeriu, pasi e shtriu në tokë delen që do të therrte, filloi të mprehë thikën. Kundrejt kësaj sjellje të pamëshirshme dhe mizore Pejgamberi ynë i Nderuar e qortoi atë:

*“A dëshiron ta vrasesh disa herë kafshën? A nuk do të ishte më mirë sikur ta mprehje thikën para se ta shtrije atë në tokë?”* (Hakim, IV, 275, 260/ 7570)



Pejgamberi (s.a.v.s) kaloi pranë një gomari që kishte një vulë në fytyrë, të cilën ia kishin bërë me hekur të nxehtë. Mbi këtë tha:

*“Allahu e mallkoftë atë që i ka bërë kësaj kafshe në fytyrë këtë vulë me hekur të nxehtë!”* (Muslim, Libas, 107)



Një herë, i Dërguari i Allahut (s.a.v.s) doli nga Medineja me ihram për të shkuar në Mekke. Arriti në Usaje. Ky ishte një vend mes Ruvejses dhe Arxhit. Aty në hije pa një sorkadhe të struktur, që po flinte. I Nderuari i botërave urdhëroi njërin nga ashabët që të priste pranë sorkadhes derisa të kalonin të gjithë, për rë mos lejuar ndokënd që ta ngacmojë dhe ta shqetësojë atë. (Muvatta, Haxh, 79, Nesai, Haxh, 78)



Kur po shkonin në Mekkë për ta çliruar atë, Pejgamberi dhe ashabët shfaqën edhe një tablo tjetër të mrekullueshme në lidhje me trajtimin e kafshëve. Kjo sjellje është gjithashtu një shfaqje e kujdesit ndaj krijesave, parë me syrin e Krijuesit. Rrugës duke shkuar nga Arxh drejt Talubas me ushtrinë e tij të mrekullueshme prej dhjetë mijë ushtarësh, i Nderuari i botërave pa një qen që i kishte mbledhur rreth vetes dhe po u jepte gji të vegjëlve të tij. Ai thirri menjëherë ashabin Xhejl bin Suraka dhe vuri të ruante qenin dhe të vegjëlit e tij. Ai e porositi atë të kujdesej që qeni nënë dhe të vegjëlit e saj të mos trembeshin nga ushtria Islame. (Vakidi, II, 804)



Enes bin Maliku radijallahu anhu, i cili ishte rritur nën edukimin e të Dërguarit të Allahut sallallahu alejhi ue selem, tregon një tjetër shembull ku del në pah përkujdesja ndaj të drejtave të kafshëve:

“Kur buanim diku, nuk i bënim tesbih (namaz nafile) Allahut dhe nuk fillonim ta adhuronim, pa i shkarkuar dhe pa i qetësuar më parë devetë tona.” (Ebu Davud, Xhihad, 44/2551)

Dijetarët myslimanë kanë thënë se është mustehab që kur një udhëtar të buajë, t’i japë kafshës së tij ushqim para se të hajë vetë. (Ebu Davud, Sunen, III, 51)

Një ditë, Ibn Omeri radijallahu anhuma takoi disa të rinj Kurejshit, të cilët po i gjuanin një zog me shigjetë. Për çdo shigjetë që nuk e kapte zogun, i jepnin para të zotit të tij. Të rinjtë, kur panë se erdhi Ibn Omeri, u larguan. Ibn Omeri u thirri nga pas:

“Kush e ka bërë këtë? Allahu e mallkoftë! Po ashtu edhe i Dërguari i Allahut (s.a.v.s) i mallkonte ata që lidhnin një kafshë dhe i gjuanin me shigjeta.” (Buhari, Zebaih, 25; Muslim, Sajd, 59)



Hazreti Bajezid Bistami ishte aq i ndjeshëm për shkak të dashurisë që kishte për Allahun, sa që për hir të dashurisë ndaj Krijuesit, e përjetonte në zemër vuajtjen e çdo krijese dhe ndihej keq.



Një ditë, ky mik i Allahut pa një gomar që i rridhte gjak nga kurri për shkak se e kishin rrahur. Pikërisht në atë çast, edhe Hazretit Bajezid Bistamit filloi t'i rridhte gjak nga pulpat e këmbëve.

Përsëri, gjatë një udhëtimi, pasi kish pushuar pak nën hijen e një peme, ky mik i madh i Allahut u përudh sërish. Në rrugë pa disa milingona që lëviznin mbi trastat e tij, të cilat i kishte parë në edhe vendin ku kishte pushuar. Ai u kthye pas për të mos i lënë në ndonjë vend tjetër dhe për të mos i lënë në kurbet. Erdhi në vendin ku kishte pushuar dhe i la milingonat në vendin e tyre.



Hazreti Shah Nakshibendi, i cili ishte mik i madh i Allahut, tregon një ngjarje të pashoqe, e cila mund të llogaritet si kulmi i trajtimit të mirë të kafshëve:

Në ditët e para të kërkimit u takova me Hazretin Emir Kulal, i cili ishte nga robërit e dashur të Allahut. Në ato çaste ndjehesha i emocionuar. Ai më tha:

“Mundohu të fitosh zemrat e njerëzve, shërbeju të paaftëve! Mbroji të dobëtit dhe zemërthyerit! Ata janë njerëz që nuk kanë asnjë të ardhur nga populli. Edhe pse janë kështu të lënduar, jetojnë me modesti dhe qetësi shpirtërore të plotë. Kërkoji dhe gjeji ata!”

Unë e mbajta fjalën e këtij njeriu të lartë. U mundova shumë në atë rrugë që më tregoi. Më pas, ky mik i Allahut më urdhëroi që të kujdesem për kafshët. Më rekomandoi që t'ua lidhja plagët, t'i pastroja i vetëm, dhe këto t'i bëja me nijet të mirë dhe sinqeritet.

Edhe këtë shërbim e bëra. E kreu ashtu si më rekomandoi. Në këtë kohë, personaliteti im arriti në një gjendje të atillë, sa që kur shikoja një qen që ecte në rrugë, ndaloja në vend dhe prisja që ai të kalonte. Nuk hidhja asnjë hap para tij.

Pastaj ai më urdhëroi që të kujdesesha për qentë, me dashuri dhe respekt, dhe përmes këtyre shërbimeve të mundohesha të fitoja mirësinë e Allahut. Ai tha:

“Do të ndjesh një kënaqësi të madhe kur t'i shërbesh ndonjërit



prej qenve.”

Këtë urdhër të tij e supozova si pasuri. U mundova shumë. E zbulova kuptimin e shenjës së tij, e prita përgëzimin që më dha dhe shkova pranë njërit prej qenve. Në mua lindi një ndjenjë e madhe. Ndalova përpara tij dhe fillova të qaj. Ai qen ishte pothuajse si Kitmiri që kishte marrë frymëzim nga Ashabu'l-Kehf...

Kur unë po qaja, ai u shtri përdhe dhe i ngriti këmbët nga qielli. Pastaj nxorri disa zëra, qau dhe filloi të rënkojë. Edhe unë hapa duart dhe me modesti e me zemër të lënduar thashë:

“Amin!” Ai pushoi dhe i uli këmbët.

Në një prej atyre ditëve dola përsëri nga shtëpia dhe shkova në disa vende. Në rrugë pashë një kafshë që e ndërronte ngjyrën sipas ngjyrës së diellit. Kishte humbur në një ndjenjë shpirtërore. Në atë moment u emocionova shumë. U ula përpara saj me një edukatë të plotë dhe respekt. I ngrita duart e mia. Në ato çaste kafsha e bekuar ndryshonte nga një gjendje në tjetër në botën ku kishte humbur dhe duke u shtrirë mbi kurriz, e ktheu fytyrën e saj nga qielli. Atëherë unë thashë:

“Amin!”<sup>31</sup>



Një ditë, Kanuni Sulltan Sulejman, nëpërmjet poezisë së mëposhtme kërkoi fetva nga Shejhulislam Ebu's-Suud Efendi për vrasjen e milingonave, të cilat thanin dardhat që ishin në kopështin e sarajit.

*Nëse milingona e dëmton kopështin;*

*A e dëmton kur t'ia prish bukurinë?*

Edhe Ebu's-Suud Efendi, po nëpërmjet një poezie dha këtë përgjigje mbi kërkimin e fetvas nga Padishahu:

*Kur nesër të dalë përpara Allahut;*

*Milingona e merr hakun prej Sulejmanit!*

31. Abdulmexhid Hani, el-Hadaiku'l-Verdiyye, përkth. Abdulkadir Akçiçek, Stamboll 1986, fq. 545-547.



Kanuni Sulltan Sulejmani, i cili kishte marrë një edukatë shpirtërore të mrekullueshme, aq sa shmangej edhe nga mundësia për të lënduar qoftë një milingonë, ishte një komandant i aftë, një burrë shteti shumë i mençur, organizator, dijetar dhe një personalitet i edukuar.



Kur vdiq Pertevnijal Valide Sulltani, që kishte ndërtuar Xhaminë Valide në Aksaraj në Stamboll, një njeri i devotshëm e pa në ëndërr në një vend të bukur dhe e pyeti:

“Mos vallë Allahu të ka ngritur në këtë vend të lartë, për shkak të faltores që ke ndërtuar të?”

Pertevnijal Valide Sulltani tha:

“Jo.”

I habitur, njeriu i devotshëm e pyeti:

“Atëherë me cilën vepër e ke fituar këtë gradë?”

Valide Sulltan dha këtë përgjigje mësimdhënëse:

“Ishte një ditë me shi. Po shkoja të vizitoja Xhaminë e Ejub Sulltanit. Në rrëkenë e ujit që mblidhej në qoshe të kalldrëmit, pashë një kotele që po mundohej të shpëtonte. E ndalova pajtonin dhe i thashë motrës<sup>32</sup> që kisha pranë:

-Shko dhe merre atë kotele, përndryshe do të mbytet e shkreta!..

Motra më tha:

-Aman Sulltanja ime! Na bëhen rrobat pis. Kështu, ajo nuk pranoi ta sillte kotelen.

Unë, për të mos e lënduar atë, zbrita nga pajtoni, hyra në baltë dhe e shpëtova kotelen. Kotelja po dridhej. Më erdhi keq, e mora në gji dhe e ngroha mirë. Pa kaluar shumë, ajo erdhi në vete.

Allahu Teala më dha këtë gradë të lartë për arsye se i shërbeva dhe e mëshirova atë kotele.”

32. Te Valide Sulltani punonin disa gra nga Sudani. Në saraj ato quheshin “motra”. Osmanët i merrnin ata për shkak se sudanezet ishin të pastra dhe të ndershme.



Ja, ka raste kur një e mirë që duket si e lehtë dhe e pavlefshme, mund ta tërheqë mëshirën e Allahut aq sa të bëhet shkak për nderime dhe mirësi të mëdha. Për këtë arsye, njeriu nuk duhet të mendojë se nuk ka nevojë për të mirat e vogla që shumë herë i pandeh si të parëndësishme, sepse ai ka nevojë për ndihmën shpirtërore të çdo mirësie që ka bërë, qoftë e madhe apo e vogël, edhe në këtë botë edhe në ahiret...



Baba Musa Efendi tregon një ngjarje që i ka ndodhur në çështjen për të qënë mik me krijesat:

“Afërsisht dyzet vjet më parë, patëm marrë me qira në Medinetu’l-Munevvera një shtëpi të përbashkët me profesorin e nderuar Sami Efendi kuddise sirruhu. Sipas kushteve të kohës, shtëpitë e atëherëshme ishin me qerpiç. Kur erdhi në dhomën që ia kishim përgatitur për të pushuar, pamë në qoshe një gjarpër të mbledhur, gjë që na frikësoi shumë të gjithëve. Ndërsa profesori tha me qetësi:

-Lëreni në hallin e vet këtë krijesë të Allahut dhe mos e prekni. Pas një farë kohe, gjarpëri i shkretë nuk u duk më.



Përsëri Musa Efendi -rahmetullahi alejhi-, tregon:

“Ishte koha e haxhit. Ishim në shtëpinë e Abdusettar Efendit, i cili ishte nga Turkmenistani, në lagjen Exhjad afër Bejtullahut në Mekketu’l-Mekerrame, bashkë me profesorin e nderuar Hazretin Sami Efendi dhe bijt e tij. Dhoma e Hazretit Efendi ishte përballë rrugës, ndërsa dhoma jonë ishte mbrenda nga qyteti.

Në kohën e drekës, ai erdhi te dhoma jonë dhe tha:

-Me sa duket një njeri aty jashtë ka nevojë për ushqim!

Kur i përgatita menjëherë ushqimet për t’ia dhënë, dola te dera por nuk pashë njeri. Duke menduar se ai kishte ikur, nuk prita gjatë dhe u ktheva persëri brenda. S’kishin kaluar as tetë apo dhjetë minuta, kur përsëri Hazreti Efendi erdhi te dera dhe tha.



-Nevojtar i erdhi përsëri dhe po shikon brenda!

Përsëri i mora ushqimet dhe kur dola në derë pashë një qen të cilit i kishte dalë gjuha jashtë. Po më shikonte. Menjëherë ia vura ushqimin përpara. Ai duhej të kish qenë shumë i uritur, sepse e hëngri të tërë ushqimin.”

Ja, kjo është edukata dhe modestia e të mëdhenjve. Hazreti Sami Efendi nuk tregoi se ishte fjala për një qen, por kishte përdorur shprehjen “person”. Madje për shumë kohë, sa herë fliste për kafshët, në vend që të thoshte “krijesë”, përdorte shprehjen “robi i Allahut”, sepse bukuria morale që tregohet ndaj krijesave për hir të Krijuesit, është bukuria e një zemre që është e lidhur me shpirt me Atë, domethënë bukuria e zemrës së shëndoshë që në të vërtetë i paraqitet Krijuesit.



Feja jonë e lartë Islame na sugjeron që në çdo rast të sillemi mirë ndaj të gjithë krijesave qofshin me shpirt apo pa shpirt. Për shkak të këtij sistemi, i ka ndaluar disa gjëra si, prerjen e pemës, prerjen e barit, gjuetinë, madje edhe t'i tregosh gjuetarit gjahun kur je me ihram, në vendin e haremit të Mekkes, gjëra për të cilat janë përcaktuar ndëshkime të ndryshme për ata që nuk i zbatojnë. Kështu, për besimtarët është kërkuar që të vijnë në një gjendje dhe vendosmëri e cila, në kuptimin e saj të plotë shpreh “padëmshmëri”, si mosbërja e mëkatit dhe mosdëmtimi i asnjë bime apo gjallese në vendin e haremit.

Me ushtrimet që ka bërë në kohën e haxhit, njeriu duhet të fitojë një ndjeshmëri të atillë sa të arrijë kulmin në mënjanimin e imoralitetit dhe të ngatërresave. Ai nuk duhet të këpusë qoftë edhe një fije bari, duhet të ruhet nga gjërat e papëlqyeshme kur burrat dhe gratë bëjnë tavafin bashkë me të, sajnin dhe kur të ndalojnë, duhet të largohet nga e keqja dhe ngatërresat duke parë vazhdimisht te gishtat e këmbës së tij...

Përpikmëria e Islamit nuk është vetëm për vendin e haremit dhe ihramin. I Dërguari i Allahut (s.a.v.s) ka thënë:

*“Kush pret një pemë sidre, Allahu ia fut kokën në xhehennem.”*  
(Ebu Davud, Edeb, 158-159/5239)



Kur Ebu Davud është pyetur për këtë hadith, ka thënë:

“Ky hadith është i përmbledhur, kuptimi i tij është ky: Atij që pa asnjë të drejtë pret një pemë sidre, nga hija e së cilës përfitojnë udhëtarët dhe kafshët, Allahu do t’ia fusë kokën në xhehennem.”



Sa mësimdhënëse është kjo ngjarje, e cila mund të tregohet si shembull për lidhjen dhe dashurinë që ka Islami për njeriun, për kafshët, e madje edhe për bimët:

Ebu’d-Derda radijallahu anhu, i cili ishte nga ashabët kryesorë, po mbillte pemë në Sham. Dikush iu afrua dhe i habitur tha:

“Ti po merresh me mbjellje pemësh, ndërkohë që je miku i Pejgamberit?!” . Hazreti Ebu’d-Derda i dha këtë përgjigje:

“Ndalo, mos më gjyko kaq shpejt! Unë e kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut (s.a.v.s) kur tha:

*Ç’ pemë, nga frutat e së cilës ha ndonjë njeri apo ndonjë nga krijesat e Allahut, është sadaka për atë që e ka mbjellë këtë pemë.”*  
(Ahmed, VI, 444)

Sigurisht, që edhe e kundërta e kësaj, domethënë të dëmtosh bimët apo gjallesat e tjera, është një sjellje që bëhet shkak për mëkat. Një gjë të tillë gjyshërit tanë e kanë shprehur në mënyrë të qartë, me fjalët: **“Ai që pret një bimë, pret një kokë.”**



Pejgamberi ynë i nderuar i ka këshilluar njerëzit që të mbjellin pemë dhe ta gjelbërojnë mjedisin. Ai u ka dhënë shembullin e vet ashabëve të tij në këtë çështje. Ibn Abbas radijallahu anhu transmeton:

Kur i Dërguari i Nderuar (s.a.v.s) po kalonte pranë dy varreve, tha për ata të dy që qenë të varrosur aty:

*“Që të dy po ndëshkohen, por jo për shkak të ndonjë mëkati të madh (sipas atyre). Njëri po ndëshkohet për shkak se merrej me thashetheme, ndërsa i dyti për shkak se nuk ruhej siç duhet kur urinon-*





te.” Pastaj kërkoi një degë hurme të njomë. E ndau atë më dysh dhe ua mbolli në krye të varrit. Pastaj tha:

*“Shpresoj se do të kenë ndëshkim të lehtë derisa të thahen këto degë.”* (Muslim, Taharet, 111)

Sepse edhe një gjethe e njomë bën dhikër në një lloj mënyre të cilën mendja jonë nuk mund ta konceptojë. Në ajetin fisnik thuhet:

**“Madhërim të merituar i shprehin Atij shtatë qiejt e toka dhe gjithçka ka në to, nuk ka asgjë që nuk e madhëron (nuk i bën tesbih), duke i shprehur falënderim Atij, por ju nuk e kuptoni madhërimin e tyre. Ai është i butë dhe falës.”** (el-Isra, 44)



Nganjëherë kënaqësia e Allahut është e fshehur në diçka të madhe, nganjëherë në diçka normale dhe nganjëherë në diçka të vogël. Edhe për zemërimin e tij është e njëjta gjë. Atëherë të gjitha krijesave të Allahut duhet tu afrohem me butësi, mëshirë, dashuri dhe tu shërbejmë kur është e nevojshme.

Islami urdhëron që ndaj të gjithë krijesave, njerëzve, kafshëve bile edhe ndaj bimëve, të sillemi me mëshirë dhe me dashuri. Njeriu ka detyrime ndaj secilës prej tyre. Ja pra, bukuria e Islamit është e fshehur në konceptimin e dashurisë dhe mëshirës ndaj gjithë botës që mban të gjitha gjallesat. Një mysliman është si një lum që rrjedh me bërçet gjatë rrugëve të gjata, duke u bërë shërbim shumë gjallesave, kafshëve, pemëve, trëndafilave, kallinjve dhe bylbylave, dhe së fundi vendi ku do të arrijë është vetëm deti i pafund dhe takimi me Zotin.

Siç është e pamundur për diellin që të mos ngrohë, edhe për shpirtrat e mëdhenj është e pamundur të mos kenë mëshirë për krijesat. Mëshira është një xhevahir hyjnor, i cili është shpërndarë në të gjithë botën. Burimi i asaj dashurie dhe butësie është Allahu. Ata që janë të privuar nga mëshira, kanë humbur thesarin më të madh, domethënë çelësin e derës së lumturisë.

Miq të Zotit që kanë arritur burimin e dashurisë të Allahut dhe të i Dërguari i Tij, mbeten gjithmonë miq të të gjithë krijesave. Ata përkuj-



tohen gjithmonë dhe jeta e tyre vazhdon edhe pas vdekjes. Sa bukur e shpreh këtë miku i Zotit, Hazreti Junus Emre:

*Vdiq Junusi dhe po japin salavate  
Ai që vdiq ishte kafshë, sepse të dashurit nuk vdesin...*

## 2. Frika dhe shpresa ndaj Allahut

Një nga cilësitë dalluese të besimtarëve që kanë arritur përsosmërinë në besim, është frika ndaj Allahut, e cila krijohet nga madhërimi dhe dashuria që ata kanë. Në të vërtetë, frika ndaj Allahut është shqetësim dhe frikë për humbjen e kënaqësisë dhe të dashurisë së pafundme që Zoti ka për ne. Për këtë arsye, sa herë që përmendet Allahu, zemrat e besimtarëve që kanë arritur përsosmërinë në besim dridhen me një frikë të madhe, në një vigjilencë të madhështore. Kjo gjendje sjell me vete edhe gjendjet e larta si, edukata, sinqeriteti dhe devotshmëria që besimtarët duhet të kenë ndaj Allahut. Allahu thotë:

**“Besimtarë të vërtetë janë vetëm ata të cilëve, kur përmendet Allahu, u rrënoqethen zemrat, kur lexohen ajetet e Tij, u shtohet besimi dhe që janë të mbështetur vetëm te Zoti i tyre.”** (el-Enfal, 2)

**“...(O Pejgamber!) Përgëzoji të devotshmit dhe të sinqerit të cilëve, kur përmendet Allahu, u rrënoqethen zemrat...”** (el-Haxh, 34-35)

Kur dikujt i shtohet dija dhe dashuria për Allahun, i shtohet edhe frika ndaj Tij. Po ashtu, Krenaria e Gjithësisë (s.a.v.s) ka thënë:

**“Unë e besoj Allahun dhe e kam frikë Atë më shumë se ju.”**  
(Buhari, Edeb, 72; Muslim, Fedail, 127)

Një ditë, të Dërguarin e Allahut (s.a.v.s) e pyetën:

“Cili zë dhe cili kiraat (lexim) është më i bukur për Kur’anin?”. I Dërguari i Allahut u përgjigj:

**“Është zëri dhe kiraati i dikujt që kur e dëgjon duke lexuar, ndjen frikë nga Allahu.”** (Darimi, Fedailu'l-Kur’an, 34)

Ata që kanë frikë Allahun, nuk kanë frikë nga asnjë gjë tjetër.



Frika ndaj Allahut është dritë lumturie për zemrat.

Besimtarët që kanë frikë nga Zoti, janë ata me të cilët Allahu është i kënaqur, e të cilët janë të kënaqur me Allahun.<sup>33</sup> Allahu u premton dy xhennete robërve të tillë të Tij.<sup>34</sup>

I Dërguari i Allahut (s.a.v.s) thotë:

*“Çdo besimtar i që nxjerr lot qoftë edhe sa koka e mizës prej frikës së Allahut, dhe ai lot i rrjedh nga faqet, Allahu ia bën haram zjarrin (e përhershëm)!”* (Ibn Maxhe, Zuhd, 19)

*“Ai që qan për shkak të frikës që ka prej Allahut, nuk do të hyjë në xhennem derisa të kthehet qumështi te gjiri. Pluhuri që ngrihet në rrugë të Allahut, kurrë nuk bashkohet me tymin e xhennemit.”* (Tirmidhi, Zuhd, 8/2311)

*“Nuk ka asgjë më të dashur te Allahu, se sa dy pika dhe dy gjurmë. Këta dy pika janë lotët që rrjedhin për shkak të frikës ndaj Allahut dhe pikat e gjakut janë që derdhen në rrugë të Allahut. Ndërsa dy gjurmët janë gjurmët që lihen në rrugë të Allahut (në xhihad) dhe gjurmët që lihen kur kryhet ndonjë vepër të cilën Allahu e ka bërë farz.”* (Tirmidhi, Fedailu'l-Xhihad, 26/1669)

Lotët që derdhen besimtarët për shkak të frikës që kanë ndaj Allahut, janë zbulurimi i netëve të përkohshme, kandilat e errësirave të varrit dhe vesat e kopshteve të xhennetit. Allahu na ruajtë nga zemrat që nuk janë të ndjeshme kundrejt urtësisë dhe fshehtësisë së Kur'anit Fisnik, dhe nga syri që nuk loton prej frikës ndaj Allahut.

Allahu Teala, duke i qortuar ata të cilët janë zemërgur dhe të privuar nga frika ndaj Tij, thotë:

**“...Pas (fakteve të qarta) zemrat tuaja u ngurtësuan, bile u bënë edhe më të forta, sepse ka nga gurët prej të cilëve gufojnë në lumenj e ka disa prej tyre që çahen dhe prej tyre buron ujë, madje ka prej tyre që nga frika ndaj Zotit rrokullisen tatëpjetë (nga maja e malit). Allahu nuk është i pakujdesëm ndaj asaj që veproni ju.”** (el-Bekara, 74)

33. el-Bejjine, 8.

34. er-Rahman, 46.



I Dashuri ynë (s.a.v.s) i është përgjëruar Allahut nga kjo gjendje, me këtë lutje:

*“O Allah! Kërkoj mbrojtje prej teje nga dija e padobishme, nga zemra që nuk ka frikë, nga vetja e pangopur dhe nga lutja që nuk pranohet.”* (Muslim, Dhikr, 73)

Ai që nuk ka frikë nga Allahu, është në një gradë më poshtë se sa kafshët dhe krijesat e pashpirta. Po ashtu gjyshërit tanë kanë thënë: “Ki frikë nga ai që nuk ka frika nga Allahu!” Me të vërtetë e ardhmja e tyre është një e ardhme e frikshme, sepse ngurtësia që kanë në zemra, errësira e përhumbjes dhe mosndjeshmëria e tyre nuk gjendet as te krijesat e pashpirta.

Po ashtu, sipas shumë deklarimeve hyjnore, edhe krijesat që pandojnë se janë të pashpirta ndryshojnë nga një gjendje në një gjendje tjetër, për shkak të frikës që kanë nga Allahu. Kjo e vërtetë shprehet kështu në ajetin fisnik:

**“Sikur Ne ta zbritnim këtë Kur’an mbi ndonjë mal, do ta shihje atë të strukur e të çarë prej frikës nga Allahu. Këto janë shembuj që ua sjellim njerëzve që ata të mendojnë.”** (el-Hashr, 21)<sup>35</sup>

Frika që besimtari ka në zemër se mos mbetet i privuar nga kënaqësia dhe dashuria e Allahut e frika se mos pëson zemërimin e Tij, duhet të gjendet gjithmonë bashkë me shpresën se mund të fitojë mëshirën e pafundme të Tij. Domethënë, zemra e besimtarit duhet të rrënoqethet në emocionin e adhurimit ndërmjet dy poleve të frikës dhe shpresës. Ky ekuilibër që gjendet ndërmjet ndjenjave të frikës dhe shpresës, është bërë shprehje në këtë mënyrë: **“bejne’l-haafi ue’r-raxha”**. Besimtari gjithmonë duhet të jetë në gjendje lutjeje, mosqë-

35. Qëllimi i shembullit që jepet në këtë ajet, është sqarimi i rëndësisë së përmbytjes së Kur’anit dhe se çfarë përgjegjësie të madhe ka njeriu. Këtu mund të nxjerrim edhe këtë kuptim: Në qoftë se një mali do t’i ishte dhënë ndërgjegje siç i është dhënë njeriut, ai do të përulej me frikë e adhurim të madh para madhërisë, fuqisë dhe sundimit të Tij absolut në gjithësi, dhe do ta bënte këtë si rezultat i ndjeshmërisë për të njohur përgjegjësinë dhe cilësitë e Allahut. Jo vetëm kaq, por ai do ta copëtohej për të adhuruar Allahun. Ndërsa njerëzit në përgjithësi rezistojnë për të mos e ndërë peshën që kanë mbi supet dhe e kalojnë jetën e tyre në përhumbje. Njeriu, për të marrë pjesë nga dashuria dhe frika ndaj Allahut, duhet ta largojë nga mëkati botën e tij të brendëshme dhe ta stolisë me jetë të devotshme.



nieje dhe përgjërimi, dhe këtë harmoni shpirtërore duhet ta ruajë derisa te vdesë. Në ajetet fisnike thuhet:

“...Luteni Allahun duke pasur frikë (dënimin) dhe duke shpresuar (mëshirën). S’ka dyshim se mëshira e Allahut është pranë të mirëve.” (el-A’raf, 56)

“...Shpresojnë mëshirën e Tij dhe kanë frikë nga ndëshkimi i Tij, sepse ndëshkimi i Zotit është një ndëshkim prej të cilit duhet të kihet frikë.” (el-Isra, 57)

Pejgamberi ynë i nderuar (s.a.v.s) ka thënë:

“*Sikur besimtari ta dijë ashpërsinë dhe mënyrën e ndëshkimit të Allahut, nuk do të shpresonte për xhennet. Edhe mosbesimtari, sikur ta konceptonte plotësisht mëshirën e Allahut, nuk do ta priste kurrë shpresën nga xhenneti i Tij.*” (Muslim, Teube, 23)

“*Xhenneti është më afër jush se sa lidhësa e këpucës suaj. Edhe xhehennemi po ashtu.*” (Buhari, Rikak, 29)

Nga ky aspekt, rruga e lumturisë dhe e paqes së përhershme është në mbrojtjen e barabartë të frikës dhe shpresës që ndjehen në zemër ndaj Allahut, sepse ai që dashuron jeton gjithmonë me frikën se mos e lëndon atë që dashuron dhe me shqetësimin se mund ta humbasë dashurinë e tij. Edhe besimtari duhet të ketë frikë nga humbja e dashurisë së Allahut, por duhet të shpresojë edhe në mëshirën e Tij.

### ***Tabllo të virtytshme dhe mësimdhënëse***

Hazreti Enes radijallahu anhu tregon:

I Dërguari i Allahut (s.a.v.s) e bënte shumë këtë lutje:

يَا مُقَلَّبَ الْقُلُوبِ ثَبِّتْ قَلْبِي عَلَى دِينِكَ

*O Zoti im që i ndryshon zemrat! Forcoje zemrën time në fenë Tënde!*

Një ditë i thashë:



-O i Dërguari i Allahut! Ne të kemi besuar ty dhe asaj që ke sjellë. Ti a ke frikë për ne?” Mbi këtë mu përgjigj:

*“Po! Zemrat janë ndërmjet dy gishtave të Rahmanit. Ai i kthen ata si të dojë.”* (Tirmidhi, Kader, 7/2140)



Hazreti Aishe radijallahu anha thotë:

Kur zbritën këto ajete:

**“Ata të cilët japin (lëmoshë dhe zekat) nga ajo që u është dhënë, zemrat e tyre u dridhen sepse e dinë se do të kthehen me Zotin e tyre. Ata nxitojnë drejt të mirave dhe garojnë në këtë.”** (el-Mu'minun, 60-61), e pyeta të Dërguarin e Allahut:

**“Ata që janë përmendur në ajet, a janë ata të cilët bëjnë mëkate si zina, vjedhje dhe pijnë alkol?”** Ai më tha:

*“Jo o vajza e Siddikut! Ata që tregohen në ajet janë ata të cilët frikësohen nëse u janë pranuar adhurimet, në një kohë kur e falin namazin, kur agjërojnë dhe kur japin lëmoshë.”* (Tirmidhi, Tefsir, 23/3175; Ibn Maxhe, Zuhd, 20)

Myslimani nuk duhet t'u besojë punëve dhe të mirave që ka bërë. Nuk ka asnjë rrugë tjetër përveçse të strehohet te mëshira e Allahut.



Suhejl bin Amr ishte ligjëruesi i Kurejshëve. Ai fliste kundra Islamit në një kohë kur fjala ndikonte shumë. Ky person u kap rob në luftën e Bedrit. Hazreti Omer tha:

“O i Dërguari i Allahut! Më jep leje që t'ia shkul dhëmbët e para Suhejlit ashtu që gjuha ti dalë jashtë! Ashtu që të mos ketë mundësi të ligjërojë kundër Teje asnjëherë dhe në asnjë vend?!”

I Dërguari i Allahut (s.a.v.s) tha:

*“Lëre o Omer! Unë nuk mund t'ia dëmtoj organet në këtë lloj mënyre. Por, nëse e bëj këtë, edhe Allahu ma bën mua edhe pse jam pejgamber. Mos u nxito, sepse do të vijë një ditë kur ai do të*



*ligjërojë në një vend që ti do ta lavdërosh, që do të të pëlqejë dhe do të të gëzojë.*” (Ibn Hisham, II, 293)

Nëpërmjet kësaj sjelljeje Pejgamberi, i Nderuari ynë na mësoi se gjithmonë duhet të kemi frikë nga Allahu dhe se nuk duhet të bëjmë asgjë që tërheq zemërimin e Tij.

Me të vërtetë, pas vdekjes së të Dërguarit të Allahut, në një kohë kur ndërmjet njerëzve patën filluar lëvizjet për lënien e fesë Islame, Suhejl bin Amr radijallahu anhu bëri ligjërimin që i përshtatej lëvdërimin që parashikoi i Dërguari i Allahut. Mes të tjerave, ai tha:

“...Për Zotin unë e di se kjo fe do të qëndrojë gjallë në këmbë, përderisa dielli dhe hëna të vazhdojnë të lindin dhe të perëndojnë...”

Kur Suhejl bin Amri radijallahu anhu e mbaroi fjalimin e tij, populli u qetësua. Kur Omeri radijallahu anhu e dëgjoi fjalimin e Hazretit Suhejl, iu kujtua fjala e të Dërguarit të Allahut dhe nuk mundi ta përmbante veten pa thënë:

(O i Dërguari i Allahut) Po dëshmoj edhe një herë se Ti je i Dërguari i Allahut!” (Ibn Hashim, IV, 346; Vakidi, I, 107; Belazuri, I, 303-304; Ibn Abdilberr, II, 669-671; Hakim, III, 318/5228)



Sipas transmetimit të Hazretit Aishe radijallahu anha, kur koha ishte me shumë erë ose kur në qiell dukej ndonjë re e zezë, Pejgamberit i ndryshonte ngjyra e fytyrës, nganjëherë ndalonte dhe e shikonte renë, nganjëherë hynte e dilte nga shtëpia. Ndërsa kur binte shi, gëzohej. Kur e pyetën për këtë, ai tha se frikësohej se mos edhe ummeti i tij do të ndëshkohej ashtu siç qe ndëshkuar populli i Adit. (Muslim, Istiska, 14-16)

Mëshira që i Nderuari ynë kishte për ummetin, ishte më e madhe se sa mëshira që kanë prindërit për fëmijën e tyre. Allahu lajmëron për këtë:

**“Juve ju ka ardhur i dërguar nga mesi juaj. Atij i vjen rëndë për vuajtjet tuaja. Ai brengoset për besimtarët, është i butë dhe i mëshirshëm.”** (et-Teube, 128)

I Dërguari i Allahut ka treguar se asnjë njeri nuk ka më shumë frikë



nga Allahu, sepse askush nuk ka vuajtur më tepër dhe nuk ka ngelur i uritur më shumë se sa Ai.<sup>36</sup> Vuajtjet i ka hequr për t'i kthyer robërit në rrugën e Allahut. Pejgamberi nuk është ankuar kurrë nga kjo. Sipas tij, edhe shpëtimi i një njeriu është më i vlefshëm se sa çdo gjë mbi të cilën dielli lind dhe perëndon. Atë e goditën me gurë në Taif, këmbët i ishin mbushur me gjak, por udhëzimi i një robi ia gëzoi zemrën.



Ebu Bekr es-Siddik radijallahu anhu, thotë:

“Kur isha pranë të Dërguarit të Allahut (s.a.v.s), atij i zbriti ky ajet fisnik:

**Kushdo që bën keq, do të ndëshkohet për të dhe nuk ka për të gjetur mik apo ndihmues përveç Allahut.** (en-Nisa, 123)

Pejgamberi, i Nderuari ynë tha:

*-O Ebu Bekr! A të të mësoj një ajet që më është zbritur?*

Unë i thashë:

*-Sigurisht, o i Dërguari i Allahut!*

Ai ma mësoi ajetin. Ndjeva sikur mu thye beli në mes dhe mbeta ashtu i kërrusur. Pejgamberi alejhissalatu vesselam më pyeti:

*-Çfarë ke o Ebu Bekr? Unë e shpreha kështu mërzinë time:*

*-Nëna dhe babai im të qofshin falë o i Dërguari i Allahut! Kush është ai që nuk bën mëkat? A do të ndëshkohemi patjetër për ato që kemi bërë?*

I Dërguari i Allahut (s.a.v.s) e shpjegoi kështu:

*-O Ebu Bekr! Ti dhe besimtarët ndëshkoheni në këtë botë (duke rënë në disa vuajtje dhe vështirësi) për shkak të gabimeve tuaja, ashtu që në fund takoheni me Allahun pa pasur mëkate. Ndërsa të tjerëve u mblidhen mëkatet dhe ndëshkohen në ditën e gjykimit.”* (Tirmidhi, Tefsir, 4/3039)





Sa mësimdhënës është ky shembull që reflekton frikën që Hazretit Ebu Bekr radijallahu anhu kishte ndaj Allahut:

Ebu Bekri radijallahu anhu pati dalë jashtë në një kohë të pastër. Po shikonte qiellin dhe shumë trajta mjeshtërore, që Allahu Teala i ka shfaqur për robërit e tij. Sytë i shkuan te një zog. Ishte ulur mbi degën e pemës dhe po cicëronte me zërin e tij të bukur. Hazreti Ebu Bekr u gëzua. Me ëndje dhe mall i tha zogut:

“-Sa mirë për ty o zog! Për Zotin edhe une dua te jem si ti. Ulesh mbi pemë, ha nga frutat e saj, pastaj fluturon dhe ikën. Nuk ke as llogari as ndëshkim!

Sa do të doja të isha një pemë në qoshe të rrugës, ashtu që të vinte ndonjë deve të më hante dhe të më gëlltiste, se sa të jem një njeri që do të duhet japë llogari përpara Allahut! (Ibn Ebi Shejbe, VIII, 144)



Një ditë Ebu Bekri radijallahu anhu po mendonte ditën e kiametit, peshoren e veprave, xhennetin, xhehennemin, qëndrimin e ëngjëjve në rreshta, shkatërrimin e qiellit, flakërimin e maleve, palosjen e diellit, shpërndarjen e yjeve dhe meditonte për to. Pastaj, për shkak të frikës që kishte ndaj Allahut, tha:

“Do të doja të isha bar i gjelbër. Ashtu që të më hante ndonjë kafshë dhe tu zhdukesh. Mbi këtë zbriti ky ajet fisnik:

**“Për ata që kanë frikë të japin llogari përpara Allahut, ka dy xhennete.”** (er-Rahman, 46) (Sujuti, Lubabu'n-Nukul, II, 146; Alusi, XXVII, 117)

Ashabët e nderuar nuk i hiqnin nga mendja ndjenjat e këtij qortimi të Allahut:

**“O ju që keni besuar! Kini frikë Allahun me sinqeritet të vërtetë dhe mos vdisni vetëm se duke qenë muslimanë!”** (Ali Imran, 102)



Një ditë të premte, Ebu Bekri radijallahu anhu doli e u tha njerëzve:



“Mblidhuni nesër dhe të ndajmë devetë e zekatit, por askush të mos hyjë pa marrë leje!”

Të nesërmen, një grua, duke i dhënë kapistrën burrit të saj, i tha:

“Merre këtë dhe shko. Nuk i dihet, ndoshta edhe ne na jep Allahu ndonjë deve.” Kur burri me kapistër në dorë shkoi në vendin ku ndaheshin devetë, gjeti Hazretin Ebu Bekr dhe Omerin në vathën ku ishin devetë e zekatit dhe iu qas atyre pa marrë leje. Ebu Bekri i tha:

“Si hyre këtu?”. Pastaj ia mori kapistrën që kishte në dorë dhe i ra lehtë, më qëllimin për ta qortuar, por u pendua shumë për këtë gjest që bëri. Kur mbaroi ndarjen e deveve, e thirri atë njeri, ia dha kapistrën dhe i tha:

“Merre dhe më godit mua si shpagim!” Kur dëgjoi këtë, Hazreti Omer tha:

“Betohem në Allahun se nuk do të lejoj ndodhë një gjë e tillë. Mos e lërë që kjo të bëhet zakon për ata që do të vijnë pas teje!”

Ebu Bekri radijallahu anhu tha:

“Atëherë kush do të më shpëtojë nga zemërimi i Allahut ditën e kiametit?”. Hazreti Omer e këshilloi me fjalët:

“Atëherë fitoja zemrën atij!” Hazreti Ebu Bekr urdhëroi shërbëtorin e tij që të sillte një deve bashkë me tërkuzën e saj, si dhe pesë dinarë, për t’ia dhënë burrit. Edhe ai e fali Ebu Bekrin radijallahu anhu. (Ali el-Muttaki, V, 595-596/14058)



Ishte një djalosh prej Ensarëve. Zemrën e kishte të mbushur me frikën ndaj xhehennemit. Ai qante kur flitej për xhehennemin. Së fundi u mbyll në shtëpi. I treguan të Dërguarit të Allahut për këtë. I Nderuari ynë shkoi te djaloshi. Djaloshi e pa me mall të Dërguarin e Allahut (s.a.v.s), u ngrit menjëherë, përqafoi të Nderuarin e Botrave dhe ra në tokë dhe ia dorëzoi shpirtin Allahut. Krenaria e Gjithësisë, i Nderuari ynë tha:



*ska copëtuar mushkëritë. Betohem në Allahun në dorën e të Cilit është shpirti im, se Allahu e ka mbrojtur atë nga xhehennemi. Kush do ndonjë gjë, i gjen rrugët për ta fituar, kush ka frikë nga diçka, ikën nga ajo.” (Hakim, II, 536/3828; Ali el-Muttaki, III, 708/8526)*



Kasimi rahimehullah tregon:

“Kur dilja në mëngjes, së pari shkoja te shtëpia e (kushërirës) Hazretit Aishe dhe i jepja selam. Kurnjë ditë shkova në shtëpinë e saj, pashë se ajo po falte namaz nafile dhe po lexonte këtë ajet fisnik:

(Të devotshmit thonë: Falenderimet i takojnë **Allahut i cili na dhuroi të mira dhe na ruajti prej dënimit të zjarrit të nxehtë.** (et-Tur, 27) Bënte lutje në këmbë, qante dhe përsëri lexonte këtë ajet. E prita derisa u lodha, pastaj shkova në treg për të marrë disa gjëra për të cilat kisha nevojë. Pasi mbarova punë dhe u ktheva, vura re se Aishja radijallahu anha ishte ende në këmbë (kijam), duke falur namaz dhe duke qarë.” (Ibnu'l-Cevzi, Sifatu's-Safue, II, 31)



Ibn Ebi Mulejke rahimehullah thotë:

“Kam njohur tridhjetë nga ashabët e të Dërguarit të Allahut (s.a.v.s). Ata të gjithë kishin frikë se mos ishin hipokritë. Asnjëri prej tyre nuk thoshte se kishte besim si Xhibrili dhe Mikaili.” (Buhari, Iman, 36)



Një ditë Hazreti Ebu Bekr radijallahu anhu takoi Hanzalanë -radijallahu anhu- dhe e pyeti për gjendjen. Hanzala radijallahu anhu, me një pikëllim dhe shqetësim të madh, tha:

“O Siddik, Hanzala është hipokrit!”

Kur Hazreti Ebu Bekr tha:

“Subhanallah (i lartmëdhëruar është Allahu)! Çështë kjo fjalë?”  
Hanzala radijallahu anhu vazhdoi:



“Kur jemi në kuvendet e Hazretit Pejgamber, ai na e kujton xhenetin dhe xhehennemin, madje vijnë në një gjendje ku pothuajse i shikojmë ata. Pasi largohemi nga i Dërguari i Allahut (s.a.v.s) dhe kur humbasim duke u marrë me fëmijët dhe jetën e kësaj bote, i harrojmë shumicën e atyre që ndjejmë. (Frymëzimin dhe ndjenjat shpirtërore që marrim nga kuvendi i tij po i humbasim.)”

Hazreti Ebu Bekr radijallahu anhu, tha:

“Për Zotin, edhe mua më ndodh kështu.”

Pas kësaj që të dy shkuam drejt e te i Dërguari i Allahut dhe ia treguam këtë. Hazreti Pejgamber (s.a.v.s) tha:

*“Betohem në Allahun, në dorën e të cilit është shpirti im, se sikur ta ruani atë gjendje që keni kur jeni me mua dhe të bëni vazhdimisht dhikër, ëngjëjt do t’ju kapin për dore edhe kur të jeni të shtrirë në shtrat, edhe kur të ecni në rrugë. (Duke e përsëritur tri herë):*

*–O Hanzala! Nganjëherë bën edhe ashtu, nganjëherë edhe kështu!”* (Muslim, Teube, 12)

Siç vihet re, ashabët e nderuar vazhdimisht jetonin duke e llogaritur veten. Edhe pse kishin shumë vështirësi në jetë, ata i jepnin shumë rëndësi mosrënies në dobësi sa i takonte jetës së tyre shpirtërore.



Një ditë, kur po kalonte pranë një shtëpie Hazreti Omer radijallahu anhu dëgjoi të zotin e shtëpisë që po lexonte suren Tur me zë aq të lartë, saqë zëri arrinte deri jashtë. Kur i zoti i shtëpisë erdhi te ky ajet fisnik:

**“Është e vërtetë se dënimi i Zotit tënd pa tjetër do të ndodhë. Atë nuk ka kush që mund ta largojë.”**, Hazreti Omer radijallahu anhu zbriti nga kafsha, u mbështet pak te muri dhe pushoi. Pastaj, për shkak të ndikimit të fortë të qortimit të këtij ajeti, u sëmur dhe u shtri në shtëpi për një farë kohe.<sup>37</sup>



Hazreti Omer radijallahu anhu ka thënë:

“Nëse vjen një zë nga qielli dhe thotë: “O njerëz! Vetëm një njeri do të hyjë ne xhennem”, do të më zinte frika se mos ai njeri do të jem unë. Nëse zëri do të thoshte “O njerëz! Vetëm një njeri do të hyjë në xhennet”, atëherë do të shpresoja se ky njeri do mund të jem unë.”<sup>38</sup>

Në ajetin fisnik urdhërohet që besimtarët të jenë në pikërisht në një gjendje të tillë shpirtërore, domethënë ndërmjet frikës dhe shpresës:

“(Të devotshmit natën i lënë shtratet), **duke e lutur Zotin e tyre nga frika e nga shpresa dhe japin nga ajo (pasuria) që u kemi dhënë.**” (es-Sexhde, 16)



Një herë, duke menduar vështirësinë e dhënies llogari përpara Allahut Teala, Hazreti Omer radijallahu anhu mori pak kashtë dhe tha i mërzitur:

“Ah sikur të isha kashtë, sikur të mos kisha ardhur fare në këtë botë, sikur të mos më kishte lindur nëna, sikur të isha harruar fare.” (Ibn Sa’d, III, 360-361)



Hazretin Ali radijallahu anhu e pyetën:

“O prijësi i besimtarëve! Përse të ndërron ngjyra e fytyrës dhe fillon të dridhesh kur vjen koha e namazit?” Ai u përgjigj:

“Sepse ka ardhur koha e kryerjes së një amaneti, të cilin as toka, as qielli dhe malet nuk kanë mundur ta mbajnë. Nuk e di nëse do të mund ta kryej të plotë apo jo.”



Hazretit Hasan radijallahu anhu i ndryshonte ngjyra e fytyrës kur

38. Ali el-Muttaki, XII, 620/35916. Veçanërisht shik. Ibn Rexheb el-Hanbeli, et-Tahvif, fq. 15.



merre abdest. Njëri e pyeti:

“O Hasan! Përse zverdhesh kështu kur merr abdest?”

Hazreti Hasan u përgjigj:

“Sepse ka ardhur koha për të dalë përpara Allahut, i cili është i plotfuqishëm, i lartë dhe i madhërishtëm.”

Kur Hasani radijallahu anhu hynte në xhami, lutej kështu:

“O Zoti im! Robi Yt është në derën Tënde. O Allahu im që je i butë. Robi Yt mëkatar ka ardhur të Ti. Ti i ke urdhëruar të devotshmit që t’ua falin të këqijat njerëzve të këqinj, sepse Ti je falës dhe bujar. O Zoti im! Me mëshirën dhe bujarinë Tënde mëshiromë dhe falmi mëkatet që kam bërë!”



Hazreti Ebu Bekr Verrak kishte një djalë të vogël. Ai e merrte nga një hoxhë mësimin e Kur’anit Fisnik. Një ditë u kthye herët nga shkolla duke u dridhur dhe i zverdhur në fytyrë. Ebu Bekr Verrak e pyeti i habitur:

“Çfarë ke o biri im? Përse je kthyer herët nga shkolla?”

I biri me fytyrën që i qe bërë si gjethe vjeshte, për shkak të frikës ndaj Allahut, frikë e cila kish zënë vend në zemrën e tij të vogël, tha:

“O babai im i dashur! Sot hoxha më mësoi një ajet nga Kur’ani. E kuptova domethënien e ajetit dhe nga frika erdha në këtë gjendje!” Babai i tha:

“O biri im! Cili ajet fisnik ishte ky?” Fëmija i vogël filloi të lexojë:

**“Nëse mohoni, si do të mbroheni në një ditë që fëmijët do t’i bëj pleq?”** (el-Muzzemmil, 17)

Më vonë, fëmija u sëmur nga ashpërsia dhe frika e këtij ajeti dhe ra në shtratin e vdekjes. Pa kaluar shumë e dorëzoi shpirtin e tij.

Babai i tij u prek shumë nga kjo ngjarje. Ai shkante shpesh të varri i birit të tij dhe duke qarë, thoshte në vete:



“O Ebu Bekr! Biri yt mësoi një ajet nga Kur’ani dhe nga frika ndaj Allahut e dorëzoi shpirtin e tij. Ndërsa ti u bënë shumë kohë që e lexon Kur’anin Fisnik dhe akoma nuk ke frikë nga ligjet hyjnore!”

Padyshim se kjo ngjarje shfaq ndjeshmërinë e besimit të një fëmije të vogël, zemrës së të cilit Allahu i kishte dhuruar butësi, tregon se si duhet ta meditojmë dhe lexojmë me zemër të ndjeshme fjalën e Allahut, por tregon edhe sjelljen që duhet të kemi përpara madhërisë hyjnore, domethënë frikën ndaj Allahut. Ja si e tregon Allahu në Kur’anin Fisnik rrugën për të arritur këtë gjendje:

“(A jobesimtari është më mirë) **apo ai që natën e kalon në adhurim, që duke bërë sexhde dhe duke qëndruar në këmbë i rullet (dënimet) të botës tjetër dhe shpreson në mëshirën e Zotit të tij? Thuaj: A JANË TË BARABARTË ATA QË DINË DHE ATA QË NUK DINË? Por vetëm të zotët e mendjes marrin mësim.**”

(ez-Zumer, 9)

Sipas kësaj, dija e vërtetë e Allahut është dija që e tërheq robin te ndjenjat e devotshmërisë dhe të frikës ndaj Zotit, domethënë njohja e Allahut. Për të fituar këtë dije, duhet të respektohen këto veçori:

1. Sigurimi i miqësisë shpirtërore me Allahun kur të jemi në sexhde dhe kijam (në këmbë) natën.
2. Përkujtimi i përkohshmërisë, duke u shqetësuar se do të japim llogari në ahiret për çdo çast, për çdo situatë dhe për çdo sjellje tonën.
3. T’i lutemi Allahut gjithmonë, duke shpresuar mëshirën e Tij, sepse shpirtërat e mëdhenj jetojnë gjithmonë në lutje.



Mansur bin Ammar tregon:

Një natë dola jashtë, duke menduar se u bë mëngjes, por pashë se nuk kishte gdhirë ende. Kur po kaloja përpara një shtëpie, dëgjova një hallexhi që lutej duke qarë:

“O Zoti im, unë kam bërë shumë mëkate. E kam turpëruar veten. Qëllimi im nuk ishte për të provuar fjalën Tënde. Unë u munda nga



vetja ime dhe pashë se për çfarëdo që bëj, Ti nuk më ndëshkon. E kuptova se Ti je mbulues i Mëkateve. Mëkatet që kam bërë i kam bërë për shkak të padijes sime. Tani e kuptova se kam gabuar. Nëse më ndëshkon, puna ime bëhet shumë e vështirë. Vaj medet për mua, vaj medet për mua! O Zoti im! Ditën kur do t'i urdhëroshë robërit e Tu për të kaluar Siratin, dikush do të bie në xhehennem dhe dikush do të hyjë në xhennet. Vallë nga cili grup do të jetë ky robi Yt i varfër?!”

Në ato çaste u dëgjua një ajet që flet për xhehennemin. Djali, i cili po lutej brenda, tha vetëm një herë “Ah!” dhe nuk rënkoj më.

U bëra merak dhe thashë: “Çfarë ndodhi vallë që iu ndërpre zëri?” Pasi e mbajta mend mirë vendin e shtëpisë së tij, u ktheva në shtëpinë time. Kur kalova aty në mëngjes, përpara asaj dere kishte një xhenaze. Kur pyeta se çfarë kish ngjarë, nëna e tij më tha:

“Ky është djali im i vdekur. Është nga soji i Pejgamberit tonë të nderuar. Kur bëhej natë, qante deri në mëngjes në dhomën ku falej. Ata që i fitonte ditën ua jepte të varfërve. Kur dëgjoi njërin prej ajeteve të xhehennemit, nuk mundi të rezistojë më dhe duke qarë ia dorëzoi shpirtin Zotit.”

Unë i thashë asaj:

“-O zonjë! Biri juaj ka hyrë në xhennet, sepse ai që qan prej frikës ndaj Allahut, nuk hyn në xhehennem. A hyn në xhehennem ai që e dorëzon shpirtin në këtë mënyrë? Falenderoj Allahun!”



Javuz Sulltan Selim Hani ishte një padishah shumë i ashpër ndaj lëvizjeve që bëheshin gabim apo me pakujdesi, por ashpërsia e tij ashtu si edhe bukuria e tij, pothuajse ishin tretur dhe zhdukur në kornizën e urdhërave të Allahut. Frika që kishte ndaj Allahut ishte mbi çdo gjë. Një herë, për shkak të një vjedhjeje që kishte ndodhur në thesar për arsye të pakujdesisë së atyre që e ruanin, urdhëroi egërsisht që të vriten rreth dyzet vetë. Shejhulislam Zenbilli Ali Efendi, i cili e dëgjoi këtë, nxitoi të shkonte te Javuzi pa marrë leje, me qëllim që ta ndalonte zbatimin e këtij vendimi. Ai e dëgjoi edhe një herë nga Sulltani të vërtetën e ngjarjes. Javuzi iu përgjigj në një mënyrë të ashpër:





“Hazret Efendi! Ajo që keni dëgjuar është e vërtetë, por ju nuk keni të drejtë të përziheni në punët e shtetit...”

Mbi këtë shejhulislam Zenbilli Ali Efendi, me të njëjtën ashpërsi i tha:

**“O Sulltani im! Unë erdha t’ju tregoj ligjet e sheriatit, sepse puna jonë është që tju mbrojmë ahiretin tuaj...”**

Javuz Sulltan Selim Hani u qetësua përpara masave të larta të Islamit, të cilat ishin më të holla se fija e flokut dhe më të prera se shpata, dhe pyeti:

“A nuk është e lejuar që të vritet një grup për rregullimin e popullit?”

Zenbilli Ali Efendi tha:

“Vrasja e këtyre nuk ka lidhje me rregullimin e botës. Duhet të ndëshkohen sipas fajit që kanë bërë...”

Padishahu i madh, i cili kishte formuar gjithë atë ushtri, uli kokën dhe e tërhoqi vendimin. Zenbilli i cili u kënaq shumë nga kjo dhe teksa po matej të largohej u kthye përsëri dhe i tha Javuzit që e shikonte me merak:

“O Sulltani im! Kërkesa ime e parë ishte për të transmetuar ligjin e fesë sonë, por kam edhe një kërkesë të dytë që është vetëm një lutje...” Dhe shtoi:

“O Sulltani im! Krimi i këtyre fajtorëve u përket vetë atyre, por kush do të kujdeset për familjet e atyre të pafajshme, kur ata të jenë në burg? Për këtë arsye po ju kërkoj që familjeve të fajtorëve t’u jepni ndihmë derisa të mbarojë ndëshkimi që u është dhënë fajtorëve.” (Shik. Mustafa Nuri Pasha, Netaicu’l-Vukuat, Ankara 1987, vëll. I-II, fq. 90-91)

Javuzi i cili e pranoi edhe këtë lutje të dytë. Ai patjetër që po kryente kërkesën e përgjegjesisë hyjnorë, për të cilën kishte dijeni.



Përsëri Zenbilli Ali Efendi e kishte qortuar Sulltanin në një çështje të njëjtë si ajo e mësipërmja, por Sulltani ngaqë e shikonte veten të



drejtë në vendimin që kishte dhënë, i tha Shejhulislamit siç i kishte thënë më parë:

“Puna juaj nuk është që të përziheni në punët e shtetit!..”

Edhe Zenbilli Ali Efendi përballë kësaj bisede kërcënuese, i qe përgjigjur pa frikë:

**“O Sulltani im! Këta janë nga çështjet e ahiretit dhe kemi të drejtë të ndërhyjmë. Nëse nuk hiqni dorë nga vendimi që keni dhënë, përgatituni për ndëshkimin e ashpër në ditën e tubimit!..”**

Shejhulislam pas këtyre fjalëve iku pa i dhënë as selam Sulltanit. Javuz Sulltan Selim Hani, i cili në atë kohë ishte në nisje e sipër për një udhëtim ushtarak, edhe pse u zemërua ndaj kësaj sjelljeje të paparë në ndonjë rast tjetër, e kuptoi të vërtetën, pranoi qortimin e Shejhulislamit dhe e ndërroi vendimin sipas fjalëve të tij. Ai la edhe një letër, me të cilën i kërkonte ndjesë Zenbilli Ali Efendit.

Edhe pse ishte padishahu i botës, frika që kishte në zemër ndaj Allahut, e ndaloi që të vepronte sipas dëshirës së tij. Ndërsa Shejhulislamit, frika që kishte ndaj Allahut i dha një trimëri të madhe, aq sa duke marrë gjithçka para sysh, guxoi të qortonte pa frikë edhe një padishah të ashpër si Javuzi.



Një herë, një ministër u takuar me mistikun e madh Hazretin Zunnun el-Misri dhe i tha:

“Më ndihmo! Natë e ditë jam i zënë me punë duke i shërbyer padishahut, shpresoj që ai të silltet mirë me mua, por kam frikë se mos zemërohet dhe më kritikon.”

Hazreti Zunnun qau dhe tha:

“Sikur të kem frikë nga Allahu ashtu si ke frikë ti nga padishahu, do të isha prej të sinqertëve.”



Së fundi, baza e çdo mirësie është dashuria ndaj Allahut, edhe baza e urtësisë është frika ndaj Allahut.”

Një njeri që e don dhe e njeh Allahun, gjithmonë sillet i kujdes-shëm, me frikën se nuk meriton dashurinë e Allahut por meriton ndëshkimin e Tij. Jetën e tij e jeton në mirësi.

Nëse robi ka frikë plotësisht nga Allahu, i jep jetës së tij drejtim sipas natyrës së Islamit dhe është i sigurtë nga të gjithë druajtjet e kësaj bote dhe të ahiretit. Po ashtu, i Nderuari i Botrave thotë:

*“Ka tre gjëra që e shpëtojnë njeriun: frika ndaj Allahut, fshehtas apo hapur, drejtësia kur je i kënaqur dhe i zemëruar, dhe kursimi kur je i varfër dhe i pasur. Ka edhe tre gjëra që e shkatërrojnë njeriun: dëshirat vetjake, kopracia dhe pëlqimi i vetes.”* (Munavi, III, 404/3471)

Për të arritur qetësinë dhe lumturinë në këtë botë dhe në ahiret, duke pasur frikë nga Allhu ashtu siç duhet, rikutë, sexhdet dhe lutjet tona duhet t'i bëjmë me lot në sy dhe duhet t'i lutemi Allahut me shpresën për të fituar mëshirën dhe faljen e Tij.

### 3. Madhërimi

Madhërimi është rezultat i ndjenjave të bukura dhe i ndjesive shpirtërore si devotshmëria, e cila formohet nga besimi, dashuria, modestia dhe besnikëria. Në fakt, edhe thelbi i Islamit është përkufizuar shkurtimisht në kornizat e këtyre dy masave:

a. “Tadhim li-emrillah”, domethënë, zbatimi me përpikmëri dhe respekt i urdhërave të Allahut.

b. “Shefkat ala halkillah”, domethënë, sjellja me butësi dhe mëshira ndaj krijesave për hir të Krijuesit.

Edukata më e lartë është lartësimi i Allahut Teala. Shfaqja më e bukur dhe më e fortë e saj tregohet nëpërmjet adhurimeve. Pas kësaj, është afrimi me ndjesi ndaj krijesave të tjera sipas gradës së afërsisë që ata kanë me Allahun. Në ajetin fisnik thuhet:



وَمَنْ يُعْظَمِ شَعَائِرَ اللَّهِ فَإِنَّهَا مِنْ تَقْوَى الْقُلُوبِ

“...Kush i madhëron dispozitat e All-llahut, sigurisht ajo është shenjë e devotshmërisë së zemrave.” (el-Haxh, 32)

Sipas kësaj, shumë amanete të shenjta siç janë namazi, Kur’ani Fisnik, ezani dhe kurbani, si dhe shumë vende të shenjta si Qabja e Lartë dhe kodrat Safa-Merve, janë nga dispozitat e Allahut. Gjatë haxhit dhe umres është e domosdoshme që këto t’i respektojmë pa mangësi dhe veçanërisht t’i lartësojmë. Është e domosdoshme që të largohemi nga sjelljet jo të mira si ulja apo shtrirja, duke i shtrirë këmbët drejt Qabes, marrja me biseda boshe në ato vende të bekuara, veçanërisht leximi dhe dëgjimi i Kur’anit Fisnik pa respekt dhe vendosja e tij në një vend ku mund t’i çvlerësohet lartësimi.

Allahu xhelle xhelaluhu i ka bërë të përhershme këto dhe gjithmonë e ka zbritur mëshirën e Tij mbi ata që respektojnë Allahun, pejgamberët e Tij, miqtë e Tij dhe amanetet e shenjta. Po ashtu edhe mushrikët e Mekkes nuk i ndëshkoi, përderisa Hazreti Pejgamber gje ndej në mes tyre.<sup>39</sup>

Tregimet mësimdhënëse të magjistarëve të Faraonit, për të cilat rrëfëhet në Kur’anin Fisnik, janë nga shembujt më të bukur të fitimeve të veçanta që sjell lartësimi i dispozitave të Allahut. Kur Faraoni mbeti i paaftë përballë mrekullive të Hazretit Musa alejhisselam, ai mblodhi magjistarët e Egjiptit dhe u premtoi shpërblime të mëdha. Por magjistarët, duke e respektuar Pejgamberin e Allahut Musanë alejhisselam, i dhanë të drejtë të zgjedhë kur filluan garën. Kjo sjellje e njerëzishme, në atë çast kur dashuria e udhëzimit filloi të rritej në zemrat e magjistarëve, duhet ta ketë kënaqur Allahun. Pastaj, mrekullitë që panë u bënë shkak për të shijuar nderin e besimit që kishin në zemër. Madje një besim i përsosur që nuk jep kompensim edhe për sakrificimin e jetës...

Shfaqjet e fshehta të lartësimit të dispozitave të Allahut, të cilat tregohen në historinë e mësipërme, Hazreti Mevlana i shpreh kështu:

“Magjistarët u udhëzuan për shkak të respektit dhe njerëzillëkut



që treguan ndaj pejgamberit të madh duke e lënë të zgjedhë në fillim të garës, por edhe u ndëshkuan për shkak se dolën në garë me pejgamberin e madh.”

Edhe martesë e vajzës së Hazretit Shejh Edebali, i cili komentoi ëndrrën që kishte parë Osman Gazi, si rezultat i respektit dhe madhërimit që kishte për Kur'anin Fisnik, është një ngjarje e njohur. Kësisoj mund të themi se në themelin e Osmanëve, që ishte shteti më jetëgjatë në historinë e kësaj bote, kishte respekt, madhërim, dashuri, edukatë dhe shërbim ndaj Kur'anit Fisnik.

Ky shtet i lartë i cili e merrte forcën nga respekti legjendar që kishte ndaj Kur'anit Fisnik, kur më vonë mori përsipër amanetet e shenjta, i ruajti ato me një madhërim të paparë në histori, veçanërisht Hamejni'sh-Sherifejn u shërbyen shekuj të gjatë në një mënyrë të përshtatshme ndaj respektit dhe shenjtërisë që meritonin.

### *Tabllo të virtytshme dhe mësimdhënëse*

Sipas transmetimit të Ebu Hurejrës, i Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem kishte parë një pështymë në anën e kibles së xhamisë. U kthye nga njerëzit dhe i qortoi:

*“Çfarë po u ndodh disave që i drejtohen Zotit dhe pështijnë përpara Tij. A dëshiron ndokush prej jush që t'i kthehen dhe ta pështijnë në fytyrë?..”* (Muslim, Mesaxhid, 53)



Khunejd Bagdadi shkoi për të vizituar dikë, për të cilin thuhej se ishte i devotshëm, por vuri re se ai pështyu në drejtim të kiblës. Me mendimin se “Ky njeri nuk e zbaton sunnetin!”, ai nuk u takua fare me të dhe u kthye prapa.



Siç tregon Enesi radijallahu anhu, i Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem, gjithnjë përpara se të hynte në tualet e hiqte unazën



mbi të cilën shkruhej “Muhammedun Rasulullah, dhe këtë e bënte për shkak të respektit që kishte ndaj Allahut”. (Ebu Davud, Taharet, 10/19)



Kur Pejgamberi ynë i Nderuar pa gjatë haxhit shtëpinë e Allahut, i ngriti duart dhe u lut duke thënë:

*“O Zoti im! Shtoja shtëpisë Tënde nderin, madhërinë dhe fisnikërinë. Shtojua nderin, fisnikërinë, madhërimin e mirësitë edhe atyre që e madhërojnë atë me haxh dhe umre!”* (Ibn Sa’d, II, 173)



Një nga dispozitat e Islamit është edhe kurban, sepse në ajetin fisnik thuhet: **“Devetë (therrjen e tyre për kurban) ua kemi bërë prej dispozitave të All-llahut...”** (el-Haxh, 36) Për këtë arsye, duhet t’i respektojmë kafshët dhe kurbanin për hir të Allahut. Si në të gjitha adhurimet e tjera, edhe në kurban ato që kërkohen janë ndjenjat e madhërimit dhe të devotshmërisë. Po ashtu, Allahu Teala thotë:

**“Te All-llahu nuk arrin as mishi as gjaku i tyre që keni prerë, por te Ai arrin bindja juaj...”** (el-Haxh, 37)

Kjo ngjarje shfaq një shembull të bukur për madhërimin që i bënte Allahut me kurban i Nderuari i Botërave:

Myslimanët patën ardhur deri në Hudejbije për umre, por mushrikët e Mekkes nuk i lanë të hyjnë. Ashabët e nderuar patën sjellë edhe kafshët që do të bënin kurban. Mes këtyre kafshëve gjendej edhe një deve e Ebu Xhehlit, e cila ishte prej llojit të mirë dhe që kishte një hallkë prej argjendi në hundë. Kur kjo deve u përzie me devetë e tjera që ishin për kurban, iku në Mekke dhe shkoi në shtëpinë e Ebu Xhehlit. Amr bin Aneme radijallahu anhu shkoi pas devesë. Disa njerëz nuk donin t’ia dorëzonin atë Amrit. Pastaj propozuan njëqind deve kundrejt kësaj deveje. Pejgamberi ynë i Nderuar tha:

*“Sikur të mos e kishim caktuar për kurban, do t’ua plotësonim dëshirën!”* (Vakidi, II, 614)



Dërguari ndaj Allahut. I Nderuari ynë sallallahu alejhi ue sellem ishte më i buti i njerëzve. Ai nuk e kishte zakon tua thyente njerëzve dëshirat e tyre të cilat ishin të përshtatshme ndaj sheriatit. Siç shihet edhe këtu, Ai do tua plotësonte dëshirën edhe qafirëve, por ndjenja e madhërimit që kishte për Allahun dhe shenjave të fesë së tij, ishte mbi gjithçka. Për këtë arsye, devenë që ishte caktuar për t'u bërë kurban për Allahun nuk e përdori për ndonjë diçka tjetër.



Sa mësimdhënëse është edhe përpikmëria që kishin miqtë e Allahut në çështjen e kurbanit:

Hazreti Sami Efendi dhe babai im Musa Efendi kuddise sirruhu, silleshin në mënyrë shumë të ndjeshme kur prisnin kurbanin. Ata nuk i prisnin dy kafshë në një gropë. Kafshës ia lidhnin sytë. Nuk e zvarritnin kafshën duke e shtyrë në vendin ku do të pritej, nëse ishte kurban një kafshë e vogël, e merrnin në krah dhe e dërgonin me butësi. Ata kishin kujdes që thika të jetë e mprehtë kur ta prisnin. Dëshironin që kafshën ta prisnin në një formë të bukur, pa e munduar atë dhe duke bërë që gjaku t'i rridhte shumë mirë. Kur pritej kurban, nuk u uleshin, por prisnin në këmbë derisa gjaku i kafshës të dilte plotësisht.

Sepse edhe kurban është një adhurim që duhet të kryhet me ndërgjegje, ashtu si adhurimet e si tjera. Madhërimi i Allahut është të shprehurit e falenderimit për mirësitë që ka dhënë dhe flijimit në rrugën e Tij. Allahu Teala e ka krijuar kafshën me qëllim që njeriu të përfitojë prej saj, dhe e ka nënshtruar ndaj urdhërit të Tij. Kjo mirësi që përfitohet nga mishi, qumështi, lëkura, leshi, shkurt nga çdo gjë e tyre, është një bujari e madhe e Allahut për robërit e Tij.

Të falenderosh edhe atë që të nderon me një gotë ujë, është një sjellje njerëzore. Atëherë, ne gjithonë duhet ta falenderojmë Allahun për shkak të mirësive të panumërta që na ka dhënë, si dhe të sillemi me edukatë, mëshirë dhe butësi kundrejt këtyre kafshëve, të cilat na janë dhënë të përfitojmë prej tyre kur t'i bëjmë kurban.



Hazreti Omer dhe Hazreti Osman radijallahu anhuma, e kishin bërë zakon që kur ngriheshin në mëngjes ta puthnin me respekt Kur'anin Fisnik. Po ashtu Abdullah bin Omeri radijallahu anhu, çdo mëngjes e merrte Kur'anin, e puthte me një ndjenjë të thellë madhërimi, e vendoste në zemër dhe thoshte:

“Premtimi i Zotit tim, urdhëri i qartë i Zotit tim!” (Kettani, II, 196-197)

Ikrimë radijallahu anhu e merrte Kur'anin Fisnik në dorë, e vendoste në fytyrë dhe e shprehte madhërimin e dashurinë që kishte ndaj Allahut duke thënë:

“Fjala e Zotit tim! Libri i Zotit tim!” (Hakim, III, 272/5062)



Kur donin t'i fshinin shkrimet e hershme që shkruheshin me bojë, i lanin me ujë. Enesi radijallahu anhu njofton se nxënësit në kohën e Hulefau'r-Rrashidin nuk i hidhnin majtas djathtas ujërat me të cilat kishin larë ajetet Kur'anore, por përkundrazi, i mbledhnin në një enë dhe i derdhnin në qoshe të varreve apo në burime të pastra që ishin hapur nëpër vende ku nuk shkelte këmba. Ata i përdornin këta ujëra edhe me nijetin për t'u shëruar. (Kettani, II, 200)



Para se të zbritet Kur'ani, populli i Mekkes e kishin bërë zakon që të varnin në muret e Qabes shtatë poezitë më kryesore që ishin në letërsi me emrin Muallekatu's-Seb'a. Njëra prej këkëtyre poezive ishte e Lebid bin Rabias. Poezitë e Lebidit kanë ngelur me shekuj të varur në Qabe. Kur Lebidi u nderua me mirësinë e besimit, ai nuk shkruajti më poezi nga shkak i madhërimit dhe i respektit që kishte për fjalën e Allahut. Poezia e tij e fundit ishte kjo strofë, të cilën e lexoi ditën kur u bë mysliman:

الْحَمْدُ لِلَّهِ إِذْ لَمْ يَأْتِنِي أَحَدِي  
حَتَّى لَبِسْتُ مِنَ الْإِسْلَامِ سِرْبَالًا





“Falenderimi i takon Allahut që nuk më mori vdekja derisa edhe unë veshva rrobën e ndritshme të Islamit.” (Ibn Abdilber, el-Istiab, III, 1335)



Sulejmani alejhisselam i dërgoi një letër mbretëreshës së Sebesë Belkisës, të cilën e ftonte në Islam. Në atë kohë Belkisa e cila adhuron-te putat, kur e lexoi letrën, tha:

“Zotërinj! Mua më ka ardhur një letër e nderuar. Atë ma ka dërguar Sulejmani. Ajo fillon me emrin e Allahut Mëshiruesit Gjithëmëshirshmit.”

Disa dijetarë, për shkak të respektit të saj kanë thënë:

“Belkisa u nderua me besim për shkak se e respektoi dhe e vlerësoi letrën e Sulejmanit.”



Hazreti Bishr Hafi, i cili ishte nga miqtë e Allahut, në fillim të jetës kishte qenë mëkatar. Një ditë, teksa po ecte në rrugë i dehur, gjeti mbi vete një letër mbi të cilën ishte shkruajtur besmeleja. E puthi atë dhe e vendosi në kokë. I hodhi erë të mirë dhe e fshehu në një vend të bukur. Atë natë pa ëndërr dhe dëgjoji një thirrje të tillë:

“Emrin Tim e mbulove me erë të mirë, e madhërove dhe e respektove atë. Edhe Unë do ta bëj emrin tënd të respektuar në të dy botët për hir të madhërisë sime.”

Kur Bishri u zgjua nga gjumi, u pendua dhe iu drejtua Allahut me besnikëri dhe sinqeritet. <sup>40</sup>



Gjyshërit tanë, të cilët e shprehnin në çdo lloj mënyre madhërimin që kishin ndaj Allahut Teala e të Dërguarit të Tij, sjellje që e kishin shndërruar në një ligj normal në jetën e tyre, për të treguar respekt, fjalën “Allah” nuk e kanë shkruajtur qartë në librat që kanë botuar. Duke menduar se librat mund të vendosen në tokë në vend të fjalës

40. Attar, Tezkiretu'l-Evlja, Tahrān 1372, fq. 128



“الله” kanë përdorur shkurtimin “اه”.



Siç tregohet, një ditë Ibrahim bin Ed'hemit i qëlloi të kalonte pranë Hazretit Imam Azam. Nxënësit që ishin pranë Ebu Hanifes e panë Ibrahim bin Ed'hemin me sy të përçmues dhe mospërfillës. Imam Azami e vuri re këtë dhe i thirri Ibrahim bin Ed'hemit:

“Urdhëroni i nderuar, na e nderuat kuvendin!”

Duke u ndjerë me turp, Ibrahim bin Ed'hemi dha selam dhe kaloi. Pasi u largua Ibrahim bin Ed'hemi, nxënësit e pyetën Imamin:

“Nga cili aspekt e meriton ky njeri cilësinë e nderimit? Si ka mundur që një njeri si ju t'i thotë atij i nderuar?”

Në lidhje me këtë, Imam Azam dha këtë përgjigje që shprehte ndjenjën e respektit që kishte për miqtë e Allahut dhe në të njëjtën kohë modestinë e tij të lartë:

“Ai gjithmonë është i përkushtuar ndaj Allahut në një lloj mënyre, ndërsa ne jemi të përkushtuar ndaj punës...”

Hazreti Imam Azami kishte qepur një rrobë prej një cope shumë të vlefshme dhe të bukur, me qëllim që ta vishte vetëm në namazet e natës. Kjo tregon edukatën, respektin dhe rëndësinë që u jepte adhurimeve, nga shkakuri i ndjenjës së madhërimit që kishte për Allahun.



Ahmed bin Hanbel rahmetullahi alejhi shkonte shpesh te miku i madh i Allahut, Bishr Hafi dhe bisedonte me të. Ai ishte i lidhur me të në kuptimin më të plotë. Një herë nxënësit i thanë:

“O Imam! Ti je një muxhtehid në shkencat e Kur'anit dhe Sunnetit. A të ka hije ty të shkosh te një njeri i zakonshëm?”

Imami i madh u përgjigj:

“Po, ato që thoni ju, unë i di më mirë se ai, por ai e njeh më mirë

Allahun se sa unë.”



Siç vihet re, Hazreti Imam Azami dhe Ahmed bin Hanbeli, për shkak të dashurisë dhe madhërimit që ndjenin kundrejt Allahut, i kanë respektuar robërit e Tij dijetarë dhe janë munduar të përfitojnë prej tyre duke i vizituar.



Shkretëtira Sina ishte një vend i tmerrshëm që nuk mund ta kalonte askush. Por me vendosmërinë dhe vendimin e prerë të Javuz Sulltan Selimit ushtria Osmane arriti të hynte në këtë shkretëtirë. Pas pak, Javuzi zbriti nga kali dhe filloi të ecë. Komandantët ishin të habitur dhe kishin frikë. Ata filluan të flisnin me njëri tjetrin: “Përse Sulltani zbriti nga kali dhe pse po ecën në këtë shkretëtirë, në të cilën edhe kali përgjaket ngaqë ecën me vështirësi?”. Kështu, zbritën edhe ata nga kuajt e filluan të ecin. Pashallarët i thanë Hasan Xhanit, i cili ishte miku i singertë i Javuzit:

“Pyete Sulltanin, ç’është kjo punë?”

Kur Hasan Xhani e pyeti i merakosur Javuzin për këtë, Javuzi u përgjigj:

**“A nuk po e shikon o Hasan, përpara nesh po ecën i Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem?! Kur Sulltani i botërave ecën në këmbë, si mund të qëndrojmë ne mbi kalë?”**



Tek Osmanët shenja e padishahut nuk ishte kurora. Edhe pse në shkrimet zyrtare përmendet fjala “kurorëmbajtësi”, padishahllëku i një padishahu realizohej me dhënien e besës dhe me lidhjen e shpatës. Kjo ka vazhduar kështu deri te Sulltan Vahiduddin, i cili ishte padishahu i 36-shtë Osman.

Pas çlirimit të Stambollit, vendi për lidhjen e shpatës u bë tyrbeja e Hazretit Ebu Ejjub el-Ensari. Për këtë arsye, ceremonive u thuhej “Shpata e Lartë”.

Shpata që padishahu i ri vendoste në brez, ishte shpata e Hazretit Omer radijallahu anhu, e cila ruhej ne Sarajin e Topkapësë. Kjo shpa-



të vendosej nga njeriu më fetar i asaj kohe, pastaj padishahu urohej me lutje me zë. Për urimet e atyre që nuk ishin muslimanë ngrihej një çadër në pjesën e brendshme të mureve të Edirnekapës. Sepse deri në “Urdhërin e Reformës” të vitit 1839, ata që s’ishin muslimanë nuk lejoheshin të hynin në vendet rreth Ejubit, sepse në këtë vend që konsiderohej i shenjtë si Haremu’sh-Sherif, ka shumë sahabi të varrosur që dihen dhe që nuk dihen. Domethënë ky vend është lagur me gjakun e sahabive të bekuar dhe është vendi ku kanë rënë dëshmorë.

Në kohën e Muratit IV, ndodh një përmbytje dhe të dy anët e Qabes shemben. Për këtë arsye, kryearkitekti Ridvan Aga dërgohet menjëherë në Mekketu’l-Mukerrame, për ta riparuar. Pasi bëri verifikimet e duhura, kur po tregonte vendet e rrëzuara, kryearkitektit i vinte turp të përdorte shprehje të tilla si “shkatërrim dhe rrëzim” për Qaben madhështore, kështu që dhe në vend të tyre përdori shprehjen:

**“Filan pjesë e Kabetullahit kanë rënë në vendin e sexhdes.”**

Gjatë riparimit ai pati treguar shfaqje respekti të rëndësishme si, marrjen e masave të nevojshme që kafshët e ngarkesës që mbartnin gjërat e nevojshme për rindërtimin, të mos i bënin pis ato vende të bekuara.

Në të vërtetë, adhurimi që Osmanët kishin për ata vende të shenjta fillonte që nga froni. Aq sa në udhëtimin e haxhit në atë kohë, vendit të parë gjatë kalimit nga pjesa Evropiane në atë Aziatike ia kishin vënë emrin “Harem”, duke iu përshtatur ndjenjave dhe edukatës së Haramejni’sh-Sherifejn, dhe në këtë rrugë nuk është pranuar asnjë lëvizje që shprehte pakujdesi.



Në vitin 1678, poeti Naibi nisi udhëtimin e haxhit bashkë me liderët e shtetit. Kur karvani po i afrohej Medines, Naibin nuk e merrte gjumi nga emocioni. Në karvan ai pa një padishah i cili e kish drejtuar këmbën pa dashje drejt Medinetu’l-Muneveras. I ndikuar shumë nga kjo gjendje, ai nisi të shkruajë poezinë e tij të njohur.

Afër namazit të sabahut, kur iu afruan Medinetu’l-Muneveras, Naibi dëgjoi i habiutur se nga minaret e Xhamisë së Pejgamberit po



këndohej pikërisht poezia që kishte shkruajtur:

*“Largohu nga mosrespekti i edukatës së këtij vendi i cili është vendi ku shikon Zoti, është vendi i Hazretit Muhammed Mustafait !..”*

*“O Nabi, hyr në këtë vend duke iu përshatur rregullave të edukatës! Ky vend është një vend i shenjtë që e kanë puthur pejgamberët dhe ku shpirtërat e shenjtë sillen rreth e rrotull si flutura.”*

Poeti Nabi, i cili i cili u prek shumë nga ky fakt, takoi menjëherë muezinin, të cilin e pyeti:

“Si dhe nga kush e ke mësuar këtë poezi?”. Muezini tha:

“I Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem erdhi këtë mbrëmje në ëndërr dhe na tha:

*“Mua po më vjen për vizitë një poet nga ummeti im me emrin Nabi. Ky person është shumë i mbushur me dashuri, admirim dhe respekt ndaj meje. Për këtë shkak, priteni atë me poezinë e tij, duke e lexuar nga minaret e xhamise sime!..”* Kështu, ne e zbatuam këtë urdhër profetik.

Nabi filloi të qante me zë të lartë. Teksa qante, ai thoshte:

“Domethënë, i Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem më tha mua “ummeti im”. Domethënë, dielli i dy boëtrave më pranoi ummet të tij!..”



Abdulhaziz Han, i cili ishte i fundit i Osmanëve, ishte i lidhur me shumë dashuri dhe respekt ndaj Pejgamberit sallallahu alejhi ue sellem. Kur një ditë ai kishte rënë në shtrat i sëmurë, në një gjendje te venitur e të zbehtë, iu tha:

“Ka një kërkesë nga shërbëtorët e Medinetu’l-Munewveres!” Pasi e dëgjoi këtë, Sulltani mblodhi të tëra fuqitë e tij dhe shfaqti dashurinë e respektin që kishte për Medinen dhe Hazretin Pejgamber sallallahu alejhi ue sellem, duke u thënë shërbëtorëve këto fjalë:

**“Më ngrini menjëherë në këmbë! Dua t’i dëgjoj në këmbë kërkesat që kanë ardhur nga Haramejni! Kërkesat e komshinje**



të Pejgamberit nuk dëgjoen duke shtrirë këmbët në mënyrë të paedukatë!...”

Sa herë që vinte posta e Medinetu’l-Munevveres, ai merrte abdest duke thënë: “**Te këto ka pluhur të bekuar të Medinetu’l-Munevveres**”, i puthte dhe i vinte në ballë. Pastaj ia jepte ato postarit dhe i thoshte: “Hape dhe lexoje!”



Respekti që kishin gjyshërit tanë për dijetarët dhe të devotshmit, duhet të përkujtohet. Djalit të tij Osman Gazit dhe të gjithë atyre që do të vinin në vendin e tij, Ertugrull Gazi i dha këtë këshillë të vlefshme në çështjen e përkujdesjes ndaj miqve të Allahut:

*“Shiko bir! Mua më lëndo, por jo shejhun Edebal! Ai është dielli i ndjenjave shpirtërore për farefisin tonë. Peshorja e tij nuk gabon.*

*Mua më kundërshto, por atë jo! Nëse më kundërshton mua, mërzitem, lëndohem; nëse e kundërshton atë, sytë e mi nuk të shohin më!*

*Fjala jonë nuk është për Edebalin, por është për senxhegin. Këto që të thashë, quaji si këshilla!..*



Edhe Osman Gazi i pati dhënë këtë këshillë djalit të tij Orhan Gazit:

*“...Respektojini dhe nderojini dijetarët e devotshëm, të cilët i japin forcë shpirtërore shtetit. Nëse dëgjon se në një vend tjetër ka një dijetar, një të mençur apo një mik të Zotit, ftoje atë në shtetin tënd me njerëzi dhe edukatë. Feja dhe punët e shtetit le të administrohen me bereqetin dhe ndihmën e tyre!..”*



Në kohën e Orhan Gazit, një mik i njohur i Allahut, i cili quhej Gejikli Baba, banonte në Ulludag. Orhan Gazi i cili dëgjoji për famën e tij, i dërgoi lajm dhe e ftoi. Por ky mik i Allahut, i cili rrinte me drerët,



nuk e pranoi ftesën. Për më tepër, ai dërgoi këtë lajm. “As Orhani të mos vijë tek unë.”

Orhan Gazi u bë merak dhe pasi e pyeti me habi për shkakun, mori këtë përgjigje:

*“Dervishët janë njerëz mendjemprehtë, janë njerëz që e kanë zemrën të lidhur me Zotin. Është e nevojshme që ata të sillen siç duhet. Në të këndërt, nëse ndahen nga rruga e Islamit, nuk u pranohen lutjet. Ndërsa ju jeni mbrojtësit e ummetit. Pra ju jeni ushtarë të kufinjve ndërsa ne ushtarë të lutjes. Fitoret korren nga përpjekja e përbashkët e ushtarëve të lutjes dhe ushtarëve të kufinjve. Siç pajisen me dije luftime dhe guxim ushtarët e kufinjve, për të arritur këtë sukses, edhe ushtarët e lutjes duhet të mbahen larg nga frymëzimi dhe dashuria e kësaj bote. Për këtë arsye, kam frikë se dhuratat që do të më jepni kur të vij te ju, në zemrën e dervishave fut dashurinë e kësaj bote dhe pakëson dashurinë për ahiretin. Kështu që edhe ne edhe ju do të humbasim... O Sulltani im! Dijeni se kur të vijë koha, do të takohemi inshallah.”*

Pas një farë kohe, Gejikli Baba erdhi në Bursa dhe mbolli një rrap në oborrin e Orhan Gazit. Sulltanit i treguan për këtë. Orhan Gazi menjëherë erdhi aty. Gejikli Baba i tha:

“E mbolla për bereqet. Përsa kohë që ky rrap të jetë këtu, ndoshta lutjet që dervishët bëjnë për ju do të pranohen.”

Edhe pse Gejikli Baba i kishte thënë se nuk pranon dhurata, Orhan Gazi i propozoi inegëlin dhe vendin rreth tij. Por Gejikli Baba i cili e kishte syrin dhe zemrën të ngopur, nuk e pranoi duke i thënë:

“Prona është e Allahut. Ai ua jep të aftëve. Ne nuk mund jemi të aftë për këtë.”

Sulltani këmbënguli. Pas kësaj, Gejikli Baba u frikësua se mospranimi i asaj që iu dha është mendjemadhësi, prandaj tha:

“Vendet që nga kodra përballë teje e deri diku këtu afër, le të jetë oborri i dervishëve!”

Orhan Gazi, i cili nuk kishte mangësi në respektin ndaj miqve të Allahut, e formonte forcën themelore të shtetit bashkë me ta. Pasi



Gejikli Baba ia pranoi dhuratën, ai e kapi për duarsh me gëzim të madh dhe e puthi, e puthi, e puthi... Edhe pasi ai vdiq, i bëri një tyrbe dhe një xhami. Kjo tyrbe vizitohet ende sot.

Historia dëshmon se respekti që sulltanët Osmanë kishin për miqtë e Allahut, përbën një nga shkaqet kryesore që atyre u jepej ndihma hyjnore.



Respekti që Fatihu kishte për Hazretin Akshemseddin ishte shumë i lartë. Edhe fjalët që u tha të pranishmëve ditën kur çliroi Stambollin, janë shumë interesante:

*“Gëzimi dhe qetësia që po shikoni te unë nuk janë për shkak të çlirimit të kësaj kalaje, por për shkak se një mik i nderuar dhe i begatë i Allahut si Akshemseddini, është në kohën time dhe bashkë me mua...”*



Kemal Pashazade i cili ishte nga dijetarët e njohur Osmanë, më parë kishte qenë një ushtar i mirë, por pastaj e la këtë profesion dhe u dha krejtësisht pas dijes. Në disa tekste të tij ai na e sqaron kështu arsyen pse e kish bërë një zgjidhje të tillë:

“Isha në një fushatë lufte nën drejtimin me Sulltan Bayezid Han Veli. Pranë Sulltanit ishte veziri i tij Ibrahim Pasha dhe Evranosoglu, që ishte një nga komandantët e njohur. Evranosoglu ishte një komandant, të cilit askush nuk i kalonte përpara dhe askush nuk mund të ulej para tij në kuvende. Por në atë kohë, erdhi një dijetar me rroba të vjetra dhe u ul përpara komandantit. U habita shumë kur vura re se askush nuk i tha gjë dhe as nuk e ndaloi. I Pyeta ata që i kisha afër:

Kush është ky njeri që guxon të ulet përpara një komandanti si Evranosoglu? Më thanë:

-Është një dijetar, një i devotshëm që quhet Molla Lutfi! Thashë:

-Sa rrogë merr?” Më thanë:

-Tridhjetë dirhem. Thashë me habi:





-Si ka mundësi që një njeri me kaq pak pozitë mund të kalojë përpara një komandanti të pashoq? Atëherë më thanë:

**-Dijetarët respektohen kështu për shkak të madhështisë së dijeve fetare që kanë. Në fakt edhe zemra e pashait dhe e komandantit, e cila ishte e mbushur me besim, me dije dhe edukatë, nuk do të kënaqeshin po të ndodhte ndryshe!..**

Në lidhje me këtë, duke u mbështetur në ndjenjën se vlera ime nuk do të mjaftojë për t' u bërë si këta komandantë, porse në fushën e dijes mund të bëhesha shumë i njohur, e lashë ushtrinë dhe fillova të përkushtohesha ndaj dijes.”

Pas kësaj zgjedhjeje, Kemal Pashazade arriti në dije gradën “faridu’l-asrihi: i vetmi në kohën e tij”. Pas vdekjes së Zenbilli Ali Efendit ai u bë shejhulislami i nëntë i shtetit Osman.



Kur një ditë Sulltani I Ahmed Hani po shkonte në Yskydar, u takua në treg me Hazretin Aziz Mahmud Hydajin. Duke zbritur menjëherë nga kali, ai vuri shejhun në kalë dhe vetë filloi të ecë pas tij. Zemra e Hazretit Hydaji nuk ishte e kënaqur që padishahu i madh ecte në këmbë dhe pas një farë kohe zbriti nga kali duke thënë:

“Hypa në kalë vetëm që të pranohet lutja e shejhut tim dhe të zbatohet urdhëri i sulltanit tim!” Kështu që u pranua edhe lutja e shejhut të tij:

“Biri im! Padishahët ecshin pas teje!”.



Sulltani I Ahmed Hani kishte një respekt dhe nder të veçantë për Hazretin Aziz Mahmud Hydajin. Një ditë, ai po bisedonte me Hazretin Aziz Mahmud Hydajin në saraj. Në një çast, teksa Hazreti Aziz Mahmud Hydaji deshë të merrte abdest, i sollën ibrikun dhe legenin. Padishahu e mori ibrikun dhe i hodhi ujë, në shenjë respekti ndaj tij, ndërsa nëna e Sulltan Ahmed Hanit kishte bërë gati peshqirin në hamam. Në atë çast, Valide Sulltanit i erdhi në zemër kjo dëshirë:



*“Ah sikur të mund të shikoja një keramet të Hazretit Aziz Mahmud Hydajit!”* Hazreti Hydaji, me mirësinë e Allahut dhe duke e ditur se çfarë i erdhi në zemër Valide Sulltanit, tha:

*“Çudi! Disa presin keramet prej nesh. Por a ka keramet më të madh se sa të të hedhë ujë Halifeja e tokës dhe nëna e tij e nderuar të të përgatiti peshqirin?”*



Komandanti i pozitës së përforcuar së Çanakkales, Mirliva Xhevat Pasha, në një farë çasti kur ndjehej shumë i dëshpëruar prej bombardimeve të flotës armike që po zvarritej në ngushticë, ra në një gjumë të lehtë nga shkaku i lodhjes së tepërt. Në ëndërr dëgjoi një zërin e një engjëlli, që i tha:

**“O Xhevat! Ju e respektoni dhe e madhëroni fjalën e lartë të Allahut. Për këtë arsye ju përgëzoj me ndihmën e Allahut! Pa shiko mbi det!”**

Xhevat Pasha, kur pa errësirën e detit, në mes të një drite pa shkronjat kef dhe vav. Pastaj u zgjua. Të nesërmen kur po lexonte Fatihanë në krye të një varri, Xhevat Pasha e dëgjoi sërish zërin që pati dëgjuar në ëndërr:

**“O Xhevat Pasha! Vendosi në det 26 municionet që janë në depo!”**

Ai u emocionua. E pa veten në një gjendje të pakuptueshme shpirtërore. Kur po mendonte se si ta zgjidhte këtë situatë, takoi pak më tutje takoi një njeri me fytyrë të ndritshme. Ai iu afrua Pashait dhe e pyeti nëse kishte ndonjë hall. Pashai i tregoi gjithçka kishte ngjarë. Ai mik i Allahut e shpjegoi përmes dijes shpirtërore atë gjë të pakuptueshme që kishte parë Pashai:

**“Biri im! Drita që ke parë mbi det është shenja e fitores sonë. Ajo tregon se qafirrat nuk do të mund t'i marrin këta toka. Ndërsa shkronjat kef dhe vav sipas llogarisë alfabetike bëjnë 26. Atëherë 26 municionet që janë në depo vendosi në errësirën e gjirit, gjë që ka për të mundësuar një nga sulmet më të mëdha të fitores sonë.”**



Pas këtyre fjalëve, personi me fytyrë të ndritur u zhduk çilembyll sytë.

Nëse sipas logjikës normale municionet duhej të viheshin vertikalisht në ngushticë, sipas kësaj ëndërre ato duhej duhej të vendoseshin paralel me tokën, në errësirën e gjirit. Në të vërtetë ky ishte vendi më pasiv i ngushticës në pikëpamje strategjike, pra aspak i përshtatshëm.

Xhevat Pasha, cili iu dorëzua kësaj shfaqjeje shpirtërore, dha urdhër që të vendoset municioni, pa humbur kohë. Anija Nusret Majën e cila ishte nën komandën e kapitenit Hakki Bej, e kreu detyrën e saj në mënyrë të shkëlqyer. Në mesnatë secili nga municionet u vendos në det me tekbir. Atë mëngjes, pasi e kreu detyrën e tij, kapiteni Hakki Bej ra shehid për shkak të krizës në zemër.

Të nesërmen, kur anijet luftareke hynë në ngushticë, municioni që ishte vendosur natën filloi ta bënte të vetën. Në fund të betejës, pjesa më e madhe e anijeve luftarake të armikut u varrosën në ngushticë bashkë me armatimet e veta. Në këtë mënyrë arriti të thyhej sulmi i armikut.

Winston Churchill, më 1930 në revistën “Revue de Paris” e analizon kështu këtë ngjarje:

“Në luftën e Parë botërore, shkaku kryesor për vdekjen e gjithë atyre njerëzve, për shpenzimet shumë të rënda të luftës dhe për mbytjen e pesë mijë anijeve tregtare dhe luftarake, janë 26 municionet që ishin lidhur në majë të një teli çeliku të hollë dhe që ishin hedhur një natë para nga Turqit.”

Ja bereqeti i respektit dhe madhërimit që bëhet ndaj fjalës së Allahut Teala...



Së fundi, gjëja më e rëndësishme që urdhërohet në Kur'an pas besimit është vepra e mirë. Edhe pas istigfarit ajo që duhet të bëhet është vepra e mirë. Domethënë, lartësimi i gradave të robërve të Allahu Teala dhe pranimi i istigfarit është në vazhden e veprave të mira.



Ndërsa puna e mirë shkurtimisht është “tadhim li-emrillah ve shefkat ala halkillah”, domethënë zbatim me respekt i urdhërave të Allahut dhe shërbimi me dashuri dhe mëshirë ndaj krijesave të Allahut.

#### 4. Mbajtja e amanetit dhe premtimit

Amaneti dhe besimi vijnë nga e njëjta rrënjë. Fjala “mumin” (besimtar) është emri i përgjithshëm i atyre që besojnë Allahun dhe në të njëjtën kohë është një nga emrat e bukur të Allahut që tregon se Ai është burimi i sigurisë, që robërve të Tij u jep siguri. Ai që u dha cilësinë “besnik” Pejgamberëve të tij, domethënë Ai që i bën besnikë është Allahu. Kështu që edhe fjala *besimtar* do të thotë njeri që beson, njeri që i lihet amaneti, njeri që jep siguri dhe që është besnik.

Ebu Musa radijallahu anhu thotë:

E pyeta të Dërguarin e Allahut: “O i Dërguari i Allahut! Kush është më i miri i myslimanëve?” Ai m’u përgjigj:

*“Është ai në gjuhën dhe në dorën e të cilit myslimanët janë të sigurtë.”* (Buhari, Iman, 4, 5, Rikak 26; Muslim, Iman 64, 65)

Besnikëria dhe mbajtja e amanetit, domethënë besnikëria ndaj fjalës së dhënë dhe marrveshjeve, përbën një nga çështjet themelore të jetës individuale dhe shoqërore. Rendi i shoqërisë është i lidhur me respektin e njerëzve besnikë dhe mbajtjen e premtimeve. Po të mos kish qenë kjo cilësi, nuk do të mund të mendohej kurrë se do të mund të mbahej feja apo të rregullohej bota.

Duke e shtjelluar cilësinë “besnikëri” të pejgamberëve, në ajetet fisnike thuhet kështu:

**“Unë po transmetoj atë që më ka shpallur Zoti juaj dhe jam një këshillues besnik për ju.”** (el-A’raf, 68)

**“Padyshim, unë jam një pejgamber besnik i dërguar te ju.”**  
(esh-Shuara, 107)<sup>41</sup>

Nga një tjetër pikëpamje, këto cilësi të bukura janë po ashtu edhe dispozita të ummetit të Muhammedit, sepse Pejgamberi ynë i Nderuar është thirrur me këtë emër dhe është njohur me cilësinë “**besnik** edhe para periudhës së profetësisë”.

Krahas amanetit, edhe bajtja e premtimit është një cilësi e rëndësishme. Duke urdhëruar për mbajtjen e fjalës së dhënë, Allahu thotë:

**“O ju që keni besuar! Mbajini premtimet tuaja!..”** (el-Maide, 1)

**“...Mbajeni fjalën e dhënë, sepse premtimi ka përgjegjësi.”**  
(el-Isra, 34)

Njërën nga cilësitë e besimtarëve që kanë arritur shpëtimin, Allahu e ka shprehur kështu:

**“Ata e mbajnë amanetin dhe marrëveshjen.”** (el-Mu'minun, 8)

Asnjëherë nuk duhet të harrojmë se të gjitha premtimet e dhëna dhe çdo lloj marrëveshje, në të njëjtën kohë do të thotë premtim ndaj Allahut. Patjetër duhet t'u përshtatemi dhe t'i kryejmë me përpikmëri premtimet dhe marrëveshjet që janë bërë përpara Allahut.

Allahu e ka vlerësuar dhe nderuar Ibrahimin alejhisselam me ajetin:

**“Ibrahimi i cili ishte shumë besnik (e mbante premtimin)...”**  
(en-Nexhm, 37)

Pejgamberi ynë i Nderuar u ka dhënë këtë përgëzim tregtarëve besnikë dhe të drejtë:

*“Një tregtar mysliman që është i çiltër, i drejtë dhe besnik, në ditën e kiametit do të jetë bashkë me pejgamberët, të sinqertët dhe dëshmorët.”* (Tirmidhi, Buju, 4/1209; Ibn Maxha, Tixharat, 1)

Në të kundërt, ka kritika shumë të tmershme për ata që nuk janë besnikë dhe që nuk e mbajnë fjalën. I Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem ka thënë:

**“Ai që nuk e mban amanetin, nuk ka as besim”** (Ahmed, III, 135)

Nëse mjedisi nuk ka besë te një person, kjo tregon shenjën e dobësimit të besimit të tij, të humbjes së dinjitetit dhe të ndjeshmërisë



së tij Islame. Tashmë te ai ka ngelur vetëm emri i besimit, esenca e adhurimeve i është boshatisur dhe nuk i ka ngelur asgjë tjetër përpos shfaqjes së hipokrizisë dhe shtirjes. Sa bukur e shpreh këtë çështje hazreti Omer radijallahu anhu:

“Mos shikoni namazin dhe agjërimin e dikujt! Shikoni nëse thotë të vërtetën kur flet, a e mban amanetin që i jepet dhe a kujdeset për hallallin dhe haramin në këtë botë.”<sup>42</sup>

Nëse nuk shërohemi nga nëpërkëmbja e amanetit dhe mosmbajtja e premtimit, në fund fare kjo gjëndje mbërrin deri në hipokrizi, që është vesi më i keq. Në hadithet e tij, Pejgamberi sallallahu alejhi ue sellem ka thënë:

*“Janë katër vese të cilat, nëse gjenden te një njeri, e bëjnë atë njeri plotësisht hipokrit. Nëse dikush nga ju ka njërin nga këto vese, kjo do të thotë se te ai ka një ves hipokrizie. Kështu, kur i jepet një amanet, tradhëton. Kur flet, gënjen. Kur premtton, nuk e mban premtimin. E tepron në armiqësi dhe bën padrejtësi.”* (Buhari, Iman 24, Medhalim 17; Muslim, Iman 106)

*“Allahu Teala thotë: Në ditën e kiametit unë jam armiku i njerëzve që i përkasin këtyre tri grupeve: I grupit të personave që betohen në emrin Tim dhe nuk e mbajnë betimin, i grupit të personave që hanë pasurinë e një njeriu të lirë duke e shitur si rob, dhe grupi i atyre që punësojnë një punëtor dhe pastaj nuk i japin pagesën atij.”* (Buhari, Buju 106, Ikhare 10)

Domethënë besnikëria dhe mbajtja e premtimit është dispozitë e Islamit. Tradhëtia dhe mosmbajtja e fjalës nga ana e një besimtari, është një cilësi e keqe që e zemëron shumë Allahun Teala dhe që e zvarrit njeriun në fundin e xhehennemit.

### *Tabllo të virtytshme*

Edhe para profetësisë i Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue se-



llem ishte më i larti i popullit nga pikëpamja e heroizmit, më i nderuari dhe nga pikëpamja e prejardhjes farefisnore, më i miri nga pikëpamja e moralit. Ishte ai që e respektonte më shumë të drejtën e komshiut, ishte ai më i larti në butësi dhe në mbajtjen e fjalës, ishte ai më i miri në siguri dhe besnikëri dhe ishte ai njeriu që nuk poshtëronte dhe nuk i bënte keq askujt. Nuk është parë kurrë që të ketë përgënjeshtuar padrejtësisht një njeri apo të ketë bërë debat me ndokënd. Populli i tij e pa të përshtatshme për Të cilësinë “besnik”, për arsye se Allahu kishte mbledhur tek ai të gjitha vetitë dhe cilësitë e bukura.<sup>43</sup>

Cilësia “besnik” pothuajse ishte bërë emri i dytë i Hazretit Pejgamber. Kur Krenaria e Gjithësisë sallallahu alejhi ue sellem mbushi 25 vjeç, në Mekke e thërrisnin vetëm me emrin “el-Emin” (besnik).<sup>44</sup> Sa herë që bëheshin në Qabe, kur e shihnin duke ardhur, gëzoheshin dhe thonin “Po vjen el- Emini!”. Për çdo çështje që kishin mbështeteshin tek ai dhe këshilloheshin me të. Krahas ashabëve të nderuar që ishin gati të flijonin për të shpirtin, pasurinë dhe çdo gjë të tyre, edhe armiqtë që donin ta vrisnin atë nuk kanë thënë asgjë kundër besnikërisë së tij.

Shprehja “**Muhammedu’l-Emin**” që përdorej për të Nderuarin tonë, nuk hiqej as nga gjuha e mushrikëve, të cilët amanetet e tyre nuk ua jepnin njerëzve të tyre, por të Dërguarit të Allahut. Madje, kur Hazreti Pejgamber alejhissalatu uesselem do të shpërngulej, kishte disa amanete të mushrikëve. Edhe pse ishte rrezik vdekjeje, ai e la Hazretin Ali në Mekke për t’ua dorëzuar amanetet mushrikëve.<sup>45</sup>



Abdullah bin Ebi’l-Hamsa na tregon një nga ngjarjet më shembullore që i jepnin të Dërguarit të Allahut cilësinë el-Emin dhe es-Sadik (i singertë):

“Para se t’i vinte shpallja, pata blerë diçka nga i Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem. U ndava prej tij duke i premtuar se do t’ia sillja menjëherë nëse priste pak. Por kisha harruar fjalën që i kisha

43. Ibn Hishan, I, 191; Ibn Sa’d, I, 121

44. Ibn Sa’d, I, 121, 156.

45. Për detajet e ngjarjes shik. fq. 24-25 të librit.



dhënë. Pas tri ditësh m'u kujtua dhe kur shkova në vendin ku kishim folur, e gjeta duke pritur në të njëjtin vend. I Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem nuk më qortoi për këtë që bëra, por vetëm më tha:

*-O djalosh! Më ke munduar. U bënë tri diët që po të pres këtu.* (Ebu Davud, Edeb, 82/4996)

Pejgamberi ynë i Nderuar sallallahu alejhi ue sellem i cili qëndronte në kulmin e paarritshëm të mbajtjes së besës dhe emanetit, nuk kishte pritur për të marrë ato pak para. Ajo që e shtyu Pejgamberin të presë tri ditë, ishte ndjenja e lartë në çështjen e mosdaljes nga fjala.



Huzejfe radijallahu anhu tregon:

“Patëm marrë rrugën nga Mekka për në Medine bashkë me babain tim Husejlin. Qafirët, Kurejshit na kapën dhe na thanë:

-Pa dyshim që ju doni të bashkoheni me njerëzit e Muhammedit.

Ne thamë:

-Jo, ne nuk po shkojmë në Medine për këtë shkak, por për një punë. Kështu, ata na detyruan t'u jepnim fjalën se nuk do të bashkoheshim me të Dërguarin e Allahut dhe se nuk do të luftonim me bashkë me Të. Kur erdhëm në Medine dhe i treguam të Dërguarit të Allahut në lidhje me këtë, Sulltani i Botrave, i Nderuari ynë tha:

*-Shkoni! Ne e mbajmë fjalën që kemi dhe lusim Allahun që të na ndihmojë kundër atyre! Ja pra, ky është shkaku që unë nuk kam marrë pjesë në luftën e Bedrit.*” (Muslim, Xhihad, 98)



Sapo ishte bërë marrëveshja e Hudejbijes dhe nenet ishin në shkrim e sipër. Në atë moment Ebu Xhendel, i cili ishte i biri i përfaqësuesit të Kurejshitëve Suhejl bin Amrit, duke i tërhequr zvarrë e me mundim zinxhirët që kishte nëpër këmbë, erdhi pranë Pejgamberit tonë të Nderuar. Ebu Xhendelin e kishin torturuar shumë për shkak se ishte bërë mysliman. Ai kishte prej tyre dhe kish ardhur te myslima-





nët, sapo kish gjetur rastin. Suheyli tha se sipas marrëveshjes, njeriu i parë që duhet të kthehej ishte biri i tij dhe me shkopin që kishte në dorë, i ra në fytyrë Ebu Xhendelit. Pejgamberi i mëshirës sallallahu alejhi ue sellem i cili i ndiqte ngjarjet i brengosur, iu lut atyre disa herë me këmbëngulje që Ebu Xhendelin ta linin jashtë marrëveshjes dhe t'ia jepnin Atij, por mushriku zemërgur nuk e pranoi këtë. Kur Ebu Xhendeli radijallahu anhu po u dorëzohej mushrikëve, thërriste dhe u përgjerohej myslimanëve duke kërkuar ndihmë prej tyre. Teksa zemra po i copëtohej, ai pyeti në një mënyrë shumë të hidhur:

“A do të më hidhni përsëri në zjarrin e dhunës? Myslimanët nuk mundën ta përballonin më gjendjen e tij dhe filluan të qajnë. Në këtë çast, kur askush nuk mund të bënte asgjë, i Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem e këshilloi Ebu Xhendelin me fjalët:

*“O Ebu Xhendel! Duro edhe pak! Shpreso nga Allahu shpërblimin e kësaj! Patjetër që Allahu i lartë do të krijojë një rrugë për ty dhe për myslimanët e dobët dhe të vetëm që janë si ti në Meke. Ne kemi bërë një marrëveshje paqeje me këtë popull dhe atyre u kemi dhënë besën në emër të Allahut. Edhe ata na kanë dhënë besën në emër të Allahut. Ne nuk mund ta thyejmë besën tonë, sepse tradhëtia nuk na ka hije!”* (Ahmed, IV, 325; Vakidi, II, 607-608; Ibn Hisham, III, 367; Belazuri, I, 220)



Pas marrëveshjes së Hudejbijes, edhe një mekkas që quhej Ebu Basir, ishte bërë mysliman dhe qe strehuar në Medine, por Hazreti Pejgamber sallallahu alejhi ue sellem, sipas marrëveshjes ishte i detyruar tua dorëzonte atë mushrikëve. Edhe Ebu Basir, duke mos e kuptuar këtë që po bënte i Dërguari i Allahut, e shprehu habinë e tij me këto fjalë:

“A doni të më ktheni mua te adhurimi i putave?”. I Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem e ngushëlloi në mënyrë të qetë:

*“O Ebu Basir! Ne nuk mund ta prishim marrëveshjen, por ti duro pak. Patjetër që Allahu Teala do t'ju tregojë një rrugë paqeje ty dhe atyre si ti.”*

Pas këtyre fjalëve, Ebu Basir iu bind urdhërit të Pejgamberit pa



bërë zë. Ai iu dorëzua mushrikëve duke pasur parasysh edhe gjendjen e myslimanëve të tjerë. Por ai po dërgohej në Mekke drejt vdekjes. Ai e dinte këtë, ndaj duke shfrytëzuar një rast që iu dha gjatë rrugës, i sulmoi ata që po e dërgonin. Ai vrau Hunejsin, njërin prej atyre që po e shoqëronin, ndërsa tjetri i iku. Ebu Basir mori rrobat, gjërat dhe shpatën e Hunejsit dhe ia solli të Dërguarit të Allahut duke i thënë:

O i Dërguari i Allahut! Merr një të pestën e këtyre dhe mbaje për vete!” I Nderuari ynë tha:

*“Nëse unë e marr një të pestën e kësaj, do të thotë se unë e kam prishur marrëveshjen që kam bërë me ata, por ti je në një situatë të ndryshme. Prandaj qëndrimi që do të mbash dhe plaçkat e atij që ke vrarë, të përkasin vetëm ty.”* (Vakidi, II, 626-627)

Ebu Basir i cili veproi me zgjuarsi dhe pas një farë kohe, doli nga Medineja. Ai u vendos në një vend që quhej Is në mes Mekkes dhe Shamit. Pas një kohe të shkurtër, ai vend u bë një vendstrehimi i pamvarur. Edhe Ebu Xhendeli për të cilin folëm më parë, arriti të shpëtonte nga dora e dhunuesve dhe shkoi te Ebu Basiri. Kështu, pa kaluar shumë kohë numri i myslimanëve arriti në treqind. Rrugat tregtare e Mekkasve për në Sham u bë e rrezikshme. Në këtëkohë, mushrikët Mekkas që kishin ngelur pa rrugëdalje erdhën te Pejgamberi ynë i Nderuar dhe kërkuan që të hiqej neni i kësaj çështjeje. Domethënë, kërkuan që të pranohen në Medine ata që bëheshin myslimanë dhe që iknin nga Mekka. Kësisoj, neni të cilin në fillin myslimanët nuk e donin dhe i bënte të ndjeheshin keq, u kthye pro tyre për shkak se kishin mbajtur marrëveshjen.<sup>46</sup>

Siç u pa, besnikëria që kishte Pejgamberi ynë i Nderuar për marrëveshjen u shndërrua në mëshirë dhe bereqet për të gjithë besimtarët.



Gjatë çlirimit të Hajberit, Jesari, i cili siguronte jetesën duke ruajtur delet e të pasurve të parisë çifute, një mëngjes teksa po kulloste delet jashtë kalasë u takua me Pejgamberin tonë të Nderuar. Pasi biseduan një farë kohe, Jesari pranoi Islamit. I Dërguari i Allahut sallallahu alej-



hi ue sellem ia vuri emrin “Eslem”. Pastaj çobani pyeti se çfarë duhet të bënte me delet që kishte. I Dërguari i Allahut i tha:

“Ktheji prapa dhe lëri të lira. Mos ki fare merak, sepse të gjitha do të shkojnë tek të zotët e tyre.” Eslami mori një grusht çakëll, ua hodhi deleve dhe tha:

“Kthehuni te të zotët tuaj! Për Zotin, tani e tutje kurrë nuk do të jem me ju. Delet ikën të gjitha dhe hynë në kala sikur të qe duke i shoqëruar dikush. Eslami radjallahu anhu, sapo u bë mysliman, menjëherë mori pjesë në xhihad dhe pas disa kohësh ra dëshmor.<sup>47</sup>

Edhe duke qenë kohë lufte, pra shumë e vështirë të siguroje ushqim, i Dërguari i Allahut ua dërgoi të zotëve të tyre delet e armikut që i erdhën deri te këmbët. Edhe çobani nuk e tradhëtoi atë me të cilin kishte bërë marrëveshje, sepse kjo i shkonte Pejgamberit që ishte “el-Emin” (besnik) dhe ummetit të tij që ishte “Mumin”.



Kur u çlirua Mekka, Pejgamberi ynë i Nderuar i dërgoi lajm Osman bin Talhas, i cili kishte çelësin e Qabës, që t’ia sillte atij. Osmani, duke pasur frikë se çelësi nuk do t’i jepej më, tha:

“Unë po ta jap si amanet i Allahut!” (Vakidi, II, 833; Hejsemi, VI, 177)

I Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem hyri në Qabe, fali namaz dhe pasi doli, mbajti një hytbe për çlirimin. Në fund të hytbes pyeti:

“*Ku është Osmani?*” Osman bin Talha u ngrit në këmbë. I Dërguari i Allahut, lexoi ajetin:

“Allahu ju urdhëron që t’ua jepni amanetin të zotëve të tyre dhe kur të gjykoni mes njerëzve, ju urdhëron të gjykoni me drejtësi. Sa e mirë është kjo që ju këshillon Allahu. Allahu dëgjon dhe sheh si veproni.” (en-Nisa, 58) tha:

“*O bijtë e Ebu Talhas! Merreni këtë amanet të Allahut që të qëndrojnë te ju dhe silluni drejt. Askush nuk mund t’jua marrë atë për sa*

47. Ibn Hisham, III, 397-398; Ibn Haxher, el-Isabe, I, 38-39.



*kohë që s' bëheni dhunues. Sot është dita e mirësisë dhe e mbajtjes së premtimit.*” Pas këtyre fjalëve ai ia dha përsëri çelësin e Qabes Osman bin Talhas. (Ibn Hisham, IV, 31-32; Vakidi, II, 837-838; Ibn Sa'd, II, 137)

Edhe pse shumica e parisë së ashabëve e pranonin shërbimin ndaj shtëpisë së Allahut si nderin më të lartë dhe si një detyrë të shenjtë, donin që çelësi t'u jepej atyre, por i Dërguari i Allahut ia dha amanetin të zotit. Të gjithë njerëzit u habitën për ndjenjën e drejtësisë që shfaqti, aq sa disa prej tyre u nderuan me besim.



Duke qenë se Mekkeja u çlirua me paqe, asnjë gjë nuk u mor ganimet (plaçkë lufte).<sup>48</sup> I Nderuari ynë mori nga të pasurit e Mekkes shpërblime, para dhe parzmore, për të plotësuar nevojat e ushtrisë Islame. Më vonë e pagoi plotësisht nga ganimetet Hevazin dhe tha:

*“Kundërvlera e shpërblimit është falenderimi dhe pagimi i tij!”*  
(Vakidi, II, 863; Ebu Davud, Buju', 88/3562; Muvatta, Nikah, 44)

Të pasurit që dhanë borxh u shqetësuan se mos ndonjë komandant i fuqishëm do t'ua merrte pasurinë, por pa kaluar shumë kohë u bindën se i Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem ishte “el-Emin” (besnik).



Kur Musai alejhisselam erdhi ne Medjen, pa shumë njerëz që po u jepnin ujë bagëtime. Prapa tyre pa dy vajza që po prisnin për t'u dhënë edhe ato ujë bagëtime. Ata nuk afroheshin, duke pritur derisa të iknin çobanët. Hazreti Musa i ndihmoi ato. Ato shkuan të babai i tyre Shuajbi alejhisselam, i treguan për këtë dhe kërkuan që ta shpërblenin djaloshin që i kish ndihmuar. Vajza e vogël tha:

*“...O babai im, merre këtë për shërbim me pagesë, sepse më i miri që do ta marrësh në shërbim është i fuqishmi dhe besniku.”* (el-Kasas, 26)



I Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem tregon:

*“...Shuajbi i tha vajzës:*

*-Bija ime, nga e kuptove se ai është i fuqishëm? Vajza e vogël tha:*

*-Mori një gurë të rëndë dhe e vendosi mbi pus. Shuajbi alejhisselam tha:*

*-Mirë, nga e kuptove se ai është besnik?” Vajza u përgjigj:*

*-Kur e ftuam në emrin tënd dhe kur po e sillnim këtu, më tha: “Ec pas meje dhe jo para meje!” Nga kjo fjalë e kuptova se ishte besnik.” (Hejsemi, VIII, 203-204)*



Babai i Xhabirit radijallahu anhu, ra dëshmor në Uhud. La pas shumë borxhe dhe një familje të madhe që kishte nevojë për kujdesje. Hazreti Xhabir tregon:

Një ditë i Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem më tha:

“Nëse do të më vijë mall zekati nga Bahrejni, do ta mbush torbën dhe do të të jap.” Por nga Bahrejni nuk erdhi mall fare derisa i Nderuari ynë ndërroi jetë. Pastaj, kur erdhi mall nga Bahrejni, Ebu Bekri radijallahu anhu lajmëroi:

“Atij që i Dërguari i Allahut i ka dhënë fjalën apo i ka borxh, le të vijë te ne!” Mbi këtë, shkova te ai dhe i thashë:

“Pejgamberi më ka pas thënë kështu kështu.” Ebu Bekri radijallahu anhu futi dorën në mallin e ganimetit dhe mori një grusht. Pashë se ata ishin 500 dinar. Pastaj më tha:

“Merr edhe dy herë më shumë se kaq!” (Buhari, Kefalet, 3)

Duke e mbajtur premtimin e të Dërguarit të Allahut, Hazreti Ebu Bekr e tregoi edhe një herë besnikërinë e tij.



Enesi radijallahu anhu tregon:



Khaxhai im Enes bin Nadr nuk mundi të merrte pjesë në luftën e Bedrit dhe nga kjo u hidhërua shumë. Ai i tha të Dërguarit të Allahut:

“O i Dërguari i Allahut! Në luftën e parë që bëre me mushrikët nuk munda të marr pjesë. Nëse Allahu Teala më bën të marr pjesë në ndonjë luftë që do të bëhet me mushrikët, do të shohësh se çfarë kam për të bërë.”

Pastaj mori pjesë në luftën e Uhudit. Kur rreshtat e myslimanëve u ndanë, duke pasur për qëllim shokët e tij, ai tha; “O Zoti im, kërkoj falje nga Ti për këtë që po bëjnë.”. Pastaj, duke e pasur fjalën për mushrikët, tha: “O Zoti im, unë jam larg nga gjërat që bëjnë këta.”. Eci përpara dhe u takua me Sa’d bin Muadh, të cilit i tha:

“-O Sa’d! Ajo që dua është xhenneti. Beto hem në Zotin e Qabes se po ndjej erën e xhennetit që nga fundi i malit të Uhudit.”

Më vonë, kur Sa’di e tregoi këtë histori, kishte thënë:

“O i Dërguari i Allahut, unë nuk munda ta bëj atë që bëri ai!”

Khaxhain e gjetën të martirizuar. Në trupin e tij kishte më shumë se tetëdhjetë plagë shpate, bajonete dhe shigjete. Mushrikët i kishin prerë gjymtyrët. Për këtë arsye asnjë nuk e njohu dot atë. Vetëm motra e tij e njohu nga majat e gishtave. Ky ajet zbriti për xhaxhain tim dhe për ata si ai:

**“Prej besimtarëve ka burra që vërtetuan besën e dhënë ndaj All-llahut, disa prej tyre e mbajtën premtimin (luftuan dhe ranë dëshmorë), dhe disa prej tyre janë duke pritur (ta mbajnë premtimin). Ata kurrë nuk e ndryshuan fjalën.”** (el-Ahzab, 23) (Buhari, Xhihad, 12)



Bera bin Ma’rur radijallahu anhu, mori pjesë në besën e Akabes si një prej dymbëdhjetë përfaqësuesve. Hazreti Bera i pati dhënë fjalën Pejgamberit tonë të Nderuar se në kohën e haxhit do të vinte në Mekke, por para se të vinte koha e haxhit, ra në shtratin e vdekjes. Duke qenë në qenë në gjendje të këtillë, ai i tha familjes së tij:

“Më ktheni drejt Qabes, sepse i kam dhënë fjalën të Dërguarit të



Allahut se do të vij.” Dhe kështu u bë i pari i atyre që i drejtohen Qabes edhe kur ishte në jetë, edhe pasi vdiq.

Kur Krenaria e Gjithësisë sallallahu alejhi ue sellem, erdhi në Medine bashkë me shokët e tij, shkoi te varri i Bera bin Ma'rurit radijallahu anhu. Bënë një rresht dhe i falën namazin e xhenazes.

Pejgamberi u lut kështu: “O Zoti im! Fale atë! Mëshiroje dhe ji i kënaqur prej tij!”

Haneshi radijallahu anhu thotë:

Kam parë Hazretin Ali kur po bënte kurban dy deshë. I thashë:

“-Përse po e bën këtë?”. Ai më tha:

“I Dërguari i Allahut ma ka lënë porosi që pasi ai të vdiste, të bëja kurban edhe për Të. Edhe unë po e bëj këtë për të mbajtur porosinë e Tij. Dhe këtu e tutje do të vazhdoj të bëj kurban!” (Ebu Davud, Edahi, 1-2/ 2790; Ahmed, I, 107)



Halife Muavije bin Ebu Sufjan kishte bërë një marrëveshje paqeje me bizantinët e asaj kohe. Pa u mbushur koha e marrëveshjes, Muavija bashkë me ushtrinë e tij mori rrugën për te Bizantinët. Ata do të prisnin në një vend afër Bizantinëve dhe do të luftonin kur të mbaronte koha e marrëveshjes.

Kur ushtria po merrte rrugën drejt Bizantinëve, u duk një kalorës. Ai thirri:

“Allahu ekber, Allahu ekber! Duhet ta mbajmë premtimin dhe nuk duhet ta shkelim fjalën e dhënë!”

Kur e panë me kujdes, vunë re se ai qe Amr bin Abese, i cili ishte nga myslimanët e parë. Halifeja i dërgoi një njeri dhe e pyeti se çfarë kërkonte të thoshte: Amr radijallahu anhu tha:

“Unë kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut sallallahu alejhi ue sellem duke thënë:

*Nëse dikush bën marrëveshje me një popull, nuk duhet ta prishë*



*dhe as ta shtyjë marrëveshjen, derisa të mbarojë koha e saj, apo derisa të njoftojë se e ka prishur atë!*

Pas kësaj, Muavija u kthye prapa bashkë me ushtrinë e tij. (Ebu Davud, Xhihad, 152/2759; Ahmed, IV, 111, 113, 385-386)

Kështu që ai e mësoi mirë se nuk ka dallim në mes myslimanit apo jomyslimanit të cilit i është dhënë fjala, dhe se myslimani që ka bërë marrëveshje me dikë duhet t'i qëndrojë besnik fjalës dhe premtimit të dhënë.



Te Osmanët trimëria kishte ardhur në një gjendje virtytesh dhe morali që zbulonte zemrat, dhe se mbajtja me çdo kusht e fjalës dhe besnikëria ishte bërë pothuajse një pjesë e personalitetit. Aq sa në Evropë fjala “Turk” është përdorur në kuptim të njëjtë me fjalën “Mysliman”. Për këtë arsye thuhet se:

“Turk do të thotë njeri të cilit mund t'i besohet.” Dhe është bërë e qarte se Osmanët kurrë nuk janë betuar në të rreme si disa popuj të tjerë.

Po ashtu, ish gjenerali francez Comte de Bonneval, i cili ishte strehuar në shtetin Osman në kohën e Ahmedit të III, e shpreh kësajsoj një ngjarje që lidhet me këtë çështje, të cilën e kishte parë me sytë e tij:

“Turqit kanë një besnikëri fetare ndaj premtimeve të tyre.”

Edhe ambasadori i Suedisë Mouradgea d'Ohsson thotë:

“Turqit mysimanë janë shumë besnikë ndaj betimeve dhe premtimeve të tyre. Ata mundohen që të mos e lëshojnë nga goja emrin e Allahut. Ata nuk ndjejnë nevojë për ndonjë argument përveç Allahut si dëshmitar në premtimet e tyre.”

Në të vërtetë, shkrimtari francez Henri Mathieu, i cili në veprat e tij ishte bërë i qartë me armiqësinë që kishte ndaj turqve, në këtë çështje e ndjen veten të detyruar që të pohojë:

“Mospranimi i konceptit namuz dhe moral, që te turqit gjendet si thesar, konsiderohet një padrejtësi e madhe. Ata janë njerëz që të vër-





tetën e pranojnë si themeli të virtytit, ndërsa fjalën e dhënë e pranojnë si të shenjtë.”



Së fundi, Allahu thotë: “...**Kush e thyen (premtimin), ai e thyen vetëm në dëm të tij, kush e mban atë që i ka premtuar Allahut, Ai do t’i japë atij shpërblim të madh.**” (el-Feth, 10)

Kur myslimani jep fjalën, duhet të mbajë Allahun si dëshmitar. Për këtë arsye, çdo fjalë që ia jep njerëzve, ia ka dhënë në të njëjtën kohë edhe Allahut. Atëherë, ajo që i takon të bëjë besimtarit, është mbajtja e premtimit, duke u bërë besnik në atë masë sa njerëzit të ndjehen të sigurtë te dora dhe te gjuha e tij.

Edhe pse Allahu Teala i vendos ligjet dhe zotëron gjithçka, në shumë ajete thotë se “**fjala nuk ndryshon te Ai**”.<sup>49</sup> Edhe myslimani, duke thënë “Fjala një herë del nga goja.” duhet të jetë besnik dhe i sigurtë, domethënë duhet të ketë moralin që ka urdhëruar Allahu.

Besnikëria është një cilësi shpirtërore që e kurorëzon jetën njerëzore në gradën më të lartë, si një cilësi që u përket pejgamberëve, miqve të Allahut dhe të devotshmëve. Nisur nga kjo, krahas pranimit me zemër dhe pohimit me gojë, disa komentues të Kur’anit e kanë përkufizuar Islamit si nënshtrim dhe si besnikëri ndaj gjithë kaderit të Allahut Teala.

## 5. Besnikëria

Besnikëria, e cila konsiderohet një nga cilësitë më të rëndësishme të pejgamberëve, si në kuptimin gjuhësor ashtu edhe si esencë do të thotë të jesh i drejtë dhe i sinqertë.

Bashkë me gjendjet dhe fjalët e tyre që ishin në rrugën e Zotit, Pejgamberët gjithmonë kanë transmetuar besnikëri. Kur në Kur’anin

49. el-Bakara, 80; Ali Imran, 9, 194; er-Ra’d, 31; el-Haxh, 47; el-Mu’minun, 27; er-Rum, 6; es-Sexhde, 13; ez-Zumer, 20; Kaf, 29.



Fisnik tregohet personaliteti i disa pejgamberëve, pohohet: **“Ai ishte një pejgamber i sinqertë.”** (Merjem, 41, 56)

Përsëri në Kur'anin Fisnik thuhet:

**“Allahu do t'i shpërblejë të sinqertit për sinqeritetin e tyre...”**  
(el-Ahzab, 24)

Për të qënë zotërues i kësaj cilësie të rëndësishme, duhet të bëjmë disa përpjekje në këtë botë. Më të rëndësishmen e tyre, Allahu na e tregon kështu:

**“O Ju që keni besuar! Jini të devotshëm ndaj Allahut dhe rriini me të sinqertit!”** (et-Teube, 119)

Që domethënë se po të ndenjurit shumë me të sinqertët bëhet shkak për të fituar nga ata cilësinë e sinqeritetit.

Shejh Sadi Shirazi e shpreh kështu virtytin e të ndenjurit me njerëzit e sinqertë, si dhe te kundërtën e kësaj, që është një e ardhme fatkeqe:

*“Kitmiri, i cili ishte qeni i Ashabu'l-Kehfit, për shkak se qëndroi me të sinqertët ishte besnik, fitoi një nderim aq të madh sa fama e tij përmendet edhe në Kur'an.<sup>50</sup> Ndërsa gruaja e Nuhut dhe e Lutit alejhimasselam, hynë në xhehennem për shkak se qëndruan me ata që nuk i zbatonin urdhërat e Allahut.”<sup>51</sup>*

Në ditën e kiametit, kur njerëzit do të jenë shumë nevojtarë dhe kur askush të mos ketë mundësi ta ndihmojë tjetrin, besnikëria do të vijë në gjendjen e kapitalit më të çmueshëm. Ata që në këtë botë jetojnë me këtë cilësi, në botën tjetër do të marrin shpërblime të shumta dhe do të shpëtojnë për shkak të besnikërisë që do t'i ndihmojë në çastet e vështira. Allahu Teala e përshkruan kështu atë ditë; **“...Kjo është dita që të drejtëve u bën dobi drejtësia e tyre...”** (el-Maide, 119) Përsëri siç thuhet në ajetin fisnik, **“...Allahu Teala ka përgatitur**

50. Shik. el-Kehf, 18. Veçanërisht Bursevi, komentuesi i Kur'anit thotë se një nga kafshët e caktuar në numër që do të hyjë në xhennet, është edhe qeni i Ashabu'l-Kehfit, për shkak se ishte me të sinqertët. (Për më shumë hollësi shik. I. Hakki Bursevi, Ruhu'l-Bejan, Stamboll 1969, V, 226)

51. Shik. et-Tahrim, 10.



**falje dhe shpërblim të madh për burrat dhe gratë e sinqerta.”**

(el-Ahzab, 35)

Edhe Krenaria e Gjithësisë, i Nderuari ynë sallallahu alejhi ue sellem na e ka treguar kështu rëndësinë e besnikërisë:

“Besnikëria (sinqeriteti) e shpie njeriun në mirësi, ndërsa mirësia e shpie në xhennet. Përderisa dikush vazhdon të thotë të vërtetën, në fund bëhet prej të sinqertëve. Gënjeshtria e shpie njeriun në mëkat, ndërsa mëkati e shpie në xhehnnem. Kur njeriu vazhdon të gjënjëjë, në fund fare Allahu e përfshin në grupin e gënjeshtarëve.” (Buhari, Edeb, 69; Muslim, Birr, 103-105)

***Tabllo të virtytshme***

I Nderuari i Botrave ishte kulmi i besnikërisë. Këtë gjendje të tij u detyruan ta pohonin edhe armiqtë më të betuar të tij si Ebu Xhehl, Ahnes bin Sherik, Nadr bin Haris dhe Ebu Sufjan i cili më vonë u bë mysliman.<sup>52</sup> I Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem asnjëherë nuk ka thënë ndonjë fjalë që nuk ishte e vërtetë, po ashtu edhe në rastet kur bënte shaka nuk u nda kurrë nga besnikëria dhe nga fjala e drejtë.



Ebu Sufjan radijallahu anhu, para se të bëhej mysliman ishte një nga armiqtë më kryesorë të Islamit. Një herë, në një vend ku shkoi për tregti, ai bisedoi shumë gjatë me mbretin e Bizantinëve Heraklijus. Duke e transmetuar atë bisedë, Ebu Sufjan thotë kështu:

“...Heraklijus më pyeti:

-A e keni akuzuar ndonjëherë për ndonjë gjënjështër, gjatë kohës kur ende nuk kish pohuar se është peygamber?

I thashë: -Jo!

52. Buhari, Bed'u'l-Vahj, 6; Muslim, Xhihad, 74; Taberi, Tefsir, VII, 240; Ibn Kethir, el-Bidaje, III, 113.



Ai tha:

-A ka ngjarë që të mos e ketë mbajtur fjalën ndonjëherë?  
Thashë:

-Jo! Fjalën që e jep e mban pa tjetër, por ne tani jemi në marrëveshje të përkohshme më të. Ne nuk e dimë se çfarë do të bëjë më vonë! Unë nuk gjeta fjalë të tjera për të thënë që të mund ta nënçmoja Atë!.. Ai më pyeti:

-Çfarë ju urdhëron Ai ju?

Ai na thotë: *“Adhuroni vetëm Allahun, mos i bëni shirk atij dhe lërini ata gjëra që ju kanë këshilluarë etërit tuaj të besoni.”* dhe na urdhëron të falim namaz, të jetojmë me besnikëri dhe me nder dhe të ndihmojmë të afërmit.

Heraklijus tha:

-Unë të pyeta nëse e keni akuzuar ndonjëherë me gënjeshtër para se të thotë se jam peygamber dhe më the që jo. Kësisoj kuptova se ai është njeri që nuk i gjënjën as njerëzit, as Allahun.

Të pyeta nëse ka ngjarë që të mos e ketë mbajtur premtimin, ti më the që jo. Edhe peygamberët kështu janë, kurrë nuk kthehen nga fjala e dhënë...

Heraklijusi më pyeti përsëri:

-Çfarë ju urdhëron?” Unë thashë:

-Na urdhëron vetëm të adhurojmë Allahun, të falim namazin, të japim zekatin, të jemi besnikë, të jetojmë me nder dhe të ndihmojmë të afërmit.

Në lidhje me këtë, Heraklijus tha:

-Nëse këto që më the janë të vërteta, po të them se brenda një kohe shumë të afërt Ai njeri do të jetë sundues edhe i këtyre vendeve që kanë shkelur këmbët e mia...” (Buhari, Bed'u'l-Vahj, 6; Muslim, Xhihad, 74)



“Më jepni fjalën për këto gjashtë gjëra, dhe unë t’ju bëhem kefil për xhennetin:

1. Kur të flisni, flisni drejt!
2. Kur të premtoni, mbajeni premtimin!
3. Jini besnikë në çështjen e amanetit!
4. Mbrojeni nderin tuaj!
5. Mbroni sytë tuaj nga harami!
6. Mbajini duart tuaja larg nga harami!” (Ahmed, V, 323)



Abdullah bin Amr radijallahu anhu tregon:

Një ditë më thirri nëna ime. Edhe i Dërguari i Allahut ishte në shtëpinë tonë. Nëna më tha:

“Eja të të jap diçka!”. I Dërguari i Allahut e pyeti:

“-Çfarë ke menduar t’i japësh?”. Nëna ime u përgjigj:

“Doja t’i jepja një hurmë.” I Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem tha:

“-Dije se të mos i kishe dhënë gjë, do të të shkruhej një mëkat për gënjeshtren.” (Ebu Davud, Edeb, 80/4991; Ahmed, III, 447)

I Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem shkoi pranë një shitësi në treg. Futi dorën në thesin e grurit që kishte përpara dhe vuri re se gruri ishte i lagur. Ai pyeti shitësin:

“Çfarë është kjo?”. Kur shitësi tha:

“O i Dërguari i Allahut, e ka lagur shiu.” I Nderuari ynë tha:

“-A nuk mund ta lije pjesën e lagur sipër, me qëllim që ta shikonin njerëzit? Ai që gënjen nuk është prej nesh!” (Muslim, Iman, 164)

Në çdo punë që bën, muslimani nuk duhet të ndahet kurrë nga e drejta dhe nuk duhet të gënjejë askënd.

Ashabët e nderuar dhe besimtarët e devotshëm që ecnin në gjur-



mët e tyre, nën kushtet e vështira të asaj kohe ecnin deri një muaj të tërë për të marrë një hadith nga ndonjë transmetues. Të mbushur me edukatë profetike, ata kishin ardhur në një gjendje aq të lartë virtyti, saqë sjelljen e një personi që e gënjente kafshën e tij me torbë boshe, vetëm për ta nxitur të ecte, e pranonin si dobësi personaliteti; nuk i besonin atij njeriu dhe moralin e njerëzve të atillë nuk e shikonin si të mirë. Domethënë, personi që prirej nga ndjenja e mashtrimit edhe në lidhje me një kafshë, nuk e shikonin të përshtatshëm në transmetimin e haditheve, për shkak se nuk i kishte praktikuar si duhet në jetë hadithet fisnike të të Dërguarit të Allahut.



Imam Malik rahimehullah tregon:

Sipas asaj që më kanë treguar, një ditë e kishin pyetur Lokman Hakimin:

“Cila është e vërteta e këtij karakteri dhe e këtij virtyti që shikojmë te ti?”

Ai qe përgjigjur:

“Është fjala e vërtetë, kryerja e amanetit, shmangia prej gjërave që nuk më interesojnë dhe besnikëria.” (Muvatta, Kelam, 17)

Kur i Nderuari ynë alejhissalatu uesselam do t’u tregonte mushrikëve Kurejshit për ngjarjen e Israsë dhe Miraxhit, tha:

“-O Xhebrail! Populli im nuk do të më besojë!”

Xhebraili alejhisselam tha:

“-Të beson Ebu Bekri. Ai është besimtar i singertë.” (Ibn Sa’d, I, 215)

Po ashtu, kur mushrikët e dëgjuan ngjarjen e miraxhit, menjëherë shkuan te Hazreti Ebu Bekr dhe i thanë:

“-Shoku yt thotë se brenda një nate ka shkuar në Xhaminë Aksa, prej aty ka shkuar në qiell, dhe ende pa aguar dita ka ardhur përsëri në Mekke. Çfarë do të thuash për këtë?”



së besimit legjendar që kishte ndaj Hazretit Pejgamber sallallahu alejhi ue sellem, tha:

“Çfarëdo që të thotë Ai, është e vërtetë, sepse nuk është e mundur që ai të gënjejë dhe të mashtrrojë! Une i besoj menjëherë asaj që sjell Ai...”

Mushrikët thanë përsëri:

“Ti i beson Atij, por a e beson se Ai ka shkuar në Bejtu'l-Makdis dhe ka ardhur brenda një nate?”

Hazreti Ebu Bekr radijallahu anhu tha:

“-Po! Çfarë ka për tu habitur këtu? Për Zotin, ai më thotë se në çdo lloj kohe të natës apo të ditës i vjen lajm nga Allahu dhe unë i besoj.”

Pastaj Ebu Bekri radijallahu anhu shkoi te Pejgamberi ynë i Nderuar, i cili gjendej në Qabe. Kur e dëgjoi edhe një herë nga goja e Pejgamberit dhe tha:

“Sadakte (the të vërtetën), o i Dërguari i Allahut!...”

Edhe i Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem, duke ngelur shumë i kënaqur nga besimi i tij, me buzëqeshjen që ndriçonte botën, i tha Ebu Bekrit:

“-O Ebu Bekr! Ti je i Sinqertë!...” (Ibn Hisham, II, 5)

Pas asaj dite, Ebu Bekri radijallahu anhu u bë i njohur me pseudonimin “Siddik” (i sinqertë).

Ja kjo është besnikëria në besim... ta besosh të gjithë çështjen dhe të mos ndahesh aspak nga ajo...



I Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem, kishte blerë një kalë nga një fshatar arab. I Nderuari ynë i kërkoi që ta merrte kalin deri të shtëpia dhe atje t'ia jepte paratë. Ai iku pak më shpejt përpara ndërsa bedeviu mbeti pas, meqenëse po ecte më këmbë. Në këtë kohë të bedeviu erdhën disa njerëz. Ata filluan të bëjnë pazar për kalin dhe i propozuan një shumë më të madhe parash. Ata nuk e dinin se kalin



e kishte blerë tashmë Pejgamberi ynë i Nderuar. Bedeviu i thirri të Dërguarit të Allahut dhe i tha:

“-Nëse do ta marrësh kalin, merre, përndryshe po e shes!” Kur i Dërguari i Allahut e dëgjoi këtë fjalë, u kthye dhe i tha:

“*Po a e bleva Unë atë?!*”. Por bedeviu e mohoi këtë duke thënë:

“Për Zotin unë nuk ta shita atë Ty!”. I Nderuari ynë tha:

“Përkundrazi! Unë e bleva atë nga ti.”. Këtë herë bedeviu tha:

“Atëherë sill një dëshmitar!”. Huzejme bin Sabit radijallahu anhu u ngrit dhe tha:

“-Unë dëshmoj se Ju e bletë atë!

I Dërguari i Allahut iu afrua Huzejmes dhe e pyeti:

“*Ti nuk ishe me ne kur e bleva, me çfarë do të dëshmosh?*”. Huzejme radijallahu anhu tha:

“-Me besimin që kam ndaj teje, o i Dërguari i Allahut!”

I Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem e pranoi dëshminë e Huzejmës si dy dëshmi për shkak të kësaj besnikërie të madhe. (Ebu Davud, Akdije, 20/3607; Nesai, Buju, 91; Ahmed, V, 215-216)

Sipas një transmetimi, i Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem e pyeti Huzejmen:

“*Ti nuk ishe me ne kur e bleva, çfarë të shtyn që të dëshmosh?*”. Huzejme tha:

“Unë i kam besuar (mesazhit) që keni sjellë dhe e di që nuk thoni asgjë përveç së vërtetës!” Kur dëgjoi këtë, i Dërguari i Allahut tha:

“Për këdo që të dëshmojë Huzejme, qoftë pro apo kundër, duhet të jetë e mjaftueshme (është në vlerën e dy dëshmitarëve).

Ja një nga shembujt që mund të llogaritet si kulmi i besnikërisë ndaj të Dërguarit të Allahut...





tërat e të Dërguarit të Allahut. Ndërsa në luftën e Tebukut, duke thënë sot-neser, u vonua. Ndërkohë ushtria që nisur, ndërsa Ka'bi kishte ngelur në Medine. Kur i dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem u thye nga lufta, ai dhe disa sahabi, duke treguar të drejtën kërkuan falje nga Allahu dhe secili prej tyre thoshte nga një arsye. Ajeti fisnik që lajmëronte se janë falur, zbriti pas pesëdhjetë ditësh. Gjatë kësaj kohe ata hoqën shumë keq. Edhe pse kjo botë është shumë e gjërë, atyre u dukej e ngushtë, por meqenëse u penduan sinqerisht fituan faljen hyjnore. Ka' b bin Malik, i cili e pohoi gabimin e tij duke u kapur për së vërtetës, e tregon kështu dobinë që ka parë nga besnikëria:

“Betohem në Allahun se mirësia më e madhe që Ai më ka dhënë pasi më nderoi me Islamin, është kur **thashë të vërtetën** përpara Pejgamberit tonë të Nderuar, si dhe shpëtimi nga shkatërrimi prej atyre që gënjen, sepse Allahu Teala shpalli këto ajete që lajmërojnë të ardhmen e keqe të atyre që nuk morën pjesë në luftën e Tebukut e që gënjen:

**...Ju largohuni nga ata, sepse ata janë të ndyrë, vendi i tyre do të jetë xhehennemi, shpërblim për atë që vepruan. Ata ju betohen juve që të jeni të kënaqur ndaj tyre. Edhe nëse ju kënaqeni nga ata, Allahu nuk është i kënaqur me popullin e paturpshëm.** (et-Teube, 95-96)” (Buhari, Megazi, 79)



Pas luftës së Uhudit, gratë që ishin në Medine patën dalë jashtë qytetit me shpresë për të marrë ndonjë lajm. Edhe Hazreti Aishe radijallahu anha, ishte me ta. Në vendin e quajtur Harre takoi gruan e devotshme Hind bint Amr. Hindi kishte vënë në deve trupin e bashkëshortit Amr bin Xhemuh, atë të të birit Hallad dhe të vëllait Abdullah, të cilët kishin rënë dëshmorë në luftë. Hazreti Aishe e pyeti:

“Çfarë lajmesh kemi?”

Hint bind Amr radijallahu anha tha:

“Kemi lajme të mira, i Dërguari i Allahut është gjallë. **Pasi Ai të jetë gjallë çdo fatkeqësi është e lehtë.**” Hazreti Aishe, duke i treguar me dorë trupat që ishin në deve, e pyeti:



“Kush janë këta?”. Gruaja e devotshme Hindi, tha:

“-Janë vëllai im Abdullahu, biri im Halladi dhe bashkëshorti im Amri.”

Kur Hazreti Aishe e pyeti:

“-Ku po i Dërgon ata?” Ajo tha:

“-Po i dërgoj në Medine. Atje do t’i varros.”

Kur Hindi donte ta bënte devenë të ecte, deveja ra në vendin ku ishte. Hazreti Aishe e pyeti:

“-Deveja u rrëzua prej peshës së rëndë?” Hindi tha:

“-Nuk e di përse u rrëzua. Më parë ka pas mbajtur peshën e dy deveve, por tani po ndjej diçka të ndryshme te ajo.”

Kur e detyroi të lëvizte, deveja u ngrit, por me t’u drejtuar kah Medineja u rrëzua përsëri. Kur u kthye nga drejtimi i Uhudit filloi të vrapojë. Hindi shkoi te i Dërguari i Nderuar dhe ia tregoi këtë. I Nderuari ynë e pyeti:

“*Deveja është e detyruar. A ka lënë ndonjë testament Amri?*” Hindi tha:

“-Amri, kur po shkonte në Uhud u kthye nga kibla dhe u lut: O Zoti im! Më dhuro martirizimin! Mos më kthe te familja të mërzitur dhe të privuar!

Kur dëgjoi këtë, i Nderuari ynë sallallahu alejhi ue sellem tha këto fjalë që shfaqin madhështinë e besnikërisë:

“Ja, kjo është arsyeja që deveja nuk ecën. O populli i Ensarëve! Kushdo prej jush që është betuar në Allahun, le ti rrijë Atij besnik. O Hind! Bashkëshorti yt është prej të sinqertëve. Që nga çasti që ai ka rënë dëshmor, engjëjt i kanë bërë hije me krahët e tyre dhe po shikonin se ku do të varroset. O Hind! Amr bin Xhemuh, biri yt Hallad dhe vëllai yt Abdullah do të bashkohen në xhennet dhe do të jenë shokë.”

Kundrejt këtij përgëzimi, Hindi shfaqti edhe një shembull tjetër besnikërie. Ajo iu lut:



“O i Dërguari i Allahut! Të lutem, lutju Allahut të më bashkojë edhe mua me ata.” (Vakidi, I, 265-266; Ibn Haxher, Fet’hu’l-Bari, III, 216; Ibn Abdilber, el-Istiab, III, 1168)



I Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem, para marrëveshjes së Hudebijes e kishte dërguar Hazretin Osman në Mekke për të diskutuar. Osmani radijallahu anhu, duke iu përgjigjur urdhërit të të dërguarit të Allahut shkoi menjëherë në Mekke. Ai u tha mushrikëve se ata donin vetëm të bënin umre dhe pastaj do të ktheheshin. Mushrikët përsëri nuk dhanë leje. Duke e vëzhguar mirë Hazretin Osman, i thënë:

“Nëse do, ti mund ta bëshë Qaben tavaf!..”

Të gjithë myslimanët po digjeshin me mallin e tavafit dhe qaben e mbanin në sytë e tyre. Bile duke menduar se Hazreti Osman do të bëjë tavaf, disa prej tyre (me kuptim të mirë të fjalës) e kishin zili. Ndërsa disa ishin në dyshim. Ndoshta Osmani nuk e bën tavaf Qaben pa iu dhënë leja të gjithë myslimanëve, duke shfaqur një shembull të madh besnikërie dhe altruizmi.

Gjithçka ndodhi ashtu si, e kish menduar grupi i dytë. Ky njeri besnik i cili ia kishte dedikuar veten Allahut dhe të Dërguarit, tha:

“Pa e bërë qaben tavaf Hazreti Pejgamber, as unë nuk mund ta bëj! Unë e vizitoj shtëpinë e Allahut vetëm pas Tij. **Edhe unë nuk jam në atë vend ku nuk pranohet i Dërguari i Allahut...**”. Kështu ai e deklaroi besnikërinë që kishte ndaj Allahut dhe të të Dërguarit të Tij. (Ahmed, IV, 324)



Javuz Sulltan Selim Hani, edhe pse ishte një trim i njohur, ishte në të njëjtën kohë shumë i ndjeshëm dhe i prekshëm, por intelgjencia e bashkimit dhe forcimit të shtetit i detyroi disa padishahë që të merrnin disa vendime të vështira. Kësisoj, si rezultat i këtij detyrimi Javuz Sulltan Selimi e vrau vëllain e tij Korkutin, pastaj mori pjesë në xhenaze, mbarti arkivolin e tij dhe qau duke thënë:



“O vëllai im! Ah sikur ti të mos kishe vepruar ashtu dhe sikur edhe unë të mos kisha qenë i detyruar ta bëja këtë!..”

Ai, duke vlerësuar një nga shokët e sinqertë të princit Korkut, i bëri atij këtë propozim:

“Ty po të fal për shkak të besnikërisë, e cila është një virtut i madh! Si shpërblim për këtë besnikëri do të të caktoj në pozitën që ti dëshiron. Nëse pranon, mund të bëhesh edhe veziri im!

Ai e falenderoi dhe duke e përforcuar edhe më besnikërinë, i tha:

**“O Sulltani im! Këtu e tutje detyra ime është që të ruaj dhe t’i shërbej tyrbes së princit Korkut...”**

Së fundi, besimtari duhet të jetë i drejtë në fjalën dhe në njetin e tij, emrin e tij duhet ta shkruajë te libri i të sinqertëve dhe besnikëria duhet t’i sjellë dobi në këtë botë dhe në botën tjetër. Sa bukur thotë Pasha Zija:

*Njeriu duhet të jetë i drejtë edhe sikur t’i bëjnë keq  
Hazreti Allah është ndihmuesi i të drejtëve!..*

## 6. Aprovimi i gjendjes

Gëzimi dhe brenga e madhe janë kurthe të mëdha për njeriun. “Aprovimi i Gjendjes” dhe “Durimi e mbështetja” që janë rezultat i tij, është cilësia dalluese e besimtarëve të përsosur.

Rregulli i prerë i lumturisë është që ta bëjmë mendjen tonë ndjekëse të shpalljes, ta zbukurojmë zemrën me moral të bukur dhe në sajë të këtyre, të jemi të kënaqur ndaj çdo gjëje të papritur të jetës. Lumturia e vërtetë është në arrihet me pranimin e të vërtetave të jetës, me durimin e vështirësive të saj, me përpjekjen për ta rregulluar, si dhe me dorëzimin ndaj Zotit të Botrave, duke e parë të bukur çdo aspekt të saj.



*“Biri im! Mos e shqetëso zemrën tënde me fatkeqësitë dhe vështirësitë! Ki kujdes nga syri i pangopur. Nënshtroju kaderit. Mjaftohu me atë që të ka dhënë Allahu, ashtu që të të zbukurohet jeta, të të mbushet zemra me gëzim dhe që të jesh i kënaqur nga jeta.”*

Zemërimi ndaj ngjarjeve që shkaktojnë brengë dhe fatkeqësi nuk përputhet me moralin e Islamit, por njeriu nuk mund të shpëtojë lehtë nga kjo dobësi njerëzore derisa të mos ketë arritur kulmin e pjekurisë shpirtërore. Kur ta pastrojë veten dhe të arrijë në gradën “Radije”, u nënshtrohet dhe u dorëzohet pa mëdyshje të gjitha ligjeve të kazasë së vullnetit hyjnor, që mund të shfaqen në formë mirësie apo të keqeje, dhe nuk ankohet kurrë. Sa i madh është përgëzimi hyjnor për ata që janë kështu:

**“O shpirt i qetësuar! Kthehu te Zoti yt si i kënaqur nga Ai dhe Ai i kënaqur nga ti! Hyr mes robërve të Mi të devotshëm dhe hyr në Xhennetin Tim!”** (el-Fecr, 27-30)

Të bëjë gjërat që duhen dhe t’u nënshtrohet atyre, është e lehtë për njeriun. Gjëja e lehtë bëhet kollaj dhe me dëshirë. Edhe besimtarit që e do Allahun, çdo gjë që i vjen nga Ai i duket e lehtë, e kënaq dhe i pëlqen.

Të devotshmit që kanë besim të fortë, janë të kënaqur ndaj kaderit të Allahut dhe e dinë se nuk u ndodh asnjë gjë e keqe të cilën s’e ka shkruajtur Ai. Për këtë arsye, çdo gjë që u ndodh e pranojnë si të lehtë, duke e krahasur me ndëshkimin e ahiretit. Allahu Teala i jep qetësi botës shpirtërore të njerëzve të këtyllë. Madje shfaqjet e ndryshme hyjnore, nën shikimet shpirtërore të tyre janë njëmijë herë më të mira se gëzimet dhe festat e kësaj bote të përkohëshme dhe fantazore, sepse ata kanë hequr dorë nga ajo së cilës i janë drejtuar njerëzit e zakonshëm duke kujtuar se është mirësi.

Pejgamberi i Nderuar thotë:

*“Madhësia e shpërblimit është sipas ashpërsisë së vështirësisë. Allahu e lëshon në vështirësi popullin që do. Kur i nënshtrohet asaj që i ndodh, Allahu kënaqet nga ai. Atë që nuk i nënshtrohet, e ndëshkon.”* (Tirmidhi, Zuhd, 57/2396; Ibn Maxhe, Fiten, 23)



Ndërsa në një hadith tjetër:

*“Besimtari i fortë është më i dashur dhe më i mirë (te Allahu) se sa besimtari i dobët. Megjithatë në të dy ka mirësi. Ti mundohu të fitosh atë që është e dobishme për ty. Kërko ndihmë nga Allahu dhe kurrë mos u dorëzo. Nëse të ndodh diçka, mos u bëj pesimist duke thënë: ah, sikur të kisha vepruar kështu, do të kishte ndodhur kështu. Thuaj: Ky është caktimi i Allahut. Ai bën çfarë të dojë. sepse fjala “sikur” hap derën e punëve që kënaqin Shejtanin.”* (Muslim, Kader, 34; Ibn Maxhe, Mukaddime, 10)

Një njeri që nuk kënaqet me gjendjen e tij, thotë “Sikur të kisha bërë kështu e ashtu.” dhe bie në disa gjendje që i kundërvihen besimit si, zemërimi, kundërshtimi i kaderit dhe mospëlqimi i vullnetit hyjnor. Kjo është një gjendje që kënaq shejtanin dhe e zvarrit njeriun për në humbje. Ndërsa miratimi i gjendjes e shpie njeriun kah kënaqësia e Allahut. Në Kur’anin Fisnik, pasi numërohen të gjitha mirësitë e kësaj bote dhe të ahiretit, thuhet:

**“...Kënaqësia e Allahut është më e lartë dhe më e madhe së këto të gjitha. Ja ky është shpëtimi i vërtetë.”** (et-Teube, 72)

### ***Tabllo të virtytshme***

Usame bin Zejd radijallahu anhu tregon:

Vajza e tij (Zejnebi) i dërgoi lajm Pejgamberit sallallahu alejhi ue sellem:

“Djali im është duke vdekur, ju lutem ejani tek ne.” Pejgamberi alejhissalatu uesselam i dërgoi vajzës së tij selam duke i thënë:

*“Allahu është ai që merr dhe ai që jep. Çdo gjë e ka të caktuar kohën te Ai. Le të durojë dhe të presë nga Allahu shpërblimin e saj!”*

Pas kësaj përgjigjeje, e Tij i dërgoi lajm përsëri:

“Ju lutem, ejani patjetër!”

Këtë radhë, i Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem, që ishte



bashkë me Sa'd bin Ubade, Muadh bin Xhebel, Ubej bin Ka'b, Zejd bin Thabit dhe disa sahabe të tjerë, u ngrit dhe shkoi në shtëpinë e vajzës së Tij. Fëmijën ia dhanë Hazretit Pejgamber. Ai e mori në krah. Fëmija po merrte frymë me vështirësi. Nga sytë e bekuar të të Dërguarit të Allahut filluan të rridhnin lot. Sa'd bin Ubade i cili e pa këtë, e pyeti:

“O i Dërguari i Allahut, ç'është kjo punë?”. I Dërguari i Allahut tha:

“Kjo është ndjenja e mëshirës që Allahu vendos në zemrën e robit që do. Në fakt Allahu mëshiron vetëm robërit e mëshirshëm.” (Buhari, Xhenaiz 33, Ejman 9, Merda 9; Muslim, Xhenaiz 9, 11)

Selami i parë që i dërgoi dhe këshillat që i dha i krenaria e Gjithësisë i Nderuari ynë vajzës së Tij, është në kuptimin më të plotë nënshttrim ndaj asaj që të ndodh. Dhuntia e vërtetë është dorëzimi ndaj Allahut, duke u kënaqur me kaderin në atë çast të dhimbshëm. Ndërsa gjendja e dytë e Tij, nuk ishte kundërshtimi i kaderit duke qarë, bërtitur apo duke shqyer kokën, siç pandehën edhe disa ashabe, por është një shfaqje e ndjenjës së mëshirës që Allahu ua ka dhënë robërve të Tij.



I Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem e tregon kështu shpërblimin e një besimtari që është i kënaqur me gjendjen e tij:

*“Kur vdes fëmija e një robi, Allahu u thotë ëngjëjve:*

*-A morët shpirtin e fëmijës së robit Tim! Ëngjëjt thonë:*

*-Po o Zoti ynë. Allahu Teala u thotë:*

*-A e këputët frutin e zemrës së tij? Ëngjëjt thonë:*

*-Po o Zoti ynë. Allahu Teala u thotë:*

*-Mirë, por çfarë tha robi Im? Ëngjëjt thonë:*

*-Ai të falenderoi Ty dhe u strehua vetëm te Ti duke thënë:*

إِنَّا لِلَّهِ وَإِنَّا إِلَيْهِ رَاجِعُونَ



“...Ne jemi të Allahut dhe te Ai do të kthehemi.” (el-Bakara, 156) Pas kësaj Allahu Teala thotë:

*-Ndërtoni një shtëpi në xhennet për robin Tim dhe emrin vendosjani “Bejtu’l-Hamd: Shtëpia e falenderimit.” (Tirmidhi, Xhenaiz, 36/1021)*



I Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem thotë:

*“Kur sëmuret robi, Allahu Teala i dërgon dy ëngjëj dhe i urdhëron ata:*

*-Shkoni dhe shikojeni, çfarë u thotë robi Im atyre që i shërbejnë!*

*Nëse kur të vijnë ëngjëjt robi është duke falenderuar dhe madhëruar Allahun, ata ia tregojnë këtë gjendje Allahut, i cili në të vërtetë di çdo gjë më mirë. Allahu Teala (i cili i dërgon ëngjëjt vetëm për të qënë dëshmitarë të veprës së robit) thotë:*

*-Nëse ia marr shpirtin robit Tim, është e drejta e tij mbi Mua që ta vendos në xhennet. Nëse e shëroj, është e drejta e tij mbi mua që mishin e tij ta ndërroj me një mish më të mirë, gjakun e tij me një gjak më të mirë dhe t’ia fal mëkatet.” (Muvatta, Ajn, 5)*



Ebu Hurejra radijallahu anhu tregon:

Një ditë, i Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem u tha ashabëve të Tij:

*“Kush i mëson këto tri fjalë nga unë, vepron me to dhe ua mëson atyre që do të veprojnë me to?”*

Unë u ngrita menjëherë dhe thashë:

“Unë o i Dërguari i Allahut!”

I Nderuari ynë alejhissalatu uesselam më kapi dorën dhe tha këto pesë gjëra:

*“Nëse ikën nga harami, bëhesh robi më adhurues i Allahut!*

*-Nëse kënaqesh me atë që të ka dhënë Allahu, (në besim) do të*





*jesh më i pasuri i njerëzve!*

*-Ndhimoje komshiun që të bëhesh një besimtar i përsosur.*

*-Atë që do për vete, dëshiroje edhe për të tjerët, ashtu që të bëhesh një mysliman i përsosur!*

*-Mos qesh shumë, sepse qeshja e tepërt e vret zemrën.* ” (Tirmidhi, Zuhd, 2/2305; Ibn Maxhe, Zuhd, 24)



I Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem po qëndronte ulur bashkë me Ebu Bekrin radijallahu anhu. Hazreti Ebu Bekr kishte një rrobë të vjetër, aq të vjetër sa majën e rrobës tek kraharori kishte lidhur me bisk peme.

Në këtë kohë zbriti Xhebraili alejhisselam. Ai i dha Pejgamberit tonë të Nderuar selamin e Allahut Teala dhe i tha:

“O i Dërguari i Allahut! Ç’është kjo puna e Ebu Bekrit? Paska veshur një rrobë aq të vjetër, sa që majën e saj e paska lidhur me bisk peme!”

I Nderuari i Botërave tha:

*“O Xhebrail! Ai e ka harxhuar pasurinë e tij në rrugë të Allahut. Për këtë arsye është në këtë gjendje.”* Mbi këtë Xhebraili alejhisselam i tha Pejgamberit:

“Jepi atij selamin e Allahut. I thuaj: Zoti të pyet: A je i kënaqur nga unë për shkak të kësaj varfërie, apo ankohesh nga kjo gjendje që ke?”

I Dërguari i Allahut, duke u kthye nga miku i tij Ebu Bekri, i tha:

*“O Ebu Bekr! Xhebraili është këtu dhe të ka sjellë selamin e Allahut. Zoti ynë i lartë të thotë: A je i kënaqur nga unë për shkak të kësaj varfërie, apo ankohesh nga kjo gjendje që ke?”* Ebu Bekri radijallahu anhu nuk dinte çfarë të thoshte kundrejt këtij lavdërimi hyjnor për shkak të gëzimit. Pothuajse iu mbyll goja. Qau një farë kohe.... Pastaj tha:



“Të ankojem prej Zotit tim?! Unë jam i kënaqur nga Zoti im, unë jam i kënaqur nga Zoti im, unë jam i kënaqur nga Zoti im.” (Ebu Nuajm, Hilje, VII, 105; Ibnu'l-Xhevzi, Sifatu's-Sahabe, I, 249-250)



Sipas një transmetimi, Junusi alejhisselam i kishte thënë Hazretit Xhebrail:

“A do të më tregosh se kush është adhuruesi më i mirë në këtë tokë?”

Dhe ai i tregoi një njeri të cilit i qenë kalbur duart dhe këmbët nga sëmundja e lebrës, e për më tepër kish humbur edhe sytë. Por ai thoshte:

“O Zoti im! Çdo gjë që më ke dhënë me këto duar dhe këmbë, vetëm Ti ma ke dhënë. Çdo gjë që e ke larguar, vetëm Ti e ke larguar. O Zoti im! Mua më ke lënë vetëm një dëshirë, e cila është vetëm takimi me Ty.”



Hazreti Ejjub alejhisselam po jetonte ditët më të vështira të sëmundjes. Bashkëshortja e tij Rrahimeja i tha:

“Ti je perjgamber! Kërko nga Allahu Teala shëndet dhe shërim, që të shpëtosh nga këto vuajtje!”. Ejjubi alejhisselam e pyeti:

“Sa ditë kemi kaluar me shëndet?”. Zonja Rrahime tha:

“Tetëdhjetë vjet.”. Pas kësaj, Hazreti Ejjub alejhisselam tha:

“O Rrahime! Allahu më ka dhënë një jetë të shëndetshme tetëdhjetëvjeçare. Në krahasim me jetën e shëndetshme, koha e sëmundjes është shumë pak. Kësisoj më vjen turp që të ankojem te Allahu. Kur Allahu Teala na jep mirësi, gëzohemi. Po atëherë përse të mos duroj edhe vështirësitë që vijnë nga Ai?! Unë jam i kënaqur nga Zoti im!”

Sjellja e Ejjub alejhisselam shfaq një shembull të bukur të nënshtrimit. Edhe pse kishte shumë fatkeqësi dhe vështirësi, Ejjubit alejhisse-



lam i erdhi turp t'ia paraqesë Allahut sëmundjen e tij dhe t'i kërkonte shëndet e shërim, që të mos u ankohej nga gjendja e tij dhe të mos qe i mangët në nënshtrimin ndaj kaderit. Së fundi, për shkak të këmbënguljes së bashkëshortes së tij, bëri vetëm këtë lutje:

“...(O Zoti im!) **Mua më ka kapur kjo sëmundje. Ti je më mëshiruesi i mëshiruesve!..**” (el-Enbija, 83)

Pas kësaj lutjeje, Allahu Teala ia kishte hequr vështirësitë, e kishte shëruar dhe përsëri i kish dhënë pasuri dhe fëmijë, për të qënë një kujtim mëshire për ata që gjithmonë janë në adhurim. Allahu e ka lavdëruar Ejjubin alejhisselam, i cili kishte arritur kulmin e durimit, falenderimit dhe nënshtrimit: “نِعْمَ الْعَبْدُ... : **Sa rob i mirë!..**” (Sad, 44)



Në rrëfimin e mëposhtëm, Hazreti Mevlana tregon se dashuria dhe miqësia e vërtetë është e mundur të tregohet edhe duke u ndjerë të kënaqur me vështirësitë dhe vuajtjet që vijnë nga miku:

“Një herë, një njeriu të nderuari i erdhën për vizitë disa miq, të cilët i sollën dhuratë një pjepër. Ai thirri shërbëtorin e tij Llokmanin, që ishte njeri i ndjeshëm dhe i sinqertë, të cilin zotëria e donte shumë me gjithë zemër.

Kur Llokmani erdhi, zotëria i tij preu një riskë nga pjepri dhe ia dha atij. Llokmani e hëngri atë riskë sikur të ishte mjaltë. Ai e hëngri me aq dashuri dhe dëshirë, saqë atyre që e panë iu hap aq shumë oreksi, sa pothuajse do të donin edhe ata nga një riskë. I nderuari i dha atij edhe një pjesë tjetër, sepse i nderuari i tij gjente qetësi kundrejt kësaj shijeje që ndjente shërbëtori i sinqertë Llokmani. Në ato çaste, teksa kishte ngelur riska e fundit e pjeprit, i nderuari i tha:

“Këtë po e ha unë, që ta shoh se sa pjepër i ëmbël është!” , por sapo e hëngri atë pjesë, i dogji goja nga ithtësia e pjepërit. Gjuha dhe goja iu ithtuan. Ai u çudit nga ithtësia e pjepërit dhe i tha Llokmanit:

“O shërbëtori im i dashur! O bota ime! Si ka mundësi që e hëngre këtë helm sikur të qe i ëmbël? Si ka mundësi që e pranove këtë gjë të keqe si mirësi? Ç’është ky durim? Kush e di sa ke hequr deri tani dhe durove pa t’u skuqur fytyra? Apo ti je armik i shpirtit të ëmbël? Përse



nuk the asgjë? Përse nuk the: Më falni, por tani nuk mund ta ha!?”

Llokmani tha:

“Unë u turpërova shumë që nuk munda t’ju kundërshtoj për këtë, sepse nga dora juaj kam ngrënë ushqime shumë të ëmbla dhe kam marrë ushqim shumë të rrallë material dhe shpirtëror. Si mund t’ju thosha për atë që ma dhatë me dorën tuaj: Kjo është e idhët, nuk halet? Mua çdo ithtësi që më vjen nga dora juaj, më duket e ëmbël, sepse çdo qelizë e trupit tim është ushqyer me mirësitë tuaja.”

Pastaj, Llokmani vijoi të shprehej me emocion dhe dashuri:

“O i nderuari im! Më raftë njëqind herë në kokë nëse bërtas nga dhimbja që më vjen nga ju. Si mund të lërë ithtësi në këtë pjepër dora jote bujare? Nga dashuria, vuajtjet bëhen të ëmbla. Bakri bëhet flori nga dashuria. Llumi pastrohet me dashuri. Sëmundjet e pashërueshmë shërohen nga dashuria. Të vdekurit ngjallen nga dashuria. Padishahët bëhen robër nga dashuria. Burgjet bëhen kopshte me trendafila nga dashuria. Shtëpitë e errëta ndriçohen nga dashuria. Zjarri bëhet dritë nga dashuria. Edhe të këqinjat bëhen hyri nga dashuria. Vuajtjet dhe fatëkeqësitë bëhen gëzim nga dashuria. Për shkak të dashurisë, ata që kanë devijuar nga rruga dhe ata që të presin rrugën shndërrohen në udhëzues lumturie. Sëmundjet bëhen shëndet për shkak të dashurisë. Mundimet bëhen mëshirë për shkak të dashurisë.”



Ja pra, shenja më e qartë e dashurisë ndaj Allahut është nënshtrimi i vërtetë ndaj gjendjes që ke.

Omer bin Abdulaziz rahimehullah atyre që e pyesnin:

“Çfarë dëshiron?”, u thoshte:

“Gëzimi im është vetëm në gjërat e caktuara nga Allahu. Unë dua atë që ka caktuar Allahu..”



Sa mësimdhënëse është kjo bisedë e zhvilluar mes një zotërie dhe robit të tij:



Zotëria:

“Çfarë dëshiron të hash në shtëpinë time?”

Robi:

“Atë që do të më japësh.”

“Çfarë rrobash dëshiron të veshësh?”

“Ato që të më japësh.”

“Në cilën dhomë të shtëpisë sime dëshiron të qëndrosh?”

“Aty ku ti dëshiron të qëndrosh?”

“Cilat punë të shtëpisë dëshiron të bësh?”

“Punët që dëshiron ti që të bëj.”

Pas përgjigjes së fundit, zotëria humbi në mendime. Pastaj, duke fshirë lotët që i rridhnin nga sytë, tha:

“Ah sikur t’i nënshtrohesha edhe unë Zotit kështu. Sa i lumtur do të isha!..”

Në këtë çast robi tha:

“O zotëria im! A ka zgjidhje dhe dëshira për robin te zotëria e tij?...”

Kur dëgjoji këto fjalë zotëria tha:

“Të kam liruar. Je i lirë për hir të Allahut, por dëshiroj të rrih pranë meje që të të shërbej me shpirt dhe me pasurinë time...”

Tek ai që e nje Allahun shumë mirë, tek ai që i dorëzohet Atij me një dashuri të vërtetë dhe që kënaqet me atë që i ka caktuar Allahu, nuk mbetet as dëshirë dhe as zgjedhje. Ai tashmë thotë vetëm:

“Çfarë t’i kërkoj Allahut?!.”<sup>53</sup>



Një ditë Synbyl Sinan Efendi, i cili ishte prej miqve të Zotit, pyeti nxënësit e tij:

53. Abdulkadir Gejlani, el-Fethu’r-Rabbani, (Abdulkadir Gejlani’nin Sohbetleri), Sta - boll 1987, fq. 421.



“Le ta zëmë se Allahu ju ka dhënë administrimin e gjithësisë. Çfarë do të donit të bënit?”

Nxënësit, të cilëve nuk u kishte rastisur asnjëherë të përballeshin me një pyetje të tillë, u çuditën, por pastaj dhanë mendime të ndryshme, për të mos u treguar të paedukatë ndaj Hazretit të moshuar:

-O i nderuar, nuk do të lija asnjë qafir në këtë botë!

-Do t'i shkatërroja të gjitha të këqijat!

-Do t'i shkatërroja ata që pijnë alkoll!”. E kështu me radhe.

Vetëm njëri prej tyre qendroi i heshtur dhe nuk dha asnjë përgjigje. Kjo sjellje i ra në Sy Hazretit, ndaj e pyeti nxënësin:

-Biri im! Po ti çfarë do të bëje?

Nxënësit, të cilit iu skuq fytyra nga ndrojtja, dhe me modesti tha:

“-I nderuari im! A ka ndonjë mangësi (Zoti na ruajt) në administrimin e Allahut në gjithësi, që unë të mund të bëja ndonjë gjë të ndryshme? Në një kohë kur rregullimi hyjnor funksionon mbi me një fuqi të pakonceptueshme, si mundem unë që me mendjen dhe vullnetin tim të paaftë dhe të kufizuar, të them se do të bëja kështu e ashtu!! Pas këtyre fjalëve i uli sytë nga turpi.

Hazreti u kënaq shumë nga kjo përgjigje e zgjuar. Duke patur në fytyrë një pamje të qeshur dhe të ndritshme, teksa e mbante të drejtuar kah nxënësi vështrimin e tij të thellë, ai i tha: “Ja, puna e gjeti qendrën!..”

Më vonë atij nxënësi i mbeti emri “qendra e nderuar”, ndërsa emri i tij i vërtetë, që ishte Musa Muslihiddin, u harrua.



Së fundi, aprovimi i gjendjes është një shfaqje e dashurisë dhe e besnikërisë ndaj Allahut. Të qenët i kënaqur me atë që të ka dhënë Allahu përbën një gradë të lartë të cilën mund ta fitojnë vetëm robërit të cilët kanë arritur dijen e vërtetë shpirtërore, duke shpëtuar kështu nga smira, xhelozia dhe injoranca.



Allahu Teala e di të mirën e robit më mirë se vetë robi i Tij. Për këtë arsye, rruga më e mirë mbetet miratimi i caktimit hyjnor dhe falenderimi i Allahut në çdo gjendje. Po ashtu, Allahu na tërheq vëmendjen kur thotë:

“...Një gjë që nuk e doni, mund të jetë e mirë për ju. Po ashtu edhe një gjë që e doni mund të jetë e keqe për ju. Allahu e di e ju nuk e dini.” (el-Bakara, 216)

## 7. Mbështetja dhe dorëzimi ndaj Allahut

Tevekkul do të thotë “mbështetje, dhe besim ndaj Zotit”. Domethënë, ata që e kanë zemrën të mbushur me Allahun duhet t'i besojnë vetëm Atij, sepse vetëm tek Ai duhet të strehohen.

Një nga emrat e bukur të Allahut është “**el-Uekil**”. Ky emër fisnik do të thotë: “Rregulluesi i punëve të atyre që ia lënë Atij t'i rregullojë sipas mënyrës së Tij, Ai që i bën më mirë se sa mund t'i bëjnë ata, Ai te i cili mund të mbështeten, Ai i cili ka gjithçka nën administrimin dhe sundimin e tij.”

Kompetenti i vetëm të cilit mund t'i besohet në çdo çështje, duhet të jetë patjetër i pavdekshëm, i përhershëm, i aftë dhe absolut. Në të kundërt, mbështetje nuk ka kuptim. Allahu thotë kështu:

**“Ti mbështetju Atij të përjetshmit që nuk vdes kurrë dhe madhëroje me lavdërimin që i takon Atij!..”** (el-Furkan, 58)

Allahu Teala dëshiron që robërit t'i besojnë dhe t'i mbështeten vetëm Atij. Në ajetet fisnike thuhet:

“...**Besimtarët le t'i mbështeten vetëm Allahut!**” (Ibrahim, 11)

“...**Allahu i mjafton atij që i mbështetet!..**” (et-Talak, 3)

Edhe Pejgamberi ynë i Nderuar ka thënë:

*“Sikur t'i mbështeteni Allahut plotësisht, Ai do t'ju furnizonte ashtu siç furnizon zogjtë, të cilët dalin të uritur në mëngjes dhe kthehen të ngopur në mbrëmje!”* (Tirmidhi, Zuhd, 33/2344; Ibn maxhe, Zuhd, 14)



Ndërsa dorëzim (teslimijet) do të thotë, bindje, pranimi i ngjarjeve pa i kundërshtuar, si dhe shpëtim. Dorëzimi është një vepër shpirtërore që do të thotë shpëtim nga dyshimet në lidhje me çështjet që janë shpallur nga Allahu, shëtim nga dëshirat vetjake që janë në kundërshtim me urdhërat hyjnorë, nga dëshirat që nuk përputhen me sinqeritetin dhe nga sëmundjet që janë në kundërshtim me caktimin hyjnor dhe ligjet fisnike. Në ajetin fisnik thuhet:

**“Për Zotin jo, ata nuk janë besimtarë derisa të mos zgjedhin ty për të gjykuar në konfliktet mes tyre, dhe pastaj (pas gjykimit tënd) të mos ndiejnë pakënaqësi nga gjykimi yt dhe (derisa) të mos binden sinqerisht.”** (en-Nisa, 65)

Fjala teslimijet vjen nga e njëjta rrënjë me fjalën Islam. Për këtë arsye, vetëm nëpërmjet dorëzimit mund ta jetojmë plotësisht Islamin dhe vetëm me të mund të bëjmë adhurim të vërtetë, sepse Allahu xhelle xhelaluhu nuk kënaqet kur robi i bindet dikujt tjetër përveç Tij.

Dorëzimi është një vepër e bindjes, që mbështetet te dashuria. Ibrahimit alejhisselam, pasuria, fëmijët me bereqetin e bindjes dhe të dorëzimit, nuk i krijuan asnjë pengesë në rrugën e Allahut. Si shpërblim për këtë, adhurimi i haxhit u bë simboli më i bukur i mbështetjes dhe i nënshtrimit që ai kishte ndaj Zotit, simbol i cili do të vazhdojë deri në ditën e kiametit, sepse gjuha e Ibrahimit alejhisselam si përkthyes e zemrës së tij thoshte gjithmonë:

**“...Unë i jam dorëzuar Zotit të Botërave!”** (el-Bekara, 131)

Tasavvufi, i cili ka në bazën e tij dashurinë dhe që është esanca e Islamit, ka për qëllim që në zemra të vendosë nënshtrimin dhe ndjenjën e dorëzimit ndaj Allahut, ashtu që robi të jetojë sipas orientimit hyjnor e t'i afrohet më shumë Allahut në çdo frymëmarrje, sepse ndikimi i dhimbjeve dhe e keqja e mashtrimeve vetjake që kanë rrethuar këtë botë, fillojnë të pakësohen vetëm nga nënshtrimi dhe nga dorëzimi ndaj Allahut. Sa bukur thotë Hazreti Ibrahim Hakki Erzurumi:

*Ti mbështetu te Allahu*

*Dorëzoju që të qetësohesh*

*Ji i kënaqur ndaj çdo pune*





*Të shohim se ç'bën Zoti  
Çfarëdo që të bëjë e bën të bukur!..*

### **Tabllo të virtytshme:**

Një bedevi e pyeti të Dërguarin e Allahut:

“O i Dërguari i Allahut! A t'i mbështetem Allahut pasi ta lidh kafshën, apo t'i mbështetem pa e lidhur?”. Pejgamberi ynë i Nderuar sallallahu alejhi ue sellem u përgjigj:

“*Së pari lidhe, atëherë mbështetju Allahut!*” (Tirmidhi, Kijamet, 60/2517)



Sipas transmetimit të Ummu selemes radijallahu anha, sa herë që i Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem dilte nga shtëpia, e ngrinte gjithnjë fytyrën nga qielli dhe lutej me këto fjalë:

بِسْمِ اللَّهِ تَوَكَّلْتُ عَلَى اللَّهِ اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ أَنْ أُضِلَّ أَوْ أُضِلَّ  
أَوْ أَزِلَّ أَوْ أُزِلَّ أَوْ أَظْلِمَ أَوْ أُظْلَمَ أَوْ أَجْهَلَ أَوْ يُجْهَلَ عَلَيَّ

“*Bismillah! U mbështeta te Allahu. O Zoti im! Unë të kërkoj mbrojtje Ty që të mos devijoj dhe që të mos devijoj nga të tjerët, që të mos largohem nga rruga e drejtë dhe që të mos më largojnë nga ajo, që të mos bëj padrejtësi dhe që të mos më bëhet padrejtësi, që të mos sillen me injorancë apo që të sillen ndaj meje kështu.*” (Ebu Davud, Edeb, 102-103/5094; Tirmidhi, Deavat, 35)



Gjatë një lufte, kur në kohë dreke erdhën në një luginë me pemë, i Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem i urdhëroi ushtarët të pushonin. Ushtarët u shpërndanë dhe u futën nëpër hije. I Dërguari i Allahut po pushonte nën një pemë plot me gjethe, që quhet Semure.



Edhe shpatën e kishte varur në atë pemë.

Xhabiri radijallahu anhu, e tregon kështu vazhdimin e ngjarjes:

“Pasi kishim fjetur pak, dëgjuam se na thirri i Dërguari i Allahut dhe menjëherë vrapuam. Pamë se pranë tij ishte një bedevi. Pejgamberi alejhissalatu uesselam tha:

*-Kur po flija ky bedevi më vodhi shpatën. Kur u zgjova, shpatën e kishte xjerrë nga këllëfi dhe e kishte në dorë. Mua më tha:*

*“Kush do të të shpëtojë tani nga dora ime?” Unë i thashë tre herë:*

*“Allahu!”* (Buhari, Xhihad, 84, 87; Muslim, Fedail, 13)

Kur Krenaria e Gjithësisë, i Nderuari ynë ishte ballë për ballë me vdekjen, për shkak të mbështetjes së fortë që kishte te Allahu, nuk pati frikë fare dhe u përgjigj i sigurtë në vete: *“Allahu do të më shpëtojë!”*. Pas këtyre fjalëve bedeviu i kish rënë shpata nga dora dhe qe dorë-zuar. I Nderuari i Botrave nuk e ndëshkoi bedeviuin që deshte ta vriste, por i tregoi Islamit dhe i propozoi që të bëhet mysliman. Kur bedeviu u kthye te populli i tij nuk e mbajti veten dhe tha:

*“Unë po vij nga më i miri i njerëzve.”* (Ibn Kethir, el-Badije, IV, 87)



Ebu Bekr es-Siddik radijallahu anhu tregon:

(Në rrugën e hixhretit) kur isha bashkë me të Dërguarin e Allahut në shpellë, pashë këmbët e mushrikëve që po na kërkonin dhe thashë:

*“O i Dërguari i Allahut! Nëse ndonjëri prej tyre ulet dhe hedh vështrimin poshtë, do të na shikojë patjetër.”*

I Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem tha:

*“Çfarë mendon për dy vetë dhe që i treti i tyre është Allahu, o Ebu Bekr?!”* (Buhari, Tefsir, 9/9; Muslim, Fedailu's-Sahabe, 1)



Ismet bin Malik radijallahu anhu ka thënë:

“Ne e mbronim natën të Dërguarin e Allahut, derisa zbriti ajeti fisnik, ...**Allahu të mbron Ty nga njerëzit...**” (el-Maide, 67) (Sujuti, Lubabu'n-Nukul, I, 148)

Nëna jonë Hazreti Aishe tregon:

Një natë i Dërguari i Allahut nuk kishte gjumë. Unë i thashë:

“Çfarë ka, o i Dërguari i Allahut?”. Ai më tha:

“*A nuk ka një njeri të devotshëm që të na ruajë sonte?*” Kur po flisnim për këtë, nga jashtë u dëgjuan zëra. I Dërguari i Allahut sallahu alejhi ue sellem pyeti:

“*Kush je?*”. Dikush nga jashtë thirri:

“Jemi Sa'di dhe Huzejfe, o i Dërguari i Allahut! Kemi ardhur për të të mbrojtur.” Pastaj i Dërguari i Allahut alejhissalatu uesselam fjeti. Madje fjeti aq mirë sa ia dëgjoja frymëmarrjet e rregulla. Në lidhje me këtë zbriti ajeti fisnik; “...**Allahu të mbron Ty nga njerëzit...**” (el-Maide, 67) Hazreti Pejgamber nxori kokën nga çadra dhe tha:

“*O njerëz, tashmë mund të ikni, sepse mua më mbron Allahu.*”<sup>54</sup>

Krenaria e gjithësisë, i Nderuari ynë i merrte masat dhe pastaj mbështetej te Allahu. Pasi Allahu Teala i premtoi se do ta ruante, ai iu mbështet pa ndjerë asnjë lloj shqetësimi.



Sipas transmetimit të Ebu Said el-Hudriut radijallahu anhu, një burrë kishte ardhur te i Dërguari i Allahut për t'i thënë se vëllain e tij po e shqetësonte dhimbja e stomakut. Pejgamberi alejhissalatu uesselam i tha:

“*I jepni sherbet mjalti!*” Burri veprooi ashtu. Pas një farë kohe ai erdhi përsëri dhe tha:

“I dhamë sherbet mjalti, por nuk i bëri dobi, veçse ia shtoi edhe

54. Vahidi, Esbabu Nuzuli'l-Kur'an, vrf: Kemal Besjuni Zaglul, Bejrut 1990, fq. 204-205



më shumë dhimbjen.” Burri shkoi e erdhi tri herë rresht. Së fundi, i Nderuari ynë tha:

“*Sigurisht që Allahu thotë të vërtetën, ndërsa stomaku i vëllait tënd po gënjen.*” Pastaj kur i dhanë edhe një herë sherbet mjalti, u shërua. (Buhari, Tib, 4; Muslim, Selam, 91)

Duke treguar përmes këtyre fjalëve të vërtetën që thuhet në ajet, se “**Në mjaltë ka shërim për njerëzit.**” (en-Nahl, 69), i Dërguari i Allahut shfaq mbështetjen dhe nënshtrimin që ai kishte ndaj Allahut Teala. Paskëtaj edhe sahabiu u shërua, duke u strehuar kështu në mbështetjen dhe nënshtrimin ndaj Allahut.



Sipas transmetimit të Hazretit Abdullah bin Abbas, shprehjen:

حَسْبُنَا اللَّهُ وَنِعْمَ الْوَكِيلُ

“*Allahu na mjafton, sa mbrojtës i mirë është Ai.*” Ibrahim i alejhisselam e ka thënë kur e kanë hedhur në zjarr. Edhe Pejgamberi e përdori këtë shprehje kur i thanë: mushrikët janë mbledhur kundra jush, bëni çfarë të doni!”. Pas kësaj, myslimanëve iu shtua besimi, ashtu që duke thënë të gjithë së bashku: “*Allahu na mjafton, sa mbrojtës i mirë është ai.*” treguan një shembull të madh nënshtrimi ndaj Allahut.<sup>55</sup>

Këta myslimanë, të cilët ishin njerëz që i mbështeteshin Atij, Allahu i lavdëron në këtë mënyrë:

“Disa hipokritë u thanë myslimanëve: “Armiqtë tuaj janë tu buar për t’ju sulmuar, pra kini frikë!” Kjo, ua shtoi edhe më shumë besimin atyre dhe thanë: “Neve na mjafton Allahu, Ai është mbrojtësi më i mirë!”. Ata, pa i gjetur asnjë e keqe, fituan begati dhe mirësi të mëdha nga Allahu dhe arritën kënaqësinë e Tij. Allahu është dhurues i madh.” (Ali Imran, 173-174) (Vakidi, fq. 135)



Përmes këtij hadithi fisnik, i Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem shpreh hapur se ata të cilët i mbështeten Atij, Allahu do t'i ruajë në këtë botë e në ahiret dhe se do të hyjnë në xhennet pa dhënë llogari dhe pa u ndëshkuar:

*“Më janë shfaqur popujt e kaluar. Pashë ndonjë pejgamber me të cilin ishte një grup i vogël prej pesë vetash. Pashë ndonjë pejgamber me të cilin ishin një apo dy veta. Pashë edhe ndonjë pejgamber që nuk kishte fare njerëz. Në atë çast më dolën përpara shumë njerëz. Kujtova se ishte ummeti im. Mua më thanë: Ky është ummeti i Musait. Ti shiko në horizont! Pashë andej dhe dallova një njollë të zezë. Më thanë: Ja ky është ummeti Yt. Prej tyre ka shtatëdhjetë mijë vetë që do të hyjnë në xhennet pa llogari dhe pa u ndëshkuar.”*

Ibn Abbas radijallahu anhu thotë:

Kur erdhi fjala këtu, Pejgamberi ynë i Nderuar u ngrit dhe shkoi në shtëpi. Sahabet që ndodheshin të pranishëm filluan të flisnin se kush ishin ata shtatëdhjetë mijë vetë. Disa thonin: “Këta duhet të jenë ata që gjenden në kuvendin e Pejgamberit.” Ndërsa disa të tjerë, thanë: “Këta janë ata që kanë lindur pas ardhjes së Islamit dhe nuk e kanë njohur shirkun.” Ata dhanë edhe disa mendime të tjera. Teksa po diskutonin rreth kësaj çështjeje, i Dërguari i Allahut u kthye përsëri. Ashabët sqaruan:

“Ne po flasim rreth atyre që do të hyjnë në xhennet pa llogari dhe pa u ndëshkuar.” I Dërguari i Allahut tha:

*“Janë ata që nuk bëjnë magji, që nuk duan t'u bëhet magji, që nuk u besojnë fatkeqësisë dhe ata që mbështeten te Zoti i tyre.”*

Ukkashe bin Mihsan radijallahu anhu u ngrit dhe tha:

“Lutju Allahut që edhe unë të jem prej tyre (o i Dërguari i Allahut)!”

Pejgamberi ynë i Nderuar sallallahu alejhi ue sellem tha:

*“Ti je nga ata!”* (Muslim, Iman, 374; Buhari, Rikak, 50)



Hazretin Ibrahim, Hazretin Ismail dhe nënën tonë Hazretin Haxher, Allahu i ka sprovuar me prova të mëdha, aq sa në fund ata hynë në histori si monumente nënshtrimi. Allahu e bëri të përhershëm sinqeritetin e nënshtrimit të tyre me adhurime si haxhi dhe umre, për të qënë si shpërblim për ta.

Kur Allahu xhelle xhelaluhu e bëri mik Hazretin Ibrahim, ëngjëjt thanë:

“O Zoti ynë! Si mund të bëhet Ibrahimimi miku Yt? Ai ka shpirt, pasuri dhe fëmijë. Zemra i anon nga ata...”. Pas kësaj, ata panë tërë ato pamje mësimdhënëse dhe sprovat e rënda të Hazretit Ibrahim. Kur Hazreti Ibrahim alejhisselam do të hidhej në zjarr me katapultë, ëngjëjt u emocionuan. Disa kërkuan leje nga Allahu që ta ndihmojnë. Engjëjt e pyetën Ibrahimin nëse kishte ndonjë dëshirë, por ai u tha:

“Mos hyni ndërmjet mikut dhe mikut!”

Pastaj erdhi Xhebraili alejhisselam dhe e pyeti:

“A ke nevojë për mua?”

Ibrahimimi alejhisselam tha:

“Unë nuk kam nevojë për ty. Ai më ndihmon mua. Sa ndihmues i mirë është Ai.

Po ashtu, mbi nënshtrimin e halilullahit dhe mbështetjen që ai kishte vetëm te Allahu. Pa rënë ende në zjarr, Allahu Teala e urdhëroi zjarrin:

“...O zjarr! Ji i freskët dhe paqe për Ibrahimin!” (el-Enbija, 69)

Pas këtij urdhëri, vendi ku ra Ibrahimimi alejhisselam u shndërrua menjëherë në kopsht trëndafilash. Aty shpërtheu një burim i ëmbël, i cili filloi të rrjedhë.



Pejgamberi ynë i Nderuar tregon:

*“Ibrahimimi alejhisselam dërgoi në Mekke Hazretin Haxher dhe birin e tij Ismailin, i cili ishte akoma në moshën e gjirit... Hazreti*



*Ibrahim u dha gruas dhe birit të tij një torbë të vogël me hurma e një enë lëkure me ujë, pastaj i la aty duke u mbështetur në shumë urtësi. Teksa Ibrahim alejhisselam po bëhej gati të largohej, Hazreti Haxher e pyeti:*

*-O Ibrahim! Si po shkon duke na lënë vetëm në një luginë ku nuk ka as njerëz, as ushqim e asgjë? Edhe pse e përsëriti këtë pyetje disa herë, Ibrahim alejhisselam heshti. Në fund, nëna jonë Haxheri i tha:*

*-A të ka urdhëruar Allahu që të veprosh kështu? Këtë herë Hazreti Ibrahim tha:*

*-Po, Allahu më ka urdhëruar.*

*Nëna jonë Haxher u qetësua menjëherë nga kjo përgjigje, dhe nga gjuha e saj dolën këto fjalë që tregojnë kulmin e nënshtrimit ndaj Allahut:*

*-Atëherë Allahu do të na ruajë dhe nuk do të na lërë të humbur!..*

*Pastaj ajo qëndroi aty. Ndërsa Ibrahim alejhisselam u largua. Kur arriti në vendin Senijje, ku nuk e shikonte askush, ai u kthye nga Qabja, ngriti duart dhe u lut kështu:*

**Zoti ynë! Unë një pjesë të familjes sime e vendosa në një luginë, ku nuk ka bimë, pranë shtëpisë tënde të shenjtë. Zoti ynë (i vendosa aty) që të falin namazin, pra bëj që zemrat e disa njerëzve të mallëngjehen për ata, dhe për të falënderuar me mirënjohje, furnizoj ata me fruta.**(Ibrahim, 37) (Buhari, Enbija, 9)

Ismaili alejhisselam kishte arritur në moshën për të luajtur dhe po jetonte kohën më të bukur të jetës së tij. për ta mbajtur fjalën që i kishte dhënë Allahut, Ibrahim alejhisselam duhet ta bënte kurban Hazretin Ismail. Pasi ai u përgatit dhe mori rrugën, melekët u emocionuan dhe thanë:

*“Një perjgamber po merr një pejgamber që ta bëjë kurban!”*

Ndërsa Ismaili alejhisselam i tha babait të tij Hazretit Ibrahim:

*“O baba i dashur! Bëje atë për të cilën je urdhëruar! Inshallah unë*



do të jem durimtar. Mprehe mirë thikën që të presë menjëherë, sepse kështu është lehtë të vdesës... kur të ma vësh thikën mos më shiko në fytyrë! Sepse kështu ndoshta e vonon premtimin që i ke dhënë Allahut, për shkak të butësisë që ke ndaj meje. Unë mërzitem se ti nuk do të mund ta harrosh dhimbjen dhe mallin e fëmijës që ke bërë kurban me duart e tua...”

Kur babai dhe i biri po notonin në këtë mënyrë në detin e nënshtrimit, erdhi Xhebraili alejhisselam. Ia largoi thikën dhe zbriti nga xhenneti dashin që do të bëhej kuban. (Shik. Taberi, Tarih, I, 275; Ibn Esir, el-Kamil, I, 112; Hakim, II, 606/4040)

Allahu e tregon kështu mbështetjen dhe nënshtrimin e Hazretit Musa alejhisselam:

“Dhe erdhi një njeri që ngutej nga ana më e largët e qytetit e tha:

“O Musa, paria është duke biseduar për të të vrarë ty, menjëherë ik, unë jam këshilluesi yt”. Musai doli prej aty i frikësuar dhe duke kontrolluar (se ç’po ndodh), tha:

–O Zoti im, më shpëto prej popullit dhunues.” (el-Kasas, 20-21)

Me këtë sjellje Musai alejhisselam shfaq se si duhet të jetë tevekkuli (mbështetja) e vërtetë:

Së pari konsultim, pastaj vendosje, pastaj marrja e masave duke ia lënë rezultatin Allahut, domethënë të lutesh, të nënshtrohesh dhe të jesh i kënaqur. Ja ky është tevekkuli i vërtetë!..



Kur Jemenasit shkonin në haxh, nuk merrnin ushqime me vete. Ata mendonin se duke vepruar kështu i qenë mbështetur Zotit. Ata thonin:

“Ne po shkojmë të vizitojmë shtëpinë e Allahut, a nuk na furnizon ai ne?”. Kur shkonin në Mekke detyroheshin të lypnin. Në lidhje me këtë zbriti ajeti: “...**Merreni ushqimin e rrugës me vete...**” (el-Bekara,





Hazreti Omer radijallahu anhu i ka qortuar kështu njerëzit që nuk përpiqen, që përtojnë dhe që pastaj thonë: “Ne i jemi mbështetur Allahut”: “Ju nuk i besoni Allahut, por jeni njerëz që hani dhe i besoni mallit të huaj. **Mbështetësi i vërtetë është ai njeri që e mbjell farën, pastaj mbështetet te Allahu.**”<sup>56</sup>



Ky hadith fisnik që e transmeton Ebu Hurejra radijallahu anhu është shumë mësimdhënëse:

I Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem tregoi gjendjen e një njeriu prej Beni Israil. Ai njeri kishte kërkuar borxh një mijë dinarë nga dikush. Ai që do të jepte borxhin tha:

“Më sill dëshmitarët që të t'i jap në prani të tyre, ashtu që ata të mund të dëshmojnë!”. Ai që po i kërkonte borxhin, i tha:

“Allahu mjafton si dëshmitar!”. Ai që do të jepte borxhin, tha:

“-Atëherë sill një qefil.”. Ai që kërkonte borxhin tha:

“-Allahu mjafton edhe si qefil.” Ai që do të jepte borxhin tha:

“The të drejtën!”. Dhe ia dha paratë për një kohë të caktuar.

Njeriu e kreu udhëtimin e detit dhe e përmbushi nevojën e tij. Pastaj kërkoi një anije për t'u kthyer prapa, me qëllim që ta paguante borxhin në kohën e tij, por nuk gjeti dot. Kur pa se nuk kishte zgjidhje tjetër, mori një copë dru dhe e gdhendi nga mbrenda. Një mijë dinarët bashkë me një letër i futi brënda në drurin e gdhendur. Pastaj ia mbylli grykën drurit të gdhendur dhe e rregulloi. Shkoi në breg të detit dhe tha:

“O Zoti im! Ti e di se unë kam marrë borxh nga filani. Kur kërkoi dëshmitarë nga unë, i thashë: Allahu mjafton si dëshmitar. Edhe ai u kënaq që Ti ishe dëshmitar. Kur më kërkoi qefil, i thashë: Allahu mjafton edhe si qefil! Edhe ai u gëzua që të bëra qefil Ty. Ndërsa unë tani po mundohem të gjej një anije, por nuk po e gjej dot. Këtë po ta lë amanet Ty!”. Dhe e hodhi drurin në det. Druri filloi të notojë dhe dalëngadalë filloi të humbiste nga sytë.

56. Ibn Rexheb el-Hanbeli, Xhamiu'l-Ulum ve'l-Hikem, Amman 1990, fq.650.



Pastaj njeriu u largua së andejmi, filloi përsëri të kërkonte një anije që ta hipte në të.

Në këtë kohë, ai që kishte dhënë borxhin po priste anijen që do t'i sillte paratë, por nuk po i zinte syri ndonjë anije. Ai pa drurin në të cilin gjendeshin paratë. Ai e mori atë dru në shtëpi që ta përdorte për zjarr. Kur e preu me sharrë, ai gjeti lekët dhe letrën.

Pas një farë kohe, ai që kishte marrë borxh mundi të gjente një anije dhe u kthye në vendin e tij. Duke mos qenë i sigurtë që tjetri do ta kishte gjetur drurin me njëmijë dinarët, ai mori me vete njëmijë dinarë të tjerë dhe shkoi menjëherë te personi të cilit i kishte marrë borxh dhe i tha:

“Kam kërkuar anije pa pushim për të të sjellë paratë, por nuk gjeta anije që vinte më herët.” Ai që kishte për të marrë borxhin e pyeti:

“-A më ke dërguar gjë ti mua?”. Ai tha:

“-Unë të thashë që më parë nuk gjeta anije.”

Ai që do të merrte borxhin tha:

“Allahu Teala m'i pagoi në vendin tënd paratë që të kisha dhënë (domethënë, Allahu m'i solli paratë si qefili yt, si shpërblim për sinqeritetin tënd). Për këtë arsye, këto njëmijë dinarë që ke sjellë tani, janë të tuat. Kështu që kthehu i qetë, sikur të kesh fituar njëmijë dinarë!” (Buhari, Kefalet 1, Buju 10)

Nëse Allahu bëhet qefil për diçka, Ai i realizon me lehtësi edhe gjërat që duken si të pamundura. Ajo që i takon robit, është sinqeriteti në mbështetje...



Sipas transmetimit të Ibn Abbasit, Omeri radijallahu anhu kishte marrë rrugën për në Sham. Kur arriti në një vend që quhej Serg, ai u takua me kryekomandantin e ushtrisë së tij Ebu Ubejde bin Xherrah dhe me komandantë të tjerë, të cilët i treguan se në Sham është shfaqur sëmundja e murtajës. Hazreti Omer i tha Ibn Abbasit:

“Më thirr muhaxhirët e parë!”. Hazreti Omer u konsultua me ta



dhe iu tha se në Sham ka sekrecion të gjendrave nga kjo sëmundje. Ata filluan të debatonin rreth mënyrës se si duhej te vepronin. Disa thanë:

“Ti ke marrë rrugën për një punë të caktuar, për këtë arsye nuk e shohim të përshtatshme të kthehesh prapa.”. Ndërsa disa të tjerë thanë:

“Myslimanët dhe ashabët e të Dërguarit të Allahut janë me ty. Ne nuk e shohim të përshtatshme që t'i shpiesh te sëmundja e murtajës.

Hazreti Omer radijallahu anhu tha:

“Mund të shkoni.” Pastaj i tha Ibn Abbasit:

“Më thirr Ensarët!”

Kur edhe Ensarët ranë në kundërshtim ashtu sikundër Muhaxhirët, Omeri radijallahu anhu tha:

“Edhe ju mund të shkoni.”. Pastaj i tha Ibn Abbasit:

“Më thirr të moshuarit e Muhaxhirëve Kurejshë, ata që janë këtu dhe të cilët kanë bërë hixhret për në Medine para çlirimit të Mekkes!”. Unë i thirra ata. Ata pa kundërshtuar aspak thanë me një zë se:

“Ne e shohim të përshtatshme që t'i kthesh njerëzit para dhe të mos i dërgosh te sëmundja e murtajës.”

Pas kësaj, Omeri radijallahu anhu i thirri të gjithë dhe u tha:

“Në mëngjes do të jem mbi kafshën time, edhe ju ua hipni atyre!”. Ebu Ubejd bin Xherrah pyeti:

“A po ikën nga kaderi i Allahut?”. Hazreti Omer tha:

“Ah sikur ta kishte thënë këtë dikush tjetër, o Ebu Ubejde!”. Omeri radijallahu anhu nuk deshë ta kundërshtonte Ebu Ubejden dhe e vazhdoi kështu fjalën:

**“Po, po ikim nga kaderi i Allahut dhe po shkojmë te kaderi i Allahut.** Si thua, sikur të kesh deve dhe ato të zbresin në një luginë, njëra anë e së cilës është pjellore ndërsa tjetra jopjellore? Po t'i kishe kullotur në anën pjellore, do ti kishe kullotur me kaderin e Allahut, por



a nuk do t'i kullosje me kaderin e Allahut edhe në anën jopjellore?

Në atë çast erdhi Abdurrahman bin Auf radijallahu anhu, i cili nuk kishte qënë aty për të kryer disa punë. Ai foli:

“Unë di diçka në lidhje me këtë çështje. Kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut sallallahu alejhi ue sellem që ka thënë:

Mos hyni në një vend për të cilin keni dëgjuar se ka murtajë. Nëse në një vend shfaqet sëmundja e murtajës dhe ju ndodheni brënda, mos dilni jashtë atij vendi duke ikur nga sëmundja!”

Pas kësaj, Omeri radijallahu anhu e falenderoi Allahun, iku prej aty dhe vazhdoi rrugën. (Buhari, Tib, 30; Muslim, Selam, 98)

Kjo ngjarje e reflekton në një mënyrë shumë të bukur konceptimin Islam të mbështetjes dhe kaderit. Sipas kësaj, t'i hedhësh besimtarët dhe veten në rrezik duke e ditur këtë, nuk përputhet me konceptimin e vërtetë të tevekkulit dhe të kaderit.



Mejjit-zade, i cili ka jetuar në kohën e Sulltan Ahmed Hanit I, ishte një dijetar i madh Osman, i njohur për mirësinë dhe dijen e tij. Shkaku që ia kanë ngjitur emrin Mejjit-zade, domethënë “i biri i të vdekurit”, sipas një transmetimi ka të bëjë me këtë shfaqje hyjnore që i ka ndodhur:

Babai i Mejjit-zades ishte një ushtar trim. Si të gjithë ushtarët e tjerë, edhe ai ishte thirrur në luftën e Egrit që zhvilloi Sulltan Mehmedi III në vitin 1596, por në atë kohë gruaja e tij që shtatzanë dhe koha e lindjes ishte afruar shumë. Megjithatë, ushtari-baba për të cilin lufta në rrugë të Allahut ishte mbi gjithçka, përgatiti armët e luftës dhe u fal me bashkëshorten. Ngriti me nderim duart nga qielli i lartë i Allahut dhe u lut në mes lotëve të mëshirës që i ishin mbledhur në sy:

*“O Zoti im! Unë po shkoj në luftë në rrugën Tënde. Unë nuk kam asnjë përveç Teje! O Zoti im! Ty po ta lë amanet fëmijën tim, që do të lindë nga kjo grua besnike dhe e brengosur. Mbroje atë më mirësinë dhe me bujarinë Tënde!”*



Pas këtyre fjalëve, ushtari-baba i hypi kalit dhe shumë shpejt humbi nga sytë. Ushtria Osmane korri fitore me mirësinë dhe ndihmën e Allahut.

Kur u kthyen, ushtari-baba mori leje nga komandanti i tij dhe shkoi drejt në shtëpi, po kur arriti aty, nuk i gjeti pjesëtarët e familjes. Ishte shpërndarë lajmi se ushtria që kthyer me fitore, dhe kësisoj gruaja e tij duhej ta priste në shtëpi. Ai u merakos shumë, shkoi menjëherë të komshinjtë dhe i pyeti për gruan. Të shqetësuar, komshinjtë i thanë ushtarit-baba:

“O trim! Allahu jua bekoftë luftën dhe ju dhashtë bereqet në jetën tuaj!”

Babai e kuptoi se çfarë kuptimi kishin ato fjali dhe me një brengë zharitëse që i ndikoi menjëherë në zemër, belbëzoi:

“Jo, është e pamundur!”. Pastaj, me një zë të mpakur tha:

“Është e pamundur! Unë fëmijën që do të lindte, ia lashë amanet Zotit të Botrave! Ai është mbrojtësi më i mirë!...”

Babai fatqeq, i cili për një farë kohe që pëhumbur në një qetësi të thellë, hodhi vështrimin drejt atyre kishte afër dhe me një frymëzim që i buroi nga zemra tha:

“Sigurisht që Allahu i mëshirshëm është mbrojtësi më i mirë! Menjëherë më tregoni varrin e gruas sime!”

Shkuan së bashku te varrezat. Kur i treguan varrin, vuri veshin te dheu i varrit dhe filloi të dëgjojë i emocionuar. Pas pak thirri me të madhe:

“Ja, po dëgjoj zërin e fëmijës tim!”

Menjëherë mori një kazëm dhe lopatën dhe filloi të hapte varrin. Ata që e shoqëronin filluan t'i ndihmojnë babait të brengosur, për shkak se edhe ata e dëgjuan zërin e fëmijës. Pasi u hap varri plotësisht, u shfaq një pamje e çuditshme dhe e frikshme që mund t'i çonte në zero dëshirat:

Në varr ishte një fëmijë si drita, i cili kishte lindur nga nëna e vde-



kur dhe po qëndronte mbi kraharonin e saj. Luftëtari-baba e mori menjëherë fëmijën dhe e përqafoi. Ia puthi faqet rozë dhe pastaj e mbuloi me një copë të ngrohtë. Mbylli me kujdes varrin e hapur, duke i lexuar gruas së tij Fatihanë e lamtumirësë. Të gjithë po madhëronin Allahun me nderim të thellë për këtë shfaqjeje mrekullore që s' ishte parë ndonjëherë. Edhe babai ra në sexhde duke lotuar dhe falenderoi Allahun, i gëzuar për fëmijën por dhe i mërziur për shkak të bashkëshortes.

Ky fëmijë u rrit në mësim dhe edukatë të bukur dhe u bë një djetar i devotshmën, fama e të cilit u shtri në të tërë shtetin Osman. Ai është kujtuar gjithmonë me emrin Mejjit-zade, pikërisht për shkak të kësaj shfaqjeje mrekullore që i kishte ndodhur. Ai njeri ishte bereqeti mësimdhënës dhe i urtë i një nënshtrimi absolut dhe të sinqertë ndaj Allahut Teala.



Së fundi, për të arritur lumturinë e përhershme e qetësinë shpirtërore në këtë botë dhe në ahiret, bëhet e mundur vetëm me kënaqësi ndaj caktimit hyjnor, duke e konceptuar madhërinë hyjnore, duke iu mbështetur dhe duke iu nënshtruar. Zemrat e bindura, të nënshtruara dhe të kënaqura ndaj urdhërave të Allahut, janë gatuar nga një burim urtësie, mirësie, dhe begatie. Nënshtrimi dhe mbështetja e plotë ndaj Allahut është e lidhur me zemrën e mbushur me ëmbëlsinë e besimit. Vetëm me rezultatin që ka arritur zemra me këtë dashuri, njeriu i drejtohet Zotit me të gjithë qënien e tij dhe qëndron larg nga kjo botë e nga ato që janë në të.

Nënshtrimi i robit ndaj Allahut lidhet me dijen dhe besimin që ai ka për Të. Nënshtrimi nga pikëpamja e asaj që formon esencën e adhurimit, është drejtimi më i rëndësishëm që ka zemra ndaj Allahut. Ky drejtim fillon me besimin dhe kur shtohet dija, edhe besimi vazhdon të shtohet. Mevlana kuddise sirruhu shprehet se e fshehta për të arritur gradën fena fillah (bashkimi me Zotin), qëndron në nënshtrimin absolut:

*“Uji i detit e mban në sipërfaqe të vdekurin që i dorëzohet plotësisht atij. Ndërsa ai që është i gjallë dhe bën qoftë edhe kundërshtimin më të vogël, a mund të shpëtojë gjallë nga deti? Po ashtu, nëse vdes*



*bashkë me sekretin “Vdisni para se të vdisni!” duke u zhveshur nga cilësitë njerëzore , deti i të fshehtës do të shëtiti mbi sipërfaqe.”*

## 8. Mirësia (ihsani) dhe mbikqyrja

Gjendja e mirësisë, e cila shpreh forcimin e ndërgjegjes në zemër dhe të konceptuarët se besimtari vazhdimisht gjendet nën mbikqyrjen hyjnore, pra është nën vëzhgimin e kamerave hyjnore, është miraxhi i shpirttrave të robërve që janë afër Allahut.

Në ajetet fisnike tregohet se Allahu vëzhgon çdo lëvizje të robit dhe se kur të vijë koha do ta marrë në llogari:

**“Ne, duke e ditur mirë, do t’ua tregojmë atyre (atë që kanë bërë) sepse ne nuk mungonim.”** (el-A’raf, 7)

**“A nuk e dinë (hipokritët) se Allahu e di atë që fshehin (në zemra) dhe atë që bisedojnë, dhe se Ai i di të gjitha të fshehtat?”** (et-Teube, 78)

**“Biri im! Nëse vepra që ke bërë (e mirë apo e keqe) peshon edhe sa kokrra e lirit dhe të jetë e fshehur në shkëmb, në qiell apo në tokë, Allahu do ta sjellë atë (përpara teje). Allahu është i butë dhe di gjithçka.”** (Llukman, 16)

Një njeri që e ndjen se e shikojnë dy sy në këtë jetë, shmanget nga shumë sjellje dhe fjalë të këqia. Mbi të gjitha kundrejt dy syve të paaftë për ta ndëshkuar... Po ashtu edhe njeriu besimtar që jeton në mirësi, e kupton se Allahu Teala e shikon dhe di gjithçka që ka folur dhe bërë.

Një kuptim tjetër i mirësisë është kryerja e çdo lloj pune në masat më të përsosura.

Një nga çështjet e rëndësishme në përgatitjen për vdekje, është përforcimi i ndjenjës së mirësisë në zemër. Domethënë, ta kesh zemrën me Zotin në çdo çast dhe ta ndjesh veten gjithmonë nën vëzhgimin hyjnor. Arritja e këtij bashkimi shpirtëror bëhet i mundur vetëm duke e përkujtuar Allahun shumë, shumë.

Ndërsa hapi i dytë për të arritur mirësinë dhe mbikqyrjen, është



meditimi në këto ajete të Zotit:

“...Kudo që të jeni, Ai është me ju...” (el-Hadid, 4)

“...Ne jemi më afër njeriut se sa damari i qafës.” (Kaf, 16)

“...Dijeni mirë se Allahu hyn në mes njeriut dhe zemrës...”  
(el-Enfal, 24)

Në lidhje këtë çështje, i dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem ka thënë:

“Grada më e lartë e besimit është të dish se Allahu është me ty kudo që të jesh.” (Hejsemi, I, 60)

Nuk ka as dyshimin më të vogël se i Dërguari i Allahut ishte gjithmonë në gjendjen e **ihsanit (mirësisë)** natë-ditë, në vështirësi, në rehati, në luftë e në paqe. Mirësitë që ai kryente çdo çast, si dhikri, duatë dhe lutjet që bënte në çdo veprim, adhurimet e vazhdueshme nafile, falja e namazit natën derisa i enjteshin këmbët, përpikmëria në zbatimin e të drejtave, përhapja e drejtësisë dhe e të drejtave, janë argumentet më të forta të ndërgjegjes dhe mirësisë së thellë që kishte ai.

Omer bin Hattab radijallahu anhu tregon një ngjarje që na bën me dije se si u është transmetuar dhe mësuar atyre mirësia që njihet me emrin “Hadithi i Xhibrilit”:

-Një ditë, kur ishim pranë të Dërguarit të Allahut sallallahu alejhi ue sellem, erdhi një burrë me rroba shumë të bardha, me flokë shumë të zeza, i cili nuk kishte ndonjë shenjë që tregonte se ai ishte udhëtar, dhe të cilin nuk e njihje asnjëri prej nesh. Ai u ul përpara Pejgamberit tonë të Nderuar, gjunjët e tij i mbështeti te gjunjët e të Dërguarit të Allahut, duart i vendosi mbi gjunjët e tij dhe tha:

“O Muhammed! Çfarë është Islami?”

I Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem tha:

“Islami është të dëshmosh se nuk ka Zot tjetër përveç Allahut dhe se Muhammedi është i Dërguari i Allahut, të falësh namazin, të japësh zekatin, të agjërosh ramazanin dhe të vizitosh Qaben nëse ke mundësi.”. Burri tha:





“The të vërtetën.”

Ne u habitëm që ai edhe pyeste, edhe e vërtetonte.

Këtë radhë burri pyeti:

“Çfarë është besimi?”

I Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem tha:

*“Është t'i besosh Allahut, engjëjve të Tij, librave të Tij, peygamberëve të Tij, ditës së ahiretit. T'i besosh kaderit, të besosh se e mira dhe e keqja vijnë nga Ai.”*

Burri pohoi përsëri:

“The të vërtetën.”. Pastaj e pyeti:

“Çfarë është **ihsani** (mirësia)?”

I Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem u përgjigj:

*“**Ihsani është ta adhurosh Allahun sikur e shikon, sepse edhe pse Ti nuk e shikon Atë, Ai të shikon Ty.**”* Burri përsëri tha:

“The të vërtetën.” Pastaj pyeti:

“Kur do të ndodhë kiameti?”

Pejgamberi alejhissalatu uesselam u përgjigj:

*“Ai që pyetet nuk ka dijeni në këtë çështje më shumë se ai që po pyet.”*

Burri tha:

“Atëherë më trego shenjat e tij.”

I Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem tha:

*“Kur nëna do të lindë fëmijë të cilët do ta trajtojnë atë si shërbëto-re, gara që bëjnë me njëri-tjetrin çobanët këmbëzbathur, kokë zbuluar dhe të varfër, për të bërë ndërtesa të larta dhe të përsosura.”<sup>57</sup>*

57. Të lindë robëresha zonjën e saj (sipas një transmetimi tjetër, zotërinë e saj) është shpjeguar në formën: “Të lindin nënat fëmijë mëkatarë që do t'i trajtojnë ato si robëresha”. Ndërsa garimi i çobanëve të deleve me kokë dhe këmbë zbathur në çështjen për të bërë ndërtesa të larta dhe të shkëlqyera, domethënë shtimi i luksit dhe i rehatisë



Burri iku pa zë. Unë një farë kohe mbeta i palëvizur. Pastaj Pejgamberi alejhissalatu uesselam tha:

*“O Omer, a e di kush ishte ai që pyeste?”* Unë thashë:

“E di Allahu dhe i Dërguari i Tij.”

I Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem tha:

*“Ai ishte Xhebraili. Erdhi t’ju mësojë fenë tuaj.”* (Muslim, Iman, 1, 5; Buhari, Iman, 37; Tirmidhi, Iman, 4; Ebu Davud, Sunnet, 16)

Dijetarët tonë thonë se ky hadith fisnik është themeli i sunnetit. Domethënë, arritja e përsosmërisë në Islam dhe në besim ka lidhje me ihsanin (mirësinë). Një besimtar që nuk ka arritur gjendjen e ihsanit, do të thotë që e ka fenë e mangët. Një besim i tillë i ngjan një pemë pa fruta, e cila e ka të pamundur të jetojë. Pas një farë kohe ajo pemë patjetër thahet.

Edhe tasavvufi, i cili ka për qëllim të forcojë ndjenjën e ihsanit në zemrat e besimtarëve, është esenca e besimit dhe e Islamit, shfaqja më e qartë e së vërtetës që ata nuk mund ta pranojnë ndryshe.

Në të vërtetë, lumturia më e madhe e robit është bashkimi me Zotin e tij, sepse Krijuesi i Gjithësisë dëshiron të jetë çdo çast me robin e Tij, ndaj thotë:

**“Ata që e përkujtojnë Allahun kur janë në këmbë, kur janë ulur, kur janë të shtrirë dhe meditojnë rreth krijimit të qiejve e të tokës (thonë): Zoti ynë, këtë nuk e krijove kot, i lartësuar qofsh, ruajna prej dënimit të zjarrit!”** (Ali Imran, 191)

Por një mendje që nuk është e lidhur me zemrën, një mendje e mposhtur nga dëshirat vetjake është e paaftë ta konceptojë ëmbëlsinë e të qenit bashkë me Zotin, pra nuk ka dijeni nga virtyti dhe lumturia më e madhe.

Të kënaqesh dhe të marrësh ëmbëlsi nga adhurimet dhe të mos

---

dhe pasurimi i atyre që dikur ishin të varfër, aq sa do të garojnë për të bërë ndërtesa të mëdha e luksoze. Gjithë pasuritë e botës do t’u shfaqen njerëzve. Pasuria dhe paraja do të bëhet masa e vetme e vlerës dhe njerëzit do të jenë të dhënë pas shpenzimit dhe shtirjes.



lodhesh prej tyre, është e mundur vetëm me ndjenjën e ihsanit. Një person që nuk e ka në zemër ndjenjën e ihsanit, nëse fal namaz lodhet dhe namazi i vjen shumë rëndë. Nëse është i pasur, nuk jep zekat e lëmoshë dhe nuk i ndihmon të varfërit. Ai nuk ka arritur ta marrë ëmbëlsinë e besimit, për shkak se është larg mbikqyrjes hyjnore. Nga ky aspekt mund të thuhet se namazi i falur saktë, zekati dhe lëmosha që jepen nga zemra, haxhi dhe agjërimi i mbajtur me dashuri, zemra e shëndoshë që gjendet mes frikës dhe shpresës, morali i bukur dhe të gjitha stolitë e tjera, janë vetëm bereqeti i ihsanit.

### *Tabllo të virtytshme*

Abdullah bin Abbas radijallahu anhu tregon:

Një ditë isha te i Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem. Ai më tha:

*“Biri im, po të mësoj disa rregulla.”* Pastaj shtoi:

*“Mbaji urdhërat e Allahut ashtu që edhe Allahu të të ruajë ty. Nëse e mban kënaqësinë e Allahut përpara gjithçkaje, do të kesh Allahun përpara. Nëse do të kërkosh diçka, kërkije nga Allahu. Nëse do të kërkosh ndihmë, kërkije nga Allahu!..”* (Tirmidhi, Kijamet, 59/2516)

Edhe në një transmetim tjetër thuhet:

*“Mbaji urdhërat e Allahut dhe do ta kesh Atë përpara. Përkujtoje Allahun kur të jesh në mirësi, ashtu që edhe Ai të të kujtojë ty kur të jesh në vështirësi...”* (Ahmed, I, 307)

Sa bukur e ka përmbledhur me këto fjalë esencën dhe shfaqjet e ihsanit i Nderuari ynë sallallahu alejhi ue sellem...



Abdullah bin Omeri radijallahu anhu kishte dalë bashkë me shokët e tij në një vend, në periferi të Medines. Kështu që ata shtruan një sofër. Në ata çaste u afrua një çoban delesh dhe dha selam. Ibn Omer i tha:



“Urdhëroni o çoban, ejani në sofër.” Çobani u përgjigj:

“-Unë jam agjërueshëm.” Ibn Omeri tha:

“Ti mban agjërime në këtë vapë të madhe dhe mbytëse, e po ashtu kullot edhe delet në këtë gjendje?”. Pastaj për të parë devotshmërinë e çobanit i propozoi:

“A bën të na shesësh një dele nga kjo kope dhe t’i japim lekët ty, e pastaj të të japim edhe mish aq sa të mburresh me të?”

Çobani u përgjigj: “Unë nuk kam kope, këto dele janë të zotërisë tim.”

Ibn Omer radijallahu anhu tha:

“Thuaji se të ka humbur, nga do ta dijë zotëria yt?”. Çobani ua kthue shpinën dhe duke e ngritur gishtin nga qielli, tha:

“Ku është Allahu?”

Ibn Omer radijallahu anhu u ndikua shumë nga ihsani dhe mbikqyrja e këtij çobani. Në këto çaste, duke e menduar fjalën e çobanit, e përsëriste atë me vete dhe thoshte: “Çobani tha: Ku është Allahu? Çobani tha: Ku është Allahu?”

Kur erdhi në Medine, i dërgoi një njeri zotërisë së çobanit, të cilit ia bleu edhe kopenë dhe çobanin. Pasi e liroi çobanin, ia fali edhe delet. (Ibn Esir, Usdu'l-Gabe, III, 341)

Ja bukuria e ndjenjës së ihsanit, e mbikqyrjes dhe bereqeti e shpërblimi që kanë akoma në këtë botë... Kush e di se sa është shpërblimi i tyre në ahiret?!



Ishte kohë mbrëmje. Si gjithmonë, Hazreti Omer radijallahu anhu shëtiste nëpër rrugët e Medines. Befas ndaloi. Ia tërhoqi vëmendjen zhurma e një debati që dëgjohej deri jashtë shtëpisë pranë së cilës po kalonte. Një nënë po i thoshte vajzës së saj:

“-Bija ime, qumështit që do të shesim nesër hidhi pak ujë!”

Ndërsa vajza thoshte:



“O nëna ime, a nuk e ka ndaluar halifja që t’i hedhim qumështit ujë?”

Duke e kundërshtuar ashpër vajzën, nëna i tha:

“O bija ime, nga do ta dijë halifja në këtë orë të mbrëmjes që ne i kemi hedhur qumështit ujë?!”

Por vajza, e cila e kishte zemrën të mbushur me dashuri dhe frikë ndaj Allahut, vazhdonte të mos e pranonte hilen e së ëmës që t’i hidhte qumështit ujë dhe tha:

“O nëna ime! Le të themi se halifja nuk na shikon, po as Allahu nuk na shikon? Është e lehtë ta fshehim këtë hile nga njerëzit, por a mund ta fshehim vallë nga Allahu, nga Krijuesi i Gjithësisë që sheh dhe di gjithçka?..”

Përgjigja me frikë të thellë ndaj Allahut, që i dha nënës së vet ajo vajzë e cila kish një zemër të gjallë dhe ndërgjegje të pastër, mbushur me të vërtetat hyjnore, e ndikoi shumë Hazretin Omer radijallahu anhu. Prijësi i besimtarëve e mori për nuse të djalit, dhe jo sepse ajo ishte vajza e një gruaje që shiste qumësht, por sepse në zemrën e saj kishte një devotshmëri të veçantë. I njohuri Omer bin Abdulaziz, i cili përmendet si halifeja i pestë, ka lindur nga kjo prejardhje. (Shik. Ibnu’l-Xhevzi, Sifatu’s-Sahabe, II, 203-204)

Duke e kapërcyer individin, ky shembull tregon se jetesa në gjendje ihsani është shkak për virtytin dhe bereqetin e të gjithë ummetit.

Në kohën e halifatit të tij, Hazreti Omer radijallahu anhu kishte dërguar Hazretin Muadh tek Benikilab. Ai do të merrte paratë që duheshin paguar nga arka e shtetit, do të jepte mallrat që duheshin dhënë dhe do t’u shpërndante të varfërve zekatin e marrë nga të pasurit.

Muadhi radijallahu anhu po e kryente me kujdes detyrën që kish marrë përsipër, kështu që duke çliruar zemrat kthehej me kujtime të bukura. Kur kthehej, nga malli i kësaj bote i ngelte vetëm shalli që hidhte në supe. Ky shall ishte i njëjti që kishte edhe kur shkonte. Një herë, duke mos u përmbajtur më, bashkëshortja e tij e pyeti:

“Ata që kanë një punë të tillë, marrin një pagesë të caktuar dhe



sjellin dhurata në shtëpi. Ku janë dhuratat e tua?”

Muadhi radijallahu anhu u përgjigj:

“Unë kam me vete një që më kontrollon dhe nuk më ndahet kurrrë. Ai llogarit gjithçka që marr dhe gjithçka që jap.”

Bashkëshortja e tij u zemërua dhe tha:

“-I Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem të besonte ty në gjithçka. Edhe Ebu Bekri po ashtu. Tani që erdhi Omeri dërgoka me ty dikë që të kontrollon? A ndjek gjithçka që bën?”

Fjala shkoi te bashkëshortja e Hazretit Omer, pastaj te Omeri. Hazreti Omer e thirri Muadhin radijallahu anhu dhe e pyeti duke e qortuar:

“Ç’janë këto gjëra që kam dëgjuar o Muadh? Kur të kam dërguar ndonjë njeri që të të kontrollojë? A mendon se nuk të besoj?”

Përgjigja e Hazretit Muadh ishte shumë kuptimplotë:

“O prijësi i besimtarëve! Vetëm këtë munda t’i them gruas sime si arsye. Ndërsa ajo që kam thënë për një që më kontrollon, nuk kam thënë për kontrollin tuaj, por për kontrollin e Allahut. Për këtë arsye nuk mund të marr asgjë për veten time, edhe nëse është e lejuar, për arsye që të mos e humbas shpërblimin e shërbimit që kam bërë...”

Hazreti Omer e kuptoi se çfarë kishte pasur për qëllim me këto fjalë, sepse Muadhi radijallahu anhu ishte i panevojshëm për gjërat që i përkasin kësaj bote. Halife i dha disa dhurata për si shpërblim dhe i tha:

“Shko e fitoje zemrën e familjes tënde me këto!”



Një tjetër shembull që e shpreh në formë të qartë ihsanin dhe mbykqyerjen është ky:

Një hoxhë në minber po tregonte gjendjen e ahiretit. Në xhemat ishte edhe Shejhu Hazreti Shibli. Hoxha po fliste rreth gjërave për të cilat t’i pyesë Allahu në ahiret dhe duke e zgatur shumë numuroi tërë



ato çështje:

“Do të pyetet: ku e ke përdorur dijen tënde! Kur e ke harxhuar pasurinë dhe pronën tënde! Si e ke kaluar jetën tënde! Si ke qënë në adhurime! A ke bërë kujdes ndaj haramit dhe hallallit! Do të pyetet kjo, do të pyetet ajo!..”

Ngaqë ai nuk po shtjellonte thelbin e kësaj çështjeje, edhe pse kishte hyrë në shumë hollësi, Hazreti Shibli i thirri:

“Hoxhë i nderuar! Keni harruar pyetjen më të rëndësishme! Allahu Teala do të pyesë: **O robi Im! Unë kam qënë me ty në çdo çast, ti me kë ke qënë?**”



Kur Ebu Bekir Kettani kuddise sirruhu, miku i Zotit, ishte në dyshekun e vdekjes dhe kur e pyetën se çfarë vepre ke bërë në jetë, ai u përgjigj me këto fjalë:

“Sikur të mos e dija se më është afruar vdekja, nuk do t’ju tregoja për punët e mia, duke u shqetësuar se mos është shtirje. Plotësisht dyzet vjet kam qënë roje në derën e zemrës sime. Jam përpjekur që të mos ia hap askujt përveç Allahut. Zemra ime erdhi në një gjendje të atillë, saqë nuk njihite askënd tjetër veç Allahut.”



Sipas një transmetimi, Isai alejhisselam takoi një njeri të sëmure që kishte pulla në trup dhe të cilit i kishin rënë të dy faqet. Ai njeri, i cili ishte në një gjendje ku pothuajse nuk kishte fare dijeni për sëmundjet, fliste me vete:

“O Zoti im! Ty të takojnë falenderimet, Ty që më ke larguar mua nga vuajtjet me të cilat po sprovon shumicën e njerëzve!..”

Isa alejhisselam, me qëllim që të shihte perceptimin dhe përsosmërinë shpirtërore të bashkëbiseduesit, i tha:

“O njeri! Nga cila vuajtje të ka larguar Allahu ty?!..”

I sëmuri u përgjigj:



“O shpirti i Zotit! Sëmundja dhe belaja më e madhe është varfëria dhe indiferenca e zemrës ndaj Allahut. Falenderimet qofshin për Zotin që unë kam dëshirë, kënaqësi dhe begati për të qëndruar me Të në një mënyrë të atillë sa pothuajse nuk di asgjë për sëmundjet që kam...”

U përhap një thashetheme se Shejh Muhammed Nura'l-Arabi, i cili ishte nga mistikët e njohur të shekullit të nëntëmbëdhjetë, kishte mohuar “vullnetin njerëzor”. Sulltan Abdulmexhit Han, i cili e dëgjoji këtë, urdhëroi që Hazreti i moshuar të thirrej në audiencë përpara tij, me qëllim që ta pyeste në lidhje me këtë çështje. Urdhëri u krye dhe Shejhu u thirr në audiencë. Kur u pyet për këtë çështje, Hazreti u përgjigj:

“Unë nuk kam thënë se nuk ka vullnet njerëzor në kuptim të përgjithshëm dhe nuk e kam mohuar. Por kam thënë se për disa njerëz pothuajse nuk ka fare, sepse për të mëdhenjtë e miqve të Allahut, për arsye se jetojnë duke e ditur se janë përpara Zotit, edhe shfaqja e vullnetit të tyre njerëzor është shumë e pakët. Për këtë arsye, përherë veprojnë sipas vullnetit të Zotit ku në pronën e të cilit gjenden dhe jo sipas vullnetit të tyre. Përndryshe do të thotë se janë sjellur pa edukatë dhe kanë bërë gabime.

Për shembull, ne tani jemi përpara Padishahut. Na thuhet Eja, vijnë, na thuhet Shko, shkojmë. Edhe pse ne na ka rrethuar vullneti i padishahut, vullnetin tonë nuk mund ta përdorim si duam. Por shikoni indiferentët dhe krijesat e tjera që janë jashtë, janë të lirë dhe veprojnë sipas vullnetit të tyre.”

Padishahu i cili u kënaq nga përgjigja, e nderoi dhe respektoi Shejhun Muhammed Nuru'l-Arabi.

Robërit e ihsanit dhe të mbikqyerjes, të cilët jetojnë me ndërgjegjen dhe perceptin se Allahu gjithmonë është dhe shikon në çdo vend, i dorëzohen vullnetit hyjnor dhe jo dëshirave të tyre...



Së fundi, ihsani dhe mbikqyerja janë esenca dhe argjendi i besimit. Frutet e diturisë si: frika, sinqeriteti dhe devotshmëria, të cilat duhen në çdo adhurim dhe në bukuritë e sjelljes, mund të fitohen vetëm me këtë





drejtim shpirtëror, sepse për çdo punë të mirë që bëhet duke e ditur se Allahu po të shikon, sinqeriteti i bën me filiza degët e tij, devotshmëria çel lule dhe frika ndaj Allahut jep frutat e saj. Të qëndrosh nën drejtimin e Islamit e larg mëkateve edhe në vende ku nuk të shikon askush, është e mundur vetëm me ndërgjegjen se **“Ai më shikon gjithmonë dhe në çdo vend!”** Për këtë arsye, në të gjitha bazat dhe shtyllat e tij tasavvufi ka për qëllim që ta ngrejë zemrën në këtë gjendje. Miqtë e Zotit janë munduar gjatë gjithë jetës që ta fitojnë këtë gjendje.

Ajo që na bie të bëjmë në këtë gjendje, pasi ta kuptojmë dhe ndjejmë se Allahu na shikon gjithmonë, është të rrisim shkallën tonë shpirtërore dhe ta drejtojmë moralin tonë duke e peshuar sipas me gjendjeve më të larta të Hazretit Pejgamber sallallahu alejhi ue sellem, i cili ishte monumenti më i përkryer i ihsanit.

**“...Patjetër se mëshira e Allahut është afër të mirëve.”** (el-A'raf, 56)

## 9. Modestia

Modesti do të thotë të jesh zemërbutë dhe të kuptosh se je asgjë përpara Allahut. Për shkak të mirësive që i janë dhënë, si dija, pozita dhe pasuria, njeriu nuk duhet të bëjë padrejtësi materiale apo shpirtërore duke pohuar se është më i lartë se ata që janë të privuar nga këto.

Sa bukur thotë poeti:

Mos u bëj mendjemadh prej pasurisë dhe pronës që ke dhe mos thuaj: “a ka si unë”!

Sepse fryn një erë e fortë, dhe e merr komplet si kashtë...

Sepse zotëruesi i çdo çasti dhe i ditëve të nesërme është Allahu, ndërsa njeriu nuk mund ta dijë se çfarë mund t'i ndodhë në të ardhmen.

Allahu thotë:



**“Ji i butë ndaj besimtarëve të cilët të ndjekin ty!”** (esh-Shuara, 215)

**“Robërit e Zotit janë njerëz që ecin nëpër tokë me modesti dhe kur atyre injorantët u drejtohen me fjalë, ata thonë: “Paqe!”** (el-Furkan, 63)

I Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue selem ka thënë:

*“Allahu Teala më ka urdhëruar: Ji aq modest saqë askush të mos mburret ndaj tjetrit dhe askush të mos i bëjë padrejtësi tjetrit.”* (Muslim, Xhennet, 64)

*“Kush është një shkallë modest (ndaj robërve të Allahut) për hir të Allahut Teala, edhe Allahu për këtë do ta ngrejë një shkallë...”* (Ibn Maxhe, Zuhd, 16)

Idrisi alejhisselam e këshillonte popullin e tij me fjalë të urta. Në një rën nga këto këshilla thotë kështu:

*“Kur një njeriu të mençur i shtohen gradët (te Zoti), i shtohet edhe modestia.”*

Hazreti Jusuf Eshat, e shpreh kështu jetimin e plotë të modestisë që në një lloj mënyre do të thotë “asgjë”:

“Kur të dalësh nga shtëpia në mëngjes, atë që do të takosh mendoj se është më i lartë se ti. Kjo është modestia, që kur dikush të thotë një të vërtetë ta pranosh, ndërsa ata që janë më poshtë se ti, t’i mendosh se janë më lart. Bëj që ata që të ofendojnë dhe ata që të lavdërojnë të jenë të barabartë...”

Allahu Teala ua ka bërë kismet lumturinë e ahiretit atyre që nuk janë mburrur dhe nuk kanë qënë kryelartë në këtë botë, atyre që nuk ngatërrojnë dhe atyre që e kanë zemrën të mbushur me dashurinë ndaj Allahut, gjë të cilën e reflektojnë. Kurse ata që largohen nga modestia dhe marrin vese të këqia, nuk kanë shpëtuar pa u bërë si Faraoni. Atëherë është e nevojshme që të shpëtojmë nga këto vese të këqia dhe të bëhemi modestë. Në ajetin fisnik thuhet:

**“Ja ky është vendi i përjetshëm (Xhennetin) të cilin do t’ua japim atyre që nuk duan as mendjemadhësi e as ngatërresë në tokë.**

**Përfundim i këndshëm u takon të devotshmëve.”** (el-Kasas, 83)



Sa bukur thotë poeti:

*Mazhar-ı feyz olamaz dü meyicek hâke nebât  
Mütevâzî olanı rahmet-i Rahmân büyütür.*<sup>58</sup>

Pozitën e kësaj bote që Allahu ua ka dhënë amanet, ashabët e nderuar nuk e kanë bërë kurrë mjet të iluzionit shpirtëror sië janë mendjemadhësia dhe mburrja, ndërsa jetën modeste të Hazretit Pejgamber e kanë bërë kushtetutë të jetës së tyre. Kufinj të shtetit Islam, i cili u krijua në Medine afërsisht nga katërqind familje, brenda dhjetë vjetëve arritën në Irak dhe Palestinë. Kur Hazreti Pejgamber sallallahu alejhi ue sellem po ndërronte jetë, në mes Bizantinëve dhe Persëve vazhdonte lufta. Në Medinë vinte shumë mall luftime, por gjendja e dhjetë vjetëve më parë të ashabëve, domethënë qëndrimi i tyre larg kësaj bote, jeta e tyre modeste, ndërtimi i shtëpive dhe pasioni për të dhënë lëmoshë, nuk kishte ndryshuar. Ata ishin të përpiktë që të mos i përdornin mirësitë e kësaj bote për vete, duke u shqetësuar se mos humbnin ëmbëlsinë e besimit. Për këtë arsye, ata e orientonin jetën e tyre sipas qëllimit që kishin: të fitonin kënaqësinë e Allahut.

### *Tabllo të Virtytshme*

Krenaria e Gjithësisë, i Nderuari ynë sallallahu alejhi ue sellem, i cili u dërgua si mëshirë për botërat dhe për hir të të cilit është krijuar gjithësia, edhe pse kishte të gjitha cilesitë dhe mirësitë e larta, gjithmonë duke thënë “لا فخر” **“Nuk ka mburrje!”**, e ka ruajtur modestinë dhe gjendjen e natyrës së tij.

Një ditë ashabët e nderuar po flisnin me njëri-tjetrin. Ata u çuditën kur mësuan se Allahu ka bërë mik Hazretin Ibrahim, një njeri të cilin e ka krijuar, se ka folur me Musain, që Hazreti Isa është fjala dhe shpirti i tij, dhe që ka zgjedhur Hazretin Adem. I Nderuari ynë erdhi pranë tyre dhe i dëgjoi bisedat e tyre. Ai i vërtetoi gjërat që po thoshin ata, me fjalët: “Po, ashtu si po flisni është.” Pastaj tregoi cilësitë e tij:

58. Pa rënë në tokë, fara nuk mund të shpërthejë dhe të rritet. Nga ky aspekt, mëshira e Allahut Teala rrit dhe i lartëson vetëm modestët dhe jo mendjemdhenjtë.



*“Unë jam i nderuari i të Dërguarve, **por nuk ka mburrje!** Unë jam i fundit i peygamberëve, **por nuk ka mburrje!** Unë jam ai i cili do të ndërmjetësojë i pari dhe i pari që do të më pranohet ndërmjetësimi, por këta (kurrë) **nuk i them për t’u lavdëruar.**” (Darimi, Mukaddime, 8)*

*“Kur të ndahet dhe të hapet toka ditën e kiametit, i pari (do të ngjallet) unë, **por nuk e them për tu mburrur.** Flamuri i falenderimit do të më jepet mua, **por edhe me këtë nuk mburrem!** Unë jam i nderuari i njerëzve ditën e kiametit, **por nuk mburrem!** Në ditën e kiametit i pari që do të hyjë në xhennet do të jemë unë, **por nuk mburrem.**” (Darimi, Mukaddime, 8. Veçanërisht shik. Tirmidhi, Menakib, 1/3616)*



Pejgamberi sallallahu alejhi ue sellem kishte një enë gjelle e cila quhej Garra, të cilën mund ta mbanin katër vetë. Kur hyri koha e paradites dhe pasi u fal namazi i duhasë, e sollën këtë enë në të cilën kishte gjellë. Kur sahabët u shtuan, i Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem u ul në gjunjë. Një bedevi tha:

“Çështë kjo ulje?”. I Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem tha:

*“Allahu më ka krijuar mua rob të ndërshëm dhe jo inatçi!”.* Pastaj vazhdoi:

*“Hajeni ushqimin duke filluar nga qoshet e enës. Mos hani nga mesi i saj ashtu që të shtohet bereqeti!” (Ebu Davud, Et’ime, 17/3773)*



Abdullah bin Xhubejr radijallahu anhu tregon:

Një ditë, kur i Dërguari i Allahut po ecte në rrugë me një grup sahabësh, dikush erdhi me një mbulesë dhe donte ta mbronte të Dërguarin e Allahut nga dielli. Kur i Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem pa hijen, e ngriti kokën dhe pa se po i bënin hije me një mbulesë. I Nderuari ynë i tha burrit që ta lëshonte mbulesën. Pastaj e mori mbulesën, e uli në tokë dhe tha:

*“Edhe unë jam një njeri si ju!” (Hejsemi, IX, 21)*



I Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem ka thënë:

*“Njeriut i mjafton si mëkat edhe po të tregohet me gisht.”* E pyetën:

“Edhe nëse ai është i mirë o i Dërguari i Allahut?”. I Nderuari ynë tha:

*“Edhe nëse është i mirë, përveç atyre që ka ruajtur Allahu. Nëse është i keq, kjo është shumë më e keqe për të.”* (Taberani, Kebir, XIII, 138/14971. veçanërisht shik. Tirmidhi, Kijamet, 21/2453)



I Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem nuk donte që ndokush nga shokët e tij ta shikonte veten të ndryshëm. Gjatë një udhëtimi, ai kërkoi nga ashabët që të presin një dele dhe ta piqnin. Njëri nga sahabët tha:

“O i Dërguari i Allahut, e pres unë atë.”

Dikush tjetër tha:

“O i Dërguari i Allahut, rjepjen e saj ma jepni mua si detyrë.”

Edhe dikush tjetër tha:

“O i Dërguari i Allahut, e pjek unë atë.”

Krenaria e gjithësisë i Nderuari ynë tha:

*“Atëherë drutë do t'i mbledh unë.”*

Edhe pse sahabët thanë:

“O i Dërguari i Allahut! E bëjmë ne edhe atë, nuk ka nevojë që të lodheni.”, Pejgamberi ynë i Nderuar tha:

*“E di që ju mund ta bëni punën time, por mua nuk më pëlqen që të rri në një gjendje të ndryshme nga ju, sepse Allahu Teala nuk do që robi i tij të jetë ndryshe nga shokët e tij.”*<sup>59</sup>



Hyrja e të Nderuarit tonë në Mekketu'l-Mukerrame pas çlirimit të saj, është një nga shembujt më të lartë të modestisë. Sahabët që

59. Kastallani, el-Mevahibu'l-Ledunnije, Egjipt 1281, I, 385.



gjendeshin atje, e përshkruajnë kështu këtë ngjarje:

“I Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem gjendej në krye të ushtrisë që po shkonte të çlironte Mekken. Pasi fitoi dhe po hynte në Mekke, hipur mbi devenë e Tij, ai e uli aq shumë kokën e tij me modesti ndaj Zotit të lartë, saqë maja e mjekrës së Tij pothuajse preku samarin e devesë. Sikur kjo të ishte sexhdeja e falenderimit. Në ato çaste thoshte vazhdimisht:

اللَّهُمَّ لَا أَعِيشُ إِلَّا عَيْشَ الْآخِرَةِ

*O Zoti im! Jeta e vërtetë është vetëm jeta e ahiretit!* (Vakidi, II, 824; Buhari, Rikak, 1)<sup>60</sup>



Një ditë i Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem kishte dalë bashkë me disa Muhaxhirë dhe Ensarë, për të përcjellë si përfaqësues të Jemenit Muadh bin Xhebelin radijallahu anhu. Muadhi radijallahu anhu ishte mbi kafshë, ndërsa i Dërguari i Allahut po ecte në këmbë. Muadhi radijallahu anhu tha:

“-O i Dërguari i Allahut! Unë jam mbi kafshë, ndërsa Ju jeni duke ecur në këmbë! A nuk bën të zbres edhe unë dhe të ec bashkë me Ju dhe ashabët?”. I Dërguari i Allahut e qetësoi atë dhe shprehu mendimin për të cilin të cilin ishte i interesuar:

*“O Muadh! Shpresoj se këta hapa që po bëj, janë hapa që bëhen në rrugë të Allahut.”*<sup>61</sup>

I Nderuari ynë alejhissalatu uesselam ishte po ashtu edhe një monument modestie. Ai nuk merakosej për veten e Tij. I gjithë halli i tij, madje shqetësimi më dërrmues, ishte që njerëzit të udhëzohen dhe të

60. Gjatë gjithë jetës, i Dërguari i Allahut e ka përsëritur shpesh këtë fjalë që tregon rëndësinë e ahiretit në lidhje me jetën e kësaj bote. Në transmetim është vërtetuar se e ka thënë kur po ndërtohej Xhamia e Profetit, kur po hapej kanali, kur po hynte në Mekke ditën e çlirimit, e dhe kur pa shumicën e besimtarëve ditën e arafatit gjatë haxhit të lamtumirës. (Buhari, Xhihad 33, 110, Menakibu'l-Ensar 9, Megazi 29; Muslim, Xhihad 126, 129; Tirmidhi, Menakib 55; Ibn Maxhe, Mesaxhid 3)

61. Dijar Bekri, Tarihu'l-Hamis, Bejrut pa dt., II, 142.



fitojnë lumturinë në këtë botë dhe në tjetrën.



Enesi radijallahu anhu, i cili ishte rritur nën edukimin profetik, kur kalonte pranë fëmijëve u jepte selam dhe thoshte:

“Edhe Pejgamberi alejhissalatu uesselam u jepte selam fëmijëve kështu.” (Buhari, Isti’dhan, 15; Muslim, Selam, 15)

Hazreti Enes në një transmetim tjetër thotë:

“Në njërin nga ditët e fëmijërisë sime, kur po luaja me fëmijët, i Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem erdhi pranë nesh dhe na dha selam. Më kapi për dore dhe më dërgoi për të bërë një punë. Ai u ul në hije të murit derisa u ktheva unë. (Ebu Davud, Edeb, 135-136/5203)

Sipas asaj që kemi mësuar nga Hazreti Enes, i Dërguari i Nderuar, i cili ishte monamenti i modestisë, shkonte shpesh për të vizituar Ensarët. Kur arrinte te shtëpitë e tyre, u jepte selam fëmijëve, u ledhantonte kokën dhe lutej për ta. (Nesai, es-Sunenu'l-Kubra, VI, 90)



Enesi radijallahu anhu thotë:

Shërbëtori i një medinasi e kapte për dorë Pejgamberin alejhissalatu uesselam dhe e dërgonte deri në vendin që donte. (Buhari, Edeb, 61)

Ishte një grua me të meta mendore, e cila quhej Ummu Zufer. Një ditë erdhi te i Dërguari i Allahut dhe i tha:

“O i Dërguari i Allahut! Kam një punë me Ty.”

I Nderuari ynë alejhissalatu uesselam tha:

“Mirë, ku të duash takohemi dhe e kryej hallin tënd.”. Mandej shkoi në qoshe të rrugës dhe e dëgjoi gruan derisa ia kreu hallin. (Muslim, Fedail, 76; Ebu Davud, Edeb, 12/4818)

Hazretin Aishe e kishin pyetur:

“Çfarë bënte në shtëpi Pejgamberi ynë i Nderuar?”

Ajo dha këtë përgjigje:



“Ai i shërbente familjes së Tij. Kur vinte koha e namazit, shkonte në namaz.” (Buhari, Edhan 44, Nefekat 8, Edeb 40)



I Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem e kryente vetë punën e Tij por ndihmonte edhe familjen e Tij. Nga transmetimet në këtë çështje, duhet të arrihet në këtë pikë:

Në shtëpi, i Dërguari i Allahut i pastronte vetë rrobat e tij, milte delet, qepte rrobën e grisur, rregullonte këpucët, fshinte shtëpinë, lidhte devenë dhe i jepte ushqimi, hante bukë bashkë me shërbëtorin e tij, bënte brum me të, ata që i merrte në treg i bartte vetë. Një herë, kur Ebu Hurejra radijallahu anhu desh i mbante rrobat që kishte blerë, por ai nuk ia dha ato dhe i tha:

*“Është më e përshtatshme për një njeri që gjërat e veta t’i mbartë vetë, por nëse është i paaftë për t’i mbartur, atëherë atë e ndihmon vëllai mysliman.”* (Hejsemi, V, 122) Hazreti Omer dhe Hazreti Ali, të cilët e kishin marrë shembull jetën e Tij, edhe në vitet kur ishin halife shkolin në treg dhe i kryenin vetë nevojat e shtëpisë së tyre.



Aishe radijallahu anha tregon këtë ngjarje, që shfaq modestinë e madhe të Pejgamberit tonë të Nderuar, i cili i ndihmonte asaj në punët e shtëpisë:

“Familja e babait tim Ebu Bekrit na pati sjellë një paçë deleje. I Dërguari i Allahut e mbajti mishin dhe unë e preva, ose Ai e preu dhe unë e mbajta.

Njëri që po dëgjonte e pyeti:

“A po e bënit këtë në errësirë, pa dritë?”

Hazreti Aishe u përgjigj kështu:

“Sikur të kishim vaj për ta vënë në llambë, patjetër që do t’ia hidhnin mishit. Kalonte një muaj dhe familja e Muhammedit alejhissalatu uesselam nuk gjente bukë për të ngrënë dhe në oxhakun e tyre nuk zinte tenxhereja.” (Ahmed, VI, 217; Ibn Sa’d, I, 405)





I Nderuari ynë alejhissalatu uesselam ka thënë:

*“Nëse ftohem për të ngrënë mish paçe apo shpatulle, shkoj menjëherë. Nëse me bëhet dhuratë një shpatull apo një paçe, menjëherë e pranoj.”* (Buhari, Hibe 2, Nikah 73; Muslim, Nikah 104)

Nuk ka dhuratë të madhe apo të vogël. Qëllimi i dhuratës është të fitosh zemrën dhe të shtosh dashurinë. Ndërsa të kapësh këtë gjendje të zemrës, mund t’ia arrish vetëm me veshjen e modestisë.

Ndjenjën e të qenit rob i Zotit, i Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem e mbante mbi çdo gjë. Një nga transmetimet që e tregojnë këtë zgjedhje të Profetit, është:

Një ditë i Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem ishte ulur bashkë me Xhebrailin alejhisselam dhe po bisedonin. Në atë çast zbriti nga qielli një engjëll. Xhebraili alejhisselam tha se ky engjëll po zbriste për herë të parë në këtë botë. Engjëlli tha:

“O Muhammed! Mua më ka dërguar Zoti te Ti. Ai po pyet nëse dëshiron të bëhesh një peygamber-mbret, apo një peygamber-rob.”

I Nderuari ynë pa Xhebrailin. Ai i tha:

“O i dërguari i Allahut! Ji modest ndaj Zotit!”

I Dërguari i Allahut shfaqti një shembull modestie të veçantë duke thënë:

*“Unë dua të jem një peygamber-rob.”* (Ahmed, II, 231; Hejsemi, IX, 18, 20) Pas kësaj zgjedhjeje, adhurimi u bë pozita më e ndershme që mund të arrijë njeriu.

Po ashtu, i Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem e ka tre-guar vlerën dhe mirësinë për të qënë rob, duke qortuar ata që e madhëronin shumë Atë:

*“Mos më ngrini mbi gradën që meritoj, sepse Allahu, para se të më bëjë të dërguar, më ka bërë rob.”* (Hejsemi, 21)



Hazreti Omer radijallahu anhu, edhe pse kishte një natyrë të ash-



për, ishte një njeri shumë modest. Ai vishte rroba me arna, mbarte në shpinën e tij ushqim dhe ujë për gratë e veja dhe jetimët, shtrihej dhe flinte mbi hasër, devetë i kreuhte dhe i pastronte me dorën e tij. Gjatë kohës së hilafetit të tij, natën shëtiste nëpër rrugë, dëgjonte ankesat e çdokujt dhe interesohej për hallet e popullit. Ebu Mahzure radijallahu anhu tregon një ngjarje përmes së cilës shfaqet modestia e Hazretit Omer:

“Një ditë, kur isha ulur pranë Omer bin Hattabit radijallahu anhu, Safuan bin Umejje solli një pjatë me ushqim dhe e vendosi përpara Hazretit Omer. Omeri radijallahu anhu u thirri të varfërve dhe robërve që ishin aty. Që të gjithë erdhën dhe hëngrën bashkë me Hazretin Omer. Gjatë ngënies, Hazreti Omer tha:

“Allahu nuk i shpëton ata që turpërohen të hanë bukë me robërit.”. Në lidhje me këtë, Safuan bin Umejje tha:

“Për Zotin ne nuk turpërohemi për të ngrënë me ta. Por nga një herë i japim përparësi vetes sonë, sepse nuk gjejmë çdo herë ushqim të mirë dhe të shijshëm që t’u japim edhe atyre për të ngrënë.” (Ali el-Muttaki, IX, 198/25650)



Një ditë, në kohën e hilafetit të tij, Hazreti Omer radijallahu anhu po ecte në rrugë me Xharud bin Mualla, i cili ishte nga ashabët e nderuar. Atyre u doli përpara Haule bint Sa’lebe. Haule, tashmë e moshuar, në kohën e të Dërguarit të Allahut sallallahu alejhi ue sellem ishte një grua e re. Ajo i tregoi të Dërguarit të Allahut një ngjarje që kishte ndodhur mes saj dhe bashkëshortit të saj të moshuar, çështje për rregullimin e së cilës zbritën ajetet e para të sures Muxhadele. Kjo grua sahabe i thirri Hazretit Omer për ta këshilluar:

“Omer!”

Kur Hazreti Omer radijallahu anhu ndaloi, Haule i tha:

“Në të kemi njohur shumë kohë si Omeri i vogël. Pastaj u rrite dhe u bërë Omeri djalosh. Më vonë u bërë Prijësi i besimtarëve Omer. Ki frikë nga Allahu dhe interesoju me punët e njerëzve, sepse për atë



njeri që ka frikë Allahun, Ai nga larg i bëhet afër. Ai që ka frikë nga vdekja, shqetësohet për të mos humbur mundësinë.”

Hazreti Omer u ndikua nga këto fjalë dhe filloi të qante. Xharudi, i cili u mërziu nga kjo, u kthye nga Hauleja dhe i tha:

“Mjaft e shqetësove Prijësin e Besimtarëve.”. Hazreti Omer u kthye nga ai dhe i tha:

“-Lëre të thotë atë që do! A e di ti se kush është kjo grua? Kjo është Haule që Allahu Teala i dha vlerë duke ia dëgjuar ankesën e saj nga Arshi i lartë. Për Zotin, nëse ajo dëshiron të më mbajë këtu deri në mbrëmje, unë fal namazin dhe vij prap për ta dëgjuar.”<sup>62</sup>

Ja një shembull i qartë se si Hazreti Omer, i cili njihej si një nga personalitetet shembullorë të moralit Islam, ishte një besimtar modest në çështje si: frika ndaj Allahut, madhërimi e dashuria ndaj Allahut, e drejta, e vërteta dhe përgjegjësia...



Me aftësinë e tij të shkëlqyer, Hazreti Mevlana tregon një ngjarje shumë mësimdhënëse e cila shfaq modestinë e Hazretit Omer radijallahu anhu:

Përfaqësuesi i bizantinëve vjen në Medinë për një takim politik. Ai pyet për sarajën e Hazretit Omer. Ata që i pyeti, i thanë:

“Edhe pse emri i halifes është i njohur në të gjithë botën si Prijësi i Besimtarëve, ai nuk ka asnjë saraj në këtë botë. Ai ka vetëm një saraj të ndritshëm zemre. Në këtë botë ka thjesht një kasolle si ato ku strehohen të varfërit dhe të huajt, por ti nuk mund ta shikosh sarajin e tij shpirtëror për shkak të sëmundjes që ke në sy!”

Mbi këto fjalë, përfaqësuesi i Bizantinëve trembet. Ai la ngarkesën, kalin dhe dhuratat e tij dhe filloi të kërkonte Hazretin Omeru'l-Fank. Ai e kërkoi Halifen në çdo anë. Pastaj pëshpëriti me vete tërë habi:

“Domethënë në këtë vend ka një sundues që qëndron i fshehur

62. Shik. Mehmed Zihni Efendi, Meshhur Kadënnlar, Stamboll pa dt., I 250; M. Jashar Kandemir, I. Lutfi Çakan, Rashit Kycyk, Rijazu's-Salihin- Përkthim dhe komentim-, III, 508.



në shikimin e njerëzve si shpirt!..” Kështu ai vazhdoi ta kërkonte halifen...

Një grua arabe i tha:

“Ja, halifeja që kërkoje është nën këtë pemë hurme! Kur të gjithë shtrihen në dysheqe, ai është mbi rërë, që është e kundërta e dysheqeve! Shko dhe shikoje dhillu'l-lahi (hijen e Zotit në këtë tokë), i cili ndodhet në hijen e pemës së hurmës!..”

Përfaqësuesi përjetoi një ndjenjë dinjiteti dhe gjendjeje të mirë shpirtërore kundrejt Hazretit Omer që po flinte. Përfaqësuesi u çudit se si ishin bashkuar në shpirtin e tij dashuria dhe dinjiteti, që janë dy tipare të ndryshme. Me vete tha:

“Unë jam një njeri që kam njohur perandorë, përrëara të cilëve tyre kam vlerë. Nëse te ata nuk kam parë fare dinjitet, tashti ndjej se ky njeri po ma zhduk vetëdijen e dinjitetit dhe dashurisë.

Ky halife qëndron i shtrirë në tokë dhe po fle pa armë dhe pa mbrojtje. Ndërsa unë po dridhem i tëri përballë tij! Çështë kjo punë? Çdo të thotë kjo?! Kjo do të thotë se dinjiteti është i Zotit dhe jo i këtij robi që ka veshur pelerinë!..”

Kur përfaqësuesi i Bizantinëve ishte përfshirë në këtë trazim shpirtëror, Omeri radijallahu anhu u zgjua nga gjumi. Përfaqësuesi i Bizantinëve i jep selam me madhërim Hazretit Omer. Halifeja ia kthen selamin. Pastaj e merr përfaqësuesin që i lëvizte zemra nga vendi në sarajën shpirtërore të tij dhe e qetëson. Ia rregullon zemrën e cila i ishte bërë humnerë. Atij i thotë fjalë të përsosura, serioze dhe të urta.

Ndërsa përfaqësuesi, duke dëgjuar, shikonte gjendje dhe pozitë. Përfaqësuesi, i cili në çastin e sapoardhjes e pa Hazretin Omer si të huaj, u bëhet më pas mik i tij i dashur. Ndërsa përfaqësuesi s'e përmbante veten nga gëzimi i kësaj bisede. Në mendje nuk i ra ndërmend as për përfaqësim e as për marrje e dhënie lajmesh...

Omeri radijallahu anhu, i cili e ndjente gjendjen e vizitorit, vazhonte bisedën me një ekstazë të veçantë. Po fliste për pozitat dhe udhëtimet e shpirtit. Po fliste për një kohë përtej kohës, për pozitat e larta të miqve të Zotit të plotfuqishëm dhe për fluturimet e pakufishme



të shpirtit të bukur në këtë botë.

Së fundi, dielli i besimit shkëlqeu në zemrën e përfaqësuesit, i cili hyri në karvanin e lumturisë së përhershme duke thënë shehadetin përpara halifes.



Një ditë Ahnef bin Kajs radijallahu anhu shkoi për të vizituar Hazretin Omer, bashkë me disa njerëz të rëndësishëm ndër Arabët. E gjeti atë duke vrapuar, teksa fundin e rrobës së tij e kishte lidhur në brez. Omeri, kur e pa Ahnefin, i tha:

“Eja dhe më ndihmo. Ka ikur një deve e shtetit. Ti e di se sa vete kanë të drejta mbi këtë deve.”

Në ata momente njëri nga ata tha:

“Përse e shqetëson kaq shumë veten? A nuk bën të urdhëroshë një rob për të kapur devenë?”. Hazreti Omer radijallahu anhu u përgjigj

“A ka rob më të mirë se sa unë!”<sup>63</sup>

Sa moral i lartë, sa konceptim i hollë dhe sa modesti e madhe...

Në kohën kur Selmani ishte përfaqësuesi i Medainit, atij i erdhi nga Shami një njeri i fisit Beni Tejm. Me vete kishte sjellë edhe një ngarkesë fiqsh. Selmani radijallahu anhu kishte një rrobë dhe një pelerinë. Njeriu nga Shami nuk e njihte Hazretin Selman. Kur e pa në këtë gjendje, i tha:

“Eja dhe mbarte këtë!”

Selmani radijallahu anhu shkoi dhe e mori ngarkesën në shpinë. Kur populli e pa, e njohën. Njeriut nga Shami i thanë:

“Ky njeri që po mbart ngarkesën, është përfaqësues!”. Njeriu nga Shami menjëherë tha:

“Ju kërkoj ndjesë, nuk ju njoha!” Selmani radijallahu anhu i tha:

63. Shibli Numani, Bytyn Jënlerijle Hazreti Omer ve Devlet Idaresi, Perkth. Talib Jashar Alp, Stamboll, pa dt., fq. 384-385.



“Nuk ka asgjë. Nuk do ta ul ngarkesën nga shpina, derisa ta çoj në shtëpinë tënde.” (Ibn Sa’d, IV, 88)

Një ditë, kur Hazreti Husejn radijallahu anhu po kalonte në rrugë, se pa të varfërit që po hanin thërrime buke. Të varfërit e ftuan:

“Urdhëro o rob i Allahut!..

Hazreti Husejn, për shkak se ishte një njeri shumë modest, iu përgjigj me gjithë gëzim kësaj ftese. Menjëherë zbriti nga kali dhe filloi të hajë nga ushqimi që po hanin ata. Kur mbaruan, nipi i mirë i Pejgamberit tonë të Nderuar tha:

“Unë e pranova ftesën tuaj. Tani po ju ftoj unë ju. Urdhëroni në shtëpinë tonë!..”. Të gjithë shkuan të shtëpia e lumturisë dhe hëngrën bukë.



Edhe dijetarët e mëdhenj të këtij ummeti të pastër kanë shfaqur shumë shembuj modestie. Halife Harun Rrashif pyeti një çështje Imamin Ebu Jusuf.

Imam Ebu Jusuf u përgjigj:

“Nuk e di.” Ndihmëtari i halifes i tha atij:

“Po thoni nuk e di, në një kohë kur merrni rrogë!..”

Imam Ebu Jusuf i përgjigjet:

“Rroga ime është sipas dijes sime. Nëse do më jepej rrogë për ato që nuk di, s’do të mjaftonte as thesari...”

Edhe dijetari Imam Gazali ka shfaqur modesti duke pohuar pa aftësinë e tij, me fjalët:

“Sikur t’i vë nën këmbë ato që nuk i di, në krahasim me ato që di, koka do të më arrinte në qiell.”



Hazreti Halid Bagdadi, në kohën që ishte nxënës, kur ende nuk e kish marrë ixhazetin (diplomën), ishte i dalluar në dije dhe kish-



te rënë në sytë e të gjithëve. Në atë kohë, kryetari i Sulejmanijes, Abdurrahman Pasha i cili e vizitoi atë dhe u habit nga dija e tij, i bëri këtë propozim: “Në cilën shkollë të Sulejmanijes të duash të bëhesh mësues, mund të bëhesh.” Ai e refuzoi atë propozim me fjalët: “Unë nuk e meritoj këtë shërbim” Këtë refuzim e bëri për shkak se ende nuk kishte marrë ixhazet dhe për respekt të traditës së dijes. <sup>64</sup>



Me rastin e hapjes së Xhamisë Ullu, Jëlldërëm Bajezid Han kish ftuar të gjithë dijetarët dhe të gjithë shejherët me në krye Emir Buharin (Emir Sulltanin).

Ishte një mëngjes xhumaje. Gjithkush ishte mbledhur për ceremoninë që do të bëhej. Pas një kohe të shkurtër, Sulltan Jëlldërëm Bajezid erdhi dhe i tha dhëndrrit të tij Hazretit Emir Buhari:

“O Emir! Urdhëro, hapi dyert e xhamisë fisnike dhe na fal namazin! Ky nder të përket ty si i madhi i ummetit.”

Por Hazreti Emir Buhari kundërshtoi me një modesti të madhe:

“Jo o sulltani im! Këtë nder duhet t’ia jepni Hazretit Shejh Ebu Hamiduddin!”

Bajezid Hani, i cili që nuk e kishte dëgjuar asnjëherë më parë një emër të tillë, pyeti:

“Kush është ky?”

Hazreti Emir Buhari u përgjigj:

“O Sulltani im! Ndoshta keni dëgjuar për një furrxhi të njohur me emrin Somuncu Bab. Ai u ka dhënë shumë bukë punëtorëve të Xhamisë ullu. Ja ky person është Hazreti Ebu Hamiduddin, një nga të mëdhenjtë e miqve të Allahut.”

Pas kësaj sulltani e pranoi propozimin. Edhe Emir Buhari ua propozoi Somuncu Babanë Xhematit, duke u ngritur në këmbë dhe duke e ftuar atë në minbere. I emocionuar, Somuncu Baba shkoi drejt min-

64. Hejet, Islam Alimleri Ansiklopedisi, Stamboll, pa dt., Tyrkije Gazetesi Jajënllarë, XVIII, 78.



beres duke thënë:

“O Emir! Çfarë bëre, na e nxorre sekretin!..”

Atë ditë Somunxhu Baba në minbere i bëri një tefsir të bukur dhe të veçantë sures Fatiha, por ngaqë e fshehta e tregua për shkak të nevojës, mori me vete nxënësin e tij Haxhi Bajram Velinë dhe e la Bursën për të shkuar në haxh.



Më 15 shkurt 1517, Javuz Sulltan Selim Han hyri në sarajën e Memlukëve me ceremoni të shkëlqyer. Ja si e tregoon historiani i kohës pritjen që iu Javuzit në Kajro nga populli:

“Populli i kishte mbushur rrugët dhe dritaret për të parë madhësh-tinë e Javuzit. Javuzin e pandehnin krejtësisht ndryshe, të gjithë mendonin se veshja dhe kapelja e tij do të ishte e ndryshme nga ata që kishte përreth. Ndërsa Javuzi nuk ishte në krye të ushtarëve por në mes të tyre. Rrobat dhe kapelja e tij nuk ishin të ndryshme nga të atyre që i kishte pranë dhe ai vetë ecte në mënyrë modeste.”

Kur u kthye nga lufta e Egjiptit për në Stamboll, Javuz Sulltan Selim Hani arriti ditën në Yskydar. Ngaqë u lajmërua se populli i Stambollit do t'i bënte shfaqje atij, Javuzi i tha edukatorit të tij:

**“Pasi të bëhet natë, të hyjnë të gjithë nëpër shtëpitë e tyre, të lirohen rrugët, atëherë do të hyj në Stamboll. Të ulemi në tokë, të mos na bëjnë që të mburremi duartrokitjet e të përko-hëshmëve, këmbanat dhe lavdërimet e fitores!..”**

Javuzin e shikojmë si një luan në shkretëtirën e frikshme Sina, kur hyn në Egjipt e shohim si një besimtar modest, me sy të përlotur dhe falenderues, ndërsa në Yskydar e shohim si një dervish të humbur në kënaqësi të thella dhe hyjnore, i cili priret kah llogaria e vetvetes. Ai i lexonte këto vargje Hasan Xhanit:

*Të jesh padishahu i botës, qenka një zënkë e thatë,*

*Të jesh i lidhur ndaj një miku të Zotit, qenka gjëja më e lartë!..*





Kur arriti në saraj lajmi i fitores legjendare që qe korrur në Kanizhe, Sulltani III Mehmed Han u gëzua shumë dhe e shpërbleu me detyrën e vezirit Tirjaki Hasan Pashanë, i cili ishte faktori kryesor i kësaj fitorje. Veç tjerash, ai i dërgoi Pashait dhurata të vlefshme dhe një urdhër të Tij.

Edhe pse kish korrur një fitore të pashoqe, ndërsa lexonte urdhërin përpara luftëtarëve Tirjaki Hasan Pasha ishte në një gjendje të mërzitur. Me modesti të thellë ai tha:

**“Padishahu ynë më ka dërguar detyrën si vezir e po ashtu dhe këtë urdhër si shpërblim për shërbimin e vogël që bëmë në mbrojtje të Kajinës. Por ne vetëm kemi kryer detyrën tonë. A këtij të moshuari i ka ngelur të bëhet vezir i këtij shteti të lartë? Allahu mos e lëshoftë shtetin tonë!”**



Koxha Sinan, i cili ishte gjeni në arkitekturën Osmane, edhe pse kishte shumë suksese, përpara Allahut ai e pranonte veten si një milingonë e paaftë, sepse ai ishte një edukues i pashoq në modesti.

Arkitekt Sinani është munduar shumë që xhamia Sulejmanije të qëndrojë në këmbë deri në kiamet, për këtë ka bërë shumë lutje dhe së fundi, me mirësinë e Allahut ai arriti të ndërtonte një vepër të shkëlqyer dhe të paparë, ndërsa tyrben e tij e bëri në një qoshe të vogël të xhamisë, si të qe një firmë e lehtë. Edhe pse kishte ndërtuar faltore të shkëlqyera dhe me famë, ai nuk mburrej dhe nuk ishte mendjemadh. Në vulat dhe në firmat për veten e tij, në vend të emrit **Ser-Mimaran-ı Hassa**, ai përdorte emrin **“Mur-i Natuvan”** (milingona e paaftë) dhe **“el-Fakirul-Hakir”**. Po ashtu, kur mbaroi ndërtimin e xhamisë Selimije, që është vepra më e madhe e tij, ai iu përgjigj kështu propozimit që iu bë për të shkruajtur në murin e xhamisë emrin e tij:

**“Kush jam unë që të shkruaj emrin tim në shtëpinë e Allahut!..”** me këto fjalë ai shfaqti një thellësi shpirtërore po aq të lartë sa përsosmëria e veprave të tij...



Një ditë, Sulltan Ahmed Han i kishte dërguar një dhuratë të vlefshme edukatorit që e donte shumë, Hazretit Hydaji, por Hazreti Hydaji nuk e pranoi dhuratën. Në lidhje me këtë, për shkak se ndjente përgjegjësi për dhuratën, Sulltan Ahmed Hani ia dërgoi njërit prej shejhëve të asaj kohe, Hazretit Abdulmexhid Sivasi. Hazreti Abdulmexhid e pranoi dhuratën dhe gjatë një vizite Sulltani i tha:

“O Hazret i nderuar! Këtë dhuratë më parë ia pata dërguar Hazretit Hydaji. Ai nuk e pranoi, por ju e pranuat!”

Sivasi, i cili e kuptoi urtësinë në fjalë, dha këtë përgjigje kuptimplotë:

“O Sulltani im! Hazreti Hydaji është një njeri i përsosur dhe nuk ulet për gjëra të fulliqura!”

Sulltani u kënaq nga kjo përgjigje dhe pasi kaluan disa ditë, shkoi te Hazreti Hydaji. Edhe atij i tha:

“O i nderuar! Dhuratën që nuk e pranuat ju e pranoi Abdulmexhid Efendi.”

Edhe Hazreti Hydaji me një fytyrë të qeshur, tha:

“O Sulltani im! Abdulmexhid Efendi është si një det. Rënia e një pike të papastër në një det të madh, nuk e dëmton pastërtinë e tij!”

Sa edukatë e bukur Islame dhe sa shembull i një modestie të veçantë...



Doktori francez A. Brayer, i cili e shikonte me përpikmëri jetën shoqërore Osmane duke qëndruar në Stamboll me vite të tëra, thotë:

“Ndërmjet myslimanëve turq, mendjemadhësia dhe mburrja si një rezultat i turpit ishin shkatërruar pothuajse fare, sepse mendjemadhësia dhe mburrja janë gjëra negative të cilat Islami i ka ndaluar në një mënyrë të ashpër. Myslimanët gjithmonë e këshillojnë njëri-tjetrin kështu:

-Kurrë mos ec me mburrje në tokë. Mos ua kthe shpinën njerëzve për shkak të mburrjes!



-Allahu i urren ata që mburren dhe janë mendjemëdhenj!

-Ji modest në veprat e tua dhe fol me zë të ulët!

-Mendjemadhësia buron nga injoranca, dijetari kurrë nuk është mendjemadh.

-Modestia u jep njerëzve fisnikëri.

Për këtë arsye, në ecjen e Osmanëve kishte dinjitet dhe madhëshi, por kurrë nuk kishte mendjemadhësi dhe mburrje. Ata gjithmonë flisnin me zë të ulët. Në lëvizjet e tyre nuk ishin dhunues. Në shërbimet e tyre kishte ëmbëlsi dhe lehtësi.”

Ja kënaqësia shpirtërore në jetën Osmane e cila përfshinte të gjithë shoqërinë që nga një njeri i thjeshtë deri te padishahu. Kur shkolinin dhe vinin nga ceremonia e së premtës, Sulltanët Osmanë, duke i urdhëruar ushtarët e tyre me pagesë që t’u thoshin:

**“Mos ji mendjemadh o padishah, Allahu është më i madh se ti!..”**, e kishin sjellë në një gjendje tradite zyrtare këtë qortim që u bëhej.

Së fundi, mirësitë e modestisë janë shumë. Njeriu modest është bujar. Njeriu bujar është i mëshirshëm. Njeriu i mëshirshëm është i mbushur me gëzimin e shërbimit ndaj krijesave. Kjo bëhet shkak për të fituar kënaqësinë e Zotit. Një njeri që është larg modestisë, është i privuar nga të gjitha këto bukuri.

Për shkak se perceptimi dhe arsyetimi janë të zhvilluar te një rob modest, ai mund ta dallojë me lehtësi mikun nga armiku.

Modestia është një veti që e zbukuron njeriun, që e bën adhurimin më serioz dhe i jep drejtim moralit. Sa bukur e shpreh këtë Hazreti Mevlana:

*“A gjelbëron në pranverë një gur? Bëhu modest si dheu, që në ty të rriten lule dhe trëndafila!..”*

Me të vërtetë, gjallesat që ecin mbi tokë e shkelin atë, ndërsa jash-tëqitjen e tyre a hedhin aty, por toka e pastron me modesti të madhe këtë gjë të papastër dhe pastaj, duke nxjerrë lloj-lloj barërash e lulesh, i



ushqen të gjitha gjallesat që ecin mbi të. Ja, edhe zemra e një besimtari të devotshmë duhet të jetë kështu, si një tokë pjellore, e të gjitha bukuritë që ka në zemër duhet t'ua reflektojë me çiltërsi të gjithë njerëzve, madje të gjithë krijesave.

## 10. Butësia dhe toleranca

Butësi, do të thotë të mos ushqesh ftohtësi në zemër dhe të jesh durimtar ndaj atyre që kanë bërë gabime kundrejt teje.

Butësia, një nga cilësitë që i pëlqejnë Allahut Teala, është e kundërta e zemërimit. Zemërimi dhe ashpërsia janë e kundërta e butësisë, janë vese të këqia që i lëndojnë njerëzit, i frikësojnë, i ndajnë, i bëjnë të urrejnë. Për këtë arsye, butësia është një nga cilësitë e pejgamberëve. Një person i cili nuk është i butë, nuk mund ta kryejë një detyrë të lartë siç është profetësia. Disa dijetarë çifutë që e mësuan rreth kësaj çështjeje nëpër librat e tyre, e përfshinë në përvojën e tyre cilësinë e butësisë së të Nderuarit tonë dhe u bënë besimtarë kur e panë oqeanin e butësisë të Ai. Allahu Teala thotë:

**“(O i dërguari im!) Ti ishe i butë ndaj atyre, për shkak se Allahu të dhuroi mëshirë, sikur të ishe i vrazhdë e zemërfortë, ata do të largoheshin nga ti, prandaj ti fali ata dhe kërko falje për ta, konsultohu me ta në të gjitha çështjet dhe kur të vendosësh, atëherë mbështetu te Allahu, sepse Allahu i do ata që i mbështeten.”** (Ali Imran, 159)

Islami e ka pranuar si ligj-princip ruajtjen e një metode të mbështetur në normalen, pa rënë në mangësi dhe ekstrem, veçanërisht në shërbime të tilla si edukimi i njeriut dhe predikimi i Islamit. Ky princip realizohet patjetër me “butësi”.

Allahu tregon se është “**el-Halim**” domethënë i Butë. Të gjitha kuvendet e të Dërguarit të Allahut<sup>65</sup>, i cili ishte më i buti i brezit njerëzor, qenë vende ku buronin dhe sundonin mirësi të tilla si butësia, dija,



turpi, durimi, mbështetja dhe amaneti.

I Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem donte që metoda e butësisë dhe e tolerancës të ishte në çdo aspekt të jetës. Po ashtu, për zbatimin e këtij morali të bukur edhe në fushën e tregtisë, thotë:

*“Allahu Teala e mëshiroftë atë që vepron me butësi në shitje, blerje dhe në kërkimin e borxhit.”* (Buhari, Buju’, 16; Ibn Maxhe, Tixharat, 28)

Përsëri, i Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem ka thënë:

*“Ishte një njeri që u jepte borxh njerëzve. Shërbëtorit të tij i thoshte:*

*-Fale atë të varfër që është në vështirësi, shpresojmë që edhe Allahu të na i falë mëkatet tona.*

*Së fundi, ai shkoi te Zoti (vdiq) dhe Zoti e fali atë.”* (Buhari, Enbija, 54; Muslim, Musakat, 31; Buhari, Buju’ 18)

Në një hadith tjetër fisnik thuhet kështu:

*“Ai që u jep kohë atyre të cilëve janë në vështirësi dhe atyre që i kanë borxh, (ose heq dorë nga borxhi), Allahu Teala do ta fusë në hijën e Tij ditën kur nuk do të ketë asnjë hije.”* (Muslim, Zuhd, 74)

Por është e nevojshme që edhe ata që marrin borxh, të mos abuzojnë ndaj kësaj sjellje tolerante dhe ndaj mirësisë së atyre që japin borxh, sepse çështja e borxhit është aq shumë e rëndësishme, saqë kur te i Dërguari i Allahut sillej ndonjë xhenaze për t’i falur namazin, ai pyeste pikë së pari: *“A ka borxh?”*. Nëse kishte, u thoshte të afërmëve të tij që t’ia lanin, pastaj i falte namazin. Nëse borxhi nuk ishte paguar, nuk ia falte namazin.

Nga një anë tjetër, Pejgamberi ynë i Nderuar alejhissalatu uesselam sillej gjithmonë me tolerancë ndaj atyre që sapo ishin bërë myslimanë dhe ndaj atyre që nuk kishin pasur mundësi ta mësonin fenë në mënyrë të mjaftueshme. Nga ky aspekt, butësia dhe toleranca janë cilësitë më të rëndësishme të miqve të Allahut, të cilët kishin marrë nga morali profetik dhe nga morali i robërve të devotshëm.

I Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem i tha Eshexhit, i cili ishte nga Beni Abdulkajs:



*“Ti ke dy veçori të cilat i do Allahu: Butësinë dhe Ndjeshmërinë.”*  
(Muslim, Iman, 25, 26)

Llokman Hakim thotë kështu:

“Biri im! Tri gjëra njihen në tri gjëra: Butësia në çastin e zemërimit, trimëria në sheshin e luftës dhe vëllazëria në kohën e nevojës.”

Si të gjitha vetitë, edhe butësia dhe toleranca kanë një masë. Të jesh i butë, nuk do të thotë kurrë që t'i bindesh dhunës apo të trajtosh me tolerancë shkeljen e ligjeve hyjnore. Një sjellje e tillë, që quhet hilmu'l-himar (urtësi gomari), përbën sjellje shumë e keqe sepse nxit te njerëzit e këqinj dëshirën dhe guximin për të bërë keq.

### *Tabllo të virtytshme*

Ebu Said el-Hudri radijallahu anhu tregon:

Një bedevi erdhi te i Dërguari i Allahut alejhissalatu uesselam, i kërkoi borxhin dhe u soll keq në lidhje me këtë çështje. Madje i tha:

“Nuk do të të lë të qetë derisa të më paguash borxhin.” Ashabët e nderuar e qortuan bedeviun dhe i thanë:

“Të të vijë turp! A e di se me kë po flet!?” Bedeviu tha:

“Unë po kërktoj të drejtën time.”. I Nderuari ynë alejhissalatu ues-salam u tha ashabëve:

*“Ju përse nuk mbani anën e atij që ka të drejtë?”* Pastaj, duke i dërguar një njeri Havle bint Kays radijallahu anha, i tha:

*“Nëse ke hurma të thata, ma paguaj borxhin. Kur të më vijë hurmat, unë ta paguaj borxhin.”* Havle tha:

“Patjetër! Babai im të qoftë falë o i Dërguari i Allahut!”

Gruaja i dha borxh të Dërguarit të Allahut. E paguajti borxhin që ia kishte bedeviu, e madje e nderoi edhe me ushqim. Bedeviu e shprehu kështu gëzimin e tij:

“Borxhin ma dhe të tërë. Edhe Allahu ta dhashtë shpërblimin të



plotë!” I Nderuari ynë tha:

*“Ja këta janë njerëzit më të mirë (të cilët e paguajnë borxhin komplet). Një shoqëri në të cilën të dobëtit nuk mund t’i marrin të drejtat e tyre pa u lënduar, nuk shpëton.”* (Ibn Maxhe, Sadakat, 17)

Siç u pa, jeta e të Nderuarit tonë alejhissalatu uesselam është e mbushur me bukuri që mund të merren si shembull pothuajse për çdo ngjarje që mund t’i ndodhë njeriut. Mjafton ta njohim nga afër Atë dhe të përpiqemi ta jetojmë si duhet sunnetin e Tij të lartë...



Khubejr bin Mut’im radijallahu anhu tregon:

Kur po ecnim bashkë me Pejgamberin alejhissalatu uesselam, gjatë rrugës së kthimit nga Lufta e Hunejnit, arabët bedevi filluan të kërkojnë me këmbëngulje ndarjen e ganimetit (plaçkës së luftës). Së fundi, ata e ndalën të Dërguarin e Allahut nën pemën Semure. Rroba e Tij u ngatërrua në degët e pemës dhe ngeci aty. I Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem ndaloi devenë e tij dhe tha:

*“Më jepni rrobën time! Sikur të kisha aq kafshë sa këto pemë që i shikoni, do t’ua jepja të gjitha ju. Pastaj edhe ju do të shikonit se nuk jam koprac, gënjeshtar dhe frikacak!”* (Buhari, Xhihad 24, Humus 19)

I Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem i trajtonte me butësi dhe tolerancë ata që sapo ishin bërë myslimanë dhe që akoma nuk i kishin në shpirt hijeshitë dhe imtësitë e kësaj feje.



Enesi radijallahu anhu tregon:

“Unë nuk kam prekur copë apo pe, që të jetë më e butë se duart e të Dërguarit të Allahut. Nuk kam marrë erë më të mirë se sa era e të Dërguarit të Allahut. Të Nderuarit tonë i kam shërbyer plot dhjetë vjet. Qoftë edhe një herë nuk ka bërë Uf përpara meje. Ashtu siç nuk më ka thënë “Përse e bërë kështu?” për shkak të ndonjë gjëje që kam bërë, nuk më ka thënë as “A nuk do ishte mirë sikur ta bëje kështu?” për ndonjë gjë që nuk e kam bërë (Buhari, Saum 53, Menakib 23; Muslim, Fedail 32)



Ja, me këto sjellje e edukonte i Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem Hazretin Enes, i cili iu la Atij amanet në moshën dhjetëvjeçare. Edhe metoda e edukimit në tasavvuf është po e këtillë. Njeriu ndikohet nga personaliteti dhe karakteri dhe e imiton atë nga i cili ndikohet, sepse “prirja e imitimt” është prirja më e rrënjësor në krijimin e njeriut. Për këtë arsye, edhe në anën pozitive edhe në anën negative, njeriu e pëlqen zhvillimin e tij material dhe shpirtëror, gjë të cilën e realizon nën ndikimin e atyre që imiton.

Muavije bin Hakem radijallahu anhu tregon:

Kur po falnim namaz prapa të Dërguarit të Allahut sallallahu alejhi ue sellem, dikush nga xhemati teshtiu. Unë menjëherë i thashë “jerhamukallah” (Allahu të mëshiroftë). Xhemati filloi të më shikonte me inat. Atëherë thashë:

“Medet, çfarë më ndodhi! Përse më shikoni ashtu?”. Kësaj here ata filluan të godasin gjunjët me duar. Kur e kuptova se ata po mundohen të më bëjnë të hesht, unë u nxeva, por nuk fola më.<sup>66</sup>

Nëna dhe babai i qofshin falë të Dërguarit të Allahut. Kurrë nuk kam parë mësues më të mirë se Ai, as para Tij, as pas Tij. Për Zotin as nuk më qortoi as nuk më rrahu. Kur e fali namazin, me një gjuhë të butë më tha:

*“Emri i këtij adhurimi është namaz. Kur falet namaz nuk fliten fjalë të kësaj bote, sepse namazi formohet nga tesbihi, tekbiri dhe Kur’ani.” Ose përdor shprehje të njëjta me këto.”* Unë thashë:

“O i Dërguari i Allahut! Unë sapo jam bërë mysliman...” (Muslim, Mesaxhid, 33)



Zeyd bin Sa’ne, i cili ishte dijetar çifut, po kërkonte të dinte nëse gjendeshin apo jo te i Dërguari i Nderuar cilësitë që qenë përshkruar në Teurat për pejgamberin e fundit që po prisnin. Një ditë ai pa se

66. Të bësh në namaz një vepër që është jashtë adhurimit, sigurisht që përbën diçka kundra shpirtit të namazit, por edhe këto sjellje që shfaqen në namaz sahabiu që u nxe, e po ashtu dhe sahabët që u inatosën me atë shembull, duhet t’i shohim të arsyeshme, sepse, populli në atë kohë sapo ishte bërë mysliman dhe





Hazreti Pejgamber po dilte nga shtëpia bashkë me Hazretin Ali dhe i ndoqi nga pas. Në atë çast, një burrë me rroba bedeviu iu afrua të Dërguarit të Allahut dhe i tha:

“O i Dërguari i Allahut! Unë u kam thënë njerëzve të filan fisi se, nëse bëhen myslimanë Allahu Teala do t’u japë shumë rizk. Ata u bënë myslimanë, por për fat të keq në fisin e tyre ka zi buke. Njerëzit janë në një gjendje shumë të vështirë. Kam frikë se këta njerëz që janë bërë myslimanë, duke shpresuar në këtë botë, do të kthehen në fenë e tyre të vjetër kur të mos e gjejnë atë që kanë shpresuar. Nëse dëshiron t’u japësh ndonjë gjë për t’i ndihmuar, unë mund t’ua dërgoj.”

Zejd bin Sa’ne e dëgjoi këtë bisedë dhe ndërhyri në bisedë, duke menduar se ka kapur një rast të përshtatshëm për ta provuar të Dërguarin e Allahut:

“O Muhammed! Nëse mendon t’i ndihmosh ata, unë mund të të jap borxh sipas një kontrate që mund të bëjmë.”

Hazreti Pejgamber sallallahu alejhi ue sellem mori nga ai tetëdhjetë dinarë borxh, ia sahabiut që t’ua dërgonte atyre njerëzve dhe i tha:

*“Shko shpejt te ata dhe ndihmoji!”*

Një ditë tjetër, Krenaria e gjithësisë, i Nderuari ynë bashkë me Hazreti Ebu Bekrin, Hazreti Omerin dhe disa sahabi të tjerë, po dërgonin një xhenaze te varrezat e Xhennetu’l-Baki<sup>67</sup>. Pasi Pejgamberi ynë i Nderuar sallallahu alejhi ue sellem fali namazin e xhenazes, Zejdi iu afrua dhe ia tërhoqi rrobën që kishte në shpinën e bekuar. I Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem, i cili nuk e kuptoi se përse bëri këtë, po shikonte me habi rrobën që ra në tokë dhe fytyrën e varur të Zejdit. Ky filloi të flasë në mënyrë të përgatitur qysh më parë:

“A nuk do ta paguash borxhin, Muhammed? Në fakt ju bijt e Abdulmuttalibit gjithmonë i vononi borxhet!”

Por koha e atij borxhi që i Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem kishte marrë nga Zejdi nuk qe mbushur akoma.

67. Xhennetu’l-Baki: Varrezat e njohura të Medines, që gjenden njëqind metra larg xhamisë së Pejgamberit tonë të Ndëruar.

Zejdi, i cili e tregon vetë ngjarjen, thotë:

Në atë moment u ktheva dhe pashë Omerin. Kur e pashe se si i fryhej dhe i ulej kraharori si gjyryk, më erdhi zemra te goja. Duke më parë ashpër në fytyrë, ai më bërtiti:

“O armik i Allahut! A këto fjalë po i thua të Dërguarit të Allahut? Po sillesh pa respekt me të edhe po i flet pa edukatë! Betohem në Atë që e ka dërguar si peygamber, se do të ta fluturoja kokën sikur i Dërguari i Allahut të mos të të kishte borxh!..” I Nderuari ynë, kur pa se si u nxeh Hazreti Omer radijallahu anhu nuk i rezistoi dot fyerjes që i bëri një çifut të Dërguarit të Allahut, buzëqeshi dhe i tha:

“Qetësohu o Omer! Tani si unë ashtu dhe ky person, po presim një sjellje tjetër nga ti. Ti duhet të më thojë që t’ia paguaj borxhin në një mënyrë të bukur, ndërsa këtë duhej ta këshilloje që ta marrë borxhin me një gjuhë më të përshtatshme. Në të vërtetë ka edhe tri ditë për t’u mbushur koha e borxhit, por t’i ngrihu dhe paguaje për mua borxhin tim! Jepi pak më tepër për shkak se e trembe!

Zejdi, pasi e mori borxhin më shumë se kishte dhënë, i tha Hazretit Omer:

“Shiko o Omer! Sa herë që shoh fytyrën e të Dërguarit të Allahut, dalloj tek ai të gjitha shenjat e profetësisë, por deri më sot nuk e kisha pasur mundësi ta vija re nëse i ka apo jo dy cilësi që patjetër duhet t’i ketë. **A thua i fal ata që sillen keq me të? A i shtohet butësia dhe toleranca aq sa i shtohen vështirësitë?** Ja, këtë provova unë sot dhe tani u binda plotësisht se ai është peygamberi që pritej. Ji dëshmitar se unë po e pranoj Allahun si Zot, Islamin si fe, Muhammedin sallallahu alejhi ue sellem si peygamber dhe se gjysmën e pasurisë sime ia kam dhënë si sadaka ummetit të Muhammedit!”

Omeri radijallahu anhu, i cili u gëzua shumë që Zejdi u bë mysliman, e qortoi kështu:

“Të gjithë myslimanëve nuk u mjafton pasuria jote. Të paktën thuaj se do t’ua fal disave.”

Zejdi e korrigjoi menjëherë fjalën e tij:



“Ke të drejtë, gjysmën e pasurisë sime po ua fal disa myslimanëve.  
(Hakim, III, 700/6547)



I Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue selem bëri që njerëzit të jepeshin pas karakterit të lartë dhe pas personalitetit të pajisur me cilësi të bukura siç janë butësia, toleranca e durimi, si dhe të orientoheshin kah mirësia e Allahut Teala, aq sa brenda një kohe të shkurtër ai e shpërndau Islamin në tërë gadishullin arab.

Ndërmjet robërve që Abdullah bin Xhahsh radijallahu anhu kishte zënë në luftën e Batu'n-Nahle, ishte edhe Hakem bin Kejsan. Krenaria e Githësisë, i Nderuari ynë e ftoi Hakemin në Islam. Ai ia shpjegoi Islamin me të gjitha hollësitë. Ia përsëriti disa herë, që atij të mos i mbetej ndonjë paqartësi. Hazreti Omer radijallahu anhu, i cili u zemërua që Hakemi nuk u bë mysliman, edhe pasi i Dërguari i Allahut u mundua aq shumë, tha:

“O i Dërguari i Allahut! Pse po flet më këtë? Për Zotin ai kurrë nuk bëhet mysliman! Më jep leje t’ia pres kokën dhe të shkojë në vendin ku ka për të shkuar, domethënë në xhehennem!”. Por Pejgamberi ynë i Nderuar vazhdoi t’ia shpjegonte Islamin Hakemit. Teksa të gjithë i kishin sytë tek ai, Hakemi pyeti:

“Çështë Islami?”

I Dërguari ynë i Nderuar tha:

*“Të adhurosh Allahun pa i shoqëruar asnjë gjë si ortak, dhe të dëshmosh se Muhammedi është robi dhe i Dërguari i Tij!”*

Hakemi tha:

“U bëra mysliman.”

Pas kësaj, Pejgamberi ynë i Nderuar u kthye nga ashabët e Tij dhe tha:

*“Nëse unë do t’i kisha dëgjuar fjalët tuaja pak më parë, ai tashmë do të ishte në xhehennem!”*

Hazreti Omer radijallahu anhu thotë:



“Kur e pashë se Hakemi u bë mysliman u zemërova me veten pa masë. Thashë me vete: Duke e ditur se Pejgamberi alejhissalatu uesselam e di gjërat më mirë se sa unë, si mund të guxoj të kërkoj ndonjë gjë kundër tij?! Pastaj e ngushëllova veten duke thënë: Qëllimi im ishte vetëm që të fitoja kënaqësinë e Allahut dhe të të Dërguarit të Tij. Hakemi u bë mysliman. Për Zotin u bë një mysliman i mirë, madje ai luftoi në rrugë të Allahut dhe ra dëshmor në Bi’ru’l-Maune.” (Ibn Sa’d, IV, 137-138; Vakidi, I, 15-16)



Ebu hurejra radijallahu anhu transmeton një ngjarje të tillë:

Njëri prej bedevive pati prishur abdestin e vogël në Xhaminë e Profetit. Sahabët filluan ta qortojnë menjëherë. Në lidhje me këtë, Hazreti Pejgamber sallallahu alejhi ue sellem tha:

*“Lëreni burrin të qetë. Hidhni një kovë ujë aty ku e prishi abdestin. Ju nuk jeni dërguar për të shfaqur vështirësi, por për të shfaqur lehtësi.”* (Buhari, Vudu’ 58, Edeb 80)



Enesi radijallahu anhu thotë:

Po ecja bashkë me të Dërguarin e Allahut sallallahu alejhi ue sellem. Ai kishte një jelek të bërë me copa nexhrani, i cili i kishte cepat e fortë dhe të trashë. Një bedevi iu afrua të Dërguarit të Nderuar dhe ia tërhoqi fort jelekun. Nga gjesti që bëri bedeviu, cepi i jelekut shkaktoi një shenjë në qafën e të Nderuarit. Pastaj bedeviu tha:

*“O Muhammed! Urdhëro që të më japin edhe mua nga mallrat e Allahut që ke Ti.”*

Krenaria e Gjithësisë, i Nderuari ynë u kthye nga bedeviu dhe buzëqeshi. Pastaj urdhëroi që t’i jepnin diçka edhe atij. (Buhari, Humus 19, Libas 18, Edeb 68; Muslim, Zekat 128)

Sa shembull i madh butësie dhe tolerance!..

Një ditë, teksa po shëtiste në qytet, Hazreti Ebu’d-Derda pa se disanjerëz po ofendonin një mëkatar me fjalë të rënda. Ata i pyeti:



“Nëse shikoni një njeri në pus, a nuk e nxirrni prej aty?”

Ata i thanë:

“Po e nxjerrim!”

Atëherë Hazreti Ebu'd-Derda tha:

“Atëherë mos i thoni fjalë të rënda vëllait tuaj, por falenderoni Allahun i cili ju ka dhënë shëndet!”

Mbi këtë ata thanë:

“A nuk po nxeheni me këtë mëkatar?”

Sahabiu i shkëlqyer, i cili ishte formuar me edukatën e të Dërguarit të Allahut sallallahu alejhi ue sellem, u përgjigj:

“Unë nxehem me mëkatin e tij dhe jo me atë. Kur ta lërë mëkatin, ai do të jetë përsëri vëllai im në fe.” (Abdurrazzak, XI, 180; Ebu Nuajm, Hilje, I, 225)



Në kohën e të Dërguarit të Nderuar sallallahu alejhi ue sellem, ishte njëri që quhej Abdullah. Ky njeri që thirrej me nofkën “Gomar”, me shakatë e tij arriti ta bënte Hazretin peygamber të qeshte. I Dërguari i Nderuar herë-herë e ndëshkonte për shkak se pinte alkool...

Një ditë, pasi Abdullahi mbaroi ndëshkimi dhe iku, njëri prej atyre që ishin të pranishëm bëri një lutje të keqe: “O Zot, mallkoje atë!” Në lidhje me këtë, i Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem tha:

*“Mos thoni ashtu. Mos i ndihmoni shejtanit kundër vëllait tuaj. Për Zotin unë e di se ai e do Allahun dhe të Dërguarin e Tij. Në vend që të luteni keq për të, lutuni kështu: O Zot! Fale atë. O Zot! Mëshiroje atë!”* (Buhari, Hudud, 4, 5; Ebu Davud, Hudud, 35)

Ja, kjo panoramë përbën një shfaqje të qartë butësie dhe tolerance, e cila buron nga dhembshuria, mëshira dhe dashuria që i Dërguari i Allahut kishte për ummetin e tij.



Kur një ditë Hazreti Rebi bin Hajsem po falte namaz, i vodhën kalin që vlente njëzet mijë dirhem, por ai në vend se të shkonte pas hajdutit, zgjodhi që të vazhdojë kryerjen e namazit me qetësi.

Miqtë e tij të cilët morën vesh për këtë humbje të madhe, shkuan ta ngushëllonin. Hazreti u tha miqve të tij:

“Unë e pashë atë tek po zgjidhte kalin, por në atë kohë isha i zënë me një punë më të rëndësishme të cilën e doja më shumë. Për këtë arsye nuk munda ta ndjek hajdutin.”

Mbi këtë miqtë e tij filluan të luteshin për ndëshkimin e hajdutit. Hazreti i qetësoi ata duke u thënë:

“Qetësohuni, mua nuk më ka dhunuar njeri! Ai njeri ka dhunuar veten. Le të mos t’i bëjmë padrejtësi edhe ne, si të mos i mjaftojë e tija!” (Shik. Babanzade Ahmed Naim, Islam Ahlakının Esasları, fq. 85-86)

Ja një shembull i pashoq që jetohet në kulmin e dashurisë dhe dhembshurisë... gjendja e veçantë që kanë miqtë e Allahut, domethënë mënyra e qasjes ndaj krijesave me shikimin e Krijuesit...



Sa reflektim i madh i virtytit është përgjigja që Imam Sha’bi, një nga të mëdhenjtë e tabiinëve i dha një mëkatari:

“Nëse ato që thua janë të vërteta, Allahu më faltë! Nëse gënjen, Allahu të faltë!”



Së fundi, butësia dhe toleranca, të cilat janë rrjedhojë e cilësive të bukura si mëshira, dhembshuria dhe dashuria, përbëjnë principe të rëndësishme në marrëdhëniet me njerëzit. Ata janë urdhëri hyjnor i Allahut dhe natyra e vërtetë e Pejgamberit tonë të Nderuar. I Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem ka thënë:

*“Atij që është i butë, i është dhënë edhe mirësi. Ai që nuk është i butë, është i privuar nga mirësia.”* (Tirmidhi, Birr, 67/2013)



## 11. Të Mendosh mirë për të tjerët

Husnu'dh-Dhan do të thotë te mendosh mirë për të tjerët, të shpresosh gjëra të mira, të qëndrosh larg nga mendimet negative dhe larg paragjykimit, domethënë nga mendimet e këqia. Për sa kohë që myslimanët të jenë të sukseshëm në të menduarët mirë për njëri-tjetrin, ata janë të mbrojtur nga mundësia e rënies në shumë gabime.

Për të mbyllur të gjitha rrugët që çojnë në paragjykim, në ajetin fisnik thuhet:

**“O ju që keni besuar! largohuni prej dyshimeve të shumta, sepse disa dyshime janë mëkate. Mos kërkonit zbulimin e të metave të njëri-tjetrit. Mos përgojoni njëri-tjetrin. Mos ndonjëri prej jush dëshiron të hajë mishin e vëllait të tij të vdekur? Këtë pra e urreni! Atëherë jini të devotshëm ndaj Allahut. Sigurisht që Allahu është mëshirues dhe e pranon shumë pendimin.”** (el-Huxhurat, 12)

Edhe Pejgamberi, i Nderuari ynë ka thënë:

*“Kini frikë nga paragjykimi, sepse paragjykimi është gjënjeshtra më e madhe. Mos dëgjoni çfarë thonë të tjerët, mos zbuloni gabimet e njëri-tjetrit, mos u mburrni ndaj njërit-tjetrit duke u lavdëruar, mos kini smirë ndaj njëri-tjetrit, mos urreni dhe mos e ktheni shpinën. O robërit e Allahut! Bëhuni vëllezër siç ju ka urdhëruar Allahu...”* (Muslim, Birr, 28-34)

Në një tjetër hadith fisnik, i Nderuari ynë alejhissalatu uesselam ka thënë:

*“Asnjëri prej sahabëve të mi të mos më tregojë për gabimin e ndonjërit! Unë dua të dal përpara jush me një zemër të shëndoshë.”* (Ebu Davud, Edeb, 28/4860)

Të mendosh mirë për njerëzit nuk i sjell ndonjë fatkeqësi apo ngarkesë njeriut, përkundrazi e shpëton atë nga shumë mëkate dhe lodhje. Këtë të vërtetë, Hazreti Ali e shpreh bukur me këto fjalë:

“Mendo mirë për robërit e Allahut. Nëse vepron kështu, shpëton nga shumë lodhje.”



Myslimanët të cilët mendojnë mirë edhe për të vdekurit, duhet të mendojnë se ata mund të falen. Të mendosh të kundërtën e kësaj, askujt nuk i bën dobi.

Gjithmonë duhet të mendojmë mirë për njerëzit dhe ngjarjet (duke mos anashkaluar as kontrollin kur të jetë nevoja). Nëse e vërteta e një çështjeje nuk dihet plotësisht, për myslimanët është kusht që të mendojnë mirë për njëri-tjetrin, sepse ne jemi përgjegjës për paragjykimin. Sepse, nëse kemi bërë gabim për arsye se kemi menduar mirë, nuk merremi në llogari. Humbja jonë është vetëm gabimi që bëme për shkak të nijetit të mirë, por nëse paragjykojmë dikë, jemi të detyruar që në fund të japim llogari për këtë.

### *Tabllo të virtytshme*

Sipas transmetimit të Abdullah bin Amrit radijallahu anhu, gjatë një tavafi Krenaria e Gjithësisë, i Nderuari ynë, duke iu drejtuar Qabes tha:

*“Sa e pastër që je, sa erë të mirë ke! Sa e lartë që je, sa nder të madh që ke! Betohem në Allahun në dorën e të cilit është shpirti i Muhammedit, se vlera e një besimtarit te Allahu është më e madhe se vlera jote. Edhe nderi i pasurisë dhe i gjakut të besimtarit kështu është. **Ne vetëm mendojmë mirë për besimtarët.**”* (Ibn Maxhe, Fiten, 2)

Të menduarët mirë për besimtarët, sipas hadithit fisnik, është një parim i rëndësishëm i Islamit.



I Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem, i cili u ndikua për një kohë të gjatë nga problemet dhe vështirësitë në ngjarjen e Ifkut, ngjarje që ndodhi si rezultat i përçarjeve dhe ngatërimeve të hipokritëve, u konsultua me Zejneb bint Xhahsh, që ishte njëra nga gratë e Tij, si dhe me shërbëtoreshën e Hazretit Aishe Berire radijallahu anhunne. Ai i pyeti ato se çfarë mendojnë për nënën tonë Aishen.<sup>68</sup> Që të dyja





dëshmuar për mirë. Në lidhje me këtë çështje, Hazreti Aishe radijallahu anha thotë:

“Gjatë hulumtimit të kësaj çështjeje, i Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem kish pyetur Zejneb bint Xhahsh në lidhje me mendimin e saj për mua dhe i kishte thënë:

*-O Zejneb, çfarë di për këtë çështje, çfarë ke parë?. Ajo i kishte thënë:*

*-O i Dërguari i Allahut, unë e mbroj gjithmonë veshin tim nga ajo që nuk kam dëgjuar dhe syrin tim nga jo që nuk kam parë. Unë nuk di veç gjëra të mira për Aishen.*

Zejnebi garonte me mua për shkak të disa virtyteve në mes grave të të Dërguarit të Allahut. (Ajo mund të mendonte se do të ishte më afër të Dërguarit të Allahut duke më ulur mua, kur e kishte edhe rastin në dorë.) Por për shkak të devotshmërisë së saj, Allahu e ruajti në këtë çështje që të mos thoshte shpifje.” (Buhari, Shehadat, 15, 30; Muslim, Teube, 56)

Sa shembull i shkëlqyer për ata që mendojnë mirë për të tjerët... Në një mjedis ku mund të rrëshqitnin shumë këmbë, Nëna jonë Zejneb u strehua në çadrën e mendimit të mirë dhe shpëtoi nga qortimi hyjnor i cili zbriti për ata që shpifën. Bashkë me ajetet që e pastruan nënën tonë Aishen, zbriti edhe një qortim i ashpër për ata që shpifën dhe për ata që u bashkuan me ta duke mos menduar mirë. Sikur të mos ishte falja e Allahut, u njoftua se të gjithë do të shkatërroheshin në një mënyrë tragjike. Mjafton përsëritja e këtij qortimi dhe presioni, për të treguar se sa sjellje e keqe është paragjykimi. Në ajetet fisnike thuhet:

**“Përse kur e dëgjuan shpifjen besimtarët dhe besimtare të mos mendonin të mirën si për vete dhe të thonin: “Kjo është shpifje e qartë?!”** (en-Nur, 12)

**“Sikur të mos ishte mëshira e Allahut dhe mirësia e Tij ndaj jush në këtë dhe në botën tjetër, do t’ju kapte një dënim shumë i madh për shkak të asaj në të cilën humbët.”** (en-Nur, 14)



Hazretit Ebu Ejjub el-Ensarit, Ummu Ejjub pyeti burrin e saj:

“A i ke dëgjuar rreth gjërave që thonë njerëzit kundër Aishes?”

Ejjubi tha:

“Po! I kam dëgjuar, ato janë të gjitha gjënjeshtra dhe shpifje!”

Pastaj ai pyeti gruan e tij:

“A e bën ti një të keqe të tillë?”

Ajo tha:

“Jo! Për Zotin unë nuk e bëj një gjë të tillë!”

Në lidhje me këtë, Ejjubi radijallahu anhu tha:

“Kur ti je kështu, për Zotit Aishja është më e mirë se ti!” (Ibn Hisham, III, 347; Vakidi, II, 434)

Ja, ky është shembull i shkëlqyer i të menduarit mirë...



Ibn Mes'ud radijallahu anhu thotë:

“Mos e ndihmoni shejtanin kundrejt vëllait tuaj, duke thënë fjalë të tilla si: O Zot! Poshtëroje atë! O Zot! Mallkoje atë!, kur shikoni se ai ka bërë mëkat. Përkundrazi thoni: O Zot! Fale atë dhe drejtoje në rrugë të drejtë! Ne, sahabët e Muhammedit, nuk thonim asgjë për një të vdekur pa ditur diçka. Nëse jeta i mbaronte me të mirë, thonim: Fitoi mirësinë. Nëse kishte vdekur në të keqe, kishim frikë të thonim diçka të keqe për të.” (Ebu Nuajm, Hilje, IV, 205)

Një njeri i cili shkoi të vizitonte Ebu Duxhanen radijallahu anhu kur ai ishte i sëmurë, vuri re se atij i shkëlqente fytyra si dritë. E pyeti:

“Përse të shkëlqen fytyra kështu?”. Ai dha këtë përgjigje:

“Unë kam dy vepra të mira:

1. Hesht në çështjet që nuk më interesojnë.
2. Zemra ime është larg nga paragjykimi i keq për besimtarët.

Unë mendoj mirë për të gjithë besimtarët.” (Ibn Sa'd, III, 557)



Përmes një shembulli të shkëlqyer, Hazreti Mevlana flet për vese të këqia dhe shkatërruese si paragjykimi i keq, smira dhe xhelozia, që njerëzit kanë në botën e tyre të brendëshme:

Një padishah kishte blerë dy robër. Ai donte të kuptonte gradën e mendjes dhe shpirtit të atyre, kështu që thirri të parin dhe filloi të bisedojë më të. Robi po i jepte padishahut ca përgjigje që të tjerët nuk mund t'i jepnin pa u menduar mirë. Padishahu u gëzua kur e pa këtë shërbëtor të kuptueshëm, të zgjuar dhe gjuhëembël. Thirri edhe robin tjetër.

Robi i dytë erdhi para padishahut. Robit i mbante era nga goja për arsye se ishte sëmurë, ndërsa dhëmbët i kishte shumë të nxirë për shkak të papërkujdesjes. Edhe pse nuk u kënaq nga pamja e jashtme e këtij robi, Padishahu filloi të bisedojë me të, që të mësonte gjendjen, të fshehtat dhe cilësitë e tij:

“Rri larg me këtë robë dhe me këtë gojë shqetësuese, por mos shko shumë larg. Së pari le t'i gjejmë një shërim gojës tënde. Ti qenke njeri i mirë, por edhe ne jemi mjekë të njohur. Nuk na ka hije që mos të të japim vlerë dhe të të nënçojmë. Ulu këtu dhe trego një apo dy histori, me qëllim që të mund të kuptojmë gradën e mendjes tënde.”

Pastaj, duke u kthyer nga robi i parë me të cilin kishte folur, Padishahu i tha:

“Edhe ti shko në hamam dhe lahu mirë.”

Pasi iku shoku i tij, Padishahu iu drejtua robit të dytë, të cilin donte ta bënte të flasë:

“Shoku yt me të cilin fola më parë më tha gjëra të këqia për ty. Po shikoj se ti nuk je ashtu si tha ai. Me gjasë ai njeri lakmiqar donte të na ftohte nga ti. Ai tha për ty:

Ai është hajdut, nuk është njeri i drejtë, rri me njerëz të këqinj, është i pandershëm. Po ti çfarë thua për të?”

Pasi dëgjoi këto fjalë, robi i dytë iu përgjigj padishahut:

“Unë nuk mund ta quaj të padrejtë shokun që mendon dhe thotë të vërtetën. Përkundrazi, duke u nisur nga fjalët e tij, unë mendoj se



kam shumë në veten time, të cilat përpiqem t'i rregulloj. O Padishah! Ndoshta ai ka parë te unë shumë mangësi te cilat unë nuk i di.”

Padishahu i tha robit:

“M'i trego edhe ti mangësitë e tij, ashtu sikundër edhe ai më tregoi të tuat.”

Robi u përgjigj:

“O Padishahu im! Ai me të vërtetë është një shok i mirë për mua. Bota ime shpirtërore më ndalon që t'i përmend mangësitë e tij. Kësisoj unë mund të them vetëm këtë: sipas mendimit tim, mangësia e tij nuk është mangësi, por virtyt. Ai është shembulli i dashurisë, i besnikërisë dhe i njerëzisë. Ai është i drejtë, i zgjuar dhe mik i mirë. Një tjetër cilësi e tij është bujaria dhe ndihma që u jep të varfërve. Ai është aq bujar, sa nëse është e nevojshme, e jep edhe shpirtin. Një cilësi tjetër e shokut tim të fatit është se ai nuk e pëlqen veten e tij. Ai është i mirë me të gjithë. Vetëm ndaj vetes së tij është i keq.”

Kur dëgjoi këtë përgjigje, Padishahu i tha robit:

“Mos shko shumë përpara duke e lavdëruar shokun tënd dhe mos guxo të lavdërosh veten kur lavdëron atë, sepse pastaj unë mund të vë në provë atë dhe ti do të turpërohesh.”

Mbi këtë robi tha:

“Jo! Nuk shkova shumë para duke e lavdëruar. Cilësitë e mikut tim janë shumë më tepër nga sa thashë. Unë thashë ato që dija rreth cilësive të shokut të fatit, por, o padishah bujar, çfarë të bëj unë nëse ju nuk u besoni atyre që thashë? Bota ime e brendëshme më bën të flas kështu.

Kur robi tjetër erdhi nga hamami, padishahu e ftoi. Atij i tha:

“Me shëndet, arritsh mirësi që nuk vjetërohen, por sa bukur do të ishte sikur të mos i kishe veset e këqia që tha shoku yt! Atëherë ai do të të shikonte në fytyrë do të gëzohej dhe kënaqej. Të të shohësh ty, është më e vlefshme se sa të shohësh gjithë botën.”

Robi tha:



“O Padishah! Ju lutem, më tregoni se çfarë tha për mua ai i poshtërl..”

Padishahu i tha:

“-Ai së pari më tregoi për hipokrizinë tënde. Më tha se ti në pamjen e jashte je si ilaç, ndërsa në të vërtetë je fatkeqësi.”

Teksa dëgjonte këto fjalë nga padishahu, robit iu shtua zemërimi, goja iu pre dhe fytyra iu skuq. Ai e kaloi kufirin duke e ofenduar shokun e tij. Tha:

“Ai ishte mik me mua, por gojën e kishte të prishur. Shumë herë hante gjëra të papastra si një qen në zi buke.”

Robi filloi të flasë shumë dhe të nxjerrë në pah gjithë të këqijat e botës së tij shpirtërore për të ofenduar shokun e vet. Pas kësaj, padishahu i tha “mjaft tashmë”, ia vuri dorën në gojë dhe shtoi:

“Për shkak të provës nën të cilën iu vura, arrita ta dalloj ndryshimin ndërmjet jush. Gojës së tij i vjen era për shkak të një sëmundje materiale, por ty të është qelbur shpirti! O ti njeri që të është qelbur shpirti, rri larg. Shoku yt do të jetë urdhëruesi yt dhe ti do të rrih nën urdhërin e tij. Mëso nga ai edukatën, njerëzinë dhe të folurit! Merr mësim nga virtyti i tij. **Lëre paragjykimin dhe zilinë. Ti me këto cilësi je një njeri i paaftë që në belin e tij ka lidhur gur. Me këtë gur as nuk mund të notosh, as nuk mund të ecësh.**”

Robi që mendonte mirë për shokun e tij fitoi shumë mirësi materiale dhe shpirtërore, për shkak se kishte kulmin e virtytit. Ndërsa robi tjetër që u zemërua pa e ditur të vërtetën, ra nga sytë dhe i humbi zemra.



Së fundi, të kesh ndjenja të bukura për njerëzit, është një frut i virtytit të të shikuarit të krijesave me syrin e Krijuesit. T'ua duash të mirën e njerëzve dhe të shikosh anët e tyre të mira, është një cilësi e rëndësishme përmes së cilës firohet kënaqësia e Allahut dhe dashuria e robërve të Tij.



## 12. Bujaria dhe zemërgjërësia

Bujari do të thotë t'i japësh atë që ke në dorë atij që s'ka. Ndërsa kulmi i bujarisë është "Zemërgjërësia". Përkufizimi më i bukur i zemërgjërësisë jepet në këto ajete fisnike:

**"Ata janë të cilët për hir të Tij u japin ushqim të varfërve, jetimëve dhe robërve. Ne po ju ushqejmë vetëm për hir të Allahut dhe prej jush nuk kërkojmë ndonjë shpërblim dhe as falenderim. Ne i frikësohemi (dënimit) Zotit tonë në një ditë shumë të vështirë që fytyrat i bën të zymta. Allahu i ruajti ata prej së keqes së asaj dite dhe u dhuroi gëzim të madh dhe shkëlqim në fytyra."** (el-Insan, 8-11)

Bujaria është një fryt mëshire që vjen nga besimi. Ndërsa mëshirë do të thotë të nxitosh për të ndihmuar të tjerët që të kompensojnë humbjen e tyre.

Bujaria nuk është harxhimi i pasurisë tënde vend e pavend, por ndihma ndaj robërve të Zotit duke e ditur vlerën e mirësisë. Po ashtu, Allahu ka vendosur masën në këtë çështje:

**"Mos e lidh dorën tënde për qafe (mos u bëj koprac), dhe as mos e shtrij komplet dhe të ngelësh i qortuar dhe duarthatë (nga shpenzimi i tepërt).** (el-Isra, 8-11)

Bujaria është një nga atributet e Allahut, sepse edhe një prej emrave të Tij është "el-Kerim", që do të thotë "Ai që jep shumë dhe që është bujar i pafund".<sup>69</sup> Veçanërisht edhe cilësitë si Rrahman, Rrahim, Vehhab, Latif, Tevvab, Gaffar, Afuvv, Rrauf dhe Hadi, shprehin bujarinë e Allahut në aspekte të ndryshme.

Po ashtu, në hadithet fisnike thuhet:

*"Allahu Teala është Xhevad, domethënë bujar dhe për këtë arsye e do bujarinë. Ai e do moralin e bukur dhe nuk e pëlqen moralin e keq."* (Sujuti, I, 60)

*"Sigurisht që Allahu është Tajjib dhe e do të mirën dhe të bukurën. Është Tahir dhe e do pastërtinë. Është Kerim dhe e do fisnikërinë."*



*Është Xhevad dhe e do bujarinë...*” (Tirmidhi, Edeb, 41/2799)

Duke marrë pjesë nga bujaria e Zotit, një besimtar duhet të jetë i ndritshëm si hëna e një nate të errët, i thellë, i ndjeshëm, zemërbutë, altruist, i mëshirshëm, i dhembshur dhe ta ketë zemrën të pasur me ndjenjën e ndihmës ndaj të varfërve, sepse në ajetet fisnike thuhet:

**“O ju që keni besuar! Jepni nga ajo që Ne u kemi furnizuar ju para se të vijë një ditë kur nuk do të ketë as shitblerje, as miqësi dhe as ndërmjetësim (pa lejen e Allahut). Qafirat janë mizorë.”** (el-Bakara, 254)

**“...Çfarëdo që të jepni, Allahu e kompenson atë.”** (Sebe', 39)

Hazreti Ali radijallahu anhu ka thënë:

“Njerëzit janë në gjumë, kur të vdesin do të zgjohen...” (Axhluni, Keshfu'l-Hafa, II, 312/2795) Për këtë arsye, duhet ta përgatitim që tani ushqimin e ahiretit tonë, duke u pajisur me moralin e bujarisë dhe zemërgjërësisë përsa kohë që jemi në këtë botë, në mënyrë që kur të zgjohemi në botën e përherëshme të mos ngelim me duar bosh dhe të mos biem në varfëri. Sa bukur thotë Hazreti Mevlana:

*“Jeta e kësaj bote është një ëndërr. Të jesh i pasur në këtë botë do të thotë të gjesh thesar në ëndërr. Pasuria e kësaj bote, edhe pse kalon nga një brez në tjetrin, në fund të fundit do të mbetet në këtë botë.”*

*“Ëngjëlli i vdekjes e zgjon indiferentin nga gjumi duke ia marrë shpirtin. Ai që thotë “vaj vaj për vështirësitë që kam hequr në këtë botë” për një pasuri që në të vërtetë nuk ka mundur ta ketë, do të pendohet shumë, por gjithçka do të ketë mbaruar...”*

Ja jeta e kësaj bote, ja jeta e ahiretit...

Në ajetet fisnike thuhet:

**“Jepni nga ajo që Ne u kemi dhënë juve para se ndonjërit prej jush t'i vijë vdekja dhe atëherë të thotë: “O Zoti im, ma shtyje edhe pak afatin (e vdekjes) që të jepja lëmoshë e të bëhesha prej të devotshmëve!” All-llahu kurrë nuk e shtyn për më vonë (vdekjen) asnjë kur atij t'i vijë afati i tij. Allahu i di ata që veproni.”** (el-Munafikun, 10-11)

Allahu i lavdëron robërit e Tij, zemërgjërë dhe bujarë, të cilët janë



të zgjuar në këto çështje, duke thënë:

**“...Edhe sikur të kishin nevojë për të madje, ata u jepnin përparësi atyre...”** (el-Hashr, 9)

I Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem, i cili kurrë nuk thoshte<sup>70</sup> “nuk kam” kur i kërkonin diçka, ka thënë kështu në lidhje me bujarinë dhe në lidhje me ata që e kanë këtë cilësi:

*“Bujaria është një pemë mes pemëve të xhennetit, që i ka shtrirë degët e saj në këtë botë. Kush kapet pas një prej degëve të saj, ajo e shpie në xhennet. Ndërsa kopracia është një pemë nga pemët e xhehennemit, e cila i ka shtrirë degët e saj në këtë botë. Kush kapet për njërës prej këtyre degëve, ajo e zvarrit për në xhehennem!..”* (Bejhaki, Shuabu'l-Iman, VII, 435)

*“Gjendja e kopracit e të bujarit i ngjan gjendjes së dy vetëve që kanë veshur nga një parzmore që u mbulon kraharonin dhe kockat e shpatullës. Bujarit, përse kohë që jep sadaka, parzmorja që ka sipër i zgjerohet, i zgjatet, ia mbulon majat e gishtave të këmbës dhe ia fshin gjurmët e këmbës. Ndërsa kopraci, kur do të japë diçka, rrathët e parzmores futen në njëra-tjetrën dhe e shtrëngojnë. Sado që të mundohet ta zgjerojë, nuk ia del dot mbanë.”* (Buhari, Xhihad 89, Zekat 28; Muslim, Zekat 76-77)

*“Njeriu bujar është afër Allahut, xhennetit, njerëzve dhe është larg xhehennemit. Ndërsa kopraci është larg Allahut, xhennetit, njerëzve dhe është afër zjarrit të xhehennemit! Bujari i paditur është më i dashur te Allahu se sa adhuresi koprac.”* (Tirmidhi, Birr, 40/1961)

*“Mos i shikoni gabimet e bujarit sepse, kur ai bën gabim, Allahu Teala e kap për dore.”* (Hejsemi, VI, 282)

Vajza e Ebu Bekrit, Esmâ radijallahu anha thotë se i Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem i ka thënë:

*“Mos ia shtëngo grykën qeses, sepse edhe Allahu të jep ty duke e shtrënguar!”* (Buhari, Zekat, 21)

*“Jep dhe mos numëro, përndryshe edhe Allahu e numëron dhe e fsheh mirësinë e Tij ndaj teje. Mos i fshih paratë në qyp, përndryshe*





*edhe Allahu i fsheh nga ti.*” (Muslim, Zekat, 88)

Në kuptimin më të plotë, altruizmi, bujaria dhe sinqeriteti janë rezultat i pjekurisë së shpirtit. Të qëndrosh larg dëshirave vetjake që prishin qetësinë dhe ndjenjën e zemrës, bëhet e mundur vetëm përmes begatisë së bujarisë dhe altruizmit.

Sa bukur e shpreh Hazreti Mevlana kuddise sirruhu vetinë e bujarisë dhe ndjenjën e kopracisë që është e kundërta e saj:

*“Bujaria është dega e selvisë së xhennetit. Turp për atë që e lë këtë degë. Ai që mbjell, së pari e zbraz hambarin (depon), por pastaj korr shumë, por ai që e mban farën në hambar, së fundi e bën ushqim për minjt.”*

*“Ashtu sikundër bukuritë kërkojnë pasqyrë të pastër, edhe bujaria kërkon njerëz të varfër dhe të dobët. Fytyra e të bukurve duket bukur në pasqyrë, edhe bukuria e bujarisë dhe e mirësisë del pah tek të varfërit dhe të dobët.”*

*“Zemrat e mbytura në varfëri i ngjajnë një shtëpie të mbushur me tym. Hapi një dritare shtëpisë me tym duke i dëgjuar hallet e tyre, ashtu që tymi të dalë jashtë dhe zemra jote të zbutet.”*

Edhe në ditët tona ka nevojë për lëmoshë dhe bujari, brenda mundësive që kemi. Nuk duhet të harrojmë se ne mund të ishim në vendin e njerëzve të vuajtur dhe nevojtarë. Për këtë arsye, bujaria dhe zemërgjërësia jonë ndaj të sëmurëve, të dobtëve, të vetmuarve, nevojtarëve dhe të uriturve, është borxh falenderimi ndaj Zotit. Mirësitë që kemi, le t'i ndajmë me të varfërit, ashtu që zemrat të cilat i kemi kënaqur, të jenë ndjenja jonë shpirtërore në këtë botë, ndihma jonë në ahiret dhe lumturia jonë në xhennet.

### ***Tabllo të virtytshme***

Enesi radijallahu anhu tregon:

Për hir të Islamit, i Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem jep-te gjithçka i kërkohej. Një herë, ai i dha i fali një kope të madhe delesh një burri që erdhi ta takonte... Kur njeriu u kthye te fisi i tij, u tha:



“O fisi im! Bëhuni myslimanë, sepse Muhammedi jep shumë gjëra pa u trembur nga varfëria.”

Madje disa bëheshin myslimanë vetëm për të fituar diçka materiale. Pa kaluar shumë, Islami në sytë e tyre vinte në një gjendje më të vlefshme se sa kjo botë dhe çdo gjë që ka në të. (Muslim, Fedail, 57-58)



Safuan bin Umejje, i cili ishte nga paria e mushrikëve Kurejshitë, në luftën e Hunejnit dhe të Taifit gjendej pranë të Nderuarit tonë edhe pse nuk ishte bërë mysliman.

I Nderuari ynë sallallahu alejhi ue sellem, kur po vërente mallrat e mbledhura në depo, pa që Safuani po i shikonte me shumë habi një pjesë të tyre, ndaj e pyeti:

“A po të pëlqejnë shumë?”

Kur iu përgjigj: “-Po.”, i tha:

“Merre komplet!

Pas kësaj, duke mos e mbajtur më veten, Safuani tha shehadetin dhe tha:

“Asnjë zemër nuk mund të jetë kaq bujare sa zemra e Pejgamberit.”. Kështu ai u nderua me besim. (Vakidi, II, 854-855)

Hazreti Pejgamber sallallahu alejhi ue sellem ishte kulmi i të gjitha cilësive të mira. Ai u jepte atyre, me qëllim që t’ua ndreqte dobësitë, si dhe që të bëhej shkak për udhëzimin e tyre.



Abdullah bin Abbas radijallahu anhu tregon:

“I Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem ishte më bujari i njerëzve. Bujarinë më të madhe e kishte në kohën kur Xhebraili alejhisselam takohej me të në Ramazan. Në çdo natë të Ramazanit, Xhebraili alejhisselam dhe Pejgamberi ynë i Nderuar lexonin Kur’an. Për këtë arsye, kur i Dërguari i Allahut takohej me Xhebrailin alejhisselam, sillej më bujar për shkak të erërave të mëshirorës që frynin pa njohur asnjë



lloj pengese.” (Buhari, Bed’u’l-Vahj 5, 6, Saum 7; Muslim, Fedail 48, 50)



Një person erdhi te i Dërguari i Allahut dhe i tha:

“O i Dërguari i Allahut! Unë jam i uritur.”

I Dërguarit i Allahut thirri njëren nga gratë e Tij dhe e porositi që t’i sillte diçka për të ngrënë atij njeriu, por nëna e besimtarëve tha:

“Betohem në Allahun që të ka dërguar si pejgamber, se në shtëpi nuk ka gjë tjetër përveç se ujë.”

Pasi që edhe gratë e tjera thanë të njëjtën gjë, Hazreti Pejgamber sallallahu alejhi ue sellem u kthye nga ashabët dhe i pyeti:

“Kush dëshiron ta marrë sonte si mik këtë njeri?”

Njëri prej Ensarëve tha:

“Unë e pranoj si mik, o i Dërguari i Allahut!”. Kështu, ai e mori të varfrin dhe e çoi në shtëpinë e tij. Ai e pyeti gruan e tij:

“A ka gjë për të ngrënë në shtëpi?” Gruaja i tha:

“Jo, ka vetëm aq sa të hanë fëmijët.” Sahabiu tha:

“Atëherë largojua vëmendjen fëmijëve. Nëse do të duan të vinë në sofër, vëri të flejnë. Kur miku të hyjë brenda, fike dritën. Edhe ne të bëjmë sikur po hamë në sofër.”

U ulën në sofër. Miku u ngop, ndërsa ata fjetën të uritur.

Në mëngjes sahabiu shkoi te Pejgamberi sallallahu alejhi ue sellem. Kur e pa, i Dërguari i Nderuar sallallahu alejhi ue sellem tha:

“*Allahu Teala u kënaq shumë nga ajo që bëtë për mikun mbrëmë.*” (Buhari, Menakibu’l-Ensar, 10; Tefsir, 59/6; Muslim, Eshribe, 172)



Sipas transmetimit të Hazretit Aishe radijallahu anha, familja e Pejgamberit të Nderuar sallallahu alejhi ue sellem kishte prerë një dele. Pasi u dha shumë vetëve, Hazreti Pejgamber sallallahu alejhi ue sellem



pyeti se çfarë ka ngelur nga delja:

Hazreti Aishe u përgjigj:

“Ka ngelur vetëm kocka e shpatullës.”. Hazreti Pejgamber tha:

*“Thuaj, përveç një kocke shpatulle, i tërë pjesa tjetër është jona!”*

(Tirmidhi, Kijamet, 33)

Domethënë, pasuria jonë e vërtetë është ajo që kemi dhënë...



Një ditë, një nevojtar erdhi te Pejgamberi ynë i Nderuar dhe i kërkoi diçka. I Dërguari i Allahut tha:

“Nuk kam asnjë gjë që mund të të jap. Shko dhe blej në emrin tim dhe kur të vijë mall, i paguaj unë. Hazretit Omer radijallahu anhu, të cilit nuk iu kënaq zemra që i Dërguari i Allahut hyri në vështirësi, tha:

“O i Dërguari i Allahut! Nëse ke, jepi, Allahu nuk të ka obliguar me gjëra që nuk ke mundësi t’i bësh.”

Nga shprehja që mori fytyra e begatë e të Dërguarit të Allahut sallallahu alejhi ue sellem, u bë e qartë se Ai nuk u kënaq nga fjalët e Hazretit Omer. Në lidhje me këtë, njëri prej Ensarëve tha:

“Nëna dhe babai im të qofshin falë, o i Dërguari i Allahut! Jep! Mos ki frikë se e pakëson Zoti i Arshit!

I Nderuari ynë i pëlqeu shumë këto fjalë të sahabiut, buzëqeshi dhe tha:

*“Edhe unë jam urdhëruar me këtë.”* (Hejsemi, X, 242)

Ja një zemër për shembull... qetësimi i një vëllai në fe përbën shkak qetësie më të mirë shpirtërore për një besimtar.



Abdullah el-Herevi e njihte cilësinë e bujarisë së të Dërguarit të Allahut sallallahu alejhi ue sellem, por dëshironte ta mësonte më mirë. Një ditë në Haleb, ai u takua me muezinin e Pejgamberit tonë të Nderuar, Bilal el-Habeshi radijallahu anhu. Kështu, atij iu dha një mu-



ndësi e rrallë. Menjëherë filloi ta pyeste atë për Pejgamberin tonë të Nderuar:

“O Bilal! Më trego se si jepte i Dërguari i Allahut!”

Hazreti Bilal i tregoi:

“Që nga dita kur është dërguar nga Allahu si Pejgamber e deri ditën kur vdiq, shumë punë të të Dërguarit të Allahut i kam bërë unë në emër të tij. Për shembull, kur i vinte ndonjë mysliman dhe shikonte se ai ishte i varfër, merrja borxh dhe bleja rroba dhe ushqim për të. Një ditë më doli para një mushrik, i cili më tha:

-O Bilal! Unë jam një njeri i pasur dhe kam shumë mundësi. Këtu e tutje mos kërkoh borxh nga askush, eja dhe merr borxh nga unë! Ashtu veprova. Një ditë pata marrë abdest dhe po përgatitesha për të thirrur ezanin. Në atë çast vë re se ai mushriku po vinte përballë me një grup tregtarësh. Kur më pa, më thirri: O Habeshi! Unë e pyeta? Çfarë ka? Ai e vari fytyrën, më hodhi një vështrim të ashpër, më tha disa fjalë të rënda e pastaj më pyeti:

-Dhe sa ka që të vijë muaji tjetër?

Unë thashë: “Është afër”.

Ai më tha:

-Ka edhe katër net. Kur të vijë ajo ditë, borxhin që ma ke do të ta marr. Unë nuk t'i dhashë ato para për hatrin tënd apo të njeriut tënd. T'i dhashë që të bëhesh robi im. Që të kullosh për sëri delet e mia si më parë!

Kur i dëgjova këto fjalë, u mërzita shumë. Shkova dhe thirra ezanin. Kur i Dërguari i Allahut fali namazin e jacisë, u kthye te familja e Tij. Kërkova të takohesha me të Dërguarin e Allahut. Ai pranoi. Hyra brenda dhe i thashë:

-O i Dërguari i Allahut! Nëna dhe babai im të qofshin falë. Mushriku që i kam marrë borxh, më tha kështu e kështu. As Ti as unë nuk kemi mundësi ta paguajmë. Do të më poshtërojë. Më jep leje që të shkoj te ato fiset që sapo kanë hyrë në Islam. Të rri tek ata derisa Allahu Teala ti japë rizk Pejgamberit të Tij dhe të m'i paguash borxhet.



I Dërguari i Allahut më dha leje. Dola dhe shkova në shtëpinë time. Vura poshtë kokës sime shpatën, thikën, heshtën dhe këpucët e mia. U shtriva duke e drejtuar fytyrën time nga qielli. Isha i shqetësuar dhe nuk flija dot. Vetëm kur ra nata plotësisht munda të flija. Në mëngjes u ngrita herët. Kur po përgatitesha të dilja, dëgjova një zë që më thirri nga jashtë:

-O Bilal! Po të thërret i Dërguari i Allahut! Shkova. Kur arrita te dera e të Dërguarit të Allahut, pashë katër deve me ngarkesën e tyre në shpinë! Kërkova leje dhe hyra brenda. I Nderuari ynë më tha:

*-Përgëzim o Bilal! Allahu Teala më ka dërguar mall që të lashë borxhin. Unë e falenderova Allahun. I Dërguari i Nderuar më pyeti:*

*-A nuk i pe katër deve përpara derës?*

-Po, i pashë.- u përgjigja.

*-Janë të tuat, bashkë me ngarkesën që kanë mbi to. I ka dërguar zotëri Fedek. Merri dhe laji borxhet. Bëra ashtu siç më tha i Dërguari i Allahut. Ua shkarkova ngarkesën, u dhashe deveve për të ngrënë dhe shkova për të thirrur ezanin e mëngjesit. Kur i Dërguari i Allahut na e fali namazin, shkova te varrezat Baki, i zura veshët me gishta dhe bërtita:*

*-Kush të ketë borxh për të marrë nga i Dërguari i Allahut, le të vijë! Ia lava të gjitha borxhet të Dërguarit të Nderuar duke i shitur mallrat e duke i kthyer ato në para. Pas kësaj, i i Dërguari i Allahut nuk i kishte më borxh askujt në këtë tokë. Tepruan edhe pak para. Në buzëmbremje shkova në xhami. Pashë se i Dërguari i Nderuar po rrinte vetëm në xhami. I dhashë selam. Ai më pyeti:*

*-Çfarë bëre?*

I thashë:

*-Allahu Teala ia paguajti të gjitha borxhet Pejgamberit të Tij. Tashmë nuk ka borxh fare. Ai më pyeti:*

*-Mirë, a ka ngelur ndonjë gjë? I thashë:*

-Po, kanë ngelur dy dinar.



Ai më tha:

*-Më shpëto edhe nga ata dy dinarë. Jepi lëmoshë edhe ato, sepse nuk do të shkoj në shtëpi derisa të qetësohem duke i nxjerrë nga dora edhe ata dy dinarë!*

Por, për shkak se nuk erdhi ndokush që t'ia jepja ata dy dinarë, i Nderuari ynë sallallahu alejhi ue sellem priti një kohë të gjatë në xhami. Së fundi, në mbrëmje erdhën dy kalorës. Shkova bashkë me ta në treg. Me ato dy dinar u bleva rroba dhe ushqim. Kur i Nderuari ynë na e fali jacinë, më thirri dhe më pyeti:

*-Çfarë u bë me ato që kishe?*

Unë i thashë:

-Allahu të rehatoi.

Pas kësaj përgjigje, i Dërguari i Allahut dha tekbir. E falenderoi Allahun se shpëtoi nga frika se mos vdiste gjatë kohës kur kishte përgjegjësi për ata dy dinarë. Pastaj u ngrit. Edhe unë i vajta pas. Ai shkoi tek të gjithë pjesëtarët e familjes dhe u dha selam. Pastaj hyri në dhomën e Tij ku rrinte natën.

O Abdullah, ja përgjigja e pyetjes!” (Ebu Davud, Haraxh, 33-35/3055; Ibn Hibban, Sahih, XIV, 262-264)

Pejgamberi ynë i Nderuar ishte aq bujar, sa merrte borxh për të dhënë lëmoshë. Po ne, si ummet i tij, sa i afrohemi bujarisë së Tij?



Sa bukur e shpreh poeti idenë se i dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem ishte në kulmin e zemërgjerësisë dhe bujarisë:

لَوْلَمْ يَكُنْ فِي كَفِّهِ غَيْرُ نَفْسِهِ  
لَجَادَ بِهَا فَلَيَّتِقَ اللَّهُ سَائِلَهُ

“Sikur në dorë të mos kishte gjë tjetër vetëm shpirtin, do t'ia jepte edhe atë atij që mund t'ia kërkonte. Për këtë arsye, kush të kërkojë



nga Ai, duhet të ketë frikë Allahun dhe të kërkojë me ndërgjegje.

Edhe një poet tjetër thotë:

مَنْ قَاسَ جَدْوَالَكِ يَوْمًا    بِالسُّحْبِ أَخْطَأَ مَدْحَكَ  
السُّحْبُ تُعْطِي وَتَبْكِي    وَأَنْتِ تُعْطِي وَتَضْحَكُ

“Nëse dikush një ditë të krahason Ty me retë në bujari, ka gabuar në lavdërimin e tij, sepse retë japin dhe qajnë, ndërsa Ti jep dhe qesh.”

Ja pra, deri në këtë shkallë ngjitej bujaria e të Dërguarit të Allahut sallallahu alejhi ue sellem. Ai e flijonte me dashuri në rrugë të Allahut gjithë pasurinë e Tij. Mevlana Hazreti Halid Bagdadi bën këtë përngjasim për kulmin e bujarisë së Tij:

“I Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem ishte një shembull aq i bukur bujarie, saqë deti jepte perla për hir të Tij, gurët e fortë nxirrnin rubinë dhe gjembat çelnin trëndafila. Nëse në një bahçe bisedohej për moralin e Tij të bukur, nuk kishte asnjë gonxhe që nuk e hapte gojën nga gëzimi dhe të mos qeshte, domethënë nuk ngelte asnjë gonxhe pa u hapur.”<sup>71</sup>

Sa e përsosur është zemërgjerësia që shfaq nëna jonë, Hazretit Aishe radijallahu anha:

Kur Hazretin Omer e plagosën me thikë dhe kur po priste vdekjen, ai thirri të birin, Abdullahun, të cilit i tha:

“...Shko te nëna e besimtarëve Aisheja radijallahu anha dhe i thuaj: Omeri të dërgon salam. Kujdes mos i thuaj Prijësi i Besimtarëve! Unë tashmë nuk jam prijësi i besimtarëve. I thuaj: Omer bin Hattabi po kërkon leje nga ti për t’u varrosur në mes dy shokëve të tij.”

Abdullahu radijallahu anhu vazhdon:

“Kërkova leje, dhashë salam dhe hyra brenda. Hazreti Aishe radijallahu anha po qante. I thashë:





-Omeri të dërgon selam. Po të kërkon leje që të varroset në mes dy shokëve të tij.

Nëna jonë Hazreti Aishe u përgjigj:

-Vendin që ka ngelur pranë të Dërguarit të Allahut sallallahu alejhi ue sellem e pata lënë për vete, por sot i jap përparësi Omerit. (I Dërguari i Allahut dhe Hazreti Ebu Bekri ishin varrosur në dhomën e Hazretit Aishe. Edhe Hazreti Aishe donte të varrosej në atë vend dhe donte të ishte pranë të Nderuarit tonë dhe afër babait të saj.)

Kur u kthye, Hazretit Omer i thanë:

“-Ja, erdhi Abdullahu!”. Tërë merak dhe emocion, Hazreti Omer foli:

“-Më ngrini!”. U ngrit duke u mbështetur mbas dikujt aty dhe më tha:

“Çfarë lajmi më ke sjellë?”. Kur i thashë:

“Dëshira t’u plotësua, Hazreti Aishe të dha leje.”. Atëherë ai tha:

“-Elhamdulillah! Nuk ka asgjë më të vlefshme për mua se sa kjo. Kur të më merret shpirti, më dërgoni atje. Kur të arrini atje, i jepni selam përsëri Hazretit Aishe dhe i thoni: Omeri po të kërkon leje. Nëse ajo jep leje, më fusni brenda. Nëse ajo nuk jep leje, më shpini te varrezat e myslimanëve!”

Kur ndërroi jetë, e morën dhe erdhën deri te dhoma e Hazretit Aishe. Abdullahu dha selam dhe tha:

“-Omeri të kërkon leje!”. Nëna jonë e nderuar tha:

“Silleni brenda!”. E futën menjëherë brenda. Kështu, ai u varros në mes dy shokëve të tij të nderuar. (Buhari, Ashabu'n-Nebi 8, Xhenaiz 96, Xhihad 174, Tefsir 59/5, Ahkam 43)

Zemërgjerësia e nënës sonë Hazretit Aishe, edukata, sjellja dhe delikatesa e Hazretit Omer, shfaqin një madhështi që nuk mund të shprehet me fjalë.



Nëna jonë Zejneb bint Xhahsh, ishte një grua që bënte punë dore dhe ishte e aftë në këtë punë. Punonte dhe fitimin e saj e harxhonte në



rugë të Allahut. Pejgamberi ynë i Nderuar u kishte thënë grave të Tij:

*“Ajo që do të vijë te Unë më herët dhe më shpejt, është ajo që e ka krahun më të gjatë.”* Hazreti Aishe thotë:

“-Ne i matnim krahët me masën e mallëngjimit të Pejgamberit dhe mundoheshim të kuptonim se cila do ta takonte më parë të Dërguarin e Allahut, por krahu më i gjatë që kishte për qëllim i Nderuari ynë kishte qënë krahu i Zejnebit, sepse ajo me dorën e saj ajo punonte dhe jepte lëmoshë.” (Muslim, Fedailu's-Sahabe, 101)



Pas hixhretit, çdo familje muhaxhire pati marrë pranë një familje Medinase. Kështu që sahabitë, të cilët bënë aktin e vëllazërisë, do të punonin së bashku dhe çdo fitim do ta ndanin ndërmjet tyre. Tokat e tepërta që kishin, Ensarët ia falën të Dërguarit të Allahut, ndërsa i Dërguari i Nderuar i ndau ndërmjet Muhaxhirëve. Ensarët, duke mos u ndalur me aq, i bënë edhe këtë propozim bujar:

“O i Dërguari i Allahut! Na i ndaj edhe vendet e hurmave me vëllezërit tanë Muhaxhirë!”

Kur Pejgamberi ynë i Nderuar nuk e pranoi këtë, Ensarët u bënë këtë propozim Muhaxhirëve:

“-Atëherë, përkujdesjen dhe vadijen e pemëve merreni ju, me qëllim që të jemi ortakë në prodhim!”. Me miratimin edhe të të Dërguarit të Nderuar, të dy palët e pranuan këtë propozim me fjalët:

“Dëgjuam dhe u bindëm!”. (Buhari, Harth, 5)

Sa nevojë kemi për këto cilësi të larta tani, në ditët tona që ka kaq shumë të varfër.



Kur Pejgamberi i Nderuar erdhi në Medine, Muhaxhirët thanë:

“O i Dërguari i Allahut! Nuk kemi parë më bujarë dhe më ndihmëtarë se këta njerëz tek të cilët kemi bërë hixhret. Ai që ka shumë pasuri, jep shumë, ai që ka pak, sakrifikon dhe ndihmon. Na i hoqën



të gjitha hallet e jetës dhe na bënë ortakë në pasurinë e tyre. Ne kemi frikë se do ta marrin të gjithë sevapin dhe shpërblimin?!”

I Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem tha:

*“Jo, përderisa t’i luteni Allahut për ta, dhe përderisa t’i falenderoni për atë që kanë bërë, edhe ju do të fitoni shpërblim.”* (Tirmidhi, Kijamet, 44/2487)



Xhabiri radijallahu anhu e tregon kështu bujarinë dhe zemërgjerësinë që Ensarët e kishin ndaj Muhaxhirëve:

“Kur Ensarët i mblidhnin hurmat, i ndanin në dy pjesë, në njërën pjesë hidhnin shumë dhe në tjetrën hidhnin pak. Pastaj pjesën që kishite pak, e sajnin sikur kishte shumë, duke i vendosur degë hurmash, dhe u thonin Muhaxhirëve: Merrni kë të doni. Ata merrnin grumbullin që dukej sikur kishte më pak, duke menduar se grumbulli më i madh duhej të ishte i Ensarëve. Në këtë mënyrë shumica e hurmave u mbe tej Muhaxhirëve, ndërsa Ensarët mbanin për vete pjesën që kishte pak hurma...” (Hejsemi, X, 40)

Një ditë, i Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem i ndau në mes Muhaxhirëve mallrat që u morën nga Beni Nadir, ndërsa Ensarëve nuk u dha fare përveç tre vetëve që kishin nevojë. Pastaj, duke u kthyer nga Ensarët, u tha:

“Nëse doni, ato që u keni dhënë Muhaxhirëve më parë lëruani atyre, pastaj edhe ju merrni pjesë nga mallrat. Nëse doni, kërkojuani ato që u keni dhënë, në mënyrë që këto mallra t’ua japim komplet atyre.”

Por Ensarët, radijallahu anhum exhmain, me një altruizëm të madh dhe duke u dhënë përparësi vëllezërve besimtarë, dhanë këtë përgjigje të shkëlqyer:

“O i Dërguari i Allahut! Ne vëllezërve Muhaxhirë u japim pjesë edhe nga pasuria edhe nga shtëpitë tona, po ashtu edhe këto mallra le t’i marrin ata.”



Mbi këtë zbriti ky ajet fisnik, i cili përgëzon se lëmoshat që janë bërë me një sakrifikim të singërtë, do ta shpëtojnë robin:

**“Ata që përgatitën vendin (Medinën) dhe që besuan, i duan ata që shpërnguleshin te ata dhe nuk ndiejnë në zemrat e tyre ndonjë brengë nga ajo që u jepej atyre (muhaxhirëve), madje edhe sikur të kishin vetë nevojë për të, ata u jepnin përparësi atyre. Kush ruhet prej lakmisë së vet, të tillët janë të shpëtuar.”**

(el-Hashr, 9) (Razi, XXIX, 250; Kurtubi, XVIII, 25)

Siç kërkohet edhe në ajetin e mësipërm fisnik, zemra e çdo besimtarit duhet të qetësohet si zemra e Ensarëve kur të japë, e jo të shqetësohet se po mbaron.



Një ditë, i Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem thirri më së pari Ensarët për të ndarë tokat e Bahrejnit në mes sahabëve. Ensarët, duke treguar një sakrificë dhe toleroncë të paarritshme, thanë:

“O i Dërguari i Allahut! Mos na jepni gjë ne, para se të ndani në mes vëllezërve Muhaxhirë një tokë edhe një herë sa kjo!”

Në lidhje me këtë, i Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem tha:

*“O Ensarë! Meqë nuk doni të merrni (duke u dhënë përparësi vëllezërve besimtarë), duroni derisa të më takoni te Burimi i Keutherit, sepse pas meje, së afërmi do të vijë një kohë që do t’ju jepet përparësi juve.”* (Buhari, Menakibu’l-Ensar, 8)



Një ditë, kur gruaja e Pejgamberit tonë të Nderuar, Hazreti Aishe radijallahu anha ishte agjërueshëm, i erdhi një i varfër i cili i kërkoi diçka për të ngënë. Në shtëpinë e Aishes radijallahu anha nuk kishte gjë tjetër përveç një buke. I tha shërbëtores:

“Jepja bukën atij! Shërbëtorja i tha:

“Në mbrëmje do të çelim iftarin, nuk ka asgjë tjetër përveç bukës!”



Hazreti Aishe radijallahu anha tha:

“Ti jepja bukën atij.”

Shërbëtorja e tregon vazhdimin e ngjarjes kështu:

Pasi më urdhëroi Hazreti Aishe, ia dhashë bukën atij të varfëri. Kur ra mbrëmja dikush na dërgoi një copë mish deleje të pjekur. Hazreti Aishe radijallahu anha më thirri dhe më tha:

“Urdhëro e ha, ky është më i ëmbël së buka jote!” (Muvatta, Sadaka, 5)

Në ajetin fisnik thuhet: “...**Allahu i merr lëmoshat...**” (et-Teube, 104) Allahu i jep robit sipas zemrës që ka.



Njërit prej sahabëve i kishin bërë dhuratë një kokë deleje. Me mendimin se dikush tjetër kishte më shumë nevojë, ai ia dërgoi atë dhuratë vëllait të tij. Por edhe ai ia dërgoi dikujt tjetër... kështu, në këtë mënyrë dhurata shkoi në shtatë shtëpi dhe u kthye së fundi te sahabiu i parë. (Hakim, II, 526)

Edhe ngjarja që tregon Huzejfe el-Adevi është shumë interesante sa i takon reflektimit të bujarisë dhe zemërgjërësisë që sahabët shfaqnin edhe në frymën e fundit:

Ishin në luftën e Jermukut. Ashpërsia e luftës kishte kaluar, myslimanët e plagosur me shigjeta dhe heshta kishin filluar te jepnin shpirt mbi rërën e nxehtë ku kishin rënë. Në ato çaste, duke e mbledhur veten me shumë vështirësi, fillova të kërkoj djalin e xhaxhait. Pasi eca pak mes të plagosurve që po jetonin frymën e fundit, në fund arrita ta gjeja. Por ç'të shihja? Djali i xhaxhait shtrihej në një pellg gjaku dhe vetëm me shenjat e syve mund të më kumtonte diçka. Duke i treguar torbën prej lëkure të mbushur me ujë që e kisha përgatitur më parë, e pyeta:

“Do ujë?”

Ishte e qartë që donte, sepse buzët pothuajse i ishin shkrumbuar nga vapa, por nuk kishte mundësi të përgjigjej. Vetëm nëpërmjet vështrimit mund ta shfaqte gjendjen e tij të vështirë.



Hapa grykën e torbës dhe teksa bëhesha gati t'i jepja ujë, u dëgjua një Ah! në mes ca të plagosurve të tjerë që gjëndeshin më tutje:

Sapo e dëgjoi këtë zë, djali i xhaxhait hoqi dorë nga nevoja e tij dhe me shenjën e vetullave dhe të syve kërkoi që ujin t'ia jepja menjëherë tjetrit.

Shkova te ai duke vrapuar në mes të dëshmorëve që ishin të shtrirë në rërën e nxehtë. Pashë se ai ishte Hisham bin As. E pyeta:

“Do ujë?” Me një gjest të syve më tha “Po!”, por në atë çastin kur po matej të pinte ujë, u dëgjua rënkimi “Ah, Ah!” i një të plagosuri tjetër. Hishami ma bëri me shenjë që t'ia jepja ujin tjetrit.

Kur shkova te ai kishte rënë dëshmor. Menjëherë erdha te Hishami dhe kur po i jepja torbën, çfarë të shikoja? Edhe ai kishte rënë dëshmor!

Të paktën t'i jap ujë djalit të xhaxhait, thashë me vete. Shkova te ai duke vrapuar. Çfarë të shihja? Edhe ai e kishte dorëzuar shpirtin duke e skuqur rërën e nxehtë si zjarr... Torba që kisha mbeti në mes të tre dëshmorëve.<sup>72</sup>

Huzejfe radijallahu anhu ndjenjën shpirtërore që kishte në atë çast e tregon kështu:

“Në jetën time kam parë shumë ngjarje, por asnjëra nuk më ka bërë të prekem dhe emocionohem kaq shumë. Në një kohë kur nuk kishin fare lidhje fafëfisnore ndërmjet tyre, shkalla e lartë e altruizmit, flijimi dhe butësia që tregonin ndaj njëri-tjetrit, (domethënë deri në frymën e fundit të tyre, që e dhanë me po atë mirësi që kishin pasur tërë ekzistencën e tyre, duke i dhënë lamtumirë jetës me ndërgegje, sipas udhëzimit të ajetit fisnik: **Vdisni vetëm myslimanë.**<sup>73</sup>) lanë gjurmë të thella në kujtesën time si një trimëri e madhe besimi që e admiroja shumë...”



Gulam Halil, i cili ishte një kundërshtar i njohur i tasavvufit, shfaq-

72. Shik. Kurtubi, XVII, 28; Zejlai, Nasbu'r-Raje, II, 318; Hakim, III, 270/5058.

73. Shik. Ali Imran, 102.



te sjellje armiqsore ndaj të gjithë mistikëve. Pasi u arrestua një grup, mes të cilit ishte edhe Ebu'l-Husejn en-Nuri, i dërguan të gjithë në qendrën e hilafetit. Me një urdhër të nxjerrë nga halifeja Abbasi e asaj kohe, u vendos që ata të ekzekutoheshin. Në çastin kur xhelati do t'i priste kokën njërit prej dervishëve, Hazreti Ebu'l-Husejin en-Nuri doli përpara me dëshirën e tij. Populli u habit nga kjo. Xhelati tha:

“O trim! Ti po del përpara, por kjo shpatë nuk është dçika me të cilën mund të matesh. Akoma nuk të ka ardhur radha, përse nxiton?” Ebu'l-Husejin kuddise sirruhu tha:

“Rruga ime është rruga e zemërgjërësisë. Gjëja më e lartë dhe më e vlefshme është jeta. Kohën që do ta shfrytëzoja për të marrë edhe pak frymë, dua ta flijoj tani, me qëllim që vëllezërit e mi të mund të jetojnë edhe pak, meqenëse për ne koha e një frymëmarrjeje në këtë botë është më dashur se sa njëmijë vjet në ahiret. Sepse këtu është vendi i shërbimit, ndërsa atje është vendi i kurbetit dhe vendi për të qënë afër Allahut. Kurbeti fitohet me shërbim. Për këtë arsye, këto frymëmarrje dua t'i flijoj për miqtë e mi.”<sup>74</sup>



Me vdekjen e Osman Gazit, zoti Alauddin i cili mbështetej nga paria e shtetit në lidhje me kalimin e postit sipas traditës, i dha përparësi vëllait të tij zotni Orhanit të cilit i tha:

“O Vëllai im! Lutja dhe ndihma e babait tonë është me ty. Kur ai ishte gjallë, komandën e ushtrisë ta pati dhënë ty, për këtë arsye, shteti të përket ty.”

Alauddini, i cili shfaqti zemërgjërësi dhe sakrifikim të madh, u bë ndihmëtari më i madh i vëllait të tij dhe shërbeu ne detyrën e vezirit.<sup>75</sup>



Më 8 tetor 2005 Pakistani u trondit nga një tërmet i madh. Më shumë se shtatëdhjetë mijë njerëz ndërruan jetë. Ata që ngelën, ishin ballë përballë me urinë dhe varfërinë. Një djalë i ri nga Turqia ua

74. Huxhviri, Keshfu'l-Mahxhub, Përkth. Sulejman Ulludag, Stamboll 1996, fq. 302.

75. Zija Nur Aksun, Osmanllë Tarihi, Stamboll 1994, I, 36.



dha vëllezërve myslimanë gjysmën e pasurisë së tij duke shfaqur një shembull që tregon kulmin e zemërgjërësisë. Në letrën e tij, që mban datën 24 nëntor të atij viti, ai shkrun kështu:

“Unë jam biri i një shtëpie të varfër. Babain nuk e kam ndërsa nëna është sëmurë. Kishim vetem dy lira bukë para, njëren prej këtyre po ua dërgoj juve, sepse unë sot kam gjetur bukë në kazan. Iftarin do ta bëjmë me atë. Më këtë lirë, merruni bukë fëmijëve që janë dëmtuar në tërmet. Kjo para është hallall. Nuk i dërgova të gjitha paratë, për shkak se do të paguaj pullën. Ju kërkoj ndjesë.”<sup>76</sup>

Sa shembull i shkëlqyer bujarie, zemërgjërësie dhe virtyti madhështor... Sa erë e mirë që fryn nga epoka e lumturisë.

I Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem, ishte në kulmin e bujarisë edhe kur kishte edhe kur nuk kishte asgjë. Ai i nxiste sahabët që të jepnin në rrugë të Allahut pa i ndarë njerëzit në të varfër apo të pasur. Në disa hadithe fisnike të Tij, duke treguar se bujaria nuk e pakëson pasurinë, ai thotë:

*“Çdo ditë, kur lind dielli, dy engjëj thërrasin: O njerëz, ejani te mëshira e Zotit tuaj. Riziku i pakët dhe i mjaftueshëm është më i mirë se pasuria e madhe që pakësohet. Këtë thirrje e dëgjojnë të gjitha krijesat përveç njerëzve dhe xhindëve.*

*Çdo ditë, kur perëndon dielli, dy engjëj zënë vendin e tyre dhe luten në një mënyrë që e dëgjojnë të gjithë krijesat që jetojnë në tokë, përveç njerëzve dhe xhindëve: O Zot, bëje mëkëmbës atë që jep në rrugën Tënde dhe shkatërroje atë që nuk jep në rrugën Tënde.”*  
(Ahmed, V, 197)

Atëherë dija e vërtetë është shndërrimi në pasuri të ahiretit i mirësive që na ka dhënë Zoti dhe tregtinë e kësaj bote, për ta mbushur zemrën me ndjenjën e bujarisë dhe zemërgjërësisë dhe për ta sjellë në një gjendje deti. Nga ky aspekt, pasuria më e mirë është ajo që është dërguar para të Zotit të saj në ahiret, ndërsa jeta më e mirë është ajo që është përdorur në rrugën e kënaqësisë së Allahut.

76. [www.presidentofpakistan.gov.pk/NeesEventImagePopUp.aspx?ImageID=129](http://www.presidentofpakistan.gov.pk/NeesEventImagePopUp.aspx?ImageID=129). (28.12.2005)





### 13. Mjaftueshmëria

Mjaftueshmëri do të thotë të jesh i kënaqur ndaj asaj që të ka përcaktuar Allahu, të mjaftohesh me atë që të ka dhënë Ai, domethënë të mjaftohesh me mundësitë materiale, duke i plotësuar nevojat në masën më të vogël dhe duke e zhdukur lakminë, për të mos ua ngulur sytë gjërave të të tjerëve.

Njeriu, i cili ka ardhur në këtë botë për t'u sprovuar, nuk duhet t'i harxhojë të gjitha mundësitë për të fituar pasuri, duke harruar kështu qëllimin e krijimit dhe duke u shqetësuar për rizkun. Ai duhet të përpiqet të krijojë kapitalin e ahiretit me pasurinë dhe mundësitë që i ka dhënë Allahu, sepse Allahu Teala e ka marrë të gjithë rizkun e krijesave në përgjegjësinë e Tij dhe ka dëshiruar që robërit të jenë edhe bindës edhe indiferentë. Në ajetet fisnike thuhet kështu:

**“Nuk ka asnjë gjallesë në tokë që Allahu të mos ia ketë garantuar furnizimin (rizkun) e saj...”** (Hud, 6)

**“Ne krijuam për ju dhe për ata, furnizimi i të cilëve nuk është në dorën tuaj, mjete jete.”** (el-Hixhr, 20)

**“Sa e sa gjallesa janë që nuk kanë mundësi të furnizohen vetë. Allahu i furnizon ato edhe ju. Ai dëgjon dhe di.”** (el-Ankebut, 60)

**“...Rizkun kërkojeni te Allahu!...”** (el-Ankebut, 17)

**“Ky është furnizimi Ynë dhe i cili nuk ka të mbaruar.”** (Sad, 54)

Pejgamberi ynë i Nderuar i lavdëron kështu robërit e tij që janë bindës:

*“Ai që është mysliman, të cilit i është dhënë rizk i mjaftueshëm dhe që i bindet mirësisë që i ka dhënë Allahu, patjetër do të shpëtojë.”* (Muslim, Zekat, 125)

Po ashtu i Dërguari i Nderuar lutej:

*“O Zoti im! Bëje rizkun e familjes së Muhammedit aq sa ç'kanë nevojë.”* (Muslim, Zekat, 126)

Një njeri i cili është i pabindur, edhe nëse është i pasur, është më i



shqetësuar dhe më me halle se të varfërit dhe nevojtarët, sepse ai nuk ngopet sado që të fitojë pasuri dhe vazhdimit do të kërkojë më shumë. I Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem e përshkruan kështu gjendjen e njerëzve të cilët nuk janë të pabindur:

*“Nëse njeriu ka një luginë me flori, do edhe një luginë tjetër. Syrin e atij nuk e ngop asgjë përveç tokës, por Allahu e pranon pendimin e atij që pendohet.”* (Buhari, Rikak, 10; Muslim, Zekat, 116-119)

Domethënë duhet të pendohemi nga mëkati i mosbindjes. I Nderuari ynë alejhissalatu uesselam i ka këshilluar kështu ata që janë në këtë gjendje:

*“Kur dikush prej jush ta shohë veten lart nga aspekti i pasurisë dhe i krijimit, le ta kthejë shikimin e tij te ai që është poshtë tij.”* (Buhari, Rikak, 30)

Edhe Llokman Hakimi jep këtë këshillë:

*“Biri im! Mos e preokupo zemrën tënde me fatkeqësi dhe pikëllime! Largohu nga syri i pangopur. Ji i kënaqur ndaj përcaktimit të Zotit. Bindju asaj që të ka dhënë Allahu, në mënyrë që të të zbukurohet jeta, zemra të të mbushet me gëzim dhe të kënaqesh nga jeta.”*

Por duke e kuptuar gabim bindjen, nuk duhet të mendohet se Islami ka këshilluar lënien e punës, dembelizmin dhe rënien në një shkallë aq të ulët sa të kesh nevojë për njerëzit. Bindja është diçka shpirtërore dhe morale. Duke fituar nga hallalli, myslimani duhet t'i kryejë nevojat financiare e duhet t'u japë edhe nevojtarëve.

Një tjetër cilësi e bukur si bindja, është edhe istignaja. Istigna do të thotë të jeshë syngopur, zemërpasur, t'i bindesh asaj që të ka dhënë Allahu, të mos presësh gjë nga njerëzit dhe të mos ua shfaqësh të tjerëve nevojave tua.

I Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem ka thënë:

*“Më erdhi Xhebraili dhe më tha: O Muhammed! Jeto sa të duash, në fund patjetër do të vdesësh. Duaj kë të duash, në fund do të ndahesh nga ai! Puno me çfarë të duash, në fund do ta marrësh shpërblimin!*

*Dije mirë se nderi i besimtarit është në namazin e natës, ndërsa dinji-*



*teti i tij është të mos u ankohet njerëzve!*" (Hakim, IV, 360-361/7921)

Istignaja është një cilësi shpirtërore e të devotshmëve dhe e të sinqertëve, të cilët kanë arritur përsosmërinë duke shpëtuar nga egoizmi. Istigna është të qenurit i mjaftueshëm shpirtërisht me atë që ke dhe të mos përpiqesh, duke degraduar si qenie, për më tepër apo për të pasur atë që kanë të tjerët. Istignaja sipas hadithit fisnik është:

"Mjaftueshmëria është një thesar që nuk ka të mbaruar." (Dejlemi, III, 236/4699). Është qetësimi i zemrës duke u pasuruar shpirtërisht si rezultat i afrimit me Allahun Teala, sepse zemra që pasurohet me bindje dhe istigna, qetësohet nga shqetësimet dhe frikërat e kësaj bote. Shpirti percepton amëshushmërinë dhe në këtë mënyrë marrin fund dëshirat e joshjet e përkohëshme të besimtari. Përveç vetes së Tij, që ka emrin fisnik "**el-Mugni**", Allahu Teala ka bërë që gjithçka tjetër të ketë nevojë për Të.

I Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem thotë kështu:

*"Kush ka nevojë dhe këtë ua shpreh njerëzve, nuk i plotësohet nevoja. Kush ia paraqet nevojën e tij Allahut, shpresohet që Allahu ta furnizojë në çast ose më tutje."* (Tirmidhi, Zuhd, 18/2326; Ebu Davud, Zekat, 28/1645)

Istignaja nuk është vetëm kundrejt pasurisë dhe pronës. Është e domosdoshme që robi të largohet nga gjërat që e bëjnë të pavëmendshëm ndaj Zotit.

### ***Tabllo të virtytshme***

I Dërguari i Allahu, i cili e praktikonte bindjen në mënyrën më të bukur, herë-herë kërkonte nga sahabët që t'i jepnin fjalën se nuk do të kërkonin asgjë nga askush. Seuban radijallahu anhu tregon:

"Një herë, i Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem tha:

*-Kush më jep fjalën se nuk do të kërkojë gjë nga njerëzit, unë i premtoj xhennetin.*

Mbi këtë unë thashë:



-Ta jap fjalën unë.

Sahabiu që e transmeton këtë hadhith, thotë se pas kësaj ngjarjeje, Seubani radijallahu anhu nuk ka kërkuar asgjë nga askush gjatë gjithë jetës së tij. (Ebu Davud, Zekat, 27/1643)

Në hadithin fisnik shfaqet mirësia e mosankimit te njerëzit. Edhe Hazreti Maruf Kerhi, duke treguar përpikmëri të madhe në çështjen e bindjes dhe istignasë në tasavvuf, që është esenca dhe shpirti i Islamit, thotë:

“Tasavvufi është të marrësh të vërtetat dhe të këpusësh shpresat nga gjërat që kanë njerëzit.”

Kjo ngjarje që transmeton Auf bin Malik radijallahu anhu është shumë tërheqëse, sepse tregon se sa shumë ua ka mësuar i Dërguari i Nderuar bindjen dhe istignanë sahabëve të tij:

“Ishim një grup prej shtatë-tetë personash dhe po qëndronim pranë të Dërguarit të Allahut sallallahu alejhi ue sellem. Ai na tha:

*-A nuk do t'ia jepni besën të Dërguarit të Allahut?*

Por ne sapo ia kishim dhënë besën! Për këtë arsye i thamë:

-O i Dërguari i Allahut! Ne ta kemi dhënë besën!

Pastaj ai tha përsëri:

*-A nuk do t'ia jepni besën të Dërguarit të Allahut?*

Ne përsëri i thamë:

-O i Dërguari i Allahut! Ne ta kemi dhënë besën!

I Nderuari ynë përsëri tha:

*-A nuk do t'ia jepni besën të Dërguarit të Allahut?*

Këtë radhe, duke i zgjatur duart për t'i dhënë besën, i thamë:

-O i Dërguari i Allahut! Ne ta dhamë besën më parë. Për çfarë do që të ta japim besën tani?

Pejgamberi ynë i Nderuar tha:

*-Do të më jepni besën se do të adhuroni Allahun dhe se nuk keni*



*për t'i bërë shirk, se do të falni pesë kohët e namazit, se do të bindeni dhe –duke e ulur zërin- se nuk nuk do të kërkoni gjë nga askush!* Beto hem se kam parë disa nga ky grup, të cilëve (kur ishin mbi kalë) u binte shkopi në tokë dhe nuk kërkonin nga askush që tua jepte.” (Muslim, Zekat, 108)

I Dërguari i Allahut e përsëriti fjalën tri herë dhe e uli zërin kur po fliste për shkak të rëndësisë së çështjes që do të predikonte.



Kur Hazretit Ebu Bekr i binte nga dora kapistra, menjëherë e ndalonte devenë dhe e merrte vetë. Ata që ishin aty, i thanë:

“Mund të na urdhëroje dhe ne ta jepnim!”

Ebu Bekri radijallahu anhu përgjigjej:

“I Dërguari i Allahut më ka urdhëruar që të mos kërkoj asgjë nga njerëzit.” (Ahmed, I, 11)



Amr bin Taglib radijallahu anhu tregon kështu:

Të Dërguarit të Allahut i patën sjellë plaçka lufte ose robër. Ai i ndau këta duke i dhënë dikujt e duke mos i dhënë dikujt tjetër. Më pas, kur dëgjoi fjalët e atyre që nuk u kishte dhënë gjë, falenderoi Allahun dhe tha:

*“Beto hem në Allahun se unë u jap disave dhe nuk u jap disa të tjerëve. Në të vërtetë ata të cilëve nuk u kam dhënë janë më të dashur se ata të cilëve u kam dhënë. Unë jap për shkak se shoh padurimin dhe lakminë në zemrat e disave. Disa të tjerë i lë të rrijnë me bindjen dhe mirësinë që ka krijuar Allahu në zemrat e tyre.”*

Amr bin Taglib thotë:

“Për Zotin, kjo fjalë që tha Pejgamberi, për mua është shkëmbim për të gjithë botën.” (Buhari, Xhum'a 29, Humus 19, Teuhid 49)



Hazreti Omer radijallahu anhu tregon:

“Nganjëherë, i Dërguari i Allahut më jepte bakshish lufte. Unë i thoja:

-Jepjani këto ndonjërit që është më i varfër se sa unë. I Dërguari i Allahu më këshilloi:

*-Ti merri këto! Merre mallin e tillë që nuk i ke vënë syrin dhe nuk e ke dashur. Merre dhe nëse dëshiron jepe lëmoshë, por mos shko pas një malli që nuk është i tillë!”* (Buhari, Zekat, 51)



Kur njerëzit e grupit Beni Tuxhib që kishin ardhur për të vizituar të Nderuarin tonë, deshën të kthehen në vendin e tyre, i Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem u dha më shumë se të tjerëve dhe i pyeti:

*“A ka mbetur ndonjëri prej jush të cilin nuk i është dhënë dhuratë?”*

Ata thanë:

“Po, një djalë i ri që është më i vogël se ne në moshë. Të cilin e kemi lënë për të ruajtur kafshët.”

I Dërguari i Allahut tha:

*“Silleni edhe atë!”*

Kur u kthyen te kafshët, ata i thanë djaloshit:

“Shko te i Dërguari i Allahut dhe merr dhuratën tënde! Ne i morëm dhe u ndamë me Të.” Kur djaloshi erdhi te Pejgamberi ynë i Nderuar, tha:

“O i Dërguari i Allahut! Unë jam njëri nga Beni Ebza. Jam nga grupi që erdhi më parë dhe të cilëve jua plotësuat dëshirat. A ma plotëson edhe dëshirën time?”

I Nderuari ynë e pyeti:

*“Çfarë dëshire ke?”*

Djaloshi tha:



“O i Dërguari i Allahut! Dëshira ime nuk është si dëshira e sho-këve të mi... Unë dua që t'i luteni Allahut të më falë mua, të më më-shirojë dhe të më pasurojë zemrën!”

Pasi u lut, Pejgamberi ynë i Nderuar tha:

*“O Zoti im! Fale atë, mëshiroje dhe pasuroja zemrën!”*

Mandej urdhëroi që edhe atij ti jepnin diçka si të tjerëve.

Grupi i Beni Tuxhib u kthye në vendin e tyre. Një grup prej kë-tyre, gjatë kohës së haxhit u takua me Pejgamberin tonë të Nderuar në Mina dhe i thanë:

“Ne jemi Beni Ebza.”

I Nderuari ynë i cili ishte një monument besnikërie, i pyeti:

*“Çfarë bën djaloshi që pati ardhur te unë bashkë me ju vitin e kaluar?”*

Ata i thanë:

Nuk kemi parë njeri më bindës se ai ndaj rizkut që i ka dhënë Allahu i Lartë. Nëse njerëzit do ta ndanin botën ndërmjet tyre, ai nuk do interesohej fare për këtë.”

I Nderuari ynë, i cili u gëzua kur dëgjoji këto fjalë, falenderoi Allahun dhe iu lut Atij në të mirë të djaloshit.

Me sjelljet që shfaqti, ky djalosh u bë një shembull virtyti për popu-llin e tij. Ai e vazhdoi jetën si një rob që nuk i jepte rëndësi kësaj bote dhe shumë i bindur ndaj asaj që i kishte dhënë Allahu. Kur populli i Jemenit deshi të dilte nga Islami pas vdekjes së Pejgamberit tonë të Nderuar, ai nuk ngurroi t’u kujtonte atyre Allahun dhe Islamin. Për shkak të tij, asnjë nga populli i tij nuk bëri irtidad, domethënë nuk e la Islamin. Më vonë, Ebu Bekri radijallahu anhu u interesua për atë djaloshi, pyeti për gjendjen e tij dhe i shkroi një letër përfaqësuesit të atij vendi, duke e këshilluar të sillet mirë me të. (Ibn Kajjim, III, 650-652; Ibn Sa’d, I, 323)



Marrëveshja e vëllazërisë që u bë ndërmjet Muhaxhirëve, të cilët u shpërngulën nga Mekka për në Medine dhe Ensarëve, ishte një tablo e pashoqe që nuk e kishte parë historia. Aq sa duke e shpalluar pasurinë dhe duke e nxjerrë të tërën në pah, Ensarët e Nderuar deshën t'i ndajnë barazim me vëllezërit Muhaxhirë. Nga ana tjetër, edhe Muhaxhirët, të cilëve u ishin shndërruar zemrat në thesare të bindjes duke shfaqur istigna, treguan pjekurinë e duhur për të thënë:

“Malli dhe prona jote qoftë e bekuar vëlla, ti më trego rrugën e tregut. Kjo mjafton!” (Buhari, Buju, 1)



Një ditë, një burrë i varfër nga myslimanët Medinas erdhi te Pejgamberi ynë i Nderuar dhe i kërkoi diçka për të ngrënë.

I Dërguari i Allahut e pyeti:

*“A nuk ke asgjë në shtëpi?”*

Burri tha:

“Kam një qilim, me njëren pjesë të të cilit mbulohemi, ndërsa pjesën tjetër e kemi shtruar në tokë, si dhe një safë uji.”

I Dërguari i Nderuar tha:

*“Mi sill mua ato!”*

Burri e solli qilimin dhe safën e ujit. Pejgamberi i Nderuar i mori në dorë ato dhe i pyeti ata që ishin aty:

*“Kush do t'i blejë këto?”*

Njëri nga sahabët tha se mund të japë një dirhem për to. Hazreti Pejgamber tha disa herë:

*“A nuk ka ndonjë që jep më shumë?”*

Dhe ia shiti një sahabiu që dha dy dirhem. Teksa po i jepte paratë sahabiut të varfër, i tha:

*“Me një dirhem merri familjes diçka për të ngrënë. Me paratë që do të teprojnë, bli një sopatë dhe ma sill mua!”*





I Nderuari ynë ia vendosi një bisht me duart e tij sopatës që solli burri. Mandej i tha:

*“Tani shko prit dru dhe shiti! Puno pesëmbëdhjetë ditë, pastaj eja te unë!”*

Pas pesëmbëdhjetë ditësh burri i varfër erdhi sërish te i Nderuari ynë. Ai kishte fituar dhjetë dirhem. Me këto para kishte marrë për vete dhe për familjen rroba dhe ushqime.

Pejgamberi ynë i Nderuar u gëzua shumë dhe tha:

*“Më mirë është për ty kështu, se sa në ditën e kiametit të të dallohet në fytyrë njolla e lypjes...”* (Ebu Davud, Zekat, 26/1641; Ibn Maxhe, Ticarat, 25)

Myslimani duhet ta perceptojë mirësinë për t'i dhënë një vëllai besimtar një profesion. Nga ana tjetër edhe myslimanët e varfër nuk duhet të ankohen te njerëzit, por duhet të përpiqen sipas orientimit që ka treguar i Dërguari i Allahut.



Ebu Said radijallahu anhu ishte nga sahabët që lidhnin gurë në bark për shkak të urisë që kishin. Nëna e tij i tha:

“Ngrihu! Shko te i Dërguari i Allahut dhe kërko disa gjëra nga Ai. Filani ka shkuar te i Dërguari i Nderuar dhe Ai e ka ndihmuar. Edhe filanin që ka shkuar, e ka ndihmuar po ashtu. Shko edhe ti, ndoshta kthehesh me ndonjë të mirë.”

Ebu Said radijallahu anhu iu përgjigj nënës me fjalët:

“Prit pak, le të përpiqemi të kërkojmë disa gjëra; nëse nuk gjejmë do të shkoj.” Por të gjitha kërkimet dhe munda i shkuan kot. Për këtë arsye, duke mos pasur asnjë rrugëzgjidhje, vendosi të shkojë te Krenaria e Gjithësisë, i Nderuari ynë sallallahu alejhi ue sellem. Kur hyri te i Dërguari i Allahut, e gjeti duke mbajtur hytbe dhe filloi të dëgjojë hytben. I Dërguari i Allahut në hytben e Tij po thoshte këto:

“Atë që shfaq istigna dhe e ruan nderin e tij, Allahu do ta bëjë që të mos ketë nevojë për të gjithë botën...”



Pasi dëgjoji këto fjalë, Ebu Said radijallahu anhu nuk guxoi t'i kërkonte ndonjë gjë të Dërguarit të Allahut sallallahu alejhi ue sellem dhe kështu u kthye në shtëpi duarbosh. Ai e përshkruan kështu gjendjen e tij të mëvonshme:

“Kur u ktheva në shtëpi pa mundur t'i kërkoja diçka të Dërguarit të Nderuar, Allahu na e dërgoi rizkun tonë. Punët tona u rregulluan aq mirë, saqë asnjë prej Ensarëve nuk ishte më i pasur se ne.” (Shik. Ahmed, III, 44)

Ja pra sa rëndësi ka që ta njohim Zotin tonë, i cili është **Rrazzak**, domethënë ai që e jep dhe e ndan rizkun... Sa më i fortë të jetë besimi, mbështetja dhe nënshtrimi ynë ndaj Tij, aq më shumë mbushet zemra jonë me pasuri dhe qetësi.



Hakim bin Hizam radijallahu anhu tregon:

Shkova te i Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem dhe i kërkoja që të më jepte një pjesë nga mallrat e luftës. Ai më dha njëqind deve. I kërkoja edhe një herë dhe përsëri më dha njëqind deve. Përsëri i kërkoja dhe përsëri më dha njëqind deve. Pastaj tha:

*“O Hakim! Me të vërtetë ky mall është tërheqës dhe i ëmbël. Kush e merr pa lakmi, në atë mall i jepet bereqet. Kush e merr duke ia ngulur sytë dhe me lakmi, atij malli nuk i ngel bereqet. Një njeri i tillë është si ai që ha e ha dhe nuk ngopet në asnjë lloj mënyre. Dora që jep, është më e mirë se dora që merr.”*

Mbi këtë unë i thashë:

“O i Dërguari i Allahut! Beto hem në Allahun që të ka dërguar ty me fenë e vërtetë, se sa të jem në jetë nuk do të pranoj asgjë nga dikush përveç se nga Ti.”

Hakimi radijallahu anhu mori njëqind devetë e para që ia dha i Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem, ndërsa të tjerat i la. Një ditë dhe Ebu Bekri radijallahu anhu e thirri Hakimin për t'i dhënë një pjesë nga malli i plaçkës së luftës, por Hakimi nuk e mori. Më vonë Hazreti Omer radijallahu anhu e ftoi për t'i dhënë disa gjëra. Hakimi



radijallahu anhu nuk i pranoi. Atëherë, këtë Hazreti Omer tha:

“O Myslimanë! Ju kam dëshmitarë ju për Hakimin. Unë po i jap një pjesë nga plaçka e luftës që ia ka ndarë Allahu, por ai nuk dëshiron ta marrë. Pas vdekjes së Profetit sallallahu alejhi ue sellem deri sa vdiq edhe vetë, Hakimi kurrë nuk pranoi asgjë nga askush. (Buhari, Vasaje, 9; Vakidi, III, 945)

Ja një shembull i veçantë i vendosmërisë në bindje, i mosankimit tek të tjerët dhe i dashurisë ndaj Pejgamberit alejhissalatu uesselam...



E pyetën Ahmed bin Hanbelin, i cili ishte i njohur me asketizmin dhe devotshmërinë e tij:

“Kush është më e lartë, pasuria apo varfëria?” Ai u përgjigj:

“Bëj tregti dhe mos u anko te njerëzit. Unë nuk di virtyt më të madh se sa të mos kesh nevojë për njerëzit.”



Ibrahim bin Ed'hemi pa një njeri që po digjte veten nga varfëria dhe i tha:

“A ta kanë dhënë varfërinë pa të paguar shpërblim, prandaj po e djeg veten?”

Njeriu pyeti me habi:

“-I Nderuar! A edhe varfërinë e marrin duke paguar shpërblim?”

Hazreti Ibrahim bin Edhemi tha:

“Po! Kur unë e pashë vlerën e varfërisë, për ta blerë atë dhashë shtetin e Belhit me kënaqësi dhe gëzim të madh...”

Çështja që synohet këtu, është të thyesh dëshirat vetjake dhe të bëhesh pasanik i bindjes. Vlera shpirtërore e një varfëri që bën durim në të, është shumë e lartë...



Kur e pyetën Hazretin Ebu Hazim:

“Çështë pasuria?” Ai tha:

“Pasuria është dy gjëra: njëra është të jesh i kënaqur nga Allahu Teala, dhe e dyta është të mos jesh nevojtar ndaj njerëzve.”. I thanë:

“-Atëherë ti je i varfër.”

Ai u përgjigj:

“Si mund të jem i varfër kur toka, qiejt dhe gjërat që janë ndërmjet tyre janë pronë e Allahut Teala dhe kur unë jam një rob i sinqertë i Tij!”

Varfëria e vërtetë është pakujdesia e zemrës ndaj Zotit. Nëse një zemër ka mirësinë për të qenë bashkë me Zotin, do të thotë se është më e pasura e botës. Ndërsa ajo që është larg Zotit, është më e privuara.



Është shumë mësimdhënëse edhe kjo histori në të cilën reflektohet mirësia e mjaftueshmërisë dhe istignasë:

Në një kohë iftari, te dera e një furre buke erdhi një njeri fytyra e të cilit kishte një fisnikëri që nuk mund ta shikonte çdo sy. Pasi u shpërndanë njerëzit, ai i tha furrxhiut:

“O biri im! Sot nuk munda të fitoj para për bukë. A mund të më jepni një çerek buke që ta paguaj nesër, nëse nuk vdes?”

Zëri i dridhej dhe fytyra i ishte skuqur. Edhe pse furrxhiu i tha:

“S’ka problem, ty të jap një bukë dhe jo një çerek buke. Hallall të goftë, nuk ka nevojë për para.” Njeriu i huaj tha:

“Jo o biri im, një e katërta më mjafton... ndoshta vijnë edhe tre të varfër të tjerë. Vetëm sa një e katërta mund ta nxi fytyrën. Me shumë nuk mund ta mbaj. Unë vendosa kusht që edhe një të katërtën të ta paguaj nesër.”

Furrxhiu ia dha çerekun e bukës i habitur. Burri i shkretë e mori bukën duke e puthur dhe u largua ngadalë-ngadalë e me hapa të lehtë.



Përpara, në një qoshe i doli një qen. Qeni po e shikonte të moshuarin me sy lutës, a thua se po i tregonte që është i uritur. Duke pëshëritur fjalët “do të thotë gjysma paska qënë e jotja!”, njeriu fytyrëndritur ia dha qenit gjysmën e çerekut të bukës. Pastaj shkoi drejt në xhami. Ai hapi iftarin me një kafshatë bukë dhe me disa gllënjka uji që i kishin ngelur, duke falenderuar Allahun për këtë mirësi.

Ditën e nesërme, një tregtar i tha:

“Xhaxha, mbushi këto torba nga çezmeja, pastaj mbarti këto gjëra që sapo erdhën!”. Mandej, si shpërblim i dha një lirë.

Burri i shkretë vrapoi menjëherë për te furra e bukës dhe pagoi paratë e çerekbukës që bënte 25 cent. Edhe pse furrxhiu nuk deshë t'i merrte, u dorëzua përballë këmbënguljes e lutjeve të fytyrëndriturit dhe u detyruata pranonte pagesën me sytë e mbushur me lot.

Ja, një shembull monumental i mjaftueshmërisë dhe istignasë... e në të njëjtën kohë një rob bujar që nuk hiqte dorë nga lëmosha dhe butësia ndaj krijesave të Allahut, edhe pse ishte i varfër...



Dy nga shembujt e shkëlqyer për mjaftueshmërinë dhe istignanë, që e shikojmë në vakëfin tonë “Aziz Mahmud Hydaji” që është në Stamboll, janë:

Vakëfi jonë i ndihmonte një nëne dhe birit të saj. I biri ishte paralizuar dhe kishte mbaruar universitetin. Një ditë kjo nënë erdhi, e falenderoi vakëfin dhe tha:

“Këtu e tutje nuk do të marr më ndihmë. Jepuni atyre që janë më në nevoje se unë, sepse im bir vdiq. Me paratë që mora në fund, rregullova punët e xhenazes. Tashmë kam vetëm shpirtin tim. Sidoqoftë unë i shtyj ditët. Paratë që m'i jepnit mua, jepuani ndonjë familjeje nevojtare që është në gjendjen tonë të kaluar.”

Në një rast tjetër i jepej ndihmë një gruaje hollandeze, së cilës i kish vdekur burri dhe kishte ngelur me jetimat. Edhe ajo një ditë i shkruajti letër vakëfit tonë dhe e falenderoi duke thënë:



“Tashmë i kam paguar borxhet e burrit tim. E shpëtova atë nga haku i robit. Tani jam në gjendje të jetoj me mundin tim.”

Ja, fisnikëria nuk është as me pasuri dhe as me varfëri, fisnikëria e vërtetë është me xhevahirin që ndodhet në zemër.



Njeriu, duhet të jetë syngopur (i mjaftueshëm me atë që ka) ndaj çdo gjëje që kanë njerëzit e tjerë kurse ndaj asaj që ka Zoti gjithmonë syçelur. Sa bukur shpjegohet kjo nëpërmjet këtij hadithi fisnik:

*“Kur Ejjubi alejhisselam kishte nxjerrë rrobat dhe po lahej, i ra një grumbull florinjsh. Menjëherë filloi t’i fuste në rrobë grushta grushta. Në lidhje me këtë Allahu Teala i tha:*

*-O Ejjub! A nuk të kam bërë jonevojtar për këto që pe? Hazreti Ejjub u përgjigj:*

*-Betohem në madhërinë Tënde se po, o Zoti im, por unë nuk jam indiferent ndaj bereqetit që më vjen nga Ti. (Buhari, Gusl, 20)*



Hasan Basri kuddise sirruhu i lutej kështu Allahut Teala:

اللَّهُمَّ اغْنِنِي بِالْفَقْرِ الْيَاكُ وَتُفْقِرْنِي بِالْإِسْتِغْنَاءِ عَنْكَ

“O Zoti im! Më pasuro duke më bërë nevojtar për Ty, mos më bëj të varfër që të mos jem i pavëmendshëm ndaj Teje!”<sup>77</sup>

Së fundi, Hazreti Pejgamber sallallahu alejhi ue sellem e ka bërë të qartë se pasuria e vërtetë nuk është mall, sa ç’është ngopje e zemrës.<sup>78</sup> Sipas kësaj, gjithkush është i pasur aq sa bindja dhe istignaja e tij. Ndërsa bindja, siç thuhet edhe në hadithin fisnik, është një thesar që nuk ka të mbaruar.<sup>79</sup> Edhe besimtarët e vërtetë janë ata që kanë këtë mirësi pasurie dhe që japin në rrugë të Allahut.

77. Bakillani, l’xhazu’l-Kur’an, Bejrut 1998, fq. 107.

78. Ahmed, II, 389.

79. Bejhaki, Kitabu’z-Zuht, Bejrut 1996, II, 88.



## 14. Të jesh asket kundrejt kësaj bote

Asketizëm do të thotë të zbukurosh botën e brendshme me bukurinë e adhurimeve dhe të veprave të mira, duke mos ndjerë nevojë ndaj asnjë dëshire vetjake të kësaj bote, pra domethënë duke mos u dhënë rëndësi. Me qëllim që, përveç Allahut xhelle xhelaluhu, gjithçka tjetër ta humbë rëndësinë në zemër.

Asket është ai që ikën nga mëkati duke shmangur edhe gjërat e dyshimta, si dhe ai që i përdor me qëllim mirësitë e kësaj bote, me dashuri dhe frikë ndaj Allahut.

Të mëdhenjtë e Islamit kanë jetuar me një adhurim të lartë, të cilin e kanë shfaqur shpirtërisht në rrugë të Allahut, me asketizëm dhe istigna të bukur që pasqyron lidhjet e tyre me këtë botë. Sepse me frikën dhe shpresën që kishin ndaj Allahut, çdo gjë e kish humbur vlerën në këtë botë, ashtu që zemrat e tyre nuk shprehnin asgjë përveç Zotit. Kështu, asketizmi është një parzmorë e fortë që të mbron nga pasionet dhe nga dashuria për këtë botë, të cilat të bëjnë të harrosh ahiretin.

Kjo botë gënjeshtare ka bërë shumë njerëz për vete me joshjen dhe magjinë e saj. Por këtë botë duhet ta shndërrojmë në kapital të ahiretit dhe duhet të përfitojmë prej saj duke e mbajtur atë jashtë zemrës. Allahu e përshkruan kësaj jetën e kësaj bote, e cila jetohet duke ndjekur dëshirat dhe pasionet vetiake:

**“Dijeni se jeta e kësaj bote nuk është tjetër vetëm se lojë, kalim kohe në argëtim, stoli, krenari mes jush dhe përpjekje në shtimin e pasurisë dhe të fëmijve, dhe është si shembulli i një shiu prej të cilit bima habit bujqit, pastaj ajo thahet dhe e sheh atë të verdhë, mandej të thyer e llomitur, ndërsa në botën tjetër ka dënim të rëndë, por edhe falje mëkatesh dhe dhurim i kënaqësisë nga Allahu. Jeta e kësaj bote nuk është tjetër vetëm se përjetim mashtrues.”** (el-Hadid, 20)

I Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem ka thënë:

*“Në krahasim me këtë botë, ahireti i ngjan futjes së gishtit të ndo-*



*njërit prej jush në det. Ai njeri le të shikojë se me sa ujë i kthehet gishti.*” (Muslim, Xhennet, 55)

*“Kush dëshiron ahiretin, Allahu ia vendos pasurinë e tij në zemër dhe ia rregullon punët. Tashmë kjo botë i shkon nga pas duke iu bindur. Kush ka për qëllim këtë botë, Allahu i vendos varfërinë në mes dy syve dhe ia ngatërron punët. Së fundi, në dorën e tij nuk i vjen ndonjë gjë më tepër nga kjo botë, përveç asaj që i është caktuar.”* (Tirmidhi, Kijamet, 30/2465)

Me qëllim që ummeti i tij të jetë asket ndaj kësaj bote dhe të falenderojë Allahun për mirësitë që i ka dhënë, Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem na jep këtë këshillë:

*“Shikoni ata që i kanë kushtet e jetës më të vështira se ju, dhe mos shikoni ata që janë më mirë se ju. Kjo është sjellje më e përshtatshme, që të mos e neglizhoni mirësinë e Allahut.”* (Muslim, Zuhd, 9)

“Zuhdi” dhe “takva” (asketizmi dhe devotshmëria), të cilat janë shenjat e atyre që kanë përvetësuar metodën profetike kundër jetës dhe ngjarjeve, nganjëherë kuptohet gabim. Njerëzit pandehin se kjo do të thotë të heqësh dorë plotësisht nga mirësitë dhe pasuritë e kësaj bote. Mirëpo edhe adhurimet financiare që kryhen me pasuri, janë shumë të vlefshme te Allahut. Në Kur’anin Fisnik fjala infak (të harxhosh në rrugë të Allahut) përmendet në shumë vende. Kryerja e zekatit dhe e haxhit, të cilat janë dy nga pesë shtyllat e Islamit, është e mundur me zotërimin e masës më të vogël të pasurisë së kësaj bote. Veçanërisht edhe shprehja<sup>80</sup> profetike “dora që jep është më e mirë se dora që merr” është po ashtu diçka që inkurajon të zotërosh pasurinë e këtyre adhurimeve. Kështu që asketizmi nuk bie në kundërshtim me çështjet që ka inkurajuar feja.

Është e qartë se të sillesh me istigna ndaj mirësive të kësaj bote duke patur frikë se bie në mëkat apo pakujdesi, ka nevojë për asketizëm dhe devotshmëri, por kjo **istigna është shpirtërore dhe jo vepërore**. Domethënë, asketizmi dhe istignaja, krahas përkushtimit ndaj mirësive të kësaj bote, është të mos i futësh ato në zemër. Nisur nga kjo, asketizmi nuk është varfëri, por një sjellje shpirtërore që i nevoj-





tet çdo besimtari të pasur apo të varfër. Nëse një njeri që në pamje të jashtme jeton në varfëri si rezultat i përcaktimit hyjnor, por që zvarritet shpirtërisht pas dëshirave të kësaj bote, nuk është asket dhe nuk ka istigna, sepse asketizmi dhe istignaja nuk janë bindje ndaj varfërisë së detyruar nga fati, por mbrojtja e zemrës me synimin që të mos bëhet rob i kësaj bote.

Sa bukur e ka përkufizuar asketizmin i Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem:

*“Asketizmi në këtë botë nuk është të bësh hallallin haram dhe as që të lësh pasurinë dhe pronën. Asketizmi në këtë botë është t'i besosh më shumë asaj që është te Allahu se sa asaj që ke në dorë, si dhe të shpresosh shumë në shpërblimin e fatkeqësisë që të ka ndodhur, përderisa mos të të lërë ajo.”* (Tirmidhi, Zuhd, 29/2340)

### *Tabllo të virtytshme*

Ijas bin Tha'lebe radijallahu anhu ka thënë:

Një ditë ashabët e nderuar po flisnin për këtë botë pranë Pejgamberit tonë të Nderuar. Në lidhje me këtë, i Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem tha:

*“Ju a nuk dëgjoni, ju a nuk dëgjoni? Është nga besimi që të jetosh thjeshtë. Është nga besimi të jetuarit thjeshtë.”* (Ebu Davud, Terexhxhul, 1/4161; Ibn Maxhe, Zuhd, 4)

Domethënë, të jetosh si asket, të jesh modest dhe jonevojtar për të tjerët...



Sipas transmetimit të Hazretit Aishe radijallahu anha, një grua nga Ensarët që erdhi për ta vizituar, por kur pa se shtrati i të Dërguarit të Allahut përbëhej prej një shilteje të palosur, shkoi në shtëpinë e vet duke vrapuar dhe solli një shtrat të mbushur me lesh. Hazreti Pejgamber sallallahu alejhi ue sellem, pasi vuri re se i qe ndërruar shtrati, pa dhënë kurrfarë shenje që ish gëzuar nga kjo gjë, i tha Hazretit Aishe:



*“O Aishe! Jepja përsëri këtë shtrat. Betohem në Allahun se po të doja, Allahu do t’i bënte të ecin me mua dhe t’i nënshtronte ndaj urdhërimit tim edhe malet prej floriri e argjendi.”* (Ahmed, Kitabu’z-Zuhd, fq. 30)



Abdullah bin Mes’ud radijallahu anhu thotë:

I Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem ishte shtrirë dhe kish fjetur mbi një hasër. Kur i Nderuari ynë u zgjua, hasra kishte lënë gjurmë në anën e trupit. Ne i thamë:

“O i Dërguari i Allahut! Sikur të marrim një shtrat për Ty?!” I Dërguari i Nderuar tha:

*“Çfarë lidhjeje kam unë me këtë botë? Unë në këtë botë jam si një kalorës që pushon në hijen e një peme, pastaj e lë atë vend dhe ikën.”* (Tirmidhi, Zuhd, 44/2377)



Ebu Hurejra radijallahu anhu takoi një grup që kishte vënë përpara mish deleje të skuqur. Ata e ftuan Ebu Bekrin, por ai nuk pranoi të hante. Tha:

“I Dërguari i Allahut iku nga kjo botë pa u ngopur as me bukë elbi!” (Buhari, Et’ime, 23)



Një ditë Sehl bin Sa’d radijallahu anhu tha:

“Që nga çasti që është dërguar si profet, derisa ndërroi jetë, i Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem nuk ka parë kurrë miell të situr në sitë.” Atë e pyetën:

“A përdornit sitë në kohën e të Dërguarit të Allahut?”. Sehli tha:

“Që kur është dërguar si peygamber e derisa ndërroi jetë, i Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem nuk ka parë sitë.”. Sehl bin Sa’dit i thanë:

“Po si e hanit miellin e elbit, të pasitur?”



“Ne e bluanim elbin dhe e hidhnim. Himet që iknin, iknin. Atë që mbetej e lagnim me ujë dhe e bënim brumë.” (Buhari, Et’ime, 23)



Enesi radijallahu anhu tregon:

“Pejgamberit tonë të Nderuar i sollën mall nga Bahrejni. I Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem tha:

*-Silleni në xhami dhe mbliidheni! Ky mall ishte malli më i madh që i ishte sjellë të Dërguarit të Allahut (deri atë ditë). I Nderuari ynë alejhis-salatu uesselam shkoi në namaz dhe nuk e pa mallin fare. Kur mbaroi namazi, erdhi te malli. Çdokujt që shikonte i jepte... I Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem nuk iku nga aty pa e ndarë të tërin, derisa nuk ngeli edhe një dirhem për Të.”* (Buhari, Slat 42, Xhizje 4, Xhihad 172)



I Nderuari i Botrave, duke i qortuar pikërisht me ajetet e Kur’anit Fisnik gratë e tij të cilat anonin nga bukuritë e kësaj bote, kërkoi nga ato që të zgjedhnin ose bukurinë e jetës së kësaj bote, ose Allahun, të Dërguarin e Tij dhe ahiretin. Pas kësaj ai qëndroi larg tyre një muaj. Në lidhje me këtë ngjarje që përkujtohet me emrin “Ila”, zbritën këto ajete fisnike:

“O Pegamber, thuaju bashkëshorteve të tua: “Në qoftë se dëshironi jetën e kësaj bote dhe stolitë e saj, atëherë ejani t’ju jap kundërvlerën e divorcit dhe t’ju divorcoj ashtu si duhet. Në qoftë se doni Allahun, të Dërguarin e Tij dhe botën tjetër, atëherë të jini të sigurt se Allahu ka përgatitur shpërblim të madh për ato që bëjnë punë të mira prej jush.” (el-Ahzab, 28-29)

Pastaj, i Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem i thirri ato, dhe duke filluar nga Hazreti Aishe, tha:

*“Unë do të të them diçka. Mos u nxito për tu përgjigjur! Më jep përgjigje pasi të këshillohesh me prindërit e tu.”*

Nëna jonë Aisheja e pyeti:

“Çfarë është ajo gjë, o i Dërguari i Allahut?”



I Nderuari ynë lexoi ajetin që zbriti. Kur e dëgjoi ajetin, nëna jonë Aisheja u përgjigj menjëherë:

“Domethënë duhet të këshillohem me familjen time në lidhje me çështjen për të të zgjedhur Ty? Kurrë! Unë dua Allahun, të Dërguarin e Tij dhe botën tjetër.”

Edhe nënat e tjera tona u sollën në të njëjtën mënyrë. (Muslim, Talak, 29)

Seuban radijallahu anhu, që ishte robi të cilin i Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem e kish liruar, tregon:

Kur i Dërguari i Allahut do të dilte në udhëtim, e fundit mes të gjithë pjesëtarëve të familjes që Ai përshëndeste, ishte e bija Fatime radijallahu anha. Kur kthehej, njeriu i parë që shkonte të takonte ishte përsëri Fatimeja. Njëherë i Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem sapo ishte kthyer nga një udhëtim. Fatimeja kishte varur mbi derë një perde dhe për më tepër u kishte vënë nga një byzlyk argjendi fëmijëve të saj Hasanit dhe Husejnit. Pejgamberi ynë i Nderuar shkoi te shtëpia e Fatimes, por nuk hyri brenda. Fatimeja e kuptoi se shkak u që i Dërguari i Allahut nuk hyri brenda ish in ata që pa. Menjëherë e hoqi perden dhe ua nxori byzylët nga dora fëmijëve. Njërin prej këtyre ua dha dy fëmijëve. Hasani dhe Husejni shkuan te i Dërguari i Allahut duke qarë. I Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem i mori këto byzlykë dhe tha:

*“O Seuban! Këto jepja filan familjeje. Hasani dhe Husejni janë nga Ehli Bejt. Nuk dua që bukuritë që do t’u japë Allahu t’i mbarojnë në jetën e kësaj bote. O Seuban! Blej për fëmijët dy byzlykë prej kocke dhe një gjerdan të bërë prej kocke për Fatimen!”* (Ebu Davud, Terexhxhul, 21/4213)

I Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem, me qëllim që Ehli Bejt të ishin shembull për ummetin, i nxiste të jetonin modestisht, të çiltër dhe jo si nevojtarë të kësaj bote.



Po ecja bashkë me Profetin sallallahu alejhi ue sellem në vendin e quajtur Harra, të Medines. Në atë çast pamë malin e Uhudit. I Dërguari i Allahut më tha:

*“O Ebu Dherr!”*. Unë thashë:

“Urdhëro o i Dërguari i Allahut! Nën urdhërin tënd.” I Nderuari ynë tha:

*“Sikur të kem flori sa mali i Uhudit, kjo nuk të gëzon ty. Për të paguar një borxh, përveç asaj që ndaj nuk dua të më kalojnë tri ditë duke pasur një dinar. I Dërguari i Allahut. Atë që kam dua tua ndaj robërve të Allahut.”*

Pastaj vazhdoi rrugën dhe tha:

*“Ata që kanë shumë pasuri në këtë botë, në ahiret do të kenë pak sevape. Përveç atyre që japin djathtas, majtas dhe prapa kështu, kështu, por sa pak janë edhe ata.”* (Buhari, Istikradh 3, Rikak 14; Muslim, Zekat 32)



Një ditë, një burrë erdhi te i Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem dhe i tha:

“O i Dërguari i Allahut! Më këshillo një vepër të atillë, sa kur ta kryej të më dojë edhe Allahu edhe njerëzit.”

I Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem i tha:

*“Ji asket ndaj kësaj bote dhe mos i jep vlerë, ashtu që të të dojë Allahu. Ji asket ndaj gjërave që kanë njerëzit, mos i duaj ato gjëra ashtu që të të duan edhe njerëzit.”* (Ibn Maxhe, Zuhd, 1)



Një ditë, i Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem shkoi në treg. Pranë tij ishin edhe ashabët. I Dërguari i Allahut pa një kec të vogël të ngordhur. E kapi për veshi dhe tha:

*“Kush prej jush dëshiron ta blejë këtë një dirhem?”*

Ashabët thanë:



“Edhe sikur të jetë edhe më lirë, nuk e marrim. Çfarë të bëjmë me atë?”

Pastaj i Dërguari i Nderuar pyeti:

“A do ta donit sikur t’u jepej falas?”

Ata u përgjigjën:

“Betohemi në Allahu se, edhe po të jetë i gjallë, ai është i mangët. Çfarë të bëjmë me të kur është i ngordhur?”

Në lidhje me këtë i Nderuari i Botës tha:

“Betohem në Allahun se kjo botë ka te Allahu më pak vlerë se ky kec i ngordhur.” (Muslim, Zuhd, 2)



Sipas transmetimit të Amr bin Auf radijallahu anhu, i Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem e kish dërguar Ebu Ubejde bin Xherrahin në Bahrejn për të mbledhur haraçin. Ensarët morën vesh se Ebu Ubejde qe kthyer dhe u mblodhën për të falur namazin e mëngjesit me të Dërguarin e Allahut. Kur i Nderuari ynë e fali namazin dhe u ngrit për të ikur, Ensarët u afruan te i Dërguari i Allahut. Kur i Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem i pa në atë gjendje, buzëqeshi dhe tha:

“Besoj se e keni dëgjuar se Ebu Ubejde ka sjellë mall nga Behrejni?”

Ensarët e përgjigjën:

“Po o i Dërguari i Allahut!”

Pejgamberi ynë i Nderuar tha:

“Gëzohuni dhe shpresoni gjëra që ju gëzojnë. Betohem në Allahun se unë nuk frikësohem për ju për varfëri, por unë kam frikë se ju hapet kjo botë siç u është hapur atyre para jush, se do të garoni për këtë botë siç garuan edhe ata për këtë botë, dhe se do t’ju shkatërrojë ashtu siç shkatërroi ata që ishin para jush.” (Buhari, Rikak, 7; Muslim, Zuhd, 6)



Sa mësimdhënës është edhe ky shembull që tregon se lënia e ahiretit në plan të dytë, duke anur nga kjo botë, përbën rrezikun më të madh:

Në kohën e Emevive, ushtria Islame e komanduar nga Abdurrahmani, i biri i Halid bin Velid, doli në rrugë me shpresë që të fitonte përgëzimin dhe lavdërimin e të Dërguarit të Allahut në lidhje me çlirimin e Stambollit. Në këtë ushtri gjendej edhe Ebu Ejjub el-Ensari radijallahu anhu. Kur Romakët u kishin vënë shpinën mureve dhe po luftonin, njëri prej Ensarëve hyri me kalin deri në mes të Bizantinëve. Nisur nga ajeti fisnik **“Mos e hidhni veten në rrezik me duart e juaja!”**, ata thanë të habitur:

“La ilahe illallah! Pa shikojeni këtë! Po e hedh veten në rrezik me dorën e tij! Mbi këtë, Ebu Ejjub el-Ensari tha:

“O besimtarë! (Mos u keqkuptoni!) ky ajet ka zbritur për ne Ensarët. Kur Allahu e ndihmoi Pejgamberin e tij dhe e bëri fenë Islame fituese, ne patëm thënë: Tashmë të qëndrojmë në krye të pasurisë sonë dhe të përpiqemi ta rregullojmë. Në lidhje me këtë, Allahu Teala i shpalli këtë ajet të Dërguarit të Tij:

**Jepni në rrugë të Allahut dhe mos e hidhni veten tuaj në rrezik me duart tuaja dhe bëni mirë, se Allahu i do të mirët.** (el-Bakara, 195) Qëllimi i ajetit fisnik **“Mos e hidhni veten në rrezik me duart e juaja!”**, ka kuptimin që të mos e anashkalojmë dhe të mos e lëmë përpjekjen në rrugën e Zotit duke u marrë me pasurinë e kësaj bote, si vreshta, kopshtije etj.”

Hazreti Ebu Ejjub el-Ensari i cili i vuri veshin dhe e ndoqi me një sinqeritet të madh këtë qortim hyjnor, duke mos e lavdëruar kurrë bukurinë dhe rehatinë e kësaj bote, ka shërbyer në rrugë të Allahut dhe së fundi është varrosur (në lagjen që sot përkujtohet me emrin e tij Ejjub) pranë mureve, si dëshmor i luftës ku mori pjesë. (Shik. Ebu Davud, Xhihad, 22/2512; Tirmidhi, Tefsir, 2/2972)



Shtëpia e të Dërguarit të Allahut ishte shumë e thjeshtë. Hazreti Hasan Basri, i cili e ka kaluar fëmijërinë e tij afër shtëpisë së të



Dërguarit të Allahut, për shkak se nëna e tij ishte shërbëtorja e nënës sonë Ummu Selemes, tregon se kur ishte i vogël mund ta prekte tavandin e dhomave të Pejgamberit tonë të Nderuar.<sup>81</sup> Nisur nga kjo, mund të themi se tavani i dhomave nuk ishte shumë i lartë, ndërsa dyert e dhomave të të Nderuarit tonë ishin prej cope të bërë me lesh të zi.<sup>82</sup>

Said bin Musejeb, që ishte nga imamët e mëdhenjt të Tabiinëve, e shpreh kështu keqardhjen e tij për këta dhoma të cilat u shkatërruan në kohën e Emevive ngaqë Xhamia e Profetit qe zgjeruar:

“Për Zotin, do doja shumë ato të liheshin ashtu siç ishin! Kësisoj, brezi i ri që po rritet dhe njerëzit që vijnë për t’i vizituar këto vende, do të mund të shihnin se me çfarë është mjaftuar i Dërguari i Allahut në jetë, gjë që do të ndikonte që ata të mos i jepnin vlerë shtimit të pasurisë dhe mburrjes me të.” (Ibn Sa’d, I, 499-500)

Pejgamberi ynë i Nderuar sallallahu alejhi ue sellem ka jetuar në dhoma të këtilla jo për shkak të varfërisë, po për shkak se nuk i jep-te vlerë kësaj bote as edhe një grimë. Sikur pjesën që i takonte nga mallrat e luftës ta mbante për vete dhe të mos e shpërndante, ai do të kishte shumë mundësi të bënte saraje dhe shtëpi të mëdha e të bukura. Por Ai, me dëshirën e Tij pëlqente një jetë të varfër dhe asketike e nuk qetësohej pa i shpërndarë edhe pjesët që i takonin nga plaçkat e luftës, sepse te Ai shfaqej ekspozimi i plotë i atributit “Rrahman” i Allahut.



Sulejmani alejhisselam e quante veten të varfër për shkak se i nxori nga zemra pasurinë dhe dashurinë e pushtetit. Kur u ngrit në mëngjes, shkoi te disa të varfër dhe të mjerë dhe u ul pranë tyre me një modesti të madhe:

*“I varfëri shkon te të varfërit.”*



Sipas një transmetimi, Hazretin Nuh alejhisselam e pyetën në ko-

81. Ibn Sa’d, VII, 161; Suhejli, I, 248.

82. Ibn Sa’d, I, 499.





hën kur i qe afruar vdekja:

“O Pejgamber jetëgjatë! Si t’u duk kjo botë?”

Nuhu alejhisselam u përgjigj:

*“Ajo është si një shtëpi me dy dyer. Hyra nga njëra derë dhe dola nga dera tjetër.”* (Ibn Esir, el-Kamil, I, 73)

Hazreti Nuh alejhisselam, kishte bërë për vete një kasolle prej kallamash. I thanë:

“Sikur të kishe bërë për vete një shtëpi më të fortë se kjo.”

Ai tha:

*“Edhe kjo është shumë për një që do të vdesë!”* (Ebu Nuajm, Hilje, VIII, 145)



Xhabir bin Abdullah radijallahu anhu tregon:

Duke vënë si komandantin tonë Ebu Ubejden radijallahu anhu, i Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem na dërgoi t’u dilnim përpara karvanit të Kurejshëve. Për ushqim na dha një torbë të vogël me hurma. Ai nuk kishte arritur të gjente diçka tjetër për të na dhënë. Ebu Ubejde na i jepte hurmat një nga një. Njëri prej atyre që ishin aty tha:

“Si mund të shtyjmë me ata hurma?”. Xhabiri tha:

“Ne i thithnin ato siç thith fëmija gjirin, pastaj pinim ujë me to dhe kjo na mjaftonte për tërë ditën, deri në mbrëmje. Shkundnim gjethe pemësh me shkopinj, i lagnim me ujë dhe i hanim.” (Muslim, Sajd, 17)

Ashabët e nderuar kurrë nuk ankoheshin edhe kur nuk kishin pa-suri aq sa ç’ishte e domosdoshme, por përpiqeshin dhe shërbenin në rrugë të Allahut.



Një ditë, Ebu Bekrit radijallahu anhu i kishin dhënë sherbet mjalti për të pirë, po kur e afroi sherbetin te goja, ai filloi të qajë. Edhe ata



që ndodheshin aty pranë nuk mundën t'i përmbanin lotët. Kur u pyet se përse qau, ai dha këtë përgjigje:

“Një herë isha me të Dërguarin e Allahut sallallahu alejhi ue sellem. Në atë çast pashë se ai sikur donte të largonte diçka, sepse thoshte: “Largohu nga unë, largohu nga unë!”, por unë nuk po dalloja ndonjë gjë. Kur e pyeta se çfarë ishte, i Nderuari unë më tha:

*M'u shfaq bota me të gjithë pasurinë e saj. I thashë që të largohet nga unë. Edhe ajo u largua, por tha kështu: Betohem në Allahun se edhe nëse ikën dhe shpëton nga unë, ata që do të vijnë pas Teje nuk do të mund të ikin!”*

Hazreti Ebu Bekr radijallahu anhu në vazhdim:

“Unë u tremba se mos po anoja nga dashuria e kësaj bote, dhe për këtë shkak qava.” (Ebu Nuajm, Hilje, I, 30-31)

Gjatë kohës së hilafetit të tij, Hazreti Ebu Bekri radijallahu anhu ka bërë një jetë shumë të thjeshtë. Madje, teksa ishte shtrirë në shtratin e vdekjes, porositi të shitej një pjesë e tokës së tij, që të paguheshin paratë që kishte marrë nga banka e shtetit si rrogë gjatë periudhës së hilafetit. (Ibn Esir, el-Kamil, II, 428-429)



Kur Ebu Bekri radijallahu anhu ishte duke dhënë shpirt, ai porositi vajzën e tij, Hazretin Aishe që devenë nga e cila kanë pirë qumësht, enën në të cilën kishte lyer rroba, si dhe rrobën kadife që e mbante veshur t'ia dorëzonte Hazretit Omer. Si justifikim tha se kishte përfituar nga këto kur udhëhiqte punët e myslimanëve. Edhe nëna jonë Aisheja, pas vdekjes së babai të saj ia dorëzoi ato halifes së ri, Hazretit Omer. Omeri radijallahu anhu, pasi mori këto gjëra, tha:

“O Ebu Bekr! Mëshira e Allahut qoftë mbi ty! Ata që vijnë pas teje i ke lënë në një gjendje të vështirë!” (Ahmed, ez-Zuhd, fq. 110-111; Sujuti, Tarihu'l-Hulefa, Egjipt 1969, fq. 78-79)



Sirija, Palestina, Egjipti ishin çliruar dhe të gjitha tokat e Iranit ishin brenda kufinjve të shtetit Islam. Thesaret e pasura të Bizantinëve dhe të Iranianëve filluan të rrjedhin në Medinetu'l-Munevera, e cila ishte qendra e botës Islame. Gëzimi i besimtarëve u rrit, por halifeja e besimtarëve Hazreti Omer radijallahu anhu, në kulmin e një zemre që s'kishte nevojë për këtë shkallë gëzimi, mbante hytbe me rroba të grisura, ndonëse ishte kryetari i një shteti të përkryer dhe kishte një thesar të pasur shteti. Nganjëherë hynte në borxh dhe e kalonte jetën në vështirësi, sepse nga ai thesar pranonte të merrte vetëm një pjesë, sa për të blerë rroba.

Paria e sahabëve nuk mundën ta pranonin më këtë gjendje të tij. Menduan t'ia rrisnin rrogën Halifes, por për shkak se kishin frikë t'ia propozonin këtë, shkuan te vajza e Hazretit Omer, Hazreti Hafsa radijallahu anha e cila në të njëjtën kohë ishte bashkëshortja e të Dërguarit të Allahut. Pa ia treguar fare emrat e tyre, i kërkuan që ajo t'ia shfaqte babait të saj këtë propozim. Hafsa radijallahu anha ia tregoi babait të saj propozimin e sahabëve. Hazreti Omer radijallahu anhu i cili kishte parë ditë<sup>83</sup> gjatë të cilave i Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem nuk gjente dot as edhe një hurmë për të ngrënë dhe qëndronte i uritur gjatë gjithë ditës, e pyeti vajzën e tij Hafsën:

“Bija ime! Si ishte i Dërguari i Allahut në të ngrënë e në të pirë dhe veshje?”. Kur mori përgjigjen: “Rroba ishte vetëm aq sa i mjaftonte.” Hazreti Omer vazhdoi:

“Ata dy miq (Hazreti Pejgamber dhe Ebu Bekri) dhe unë, u ngjajmë tre udhëtarëve që ecin në të njëjtën rrugë. I pari ynë (Hazreti Pejgamber) shkoi te vendi i tij. Tjetri (Ebu Bekr) arriti tek i pari, duke shkuar në të njëjtën rrugë. Edhe unë si udhëtar i tretë, dua të shkoj te shokët e mi. Nëse shkoj me shumë ngarkesë, nuk mund t'i zë ata! Apo ti nuk do që unë të jem i tretë i kësaj rruge?”<sup>84</sup>

Ebu Dherr el-Gifarit, i cili bënte jetë të thjeshtë e modeste dhe të qëndronte larg nga stolitë e kësaj bote, i dhanë katër mijë dinar nga

83. Shik. Muslim, Zuht, 36.

84. Shik. Ahmed, Zuht, fq. 125; Shehbenderzade Ahmed Hilmi, Tarihu'l-Islam, I, 367.

thesari i shtetit. Ai përdori pak prej tyre, ndërsa shumicën ua shpërndau të varfërve. (Ebu Nuajm, Hilje, I, 163)

Ky sahabi i cili thoshte se ai që ka dy dirhem do të nxirret para një llogarie më të rëndë derisa të ketë vetëm një, ia ktheu prapa treqind dinarë që ia pati dërguar përfaqësuesi i Shamit, me fjalët:

*“A nuk ka gjetur përfaqësuesi njerëz më të varfër se ne? Ne kemi vend për të futur kokën, kemi dele për të përfituar nga ata dhe kemi një shërbëtor që na shërben. Unë kam frikë të kem më shumë se kaq.”*  
(Ahmed, Zuhd, fq. 147)



Edhe në periudhën që pasoi ashabët e nderuar, botën e kishte kapluar një emocion aq i madh besimi, sa që ushtria prej pesëmijë vetësh e Tarik bin Zijadit arriti ta shkatërronte ushtrinë e Spanjës prej nëntëdhjetë mijë vetësh. Tariku kishte vënë këmbën mbi thesaret e mbretit dhe thoshte me vete:

“Tarik! Dje ishe një rob me hallkë në qafë, erdhi një ditë që Allahu të nderoi. Pastaj u bërë komandant! Sot ke çliruar Edulusin (Spanjën) dhe je në sarajën e mbretit. Dije mirë dhe kurrë mos e harro se nesër do të dalësh përpara Allahut!”

Ç’është kjo edukatë që ia ndërton personalitetin një robi dhe e shpie atë në kulmin e mirësisë!.. Zembrën nuk e lë që të anojë nga kjo botë as edhe sa një grimcë, por e bën të jetojë gjithmonë në klimën e kërkimit të llogarisë ndaj vetvetes...



Hazreti Muhammed Parisa, i cili ishte nga miqtë e mëdhenj që kishte edukuar Hazreti Shah Nakshibendi, kur po shkonte në haxh, takoi në rrugën e qytetit të Bagdadit një argjendar, një djalosh me fytyrë të ndritur. Ai u mërzi ngaqë mendoj se duke duke u shitur klientëve pa pushuar, djaloshi e kalon kohën duke iu përkushtuar kësaj bote. Tha me vete:

“Turp! Ia ka dhënë veten punëve të kësaj bote, në një kohë kur



dyhet të përkushtohet plotësisht për të bërë adhurim!”. Kur kontrolloi një çast, pa me habi se zemra e djaloshit që shiste florinj ishte bashkë me Zotin.

Këtë radhë e pëlqeu djaloshin dhe tha:

“Mashallah! Dora në fitim, zemra te i dashuri!..

Sepse gjendja “Vetëm në popull”, do të thotë që edhe kur të jesh me njerëzit, të jesh me Allahun, të rrish vetëm me atë dhe të jetosh vetminë në shumë njerëz.

Kur Hazreti Muhammed Parisa arriti edhe në Hixhaz, ai u takua me një të moshuar mjekërbardhë, i cili kishte kapur mbulesën e Qabes dhe po qante me gjithë zemër. Në fillim, duke parë pamjen e jashtme të të moshuarit dhe përgjërimin që i bënte Allahut, tha:

“Ah sikur edhe unë t’i lutesha Allahut duke qarë kështu.”. Kësisoj, atë e kaploi dëshira për ta pasur edhe vetë atë gjendje.

Por pastaj, kur i pa zemrën, e kuptoi se e gjithë kjo lutje dhe kjo e qarë ishte për një pasuri të përkohëshme. Atëherë zemra e tij e butë u mërzi shumë.

Siç kuptohet edhe nga tregimi, të jesh asket ndaj kësaj bote nuk ka të bëjë vetëm me varfërinë, por është një sjellje shpirtërore që duhet të jetohet në çdo çast. E rëndësishme është që të vazhdojmë me punët e kësaj bote, por duke mos duke mos qenë të pakujdesshëm me ahiretin.



Sa e shkëlqyer është kjo gjendje e mikut të Zotit, Hazretit Mevlana, i cili për shkak të dashurisë që ndjente për Pejgamberin tonë të Nderuar, e kishte pasqyruar në jetën e vet jetën askete të Tij:

“Kur vinte në shtëpi dhe pyeste “Çfarë ka sot në shtëpi?” e merrte përgjigjen “Nuk ka asgjë!”, gëzohej e thoshte: “Falenderimi i takon Allahut, sepse sot shtëpia jonë i ngjan shtëpisë së Pejgamberit sallallahu alejhi ue sellem! Ashtu siç nuk pranonte në mënyrë të prerë dhuratë apo lëmoshë, Hazreti Mevlana i ndalonte edhe nxënësit e tij



nga kjo, duke i nxitur që të punonin.”<sup>85</sup>

Një natë, Hazreti Malik bin Dinar kishte parë në ëndërr Refin, i cili ishte prej miqve të Allahut. Ai po vraponte duke qenë lakuriq kokë e këmbë. E pyeti:

“Ku po shkon?”

Refi tha:

“Elhamdulillah, shpëtova nga burgu.”

Në mëngjes, Hazreti Malik menjëherë shkoi te shtëpia e Refit. Pa se Refi kishte vdekur.

Pejgamberi ynë i Nderuar ka thënë:

“*Kjo botë është burgu i besimtarit dhe xhenneti i qafirrit.*” (Muslim, Zuhd, 1)



Sulltani Murad Hani II shkoi në Manisa, duke hequr dorë nga salltanati. Për të treguar se këtë e kish bërë vetëm për hir të Allahut, ai thoshte këto vargje:

*Të shkojmë nja dy ditë, Zotin të përkujtojmë,  
Se nuk na është falur kjo botë e gënjeshtërt...*



Edhe njëri nga ushtarët shpirtërorë që kishin një sjellje askete ndaj pasurisë dhe pozitës, i cili i pranonte mirësitë e kësaj bote për t’u shërbyer robërve të Zotit dhe jo për të kënaqur veten e tij, ishte Javuz Sulltan Selim Hani. Një ditë, sulltani i lartë u tha atyre që ishin nën urdhërat e tij:

“Nëse dëshira juaj është që të vazhdoni me kundërshtime, më thoni që të heq dorë menjëherë nga shteti. Unë e kam marrë këtë salltanat nga dora e babait tim vetëm për t’i shërbyer Islamit dhe i kam flijuar vëllezërit dhe nipërit e mi për rregullimin e kësaj bote. Iu kërkova



besën dhe ju ma dhatë. Unë mundohem të forcoj fenë e vërtetë duke hequr dorë nga gjumi, rehatia dhe qetësia ime. Në qoftëse nuk keni për qëllim të forconi Islamin, edhe unë kurrë nuk e dua salltanatin.”

Së fundi, njeriu duhet t'i drejtohet Allahut dhe të kërkojë kënaqësinë e Atij që është Krijuesi i gjithçkaje. Kur dashuria e zemrës i dorëzohet Allahut, tek njeriu shfaqet përkorësia. Kur shfaqet përkorësia, pasurisë dhe pronës i bie vlera, por mbeten si diçka që duhen shfrytëzuar për të fituar kënaqësinë e Allahut, domethënë fitojnë vlerë duke u shpenzuar në rrugë të Tij.

Kështu që vendoset në formën e vërtetë që duhet të jetë, sepse zemra tashmë e ushqen dashurinë që ka për Allahun me keutherin e punëve të mira, puna që ai do, kënaqin shpirtin e tij.

## 15. Durimi dhe vendosmëria

Durim do të thotë të mos e prishësh ekuilibrin kundrejt situatave materiale dhe shpirtërore të cilat ndryshojnë, të mbrosh normalen, të durosh kundrejt dëshirave të mëdha, të durosh dhimbjet, të sillesh gjakftohtë ndaj vështirësive dhe vuajtjeve, ndërsa ndjenjat njerëzore t'i mbash brenda kufinjve që ka vendosur mendja dhe feja.

Vendosmëri do të thotë qëndrueshmëri, përforcim, qëndresë dhe përballim.

Durimi është qendra kryesore e moralit të bukur, gjysma e besimit dhe çelësi i gëzimit dhe i lumturisë. Është një virtyt i madh që të shpie në xhennet. Durimi është heshtja pa e prishur ekuilibrin përballë ngjarjeve të papëlqyeshme që të japin dhimbje, dhe t'i dorëzohesh Allahut.

Edhe në çështjen e durimit, Profetët dhe miqtë e Allahut kanë shfaqur shembuj të paarritshëm dhe kanë fituar ndihmën e Allahut. Për këtë arsye, ata duhet të jenë shembuj tanë në çështjen e durimit.

Durimi në këtë botë të jep dhimbje, ndërsa në ahiret është dritë. Ata që i ndjejnë dhimbjet e durimit në zemër fitojnë kënaqësinë e



Allahut dhe xhennetin, i cili është vendi i amëshueshmërisë.

Të mendosh në çdo kohë mirësinë, urtësinë dhe shpërblimin hyjnor sipas urdhërave dhe ndalesave të Allahut, lehtëson durimin.

Kushti i parë i durimit është që ai të shfaqet sapo njeriu të përballlet me ngjarjet që e bëjnë atë të nevojshëm. Durimi që nuk bëhet në kohën e tij, nuk ka shumë shpërblim.

Durimi ka një pozitë shumë të madhe në fenë tonë, për shkak se i përfshin të gjitha bukuritë e moralit. Në Kur'anin Fisnik flitet për durimin më shumë se në shtatëdhjetë vende. Në ajetet fisnike, si dhe në tërë personalitetin e Hazretit Pejgamber sallallahu alejhi ue sellem Tij, të gjithë ummetit i këshillohet durim:

**“O ju që keni besuar, kërkoni ndihmë me durim dhe namaz nga Allahu!..”** (el-Bakara, 153)

**“O ju besimtarë, bëni durim, bëhuni të qëndrueshëm kundër armikut, rrini të përgatitur dhe kini frikë nga Allahu ashtu që të bëheni të suksesshëm.”** (Ali Imran, 200)

Në komentin që i bën këtij ajeti, Elmallë Muhammed Hamdi Jazar, na jep këtë sqarim:

“Një nga emrat më të nderuar të Zotit është edhe emri **“es-Sabur”**. Kush ka durim, do të thotë se te ai ka një shfaqje të fuqisë së Allahut. Veçanërisht, nëse këta njerëz durimtarë mbledhen dhe formojnë një grup, në çdo situatë fitojnë ndihmën e Allahut. Allahu gjithmonë është miku dhe i dashuri i tyre.”<sup>86</sup>

Shpërblimet e mëdha gjithmonë vijnë pas durimeve të mëdha dhe pas përballimit të fatkeqësive. Në ajetin fisnik thuhet:

**“Durimtarëve u jepet shpërblimi i pamasë!”** (ez-Zumer, 10)

Në një hadith fisnik që tregon llojet e durimit dhe mirësitë e tij, i Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem thotë:

*“Durimi është tri llojesh:*

*Durimi ndaj fatkeqësive, durimi për të bërë adhurim dhe durimi*





*për të mos bërë mëkat...*” (Sujuti, II, 42; Dejlami, II, 416)

I Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem ka lajmëruar se Allahu Teala ka thënë:

*“Shpërblimi i një robit Tim, i cili në këtë botë merr atë që do dhe duron duke pritur shpërblimin nga Allahu, është xhenneti.”* (Buhari, Rikak, 6)

*“Nëse robi Im duron kur ta sprovtoj duke ia verbuar të dy sytë, si shpërblim të syve i jap xhennetin.”* (Buhari, Merda, 7; Tirmidhi, Zuhd, 58)

Durimi është një nga disiplinat më të rëndësishme të fesë sonë. Sprova e durimit është nga sprovat më të vështira. Për këtë arsye, Hazreti Ebu Bekr ka thënë:

*“Nisur nga kjo, është më e lehtë të jem mirë dhe të falenderoj, se sa të sprovohem dhe të duroj.”*

### *Tabllo të virtytshme*

Nga fillimi deri në fund, jeta e të Dërguarit të Allahut është e mbushur me shembujt më të bukur të durimit. I Nderuari ynë sallallahu alejhi ue sellem, që nga fëmijëria e derisa ndërroi jetë, është përballur gjithmonë me dhimbje të mëdha dhe ka jetuar çdo lloj vuajtje dhe brengje. Kur ai ende nuk kishte lindur akoma, përcolli te Allahu babain e Tij, në moshën gjashtëvjeçare nënën e Tij, në moshën tetëvjeçare gjyshin e tij, në vitin e dhjetë të profetësisë Ebu Talibin, i cili e mbronte, ndërsa tri ditë pas kësaj ngjarje përcolli bashkëshorten e Tij të dashur, e cila i jepte mbështetjen më të madhe në mesazhin e Tij, Hazreti Hatixhen. Në Uhud varrosi të nderuarin e dëshmorëve Hazretin Hamza, gjatë jetës nga shtatë fëmijët e Tij varrosi gjashtë prej tyre bashkë më shumë nipër, disa në moshë të vogël dhe disa të rritur. Me duart e Tij varrosi shumë prej ashabëve që i donte shumë. U torturua, u fye, u shpif për Të, mbeti i uritur dhe i varfër. U plagos nëpër luftëra, vuajti nga sëmundjet djegëse. Por asnjëra nga këto nuk mundi tia prishte vendosmërinë dhe eikuliberin e Tij. Ai në çdo situatë ishte shembulli i durimit dhe nënshtrimit.



Sa njerëz ka që ia kanë dhënë tokës të gjashtë fëmijët me duart e tyre? Në gjirin e sa njerëzve fëmijët dhe nipërit e vegjël e dorëzonin shpirtin duke marrë frymë me vështirësi? A ka ndonjë njeri që ia kanë coptuar trupin e xhaxhait të tij dhe ia kanë ngrënë mushkëritë? Së fundi, a ka ndonjë, përveç të Dërguarit të Allahut sallallahu alejhi ue sellem, që është sprovuar me të gjitha llojet e dhimbjeve më të ashpra dhe që ka mbetur shembull i durimit në të gjitha prej tyre?



Në kohën e xhahilijetit, gjatë muajit të haxhit, i Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem transmetonte Islamin nëpër panaiuret që bëheshin dhe gjatë kësaj kohe vuante, brengosej dhe torturohej. Të gjitha i duronte dhe nuk ankohej. Një herë ftoi në Islam bijt e Amr bin Sa'saa, ashtu si dhe fiset e tjera. Ata e dëgjuan të Nderuarin tonë, i bënë disa pyetje, por nuk u bënë myslimanë. Befas, kur i Dërguari i Allahut u ngrit nga ata dhe hipi në deve, njëri nga mushrikët i cili quhej Bejhara, e shpoi me diçka devenë e Tij. Kur deveja u tërhuz dhe u ngrit përpjetë, e hodhi në tokë Krenarinë e Gjithësisë të Nderuarin tonë. Një grua myslimane, që quhej Dubaa bint Amir, kur fyerjen që iu bë të Dërguarit të Allahut, thirri me të madhe:

“O fisi i Amirit! A nuk ka ndonjë prej jush që ta mbrojë të Dërguarin e Allahut duke e parë poshtërimin që iu bë Atij?”. Tre nga djemtë e xhaxhait të saj brofën menjëherë dhe e hoqën zvarrë Bejharanë. Pas kësaj ngjarjeje, i Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem, duke shfaqur një shembull besnikërie u lut për ta:

“O Zoti im! Jepu bereqet këtyre!” Me bereqetin e kësaj lutjeje, Allahu Teala u dhuroi besimin atyre trimave dhe në fund fituan gradën e martirizimit. (Ibn Haxher, el-Isabe, IV, 353)



Tarik bin Abdullah el-Muharibi tregon një ngjarje në lidhje me vuajtjet që ka duruar i Dërguari i Allahut në rrugën e predikimit të Islamit, ngjarje të cilën e ka parë me sytë e tij:

“Të Dërguarin e Allahut sallallahu alejhi ue sellem e pashë në pa-



nairin Dhulmexhaz. Ai po fliste me zë të lartë:

*-O njerëz! Thoni la ilahe illallah dhe shpëtoni!* Një burrë e qëllonte me gurë dhe bërtiste me zë të madhe:

-O njerëz! Mos i besoni dhe mos iu bindni Atij, sepse ai është mashtrues! Prej gurëve me të cilët ai e qëllonte, të Nderuarit tonë iu bënë gjak kyçet e këmbës. Pyeta ata që ishin aty:

-Kush është ky njeri? Ata më thanë:

-Ky është një nga bijtë e Abdulmuttalibit.

Unë i pyeta:

-Po ai që i shkon nga pas dhe e gjuan me gurë, kush është?

Më thanë:

-Ai është xhaxhai i tij, Ebu Leheb.<sup>87</sup>

Një tjetër nga shembujt që tregon se i Dërguari i Allahut ishte monument i durimit, e rrëfen Mudrik el-Ezdi:

“Bashkë më babain tim, po kryeja haxhin (e xhahilijetit). Kur arriëm në Mina dhe bujtëm aty, u takuam me një grup njerëzish. Pyeta babain:

-Përse është mbledhur ky grup?

Babai më tha:

-Janë mbledhur për këtë njeri që ka lënë fenë e popullit të tij. Kur pashë në anën kah po tregonte ai, vura re të Dërguarin e Nderuar. Ai po thërriste:

*-O njerëz! Thoni la ilahe illallah dhe shpëtoni!*

Disa prej njerëzve e pështynin në fytyrë, disa i hidhnin dhé mbi kokë, ndërsa disa të tjerë e fyenin. Kjo gjendje vazhdoi deri në kohën e drekës. Në atë kohë erdhi një vajzë së cilës i ishte zbuluar qafa, që mbante në duar një enë me ujë dhe një mindil. Ajo qante. Krenaria e Gjithësisë i Nderuari ynë e mori enën, piu ujë dhe lau duart dhe fyty-

87. Derakutni, Sunen, Bejrut 1986, III, 44-45.



rën. Ngriti kokën dhe tha:

*-Bija ime, mbuloje qafën me shaminë tënde! Mos ki frikë për babain tënd se do të poshtërohet, do të vritet dhe do të lëndohet!*

Pyetëm se kush ishte kjo. Na thanë; Është vajza e tij Zejnebi!”  
(Hejsemi, VI, 21)



Abdullah bin Mes'ud radijallahu anhu tregon:

Kur i Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem po ndante ganimetet që ishin fituar në luftën e Hunejnit, disave u dha më shumë se të tjerëve. Akra bin Habisit i dha njëqind deve, edhe Ujejne bin Hinsit i dha po aq. Edhe atyre që ishin nga kryesoret e Arabëve u dha pak më shumë në ndarjen e asaj dite. Në lidhje me këtë, dikush tha:

“Për Zotin, nuk ka drejtësi në këtë ndarje dhe kënaqësia e Allahut nuk është marrë parasys!”

Edhe unë thashë:

“Betohem në Allahun se këtë do t’ia tregoj të Dërguarit të Allahut sallallahu alejhi ue sellem.” Shkova dhe ia tregova ato që tha ai.

Kur dëgjoji këtë, fytyra e bekuar e të Dërguarit të Allahut u bë e kuqe nga mërziya. Ai tha:

*“Nëse nuk sillet me drejtësi Allahu dhe i Dërguari i Tij, askush nuk sillet me drejtësi.”*

Pastaj vazhdoi:

*“Allahu e mëshiroftë Musain. Ai u sprovua me një provë më të rëndë se kjo, por duroi.”*

Pas kësaj, un vendosa që të mos i tregoj më të Dërguarit të Allahut sallallahu alejhi ue sellem fjalën e askujt. (Buhari, Edeb, 53; Muslim, Zekat, 145)



Pejgamber sallallahu alejhi ue sellem kaloi pranë një gruaje që po qante me kuje te varri i fëmijës së saj. Ai i tha asaj gruaje:

*“Ki frikë nga Allahu dhe duro!”*

Gruaja u përgjigj:

“Largohu dhe hiqmu qafe, sepse fatkeqësia që më ka ndodhur mua, nuk të ka ndodhur Ty!”

Gruaja nuk e njohu Hazretin Pejgamber sallallahu alejhi ue sellem. I thanë se është i Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem. Me ta marrë vesh këtë, gruaja shkoi turravrap të shtëpia e Pejgamberit tonë të Nderuar. Ngaqë aty nuk kishte ndonjë njeri mund që ta pengonte, ajo hyri drejt e në shtëpi dhe kërkoi ndjesë duke thënë:

“O i Dërguari i Allahut! Nuk ju njoha.”

I Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem e këshilloi gruan duke i thënë:

إِنَّمَا الصَّبْرُ عِنْدَ الصَّدْمَةِ الْأُولَى

*“Durimi i vërtetë është ai që tregohet në çastin e parë të fatkeqësisë!”* (Buhari, Xhenaiz, 32)



Abdullah bin Mes'ud radijallahu anhu tregon:

Shkova te i Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem. Ai ishte i sëmurë nga malarja. I thashë:

“O i Dërguari i Allahut! Me të vërtetë ti qenke sëmurë shumë nga malaria! Ai tha:

*“Po, kam një sëmundje që mund ta mbajnë dy vetë nga ju.”*

Unë i thashë:

“Ndoshta është që të fitosh dy herë më shumë sevap.”

Ai ma ktheu:



*“Po, ashtu është. Allahu bën shkak për t’ia falur mëkatet një myslimani nguljen e një gjëmbi në këmbë ose ndonjë fatkeqësi më të madhe. Mëkatet e atij myslimani bien siç bien gjethet e pemës.” (Buhari, Merda, 3, 13, 16; Muslim, Birr, 45)*



I Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem pyeti Xhebrailin alejhisselam:

*“Në çfare grade kishte arritur dhimbja që Jakubi kishte për Jusufin?”*

Xhebrail alejhisselam u përgjigj:

*“Sa dhimbja e shtatëdhjetë grave që kanë humbur fëmijën e tyre!”*

Krenaria e Gjithësisë i Nderuari ynë e pyeti:

*“Atëherë sa është sevapi i tij?”*

Ai tha:

*“Është sa sevapi i njëqind dëshmorëve, sepse Ai nuk mendonte keq për Allahun qoftë edhe një çast.” (Taberi, XIII, 61; Sujuti, ed-Durru’l-Mensur, IV, 570; Jusuf, 86)*

Ja ky durim ishte **“durimi i bukur”**.



Abdullah bin Mes’ud radijallahu anhu thotë:

Pejgamberi ynë i Nderuar rrëfeu për një pejgamber i cili ishte dërguar te populli i tij. Populli i tij e kishte rrahur dhe i kishte nxjerrë gjak në fytyrë. Ai pejgamber, në një rën anë fshinte gjakun në fytyrë dhe në anën tjetër thoshte:

*“O Zoti im, fale popullin tim, sepse ata nuk dinë.”* Akoma e kam përpara syve mënyrën se si e tregonte i Dërguari i Allahut situatën e këtij pejgamberi. (Buhari, Enbija, 54; Muslim, Xhihad, 104)



shpërblimi i durimit është xhenneti:

Një ditë, Abdullah bin Abbas radijallahu anhuma i tha Ata bin Ebi Rebah:

“A të tregoj një grua që është prej banorëve të xhennetit?” Kur i biri tha:

“Po, ma trego!”, Ibn Abbas vijoi:

“E shikon këtë grua të zezë! Ja kjo grua erdhi te Krenaria e Gjithësisë i Nderuari ynë dhe i tha:

-Unë jam e sëmurë me epilepsi dhe po më zbulohet trupi dhe koka. A mund ta lutni Allahun që të shërohem?

I Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem tha:

*-Nëse thua se do të duroj, si shpërblim ke për të pasur xhennetin, por po deshe, unë i lutem Allahut që të të shërojë.*

Mbi këtë gruaja tha:

-Unë e duroj sëmundjen, por i luteni që kur të më kapë epilepsia të mos më zbulohet trupi. I Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellemiu iu lut Allahut për këtë.” (Buhari, Merda, 6; Muslim, Birr, 54)

Ja vlera e lartë e durimit te Allahu ndaj sprovave që të ndodhin...



Ebu Said radijallahu anhu tregon:

“U ula me një grup nga të varfërit e Muhaxhirëve. Disa prej tyre (për shkak se nuk kishin rroba që ua mbulonte të tërë trupin) mundoheshin të mbuloheshin (duke përfitur nga hija e të tjerëve). Ndërkohë dikush po lexonte Kur’an. Në atë çast erdhi i Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem dhe u ndal pranë nesh. Ai që po lexonte Kur’an u ndal kur pa të Dërguarin e Allahut. I Dërguari i Allahut dha selam dhe na pyeti:

*-Çfarë po bëni?*

Ne i thamë:



-O i Dërguari i Allahut! Ai është hoxha i jonë dhe po na lexon Kur'an. Ndërsa ne po dëgjojmë librin e Allahut Teala.

Mbi këtë Krenaria e Gjithësisë sallallahu alejhi ue sellem tha:

*-Falenderoj Allahun që ka krijuar njerëz që janë urdhëruar të durojnë bashkë me mua!*<sup>88</sup>

Pastaj, duke e vënë veten në një gradë me ne, i Dërguari i Allahut u ul midis nesh. Duke bërë një shenjë me dorë, ai tha:

*-Ashtu (Bëni një rreth!)*

Grupi menjëherë u bënë rreth dhe të gjithë i kthyen fytyrat drejt Atij. Së fundi, i Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem na dha lëtë përgëzim:

*-Përgëzime o Muhaxhirë të varfër! Ju përgëzoj me një dritë të plotë në ditën e gjykimit. Ju do të hyni në xhennet një gjysëm dite para të pasurve. Kjo gjysëm dite (me ditët e kësaj bote) janë pesëqind vjet.*" (Ebu Davud, Ilim, 13/3666)



Ky është shpërblimi i të varfërve durimtarë...

Sa shembull i shkëlqyer është kjo ngjarje që transmeton Fedale bin Ubejd radijallahu anhu, e cila shfaq durimin dhe vendosmërinë legjendare të sahabëve të cilët ishin nxënësit e veçantë të të Dërguarit të Allahut, kundrejt varfërisë dhe vuajtjeve që jepnin ata:

"Kur i Dërguari i Allahut po u falte namazin ashabëve, disa prej tyre, duke mos pasur mundësi të mbaheshin në këmbë, u binte të fikët nga pafuqia që u shkaktonte uria. Këta ishin njerëzit e Suffes. Bedevitë të cilët vinin nga shkretëtira, thonin: Këta janë të çmendur!

88. Përmes këtyre fjalëve Pejgamberi ynë i Nderuar sqaron këtë ajet fisnik: "Përk - fizoje veten tënde me ata që lusin Zotin e tyre mëngjes e mbrëmje, e që kanë për qëllim kënaqësinë (razinë) e Tij dhe mos i shkëlput sytë prej tyre për të kërkuar bukurinë e kësaj bote dhe mos iu bind atij që ia kemi shmangur zemrën prej përkjimit ndaj Nesh dhe që i është dhënë epshit të vet, sepse puna e tij ka mbaruar!" ( el-Kehf, 28) Këtu Allahu Teala e ka urdhëruar të Dërguarin e Nderuar sallallahu alejhi ue sellem që t'i durojë problemet që do të ndodhin krahas të varfërve dhe të dobtëve të cilët kanë hyrë të parët në Islam dhe të tregohet shumë i ndjeshëm në trajtimin e tyre.





Kur i Dërguari i Allahut mbaronte namazin, shkonte te ata që u kishte rënë të fikët nga uria dhe i ngushëllonte duke i thënë:

*Sikur ta dini se çfarë ka përgatitur Allahu Teala për ju, do të donit të ishit edhe më të varfër e më nevojtarë.* (Tirmidhi, Zuhd, 39/2368)



Hazreti Ebu Hurejra ka thënë:

“Unë kam parë shtatëdhjetë vetë nga njerëzit e Suffes. Asnjëri prej tyre nuk kishte një rrobë që t’ia mbulonte të tërë trupin. Ose kishin një rrobë që vishej në bel dhe poshtë ose kishin një mbulesë që vishej në bel e sipër. Rrobat e tyre i lidhnin në qafë. Disave prej këtyre u arrinin deri te gjysma e pulpës dhe disave deri të thembëra e këmbës dhe i mblidhin rrobat e tyre me dore që të mos u dalloheshin pjesët e turpshme.” (Buhari, Salat, 58)

Siç e shohim, sahabët e ndershëm, duke përballuar me durim çdo vështërsi si, urinë, varfërinë, luftën dhe fatkeqësitë janë bërë shkas që Islami të arrijë deri në ditët tona. Edhe ne, duke ndjekur rrugën e tyre duhet që këtë amanet të shenjtë t’ua lëmë brezave që do të vijnë.



Abdurrahman bin Auf radijallahu anhu thotë:

“Islami kishte sjellë disa urdhëra që nuk i pëlqenin vetes. Por megjithatë, më të mirën e më të mirave ne e gjetëm në ato urdhëra të vështira që nuk i pëlqen vetja. Përshembull, u shpërngulëm nga Mekke bashkë të Dërguarin e Allahut sallallahu alejhi ue sellem. Neve na u dha epërsi dhe fitore (u hapën rrugët e fitores) me këtë shpërngulje, që vetes i dukej e vështirë në fillim. Ne dolëm në luftën e Bedrit bashkë me të Dërguarin e Allahut teala, dhe na u dha epërsi e fitore, gjithnjë duke iu përmbajtur asaj që përshkruajti Ai në Kur’anin Fisnik:

(Gjendja e atyre është) **Si ajo kur të nxori Zoti yt nga shtëpia jote për të vërtetën dhe një grup nga besimtarët nuk ishte i kënaqur. Debatojnë me Ty për të vërtetën pasi që e kishin të qartë sikur po shtyheshin në vdekje.** (el-Enfal, 5-6), ne dolëm në luftën e Bedrid bashkë me të Dërguarin e Allahut. Allahu Teala edhe këtu na



dha epërsi dhe fitore.

Së fundi, mirësitë më të mëdha ne i kemi arritur nëpërmjet zbatimit të këtyre urdhërave që gjithmonë i dukeshin të vështira vetes.” (Hejsemi, VII, 26-27)



Edhe këto fjalë simbolike të Muhammed Ikbalit tregojnë mirësinë e durimit dhe përballimit të vështirësive:

“Një sorkadhe po ua tregonte hallin e saj sorkadheve të tjera:

-Këtu e tutje do të jetoj në Qabe, në Harem. Aty do të qëndroj dhe aty do të kullos, sepse gjuetarët kanë bërë kurthe në lugina, ne natë-ditë lëvizim me lejen e gazelës. Tashmë dua të qetësohem nga vuajtjet që të shkaktojnë gjuetarët. Edhe zemra të më qetësohet!..

Një sorkadhe tjetër që po dëgjonte, tha:

-O e dashura ime! Nëse dëshiron të jetosh, jeto në rrezik. Mbrehe gjithmonë veten me gurë zmeril dhe jeto më e mprehur se shpata që e ka xhevahirin e pastër. Rreziku të vë në provë fuqinë dhe forcën. Ai na tregon se për çfarë është i aftë trupi dhe shpirti.”



Esenca e fjalës, durimi është një thesar i vlefshëm në zemrën e njeriut. Është mburoja më e fortë kundrejt belave dhe fatkeqësive. Është një veti e lartë, prej së cilës Allahu kënaqet dhe për të cilën ka premtuar shumë shpërblime të mëdha. I Dërguari i Allahut ka thënë:

“Durimi është dritë.” (Muslim, Taharet, 1) Në fund ai ia ndriçon njeriut këtë botë dhe ahiretin.

## 16. Hamdi dhe shukri (Falenderimi)

“**Hamd**” është lavdërimi i madhësisë së pafundme, i artit hyjnor dhe i shfaqjeve të attributeve të Zotit. “**Shukr**” është falenderimi dhe lavdërimi me gjuhë, me vepër, i dhuntive dhe favoreve të pafundme të Zotit.



Çdo lloj madhërimi i përket Allahut, edhe hamdi është vetëm e drejtë e Tij. Të lavdërosh të gjitha mirësitë e Allahut Teala përbën një nga detyrat e adhurimit të myslimanit. Kur lavdërimi është një borxh adhurimi, bëhet favor, mirësi e madhe dhe një shfaqje e mëshirës së pafund të Allahut, sepse Ai thotë se është i kënaqur nga robi që e lavdëron.<sup>89</sup>

Vetëm Allahu është ai që e meriton Hamdin. Në ajetin fisnik thuhet:

**“Falenderimi është vetëm për Allahun i cili krijoi qiejt dhe tokën, errësitat dhe dritën...”** (el-En`am, 1)

Allahu kërkon nga robërit e Tij që ta falenderojnë në çdo kohë. Në ajetet fisnike thuhet:

**“...Thuaj, falenderimi i takon Allahut!..”** (el-Isra, 111)

**“...Lutja e tyre aty është: “I lartë je o Allah!”, përhëndetja e tyre është: Selam!, dhe lutja e fundit e tyre: “Falënderimi i qoftë Allahut, Zotit të botrave!”** (Junus, 10)

Ajeti i parë i Fatihasë të cilin e lexojmë në çdo rekat të namazit, na sugjeron “hamdin”:

**“Falënderimi i takon Allahut , Zotit të botërave !”** Në fakt nuk është e mundur që të shpresohet mirësi në një punë apo një sjellje që fillon pa falenderuar Allahun. Në lidhje me këtë çështje, i Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem na ka tërhequr vëmendjen ne, si ummeti i Tij, duke thënë:

*“Çdo punë e rëndësishme që nuk fillon duke falenderuar Allahun, është pa begati.”* (Ebu Davud, Edeb, 18/4840)

Hamdi në të njëjtën kohë është një dhikër i rëndësishëm. Pejgamberi ynë i Nderuar e tregon kështu mirësinë e hamdit:

*“Pastërtia është gjysma e besimit. Lutja “Elhamdulillah” mbush me sevap peshoren, ndërsa fjalët “Subhanallahi ue'l-hamdulillahi” mbushin atë që është në mes qiejve dhe tokës. Namazi është dritë, sadakaja është argument, durimi është ndriçim. Kur’ani është argument pro teje ose kundër teje. Çdokush në mëngjes (del në treg) dhe e shet*

89. Muslim, Dhikr, 89.



*veten, dikush e lë të lirë dhe dikush e shkatërron.*” (Muslim, Taharet, 1; Tirmidhi, Deavat 85/3517)

Edhe shukri është një nga detyrat e rëndësishme si hamdi. Shukri është adhurimi i singertë i robit ndaj Zotit, me fjalë dhe sjellje të ndryshme, duke u gëzuar kundrejt mirësive dhe begative që Ai i ka dhënë. Kjo tregon se shukri është njohja e zotëruesit të vërtëte të mirësisë.

Për t’u bërë një rob që falenderon ashtu siç duhet, nuk mjafton vetëm të dish se mirësitë që të jepen janë nga Allahu dhe ta shprehësh këtë me gojë. Është e domosdoshme t’i kryejmë ashtu siç duhet bukuritë e adhurimeve dhe të sjelljeve ndaj Zotit tonë.

“Hamdi” dhe “shukri” që shfaqen si nevojë e natyrshme që njeriu të jetë “eshrafu’l-mahlukat” (më i nderuari i krijesave), pra ai që formon pikën më të lartë të zinxhirit hierarkik që nga krijesa më e lehtë deri te ajo më e përsosura, përbëjnë një nga çështjet më të thella dhe më të rëndësishme të fesë. I Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem ka thënë:

*“Shukri është gjysma e besimit...”* (Sujuti, I, 107)

Çdo njëri që e ka ruajtur fisnikërinë dhe bujarinë në natyrën e tij, ndjen në ndërgjegje një borxh falenderimi ndaj atij që i jep një gotë ujë. Kësisoj, është jashtë mendjes, jashtë bindjes dhe ndërgjegjes që njeriu të rrijë neglizhent dhe i zymtë ndaj Zotit të tij, i Cili është burimi dhe dhuruesi i të gjitha të mirave. Kjo gjendje është vetëm një shfaqje e e pandjeshmërisë dhe e varfërisë së mendimit.

Megjithatë, për fat të keq shumë njerëz janë neglizhentë kundrejt mirësive të panumërta që ua ka dhënë Allahu. Për shkak të kësaj neglizhence të thellë të njeriut, Zoti thotë:

**“...Robërit e Mi që falenderojnë, janë shumë pak.”** (Sebe, 13)

Gjendja e mosfalenderimit është një gjendje që Zoti nuk e pëlqen. Ajo bëhet shkak që të humbin mirësitë që na ka dhënë Allahu. Po ashtu, në ajetet fisnike Allahu thotë:

**“Më kujtoni Mua, Unë t’ju kujtoj juve. Më falënderoni dhe mos më mohoni!”** (el-Bakara, 152)



“...Nëse më falënderoni, do t’ua shtoj të mirat. Nëse më përbuzni, pa dyshim që dënimi Im është shumë i ashpër!” (Ibrahim, 7)

“...Kush falenderon, ka falenderuar për veten e tij. Kush refuzon(edhe ai e ka për vete), le ta dijë se Allahu nuk ka nevojë për asgjë. Ai e meriton çdo lloj falenderimi.” (Lukman, 12)

### *Tabllo të virtytshme*

Sa herë ngrihej nga sofa Pejgamberi ynë i Nderuar alejhissalatu uesselam thoshte:

*“O Zot! Të falenderojmë Ty me ndjenjat më të pastra që nuk pakësohen, por shtohen, me falenderimet e panumërta që nuk refuzohen por pranohen te Ti.”* (Buhari, Et’ime, 54; Ebu Davud, Et’ime, 52; Tirmidhi, Deavat, 55)



I Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem ka thënë:

*“Allahu Teala kënaqet nga rob i Tij që e falenderon pasi të hajë bukë, ose pasi të pijë diçka.”* (Muslim, Dhikr, 89; Tirmidhi, Et’ime, 18)



Njëherë, pranë të Dërguarit sallallahu alejhi ue sellem teshtinë dy vetë. I Nderuari ynë njërit prej tyre i tha “jerhamukallah”, ndërsa tjetrit nuk i tha. Personi të cilit Pejgamberi nuk i tha “jerhamukallah” pyeti:

“Filan person teshtiu dhe i thatë “jerhamukallah”. Po kur teshtiva, përse nuk më thatë?!” Pejgamberi ynë i Nderuar u përgjigj:

*“Ai person tha **elhamdulillah**, ndërsa ti nuk the.”* (Buhari, Edeb, 127; Muslim, Zuhd, 53)



Krenaria e Gjithësisë, i Nderuari ynë pa se Hazreti Omer kishte



veshur një këmishë. E pyeti:

“Kjo këmishë është e re, apo e larë?”. Kur Omeri radijallahu anhu tha:

“Nuk është këmishë e re, por e larë o i Dërguari i Allahut!”. I Dërguari i Allahut tha:

“**Vish rroba të reja, jeto si falenderues dhe vdis si dëshmor!**”  
(Ahmed, II, 89)

Deklarimet e mrekullueshme të Pejgamberit tonë të Nderuar u realizuan plotësisht e kur u erdhi koha, edhe Hazreti Omer radijallahu anhu ndërroi jetë si dëshmor.



Sigurisht që puna më e rëndësishme që bën rob është falenderimi i Allahut. Në hadithet fisnike që tregojnë mirësinë e falenderimit, i Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem thotë:

*Një rob nga robërit e Allahut tha: **O Zot! Falenderimi të takon Ty në mënyrën më të përshtatshme ndaj madhërisë, fuqisë dhe madhështisë së sundimit Tënd. Ky falenderim i habiti Engjëjt, të cilët kanë për detyrë të shkruajnë veprat e robërve. Ata nuk dinin se si ta shkruanin sevapin e këtij falenderimi. Shkuan në qiell dhe thanë:***

*-O Zoti ynë! Robi yt tha një fjalë që nuk dimë se si t'ia shkruajmë sevapin. Allahu Teala (i cili e di më mirë se çfarë ka thënë rob i Tij) i pyeti ëngjëjt:*

*-Çfarë tha rob i im? Engjëjt u përgjigjën:*

*-O Zoti ynë! Robi yt të falenderoi në këtë mënyrë:*

يَا رَبِّ لَكَ الْحَمْدُ كَمَا يَنْبَغِي لِجَلَالِ وَجْهِكَ وَعَظِيمِ سُلْطَانِكَ

***O Zot! Falenderimi të takon Ty në mënyrën më të përshtatshme ndaj madhërisë, fuqisë dhe madhështisë së sundimit Tënd.***

*Atëherë, Allahu Teala u tha dy ëngjëjve:*



*-Ju shkruajeni atë fjalë ashtu siç e tha robi im, derisa robi im të vijë te Unë dhe ta shpërblej për atë falenderim!” (Ibn Maxhe, Edeb, 55)*

Allahu na e mundësoftë të gjithë neve që ta bëjmë këtë lutje me sinqeritet!..

Ebu hurejra radijallahu anhu thotë:

“Jam rritur jetim dhe kam bërë hixhret si i varfër. U bëra punëtori i vajzës së Gazvanit (Busres) në kundërvlerë të një këpuce, për të ngopur barkun. (Gjatë udhëtimit) Kur buanin, u mblidhja dru, i udhëzoja kur u hipnin kafshëve dhe i nxitoja devetë. **Falenderimi i takon Allahut** që e forcoi Islamit dhe e bëri Ebu Hurejrën imam.” (Ibn Maxhe, Ruhun, 5/2445)



Aishe radijallahu anhu tregon:

“Një natë i Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem më tha:

*-O Aishe! Nëse më jep leje, dua ta kaloj natën duke adhuruar Allahun. Edhe unë i thashë:*

*-Për Zotin unë dua shumë që të rri me Ty, por atë që të gëzon Ty e dua më shumë.*

Pastaj u ngrit, mori mirë e mirë abdest dhe filloi të falë namaz. Po qante... Qau aq shumë sa që iu lagën krejt rrobat, mjekrra e begatë, madje edhe vendi ku bënte sexhden. Kur Ai ishte në këtë gjendje, Hazreti Bilal e thirri për në namaz. Kur e pa që po qante, tha:

*-O i Dërguari i Allahut! Përse qani kur Allahu Teala jua ka falur mëkatet tuaja të kaluara dhe të ardhme?*

Kur dëgjoji këto fjalë, i Nderuari ynë sallallahu alejhi ue sellem u përgjigj:

*-A të mos jem një rob që e falenderon Allahun? Për Zotin sonte më kanë zbritur disa ajete të atillë, që do të jetë turp për ata që i lexojnë dhe nuk mendojnë në to! Pastaj ai lexoi këto ajete fisnike:*

**Në krijimin e qiejve dhe të tokës, në ndërrimin e natës dhe të**



ditës ka argumente të qarta për ata që kanë intelekt. Ata e përme-  
ndin Allahun kur janë në këmbë, kur janë ulur, kur janë të shtrirë  
dhe thellohen në mendime rreth krijimit të qiejve e të tokës (duke  
thënë): Zoti ynë, këtë nuk e krijove kot, i lartësuar qofsh, ruajna  
prej dënimit të zjarrit! (Ali Imran, 190-191) (Ibn Hibban, II, 386)



I Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem e falenderonte me-  
njëherë Allahun, sa herë vërente se kishte një mirësi që nuk e kishin të  
tjerët. Një herë, kur kaloi pranë një të sëmuri me paralizë, zbriti menjë-  
herë nga kafsha dhe bëri sexhden e falenderimit. (Hejsemi, II, 289)

Shenja e dashurisë ndaj të Dërguarit të Allahut është që përfitosh  
nga gjendja e Tij. Sa sexhde falenderimi bëjmë kundrejt shfaqjeve shu-  
më mësimdhënëse që shikojmë?!



Sa'd bin Ebi Vakkas radijallahu anhu tregon:

“Një ditë dolëm nga Mekke bashkë me të Dërguarin e Allahut  
për të shkuar në Medine. Kur u afruam te një vend që quhet Azvera,  
i Dërguari i Allahut zbriti nga kafsha. Pastaj ngriti duart dhe u lut një  
kohë të gjatë, ndërsa më pas bëri sexhde. Në sexhde qëndroi për një  
kohë të gjatë. Këtë e përsëriti tri herë. Në fund tha:

*Iu luta Zotit dhe i kërkova ndërmjetësim për ummetin tim. Edhe  
ai e fali një të tretën e ummetit tim. Edhe unë bëra sexhde për ta fale-  
nderuar Zotin. Pastaj përsëri e ngrita kokën dhe iu luta Zotit që ta falë  
ummetin tim. Edhe Ai përsëri e fali një të tretën e ummetit tim. Mbi  
këtë edhe unë bëra sexhde për ta falenderuar Zotin. Pastaj e ngrita ko-  
kën përsëri dhe kërkova nga Zoti ta falë ummetin tim. Edhe Ai ma fali  
një të tretën e ummetit që kishte ngelur. Edhe unë bëra sexhde përsëri  
për ta falenderuar Zotin.” (Ebu Davud, Xhihad, 162/2775)*

Përgëzimi që e lumturoi shumë dhe e shtyu të bëjë sexhde të  
Nderuarin tonë, ishte që, ata të cilët bëjnë mëkate të mëdha nga um-  
meti i tij, edhe nëse do të ndëshkohe, nuk do të rrijnë gjithmonë në  
xhennem dhe se do të hyjnë në xhennet me ndërmjetësimin e Tij,





ndërsa ata që bëjnë mëkate të vogla ndoshta do mund t'u falen pa u ndëshkuar fare. Ndërsa për ata që nuk besojnë, nuk bëhet fare fjalë të hyjnë në xhennet.



Abdurrahman bin Auf radijallahu anhu tregon një ngjarje e cila shfaq ndjeshmërinë e Pejgamberit tonë të Nderuar në çështjen e falenderimit kundrejt mirësive dhe begative që i jepte Allahu:

“Një herë i Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem kishte dalë nga xhamia. Unë e ndoqa pa rënë në sy. Hyri në një kopësht hurmash. U drejtua nga Qabja dhe bëri sexhde. Ai e zgjati aq shumë sexhden sa që pandeha se nderroi jetë. Menjëherë i shkova pranë, u përkula dhe fillova t'i shikoj fytyrën. Ai e ngriti kokën dhe më pyeti:

-Çfarë ka, o Abdurrahman?

Unë i thashë:

-O i Dërguari i Allahut! Ju e zgjatët aq shumë sexhden, sa që pandeha se ndërruat jetë dhe menjëherë erdha te Ju.

Pejgamberi ynë i Nderuar tha:

-*Kur hyra në kopsht u takova me Xhebrailin alejhisselam. Ai më përgëzoi se Allahu Teala ka thënë: “Kush te jep selam Ty, edhe Unë i jap selam atij. Kush të dërgon salavate Ty, edhe Unë i dërgoj salavate atij.” (Për këtë arsye, i bëra Zotit sexhden e falenderimit)” (Hakim, I, 344-345/810)*



Është e sigurtë që të gjitha mirësitë që na janë dhënë, na janë dhënë nga Allahu Teala, por edhe të falenderosh që është shkak për të na ardhur mirësitë është shenjë besnikërie dhe mirësjelljeje. Në hadithin fisnik thuhet:

“Nëse dikujt që i kanë bërë mirë, lutet për atë që ia ka bërë duke thënë: Allahu të dhashtë të mira!, e ka larë borxhin e falenderimit në një mënyrë shumë të lartë...” (Tirmidhi, Birr, 87/2035)



Aisheja radijallahu anha thotë:

I Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem më thoshte shpesh:

*“O Aishe! A mund të lexosh ca nga poezitë që di përmendësh?”*

Unë i thoja:

“Cilat poezi do, o i Dërguari i Allahut! Unë di shumë poezi përmendësh?”

Ai më thoshte:

*“Ato që flasin për falenderimin!”*

Njëherë unë i thashë:

“Nëna dhe babai im të qofshin falë! Poeti ka thënë: Kape për dore dhe ngrije të dobtin që shikon. Mos u mashtro ngaqë ai është i dobët. Vjen një ditë dhe të kapin fatkeqësitë dhe rrethojnë çdo anë tënden. Ja, atëherë i varfëri që pate ndihmuar, të shpërblen, ose nëse nuk mund të bëjë gjë, të paktën të lavdëron, sepse ai që të lavdëron për arsye se i ke bërë ndonjë të mirë, të ka shpërblyer ty. Nëse dëshiron të poshtërosh dikë që është bujar, dije mirë se fuqitë e dobta nuk mund ta vjetërojnë litarin e tij të fortë.”

Në lidhje me këtë, i Dërguari i Allahut më thoshte:

*“O Aishe! Sipas lajmit që më ka dhënë Xhebraili, kur Allahu Teala t'i tubojë krijesat e Tij në ditën e kiametit, Ai i thotë një robi që i është bërë mirësi nga dikush:*

*-A e ke falenderuar robin tim që të ka bërë mirë?*

*Ai thotë:*

*-O Zoti im! Duke e ditur se mirësia që më është bërë vjen vetëm nga Ti, të kam falenderuar vetëm Ty. Atëherë Allahu Teala i thotë:*

*-Përderisa të mos falenderosh robin tim që e kam bërë shkak që të të vijnë të mirat, nuk më ke falenderuar as Mua!” (Ali el-Muttaki, III, 741-742)*

Në një hadith tjetër, i Nderuari i Botrave ka treguar lidhjen e afërt që ka ndërmjet falenderimit ndaj Allahut Teala dhe falenderimit ndaj një njeriu që bën mirë:

*“Ai që nuk i falenderon njerëzit, nuk ka falenderuar as Allahun.”*



(Ebu Davud, Edeb, 11/4811; Tirmidhi, Birr, 31)



Pejgamberi ynë i Nderuar, ka përmendur një zemër falenderuese si një prej mirësive më të mëdha që i jepen njeriut. Seubani radijallahu anhu tregon:

Ne ishin në luftë bashkë me të Dërguarin e Allahut kur zbriti ajeti “...Lajmëroji për një dënim të dhimbshëm ata të cilët e ruajnë floririn e argjendin dhe nuk e japin në rrugën e All-llahut!” (et-Teube, 34) Disa prej sahabëve thanë:

“Ajo që do të zbriste për floririn dhe argjendin, zbriti. (Tashmë nuk do t’i ruajmë më ato.) Ah sikur ta dinim se cili mall është i mirë dhe ta ruanim?” I Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem u përgjigj:

*“Gjërat më të vlefshme që mund të kesh, janë një gjuhë që bën dhikër, një zemër që falenderon dhe një grua e devotshme që e ndihmon burrin e saj në besim.”* (Tirmidhi, Tefsir, 9/3094)



Davudi alejhisselam e falenderonte shumë Allahun. Ai një herë kishte thënë:

“O Zot! Si të të falenderoj unë Ty, sepse unë mund të të falenderoj vetëm për mirësitë e Tua.”

Atij iu shpall:

“A e di se unë i kam të gjitha mirësitë që i ke ti?”

Hazreti Davud tha:

“Po.”

Në lidhje me këtë, Allahu Teala tha:

“Mua më mjafton që të kënaqem nga ti, ngaqë ti mendon në këtë mënyrë.”<sup>90</sup>



90. Ibn Kethir, Kisasu'l-Enbija, Bejrut, Daru'l-Kalem, fq. 524.



Hazreti Omer radijallahu anhu kishte takuar një besimtar. Ai vazhdimisht lutej: “O Zoti im, më bëj prej të paktëve!” Omeri radijallahu anhu nuk e kuptoi se çfarë kishte për qëllim ai njeri me atë lutje. E pyeti:

“Përse lutesh kështu?”. Besimtari dha këtë përgjigje:

“Allahu Teala thotë: “...**Robërit e Mi që falenderojnë janë shumë pak.**” (Sebe, 13) edhe unë po i kërkoj që të jem prej kësaj pakice të gëzuar.”

Omeri radijallahu anhu i cili u habit nga ky mendim dhe i erdhi keq:

“Turp për mua, çdokush është më i mençur dhe ka më shumë dije se sa Omeri!” (Ibn Ebi Shejbe, Musannef, VII, 81)



Kur Xhunejd Bagdadi ishte shtatë vjeç, daja i tij Serijj Sakati e mori në haxh. Në një prej kuvendeve të dijes që bëheshin në Harem, po flitej për falenderimin. Pasi dijetarët e pranishëm bënë vlerësimet e tyre, Serijj Sakati u kthye nga Xhunejdi dhe i kërkoi që të fliste. Pasi mendoi pak, Xhunejdi dha këtë përgjigje të shkëlqyer:

“Falenderim është të mos jeshë mëkatar ndaj Allahut Teala me mirësitë që të ka dhënë, si dhe të mos e bësh kapital për mëkatin atë mirësi.” (Feriduddin Attar, fq, 318)



Sa e urtë është kjo biseda ndodhi në mes Ibrahim bin Ed'hemit dhe Shakik Belhit, në lidhje me çështjen e falenderimit:

Shakik Belhi e pyet Ibrahim bin Ed'hemin:

“Çfarë bëni në çështjen e jetesës?”

Ibrahim bin Ed'hemi u përgjigj:

“Kur gjejmë, falenderojmë, kur nuk gjejmë falenderojmë!..”

Shakik Belhi tha:



“Edhe qentë e Horasanit bëjnë kështu!” Kësaj here është Ibrahim bin Ed’hemi ai që pyet

“Po ju, çfarë bëni?”

Shakik Belhi përgjigjet:

“Kur gjejmë falenderojmë dhe japim në rrugë të Allahut, kur nuk gjejmë përsëri falenderojmë dhe durojmë.”



Të falenderosh Allahun ashtu siç duhet për mirësitë që ka dhënë është e pamundur, por nëse e falenderojmë aq sa kemi mundësi, Allahu e pranon atë të paktën tonë dhe kënaqet nga ne. Bishri Hafi, i cili ishte nga miqtë e Allahut, jep një shembull të bukur në këtë çështje:

Pasi vdiq, Hazreti është parë në ëndërr. Kur u pyet:

“Si të ka gjykuar Allahu?”, dha këtë përgjigje: Allahu më fali dhe duke më dhuruar xhennetin. Më tha:

-O Bishr! Sikur të kishë bërë sexhde edhe mbi prush, nuk do ta kryeje falenderimin e dashurisë që kam vendosur në zemrat e robërve të mi për ty!” (Kushejri, Risale, Bejrut 1990, fq. 406)



Barbaros Hajreddin Pasha e mund Andrea Dorjanë në Prevezë. Andrea Dorja, në një gjendje të mjeruar, e shpëton shpirtin e tij duke ikur dhe duke e lënë flotën.

Barbaros hyri në gji nga Sarajburnu duke i vënë përpara anijet armike që i kishin spirancat e ulura bashkë me dhjetëra mijëra robër. Sipërfaqja e detit ishte e mbushur me anijet armike të cilat ishin përplot me robër.

Kanuni, vezirët dhe pashallarët po e shikonin këtë pamje të mrekullueshme prej një saraje në bregdet, por që tashmë nuk është më në Sarajburnu. Njëri nga padishahët, duke qenë i emocionuar, tha:

“O sulltani im! Sa herë e ka parë bota një pamje të tillë? Sado që



të lavdëroheni është pak!”

Ndërsa Sulltani i Lartë, Kanuni, u përgjigj:

“O pasha! A na takon të mburremi apo të falenderojmë Allahun e Lartë për këtë fitore që na ka dhënë?!”

Sa edukatë madhështore Islame, sa botë e mrekullueshme shpirtërore...



Së fundi, të jetojmë çdo moment tonin me ndjenjat e hamdit dhe të shukrit është një detyrë e rëndësishme e adhurimit. Po ta kryejmë këtë detyrë të rëndësishme, ajo do të na afrojë te Allahut Teala dhe do të bëhet shkak për shtimin e mirësive tona. Sa bukur thotë Hazreti Mevlana:

*“Të falenderosh për mirësinë, është më mirë se mirësia. Ai që e do shukrin, a e lën atë dhe shkon në anën e mirësisë? Të falenderosh është shpirti i mirësisë. Ndërsa mirësia është si lëkurë, sepse vetëm shukri të shpie në derën e mikut. Mirësia mund t’i japë njeriut neglizhencën, që është e kundërta e vigjilencës. Ndërsa shukri gjithmonë jep vigjilencë. Ti vërja gishtin kokës dhe gjuaj mirësinë e vërtetë me mirësinë e shukrit (falenderimit)!”*

## 17. Trimëria

Trimëri do të thotë guxim, kurajo, heroizëm, vendosmëri shpirtërore, të jesh i guximshëm në dhunë dhe në rrezik. Është gjendja normale mes zemërimit e forcës së ashpërsisë, dhe e frikës që është e kundërta e këtyre.

Esenca e trimërisë është kënaqësia dhe nënshtrimi ndaj kaderit të Allahut. Për këtë arsye, një myslimani që i beson kaderit dhe i cili i mbështetet Allahut, kurrë nuk i ka hije frika dhe poshtërimi.

Sipas transmetimit të Seubanit radijallahu anhu, i Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem ka thënë:



*“Është afër koha kur popujt e huaj do ta thërrasin njëri-tjetrin për t’ju sulmuar juve, ashtu siç thërrasin ngrënësit njëri-tjetrin në sofër (tryezë).”*

Njëri prej atyre që gjendeshin aty pyeti:

“Kjo do të na ndodhë ngaqë atë ditë do të jemi të pakët në numër, o i Dërguari i Allahut!?” I Nderuari ynë tha:

*“Jo, përkundrazi, atë ditë do të jeni shumë, por ju do të jeni si mbeturinat që sjell dhe i hedh rrëkeja, do të jeni në një gjendjen e atyre që nuk kanë fare peshë. Allahu do t’ia heqë armiqtë tuaj nga zemra ndjenjën e frikës kundër jush dhe do të vendosë dobësi në zemrat tuaja!”*

I thanë: “Çfarë është dobësimi, o i Dërguari i Allahut?”

“Është dashuria ndaj kësaj bote dhe frika ndaj vdekjes!” (Ebu Davud, Melahim, 5/4297)

Domethënë, kur trimëria dhe guximi do të dalë nga zemrat, kur në vend të tyre do të anojnë pasuritë e kësaj bote dhe kur të hiqet frika e vdekjes, besimtarët do të poshtërohen. Me një gjendje të këtillë nuk do t’u mbetet kurrfarë peshe kundrejt armiqtë.

### ***Tabllo të virtytshme***

Nuk është e mundur të flitet që ndonjë tjetër të ishte aq trim se sa i Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem. Ai ishte durimtar dhe i vendosur edhe ndaj situatave të jashtëzakonshme dhe nuk bënte ndonjë gjë të papërshtatshme duke u trembur dhe hyrë në telash.

Kur Allahu e urdhëroi të Dërguarin e Tij të shpërngulet për në Medine, me ta dëgjuar këtë mushrikët Kurejshë rrethuan shtëpinë e të Nderuarit tonë dhe nxorrën shpatat e tyre për ta vrarë sapo ai të dilte nga shtëpia. Krenaria e Gjithësisë, i Nderuari ynë pa u frikësuar fare hapi derën, u hodhi dhë mbi krye mushrikëve dhe kaloi mes tyre me dinjitet, duke lexuar ajetet e para të sures Jasin. (Ibn Sa’d, I, 227-228)



Hazreti Ali radijallahu anhu ka thënë:

“Ne në luftën e Bedrit strehoheshim te i Dërguari i Allahut. Atë ditë Ai ishte më afër armikut nga të gjithë ne dhe më trimi e i vendosuri i njerëzve.” (Ahmed, I, 86)

Edhe Abdullah bin Omer radijallahu anhu ka thënë:

“Nuk kam parë njeri më bujar, më trim, më guximtar se i Dërguari i Allahut!” (Ibn Sa’id, I, 373)



Në Uhud, njëri prej mushrikëve doli në mejdan hipur mbi deve dhe kërkoi një ushtar për tu ndeshur. Kur mushriku e pa se të gjithë tërhiqeshin dhe rrinin pas Atij, e përsëriti tri herë kërkesën e tij. Pas kësaj, Zubejr bin Avvam radijallahu anhu shkoi drejt tij. U hodh mbi deve, iu hodh përsipër dhe filluan të kacafyten. Pejgamberi ynë i Nderuar tha:

“*Tërhiqe poshtë dhe hidhe në tokë!*” Pa kaluar shumë, mushriku ra në tokë. Edhe Zubejri i hipi sipër dhe e vrau. Pas kësaj, i Dërguari i Nderuar tha:

“*Sikur të mos dilte Zubejri, do t’i dilja Unë, për shkak se gjithkush u tërhoq prapa!*”<sup>91</sup>

Ubej bin Halef, i cili ishte nga mushrikët e Mekkes, qe një nga armiqtë më mizorë në luftën kundër Islamit. Para hixhretit, ai i pati thënë të të Nderuarit të Botrave:

“Unë ushqej një kalë, po i jap për të ngrënë gjërat më të mira. Një ditë do t’i hip atij kali dhe do të të vras!”

Një herë, edhe i Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem iu përgjigj:

“*Inshallah do të të vras unë ty!*”

Në ditën e luftës së Uhudit, ky mushrik i marrë po kërkonte Hazretin Pejgamber sallallahu alejhi ue sellem dhe thërriste:





“Nëse ai shpëton sot, do të thotë se puna ime ka mbaruar!”

Me këtë mendim ai erdhi deri afër Pejgamberit tonë të Nderuar për ta sulmuar. Sahabët e nderuar deshën t’ia prisnin kokën teksa ai ndodhej ende larg. I Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem tha:

“*Lëreni të vijë!*”

Kur Ubej bin Halef u afrua, Krenaria e Gjithësisë, i Nderuari ynë mori shtizën e një sahabiu. Këtë radhë Ubej filloi të ikë prapa, por Sulltani i Pejgamberëve i hodhi shtizën, duke i thënë:

“Ku po shkon o gënjeshtar?”

Shtiza e gërvishti Ubejin lehtë në qafë, por ai edhe me kaq gjë ra nga kali. Disa herë u kapërdredh dhe iku në anën e tij duke vrapuar në mënyrë dëshpëruese. Teksa vraponte, bërtiste me sy të zgurdulluar:

“Betohem se Muhammedi më vrau!..”

Mushrikët të cilët i shkuan pranë, ia panë plagën dhe i thanë:

“Kjo është një gërvishtje e lehtë!” Por ai nuk arrinte të qetësohej dhe tha:

“Kur Muhammedi ishte në Mekke, më pati thënë: *Unë do të të vras patjetër!* Kështu që, betohem se edhe nëse Ai më hedh një pësh-tymë, unë përsëri vdes!..”

Pastaj vazhdoi të bërtiste. Zëri i dilte si britmë kau.

Kur Ebu Sufjan e qortoi:

“Pse bërtitet kaq shumë për këtë gërvishtje të vogël?” Edhe atij, Ubej i tha:

“A e di se kush ma ka bërë këtë gërvishtje? Kjo është një plagë që e ka hapur Muhammedi. Betohem në Lat dhe Uzza, se sikur t’u ndahet të gjithë popullit të Hixhazit dhimbja që ndjeva unë nga kjo plagë, të gjithë do të shkatërroheshin. Muhammedi në Mekke më pat thënë: *Unë do të të vras patjetër!* Që atëherë, unë e kuptova se do të vritem nga dora e Tij dhe se nuk do të shpëtoj nga Ai.”

Ubej, i cili ishte një armik mizor i Pejgamberit, vdiq një ditë para



se të arrinin në Mekke. (Ibn Ishak, fq. 89; Ibn Sa'd, II, 46; Hakim; II, 357)



Muhammed bin Mesleme thotë:

Kur myslimanët u prishën në Uhud, i dëgjova me veshët e mi dhe i pashë me sytë e mi se ata po iknin drejt malit. I Dërguari i Allahut u thërriste nga prapa:

*“O filan! Eja te Unë. O filan! Eja te Unë. Unë jam i Dërguari i Allahut!”* (Vakidi, I, 237)

Duke folur për këtë të vërtetë, Allahu thotë:

**“Atëherë ju largoheshit e nuk përfillnit as njëri-tjetrin, ndërsa i Dërguari ju thërriste nga prapa...”** (Ali Imran, 153)



Sipas marrëveshjes që u bë ditën e Uhudit, mushrikët dhe myslimanet do të luftonin përsëri një vit më vonë. Për shkak të kësaj marrëveshjeje, Ebu Sufjan erdhi në krye të ushtrisë deri te vendi Murre'z-Zahran, por përsëri ia pushtoi zemrën frika dhe u detyrua të kthehej prapa. Nga ana tjetër, për shkak se nuk donte të shkelte krenarinë e tij, dërgoi në Medine një person. Duke e urdhëruar atë që të çonte lajmin se “ne kemi dalë në rrugë me një ushtri të madhe”, në mënyrë dinake u përpoq t'i frikësonte besimtarët dhe t'i pengonte të dilnin në luftë.

Kur lajmi arriti në Medine, i Dërguari i Allahut i kishte mbaruar përgatitjet e luftës, madje kishte dhënë urdhër për nisje. Lajmëtari, duke e ditur se Ebu Sufjani kishte frikë dhe që kthyer prapa, u orvat t'i trembte dhe u mundua t'i pengonte të niseshin në luftë. Përveç gënjeshtreve që e kishin porositur të thoshte, ai shtonte edhe gënjeshtër të reja, duke thënë se nëse myslimanët luftojnë me Mekkasit jashtë qytetit, do ta pësonin shumë keq. Si rezultat i përpjekjeve të tij dhe sjelljes së disa hipokritëve, në zemrën e ca myslimanëve hyri frika, aq sa refuzuan të dilnin në luftë. Në lidhje me këtë, Hazreti Pejgamber sallallahu alejhi ue sellem tha:



*“Betohem në Allahun, në dorën e të Cilit është shpirti im, se unë do të shkoj në Bedr qoftë dhe i vetëm, edhe nëse nuk kam asnjë pranë!”* Pastaj, Allahu Teala i ndihmoi myslimanët duke mbjellë në zemrat e tyre vendosmëri. (Ibn Sa’d, II, 59; Vakidi, I, 386-387)



Një nga vendet e tjera ku i Dërguari i Allahut ka treguar heroizëm, është Hunejni. Atë ditë, kur të gjithë iknin nga armiku, Krenaria e Gjithësisë, i Nderuari ynë e ngiste kafshën e tij drejt rreshtave të armikut duke përparuar, pa i marrë fare parasysht këshillat e ashabëve që donin ta ndalonin. (Muslim, Xhihad, 76) Hazreti Enes radijallahu anhu tregon:

Në ditën e Hunejnit, Hevazinët dhe Gatafanët erdhën në vendin e luftës bashkë me fëmijët dhe devetë e tyre. Atë ditë në ushtrinë e të Dërguarit të Allahut kishte dhjetë mijë vetë. Edhe Mekkasit që u falën pas çlirimit të Mekkes, ishin në rreshtin e të Dërguarit të Allahut. (Sapo filloi lufta) të gjithë ikën prapa. I Nderuari ynë alejhissalatu uesselam mbeti vetëm. Atë ditë i Nderuari ynë thirri dy herë dhe ndërmjet këtyre dy thirrjeve nuk tha më asnjë fjalë tjetër. U kthye në anën e djathtë dhe thirri:

*“O grupi i Ensarëve!”* Ata që ishin në atë anë thanë:

*“Urdhëro o i Dërguari i Allahut! Përgëzim! Ne jemi me Ty!”*

I Nderuari ynë alejhissalatu uesselam u kthye pastaj në të majtë dhe përsëri thirri:

*“O grupi i Ensarëve!”* Ata që ishin në atë anë, thanë:

*“Urdhëro o i Dërguari i Allahut! Përgëzim! Ne jemi me Ty!”*

Pejgamberi ynë i Nderuar ishte mbi një mushkë të bardhë. Zbriti nga mushka dhe tha:

*“Unë jam robi dhe i Dërguari i Allahut!”* (Pas kësaj myslimanët u mblodhën dhe kaluan në sulm) mushrikët u mundën... (Buhari, Megazi 56, Humus 19; Menakib 14, Menakibu'l-Ensar 1; Muslim, Zekat 135)

Një njeri erdhi të Bera Ibnu Azib radijallahu anhumana dhe e pyeti:



“O Ebu Umare! A të gjithë ikët në ditën e Hunejnit?”

Bera u përgjigj:

“Unë dëshmoj se i Dërguari i Allahut nuk ka ikur, por ata që ishin të parët, ata që nuk kishin pesha të rëndë bashkë dhe ata që nuk mbartnin pazmore, ikën në Hevaz. Ndërsa ata që qëndruan aty, ishin shigjetarë. Ata ngelën nën shiun e shigjetave që ngjanin si plim karkalecash. Pastaj u detyruan të shpërndaheshin. Kësisoj që armiqtë u drejtuan kah i Dërguari i Allahut. Mushkën e të Nderuarit tonë alejhissalatu uesselam po e tërhiqte Ebu Sufjan Ibnu'l-Harith radijallahu anhu. I Nderuari ynë zbriti nga mushka, u lut dhe kërkoi ndihmë nga (Allahu). Ai thoshte kështu:

*“Unë jam Pejgamber dhe jo gënjeshtar! Unë jam biri i Abdulmuttalibit! O Zoti im! Zbrite ndihmën Tënde.”*

Pastaj i vendosi në rregull ushtarët. Bera në vazhdim thotë:

“Për Zotin, kur ashpërsohej lufta, ne strehoheshim te i Dërguari i Allahut alejhissalatu uesselam. Më i forti prej nesh ishte ai që mund të qëndronte në një vijë me të Dërguarin e Allahut.” (Muslim, Xhihad 79; Buhari, Megazi 54, Xhihad 52, 61, 97, 167)



Enes bin Malik radijallahu anhu thotë:

“I Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem ishte më i bukuri i popullit, më bujari dhe më trimi. Kur në Medine dëgjohej ndonjë britmë apo ndodhte ndonjë gjë e frikshme, Pejgamberi merrte menjëherë kalin e Ebu Talhas, të cilin e quanin Mendub, dhe shkonte në vendin prej nga vinte britma. Nuk kemi dëgjuar asnjë britmë apo zë ndihme, e që pastaj të mos shikonim Mendubin tek bëhej erë. Një natë, Medinasit dëgjuan një britmë, u frikësuan dhe shkuan drejt anës nga vinte zëri. Ndërkohë i Dërguari i Allahut kishte shkuar para tyre atje prej nga vinte zëri, kishte shqyrtuar situatën dhe teksa po kthehej u takua me njerëzit. Ai ishte mbi kalin e Ebu Talhas, shpatën e kishte të lidhur në trup dhe po u thoshte ashabëve:



*ai ishte i shpejtë si rrëke!*” (Ibn Sa’d, I, 373; Buhari, Edeb, 39)



Ashabët e nderuar shfaqën në Bedr shumë sakrifica dhe heroizëm. Veçanërisht Luani i Allahut, Hazreti Hamza radijallahu anhu shfaqti një shembull të rrallë trimërie. Umejje bin Halef, i cili bënte pjesë në parinë e mushrikëve, kishte pyetur nga Abdurrahman bin Auf:

“Kush ishte ai që mbante në kraharor fletë struci si shenjë?” Kur mori përgjigjen “Ai ishte Hamza bin Abdulmuttalib!”, tha:

“Ja, gjithçka që na është bërë neve, ai na e ka bërë!” (Ibn Hisham, II, 272)



Kur u ashpërsua lufta në Uhud, i Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem mori një shpatë në dorë dhe pyeti:

“*Kush e merr këtë nga unë?*” Sahabët i zgjatnin duart ta merrnin, gjithë duke thënë:

“Unë, unë!” Kur i Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem pyeti:

“*Kush e merr këtë shpatë për t’ia dhënë hakun e saj?*”, ata u tërhoqën.

Ebu Duxhane radijallahu anhu, i cili ishte nga Ensarët, u ngrit në këmbë dhe tha:

“E marr unë për t’ia dhënë hakun, o i Dërguari i Allahut!” (Muslim, Fedailu’s-Sahabe, 128)

Kur Ebu Duxhane e mori shpatën, pyeti:

“Kush është haku i kësaj shpate, o i Dërguari i Allahut!”

Pejgamberi ynë i Nderuar tha:

“*Haku i asaj është të luftoshë me armiqtë derisa të biesh...*”

Ebu Duxhane e mori shpatën, e nxori lidhësen e kuqe, e lidhi në kokë dhe filloi të ecë me rreshtat myslimanë mes rreshtave mushrikë grupe-grupe.



Kur i Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem e pa atë duke ecur me mburrje dhe krenari, tha:

*“Kjo është një ecje të cilën Allahu Teala e urren jashtë këtyre situatave!”* (Ibn Hisham, III, 11-12)



Gjatë luftës së Hendekut, halla e të Dërguarit të Allahut, Hazreti Safijje me gjithë gratë dhe fëmijët ishin në shtëpinë me emër të Fari të Hassan bin Sabitit. Një grup çifutësh i përbërë prej dhjetë vetësh, hodhën shigjeta në shtëpi dhe u munduan të hynin brenda. Njëri prej tyre po ecte rreth e rrotull shtëpisë dhe po kërkonte ndonjë vend të hapur. Në atp çaste i Dërguari i Allahut ndodhej bashkë me ashabët çate në Hendek, duke luftuar kundër armikut.

Kur Hazreti Safijje nuk mundi të gjente ndonjë rrugëzgjidhje dhe e kuptoi se këtë të keqe nuk kishte njeri që do të mund ta largonte përveç saj, lidhi kokën e saj fort me një lidhëse dhe duke marrë në dorë një shtizë, zbriti poshtë nga shtëpia. Hapi derën dhe iu afrua pa zë çifutit që ndodhej aty pranë dhe e goditi në kokë duke e vrarë në vend. Çifutët e tjerë, kur panë se shoku i tyre u vra, i zuri frika dhe u tërhoqën duke thënë:

*“Ne na thanë se nuk ka roje këtu te gratë!”* (Hejsemi, VI, 133-134; Vakidi, II, 462)

Halid bin Velid radijallahu anhu ka thënë:

Në ditën kur është bërë lufta e Mutes, në dorën time më janë thyer nëntë shpata. Vetëm një shpatë me strukturë Jemenase nuk u thye. (Buhari, Megazi, 44)



Mistiku i madh që ndiqte gjurmët e të Dërguarit të Allahut dhe të ashabëve të Tij, Hazreti Nexhmeddin Kubra, kur vendi i tij Harez u pushtua nga Mongolët, u përball me ta në mënyrë heroike dhe ra dëshmor bashkë me nxënësit e tij. Në kulturën e Tasavvufit (misticizmit), ata që e bënë mallin e dëshmisë mësim, ata që vendosen në tre trupa për të



siguruar kufinj, si dhe dervishët që kanë shfaqur shembuj heroizmi, janë përfaqësuesit më të rëndësishëm të trimërisë dhe të kurajos.



Ushtria aleate e kryqëzatave, që u formua duke pasur si qëllim shkatërrimin e Osmanëve, shpëtimin e Bizantit dhe marrjen e Kudsit që ishte në dorë të myslimanëve, hynë në tokat Osmane dhe rrethuan kalanë e Nigbolluit, e cila gjendej ne breg të lumit Tuna.

Bajezidi i cili u lajmërua për këtë dhe me një shpejtësi që i ka hije emrit të tij, ai mbërriti në Nigbollu. Madje, duke lëvizur në mes të natës i vetëm mbi kalin e tij, ai arriti të kalonte me mjeshtëri nëpër rreshtat e armiqve, derisa arriti rrëzë mureve nga ku i thirri komandantit të kalasë:

“-Bre Dogan! Bre Dogan!..”

Dogan Bej, i cili e njohu menjëherë zërin e sulltanit, u habit pa masë dhe u përgjigj menjëherë nga pirgu i kalasë:

“Urdhëroni sulltani im!..”

Padishahu Jëlldërëm Bayezid Hani i dha disa të dhëna dhe i tha:

**“Dogan! Kam ardhur me ushtrinë time! Mos e dorëzo kalanë!”** Pastaj, duke u kthyer pas çilembyll sytë, humbi në errësirë.

Të nesërmen, lufta e përgjakshme që u bë kundër ushtrisë së madhe të kryqëzatave, përfundoi me fitoren e padiskutueshme të Jëlldërëm Hanit. Ushtria e kryqëzatave përbëhej nga ushtarë që vinin prej të gjitha vendeve të mëdha e të vogla të Europës. Në mes tyre kishte dhjetë mijë kalorës francezë, të cilët thërrisnin me mburrje: “Edhe nëse bien qiejt, ne mund t’i mbajmë me shtizat tona! Megjithatë, kryqëzatat u tretën dhe u shkatërruan përballë sulmeve të Osmanëve të mbushur me besim. Atë ditë, Yëlldërëm Bajezidi i cili ishte plagosur edhe vetë në disa pjesë të trupit, ngaqë pati rënë nga kali, arriti megjithatë të hipte mbi një kalë tjetër dhe të korrte fitore duke qenë vazhdimisht në ballë të ushtrisë së tij.



Me fitoren e Nigbolluit, Jëlldërëm Bajezid Hani mori shumë robër aristokratë dhe kalorës. Mes të robërve ishte edhe kalorësi guximtar Zhan (Jean). Yëlldërëm Bajezid Hani i la të lirë në shpërblim të pagesës. Për më tepër, ditën kur do të ktheheshin në vendet e tyre, ai shtroi një gosti për të gjithë ata. Kalorësit u turpëruan përballë kësaj sjelljeje njerëzore të sulltanit, duke sjellë ndërmend sjelljet e këqia dhe dhunën që ata vetë kishin ushtruar ndaj robërve, kështu që thanë:

*“Që tani betohemi në nderin tonë, se nuk do të luftojmë dhe nuk do t’i përdorim më armët kundra Sunduesit të Anadollit dhe Rumelisë Jëlldërëm Bajezid Hanit!..”*

Mbas këtyre fjalë që ata thanë për mirënjohje, sulltan Jëlldërëm Bajezid Hani, i cili ishte një monument i përkryer trimërie kundra qafirëve, u tha kalorësve me zërin e tij buçitës:

*“Unë i kthej pas betimet që bën Zhani, i cili në Europë ka marrë titullin “i patremburi”, bashkë me shokët e tij se nuk do të luftojnë më kundra meje. Shkoni, mblidhni përsëri ushtri dhe ejani kundër meje! Dijeni se kjo që do të bëni, do të jetë shkak që të fitoj edhe një herë, sepse unë jam një sulltan me një ndërgjegje dhe se në këtë botë kam ardhur për të fituar kënaqësinë e Allahut duke e lartësuar fenë e Tij. Nisur nga kjo, ndihma e Allahut është me ne, dhe nëse Allahu ndihmon dikë, sigurisht që nuk ka asnjë lloj force dhe fuqie që ta mposhtë atë!..”*

Kur Timuri e rrethoi kalanë e Sivasit me elefantë që konsiderohen si tanket e asaj kohe, biri i Jëlldërëm Bajezidit, Shehzade Ertugrull mblodhi parinë e qytetit dhe u tha:

*“Detyra ime është që të mundohem t’ju mbroj juve. Forcat e Timurit mund të jenë aq shumë, sa që nuk mund të krahasohen me tonat. Ky është një përcaktim hyjnor. Detyra ime është që të përballim trimërisht me sulmet e tyre dhe t’ju mbroj juve dhe kalanë në një mënyrë që i ka hije emrit tonë. Ta dini se Timuri nuk do të mund të hyjë kurrë në këtë qytet pa shkelur më parë mbi trupat tanë...”*

Pas këtyre fjalëve, Shehzade Ertugrull veproi ashtu siç tha. Me një grusht trimash luftoi heroiksht dhe shfaqti një qëndresë të pabesueshme kundra ushtrisë së panumërt të Timurit, por ai dhe ushtarët





e tij pinë sherbetin e ëmbël të martirizimit përpara ushtrisë armike që rridhte si rrëke e tërbuar.

Timuri i cili iu shmang Shehzades, lajmëroi se nëse dorëzoheshin ata që ishin në kala, ai nuk do t'i vriste. Megjithatë, ai i vrau në mënyrë të përgjakshme të gjithë mbrojtësit që u dorëzuan duke i besuar fjalës së tij.



Ja një ngjarje tjetër, një shembull i bukur që tregon trimërinë e ushtarëve osmanë:

Leventi, ai që solli lajmin e fitores së Prevezës, kishte hipur mbi një kalë shumë të shpejtë dhe kur hyri në sarajën Topkapë kali u ngrit në këmbët e para, ngaqë ai tërhoqi frerët. Kur e vuri re një gjë të tillë, Kanuni i tha Leventit:

*“Paske ardhur me një kalë të egër!...”* Përgjigja e Leventit, që tregon një shfaqje të besimit në vete por edhe të guximit që lidhej me besimin, ishte:

*“Sulltani im! Deti Mesdhe ishte një kalë i egër, por ne e zbutëm edhe atë!...”*



Gjatë luftës së Çanakkalesë, u vendos që padishahu dhe qeveria të transportohen në Eskishehir si masë paraprake, ngaqë ishin të shqetësuar se mos flota armike mund ta kalonte detin e Marmarasë. Kur Abdulhamit Hani, i cili qe rrëzuar nga fronti dhe ndodhej i burgosur në Sarajën Bejlerbeji, u lajmërua për situatën, refuzoi me një trimëri dhe guxim të madh. Ai tha:

**“Unë jam nipi i sulltan Fatih Mehmed Hanit!.. Asnjëherë nuk mund të rri nën Kostandinin, Perandorin e Bizantëve! Kur gjyshi im Fatihu po merrte Stambollin, Kostandini vdiq duke luftuar në krye të ushtarëve të tij. Nëse bëhet e vërtetë –Allahu na ruajt- që armiku të hyjë nga Çanakkale, marr një armë në dorë, shkoj si ushtar dhe vdes duke luftuar. Armiku mund të hyjë në Stamboll**



vetëm duke shkelur trupin tim. Edhe vëllait tim që është në krye të shtetit i thoni që mos shkojë në asnjë vend. Nëse ai dhe qeveria do të ndahen nga Stambolli, nuk mund të kthehen më!..”

Padishahu dhe qeveria ngeli në Stamboll kundrejt këtij vendimi të Tij. Kështuqë, që atë ditë, pengoi që shteti të shkatërrohet.

Turisti francez A. L. Castellan, e përshkruan me këto fjalë trimërinë e njerëzve Osmanë:

*“Besimi i kadasë dhe i kaderit ka zënë rrënjë në mendjen e Osmanëve. Ky besim te ata kalon në vendin e trimërisë dhe ua shton vendosmërinë. Bëhet shkak që edhe vdekjen ta pranojnë me tevekkul. Ja, për këtë arsye edhe rreziqet absolute që mund të shihen me sy, nuk i trembin ata. Madje edhe nëse hidhen në zjarre të mëdha e nën bajonetat e armikut, edhe pasi t’u bëhen trupat vrima-vrima, nëse nuk janë të bindur se nuk u ka ardhur vdekja, nuk e këpusin shpresën nga jeta.”*

Së fundi, besimtarët kanë frikë vetëm nga Allahu dhe për shkak se i mbështeten vetëm Atij, nuk kanë frikë nga asgjë tjetër. Ata i zbatojnë urdhërat e Allahut me trimëri dhe vendosmëri. Duke e përdorur trimërinë e tyre me intelekt dhe me objektivitet, veprojnë ashtu si duhet. Allahu e lavdëron kështu këtë gjendje:

**“Ata të cilët e transmetojnë shpalljen e Allahut, nuk kanë frikë asnjë përveç Allahut...”** (el-Ahzab, 39)

## 18. Istikameti

Istikameti, në kuptimin e përgjithshëm do të thotë të drejtohesh dhe të përparosh vazhdimisht drejt një qëllimi pa kontradiktë dhe kundërshtim. Ndërsa në terminologjinë e Tasavvufit (misticizmit), do të thotë ta ruash të panjollësor çiltërsinë dhe dëlirësinë e krijimit.

Istikameti, me një kuptim tjetër do të thotë të marrësh nga personaliteti shembullor i Pejgamberit, të marrësh nga morali i Tij, të jetosh një jetë të tërë me ndjenjat shpirtërore të Kur’anit dhe Sunnetit, të



largohesh nga dëshirat vetjake të kësaj bote, të fitosh perceptimin e të fshehtave të adhurimit dhe të dijes duke e mbajtur të gjallë dashurinë ndaj të Dërguarit të Allahut.

Siç nuk ka asnjë rrugë tjetër për të shkuar te Zoti përveç istikametit, nuk ka asnjë pozitë më të lartë se sa ruajtja e istikametit në çdo çështje, por dhe asnjë urdhër më të vështirë se sa zbatimi i tij siç duhet. Për këtë arsye, istikameti në rrugën e Zotit, është parë si kerameti më i madh.

Allahu i përgëzon kështu njerëzit e istikametit:

“S’ka dyshim se ata që thanë: Zoti ynë është Allahu, pastaj nuk u luhatën, atyre u zbresin ëngjëjt dhe u thonë: “Mos u frikësoni dhe mos u mërzitni e gëzohuni me xhennetin që ju premtohet! Ne jemi miqtë tuaj në jetën e dynjasë dhe në ahiret. Këtu do të keni atë që dëshironi dhe gjithçka që kërkon. Pritje e nderuar nga Falësi, Mëshiruesi!” (Fussilet, 30-32)

“Ata që thanë: Zoti ynë është Allahu dhe qëndruan besnikërisht, për ta nuk ka frikë dhe ata nuk do të pikëllohen. Ata janë banues të xhennetit, aty do të jenë përgjithmonë. Atë e kanë shpërblim për veprat që kanë bërë.” (el-Ahkaf, 13-14)

Rruga e njerëzve të istikametit është “siratu’l-mustekim”. Në Kur’anin Fisnik thuhet kështu për ata që ecin siç duhet në këtë rrugë:

“Kushdo që i bindet Allahut dhe të Dërguarit të Tij, do të jetë sëbashku me peygamberët, me të sinqertët, me dëshmorët dhe të devotshmit të cilët Allahu i shpërbleu. Sa shokë të mirë janë ata!” (en-Nisa, 69)

Siratu’l-mustekim është rruga e njerëzve të zgjedhur. Edhe themeli i istikametit është besimi dhe devotshmëria. Vendi i këtyre të dyjave është zemra. Nisur nga kjo, istikameti është lidhja e besimit dhe e devotshmërisë që janë në zemër, me trupin. Besimi, sinqeriteti dhe butësia sjellin istikametin dhe e bëjnë të përhershëm. Peygamberi sallallahu alejhi ue sellem ka thënë:

*“Përderisa gjuha të mos jetë në istikamet, zemra nuk është e drejtë, përderisa zemra të mos jetë në istikamet, besimi nuk është i plotë.”*



(Ahmed, II, 198)

Në këtë botë të përkohshme besimtari duhet të jetë gjithmonë në istikamet dhe asnjëherë nuk duhet të devijojë nga rruga e vërtetë. Sa bukur thotë poeti:

*Mos ki frikë nga armiku që po të jetë edhe zjarr nuk të djeg!  
Ji në istikamet, Allahu nuk të turpëron!*

### **Tablo të virtytshme**

Allahu i ka thënë Pejgamberit tonë të Nderuar dhe neve si ummet të Tij:

**“Ti (Muhammed) përqëndrohu vendosmërisht ashtu si je urdhëruar dhe bashkë me Ty edhe ata që u penduan dhe mos i tejkaloni (kufijtë e caktuar)!..”** (Hud, 112)

Duke pasur për qëllim këtë ajet, i Dërguari i Nderuar sallallahu alejhi ue sellem ka thënë:

*“Mua më plaku sureja Hud...”* (Tirmidhi, Tefsir, 56/3297; Kurtubi, IX, 107)

Abdullah bin Abbas radijallahu anhu, në lidhje me këtë ajet, ka thënë:

**“Në Kur’anin Fisnik, për të Dërguarin e Allahut sallallahu alejhi ue sellem nuk ka asnjë fjalë më të ashpër se sa ky ajet.”**<sup>92</sup>

Sado që të jetë kjo për të Dërguarin e Nderuar, ajo që e bënte të vuante nuk ishte shqetësimi i istikametit në lidhje me veten e tij, sepse Ai kishte fituar sigurinë hyjnore:

**“O i Dashuri Im! Ti je në rrugë të drejtë.”** (Jasin, 4) çështja që e bënte të mendonte aq shumë deriisa ta plakte, është shqetësimi që ai ndjente për besimtarët, sepse ky urdhër përfshinte edhe besimtarët.



Krenaria e Gjithësisë i Nderuari ynë në një hadith fisnik thotë:

*“Qëndroni në istikamet. (Sevapin e kësaj) nuk mund ta vlerësoni dhe nuk mund ta kuptoni. Dijeni mirë se puna më e mirë e juaja është namazi...”* (Muvatta, Taharet, 6)



Sufjan bin Abdullah radijallahu anhu tregon:

Të Dërguarit të Allahut sallallahu alejhi ue sellem i thashë:

“O i Dërguari i Allahut! Ma mëso Islamin në një mënyrë të atillë sa të mos ndjej të nevojshme të pyes askënd.” I Nderuari ynë tha:

*“Thuaj i kam besuar Allahut, pastaj ji i drejtë!”* (Muslim, Iman, 62)



Sipas transmetimit të Enesit radijallahu anhu, i Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem lexoi ajetin:

**“S’ka dyshim se ata që thanë: Zoti ynë është Allah, pastaj nuk u luhatën, atyre u zbresin ëngjëjt dhe u thonë: “Mos u frikësoni e mos u mërzitni dhe gëzohuni me xhennetin që ju premtohej! Ne jemi miqtë tuaj në jetën e dynjasë dhe në ahiret.”** (Fussilet, 30) Pastaj ai tha:

*“Njerëzit gjithmonë e kanë thënë këtë, por pastaj shumica e tyre ra në kufër. Kush vdes mbi këtë fjalë, është nga ata të cilët janë në istikamet.”* (Tirmidhi, Tefsir, 41/3250)



Njëri prej të mëdhenjve kishte takuar një të moshuar që kishte ngarkuar dru në kurriz. Kur e pa, i tha:

“O i moshuar! A nuk të ka ngelur besim ndaj Allahut që akoma në këtë moshë heq këtë vuajtje? Apo nuk ka kush të kujdeset për ty?”

I moshuari, për t’ia hequr bashkëfolësit mungesën e perceptimit shpirtëror, i ngriti sytë drejt qiellit, hapi krahët dhe tha:

“O Zot! Bëji këto florinj!” Dhe drutë u bënë florinj.



Personi i cili e pa këtë keramet, kësaj here pyeti i habitur:

“Po përse mbart dru një njeri që ka arritur një gradë të tillë?”

I moshuari tha:

“Biri im, këtë e bëj që vetja ime të më njohë si rob dhe të mos dalë jashtë rrethit të adhurimit, sepse **ajo që pranohet te Zoti, është në lidhje me istikametin në adhurim...**”



Bajezid Bistami kuddise sirruhu thotë:

“Nëse shikoni dikë që ulet këmbëkryq në ajër, mos besoni se kjo është një keramet, pa e parë se ai i ruan kufinj të urdhrave dhe të ndalesave hyjnore, pa e parë nëse ndjek Sunnetin dhe nëse i respekton ligjet e Zotit.”



Përsëri Hazreti Bajezid Bistami tregon:

Një ditë do të kaloja në anën tjetër të lumit Tigër. Kur arrita, të dy brigjet e lumit u bashkuan për të më bërë rrugë. Menjëherë e mblodha veten dhe i thashë Tigrin:

“Betohem se unë nuk mashtrohem ndaj kësaj, sepse barkëtarët i kalojnë njerëzit me gjysëm akçe, kurse ti do punën time tridhjetëvjeçare! Atëherë kurrë nuk mund t’i humb punët e mira të miat që i kam përgatitur për ahiretin në këmbim të një gjysëm akçeje. Mua më duhet Kerimi dhe jo kerameti!”



Një ditë nxënësit kishin kërkuar keramet nga Hazreti Shah Nakshibend. Hazreti u tha atyre:

“Kerameti ynë është i qartë. Ja shikoni; edhe pse kemi shumë peshe mëkati mbi supe, akoma mund të qëndrojmë në këmbë dhe mund të ecim në tokë. A ka keramet më të madh se ky?”



në misticizëm nuk është kerameti por istikameti, tha:

“Nëse dikush hyn në një kopësht, dhe nëse dëgjon se çdo gjethe e pemëve që është aty thotë, qoftë haptaz apo fshehtas: Tungjatjeta o miku i Allahut!, nuk duhet të gëzohet kurrë nga ky zë.”

Në lidhje me këtë, disa nxënës i thanë:

“O i Nderuar, sado që të fshiheni herë herë kerameti shfaqet nga ju!..”

Ai monument i modestisë së madhe dhe miku i Zotit tha:

“Ajo që shikoni ju janë kerametet e nxënësve të mi.”, sepse ai, me një gjendje në të cilën donte ta fshihte gradën e tij shpirtërore.

Për këtë arsye, sa ishte në jetë, ai nuk i dha leje nxënësit të tij Husameddin Haxhe Jusufit, që ti shkruante fjalët dhe kerametet e tij.

Të mëdhenjtë e Islamit kanë arritur grada të larta në rrugën e Zotit, duke e bërë gjithmonë ligj për veten e tyre istikametin dhe jo kerametin. Ata kanë thënë se për shkak të kerametit nuk kanë fituar më shumë vlerë se sa zogu që fluturon në ajër dhe peshku që noton në ujë. Ata janë shprehur me çdo mënyrë se dija shpirtërore e vërtetë është të jetosh në istikamet me ndërgjegjen e një adhurimi të lartë, duke fituar kënaqësinë e Allahut dhe jo duke u drejtuar te imitimi i asaj që bën zogu dhe peshku.

Ngaqë janë të pastër nga shtirja, miqtë e Zotit nuk shfaqin keramet pa qënë shumë të detyruar. Ata shfaqen ndaj njerëzve me përsosmëritë e një morali njerëzor që mund të merret si shembull.

Kjo këshillë që i ka dhënë Hazreti Hasan Basri njërit prej nxënësve të tij është shumë e rëndësishme:

“Mos u mashtro ndaj lartësisë së gradës së dijes, gjendjes dhe dijes shpirtërore! Kujto se çfarë i ka ndodhur Bel’am bin Bauras, kur ai arriti në një gradë të tillë sa të mun ta shikonte dhe ta lexonte Leuhu’l-Mahfudhin!”

Gjendja e tij mësimdhënëse shprehet kështu në Kur’anin Fisnik:



“...Por ai nuk iu largua kësaj bote dhe shkoi pas epshit të tij. Gjendja tij është si gjendja e qenit të cilin, nëse e përzë, ai e nxjerr gjuhën, edhe nëse nuk e përzë, ai sërish e nxjerr gjuhën. Kjo është gjendja e atyre që i konsideruan mashtrim argumentet Tona. Ti rrëfeja tregimet (ummetit tënd) në mënyrë që ata të mendojnë.” (el-A`raf, 176)

Hazreti Mevlana Halid Bagdadi thotë:

“Istikameti dhe përpjekja janë më të mirë se keshfi (shikimi me syrin e zemrës) dhe kerameti. Në mënyrë të veçantë duhet të dihet se nëse keshifi dhe kerameti nuk e shtojnë respektin ndaj urdhëra të fesë, nuk janë gjë tjetër përpos përçarje dhe bela.”



Qortimet e të Nderuarit Muhammed Es`adit rahmetullahi alejhi në lidhje me rëndësinë e istikametit, veçanërisht për liderët janë:

*“Qoftë dijetar, qoftë shejh, çdonjëri që nuk e vë në kokë çallmën e istikametit, në fund shkatërrohet dhe ikën.”*

*“Nëse kurrizi nuk të është forcuar dy herë nën peshën e istikametit, a e qëllon shigjeta e dëshirës pikën e afrimit të Allahu?”* (Divan, Stamboll, 1991, fq. 27)

Kur edhe zemrat e miqve të Zotit të cilët bëjnë keramete dridheshin të shqetësuar në çështjen e istikametit, le të mendojmë se sa të përpiktë duhet të jemi në këtë çështje ne besimtarët mëkatarë...



Së fundi, istikameti është i domosdoshëm për çdo besimtar, por është e vështirë ta mbashë dhe ta ruash. Nderi i një rezultati që fitohet, ngaqë ka lidhje me vuajtjet me të cilat duhet përballur për ta mbërritur, njerëzit e istikametit kanë fituar nder të madh dhe shpërblime të pa-fundme, si shpërblim i sakrificave të larta me të cilat e kanë paguar.





## 19. Mirënjohja dhe besnikëria

Mirënjohja dhe besnikëria janë dy nga dispozitat më të rëndësishme Islame, që e bëjnë njeriun të fitojë nderin njerëzor. Si cilësi që u përkasin Pejgamberëve, miqve të Zotit dhe të devotshmëve, ato janë veti të bukura shpirtërore që kurorëzojnë jetën njerëzore në shkallën më të lartë. Këto ndjenja të larta janë përbëjnë masën e vlerës që u jepet atyre që duhen apo që duhet të duhen. Ata që nuk e kanë ndjenjën e besnikërisë, janë njerëz egoistë, njerëz që mendojnë vetëm veten e tyre, për dëshirat dhe interesin e tyre.

Para së gjithash njeriu duhet të jetë besnik ndaj Zotit, gjë që bëhet e mundur vetëm duke i respektuar urdhërat e Tij. Allahu thotë:

**“Mos u bëni si ata që harruan Allahun dhe Allahu bëri që ata të harrojnë vetveten! Të tillët janë njerëz të devijuar.”** (el-Hashr, 19)

Pas besnikërisë ndaj Allahut, besnikëria më e lartë dhe më e domosdoshme është besnikëria ndaj Krenarisë së Gjithësisë, Hazretit Pejgamber sallallahu alejhi ue sellem. Kjo besnikëri është shfaqje e ndjenjave të falenderimit që ndjehen për Pejgamberin alejhissalatu uesselam, i cili në lutjet e Tij ndaj Allahut, së pari lutej për ummetin e Tij duke thënë: ummeti, ummeti. Kjo besnikëri e cila do të fillojë duke u thelluar në dashurinë ndaj Pejgamberit, është e mundur me zbatimin e Sunnetit të Lartë të Tij.

Çdo besimtar është i detyruar të jetë i mbushur me ndjenjën e besnikërisë ndaj të mëdhenjve të fesë, domethënë ndaj miqve të Zotit, sepse janë këta miq të Zotit ata që i sjellin tek ne moralin e bukur, urdhërat dhe ndalesat që ka shpallur Allahu dhe i Dërguari i Tij, kandilat madhështorë që ndriçojnë të dy botët tona.

Ata ndaj të cilëve duhet të kemi besnikëri, nuk janë vetëm ata që kemi numëruar këtu. Veçanërisht duhet ta vendosim në zemër besnikërinë ndaj miqve dhe vëllezërve në fe. Nga ana tjetër, besnikëria ndaj gjyshërve, ndaj tyre që janë gjallë dhe ndaj të vdekurve, ndaj shtetit dhe ndaj të gjitha amanete të popullit, është nga cilësitë e një karakteri dhe personaliteti të fortë.



Sa bukur e shpjegon Hazreti Mevlana mirësinë për të qënë mirënjohës dhe besnik:

*“Të gjitha çështjet, si dashuria dhe miqësia, janë të lidhura me besnikërinë dhe kërkojnë gjithmonë njerëz besnikë. Këto nuk i afrohen kurrë një zemre jobesnike.*

*Lapsi ka shkruajtur se Shpërblimi i besnikërisë është besnikëria dhe kundërvlera e tradhëtisë është tradhëtia. Dhe pastaj i është tharë boja.*

*Një padishah e vret atë që e tradhëton edhe nëse është biri i tij, por nëse një rob indian është besnik ndaj padishahut, zemrat drejtohen nga ajo zemër dhe i japin vlerë... nderin që e fiton ai, nuk e fitojnë me qindra vezirë.*

*Lëre robin, por edhe nëse edhe një një qen që rri përpara derës është besnik, në zemrën e të zotit të këtij qeni gjelbërojnë me qindra ndjenja kënaqësie ndaj tij dhe kështu ai e leshaton me dashuri...”*

### **Tabllo të virtytshme**

I Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem e ka shfaqur ndjenjën e besnikërisë së lartë që kishte ndaj tyre me fjalët:

*“Unë jam lutja e gjyshit tim Ibrahim, përgëzimi i vëllait tim Isa dhe ëndërra e nënës sime Amine.”*,<sup>93</sup> Gjatë udhëtimit, teksa po shkonte për në Mekke në vitin e Hudejbijes, i Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem ndaloi në Ebva. Duke kërkuar leje nga Zoti, Pejgamberi ynë i Nderuar vizitoi varrin e nënës së Tij. Gjatë vizitës ai rregulloi varrin e nënës me duart e Tij të bekuara dhe qau nga mallëngjimi. Myslimanët që e panë duke qarë, qanë edhe ata. Pastaj, atyre që e pyetën se përse

93. Ahmed, V, 262; Hakim, II, 453. Ibrahim alejhisselam ka bërë këtë lutje për Pejgamberin tonë të Nderuar: “Zoti ynë, dërgo nga gjiri i tyre të dërguar që t’u lexojë atyre ajetet e Tua, t’u mësojë atyre librin dhe urtësinë dhe t’i pastrojë (prej ndytësisë së idhujtarisë)!..” (el-Bakara, 129) Isai alejhisselam ka përgëzuar se pas tij do të vijë një pejgamber me emrin Ahmed. (es-Saff, 6) Ndërsa nëna jonë Amine, para se të lindte i Dërguari i Allahut, kishte parë në ëndërr një dritë që dilte nga ai dhe ndriçonte gjithësinë. (Ibn Sa’d, I, 102)



kishte vepruar kështu, Pejgamberi ynë i Dashur u tha: “*Qava se m’u kujtua butësia dhe mëshira që kishte nëna ime për mua.*” (Ibn Sa’d, I, 116-117; Veçanërisht shik. Muslim, Xhenaiz, 105, 108)



Kur i Dërguari i Allahut e nderoi këtë botë, jetonte zonja Suvejbe, e cila kishte një djalë që e quanin Mesruh. Për një kohë zonja Suvejbe i pati dhënë qumësht edhe Pejgamberit tonë të Nderuar.<sup>94</sup> I Dërguari i Allahut, i cili ishte një shembull besnikërie, në periudhat e mëvonshme të jetës është imteresuuar gjithmonë për zonjën Suvejbe. Kur ishte në Mekke, qoftë i Dërguari i Allahut, qoftë nëna jonë Hatixhe, e ndihmonin dhe e nderonin atë. Kur Drita e Ekzistencës u shpërngul për në Medine, i dërgonte gjithmonë ushqime dhe rroba zonjës Suvejbe dhe ia plotësonte asaj nevojat. Në vitin e shtatë të hixhretit, kur po ktheheshin nga lufta e Hajberit, i Dërguari i Allahut u lajmërua se ajo kishte vdekur. Ai pyeti:

“*Çfarë bën biri i saj Mesruh?*” I thanë:

“Ai ka vdekur para nënës së tij!”

Kur dëgjoji këtë, i Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem pyeti nëse kishte mbetur gjallë ndonj nga të afërmit e saj, por i thanë se nuk kishte ngelur asnjë. (Ibn Sa’d, I, 108, 109)



Gjatë gjithë jetës së tij, Hazreti Pejgamber alejhissalatu uesselam është sjellë besnik edhe ndaj të afërmëve të qumështit. Sa herë që e shikonte nënën e qumështit, zonjën Halime, ai thoshte: “Nëna ime e dashur! Nëna ime e dashur!”, E donte dhe e respektonte me gjithë shpirt, e shtronte rrobën e tij në tokë që ajo ulej mbi të dhe nëse ajo kishte ndonjë kërkesë, ia plotësonte menjëherë. (Ibn Sa’d, I, 113, 114)

Kur një ditë Pejgamberi ynë i Nderuar ishte ulur, erdhi bashkëshor-ti i nënës së qumështit të Tij. Për ta respektuar, i Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem, shtroi në tokë një pjesë të rrobës së Tij dhe e uli mbi të. Pas pak erdhi nëna e qumështit. Pejgamberi alejhissalatu

94. Ibn Sa’d, I, 108.



uesselam shpalosi për të edhe pjesën tjetër të rrobës, që ajo u ulej aty. Pas pak erdhi edhe vëllai i qumështit. I Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem u ngrit në këmbë dhe e uli përpara vetes.” (Ebu Davud, Edeb, 119-120)

Një ditë, zonja Halime kishte ardhur në Mekke për të parë Pejgamberin tonë të Nderuar. I Nderuari ynë atë kohë ishte martuar me Hazretin Hatixhe. Të dy e pritën me nderim dhe respekt të thellë zonjën Halime. Hazreti Halime po qahej nga thatësira dhe zia e bukës që ishte në vendin e saj dhe për shkak se po ngordhnin kafshët. Kur Krenaria e Gjithësisë, i Nderuari ynë ia tregoi gjendjen e saj Hazretit Hatixhe, nëna jonë Hatixhe i dhuroi asaj dyzet dele dhe një deve për t’i hipur dhe për të mbartur ngarkesë. Kështu, edhe nëna jonë Hatixhe e shfaqti besnikërinë që kishte ndaj të Nderuarit tonë. (Ibn Sa’id, I, 114)



Gjatë çlirimit të Mekkes, kur i Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem ishte në vendin Ebtah, vajza e zonjës Halime kishte ardhur për ta vizituar. Atij i dhuroi disa gjëra, mes të cilave një torbë me djathë të thatë dhe gjalpë. I Dërguari i Allahut e pyeti menjëherë për nënën e qumështit. Kur i tha se ajo kishte ndërruar jetë, sytë e Pejgamberit tonë të Nderuar u mbushën me lot. E pyeti se kush ka ngelur prej tyre. Pastaj urdhëroi që kësaj zonje t’i jepeshin rroba, një deve dhe dyqind dirhem argjendi. Kur gruaja e shkretë po kthehej e gëzuar në vendin e saj, thoshte:

“Ti edhe kur ke qënë i vogël edhe tani që je rritur, je një i afërm i mirë!” (Vakidi, II, 869; Belazuri, I, 95)



Në luftën e Hunejnit qe korrur një fitore e madhe dhe përveç ganimeteve ishin zënë, qenë kapur edhe shumë robër. Hazreti Pejgamber sallallahu alejhi ue sellem u njoftua se në mes të robërve ishte edhe motra e Tij e qumështit. I Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem dha urdhër menjëherë që t’ia sillin aty dhe kur ajo erdhi, ai nxori rrobën e tij dhe e shtroi përdhe që të ulej Hazreti Shejman. Duke treguar një besnikëri të madhe ndaj motrës së qumështit me të cilën ishte rritur



në shkretëtirë, ai u soll me butësi ndaj saj dhe i tha:

*“Mirë se erdhe!”* Iu kujtuan ditën e kaluara dhe sytë iu mbushën me lot. E pyeti për nënën dhe babain e saj. Shejma i tha se ata kishin ndërruar jetë. I Dërguari i Allahut e pyeti edhe për të afërmit e tjerë. Pastaj tha:

*“Nëse do, qëndro te Unë me dashuri dhe respekt! Nëse do, të jap mallra dhe të dërgoj te fisi yt! Për ty e bëj edhe këtë.”* Shejma tha:

“Ti më jep mallra dhe më dërgo te njerëzit e mi.” Paskëtaj ajo u bë myslimane. I Dërguari i Allahut i dha një deve dhe një dele Shejmas dhe pjesëtarëve të familjes së saj që ishin gjallë. Për më tepër zonjës Shejma i dha një burrë rob dhe një grua robinë, të cilët pastaj Shejma i martoi me njëri-tjetrin. (Ibn Hisham, IV, 101; Vakidi, III, 913)

Pas një farë kohe, Pejgamberi ynë i Nderuar lajmëroi se robërit që ishin nga vëllezërit e tij të qumështit, i kishte lënë të lirë në pjesën e tij dhe në pjesën që u takonte bijve të Abdulmuttalibit. Ashabëve u tha:

*“Kush prej jush kënaqet duke i gëzuar vëllezërit e tij, duke i dhënë robërit pa shkëmbim dhe me kënaqësi, le të veprojë kështu! Kush nuk dëshiron t’i japë pa shkëmbim robërit që i kanë rënë në pjesë, këtë do t’ua paguajmë nga ganimeti i parë që do të na e japë Allahu. Ai që do, mund të veprojë edhe kështu!”* Duke shfaqur një shembull të madh virtyti, ashabët e nderuar thanë:

“Edhe ne ia kemi dhuruar robërit tanë Pejgamberit të Allahut!” (Buhari, Megazi, 54; Ibn Hisham, IV, 134-135)

Kështu, me mijëra robër u kthyen atë ditë në Hevazin pa kërkuar asnjë shpërblim. Për shkak të ndjenjës së besnikërisë që kishte i Dërguari i Allahut, me mijëra njerëz u ngjallën dhe fituan besimin e lirinë.



Në moshën gjashtëvjeçare Drita e Ekzistencës alejhissalatu ues-salam shkoi në Medine bashkë me nënën e tij, që të vizitonte varrin e babait. Gjatë rrugës së kthimit, në fshatin Ebva ndërroi jetë edhe nëna e Tij. I Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem, duke ngelur



jetim edhe nga nëna, u kthye në Mekke me shërbëtoren e tyre Ummu Ejman radijallahu anha.

I Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem, gjatë gjithë jetës së Tij e vizitonte shpesh dadon e tij Ummu Ejmenin dhe e quante “Nënë!” Për këtë arsye e lavdëronte me fjalët: “Nëna pas nënës sime! Ky është i vetmi njeri që ka mbetur gjallë nga familja ime!” Në këtë mënyrë e shfaqte ai respektin dhe dashurinë që kishte për të.<sup>95</sup>



Bashkëshortje e Ebu Talibit, zonja Fatime, ishte një grua shumë e virtytshme dhe zemërmirë. Krenaria e Gjithësisë, i Nderuari ynë e vizitonte shpesh këtë grua të bekuar, e cila ishte nderuar me Islam, qe shpërngulur në Medine dhe në shtëpinë e saj bënte gjumin e paradites. (Ibn Sa'd, VIII, 222)

Kur zonja Fatime ndërroi jetë, të Dërguarit të Allahut sallallahu alejhi ue sellem i dolën lotët si perla nga sytë e tij të bekuar, këmishëm e tij ia bëri qefin duke thënë: “Sot ka vdekur nëna ime!”. Pastaj i fali namazin e xhenazes dhe u shtri në varrin e saj pak kohë. Atyre që e pyetën për shkakun e kësaj sjelljeje, u tha:

*“Askush nuk më ka bërë më mirë se kjo grua e shkretë, pas Ebu Talibit! Ia bëra këmishën timë qefin, që në ahiret të veshë nga rrobat e xhennetit. U shtriva në varr të saj pak kohë që të ngrohej!”*

Atyre që u habitën për shkak të pikëllimit të tij, i Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem u tha:

*“Ajo ishte nëna ime pas nënës sime. Ajo më jepte mua për të ngrënë, më krihte flokët dhe më lyente me vaj trëndafili në një kohë kur fëmijët e saj ishin të uritur dhe kishin rrudhur fytyrat. Ajo ishte nëna ime!”* Pastaj u lut për të:

*“Allahu të faltë dhe të shpërbleftë me të mira! Allahu të mëshiroftë o nëna ime e dashur! Ti ishe nëna ime pas nënës sime! Vetë rrije e uritur dhe mua më jepje për të ngrënë! Vetë nuk vishje dhe mua me jepje për të veshur! Veten tënde e privoje dhe mua më jepje gjërat më*



*të mira! Këtë e bëje duke shpresuar kënaqësinë e Allahut dhe ahiretin!..”* (Hakim, 116-117; Hejsemi, IX, 256-257; Ja'kubi, II, 14)



Aisheja radijallahu anha e tregon kështu besnikërinë që kishite Hazreti Pejgamber sallallahu alejhi ue sellem ndaj nënës sonë Hatixhes:

Për asnjërin nga gratë e Pejgamberit tonë të Nderuar nuk kam qenë xheloze sa për Hatixhen. Për më tepër atë nuk e kam parë fare. I Dërguari i Nderuar e kujtonte atë shpesh. Kur priste një dele dhe e copëtonte mishin, shumicën e rasteve ua dërgonte miqve të Hatixhes. Nganjëherë nuk rezistojta dot dhe i thoja të Dërguarit të Allahut:

“Sikur në këtë botë nuk ka ngelur grua përveç Hatixhes!”

Krenaria e Gjithësisë, i Nderuari ynë i numëronte veçoritë e saj dhe thoshte:

*“Ajo ishte kështu, kështu...” dhe “Fëmijët e mi janë nga ajo.”* (Buhari, Menakibu'l-Ensar, 20; Muslim, Fedailu's-Sahabe, 74-76)



Kur i Dërguari i Allahut dha urdhër që të varroseshin dëshmorët e Uhudit, për Amr bin Xhemuh dhe Abdullah bin Amr bin Haram radijallahu anhumu tha:

*“Ata në këtë botë ishin krah për krah me njëri-tjetrin dhe ishin shumë të sinqertë. Këta dy dëshmorë që e donin shumë njëri-tjetrin në këtë botë, i vendosni pranë njëri-tjetrit në të njëjtin varr!”* (Ibn Hisham, III, 49; Ibn Sa'd, III, 562)

Çfarë ndjenje e një besnikërie madhështore...



Ishte një njeri i zi që pastronte xhaminë e Profetit. Një herë, i Nderuari ynë nuk e pa më. U bë merak dhe pyeti se ku ndodhej ai. I thanë se kishte vdekur. Në lidhje me këtë, i Nderuari ynë i cili ishte një monument besnikërie, tha:



“A nuk duhej të më lajmëronit?” Pastaj duke thënë: “Më tregoni varrin e tij!”. Shkoi te varri i tij, i fali namazin e xhenazes dhe u lut për të. (Buhari, Xhenaiz, 67)



Kishin kaluar vite nga shpërngulja në Habeshistan. Një herë, përfaqësuesit e mbretit të Habeshistanit erdhën te i Dërguari i Nderuar. Pejgamberi sallallahu alejhi ue sellem u interesua nga afër me ata, madje u shërbeu vetë. Është shumë kuptimplote përgjigja që Pejgamberi ynë i Nderuar u dha sahabëve, të cilët thanë se mund t’u shërbenin ata:

*“Këta u kanë dhënë vend dhe i kanë nderuar ashabët e mi kur janë shpërngulur në Habeshistan. Edhe unë tani dua tu shërbej si shpërblim i kësaj.”* (Bejhaki, Shuabu’l-Iman, VI, 518, VII, 436)



Në muajin Rexhep, me kthimin nga Tebuku kishte vdekur Mbreti Habeshi. Atë ditë, pasi i njoftoi ashabët se kishte vdekur Mbreti, i Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem dhe tha:

*“Faleni namazin e xhenazes së vëllait tuaj që ka vdekur në vend të largët!”*

Ashabët pyetën:

“O i Dërguari i Allahut! Kush është ai?” Krenaria e Gjithësisë sallallahu alejhi ue sellem tha:

*“Është mbreti Ashama! Sot robi i devotshëm i Allahut vdiq! Kërkoni mëshirë nga Allahu për vëllain tuaj!” Pastaj i fali namazin (gijabi) e xhenazes.”* (Muslim, Xhenaiz, 62-68; Ahmed, III 319, IV 7)

Më vonë u mor vesh se Mbreti kishte vdekur pikërisht në atë ditë që lajmëroi i Dërguari i Allahut.



Pas çlirimit të Mekke, i Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem qëndroi pesëmbëdhjetë ditë aty. Në këtë kohë, disa nga Ensarët u





shqetësuan dhe filluan të mendojnë nëse Hazreti Pejgamber sallallahu alejhi ue sellem do të kthehej në Medine, apo jo, sepse Allahu Teala i kishte dhënë çlirimin e vendit të begatë dhe të shenjtë në të cilin ai kishte lindur dhe që rritur. Hazreti Pejgamber sallallahu alejhi ue sellem, i cili ishte duke u lutur në kodrën Safa, e ndjeu shqetësimin e Ensarëve të nderuar. Pasi mbaroi lutjen, shkoi te ata dhe i pyeti:

*“ Për çfarë po flisni?”*

Kur ata ia shprehën shqetësimin e tyre, i Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem, shfaqti një shembull të madh besnikërie, duke u thënë:

*“O Ensarë! I kërkoj mbrojtje Allahut që të bëj diçka të tillë. Unë jam shpërngulur në vendin tuaj. Jeta ime është jeta juaj, edhe vdekja ime do të jetë pranë jush.”*

Pas këtyre fjalëve, Ensarët u qetësuan. (Muslim, Xhihad, 84, 86; Ahmed, II, 538)



I Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem e tij nuk i ka nxjerrë kurrë nga zemra dhe nuk i ka harruar asnjëherë ashabët, të cilët kanë luftuar me pasurinë dhe me jetën e tyre në rrugën e thirrjes në Islam dhe të cilët ranë dëshmorë për hir të saj. Herë-herë shkonte te varrezat Xhennetu'l-Baki, herë-herë shkonte te varrezat e dëshmorëve të tjerë dhe lutej për ta. Ashabët e nderuar tregojnë:

Pejgamberi ynë i Nderuar doli në minbere dhe pasi tha shehade-tin, fjala e parë e tij ishte lutja e mëshirës nga Allahu për dëshmorët e Uhudit. (Ibn Sa'd, II, 228)

Pastaj, duke shfaqur besnikërinë që kishte ndaj Ensarëve, tha:

*“O njerëz! Njerëzit po shtohen, por Ensarët po pakësohen. Madje do të pakësohen sa kripa në gjellë. Çdokush nga ju, nëse vjen në krye të një punë që mund të dëmtojë apo të ndihmojë dikë, le t'i trajtojë mirë të mirët e Ensarëve dhe le t'i falë të këqinjët prej tyre.”* (Buhari, Menakibu'l-Ensar, 11)



*“Ju këshilloj që me Ensarët të silleni mirë, ata janë xhemati, shoqërit dhe besnikët e Mi. Ata i kanë kryer përsosmërisht detyrat që u kanë takuar. Ndërsa shpërblimi i shërbimeve të tyre akoma nuk është paguar. (Në ahiret do t’u paguhet me shumicë.) Për këtë arsye, pranojeni atë që bëjnë të mirët e tyre dhe lëreni atë që bëjnë të këqinj të tyre.”* (Buhari, Menakibu’l-Ensar, 11)



Hazreti Pejgamber sallallahu alejhi ue sellem nuk i ka harruar kurrrë edhe sakrificat që kanë bërë Muhaxhirët. Kur ashabëve të tij u jepte detyrë të rëndësishme, i kishte gjithmonë parasysht ata që e kanë ndihmuar Islamin në ditët e para, por Ebu Bekri radijallahu anhu kishte një vend të veçantë ndërmjet tyre. I Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem e shpreh kështu mirënjohjen që kishte për të:

*“Çdonjërit që na ka bërë mirë, ia kami paguar me të njëjtën masë, apo me më shumë, përveç Ebu Bekrit! Ai ka bërë aq shumë, sa që shpërblimin do t’ia japë Allahu Teala në ditën e kiametit. Pasuria e askujt nuk më ka dhënë aq shumë dobi sa pasuria e Ebu Bekrit. Sikur të kisha bërë një mik për vete, patjetër do të bëja Ebu Bekrin. (Duke pasur për qëllim veten e tij tha:) Djeni se shoku juaj është miku i Allahut.”* (Tirmidhi, Menakib, 15/3661)



Kur Ebu Bekri radijallahu anhu u bë halife, caktoi një njeri që të lajmëronte që, kush të kishte premtimin e Pejgamberit tonë të Nderuar, le të vinte dhe ta merrte, dhe i pagoi ato me mallrat që erdhën nga Bahrejni. (Buhari, Kefale, 3)

Edhe Hazreti Ali, pas vdekjes së të Dërguarit të Allahut, caktoi një njeri që të shpallte një lajm:

*“Kush ka ndonjë premtim të të Dërguarit të Allahut sallallahua lejhi ue sellem apo ndonjë borxh për të marrë, le të vijë te unë!”* Sa ishte gjallë, çdo vit vazhdonte të caktonte dikë për të thirrur në Mina në ditën e prerjes së kurbaneve. Çdokush që vinte me një kërkesë të tillë, i jepte çfarë të kërkonte. Pas Hazretit Ali radijallahu anhu, veproi



po kështu edhe Hazreti Hasan, e pas tij po ashtu Hazreti Husejn, derisa ra dëshmor. (Ibn Sa'd, II, 318)



Lidhja ndaj kujtimeve dhe besnikëria e Abdullah bin Omerit radijallahu anhu, ishte e njohur. Kjo sepse ai ecte nëpër rrugët ku dikur kishte kaluar i Dërguari i Allahut, duke menduar për Atë, ulej nën pemët ku ishte ulur edhe Ai dhe e kujtonte, i vadiste ato pemë pa marrë parasysh se ku janë, në mal apo në kodra, shfaqte dashurinë dhe besnikërinë e pashoq që kishte ndaj kujtimeve të të Nderuarit tonë.



Sa bukur e tregon Hazreti Feriduddin Attar gjendjen e atyre që tradhëtojnë duke anuar nga dëshirat e zakonshme vetjake e duke duke harruar mirësitë që i ka dhënë Allahu:

Padishahu kishte një qen që kishte fituar përkujdesjen e veçantë të tij. Në gjueti ishte mjeshtër. Padishahu e vlerësonte shumë dhe sa herë që dilte në gjueti, e merrte me patjetër me vete. Hallkat ia kishte zbukuruar me xhevahirë, ndërsa në këmbë i kishte lidhur byzylykë dhe r Rathë prej floriri e argjendi. Edhe kurrizin e kishte të mbuluar me një copë mëndafshi me argjend.

Një ditë padishahu e kishte marrë me vete kur kishte dalë për gjueti bashkë me parinë e sarajës. Sulltani kishte mbi kalë dhe ecte me dinjitet, rripin prej mëndafshi të hallkës e mbante në dorë dhe ndjehej shumë i gëzuar, por befasi ra diçka në sy që ia prishi gëzimin. Qeni që ai e donte aq shumë e kishte harruar padishahun dhe po merrej me diçka tjetër. Qeni vazhdoi të këmbëngulte në të veten, duke brejtur kockën që kishte përpara, edhe pse padishahu i mërzhitur e tërhoqi rripin që kishte në dorë. Përballë kësaj gjendjeje, Padishahu thërriti i habitur dhe i acaruar:

“Të merresh me diçka tjetër këtu përpara meje, duke më harruar mua! Çfarë është kjo?!”

Ai u mërzhit shumë. Mosmirënjohja, tradhëtia dhe pandjesia e qenit të tij e preku shumë. Edhe pse ishte një qen, nuk i bënte zemra



t'ia pranonte arsyen dhe ta falte. Fakti që qeni e harroi në një çast e thjesht për shkak të një kocke, përkundër gjithë atij nderi dhe mirësie, ishte shfaqje e një sjelljeje që plagos zemrën dhe lëkund besnikërinë. Nuk qe diçka që nuk mund të falej. I zemëruar, Padishahu tha:

“Jepini rrugë këtij të paedukati!”

Qeni e ndjeu kuptimin e kësaj ashpërsie, por gjithçka kishte mbaruar dhe nuk i mbetej asgjë për të bërë. Ata që ishin pranë padishahut i thanë:

“O sulltani ynë! T'ia marrim xhevahirët, florinjët dhe argjendin që ka sipër dhe ta lëmë ashtu!”

Por padishahu tha:

“Jo! Lëreni të shkojë ashtu!”

Pastaj shtoi:

“Lëreni të shkojë ashtu! Le të shkojë ashtu dhe të mbetet i vetëm, i uritur dhe pa ujë nëpër shkretëtirat e pazot, të nxehta e të zhveshura, ashtu që ta ndjejë vazhdimisht dhimbjen e mirësive dhe të nderimeve që ka humbur!..”

Sa mësimdhënëse është kjo histori që pasqyron gjendjen e atyre tradhëtarëve që shkatërrojnë veten duke ndjekur interesat e zakonshme dhe të përkohëshme, duke mos njohur vlerën e mirësive të pa-fundme që u ka dhënë Allahu.



Detyra për të shkruajtur kaligrafitë në kubben e Xhamisë Sulejmanije i qe caktuar kaligrafistit Karahisari. Karahisari iu vu punës me përkushtim të jashtëzakonshëm që t'i realizonte kaligrafitë në mënyrën më të mirë, ashtu siç i kishte hije madhështisë së xhamisë. U përkushtua aq shumë për t'ia arritur kësaj, sa që në çastin kur mbaroi korrigjimin e fundit të vijës së fundit, i iku drita e syve dhe iu mbyll dritarja e shikimit për të parë këtë botë.

Pasi përfundoi ndërtimi i xhamisë dhe ajo do të hapej për adhurim, Kanuni Sulltan Sulejman Hani tha:



“Nderi i hapjes së kësaj xhamie për adhurim i takon kryearkitektit tonë, Sinanit, i cili arriti ta ndërtonte me një madhësi të tillë dhe në një mënyrë kaq të përsosur.”

Arkitekt sinani i cili kishte mësuar të ishte modest para artit, por njëkohësisht edhe duke e treguar përmes pjekurisë së tij shpirtërore veprën e jashtëzakonshe që kishte bërë, në atë çast solli ndërmend sakrificën e kaligrafistit Karahisari. Kësisoj iu përgjigj Sulltanit me edukatë:

“O sulltani im! Kaligrafisti Karahisari i humbi sytë e tij dhe u verbua kur po zbukuronte me kaligrafi këtë xhami fisnike. Jepjani atij këtë nder!..”

Mes lotëve të njerëzve që gjendeshin aty, duke treguar mirënjohje të madhe, Kanuni dha urdhër që hapjen e xhamisë fisnike ta bënte kaligrafisti Karahisari.



Profesori im i persishtes, i ndjeri Jaman Dede, i cili u udhëzua për shkak të Mevlanës dhe Mesnevisë së tij në një kohë kur ishte kristian, u pyet:

“Përse flisni kaq shumë për Mevlanën dhe Mesnevinë e tij?” Ai tha:

“Biri im, Mevlana më ka kapur për dore. Ai u bë shkak për udhëzimin tim, duke më dërguar te dera e Hazretit Pejgamber. Madje është pak ta kujtoj kaq një njeri që më ka shpëtuar nga zjarri!”

Sa besnikëri e bukur dhe sa mendim i mprehtë!..



Babai dhe profesori ynë **Musa Efendi** kuddise sirruhu, ndërmjet të dashurve të tij ishte i njohur si “**Sahibu’l-Vefa**”. Disa nga ndjenjat e pafundme të besnikërisë së Hazretit Musa Efendi, mund t’i trasmetojmë kështu:

Ai prekej shumë kur shihte njerëz të vetmuar dhe të moshuar, të lënë vetëm në mënyrë të pabesë nga shoqëria, ballë për ballë me



vuajtjet e tyre, dhe thoshte:

“Këta të vetmuar duhet t’i marrim në shtëpinë tonë, por ne nuk kemi mundësi për këtë. Atëherë duhet të ndërtojmë një konvikt për ta.”. Herë-herë i vizitonte të vetmuarit dhe interesohej nga afër për nevojat e tyre.

Zemra e tij shtrihej deri te karakteri i maceve në kopësht dhe secilën e trajtonte sipas besnikërisë dhe mëshirës që kishte ndaj koteleve të tij, duke i emërtuar sipas cilësive të tyre.

Një infermiere që më ka shërbyer mua, e kishte kërkuar, e kish gjetur dhe nderuar edhe pas pesëdhjetë e pesë vjetësh.

Veçanërisht besnikëria që kishte për profesorin e tij **Sami Efendin**, ishte bërë legjendë. Vendi i parë që vizitonte në ditët e festave, ishte shtëpia e Sami Efendiut. Edhe kurbanët e parë i priste për të. Ishte kryesisht ai i cili bëhej shkak që shpirtit të tij t’i lexoheshin hatme. Hatmet fisnike që lexoheshin çdo vit për profesorin e tij, nga ana e atyre që e donin, ia gëzonin shumë zemrën e tij besnike.

Së fundi ai, në çështjen se “kush dhe si duhet të jetë besnikëria e atyre që duhen” ai na ka mësuar neve një dashuri shembullore si të Ebu Bekrit radijallahu anhu, me sjelljet e bukura që ia kishin zbukuruar jetën.

**Allahu na i dhuroftë edhe neve këto ndjenja të bukura të tyre!**

**O Zoti im! Na bëj prej grupit të të devotshmëve duke u dhuruar zemrave tona ndjenjat e bukura të besnikëve! Na bëj prej banorëve të xhennetit Naim, duke u dhënë veprave tona besnikëri dhe sinqeritet. Të devotshmëve nga brezat tanë dhe pasardhësve tanë jepu fëmijë që do të behën drita e syve dhe gëzimi i zemrave! Na bëj të gjithëve besnikë ndaj Teje, ndaj të Dërguarit Tënd, ndaj nënës dhe babait, ndaj të afërmeve, ndaj besimtarëve, ndaj atdheut dhe popullit dhe ndaj të gjitha amaneteve të tjera! Na bëj të jetojmë në klimën e kënaqësisë fisnike në të dy botët!**

Amin!..



## 20. Nderi dhe turpi

Nder do të thotë ta ruash veten që të mos mashtrohet nga çdo lloj epshi dhe nga dëshirat e këqia. Nderi është një veçori e njeriut dhe njëkohësisht vetia më dalluese që e ndan njeriun nga krijesat e tjera. Të të humbasë nderi do të thotë të të humbasë vlera njerëzore dhe të biesh në gjendje të njëjtë me krijesat e tjera.

Nderi është damari i jetës për të gjitha virtytet dhe moralin. Vetitë si morali, nderimi dhe respekti, janë të lidhura me nderin.

Dy vetë që kanë arritur kulmin në çështjen e nderit, Allahu i ka lavdëruar dhe i ka treguar si shembuj për besimtarët. Njëri është Jusufi alejhisselam historia e të cilit, si “historia më e bukur”, shtjellohet në suren Jusuf , ndërsa tjetra është Hazreti Merjem alejhasselam, për të cilën flitet me lavdërim në vende të ndryshme. Në ajetin fisnik thuhet:

**“(Përkujto) Edhe atë që e ruajti nderin e saj, Ne e frymëzuam me shpirt nga ana Jonë. Atë dhe birin e saj e bëmë mrekulli për njerëzit.”** (el-Enbija, 91)

Burrat dhe gratë që e ruajnë nderin e tyre, do të fitojnë faljen e gjërë të Allahut Teala.<sup>96</sup> Allahu i lavdëron kështu robërit e Tij të ndershëm:

**“Dhe ata të cilët e ruajnë nderin e tyre, përveç ndaj grave të veta (me kurorë) dhe ndaj (robërshave) që i kanë në pronësinë e vet, për të cilat nuk janë të qortuar. Atëherë kush kërkon jashtë këtyre (dëfrim nga të ndaluarat), këta janë ata që i kanë shkelur normat e caktuara.”** (el-Mu'minun, 5-7)

Ashtu siç u ka mësuar njerëzve bazat e besimit dhe të adhurimit, Pejgamberi ynë i Nderuar u mësonte atyre edhe bazat e moralit, si drejtësinë, nderin dhe mbrojtjen e të afërmëve. Po ashtu, kur perandori Bizantin Heraklius e pyeti Ebu Sufjanin se “Çfarë u urdhëron njerëzve i Dërguari i Allahut”, Ebu Sufjani u përgjigj: “U urdhëron që të jenë të drejtë, të ndershëm, të kujdesen dhe të mbrojnë të afërmit”.

96. Shik. el-Ahzab, 35.



(Buhari, Bed'u'l-Vahj 6, Salat 1; Muslim, Xhihad 74)

I Dërguari i Allahut i jepte aq shumë rëndësi nderit, sa që veçanërisht grave u merrte besën në çështjen e ruajtjes së nderit.<sup>97</sup> Ai, duke iu drejtuar të gjithë besimtarëve, thotë:

*“Kush më jep fjalën se do ta ruajë atë që ka në mes dy nofullave (gjuhën) dhe nderin e tij, edhe unë i premtoj xhennetin.”* (Buhari, Rikak, 23)

Nga ana tjetër, sundimi i turpit, nderit, pastërtisë dhe njerëzillëkut mes burrave dhe grave është një çështje shumë e rëndësishme, sepse Islami i ka ndaluar të gjithë punët e këqia, paturpësinë dhe imoralitetin.

Lidhja dhe dashuria në mënyrë të paligjshme mes një burri dhe një gruaje fillon me “shikimin”. Për këtë arsye, është urdhëruar që burrat dhe gratë myslimane të mos e shohin njëri-tjetrin me epsh, ndërsa kur të flasin, ta mbajnë kokën të ulur përpara:

**“Thuaju besimtarëve të ndalin shikimet (nga harami), të ruajnë pjesët e turpshme të trupit të tyre, sepse kjo është më e pastër për ta. Allahu i di shumë mirë atë që veprojnë ata.**

**Thuaju edhe besimtareve të ndalin shikimet e tyre, të ruajnë pjesët e turpshme të trupit të tyre. Të mos i zbulojnë stolitë e tyre përveç atyre që janë të dukshme. Le t’i vendosin shamitë mbi kraharorin e tyre dhe të mos ua tregojnë bukuritë e tyre askujt përveç burrave të tyre, baballarëve të tyre ose baballarëve të burrave të tyre, djemve të tyre ose djemve të burrave të tyre, vëllezërve të tyre ose djemve të vëllezërve të tyre, apo djemve të motrave të tyre, ose grave (besimtare) dhe robëreshave të cilat i kanë në pronësinë e tyre, ose shërbëtorëve nga meshkujt të cilët nuk ndiejnë nevojë për femrat ose fëmijët të cilët nuk e kanë arritur moshën e pubertetit. Le të mos kërcasin me këmbët e tyre për të zbuluar stolitë e tyre. O besimtarë! Pendohuni të gjithë te Allahu, në mënyrë që të shpëtoni.”** (en-Nur, 30-31)

Përveç se u drejtohet nënave të besimtarëve, ky ajet fisnik prek edhe çështjet ndaj të cilave duhet të kenë kujdes edhe gratë e tjera:





**“O gratë e Pejgamberit! Ju nuk jeni si gratë e tjera. Nëse keni frikë (Allahun), mos flisni në një mënyrë tërheqëse (përballë burrave të huaj) e të shpresojë ai që ka sëmundje në zemrën e tij. Flisni fjalë të matura. Rrini në shtëpitë tuaja e mos shfaqni bukurinë tuaj siç shfaqej në injorancën e hershme. Faleni namazin, jepni zekatin dhe respektojini Allahun dhe të Dërguarin e Tij. O familje e shtëpisë (së Pejgamberit)! Allahu dëshiron t’ju largojë nga mëkatet dhe t’ju bëjë shumë të pastër.”** (el-Ahzab, 32-33)

Edhe në një ajet tjetër fisnik thuhet:

**“O Pejgamber! Thuaju grave të tua, bijave të tua dhe grave të besimtarëve që t’i vendosin shamitë (mbulojë) e veta mbi trupin e tyre. Kjo i bën të njihen (si gra të ndershme) dhe të mos ofendohen. Allahu është falës dhe mëshirues.”** (el-Ahzab, 59)

Kur burrat dhe gratë e huaja të kërkojnë diçka nga njëri-tjetri ose kur t’ju thonë diçka, këtë duhet ta bëjnë pas derës apo pas perdes, sipas mundësisë që kanë.<sup>98</sup>

Njerëzit nuk duhet të hyjnë në shtëpitë e njëri-tjetrit pa leje. Madje edhe pjesëtarët e familjes, kur të hyjnë në dhomat e njëri-tjetrit, duhet të hyjnë duke marrë leje dhe duke i lajmëruar, sepse Allahu njofton se sjellja e ndershme është më e mirë.<sup>99</sup>

Allahu i jep shumë rëndësi faktit që robërit e Tij të jenë të ndershëm dhe këtë e shpreh në shumë ajete.<sup>100</sup> Për këtë arsye, të shpifësh ndaj njerëzve të ndershëm është pranuar si mëkat i madh, ndërsa ndaj shpifësve është zbatuar “ndëshkimi i shpifjes”. Allahu thotë:

**“Vërtet, ata që akuzojnë (për prostitucion) gratë e ndershme, besimtare të pafajshme, janë të mallkuar në këtë botë dhe në botën tjetër dhe ata i pret një dënim shumë i madh.”** (en-Nur, 23)

Për këtë arsye, edhe Pejgamberi ynë i Nderuar ka thënë; *“...Mos e akuzoni për prostitucion një grua të ndershme!..”* (Tirmidhi, Isti’zan, 33/2733)

98. Shik. el-Ahzab, 53.

99. Shik. en-Nur, 27, 58-60.

100. Shik. en-Nisa, 25; el-Maide, 5; el-Enbija, 91; en-Nur, 4, 23; et-Tahrim, 12.

Me të vërtetë, vetia dalluese e një gruaje është nderi. Edhe parajmërimet e mësipërme tregojnë peshën e fajit të shpifjes që bëhet ndaj nderit. Sipas kësaj, në çdo lloj situatë dëshmie, t'i përcjellësh pa i shqyrtuar ato që dëgjon, duke i lënë njerëzit nën akuzë për nderin dhe namusin, përbën nga fajet më të mëdha.

Në çështjet të tjera, veçanërisht në çështjen e të kërkuarit diçka nga njerëzit, duhet të sillemi në mënyrë të ndershme. Allahu i lavdëron kështu robërit e Tij të ndershëm:

**“(Jepni) për të varfërit që janë të angazhuar në rrugën e Allahut dhe nuk kanë mundësi të ecin për të kërkuar fitimin e tyre në tokë. Ata nuk lypin, prandaj ai që nuk e di gjendjen e tyre, mendon se ata janë të pasur. Ata i njeh nga vetë pamja e tyre (të raskapitur), por nuk kërkojnë e as nuk i mërzhisin njerëzit. Pra, çfardo që të jepni nga pasuria, s’ka dyshim se All-llahu e di mirë.”** (el-Bakara, 273)

Hazreti Pejgamber sallallahu alejhi ue sellem ka thënë:

*“I varfër nuk është ai që lyp një apo dy hurma, një apo dy kafshata. I varfër është ai i cili heq keq kur ka nevojë dhe nuk kërkon gjë nga askush, për shkak të nderit dhe të njerëzillëkut të tij. Nëse kërkon, lexoni ajetin; ...Nuk kërkojnë gjë nga njerëzit me këmbëngulje...”* (el-Bakara, 273) (Muslim, Zekat, 102)

*“Banorët e xhennetit janë tri grupe: I drejti, ai që jep në rrugë të Allahut dhe kryetari i suksesshëm i shtetit, ai që është i mëshirshëm dhe zemërbutë ndaj të afërmëve dhe myslimanëve, myslimani i ndershëm i cili edhe pse ka një familje me shumë anëtarë për të mbajtur, nuk kërkon asgjë nga askush dhe largohet nga fitimi haram.”* (Muslim, Xhennet, 63)

*“Ata që nuk duan të lypin, Allahu i bën të ndershëm. Edhe ata që duan të sillen syngopur kundrejt popullit, Allahu i shpëton nga nevoja që mund të kenë për njerëzit.”* (Buhari, Zekat, 18)

Ndërsa turpi, i cili është një degë e besimit, ka kuptimin e të qëndruarit larg gjërave të këqia, i të qenit i matur në sjellje dhe i të mostepëruarit në asnjë çështje. Ndjenja e turpit është themeli i të gjithë të



mirave dhe është e kundërta e gjithçkaje të keqe dhe të shëmtuar.

Krenaria e Gjithësisë, i Nderuari ynë thotë kështu për turpin, i cili është një veti që Allahu e do:

*“Turpi është nga besimi!”* (Buhari, Iman, 3)

*“Turpi dhe besimi janë bashkë, kur ikën njëri, ikën edhe tjetri!”*  
(Sujuti, I, 53)

*“Turpi sjell vetëm të mirë.”* (Muslim, Iman, 61)

*“Fjala e keqe nuk sjell asgjë përveç së keqes! Ndërsa turpi dhe edukata e zbukurojnë vendin ku hyjnë.”* (Muslim, Birr, 78)

*“O Zoti im! Kërkoj nga Ti udhëzim, devotshmëri, nder dhe pasuri shpirtërore.”* (Muslim, Dhikr, 72)

Njeriun vetëm virtyti i turpit mund ta ndalë nga çdo lloj gjëje e keqe dhe nga mendimet egoiste. Ndikimi i edukatës dhe i turpit në çështjen për ta ruajtur besimtarin, janë më të forta se qindra ligje dhe qindra forca të policisë. Në lidhje me çdo lloj çështjeje, një njeriu të ndershëm dhe të turpshëm është e mjaftueshme t'i thuash: “A nuk ke turp?”.

Hazreti Osman radijallahu anhu kishte një personalitet të lartë që përbënte shembull në aspektin e ndjenjës së turpit dhe turpërimit. I Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem ka lajmëruar se edhe ëngjëjt bëhen turp nga Hazreti Osman.<sup>101</sup>

Allahu i kritikon kështu ata që nuk janë të turpshëm dhe ata të cilët duan të përhapet paturpësia:

**“Ata të cilët dëshirojnë që te besimtarët të përhapet amoraliteti, i pret një dënim i dhembshëm në këtë botë dhe në botën tjetër...”** (en-Nur, 19)

Ata të cilët duan që paturpësia të shpërndahet në shoqëri, ndaj vendit dhe popullit të tyre, kanë bërë të keqen më të madhe. Ata që veprojnë kështu, edhe vetë bien në dëmet më të mëdha, sepse paturpësia, sipas lajmërimit të Pejgamberit tonë të Nderuar, është shkak për tu shkatërruar:

101. Ahmed, I, 71; VI, 155.



*“Pa dyshin se, kur Allahu i cili është Aziz dhe Xhelal, dëshiron të shkatërrojë një rob të Tij, i merr turpin. Kur ia merr turpin, ai rob bëhet njeri agresiv. Kur bëhet agresiv, i hiqet besnikëria. Kur i hiqet besnikëria, ai bëhet vetëm tradhëtar. Kur bëhet tradhëtar, i hiqet mëshira. Kur t’i hiqet mëshira, ai vetëm mallkohet dhe bëhet i mallkuar. Kur të mallkohet dhe kur të bëhet i mallkuar, lidhja që kishte me Islamin, këputet!”* (Ibn Maxhe, Fiten, 27)

### ***Tabllo të virtytshme***

Ebu Said el-Hudri radijallahu anhu thotë:

*“Pejgamberi ynë i Nderuar kishte më shumë turp se sa një vajzë e re që kishte hyrë në kohën për t’u mbuluar. Kur shikonte diçka që nuk e pëlqente, kjo gjendje vihej re menjëherë në fytyrën e Tij të bekuar.”* (Buhari, Menakib, 23; Ebu Davud, Haraxh, 34-36)

Hazreti Pejgamber sallallahu alejhi ue sellem nuk ka folur kurrë me zë të lartë. Ai kalonte ngadalë pranë njerëzve dhe duke buzëqeshur. Kur dëgjonte një fjalë që nuk e pëlqente, nuk u thoshte gjë njerëzve në fytyrë. Po për shkak se fytyra i shpërfaqte qartazi ndjenjat, ata që ishin pranë tregoheshin të kujdesshëm me fjalët dhe veprat e tyre. Ai nuk qeshte me të madhe për shkak të turpit, edukatës dhe njerëzillëkut që kishte. Ai vetëm buzëqeshte. Në hadithin fisnik thuhet:

*“Turpi është nga besimi dhe ai që është i turpshëm është prej banorëve të xhennetit! Ndërsa paturpësia është nga ngurtësia e zemrës, ai që e ka zemrën e ngurtë, është prej banorëve të xhehennemit!..”* (Buhari, Iman, 16)



Për shkak të ndjenjës së lartë të turpit që kishte, i Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem nuk ia ngulte sytë fytyrës së dikujt dhe nuk e shikonte me vërejtje. (Munavi, V, 224)



Gjyshi i Behz bin Hakimit erdhi te i Dërguari i Allahut dhe e pyeti për çështjen e mbulimit të vendeve të turpshme. I Nderuari ynë i tha:

*“Ruaji vendet e turpshme nga gjithkush, përveçse nga gruaja dhe ajo që ke nën pronësi!”* Pyetjes së të njëjtit person, nëse mund të sillej lirshëm në një vend ku nuk ka njeri, iu përgjigj në këtë mënyrë:

*“Allahu meriton që të kihet turp prej tij më shumë se sa prej njerëzve.”* (Ebu Davud, Hammam, 2/4017)

Një një hadith tjetër fisnik ka thënë:

*“Largohuni nga lakuriqësia! Pranë jush ka ëngjëj që nuk ju ndahen kurrë. Këta largohen vetëm kur robi të hyjë në tualet dhe kur t'i afrohet gruas së tij. Kini turp dhe silluni mirë ndaj tyre.”* (Tirmidhi, Edeb, 42/2800)



Pa dyshim se i Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem ishte ai i cili kishte më shumë turp ndërmjet njerëzve. Ai ishte i dalluar me këtë veti të lartë edhe para profetësisë, në një kohë kur të gjithë njerëzinë e kishte kapluar imoraliteti. Ja një nga shembujt më të bukur në lidhje me këtë:

Kur po rindërtohej Qabja, Krenaria e Gjithësisë, i Nderuari ynë po mbarnte gurë bashkë me xhaxhain e tij Hazretin Abbas. Abbasi radijallahu anhu, Me qëllim që të Nderuarit tonë të mos i vriteshin nga gurët supet e zbuluara, i tha:

*“Vëre rrobën tënde mbi supet!”* Kur i Nderuari ynë deshë ta vendosë rrobën mbi supet, ajo ra në tokë. Atëherë, duke i drejtuar sytë nga qielli, i tha xhaxhait të tij:

*“Më trego ku është rroba ime!”* Pastaj ai e mori atë menjëherë dhe mbuloi trupin. (Buhari, Haxh, 42)



Një ditë, Krenaria e Gjithësisë, i Nderuari ynë pa një njeri që po merrte gusull (pastrim i plotë i trupit) lakuriq në një vend të hapur. Duke dalë në minbere, ai tha në lidhje me këtë:



*“Allahu azze ue xhelle është shumë i turpshëm dhe është shumë i fshehtë. Për këtë arsye e do turpin dhe mbulimin. Atëherë, kur ndonjëri prej jush të marrë gusull, le të mbulohet.”* (Ebu Davud, Hammam, 1/4012)



Misver bin Mahreme radijallahu anhu tregon:

Mora një gur të rëndë dhe e solla. Mbi supe kisha një rrobë të lehtë. Guri e kishte shqyer rrobën. Nuk e lashë gurin, por e mbarta në atë mënyrë. Mbi këtë, i Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem më tha:

*“Shko dhe merre rrobën! Mos ecni kështu lakuriq!”* (Muslim, Hajd, 78; Ebu Davud, Hammam, 2/4016)



Ibn Mes'ud radijallahu anhu transmeton:

Një ditë Pejgamberi ynë i Nderuar tha:

*“Kini turp nga Allahu ashtu siç duhet!”* Ne thamë:

*“O i Dërguari i Allahut! Ne kemi turp nga Allahu elhamdulillah!”*  
Mbi këtë i Nderuari ynë na qortoi:

*“Ajo që doja të them, nuk është turpi që dini ju. Të kesh turp nga Allahu, do të thotë të ruani kokën dhe organet që janë në të, të ruani trupin dhe organet e tij, të kujtoni vdekjen dhe se do të kalbeni në tokë. Kërkoni ahiretin dhe zgjidhni ahiretin në këtë jetë, duke i lënë stolitë e kësaj bote. Ja, kush i zbaton këto që thashë, ka turp nga Allahu ashtu siç duhet.”* (Tirmidhi, Kijamet, 24/2458)

Hazreti Xhunejd Bagdadi ka thënë:

*“Turpi është të parët e mirësive të pafundme të Zotit dhe të kuptuarit se sa i mangët je ndaj këtyre mirësive.”*



Egjiptin e komandonte familja e Faraonit. Këta ishin njerëz dhunues dhe mendjemëdhën. Kur nga kufinj të në qytet hynte ndonjë



grua e huaj dhe e bukur, menjëherë lajmërohej Faraoni. Nëse ishte e martuar, burri i ekzekutohej, nëse kishte vëllain, gruan e kërkonin nga vëllai. Kur Ibrahim alejhisselam bashkë me nënën tonë Sarën kaluan kufirin, përsëri lajmi shkoi në saraj. U lajmërua se një grua e bukur hyri në Egjipt. E morën nënën tonë Sarën dhe e dërguan në saraj. Në lidhje me këtë çështje, në një hadith fisnik thuhet:

*“Kur Sara hyri në saraj, menjëherë mori abdest dhe filloi të falë dy rekatë namaz. Kur e mbaroi namazin, iu lut Allahut:*

*O Zoti im! Nëse jam një rob që të kam besuar Ty dhe Pejgamberit Tënd, që e kam ruajtur nderin tim me përpikmëri përveçse nga bashkëshorti im, më shpëto nga ky qafir!”* (Buhari, Buju', 100)

Faraoni deshi t'i afrohet Sarës. Befas iu ndërpre fryma. U paralizua, sepse Allahu po e mbronte Sarën nga e keqja e tij. Kjo ndodhi disa herë.

Faraoni e la të lirë nga frika. Edhe robëreshën e tij Haxherin ia dha asaj dhuratë. Atyre që kishte pranë dhe që po habiteshin, u tha:

“Kjo grua është një xhind. Nëse qëndron edhe pak pranë meje, unë pothuajse do të shkatërrohem fare. Unë i dhashë asaj Haxherin që të mbrohem nga e keqja e saj.”<sup>102</sup>

Sa shembull i bukur në lidhje me mbrojtjen e nderit, turpit dhe edukatës...

Në ajetin fisnik thuhet:

**“Kërkoni ndihmë nga Allahu me durim dhe namaz...”** (el-Bakara, 45)



Njëra nga gratë e Ensarëve, kishte shkuar te një argjendar çifut për të blerë. Çifuti veproi në një të mënyrë të atillë që e njolloste nderin e gruas myslimane dhe u soll imoralisht me të. Kur dëgjoji klithmën e gruas, një mysliman që po kalonte atje erdhi menjëherë e rrahu çifutin për të mbrojtur gruan. Por zënka nuk u ndal me aq. Atëherë mys-

102. Shik. Muslim, Fedail, 154.



limani e mposhti çifutin dhe e vrau. Pastaj, çifutët që u mblodhën aty e martirizuan atë mysliman. Mjedisi u ngatërrua keq dhe marrëveshja që ishte bërë me çifutët, u prish plotësisht.

Në lidhje me këtë çështje, i Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem i mblodhi çifutët dhe u tha:

*“O bashkësia çifute! Kini frikë nga Allahu! Bëhuni myslimanë dhe kini frikë që të mos ju ndodhë ndonjë e keqe siç u ndodhi Kurejshëve, sepse ju e dini që unë jam një pejgamber i dërguar nga Allahu. Këtë e shikoni në librin dhe në premtimin që Allahu ju ka dhënë.”*

Pastaj propozoi që të rinovonin marrëveshjen, por përgjigja e çifutëve ishte e paedukatë. Mbi këtë Pejgamberi ynë i Nderuar u shpalli luftë fisit Beni Kajnuka.<sup>103</sup>

Ja pra, kaq i rëndësishëm është nderi i një gruaje myslimane.



Ebu Shehm radijallahu anhu rrëfen:

Në Medinë, pranë meje po kalonte një vajzë e re. E kapa për qafe. Pastaj e lashë. Kur agoi, i Dërguari i Allahut po u merrte besën njerëzve. Edhe unë shkova pranë Tij. Mua nuk ma mori besën dhe më tha:

*“A ka ardhur ai që kap dhe tërheq për qafe?”* Unë i thashë:

*“Për Zotin nuk do ta bëj më atë gjë.”* Atëherë i Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem e pranoi besën. (Ahmed, V, 294)



Kur po kalonte pranë një myslimani që po këshillonte vëllain e tij ta linte turpin, për shkak se ai ishte shumë i turpshëm, i Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem i tha:

*“Lëre atë në hallin e tij, sepse turpi është nga besimi.”* (Buhari, Iman 16, Edeb 77; Muslim, Iman 57-59)





Ummu Hallad ishte një nga zonjat sahabie Medinase. Birin e saj e kishte dërguar në luftën që po bëhej me çifutët Beni Kurejdha. Disa myslimanë të cilët dëgjuan se ushtarët e Islamit po ktheheshin dhe moren vesh se Halladi kishte rënë dëshmor, shkuan te shtëpia e Ummu Halladit dhe e lajmëruan për atë që i kishte ndodhur birit të saj. Kjo grua myslimane mori shaminë e saj dhe vrapoi për te i Dërguari i Nderuar që ta pyeste për fatin e djalit të saj. Dikush aty që e pa me shami, i tha i habitur:

“Halladi vdiq, kurse ti akoma merresh me shaminë!”

Ummu Hallad dha një përgjigje të shkëlqyer që shpërfaq mendimin dhe pikëpamjen e jetës së një gruaje myslimane:

**“Nëse kam humbur Halladin, turpin nuk e kam humbur!”**

Kur e lajmëruan Pejgamberin për këtë përgjigje të Ummu Halladit, i Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem, tha:

*“Për Halladin ka dy sevape dëshmori.”* I thanë:

“Përse o i Dërguari i Allahut?” Ai tha:

*“Sepse ata e kanë vrarë ehli kitab (çifutët).”* (Ibn Sa’d, III, 531; Ibnu’l-Esir, Usdu’l-Gabe, II, 140)



Te Hazreti Aishe radijallahu anha kishte ardhur një grup grashë nga Shami. Hazreti Aishe tha:

“Ju më duket se jeni nga vendi ku gratë hyjnë në hamam (dhe nuk kanë kujdes për mbulimin)!” Gratë u përgjigjën; “Po!”. Hazreti Aishe tha:

“Unë kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut sallallahu alejhi ue sellem të thotë; *Çdo grua që e nxjerr rrobën e saj në një vend jashtë shtëpisë së saj, e ka shqyer perden mes Allahut dhe saj.* (Ebu Davud, Hammam, 1/4010; Tirmidhi, Edeb, 43/2804)

Një grua e cila sillet kështu, e ka shqyer perden e edukatës dhe të turpit, sepse Allahu Teala e ka urdhëruar që të ruhet me rrobën e devotshmërisë. Ndërsa duke bërë këtë, ajo e ka shkelur edhe urdhërin e



Allahut për mbulimin edhe urdhërin e devotshmërisë.



Gruaja e Ferezdakut, i cili ishte një nga tre poetët satirikë më të mëdhenj në kohën e Emevime, kishte vdekur. Në ceremoninë e varrosjes gjendej edhe Hasan Basri. Duke treguar me gisht nga varri, Hazreti Hasan Basriu e pyeti këtë poet që i njolloste njerëzit dhe trondiste nderin me poezitë e tij:

“Çfarë ke përgatitur për ahiretin?” Poeti i vjetër tha:

“Që prej shtatëdhjetë vjetësh kam përgatitur shehadetin.” Pasi Hasan Basri tha

“Sa përgatitje e bukur!” Pastaj shtoi:

“Por shehadeti ka kushtet e tij. Për këtë arsye, ki kujdes dhe mos shpif për gratë e ndershme!”

Dikush i kishte thënë Vehb bin Munebbihut:

“A nuk është La ilahe illallah çelësi i xhennetit?” Ai është përgjigjur:

“Po, ashtu është, por a funksionon çelësi pa dhëmbë? Nëse ke çelës me dhëmbë, dera të hapet, përndryshe mbetet e mbyllur dhe nuk hapet.” (Buhari, Xhenaiz, 1)

Dhëmbët e çelësit të teuhidit (njësimit) gjenden te mirësitë dhe te punët e mira.



Në shtetin Osman nderi dhe morali i njerëzve ishte nën siguri. Për shembull, pas çlirimit të Bosnjes, Fatihu lëshoi një urdhër të ri:

“Kini kujdes, kur vajzat serbe të vijnë te çezma për të mbushur ujë, ushtarët e mi të mos gjenden aty!..”

Përmes këtij urdhëri Fatihu mbrojti edhe ushtarët e tij, edhe nderin kristjaneve që ishin nën sigurinë e tij.



Në kohën e Kanunit, në Francë sapo kishte filluar të dalë në shesh paturpësia dhe çnjerëzimi nëpërmjet asaj që quhej dans. Me ta dëgjuar këtë, Kanuni i dërgoi menjëherë mbretit të Francës këto urdhëra:

*“...Kam dëgjuar se në vendin tuaj është shpikur një lloj zbatimje e poshtër që quhet dans, që është kundër moralit dhe turpit dhe që e bëjnë gratë dhe burrat duke u përçafuar me njëri-tjetrin përpara popullit. Kjo poshtërsi ka mundësi të vijë edhe në vendin tonë, për shkak se jemi në kufi. Nisur nga kjo, duhet t'i jepet fund kësaj poshtërsie, sapo t'ju arrijnë urdhërat e mi. Përndryshe vij unë dhe sigurisht që kam mundësi ta zhduk atë poshtërsi.”*

Historiani Hammer shkruan se nga efekti i kësaj letre, në Francë është ndaluar dansi plot njëqind vjet.



Janë shumë të njohur **Gurët e lëmoshës** që kishin vendosur gjy-shërit tanë në disa lagje të Stambollit të vjetër, për të mos thyer zemrën e atyre që nuk mund të kërkonin asgjë për shkak të nderit dhe turpit dhe për të mos i detyruar të lypnin.

Këto gurë lëmoshe dikur ishin shërbime dhe garime të mëdha në të mirë. Ata që jetonin në ato vende, për të dhënë për hir të Allahut në mënyrën sipas së cilës “atë që e jep dora e djathtë të mos e shikojë dora e majtë”, i linin lëmoshat e tyre mes errësirës së natës mbi këta gurë.

Më vonë, të varfërit e virtytshëm dhe të ndershëm të lagjes merrnin parà aty aq sa kishin nevojë, ndërsa të tjerat nuk i preknin. Veçanërisht, ata që kishin turp të kërkonin sado që kishin nevojë, vinin e merrnin parà nga gurët në orët e vona të natës dhe merrnin aq sa kishin nevojë. Një turist francez i cili përshkruan Stambollin e shekullit të shtatëmbëdhjetë, rrëfen se ka vëzhguar plot një javë një gur mbi të cilin kishte parà, por prapëseprapë nuk kishte parë askënd që të vinte e të merrte lëmoshë aty.



Së fundi, besimtari duhet të jetë i ndershëm dhe i turpshëm. Është



e domosdoshme që ta orientojë zemrën gjithmonë kah ndjenjat e bukura dhe mendjen kah mendimet e larta që lidhen me mbrojtjen e nderit dhe me sundimin e vetes, për shkak se forca e të gjitha dëshirave dhe e ndjenjave vetjake është në imagjinatë. Veçanërisht të largohesh nga shokët e këqinj, është një princip shumë i rëndësishëm.

I Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem thotë:

*“Jini të ndershëm ndaj grave të huaja, ashtu që edhe gratë tuaja të jenë të ndershme. Silluni mirë ndaj prindërve tuaj, ashtu që edhe fëmijët tuaj të sillen mirë me ju. Dikujt që i vjen vëllai duke i kërkuar ndjesë, le ta pranojë qoftë në të drejtë qoftë në të padrejtë. Përndryshe, në xhennet nuk mund të vijë te unë, te burimi i Keutherit.”* (Hakim, IV, 170/7258)

Turpi i cili është stolia e njerëzisë, është një mburojë që e ruan të zotin nga çdo lloj e keqeje dhe që ia mundëson njeriut kryerjen në mënyrë të përkryer të të gjitha detyrat që ka ndaj Allahut. Duke nxjerrë në pah ndikimin dhe rëndësinë e turpit, i Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem thotë:

*“Që nga profetët e parë është një fjalë që ka mbetur në kujtesën e njerëzve: Bëj çfarë të duash nëse nuk ke turp!”* (Buhari, Enbija 54, Edeb 78)

## 21. Mendjemprehtësia dhe inteligjenca

Mendjemprehtësi, që do të thotë të kesh fuqi zgjuarsie të lartë, është një nga pesë cilësitë dalluese të peygamberëve. Mendjemprehtësia nuk është një mendje dhe logjikë e thatë, por një shkallë perceptimi përtej gjenisë. Është shfaqja e intelektit dhe zgjuarsisë në një mendje të lidhur me zemrën. Është e domosdoshme që çdo peygamber të ketë një zgjuarsi të tillë të lartë, që të mund të zbatojë në mënyrë të paccnuar dhe të përkryer detyrën e predikimit të fesë. Në të kundërt, nuk mund t’u sjellin argumente te forta atyre për të cilët janë dërguar dhe nuk mund t’i bindin apo t’i bëjnë të heshtin.

Me mendjen, zgjuarsinë dhe intelektin që zotërojnë, Peygamberët janë në gradën më të lartë mes njerëzve nga çdo aspekt. Ata kanë një



kujtesë të fortë, një perceptim të lartë, një llogjikë të fuqishme dhe aftësi bindëse. Ata ishin në gjendje t'i zgjidhin lehtë edhe çështjet më të mbyllura dhe më problematike. Kur ata shpjegojnë çështjet, për shkak se flasin me sehlul-mumteni<sup>104</sup>, bashkëbiseduesit nuk e kanë të vështirë t'i kuptojnë, pavarësisht se e kanë të ndryshme shkallën e perceptimit.

Inteligjenca, e cila është një nga cilësitë e pejgamberëve, është të sjellurit me mendjemprehtësi sipas shkallës së mendjes së bashkëbiseduesit, sepse një sjellje që gëzon dikë mund të zemërojë dikë tjetër. Për këtë arsye, edukimi i njeriut është i mundur vetëm duke vërtetuar gjendjen psikologjike të tij.

Është shumë e rëndësishme kjo ngjarje e cila tregon se si është sjellë i Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem ndaj atyre që janë larg intelektit dhe zgjuarsisë, ndaj atyre që japin fetva duke mos i njohur plotësisht urdhërat e fesë, të cilët bëhen shkak për dëmtimin e njerëzve me fetvatë që japin:

Xhabiri radijallahu anhu tregon:

Ishim në luftë. Njërit prej shokëve tonë i ra një gur në kokë dhe u plagos. Gjatë natës ai në mënyrë të pavetëdijshme u bë xhunub (gjendja e ejakulimit në ëndërr). Kur u zgjua në mëngjes i pyeti shokët që kishte pranë:

“A është e lejuar të marr tejemmum?” Ata i thanë:

“Ti ke mundësi të përdorësh ujin, por ne nuk mendojmë se është e lejuar.”

Njeriu i plagosur u la dhe për këtë arsye vdiq. Kur erdhën te i Dërguari i Allahut, ia treguan këtë ngjarje.

Krenaria e Gjithësisë, i Nderuari ynë u zemërua shumë dhe tha

“Shërimi i padijes është te pyetja. Për të ishte e mjaftueshme të merrte tejemmum, ta lidhte plagën me një copë, pastaj ta fshinte copën dhe ta lante pjesën tjetër të trupit.” (Ebu Davud, Taharet, 125/337; Ibn

104. Sehlul-mumteni; janë shprehje të vështira për t'u gjetur dhe për t'u imituar, në një kohë që në pamjen e jashtme duken të lehta.

Maxhe, Taharet, 93)

Për këtë arsye, edhe myslimanët që ecin në rrugën e Pejgamberit tonë të Nderuar duhet të jenë të mençur, të ditur, të zgjuar dhe intelektualë.

Inteligjenca është një dritë që Allahu Teala ua ka dhënë robërve që i do. Domethënë është shfaqja në zemër e gjendjeve të tilla si intelekti, zgjuarsia e lartë, ndjesia, të diturit dhe konceptimi si një aftësi perceptimi shpirtëror. Domethënë që nëpërmjet ndjenjave të singërta që lindin në zemër dhe të frymëzimeve, të zbulosh fytyrën e brendshme dhe ato gjëra që të vijnë në mendje dhe në zemër. Sigurisht që këtë intelekt mund ta fitojnë ata që shohin me dritën e Allahut dhe duke u zhveshur nga mburrjet e vetes.

Hazreti Pejgamber sallallahu alejhi ue sellem ka treguar se intelekti i çdo besimtarit është i lidhur me besimin:

*“Kini frikë nga inteligjenca e besimtarit, sepse ai shikon me dritën e Allahut.”* (Tirmidhi, Tefsir, 15/3127) Nisur nga kjo, inteligjenca e miqve të Allahut, të cilët janë besimtarë të përsosur, është shumë më e fortë se ajo e besimtarëve të tjerë.

Gjëja e përkryer e inteligjencës fillon me zgjidhjen e fjalëkryqit të vdekjes, sepse të dish të fshehtat dhe të vërtetat e kësaj bote të përkohëshme, është e mundur vetëm me “vdekjen para se të vdesim”. Hazreti Mevlana thotë:

“Të mençurit së pari qajnë, në fund buzëqeshin. Ndërsa budallenjtë së pari qeshin, pastaj qajnë duke i rënë murit me kokë. O njeri! Ji inteligjent dhe shikoje fundin e punës në fillim, ashtuqë ditën e ndëshkimit të mos digjesh në zjarrin e keqardhjes!..”

Kushti i inteligjencës është të hash kafshatë hallall, të zbulosh jetën shpirtërore dhe të thellohesh në mendim. Hapi i parë në mendim dhe në ndjesi është ta kundrosh mjedisin me shikimin mësimdhënës. Në Kur'anin Fisnik, Allahu i fton robërit e Tij që t'i shikojnë me një zgjuarsi e cila do të bëhet shkak për të kuptuar mësimet të tilla edhe në ajete të ndryshme fisnike:

**është ngritur lart! Edhe kodrat se si janë vendosur! Edhe tokën se si është shtruar!”** <sup>105</sup>

Nga ana tjetër, pasi numërohen mirësitë e Allahut, në Kur'anin Fisnik u thuhet njerëzve disa herë: يَا أُولِي الْأَبْصَارِ domethënë “o njerëz inteligjentë..”<sup>106</sup>, dhe është kërkuar që gjithësinë ta shikojnë për të marrë mësim. Në këtë drejtim, edhe në shumë ajete fisnike thuhet: **“a nuk mendoni fare?”**<sup>107</sup>, se njeriu duhet ta shikojë gjithësinë jo me një shikim bosh dhe pa konceptim, por me zgjuarsi që të mund të perceptojë urtësinë.

Në ajetin fisnik ku flitet për mendjemprehtësinë, lexojmë:

**“...sigurisht që në këtë ka mësim të madh për ata që kanë mendje të kthjellët.”** (Ali Imran, 13)

**“Përkujto robërit tanë Ibrahimin, Is'hakun, Jakubin që ishin të fortë në zbatimin e detyrave dhe largpamës. Ne i pajisëm ata me një virtut të posaçëm që të përkujtojnë botën tjetër. S'ka dyshim se ata te Ne ishin prej të zgjedhurve më të mirë.”** (Sad, 45-47)

**“Thuaj: “Kjo është rruga ime që ftoj për te Allahu me mendjemprehtësi veten time dhe ata që më ndjekin mua.”** (Jusuf, 108)

### *Tabllo të virtytshme*

Një ditë i Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem u pyet:

**“O i Dërguari i Allahut! A keni adhuruar dikë tjetër përveç Allahut?”**  
Ai u përgjigj:

**“Jo!”** E pyetën:

**“A keni pirë ndonjëherë alkol?”** Ai tha:

**“Jo! Unë edhe para se të dija çfarë është Kur'ani dhe besimi, e dija**

105. Shik. Kaf, 6; Junus, 101; el-Gashije, 17-20; en-Nur, 43; el-Haxh, 63; er-Ra'd, 3; el-Enbija, 31; en-Nahl, 65; er-Rum, 50; Muhammed, 10...

106. Shik. Ali Imran, 13; en-Nur, 44; el-Hashr, 2...

107. Shik. el-En'am, 50; el-Bakara, 219, 266; Muhammed, 24; en-Nisa, 82; Jasin, 68...



*se ato gjëra që bënin ata janë kufër.*” (Dijarbekri, I, 254-255)

Natyra e pastër e të Dërguarit të Allahut sallallahu alejhi ue sellem ishte krijuar mbi mendjemprehtësinë, inteligjencën dhe zgjuarsinë.



Kurejshit e rregulluan Qaben pesë vjet para profetësisë së të Dërguarit të Allahut. Edhe Drita e Ekzistencës mori pjesë në ndërtim, bashkë me xhaxhain e Tij Abbasin. Pastaj, kur erdhi koha për të vendosur gurin e zi, doli një ngatërresë e madhe, për shkak se çdo fis donte ta kryente vetë këtë detyrë të ndershme. Ndërmjet tyre filluan debate të ashpra dhe grindje. Pothuajse do të derdhej gjak. Bijtë e Abduddar sollën një enë të mbushur me gjak, bënë marrëveshje me bijtë e Adij bin Ka'b dhe vendosën të luftonin deri në vdekje. Për të forcuar betimet e tyre, i futën duart në enën me gjak. Kurejshit u mbërthyen në këtë situatë katër ose pesë ditë.

Së fundi, Ebu Umejje i cili ishte më i moshuari i kurejshve, tha me zë të lartë:

“O populli im! Ne duam vetëm të mirën dhe jo të keqen. Edhe ju mos hyni në garën e xhelozisë në këtë çështje. Lëroni diskutimet! Meqënëse nuk mundëm ta zgjidhim këtë problem në mes nesh, le të gjykojë ai që do të hyjë i pari nga dera e haremit dhe ne le të jemi të kënaqur në gjykimin e tij!” Paskëtaj ai e drejtoi dorën nga dera Beni Shejbe e Mesxhidu'l-Haram.

Në atë moment, në derën e haremit hyri Krenaria e gjithësisë. Fytyra e gjithkujt filloi të buzëqeshte, sepse ai që po vinte ishte Muhammedu'l-Emin. Dashuria, respekti dhe besimi që kishin kurejshit për Pejgamberin tonë të Nderuar, shtohet çdo ditë që kalonte. Madje, kur prisnin ndonjë deve e thërrisnin të Nderuarin e Botrave. Dhe ai vinte e lutej për begatinë e punëve të tyre.<sup>108</sup>

Për këtë arsye, sapo Kurejshit e panë Atë, thanë:

“Ja el-Emin! Të gjithë jemi të kënaqur që ai të gjykojë ndërmjet nesh!”





Atij i treguan çështjen. Ai zgjodhi nga një person për çdo fis, hoqi rrobën e Tij dhe e shtroi në tokë. Pastaj urdhëroi që Gurin e Zi ta vendosin mbi të dhe u tha që të gjithë ata që i kishte zgjedhur, le ta kapnin nga njëri cep. Gurin e bekuar e mbartën të gjithë bashkë. Drita e Eksiztencës e vendosi në vendin e tij me duart e veta. Kështu, duke shfaqur mendjemprehtësinë dhe inteligjencën e Tij, i Nderuari ynë e ndaloi luftën që mund të shpërthente ndërmjet fiseve. (Ibn Hisham, I, 209-214; Abdurrazzak, V, 319)

Inteligjenca që ka shfaqur i Dërguari i Allahut në luftërat që ka bërë në rrugë të Islamit, mendjemprehtësia që ai ka nxjerrë në pah në marrëveshjet e paqes, sidomos në atë të Hudejbijes, metoda e jashtëzakonshme dhe drejtësia që tregoi në çlirimin e Mekkes, Hunejnit dhe Taifit, ishin aq të larta sa askush nuk do të mund t'i arrijë.

Njerëzit i admirojnë gjithmonë ata që kanë inteligjencë dhe personalitet dhe u besojnë atyre.



Mbasi u vërtetua se Hazreti Jusuf ishte i pafajshëm, u dërgua një përfaqësues për ta nxjerrë nga burgu. Por Jusufi alejhisselam nuk desh të dalë nga burgu pa e kuptuar mirë mbreti të vërtetën, pa u kuptuar mirë çështja, pa e pranuar të gjithë se është futur në burg padrejtësisht. Duke përdorur mendjen dhe duke shfaqur durim dhe sjellje serioze, ai i pengoi edhe ata që e kishin zili që të mos i ngatërronin punët më keq. Vetëm kur u vërtetua së çdo shpifje e bërë kundër tij ishte gënjeshtër dhe kur shpëtoi nga akuzat, pranoi të dalë nga burgu.

Për këtë arsye, duke marrë mësim nga kjo vepër inteligjente e Jusufit alejhisselam, çdo mysliman duhet të jetë shumë i kujdesshëm dhe i përpiktë në çështjen e heqjes së akuzës dhe në largimin prej vendeve akuzave.



Që në fëmijëri, Sulejmani alejhisselam kishte mendjemprehtësi të lartë dhe ishte shumë i zgjuar. I Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem tregon një ngjarje në lidhje me këtë veçori të tij:



“...Një herë kishin qënë dy gra dhe me vete kishin fëmijët e tyre. Kur po ecnin në rrugë, doli një ujk dhe ia mori fëmijën e gruas së madhe. Pas kësaj, gruaja i tha shoqes së saj (gruas më të vogël):

-Ujku mori fëmijën tënd. Gruaja tjetër tha:

-Jo, ka marrë fëmijën tënd!

Së fundi këto dy gra shkuan te Davudi alejhisselam për të gjykuar ndërmjet tyre. Davudi alejhisselam gjykoi se fëmija ishte i gruas së madhe.<sup>109</sup> Ato dolën nga gjykata dhe shkuan të biri i Davudit alejhisselam, Sulejmani alejhisselam. I treguan për gjykimin e Davudit. Sulejmani alejhisselam tha:

-Më sillni një thikë që ta ndaj fëmijën përgjysëm në mes jush!

Me të dëgjuar këto fjalë, nëna e vërtetë e fëmijës e cila ishte gruaja më e vogël, u hodh menjëherë përpara dhe tha:

-Të lutem mos bëj ashtu! Allahu të mëshiroftë! Fëmija është i kësaj gruaje!

Mbi këtë, Sulejmani alejhisselam gjykoi se fëmija ishte i gruas më të vogël.” (Buhari, Enbija, 40)



Sipas një transmetimi që gjendet në librin *Araisu'l-Mexhalis*, thuhet:

Dy janë nga gratë më të larta nga aspekti i inteligjencës. Që të dyja kanë dhënë përgjigje të saktë në zbulimet për Hazretin Musa:

Njëra është gruaja e Faraonit Asije. (Ajo, kur Musai u soll në një kuti në saraj, i anoi zemra nga ai, e mori dhe ia dërgoi Faraonit:)

“Ky fëmijë le të jetë drita dhe ndriçimi i syve tanë! Mos e vrit!”

109. Njëra nga cilësitë e pejgamberëve është ismeti, domethënë mbrojtja nga mëk - tet, por edhe ata nuk janë të lirë nga zelle si nevojë njerëzore. Zelle janë gabimet e pavullnetshme që bëjnë pejgamberët. Kjo ka shumë urtësi. Ndonjëherë, me to zelle Allahu dëshiron që të shfaqet një ligj, ndonjëherë u kujton robërve të Tij adhurimin edhe nëse janë pejgamberë, duke ua bërë të qartë paaftësinë e tyre, ndërsa ndonjëherë duke u treguar njerëzve se edhe këta robër të veçantë janë njerëz të cilët mund të gabojnë si nevojë njerëzore, dëshiron të pengojë që atyre të mos u japim cilësi hyjnore.



Ndërsa tjetra është vajza e Shuajbit alejhisselam. Ajo e vërtetoi moralin e Musait alejhisselam dhe tha:

“O Baba! Merre atë me pagesë për të ruajtur delet tona. Ai është më i miri dhe më besniku prej atyre që do të marrësh me pagesë!”

Vajza e Shuajbit alejhisselam Safura e vërtetoi me inteligjencë besnikërinë e Hazretit Musa. Kur u pyet se si e kuptoi këtë, u përgjigj:

“Sepse ai nuk na ka parë as fytyrën. Edhe në rrugë ecte para nesh. Kuptohet se ishte një njeri shumë besnik!”



Duke marrë nga cilësia e inteligjencës së peygamberëve, çdo musliman duhet ta përdorë në mënyrën më të frytshme edhe mirësinë e mendjes. Duhet ta dijë se kujt, çfarë, kur, ku dhe si duhet të flasë e të sillet. Për shembull, metoda delikate që përdori Xhafer Tajjari radijallahu anhu ndërsa po i jepte të dhëna për Islamin mbretit të Habeshistanit, Nexhashit, është shumë mësimdhënëse në lidhje me mënyrën se si duhet të përdorë inteligjencën një musliman. Kur Nexhashi, i cili ishte kristian, urdhëroi Xhafer Tajjarin radijallahu anhu që të lëxonte disa nga ajetet e Kur'anit Fisnik, ai nuk lexoi në fillim ajetet që sfidojnë mohuesit, por lexoi suren Merjem, e cila flet me lavdërim për nënën e Hazretit Isa. Nexhashi, i cili po i dëgjonte me frikërespekt ndaj Allahut ajetet që lexonte Hazreti Xhafer, tha me sy të mbushur me lot:

“Patjetër që këto që dëgjova shpërthejnë nga i njëjti burim drite me ato që ka sjellë Isai!” . Pas njëfarë ai u nderua me Islamin. (Ibn Hisham, I, 358-360)



Sipas transmetimit të Hazretit Enes radijallahu anhu, një ditë, teksa ai po shkonte i vetëm te Hazreti Osman, pa një grua. Bukuria e gruas i mbeti në mendje. Me këtë mendim shkoi te Hazreti Osman. Hazreti Osman i tha:

“O Enes! Po hyn këtu në një kohë kur sytë e tu kanë shenjat e zinasë.”



Enesi radijallahu anhu i cili u habit nga kjo fjalë, pyeti i mahnitur:

“A vjen shpallje edhe pas të Dërguarit të Allahut?” Hazreti Osman radijallahu anhu tha:

“Jo, kjo është një mendjemprehtësi dhe inteligjencë e drejtë.”<sup>110</sup>



Kur Abdullah bin Omer radijallahu anhu u lajmërua se Hazreti Husejn mori rrugën për në Irak, menjëherë u nis pas tij dhe pas tri ditë udhëtimit, e arriti Husejnin radijallahu anhu dhe i tha:

“O Husejn, ku po shkon?” Hazreti Husejn tha:

“Po shkoj në Irak.”

Ibn Omeri radijallahu anhu pa se Hazreti Husejn kishte disa grumbuj letrash. Hazreti Husejn tha:

“Ja, këto janë letrat e irakjanëve.” Ibn Omeri tha:

“Mos u gënje nga letrat e atyre dhe mos shko tek ata!”

Por Hazreti Husejn këmbënguli për të shkuar, edhe pse e luti shumë dhe tha:

“Kush të shkojë, po të mos shkoj unë?” Në lidhje me këtë, Ibn Omer i tha Hazretit Husejn:

“Atëherë unë po të kujtoj ty një hadith të të Dërguarit të Allahut:

Xhebraili alejhisselam erdhi te i Dërguari i Allahut. Të Dërguarin e Allahut e la të lirë të zgjedhë mes kësaj bote dhe ahiretit. I Dërguari i Allahut zgjodhi ahiretin. Edhe ti je një pjesë e të Dërguarit të Allahut. Beto hem në Allahun se asnjë nga ju Ehli Bejt nuk do ta sundojë këtë botë deri në kiamet, (domethënë një kohë të gjatë apo plotësisht nuk do të posedoni gjëra të kësaj bote si pasuri, pronë, dhe pozitë). Ajo që ju pengon të mos e sundoni këtë botë, është se ju keni zgjedhur ahiretin, që për ju është më e vlefshme se kjo botë.”

Hazreti Husejn nuk pranoi që të kthehet. Mbi këtë Abdullah bin



Omer e përqafoi dhe filloi të qajë. Pastaj tha:

“Allahu të ruajtë, ti po shkon drejt vdekjes!” (Ibn Kethir, el-Bidaje, VIII, 152; Dhehebi, Sijer, III, 296)

Edhe vëllai i Hazretit Husejn, Hasani radijallahu anhu i shkruajti një letër Muavijes e dha dorëheqje nga Hilafeti për të ndaluar vazhdimin e fitnes (përçarjes) ndërmjet myslimanëve e për të mos u derdhur gjak.

Këto ngjarje që reflektojnë inteligjencën e Hazretit Abdullah, shfaqin sakrificat dhe vuajtjet që kanë duruar për hir të përgjegjësisë dhe të shërbimit.



Hazreti Abdulkadir Gejlani e tregon kështu një ngjarje që i ka ndodhur:

Një ditë mu shfaq përpara syve një dritë që kaploi të tërë horizontin. Kur po e shikoja se çfarë ishte, nga drita erdhi një zë që më tha:

“O Abdulkadir, unë jam Zoti yt. Nga punët e mira që ke bërë jam aq shumë i kënaqur, sa që edhe haramet t’i kam bërë hallall.”

Por, sapo mbaroi fjalën, unë e kuptova se zoti i këtij zëri ishte shejtani alejhillane dhe i thashë:

“Ik, zhduku, o i mallkuar! Drita që po shfaq për mua, është një errësi e përjetshme.

Mbi këtë shejtani u largua dukë thënë:

“Përsëri shpëtova nga dora ime me urtësinë dhe inteligjencën që të ka dhënë Zoti! Me këtë metodë unë kam nxjerrë shumë njerëz nga rruga e drejtë.”

I hapa duart e mia nga qielli dhe e falenderova Allahun, duke e kuptuar se kjo është mirësia e Zotit.

Njëri prej xhematit që po dëgjonte këto fjalë, pyeti:

“O Abdulkadir, nga e kuptove se ai ishte shejtani?”



Abdulkadir Gejlani kuddise sirruhu u përgjigj:

“Nga ajo që tha: “t’i kam bërë haramet hallall”!..”

Ja kjo është një inteligjencë për të cilën gjithkush ka nevojë gjatë gjithë jetës.



Në kohën e fetretit (periudha nga lufta e Ankarasë 1402 deri në salltanatin e Çelebi Mehmetit 1413) të Osmanëve, populli, në luftën ndërmjet princave, ishte i fortë, i pjekur dhe sundues i ndërgjegjes së historisë, aq sa nuk mund të krahasohet me të sotmit dhe duke mos simpatizuar asnjërin prej princave, pritnin rezultatin e zënkës që ishte ndërmjet tyre. Për këtë arsye, populli, duke dërguar përfaqësuesit të Musa Çelebi i cili kishte ardhur në periferi të kryeqytetit të asaj kohe që ishte Bursa, i thanë:

*“Ne nuk jemi as simpatizantë dhe as kundra jush! Ju vëllezërit zgjidheni problemin që keni ndërmjet jush! Nëse na futni edhe ne në këtë zënkë, do të bëheni shkak që të hapen plagë të cilat është e pamundur të mbyllen përsëri. Besnikëria e çdo ushtari që keni nën urdhërin tuaj është një borxh ndërgjegjeje, por ne ju kërkojmë që zënka juaj të mos bëhet shkak për të ndarë popullin...”*

Një nga forcat më ndikuese që ndalonte copëtimin e shtetit Osman, ishte mendjemprehtësia, zgjuarsia dhe karakteri i fortë i popullit. Përndryshe, siç është parë edhe në shumë popuj të tjerë, çdokush lidhej pas një lideri në një mënyrë të verbër sikur po zgjedh një parti, ashtu që ndërmjet popullit hynte gjaku dhe urrejtja.



Timuri i cili e mundi Jëlldërëm Bajezidin në Ankara, i pati detyruar Osmanët të paguanin një taksë që do të zgjaste vetëm disa vite. Pastaj Ilhanllëllarët, duke thënë se ata janë në vend të Timurit, vazhduan ta marrin këtë taksë. Kjo taksë është dhënë deri në kohën e Murad Hanit II. Në kohën e Muradit II. Pashallarët e shtetit Osman që ishin mbledhur dhe forcuar plotësisht, i thanë sulltanit:



“O padishahu ynë! Përse u paguajmë akoma taksë atyre? Tashmë le t’i zhdukim prej këtu!..

Murad Hani II, i cili ishte njeri shumë i mençur dhe inteligjent, iu përgjigj kështu kësaj kërkesë:

*“Ata nuk e dinë rimëkëmbjen dhe forcën që ne kemi tani. Nëse nuk ua japim paratë që duan, ata shkojnë dhe mbledhin qoftë edhe një ushtri të zakonshme dhe vijnë të na sulmojnë. Në të vërtetë ata mposhten, por gjaku i myslimanëve do të rrjedhë... Për këtë arsye vazhdoni t’ua jepni ato para, sepse nuk dua që të rrjedhë gjaku i myslimanëve për para!*

*Por bëni disa shfaqje për përfaqësuesit e llhanllëllarëve dhe tregojani madhësitinë e ushtrisë sonë në atë mënyrë që ta kuptojnë forcën e ushtrisë që kemi, që të mos guxojnë të kërkojnë më taksë nga ky shtet i lartë që është shumë më i fortë se i atyre!..”*

Me të vërtetë, rezultati doli ashtu si tha Murad Hani II.



Një nga shkaqet që e shtynte Murad Hanin II të këmbëngulte për të vendosur në fron birin e tij Mehmed Fatihun e II, është aftësia që shikonte te ai, sepse princi Mehmed, edhe pse ishte akoma në moshë të re, mendonte dhe bënte gjëra të cilat as edhe një njeri i pjekur nuk mund t’i mendonte, e madje edhe babait të tij i bënte pyetje shumë të thella. Një herë pa babain e tij në oborrin e sarajit dhe menjëherë vrapoi drejt tij. Pasi e pyeti për gjendjen e tij, i tha:

“O babai im! Çfarë urtësie është kjo që nuk shoh te ju shenjat e pleqërisë si te të moshuarit e tjerë, paçka se keni shumë vuajtje dhe peshë në shpinën tuaj. Ju jeni plakur si njerëzit e tjerë, por nuk jeni kërrusur dhe shtrembëruar. Edhe pse keni vuajtur dhe jeni munduar shumë, e përdorni shumë mirë mendjen dhe vullnetin tuaj bashkë me energjinë, heroizmin dhe trimërinë e moshës së re. Shikoj se në fushat e luftës jeni një komandant që korr fitore, në kuvendet e dijes jeni një mjeshtër i thellë, jeni një dervish i sinqertë që i shërben popullit!.. nuk keni as natë as ditë! Si ia dilni mbanë kundrejt këtyre duke e mbajtur trupin drejt si fidan dhe pa e vjetëruar shpirtin tuaj delikat? Çështë kjo



punë baba?!. Në një kohë kur preokupimi i vazhdueshëm i mendjes e tret dhe e mbaron njeriun, te ju s'ka arritur të shkaktojë ndonjë ndryshim dhe nuk ka mundur ta prishë gjendjen tuaj të qetë!.. Çfarë ilaçi pini për karakterin veçantë që keni dhe çfarë lëngu përdorni për mendjen tuaj të epërme? A mund të m'i mësoni edhe mua këto, ashtu që edhe unë të eci në rrugën tuaj...”

Përveç se u habit shumë nga këto pyetjeve që nuk i priste prej birit të tij, Sulltani Murad Hani II u gëzua shumë dhe i dha këtë këshillë historike:

*“O biri im i dashur! Më gëzove. Zoti i lartë të cilin e adhurojnë gjithësia dhe të gjithë krijesat, t'i shtoftë epërsitë që t'i ka dhënë. Të bëftë që të interesohesh vazhdimisht për të studiuar dhe për të kërkuar rreth çështjesh të tilla të mëdha dhe të gjëra.*

*O biri im! Le të thonë ç'të duan, por unë besoj se ata që jetojnë në drejtësi, kur të ndahen nga kjo botë do të fitojnë në ahiret mirësi të pafundme që nuk mund të imagjinohen. Në këtë që besoj nuk kam as dyshimin më të vogël. Për këtë arsye, adhurimet që i bëj për Allahun e lartë, i bëj në mënyrën më të sinqertë dhe me zemër. Unë besoj se shpërblimin e këtyre vuajtjeve që kam hequr në këtë botë brengash dhe mundimesh, do të ma japë Allahu në ahiret, dhe në çdo çështje i kërkoj mbrojtje Atij. Veçanërisht, mendoj se takdiri i Tij, domethënë kaderi i Tij për mua është një nder i madh.*

*O biri im! Mos i beso dhe mos u mashtro ndaj çdo gjëje që thuhet, duhet ta mësosh dhe mendosh fytyrën e brendshme të çdo lloj situatë dhe t'i qasesh së vërtetës vetë!*

*Siç hahet mirë një frut vetëm atëherë kur piqet, ashtu edhe ata të cilët kanë dije dhe përvojë, janë përherë të përshtatshëm për t'i zgjedhur, përndryshe, të hash fruta akoma të papjekura kur ka rrush të pjekur dhe të shijshëm, është dobësi e mendjes.*

*O biri im! Herë-herë kujtoj gjyshërit e mi të lartë. Humbas në mendime për të ardhmen e brezave të mëvonshëm. Elhamdulillah, deri sot kemi ardhur me dashuri, respekt dhe besnikëri. Shpresoj se edhe pas të sotmes të vazhdojmë në të njëjtën mënyrë. Ashtu siç lindëm dhe erdhëm, përsëri ashtu dua të shkojmë...*





*Dije mirë se, vazhdimi i çdo lloj gjëje nuk është i mundur vetëm me forcë, shpatë, heroizëm dhe me poshtërim. Mendja, marrja e masave, durimi, të shikuarët përpara, provimi dhe përvojat lodhëse janë shumë të rëndësishme. Siç nuk është rruga e parë gjithmonë e kalueshme, ajo ka edhe shumë pengesa. Edhe rruga e dytë nuk ka dobi vetëm. Që të dyja duhet t'i administrosh në të njëjtën kohë, për të fituar suksese të mëdha! Mos ki turp, në të vërtetë gjyshërit tanë të lartë i kanë korrur fitoret e mëdha me mendje, llogjikë e me forcën e dashurisë, dhe jo nën hijen e shpatës siç duket në pamjen e jashtme.*

*O biri im! Kujdes, mos e lër drejtësinë qoftë edhe një çast, sepse Allahu i madhërisëm është i drejtë dhe e do të drejtin. Nga një aspekt ti je halifeja e tij në këtë tokë. Ai të ka dhënë disa të mira dhe të ka bërë komandant në krye të robërve të Tij, këtë mos e harro!..*

***O biri im! Në këtë botë ka tri lloj njerëzish:***

***Grupi i parë***, janë njerëz që e kanë mendjen në vend, e shikojnë pak a shumë të ardhmen dhe janë besnikë.

***Grupi i dytë***, janë ata njerëz që nuk e dinë se cila rrugë është e vërtetë apo e gabuar, por nuk kanë rënë në këtë gjendje me dëshirën e tyre, por me ndikimin e njerëzve. Kur këshillohen, vijnë në rrugë të drejtë, e pranojnë të vërtetën dhe ta dëgjojnë fjalën. Krahas kësaj, shumicën e kohës e jetojnë duke u përshtatur atyre që kanë dëgjuar.

***Ndërsa grupi i tretë***, janë njerëz që nuk dinë gjë dhe nuk dëgjojnë as qortim e as këshillë. Vetëm u përshtaten dëshirave të veta dhe pandehin se dinë çdo gjë. Këta janë ata më të rrezikshmit.

*O biri im! Nëse Allahu të ka krijuar nga njerëzit që numurova në grupin e parë, gëzohem dhe e falenderoj Allahun. Nëse je nga grupi i dytë, të këshilloj që tua vësh veshin këshillave dhe qortimeve. Bëj kujdes që të mos jesh nga grupi i tretë! Ata nuk janë në një gjendje të mirë as para Allahut, as para njerëzve.*

*O biri im! Padishahët u ngjajnë njerëzve që kanë peshore në dorë, por padishahu i vërtetë është ai që e mban drejt peshoren që ka në dorë! Kur të bëhesh padishah, të këshilloj ta mbash drejt peshoren. Atëherë edhe Allahu i lartë të jep mirësi dhe të bën prej të devotshmë-*



*ve. Ai e di gjithçka...*”

Ja një inteligjencë dhe intuitë e jashtëzakonshme që shikohet te babai dhe i biri...

Krahas vakëfeve, bibliotekave, spitaleve dhe shërbimeve të tjera të mira të Bajezid Veliut II, është shumë e madhe edhe rëndësia që ai u ka dhënë dijeve Islame dhe kulturës. Koha e tij është koha kur janë hedhur themelet e kulturës dhe qytetërimit Osman. Kur piktori dhe arkitekti i njohur italian, Leonardo da Vinci i shkruajti një letër Bajezidit II, në të cilën i propozoi që t'i bënte ai planet dhe projektet e xhamive dhe të veprave tjera në Stamboll, vezirët që ishin nën Kubbe u gëzuan. Ndërsa Bajezid Hani II, i cili kishte një perceptim të thellë dhe të hollë tasavvufi e refuzoi këtë propozim. Më pas tha:

**“Nëse e pranojmë këtë, në vendin tonë do të sundojë një arkitekturë që imiton arkitekturën e kishave nisur nga metoda dhe shpirti, ndërsa arkitektët tanë myslimanë nuk mund ta zbulojnë dhe nuk mund ta fitojnë personalitetin!”**

Ky mendim shpreh horizontin e një myslimani i cili ishte i mençur, inteligjent dhe me dije të thellë shpirtërore, sepse pas Bajezidit II, ashtu siç arritën tokat Islame në njëzetekatër milionë kilometra katrorë, në po atë mënyrë u përhap edhe arti Islam duke arritur kulmin. Për shkak të këtij mendimi, shpirti i Islamit u transmetua në inxhinieri dhe nxori në pah **Xhaminë Selimije**, **Xhaminë Sulejmanije** dhe një zinxhir monumentesh të tilla që do ta ruajnë vlerën e tyre deri në kiamet.



Sigurisht që i dhunuari i parë i Palestinës është Abdulhamid Hani II. Ai ka shfaqur një përpikmëri në çështjen e Palestinës dhe është sjellë me zgjuarsiri dhe inteligjencë kundrejt dëshirave dhe shpresave të çifutëve, të cilat në pamje të parë dukeshin të pafajshme. Teodor Herzlit, i cili kërkonte që ai t'i jepte tokë nga Palestina si kundërvlerë për të paguar të gjitha borxhet e jashtme të Osmanëve, Abdulhamid Hani i tha:

**“Unë nuk shes as edhe një pëllëmbë tokë nga Palestina, sepse ky atdhe nuk është i imi por i popullit tim. Ndërsa populli im**



i ka fituar ato duke derdhur gjak. Pjesa e atdheut që merret me gjakun e dëshmorëve, nuk shitet me para! Dijeni se unë kurrë nuk ju jap leje të bëni një operacion tradhëtar që e keni planifikuar për ta bërë mbi trupat e gjallë!” Paskëtaj ndërmori disa masa paraprake shumë serioze për ta zhdukur këtë rrezik.

Kur shikojmë ato që ndodhin sot, e kuptojmë më mirë inteligjencën dhe intuitën e Abdulhamid Hanit II.

Akoma edhe sot, në krye të emrave që u vendosen fëmijëve në Palestinë, vjen emri “Abdulhamid”. Palestinezët e kujtojnë për mirë me shprehjen: “Ne jemi jetimët e Abdulhamidit.”



Së fundi, inteligjenca dhe zgjuarsia janë disa nga cilësitë më të rëndësishme për besimtarin.

Shah el-Kirmani thotë:

“Nuk gabon inteligjenca e atij që e ruan syrin nga harami, e ruan veten nga dëshirat vetjake, që kontrollon të fshehtën e tij, që ndërton të jashtmen duke ndjekur Sunnetin dhe që ushqehet me kafshatë hallall!”

## 22. Pastrimi i vetes dhe dëlirësia e zezrës

Në mësimin e moralit të bukur që formon personalitetin Islam, një nga hapat që duhet hedhur më së pari është pastrimi i vetes dhe dëlirja e zezrës. Në të njëjtën kohë ky pastrim dhe kjo dëlirje janë faktorët më të qartë në realizimin e tragjedisë apo të lumturisë në të ardhmem e njerëzve.

Për të pastruar veten dhe për të dëlirë zezrën, së pari duhet t'i bindesh vullnetit hyjnor, e po ashtu të përpiqesh të dalësh kundra pacioneve vetiake dhe gjendjeve të këqia. Duke e kuptuar gabimin, mangësinë, paaftësinë, asgjënë dhe padijen e tij, çdo besimtar duhet ta perceptojë Zotin me gjithë madhëstlinë, fuqinë dhe përsosmërinë e



Tij, ndërsa veprat e tij duhet t'i drejtojnë në këtë përceptim. Ja, kur të bëhet kjo -me shprehjen e Kur'anit- "vetja e cila urdhëron të keqen me këmbëngulje"<sup>111</sup>, pastrohet nga cilësitë e këqia dhe vjen në një gjendje të pranueshme.

Të përpiqesh të pastrosh veten dhe të hysh në në këtë rrugë me përpekje serioze për hir të kësaj, është pranuar si "**xhiahadi më i madh**" duke u mbështetur në rëndësinë dhe vështirësinë që ka. Po ashtu, këtë shprehje e ka përdorur Pejgamberi ynë i Nderuar sallallahu alejhi ue sellem në kthimin nga Lufta e Tebukut, në të cilën u hasën vështirësi të mëdha. Në këtë luftë ashabët e nderuar kishin shkuar një mijë kilometra dhe ishin kthyer. Në udhëtim përjetuan shumë vuajtje si uria dhe etja. Mjekrat dhe flokët e sahabëve ishin ngatërruar me njëra-tjetrën dhe lëkurat iu ishin ngjitur pas kockave. Kur pa ashabët e nderuar në këtë gjendje, i Nderuari ynë tha:

*"Tani po kthehem nga xhiahadi i vogël dhe po shkojmë te xhiahadi me dëshirat e vetes, i cili është xhiahadi më e madh!"<sup>112</sup>*

Në hadithe të ndryshme fisnike, i Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem ka thënë:

*"(Në të vërtetë) Luftëtar është ai që lufton me veten e tij."* (Tirmidhi, Fedailu'l-Xhihad, 2/1621; Ahmed, VI, 20)

*"I mençur është ai që e sundon veten dhe punon për pasvdekjen, duke i kërkuar llogari asaj. Ndërsa budalla është ai që ndjek dëshirat e vetes dhe shpreson (të mirë) nga Allahu."* (Tirmidhi, Kijamet, 25/2459; Ibn Maxhe, Zuhd, 31)

*"Ajo që kam më shumë frikë për ummetin tim është ndjekja e dëshirave vetjake."* (Sujuti, I, 12)

Nga ky aspekt, edhe edukata profetike e të Nderuarit tonë alejhis-salatu uesselam është realizuar në trajtën e një lufte të pamëshirshme që i bëhet vetes. Ashabët e nderuar, që edukoheshin me këtë edukim profetik, u bënë njerëz të përsosur dhe erdhën në një gjendje brezi shembullor, duke arritur të pastroheshin nga veset e këqia, si rezultat i

111. Shik. Sureja Jusuf, ajeti fisni i 53.

112. Shik. Sujuti, Xhamiu's-Sagir, II, 73.



pastrimit të vetes dhe dëlirjes së zemrës. Ibn Mes'udi radijallahu anhu përjetonte gjendjen e falenderimit, lavdërimit dhe dhikrit në mësimet e Pejgamberit tonë të Nderuar. Edhe pse kishte një dije të gjërë, të fituar për shkak të afërsisë që kishte ndaj të Nderuarit tonë, ai transmetoi vetëm 848 hadithem për shkak të përpikmërisë që kishte në transmetim. Gjendjen shpirtërore që e kishte arritur nën edukimin shpirtëror të të Nderuarit tonë alejhissalatu uesselam, Ibn Mes'udi radijallahu anhu e shpreh kështu:

“Ne përfshiheshim aq shume në disa gjendje të të Dërguarit të Allahut, saqë mund të dëgjonim edhe dhikrin e kafshatave që hanim.”  
(Shik. Buhari, Menakib, 25)

Ibn Mes'ud radijallahu anhu, që në të kaluarën ishte një çoban deveshë, kur u udhëzua dhe kaloi në edukimin shpirtëror të të Dërguarit të Allahut iu bë zemra det. U hollua, u thellua dhe zemra filloi të reflektonte shfaqjet hyjnore. Shkolla e famshme e Kufes është vepra e këtij sahabiu të njohur. Edhe Imam Azami Ebu Hanife, i cili ishte juristi më i madh i botës, është edukuar po nga kjo shkollë. Ai ishte Imam Azami, para të cilit Soloni dhe Hamurabi, që njihen si juristët më të mëdhënj të botës, mund të jenë vetëm nxënës. Përderisa të vazhdojë medhhebi Hanefi që e ka formuar Ebu Hanife, Ibn Mes'ud radijallahu anhu do të fitojë sadakutu'l-xharije (punë e mirë që vazhdon edhe pas vdekjes). Kësisoj, ai dhe sahabët e ngjashëm me të, nuk harrohen edhe pasi t'u bëhen trupat tokë. Salltanatet e tyre do të vazhdojnë deri në kiamet në zemrat e ummetit të Muhammedit.

Edhe njëri nga mënyrat kryesore që përdornin pejgamberët dhe miqtë e Zotit me qëllim që të ndikonin shpirtrat dhe zemrat në edukimin shpirtëror të njerëzve, është “**kuvendi**”. Ndjenjat e gjendjes që jeton janë të ngarkuara në fjalët e atij që e ka pastruar veten dhe e ka dëlirur zemrën. Fjalët që thuhën me këto ndjenja dhe me këtë sinqeritet, e gjejnë rrugën nga veshi për në zemrën e bashkëbiseduesit, japin ndikime të mira dhe bëhen shkak për kalimin e begatisë dhe të ndjenjës shpirtërore.

Edhe dijetarët të cilët janë trashëgimtarë të Pejgamberit, para së t'iu rregullojnë njerëzve përjetimet negative, i sjellin në një gjendje të



gatshme për t'u rregulluar, duke ua zbutur zemrat me begatinë dhe bereqetin e kuvendit. Duke i ndalur furtunat e zemërimit dhe të inatit, përgatisin bazat që flladet e ëmbla të pendimit të bëhen realitet.

Edhe begatia që transmetohet te zemra e nxënësve të përsosur në formë zinxhiri nga i Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem, vjen në zemrat e besimtarëve me rabita (lidhje shpirtërore) dhe kuvende. Për këtë shkak, personaliteti shembullor i Pejgamberit tonë të Nderuar reflektohet në zemrat besimtare aq sa ato e duan Atë.

Aq sa ç'kryhen kuvendet me adhurim, po aq vijnë edhe shfaqjet. Zemrat në kuvende ndahen sipas bashkëbiseduesit, sepse kuvendi është sikur t'i shkruash një recetë shpirtërore bashkëbiseduesit. Kuvendi që bëhet dhe dëgjohet me zemër të sinqertë, është një gjendje zbulimi e thellë. Shfaqjet fillojnë të vijnë sipas gjendjes së zemrës së bashkëbiseduesit.

Metoda me ndikuese që ka përdorur i Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem për edukimin dhe pastrimin e ashabëve të Tij, është kuvendi, sepse Allahu i thotë Pejgamberit tonë të Nderuar:

**“Këshillo, sepse këshilla u bën dobi besimtarëve.”** (edh-Dharijat, 55)

**“...Ti je vetëm një këshillues.”** (el-Gashije, 21)

Është shumë interesant edhe fakti se fjalët “sahabi” dhe “kuvend” janë formuar nga e njëjta rrënjë. Me dashurinë, respektin dhe ndjesinë që e kishin ndaj të Dërguarit të Allahut sallallahu alejhi ue sellem, ashabët e nderuar janë bërë shembulli më i përkryer dhe më i shkëlqyer i përfitimit të asaj që duhet nga kuvendi dhe nga edukata shpirtërore. Qetësinë dhe edukatën që kishin në kuvendin e të Dërguarit të Allahut sallallahu alejhi ue sellem në lidhje me kushtin e asaj që përfituan, e kanë shprehur kështu:

“Ne pandehnim se në kokën tonë kishte një zog, i cili nëse lëviznim, do të fluturonte.” (Shik, Ebu Davud, Sunnet, 23-24/4753; Ibn Maxhe, Xhenaiz, 37; Ibn Sa'd, I, 424)

Ja pra, me një dëshirë të tillë të zjarrtë bëheshin kuvendet e të Dërguarit të Allahut. Kur Ai fliste, ato e dëgjonin me aq mall e përqe-



ndrim shpirtëror saqë tek to reflektohej një gjendje lumturie e ekstaze. Edukata dhe turpi që reflektohej te ashabët nga Ai, ishte në një gradë të atillë sa që ashabët e nderuar shumë herë nuk guxonin t'i bënë as pyetje të Dërguarit të Allahut. Për këtë arsye, nëse ndonjë bedevi vinte nga shkretëtira dhe bëhej shkak për kuvend duke i bërë pyetje Hazretit Pejgamber, ashabët prisnin që të përfitonin edhe ata nga begatia e Tij.

Ashabët e nderuar, të cilët në të kaluarën ishin njerëzit e xhahilijes, pasi u udhëzuan, pasi e pastruan veten dhe pasi e dëlirën zemrën me kuvendet e begata dhe me edukatën shpirtërore të të Dërguarit të Allahut, u bënë njerëzit më të shkëlqyer të kësaj bote. Ata i kaluan legjendat e begata që shëtisnin gojë më gojë dhe që kishin zënë vend në zemra.

Pastrimi i vetes dhe dëlirja e zemrës kanë një pozitë të rëndësishme në formimin e personalitetit Islam. Së pari është pastrim nga kufri, padija, ndjenjat e këqia, besimi i gabuar dhe vetitë e këqia. Do të thotë të pastrohesh nga çdo besim i gabuar që bie ndesh me Fenë e qartë, të pastrohesh nga gabimet etike dhe veprorë. Domethënë, pasi të pastrohet zemra dhe të mbrohet nga të këqijat, ta mbushësh me ndjenja shpirtërore, duke e zbukuruar me vetitë dhe me edukimin e devotshmërisë si besimi, dija, dija shpirtërore, urtësia, ndjenjat e mira dhe prirjet e bukura.

Njeriu që kur ka ardhur në këtë botë për tu sprovuar deri në vdekje, është i dhënë pas një sëmundeje që i thuhet vete dhe e cila përfshin shumë gjëra negative. Ai, edhe nëse ngrihet në shkallën më të lartë të (velajetit) miqësisë, çdo çast është kundra hileve, vesveseve dhe kurtheve të gjithmonshme të treshes: kësaj bote, vetes dhe shejtanit. Në fakt, edhe vlera e adhurimit fillon duke i mënjeluar këto rreziqe, duke u bërë i devotshëm e duke u larguar nga mashtrimet tërheqëse të kësaj bote të përkohëshme, dhe si rezultat i kësaj duke iu drejtuar Allahut.

Hazreti Mevlana, i shpreh kështu baticat dhe zbaticat që janë në botën e brendshme të njeriut:

*“Ai që e komandon veten, është si Musa alejhisselam. Ndërsa trupi është Faraoni i tij. Ai që e komandon veten, e lë veten që e ka brenda*



*tij dhe fillon të kontrollojë jashtë se ku është armiku.”*

*“O udhëtar i Zotit! Nëse dëshiron të mësosh të vërtetën, as Musa e as Faraoni nuk kanë vdekur. Ata sot jetojnë brenda teje, janë fshehur në ekzistencën tënde dhe vazhdojnë të luftojnë në zemrën tënde! Për këtë arsye, këto dy vetë që janë armiq të njëri-tjetrit, duhet t'i kërkosh në veten tënde!*

Përsëri Hazreti Mevlana thotë:

*“Mos u mundo ta ushqesh trupin shumë, sepse ai është një kurban që në fund do t'i jepet tokës. Ti mundohu të ushqesh zemrën! Është ajo që do të ngrihet lart dhe që do të nderohet.”*

*“Trupit tënd jepi pak gjëra me vaj dhe me mjaltë, sepse ai që e ushqen tepër, bie në dëshirat vetjake dhe në fund poshtërohet.”*

*“Shpirtit jepi ushqime shpirtërore. Shfaqti atij mendim të pjekur, perceptim të mprehtë dhe ushqime shpirtërore, ashtu që të shkojë i fuqishëm në vendin ku do të shkojë.”*

Me të vërtetë, vetja është diçka dyanëshe e cila, kur edukohet e ngre njeriun në pozitën më të nderuar të krijesat, por kur nuk edukohet, i ndodh kundërta: e lëshon atë në fund të xhehennemit. Është pothuajse si një thikë me dy tehe të mprehura.

Çdo vete që është e privuar nga udhëzimi shpirtëror dhe kontrolli, është perde e një humbjeje të dhembshur që i mbulon të vërtetat me neglizhencë, por nëse njeriu shpëton nga morali i keq, paçka se e pengon vetja, nëse njeriu mund ta pastrojë veten dhe ta dëlirë zemrën, ai mund t'i kalojë edhe engjëjt të cilët nuk i pengon asgjë për t'u drejtuar te Allahu dhe te e mira, sepse nderi i një rezultati është i lidhur me vështirësitë që kapërcehen për ta arritur atë.

Prandaj themi se pastrimi i egos dhe purifikimi i zemrës është një domosdoshmëri për të gjelbëruar farërat e devotshmërisë (takvasë) dhe për të edukuar prirjen e natyrshme të njeriut për kah e keqja. Për këtë arsye, çdo njeri është i urdhëruar ta lartësojë dhe ta madhërojë Allahun me punë të mira, aq sa ka mundësi, ta njohë Atë dhe këtë informatë ta sjellë në gjendjen e dijes shpirtërore. Ja ky është “adhurimi”. Që ky adhurim të arrijë qëllimin e tij, kjo është diçka që lidhet me





pastrimin e vetes dhe me dëlirjen e zemrës, që do të thotë mbushje e njeriut me ndjenja të larta duke kapërcyer pengesat e vetes.

Pastrimi i vetes është një çështje e rëndësishme të cilën Allahu e ka theksuar duke u betuar herë pas here. Në suren Shems (dielli) thuhet:

**“PASHA diellin dhe dritën e tij! Pasha hënën kur vjen pas tij! Pasha ditën kur ai (dielli) e shëndrit! Pasha natën kur ajo e mbulon atë (dritën e diellit)! Pasha qiellin dhe Atë që e ndërtoi atë! Pasha tokën dhe Atë që e shtriu atë (e sheshoi)! Pasha njeriun dhe Atë që e krijoi atë dhe që ia mësoi se cilat janë të këqiat dhe të mirat. Pra, patjetër ka shpëtuar ai që e pastroi vetveten dhe ka humbur ai që e poshtëroi vetveten.”** (esh-Shems, 1-10)

Betimi i Allahut, në të vërtetë deklarimi hyjnor që shprehet pas betimit, përveç se tregon vlerën dhe nderin e atyre që betohen në të, ka për qëllim të tregojë madhështinë dhe rëndësinë e tyre. Edhe gjendja në këto ajete është e njëjtë, por ka vetëm këtë ndryshim:

Allahu betohet në këto ajete fisnike plotësisht dhjetë herë njëra pas tjetrës, pastaj, për të forcuar më shumë kuptimin, përdor pjesëzën “قَدَّ” (patjetër) dhe vetëm pas këtyre qortimeve dhe përforcimeve thotë:

**“Patjetër ka shpëtuar ai që e pastroi vetveten dhe ka humbur ai që e poshtëroi vetveten!..”**

Është interesante edhe kjo: që Allahu në Kur'anin Fisnik nuk betohet njëmbëdhjetë herë në mënyrë njëra pas tjetrës përveçse në çështjen e pastrimit të vetes. Kjo e vërtetë është e mjaftueshme për të treguar se sa i rëndësishëm dhe i domosdoshëm është pastrimi i vetes për shpëtimin e njeriut.

Pastrimi në tasavvuf është thyerja e sundimit të vetes mbi trupin, duke i pakësuar dëshirat e saj e duke siguruar kësisoj sundimin e shpirtit. Kjo mund të sigurohet vetëm me rrugën e rijadatit, domethënë me metoda të tilla si respekti ndaj normales në të ngrënë dhe në të pirë, në të fjetur dhe në të folur, me qëllim që këto ta forcojnë vullnetin kundra vetes. Për këtë arsye, në tasavvuf metoda për të frenuar veten është kiletu't-taam (të hash pak), kiletu'l-menam (të flesh pak) dhe



killetu'l-kelam (të flasësh pak), sepse këto janë hapat e parë të sundimit ndaj vetes. Megjithatë, si në çdo çështje tjetër, gjatë zbatimit të këtyre metodave nuk duhet ta lëmë normalen, sepse trupi është një amanet që Allahu ua ka dhënë njerëzve.

Në fakt, me luftën që bëhet kundra saj vetja nuk vdes por vetëm mund të merret nën kontroll. Ajo që kërkohet nuk është të shkatërrojmë veten, por t'i kufizojmë dhe t'i edukojmë dëshirat e pasionet e saj me ligjet e përshtatshme ndaj kënaqësisë hyjnore, duke e larguar nga gjërat e tepërta.

Edhe një çështje tjetër e rëndësishme krahas pastrimit të vetes, është që ta sjellim zemrën në një gjendje të pastër dhe të dëlirë. Nisur nga xhevahiri i saj i vërtetë, zemra është “vendi” ku shikon Zoti i madhëruar. Domethënë ka nderin për të qenë vendi që sheh Zoti, por siç nuk është e mundur që në fronin e një saraji të ulet dikush tjetër përveç sulltanit, edhe zemra që është saraji i gjithëçkaje duhet të pastrohet nga mendimet vetjake, nga pasionet e shëmtuara dhe nga gjërat e kësaj bote, përveçse nga Allahu. Në të kundërt, zemra mbyllet ndaj të mirave hyjnore, por kjo nuk do të thotë se nuk mund të dojë dikë tjetër përveç Allahut. Në të vërtetë, ata të cilët arrijnë në kulmin e zemrës së shëndoshë duke e pastruar veten dhe duke e dëlirur zemrën, janë liruar nga dashuria e gjërave të kësaj bote, por njerëzit e tjerë, nuk kanë mundur ta fshijnë plotësisht nga zemrat e tyre dashurinë ndaj pasurisë dhe fëmijëve. Në të vërtetë, kjo lloj dashurie është e lejueshme derisa të mos kalojë një kufi të caktuar.

Për të perceptuar rëndësinë e dëlirjes së zemrës, është e mjaftueshme të shikosh pozitën e zemrës në jetën materiale dhe shpirtërore. Pejgamberi ynë i Nderuar sallallahu alejhi ue sellem e ka shprehur kështu rëndësinë jetësore të zemrës:

*“...Njeriu në trupin e tij ka një copë mish. Nëse ajo copë bëhet e fortë dhe e devotshme, po ashtu i tërë trupi bëhet i mirë, nëse ajo bëhet e keqe, po ashtu i tërë trupi bëhet i keq. Kini kujdes, ajo është zemra.”* (Buhari, Iman, 39)

Hazreti Mevlana kuddise sirruhu, thotë se të mbushësh një thes pa ia mbyllur vrimën që ka në fund, është një punë boshe. Kështu edhe



veprat, vetëm kur të kryhen me një zemër të pastër dhe të dëlirë, mund të bëhen shkak për lumturinë e njeriut, sepse veprat janë të lidhura me nijetet dhe nijeti është një nga veprat e zemrës. Nisur nga kjo, është kusht që nijeti të rregullohet dhe të zbukurohet me sinqeritet.

Kjo është një gjendje që mund të fitohet vetëm si rezultat i edukimit shpirtëror që zbatohet si duhet. Pika që kanë për qëllim miqtë e Zotit në edukimin e zemrës, është që zemra të ketë një ndërgjegje për të qenë vazhdimisht me Allahun, që kështu të bëhet një zemër e gjallë. Që zemra të arrijë në këtë gradë, duhet të jetë e pastruar nga çdo gjë e kësaj bote, përveç Allahut.

Zemra e cila e arrin këtë gradë, i kupton të vërtetat delikate dhe të thella. Aq sa ç' bëhet e butë duke shpëtuar nga ashpërsia, zemra bëhet po aq një vend që reflekton emrat dhe të fshehtat hyjnore. Kështu fitohet marifetullah, që do të thotë ta njohësh Zotin me rrugën e zemrës. Kjo do të thotë se dija ka ardhur në gjendjen e dijes shpirtërore.

Ata që dalin para Allahut me zemër të shëndoshë, domethënë me zemër të pastër dhe të mbushur me dashuri hyjnore, me një zemër e cila është e pastruar nga të gjitha sëmundjet shpirtërore, do të shpëtojnë. Këtë Allahu e tregon kështu:

**“Atë ditën nuk bën dobi as malli dhe as fëmijët. Vetëm kush i paraqitet Zotit me zemër të shëndoshë.”** (esh-Shuara, 88-89)

Për të pasur një vete mutmain (të sigurtë, të bindur) dhe një zemër të shëndoshë si rezultat i pastrimit dhe i dëlirjes shpirtërore, ka disa kushte që duhen respektuar. Këto janë:

- a. Ushqimi hallall
- b. Istigfari dhe lutja
- c. Leximi i Kur'anit dhe zbatimi i ligjeve të tij
- ç. Kryerja e adhurimeve me hushu (frikërespekt)
- d. Shpenzimi në rrugë të Allahut
- e. Falja namaz natën
- f. Dhikri dhe meditimi



g. Dashuria ndaj të Dërguarit të Allahut sallallahu alejhi ue sellem dhe vazhdimi i salavateve fisnike

gj. Mendimi i vdekjes

i. Qëndrimi me të devotshmit dhe të singertët

j. Posedimi i moralit të bukur

Zemra e shëndoshë që fitohet si rezultat i të qëndruarit me seriozitet, duke i jetuar me përpjekje të gjitha këto kushte, ka ardhur në një gjendje pasqyre të pastër në të cilën shfaqen cilësitë e bukura të Zotit. Kur Allahu Teala shikon shfaqjet e cilësive të bukura në zemrën e robit, e do atë dhe kënaqet nga ai.

Zoti është krijuesi dhe zotëruesi i gjithçkaje. Për këtë arsye, Ai nuk ka nevojë për krijesat. Nuk ka asnjë lloj dhurate që mund t'i dërgohet, që të mos gjendet në thesarin e Tij. Ai është burimi i të gjitha të mirave dhe i të gjitha bukurive. Për këtë arsye, gjëja më e bukur dhe më e vlefshme të krijesat është një “zemër” e pastër dhe e dëlirë, e cila mund të bëhet pasqyrë e esmau'l-husna, domethënë e emrave të bukur të Allahut. Për këtë arsye, dhurata më e përshtatshme që mund t'i paraqitet Zotit, është “zemra e shëndoshë”, që Zoti i madhërishëm e do nga ne.

### *Tabllo të virtytshme*

I Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem, në minberin e xhamisë ua transmetonte ashabëve të nderuar herë pas here të gjitha fazat e luftës së Mutes. Fusha e luftës ishte përpara syve të Tij. Martirizimet që ndodhnin njëra pas tjetrës, luftën që ashabët e nderuar bënë, nga njëra anë me armikun dhe nga tjetra me djallin dhe vetet e tyre, i tregonte i mërzitur:

*“Zejd bin Harithe e mori flamurin në dorë. Shejtani menjëherë erdhi te ai. Këtë botë ia shfaqti të dashur, ndërsa vdekjen të shpifur dhe të keqe. Ndërsa Zejdi tha:*

*-Ky çast është një kohë kur besimtarët do të forcojnë besimin në*



*zemrat e tyre! Ndërsa ti kërkon të ma bësh të dashur këtë botë! Dhe përparoi. Hyri në luftë dhe ra dëshmor. Kërkoni nga Allahu falje për të.”*

Pastaj vazdoi:

*“Ai tani ka hyrë në xhennet dhe po vrapon! Pastaj flamurin e mori Xhaferi. Shejtani menjëherë shkoi te ai. Këtë botë deshi t’ia shfaqte të dashur, ndërsa vdekjen të shpifur dhe të keqe. Ndërsa Xhaferi tha:*

*-Ky çast është një kohë kur besimtarët do të forcojnë besimin në zemrat e tyre! Ndërsa ti kërkon të ma bësh të dashur këtë botë! Dhe përparoi. E sulmoi ushtrinë armike, luftoi me të, e në fund edhe ai ra dëshmor. Unë dëshmoj se ai ka rënë dëshmor.”<sup>113</sup>*

Më vonë tha:

*“Kërkoni falje nga Allahu për vëllain tuaj. Ai hyri në xhennet si dëshmor. Tashmë ai në xhennet fluturon si të dojë me dy fletë të ndritshme.”*

Pasi i Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem tha:

*“Pas Xhaferit flamurin e mori Abdullah bin Revaha!”* Heshti pak. Fytyrat e Ensarëve u zverdhën dhe u venitën, sepse filluan të mendojnë se Abdullah bin Revaha ka bërë diçka që nuk e ka pëlqyer Allahu dhe i Dërguari i Tij. Teksa Hazreti Abdullah në ato çaste mori flamurin dhe po përparonte mbi kalë drejt armikut, nga njëra anë luftonte me armikun, nga ana tjetër po mudohej të sundonte veten e pabindur:

*“O vetja ime! Unë jam betuar se do të të bëj të më bindesh. Këtë, ose pranoje me dëshirën tënde, ose do të të bëj ta pranosh me forcë! Po shoh se ti nuk e pëlqen shumë xhennetin! Ti nuk je gjë tjetër përveçse një pikë uji në torbën e trupit. O vetja ime! Nëse ti nuk do të writesh tani, a nuk do të vdesësh? Nëse vepron ashtu si bënë ata të dy*

113. Ibn Omer radijallahu anhumu thotë:

*“E kërkuam Xhaferin. Atë e gjetëm në mes të dëshmorëve. Ishte në një gjendje të tillë, sa që në pjesën e përparme të trupit të tij numëruam nëntëdhjetë e më shumë plagë shigjetash dhe heshtash. Asnjëra nga këto nuk kishte dalë prapa.”* (Buhari, Megazi, 44) Kur Xhaferi radijallahu anhu ra dëshmor, ishte tridhjetë e tre vjeç. (Ibn Hisham, III, 434)

dhe zgjedh martirizimin, ke bërë një punë të drejtë! Nëse vonohesh, do të jeshëfatkeq!”

Në këto momente Abdullahu radijallahu anhu u plagos në gisht. Ai zbriti nga kali dhe duke e vendosur gishtin e plagosur nën këmbë, lexoi një poezi që do të thotë:

“A nuk je ti vetëm një gisht që nxjerr gjak? Këtë aksident e ke pësuar në rrugë të Allahut!”, e tërhoqi shpejt dorën dhe e këputi gishtin që e kishte shtrënguar. Pastaj vazhdoi të luftojë. Kur në njërin anë ishte në xhihadin e vogël kundra armikut, në anën tjetër vazhdonte xhihadin e madh kundra vetes së tij:

“O vetja ime! Nëse shqetësohesh se do të jesh e privuar nga gruaja jote, ja atë e divorcove plotë tri herë. Nëse shqetësohesh se do të jesh larg robërve, edhe ata i lirove. Nëse shqetësohesh se do të ngelësh e privuar nga bahçeja dhe kopshti, edhe ato ia kam dhënë Allahut dhe të Dërguarit të Tij.”

Pejgamberi ynë i Nderuar sallallahu alejhi ue sellem vazhdoi të transmetojë fazat e luftës:

*“Abdullah bin Revaha e mbloodhi guximin e tij, po luftonte me armikun me flamur në dorë dhe ra dëshmor. (Ai për shkak të hezitimit) hyri në xhennet si hezitues!”*

Ensarëve u erdhi shumë rëndë që Abdullahu radijallahu anhu hyri në xhennet si hezitues dhe pyetën:

“O i Dërguari i Allahut! Kush ishte hezitimi i tij?”

Pejgamberi ynë i Nderuar sallallahu alejhi ue sellem tha:

*“Kur u plagos, u tërhoq nga lufta me armikun. Pastaj e qortoi veten, e mbloodhi guximin dhe ra dëshmor! Hyri në xhennet. Ata më janë treguar mua në xhennet mbi frone floriri. Pashë se froni i Abdullahut ishte më poshtë se i të tjerëve dhe ishte i shtrembër. Kur pyeta për shkakun, mu tha:*

*-Abdullahu, kur po shkonte të luftonte, shkoi të luftonte pasi kaloi disa hezitime!”*



Ensarët u kënaqën dhe u gëzuan që Hazreti Abdullah së fundi ra dëshmor dhe hyri në xhennet.

Të Dërguarit të Allahut sallallahu alejhi ue sellem që po i transmetonte këto, iu shtua mërzia dhe filluan ti rridhnin lot si perla nga sytë e Tij të bekuar. Pastaj tha:

*“Tani flamurin e Allahut e ka marrë në dorë një shpatë nga shpatat e Allahut. Në fund Allahu luftëtarëve të Islamit u dha çlirimin.”* (Shik. Buhari, Megazi, 44; Ahmed, V, 299; III, 113; Ibn Hisham, III, 433-436; Vakidi, II, 762; Ibn Sa'd, III, 46, 530; Ibn Esir, Usdu'l-Gabe, III, 237)

Domethënë vetja dhe shejtani nuk e lënë njeriun deri sa të vdesë. Atëherë duhet të jemi gjithmonë të zgjuar, të luftojmë dhe të strehoemi te mbrojtja e Zotit. Në ajetin fisnik thuhet:

**“Adhurojë Zotin derisa të të vijë jakini (vdekja)!”** (el-Hixhr, 99)



Hazreti Abdulkadir Gejlani, i cili ishte nga miqtë e mëdhenj të Allahut, pasi arriti përsosmërinë në dijet zahiri (e qarta), për të fituar “gjendjen asgjë”, pra për t’u mbrojtur nga egoizmi e nga mashtrimet e vetes dhe për ta mbrojtur zemrën nga çdo gjë që e largonte nga Zoti, për një farë kohe shkoi në rrethinat e vjetra të Bagdadit. Shah Nakshibend kuddise sirruhu, në vitet e para të hyrjes në tarikat, për të edukuar veten dhe për të arritur “gjendjen asgjë”, që është e kundërta e mburrjes dhe e mendjemadhësisë, u shërbeu njerëzve të sëmurë, të vuajturve, të vetmuarve, të plagosurve. Madje duke pastruar rrugën ku do të kalonin njerëzit, për plot shtatë vjet ai jetoi një jetë shërbimi të pashoq.

Ja vështirësia e pastrimit të vetes dhe shpërblimi i madh që jepet në kundërvlerë të saj...



Kur ishte në kulmin e dijes së asaj kohe, për të fituar afërsi me Zotin, Hazreti Imam Gazaliu jetoi për një kohë të gjatë në “gjendjen asgjë”, domethënë hoqi dorë nga të gjitha dëshirat vetjake.



Hazreti Imam Gazaliu e tregon kështu gjendjen e tij në kulmin e dijes:

“Unë merresha me dijet racionale dhe të shariatit. Kisha shumë nxënës. Mendova për gjendjen time. Pashë se isha i rrethuar nga pasione të ndryshme. Mendova për nijetin në dijen time. E gjeta veten jo të sinqertë për Allahun, por të përzier me dashurinë e pozitës dhe të famës. E kuptova plotësisht se jam në një gjendje shkatërruese dhe në qoshe të humnerës.

Atëherë ndodhi diçka. Gjashtë muaj ngela i hutuar, duke rënkuar dhe duke qarë në luginën e hutimit, mes dëshirave të kësaj bote dhe ahiretit, duke ikur nga kjo botë dhe nga ata që e duan. Zemra më vuan-te. Pashë dhe kuptova paaftësinë time. Pashë se vullneti dhe zgjedhja doli nga dora ime. Iu luta dhe iu përgjérova Allahut, duke qarë si një njeri i kapur nga një sëmundje e pashërueshme dhe pa rrugëdalje. Së fundi, siç thuhet në ajet:

**... Ai është i cili i përgjigjet nevojtarit (të mjerit) kur ai e thërrret, duke ia larguar të keqen...** (en-Neml, 62) Allahu Teala ma pranoi lutjen time dhe ma zgjoi zemrën. Dëshira për pasuri dhe pozitë m'u hoq. Ua ktheva kurrizin të gjithave. U mora me dhikrin, vetminë, ngujimin, përpjekjen, përgatitjen, pastrimin e vetes dhe me përsosmërinë e moralit. Me dije të sigurtë mësova se ata që shkojnë te Allahu dhe ata që janë udhëtarë të rrugës së udhëzimit, janë veçanërisht të mëdhenjtë e tasavvufit (misticizmit Islam). Karakterin dhe moralin më të bukur e kanë ata, sepse gjendjet e tyre të jashtme dhe të fshehta, janë marrë nga drita e profetësisë. Në tokë nuk ka një dritë përtej dritës së profetësisë.” (Shik. Gazali, el-Munkidhu mine'd-Dalal, Stamboll 1994, fq. 35-39)



Animi i sulltanit të Belhit Ibrahim bin Ed'hemit nga pastrimi i vetes dhe dëlirësia e zemrës, u realizuan si rezultat i një qortimi të tillë:

Një natë Ibrahim bin Ed'hemin e kish zënë gjumi mbi fron. Befas, në strehën e sarajit ndodhi një zhurmë e frikshme. Zërat dhe thirrjet shtoheshin dora-dorës, derisa më në fund e zgjuan sulltanin.

Sulltan Ibrahim bin Ed'hemi u ngrit menjëherë nga vendi dhe thirri





duke u kthyer kah streha:

“Kush është aty? Çfarë bëni nën strehë në këtë orë të natës?”

Nga streha erdhi një përgjigje:

“Po kërkojmë devenë që kemi humbur, o sulltani ynë!”

Ibrahim bin Ed’hemi bërtiti i zemëruar:

“A nën strehë kërkohet deveja, o njerëz të pamatur?!.”

Kësaj radhe përgjigja kishte natyrën e një udhëzimi shumë kup-timplotë:

“O Ibrahim! Ti e di se deveja nuk kërkohet në strehë, por a e di se Zotin nuk mund ta gjesh me rrobat e mëndafsha që ke veshur, me kurorën që ke në kokë, me kërbacin që ke në dorë dhe me fronin ku je ulur?!.”

Kjo ngjarje i shtoi shumë baticat dhe zbaticat shpirtërore që kishin filluar prej një kohe të gjatë në shpirtin e Ibrahim bin Ed’hemit. Ndodhia e la në një gjendje të hutuar dhe të pavendosur, por sulltani përsëri nuk mundi të shkëputej krejtësisht nga jeta e vjetër.

Por qortimi i dytë shpirtëror që ndodhi gjatë gjuetisë, pas së cilës ishte shumë i dhënë, e bëri Ibrahim bin Ed’hemin një udhëtar të vërtetë të Zotit. Ngjarje ndodhi kështu:

Një ditë Hazreti Ibrahim bin Ed’hemi kishte dalë për gjueti. Vrapoi pas një sorkadheje aq shumë, sa që u largua plotësisht nga ushtarët e tij. Kali kishte ngelur në gjak dhe djersë, por Ibrahim bin Ed’hemi ngaqë ishte i vendosur për ta vrarë sorkadhen, nuk ndalej. Në një farë çasti, teksa e pati zënë ngushtë sorkadhen, kafsha delikate dhe e bukur filloi të flasë:

“O Ibrahim! A për këtë je krijuar? A të ka krijuar Allahu për të më vrarë mua? Nëse do të më vrasësh mua, çfarë do të fitosh? Çfarë do të fitosh, përveç se more një jetë?”

Kur Ibrahim bin Ed’hemi dëgjoi këto fjalë, iu trondit aq shumë zemra sa u rrëzua nga kali. Filloi të vraponte drejt shkretëtirës. Pas një farë kohe, kur pa rreth e rrotull, në tërë atë shkretëtim të gjerë nuk pa



asnjë tjetër përveç një çobani. Menjëherë i shkoi pranë tij dhe iu lut:

“Të lutem merri këto xhevahirë, rrobat e padishahllëkut, armët e mia, kalin tim dhe më jep pelerinën që mban veshur! Mos i thuaj gjë askujt!”

E veshi pelerinën nën vështrimin e habitur të çobanit dhe iku. Çobani ngarendte pas tij dhe thoshte: Padishahu duhet të jetë çmendur! Por Ibrahim bin Ed’hemi nuk ishte çmendur, përkundrazi, i kish-te ardhur mendja. Ai kishte dalë për të vrarë sorkadhe, por Allahu Teala e gjuajti atë me një sorkadhe.

Nuk është e mundur ta rregullosh dhe ta pastrosh veten pa u përpjekur, veçanërisht duke bërë atë që dëshiron. Për ta sjellë atë në drejtimin që do Zoti dhe për të arritur paqen në ahiret, patjetër që duhet të bësh përpjekje serioze. Këtë mundim dhe përpjekje duhet ta fillojmë menjëherë pa humbur kohë, sepse vdekja mund ta kapë njeriun në çdo çast!..



Hazreti Nexhmeddin Kubra, i cili ishte nga miqtë e Zotit, po shoqëronte një xhenaze të një personi të devotshëm bashkë me nxënësit e tij. Kur po luteshin për të vdekurin, hazreti Nexhmeddin Kubra buzëqeshi. Nxënësit e tij u habitën që hoxha i tyre buzëqeshi në një moment të tillë dhe e pyetën për urtësinë e këtij gjesti. Hazreti nuk donte ta shpjegonte, por kur ata këmbëngulën, u përgjigj:

“Zemra e atij që po lutej për të vdekurin ishte e hutuar, ndërsa zemra e të vdekurit ishte e gjallë. U habita që një njeri indiferent lutej për një që e ka zemrën e gjallë.”

Një besimtar që e pastron veten dhe e dëlir zemrën e tij, vazhdon të jetojë edhe pasi të vdesë. Ata që nuk e bëjnë këtë, nuk kanë ndonjë dallim nga i vdekuri, paçka se jetojnë akoma.



Hazreti Mevlana Halid Bagdadi dhe disa shokë të tij kishin marrë rrugën për të vizituar Hazretin Abdullah Dehleviun. Pas një udhëtimi që



zgjati me muaj, së fundi arritën në Dehli (Xhihanabad). Transmetohet se ky udhëtim ka zgjatur një vit. Mevlana Halid i cili po priste me padurim të takohet me Hazretin Abdullah Dehleviun, shkoi bashkë me shokët në teqen e shejhut. Ata që ndodheshin pranë tij i thanë dervishit që u hapi derën:

“Haxhi Mevlana Halid Zijaduddin i cili është nga dijetarët e Sulejmanijes, Shamit dhe Bagdadit, bashkë me shokët e tij ka ardhur për të vizituar Hazretin e moshuar.”

Hazreti Abdullah Dehlevi i cili këtë vizitë në fakt e dinte shpirtërisht, tha:

“Halidi le të qëndrojë! Të tjerët le të shkojnë në vendet e tyre, pasi të rrinë si miq për një farë kohë!..”

Urdhëri u zbatua. Pastaj erdhi urdhëri i dytë:

“Halidi le të fillojë të pastroje vendin e abdestit në teqe!”

Por Mevlana Halid, edhe pse u trajtua si nxënës në këtë lloj mënyrë, në një kohë kur ende s'që takuar fare me Hazretin Shejh, edhe pse kishte një dije të gjërë sa deti, edhe pse ishte i famshëm në të gjithë botën Islame, nuk bëri asnjë kundërshtim. Mori kovën dhe fshesën në dorë dhe filloi të shërbejë.

Ujin që nevojitej për pastrimin e merrte nga një pus që ishte larg teqes. E mbushte ujin, e lidhte në majë të një shkopi dhe e mbartte mbi sup. Kësisoj, shkonte dhe vinte disa herë në ditë nga teqeja te pusi. Pastronte teqen dhe përgatiste ujin e abdestit. Kështu, ai ishte në një përpjekje dhe mundim të madh në rrugën për edukimin e vetes. Nëse vetja nuk kënaqej dhe turpërohej për shkak të shërbimit që bënte, menjëherë pendohej dhe kërkonte falje. Në këtë mënyrë kaluan muaj.

Një ditë ishte lodhur shumë duke pastruar gurët e banjos. Në ato caste vetja e gjeti të dobët Mevlana Halidin dhe filloi ti shkaktonte zemrës disa druajtje:

“O det i dijes së pashoq i vendeve të Bagdadit dhe Shamit! O Mevlana Halid i klimës së pasur! Je nisur me fjalën e dikujt që nuk dihet nëse është i çmendur apo mik i Zotit dhe duke kaluar shumë rrugë,



ke ardhur deri këtu. A e gjete atë që kërkoje? Shiko, këtu nuk ka as shejh dhe as tarikat! Ka muaj që kanë kaluar dhe çfarë të kanë dhënë, përveçse të pastrosh banjon natë e ditë? A kjo ishte dija hyjnore që kërkoje?..”

Hazreti Halid Bagdadi, i cili u befasua me frikë kundrejt këtij devijimi, e copëtoi menjëherë me rrufenë e sinqeritetit këtë perde që donte t’ia vendoste në sy vetja, kështu që e qortoi:

“O vetja ime! Nëse nuk e pranon si mirësi këtë detyrë të ndershme që më ka dhënë hoxha im i bekuar dhe nëse dëshiron të largohesh një çast, do të të bëj ta fshish vendin jo me fshesë por me mjekrrën time!..”

Hazreti Abdullah Dehlani po e vështronte nga larg duke buzëqeshur. Tashmë ai pa se kovën dhe fshesën e Mevlana Halidit, i cili zhduku edhe sulmet e fundit të vetes, kishin filluar t’i mbrartnin ëngjëjt. Veçanërisht kishte filluar të shkëlqente një dritë që zgjatej drejt për në qiell nga supet që ishin vlarë duke mbartur ujë deri atë çast. Hazreti i moshuar, i cili u kënaq shumë me këtë, e thirri këtë nxënës të veçantë të tij që të shkonte te ai dhe i tha:

“O biri im Halid! Në dije ke arritur një gradë të pashoqe, por ishte e nevojshme ta zbukuroje me ndjenja shpirtërore. Për këtë arsye e kishe të domosdoshme edukimin e vetes dhe pastrimin e zemrës. Përndryshe, vetja do të të shkatërronte duke të tërhequr zvarrë drejt kënetës së mburrjes dhe të mendjemadhësisë. Elhamdulillah që tani je ngritur në kulmin e përsosmërisë duke e vënë veten nën këmbë. Tashmë punën tënde e bëjnë ëngjëjt.” Dhe shtoi:

“O biri im! Të nderuarit tanë që ne ndjekim, janë njerëz që kanë pasur sheriatin, tarikatën, hakikatën dhe marifetin. Tani ti je bërë një hallkë e tyre si një muxheddid. Tashmë udhëzimi i të gjitha klimave të pret ty! Allahu ta lartësoftë nijetin!”<sup>114</sup>

Sado që të ketë dije, një vete jobindëse dhe e papastruar dhe një zemër e papastër, e padlirë, nuk është e mundur t’i udhëzojë njerëzit,

114. Muhammed bin Abdullah el-Hani, Adab, Përkth. Ali Hysrevoglu, Stamboll 1995, fq. 107-108; Hejet, Islam Alimleri Ansiklopedisi, Stamboll pa dt., Turkije Gazetesi Jaj. XVIII, fq. 81-82.



por pasi t'i kryejë këto dy kushte të rëndësishme, njeriu vjen në një gjendje të gatshme që të përfitojë shpirtërisht e të përfitohet prej tij shpirtërisht.



Hazreti i Dashur Muhammed Muhyiddin, në fillim i rekomandoi asgjënë nxënësit të tij Aziz Mahmudin, për shkak se ky vinte nga një detyrë gjykatësi të ndritshme, pas kësaj e caktoi të shiste mushkëri në tregun e Bursës, ndërsa më vonë e urdhëroi të pastronte edhe vendet e abdestit në teqe. Si rezultat i këtij edukimi, duke fituar një përsosmëri që drejtonte edhe padishahët, gjykatësi Mahmudi u cilësua “Hydaji” nga vetë hoxha i tij.

Një njeri, dëgjoi se Hazreti Hydaji kishte marrë dijen e alkimisë<sup>115</sup>, kështu që erdhi te Hazreti dhe i tha:

“O i Nderuar! Kam dëgjuar se ju keni marrë dijen e alkimisë, çfarë më thoni?”

Pa thënë asgjë, Hazreti Hydaji këputi tri gjethe nga dega e varur pranë tij dhe u fryu. Gjethet, me lejen e Allahut, u bënë gjethe floriri. Njeriu i shkretë që po e shikonte këtë ngjarje me habi, edhe pse bëri të njëjtën gjë, nuk ia doli mbanë. Hazreti Hydaji tha:

“O biri im! Dije se, të mësosh dijen e alkimisë, do të thotë të alkimosh veten...”

Qëllimi i jetës dhe i adhurimit nuk është të bësh mrekulli, por të bëhesh një mysliman i përsosur ,duke shpëtuar nga veset, përmes rrugës së pastrimit të vetes dhe dëlirjes së zemrës.



Sa bukur e tregon poeti dhe mendimtari i madh Muhammed Ikbali në një poezi të tij, rëndësinë e mbushjes së zemrës me dashuri, duke e pastruar veten:

Një natë, në librarinë time, dëgjova që një insekt i tha fluturës:

115. Simja: Dija që bën materiale të vlefshme nga materiale të pavlefshme, Alkimi.



“Jam vendosur në librat e Ibn Sinas. Kam parë librat e Farabiut. (Kam ecur ndërmjet rreshtave të thatë që nuk dinë të mbarojnë dhe shkronjave të venitura të atyre rreshtave e i kam shkatërruar. Nisur nga kjo, kam shëtitur rrugë më rrugë në el-Medinetu'l-Fadila të Farabiut, që do të thotë qyteti i virtyteve, por) nuk e kuptova filozofinë e kesaj jete. U bëra një udhëtar i trishtuar i këtyre rrugëve pakrye e plot ankth. Nuk kam një diell që të m'i ndriçojë ditët e mia...”

Flutura, duke iu përgjigjur insektit, i tregoi flatrat e djegura dhe i tha:

“Shiko!” “Unë i kam djegur flatrat e mia për këtë dashuri.” Pastaj vazhdoi:

“Ata që e bëjnë jetën më të gjallë, janë përpjekjet dhe dashuritë. Dhe ajo që e bën jetën me flatra, është dashuria!..”

Domethënë, duke i treguar insektit fletët e djegura, flutura po i thoshte me gjuhën e saj:

“Ti shpëto veten tënde që të mos shkatërrohesh në shtigjet pa rrugëdalje të kësaj filozofie! Fluturo për te takimi, duke marrë pjesë në detin e kuptimit të Mesnevisë, i mbushur me dashuri, ndjenjë shpirtërore dhe begati!..”

Ja pra! Për pastrimin e vetes dhe dëlirjen e zëmrës, duhet të kthehesh me një dashuri të thellë si flutura rreth diellit të ndjenjave shpirtërore, duhet të jetosh një jetë të mbushur me përpjekje dhe shërbim.



Hoxha i nderuar Mahir Iz e kuptoi se dija e privuar nga thellësitë shpirtërore është e mangët, dhe se zgjidhja e vetme për ta zhdukur këtë mangësi është udhëzimi shpirtëror, kështu që në vitet e fundit të jetës së tij ai shkoi në rrugën e edukimit shpirtëror. Ai e tregon kështu këtë gjendje të tij:

“Unë besoj se dituria e plotë arrihet nëpërmjet miqve të Zotit, sigurisht duke mos lënë pas dore edhe ndjekjen e saj me anë të studimit e të librit, por ama të mbledhësh të gjitha thashethemet e diturisë në mënyrë të pavarur është krejt e pamundur. Prandaj për të përshkuar shkallët e mija te vullnetit drejt miraxhit qiellorë të marifetit u lidha me



atmosferën shpirtërore të Samiut, kjo u arrit në mënyrë krejt intuitive, pa asnjë masë inteligjence.”<sup>116</sup>

Për të hapur krahët në qiellin e dijes shpirtërore, duhet t'i mbësh-tesim shkallët e dashurisë dhe të shërbimit në diellin e dijes shpirtërore dhe të ngjitemi ne to duke u përpjekur.



Së fundi, pastrimi i vetes dhe dëlirja e zemrës është një vepër që duhet të vazhdojë pandërprerje gjatë tërë jetës. Besimtari duhet të jetë gjithmonë i zgjuar kundrejt vetes së tij, asnjëherë nuk duhet të mendojë se ka arritur përsosmërinë dhe nuk duhet të mposhtet nga hilet dhe mashtrimet e vetes. Hazreti Mevlana në këtë çështje bën këto qortime:

*“Kjo vete e poshtër kërkon të të dërgojë te një fitim i përkohshëm. Deri kur do të merresh me këtë fitim të përkohshëm, të mjafton ajo me të cilën je marrë deri tani.”*

*“Kur vetja të jep premtime të reja për të mirë, i prish njëmijë herë ato premtime dhe pendime.”*

*“Nëse jeta të jep njëmijë vjet kohë, vetja jote çdo ditë gjen nga një pretext të ri.”*

*“Nëse vetja e poshtër kërkon nga ti një fitim shpirtëror, domethënë vepra të mira, kujdes, mos u mashtro, sepse pas asaj kërkese, ka një hile të armikut vete.”*

*“Vetja në dorën e djathtë ka tespitë dhe Kur'anin, por në mëngë ka të fshehur thikën dhe shpatën.”*



Tasavvufi i cili e shikon të domosdoshme pastrimin e vetes dhe dëlirjen e zemrës, është një oqean që nuk ka fund. Është një dije hyjnore që përfshin të gjithë gjithësinë. Ai nuk mund të përshkruhet siç duhet,

116. Mahir Iz, Jëllarën Izi, Stamboll 1975, fq. 396.



por gjithkush flet për të sipas kuptimit dhe perceptimit që ka.

Mistikët janë njerëz me cilësi të larta, si morali i bukur, bujaria, mëshira, njerëzia dhe modestia. Ata kalojnë mirë me të gjithë dhe shikojnë përpara me zgjuarsi dhe inteligjencë. Çdo lëvizje të tyre e kanë të përshtatshme ndaj ligjeve të Kur'anit Fisnik dhe moralit, edukatës dhe veprave të të Dërguarit të Allahut sallallahu alejhi ue sellem. Ata e duan Allahun Teala dhe të Dërguarin e Tij më shumë se jetën, pasurinë dhe fëmijët e tyre.

Allahu na bëftë të jetojmë një jetë adhurimi në këtë mënyrë dhe na mundësoftë përdorimin e kapitalit të jetës në formën më të bukur me të cilën do të kënaqet!..

O Zot! Zbukuroi zemrat tona me dashurinë e besimit! Na bëj prej atyre të cilët e shikojnë të keqen e kufrit dhe mëkatit dhe që largohen siç duhet prej tyre. Na mundëso që të bëhemi një Kur'an i gjallë duke marrë nga morali profetik, dhe një jetë she-mbullore të virtytshme në mirësi! Jepu zemrave tona pjesë nga dashuria Jote! Na bëj të përshtatshëm ndaj fjalës Tënde “Robërit e Mi!” të mbushur me dashuri dhe nder, dhe ndaj lavdërimit “Vëllezërit e Mi!” të të dashurit Tënd! Na mundëso që të edukojmë breza të virtytshëm që do të luten për ne pas nesh dhe që do të jenë drita e syve në të dy botërat!.

O Zot! Ruaje atdheun dhe popullin tonë nga mosbesimi dhe imoraliteti! Na mundëso që të jetojmë një jetë xhenneti, duke iu përshtatur madhësisë së vërtetë të Kur'anit Fisnik dhe të shërbejmë për dobinë e vazhdimit të brezit të virtytshëm të Kur'anit!..

Amin!..







## FJALOR

### -A-

**âbâd**: I begatë, gazmor, i hareshëm,  
**âbid**: Adhures, asket  
**axhz, axhzijet**: Paaftësi, pazotësi, dobësi  
**âfâk**: 1. Horizonte, 2. Kufinj të mendimit,  
3. Bota e jashtme.

**agnija-i shakirin**: Të pasurit që e  
falenderojnë Allahun dhe të cilët e  
shpenzojnë pasurinë e tyre sipas  
kënaqësisë hyjnore.

**ahvâl**: (shumësi i hâl) 1. Gjendje,  
2. gjendje shpirtërore në tasavvuf.

**alejhimesselâm**: Paqja dhe bekimi i  
Allahut qoftë mbi ata të dy.

**alejhissalatu uesselam**: Paqja dhe  
bekimet e Allahut qofshin mbi të.

**alejhisselam**: Paqja e Allahut qoftë mbi të.

**âli**: I lartë, i madhërueshëm, i madh.

**âlixhenap**: 1. Bujar, 2. I ndershëm

**âmâde**: I gatshëm, ai që pret urdhëra

### -B-

**basîret**: Largpamësi, tejpamësi, perceptim.

**bediî**: I bukur, bukuri.

**belâgat**: Shkenca e rregullave të letërsisë.

**bende**: Rob, skllav, simpatizant.

### -E-

**ebedi**: I përhershëm, i pafund.

**ef'al**: vepra, sjellje.

**el-Emin**: Besnik, i besueshëm, cilësia e të  
Nderuarit tonë sallallahu alejhi ue  
selem dhe e Xhebrailit alejhisselam.

**enbija**: Profetë, pejgamberë.

**esfeli safilin**: Niveli më i ulët i karakterit,  
niveli më i ulët i xhehennemit.

### -F-

**Fahri kainat**: Burimi i Krenarisë së  
gjallesave, Hazreti Pejgamber  
sallallahu alejhi ue selem.

**farik(farika)**: Dallues.

**fitrat**: Krijim, natyrë.

**fuxhur**: Mëkat.

### -H-

**halef**: Dikush që vjen pas dikujt, kalim në  
vend të tjetrit.

**hashr**: Mbledhja e të vdekurve, pasi të  
ngjallen në ditën e gjykimit për të  
dhënë llogari.

**husul**: Të shfaqesh, të dalësh në pah.

**hushu**: Frikërespekti ndaj Allahut, modesti.

### -I-

**idrak**: Kuptim, perceptim, konceptim.

**iftihar**: Mburrje, lavdërim, krenari, famë,  
nder.

**iltixha**: Kërkim strehimi, siguri.

**imdad**: Ndihmë.

**imtisal**: Të bësh të duhurën, të veprosh  
sipasnjëshëmbulli, t'ibindeshurdhërit.

**in'ikas**: Reflektim.

**intikal**: Kalimi nga një vend në tjetrin, të  
ndërrosh vend.

**irade**: Vullnet, dëshirë, vullnet për të  
dëshiruar dhe vepruar.

**irshad**: Të tregosh rrugën e vërtetë.

**irtidad**: Të dalësh nga feja Islame.

**istidad**: Aftësi, mendje, kuptim.

**istinga**: Të bindesh ndaj së pakut,  
ngopje.

**ishtigal**: Preokupim, mundim, përpjekje.

**iz'an**: Kuptim, perceptim, bindje,  
edukatë.

### -K-

**kaim**: Ai që është në këmbë, shkaku që e  
bën të mundur diçka.

**karakter**: Karakter.

**katre**: Pikë.

**kifajet**: Mjaftueshmëri.

### -L-

**lahuti**: Diçka që ka të bëjë me botën hyjnore.

**likaullah**: Takimi me Allahun xhelle  
xhelaluhu.

### -M-

**madhhar**: I sukseshëm, realizues.



**mefnun** : I dhënë, i kushtuar.

**melahat** : Bukuri, ëmbëlsi.

**menfi** : Negativ.

**mesabe** : Vlerë, gradë, shkallë.

**mes'ulijet** : Përgjegjësi.

**mejl** : Anim, dashuri.

**mezmum** : I poshtëruar.

**minval** : Rugë, stil, formë.

**muahede** : Marrëveshje zyrtare.

**muamele** : Sjellje, trajtim.

**muhten** : I prishur, i përzier.

**mukteza** : Gjëra të nevojshme, rezultate.

**mulahadha** : Të mendosh me kujdes dhe hollësishtëm, të shikosh me kujdes.

**mushahas** : I formuar, diçka që është në gjendje që mund të shihet dhe preket.

**muteessir** : I prekshëm, i mërzitur, i ndikueshëm.

**mutevekkil** : Mbështetës, ai që i beson dhe i mbështetet Allahut.

**muttaki** : I devotshëm, ai që rri larg mëkateve për shkak se ka frikë Allahun dhe e do Atë.

**-N-**

**name** : Letër, letër ose shkrim zyrtar.

**nazargah-ëilahi**: Vendikushikon Zoti, zemra.

**nazarijat** : Mendime, teori.

**nazil** : Ai që zbret.

**nexhib** : Fisnik, i pastër.

**nehj** : Ndalesë, të ndalosh nga gjërat që i ka ndaluar feja.

**neseb** : Soj.

**nishane** : Shenjë, gjurmë.

**-P-**

**pervane** . Flutur nate që sillet rreth dritës.

**perverde**: Njeri i ushqyer, irritur me edukatë.

**pejda** : E qartë, e hapur, në pah, ashiqar.

**-R-**

**radijallahu anhu** : Allahu qoftë i kënaqur prej tij.

**radijallahu anha** : Allahu qoftë i kënaqur prej saj.

**radijallahu anhum exhmain**: Allahu

qoftë i kënaqur prej të gjithë atyre.

**radijallahu ahnum**: Allahu qoftë i kënaqur prej tyre.

**ram olmak** : Të bindesh, të nënshtrohesh,

lidhja e robit me Allahun me të tërë qënien e tij.

**rasulu'th-thekalejn** : Pejgamberi i të dy botërave, të njerëzve dhe të xhindëve.

**riajet** : Nder, nderim, sjellje e përshtatshme, respektim.

**rida** : Mbulesë që vihet në supe.

**rikkat** : Butësi, njerëzi, mëshirë.

**risalet** : Profetësi.

**-S-**

**saik** : Shkak, motiv, nxitje.

**sallallahu alejhi ve sellem** : Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të.

**sehavet** : Bujari.

**selaset** : Hapje, aheng, lehtësim.

**sima** : Fytyrë, person, personalitet, tip.

**-Sh-**

**shahsijet** : Personalitet.

**shexhaat** : Trimëri.

**shiar** : Shenjë, gjurmë.

**shuju** : Përhapje, shpërndarje.

**-T-**

**tabi olmak** : Të bindesh, të lidhesh, të mish në ndikimin e dikujt.

**takva** : Devotshmëri, devocion, frika ndaj Allahut.

**teba** : Atdhetar, popull.

**tebxhil** : Lartësim, madhërim, respekt.

**texhelli** : Shfaqje, kader, fat, të fitosh mirësinë e Allahut.

**tedai** : Pajtim mendimesh.

**teemmul** : Të mendosh mirë, meditim.

**teeththur** : Ndikim, të ndjesh dhimbje.

**tekamul** : Zhvillim që formohet gradualisht, tëndryshosh formë dhe të zhvillohesh, të arrish përsosmërinë, pjekuri.



**telakki** : Të pranosh, kuptim, perceptim personal.  
**temajul** : Të anosh nga një anë, të interesohesh.  
**tenezzul** : Zbritje, ulje.  
**teselsul** : Ardhja njëra pas tjetrës, ndjekje.  
**teskin** : Qetësim, ndalim.  
**teshkil** : Formim, të nxjerrësh diçka në pah.  
**teshrif** : Nderim, të nderosh.  
**tevazu** : Modesti.  
**tevzi** : Shpërndarje, t'i japësh gjithkujt atë që i takon.  
**tezahur** : Shfaqje, dalje në pah.  
**tezkije** : Pastrimi i vetes nga çdo lloj cilësie e keqe.

-U-

**uxhub** : Pëlqim i vetes, mburrje, krenari.  
**uful** : Vdekje.  
**uhrevi** : Gjëra në lidhje me ahiretin.  
**ukubet** : Shkatërrim, fatkeqësi, ndëshkim, poshtërim.  
**ulvi** : I lartë, i madhërueshëm.

-V-

**vuslat** : Të arrish diçka, takim, takimi me të dashurin.

-Xh-

**xheddu'l-Hasenejn** : gjyshi i Hasani dhe i Hysejnit radijallahu anhuma.  
**xhehri** : Hapur, me zë.  
**xhemali sifati** : Cilësitë që tregojnë për mëshirën dhe butësinë e Allahut.  
**xhemali** : Në lidhje me cilësitë e bukura të Allahut.  
**xhuruf** : Zgjyrë, bramcë.

-Z-

**zahid** : Akset.  
**zeval** : Shkatërrim, vdekje, poshtërim.  
**zuht** : Asketizëm.



## PERMBAJTJA

PARATHENIE.....	5
-----------------	---

### PJESA I.

#### BESIMI dhe ADHURIMI / 13

1. Përjetimi i Besimit me Dashuri.....	15
2. Sinqeriteti .....	39
3. Devotshmëria.....	53
4. Pendimi dhe Kërkimi i Faljes.....	63
5. Bindjandaj Urdhërave të Allahut dhe të të Dërguarit të Tij.....	73
6. Përpikmëria në Adhurime.....	86
a. Adhurimet Nafie (Vullnetare).....	97
b. Frekuentimi në Xhemat.....	105
c. Adhurimi i Natës.....	118
ç. Lutja dhe Përgjërimi.....	129
d. Hushu-ja (Bindja me frikërespekt ndaj Allahut).....	147
7. Të Jesh Në Një Gjendje Me Kur'anin Fisnik.....	155
8. Përkujtimi i Allahut dhe Salavatet Fisnike.....	170
9. Shqetësimi i Frymës së Fundit / Të Parapërgatitësh për Vdekjen dhe për Pasvdekjen.....	185

### PJESA II.

#### PERSONALITETI DHE VENDOSMERIA SHPIRTERORE / 205

1. Dashuria.....	207
------------------	-----



a. Dashuri ndaj Allahut (Muhabbetullah).....	208
b. Dashuri ndaj të Dërguarit të Allahut.....	223
c. Dashuria Ndaj Vëllait në Fe.....	265
ç. Dashuria Ndaj të Gjithë Krijesave.....	274
2. Frika dhe Shpresa ndaj Allahut.....	288
3. Madhërimi.....	305
4. Mbajtja e Amanetit dhe Premtimit.....	322
5. Besnikëria.....	335
6. Aprovimi i Gjendjes.....	346
7. Mbështetja dhe Dorëzimi ndaj Allahut.....	357
8. Mirësia (ihsani) dhe Mbikqyrja.....	373
9. Modestia.....	383
10. Butësia dhe Toleranca.....	402
11. Të Mendosh Mirë për të Tjerët.....	413
12. Bujaria dhe Zemërgjërësia.....	420
13. Bindja dhe Istignaja.....	439
14. Të Jesh Asket Kundrejt Kësaj Bote.....	453
15. Durimi dhe Vendosmëria.....	469
16. Hamdi dhe Shukri (Falenderimi).....	480
17. Trimëria.....	492
18. Istikameti.....	504
19. Mirënjohja dhe Besnikëria.....	511
20. Nderi dhe Turpi.....	525
21. Mendjemprehtësia dhe Inteligjenca.....	538
22. Pastrimi i Vetes dhe Dëlirja e Zembrës.....	553

